

UNIVERSITETI I SHKODRËS “LUIGJ GURAKUQI”

INSTITUTI I STUDIMEVE ALBANOLOGJIKE

DEPARTAMENTI I LETËRSISË

DEPARTAMENTI I GJUHËSISË

MARTIN CAMAJ
PËR KULTURËN SHQIPTARE.
SHKRIMTARI DHE
ALBANOLOGU

Në 85-vjetorin e lindjes

Studime shqiptare 17

Shkodër, 2011

Këshilli shkencor:

Prof.dr. Artan Haxhi
Prof.dr. Tomor Osmani
Prof.as.dr.Ledri Kurti
Dr. Mimoza Priku
Prof. dr. Alfred Çapaliku
Prof.as.dr. Tefë Topalli

Redaktuan dhe përgatitën botimin:

Prof.dr. Tomor Osmani
Prof.as.dr.Ledri Kurti
Dr. Mimoza Priku

ISBN 978-9928-4011-3-7

© Copyright:

Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”

Korrektoi dhe faqosi: Arta Bajrami

Me rastin e 85-vjetorit të lindjes së shkrimtarit Martin Camaj, më dt. 26 korrik 2010 u organizua konferenca shkencore “*Martin Camaj për kulturën shqiptare. Shkrimtari dhe albanologu.*”

Pas hapjes së konferencës nga prof.dr. Tomor Osmani, përshëndetën prof.as.dr. Fatmir Vadahi në emër të Rektoratit të Universitetit, dr. Erika Camaj, bashkëshortja e M.Camajt, z. Ndue Sanaj, kryetar i Shoqatës “Atdhetare Dukagjini”, prof.as.dr. Gjovalin Kolombi, kryetar i Këshillit të Qarkut të Shkodrës dhe prof.dr. Ardian Marashi, drejtor i Qendrës Albanologjike në Tiranë.

Referatin “*Martin Camaj, krijues dhe dijetar*” e mbajtën prof.as.dr. Ledri Kurti dhe dr. Mimoza Priku.

Pastaj konferenca i vazhdoi punimet në dy seksione: në atë të letërsisë dhe të gjuhës

Në fund prof. dr. Bardhyl Demiraj bëri paraqitjen e botimit “Ne jemi të tutë”, ku janë përfshirë studime për nder të Martin Camajt.

Ky aktivitet u mbështet nga Universiteti “Luigj Gurakuqi” i Shkodrës dhe Shoqata “Atdhetare Dukagjini”.

* * *

Në këtë botim janë përfshirë materialet e kësaj konference.

PASQYRA E LËNDËS

Fjala e hapjes: prof. dr.Tomor OSMANI

Përshëndetjet:

**Prof.as.dr. Fatmir VADAHI, Zv.Rektor i Universitetit të Shkodrës
“Luigj Gurakuqi”;**
Erika CAMAJ (bashkëshortja e autorit);
Ndue SANAJ, Kryetari i Shoqatës “Atdhetare-Dukagjini”.

Ledri KURTI, Mimoza PRIKU (Referat)

Martin Camaj – shkrimtari dhe dijetari
Martin Camaj - writer and scholar.....19

Fatbardha HOXHA (Shkodër)

Martin Camaj njeriu, poeti, dijetari, midis vatrës dhe botës dhe novela
“Gjon Gazulli”
*Martin Camaj man, poet, scholar, and between focal and the world &
Novella "Gjon Gazulli*.....29

Ledri KURTI (Shkodër)

Drama apo tekste të dramatizuara: “Loja e mbasdrekes” dhe “Kandil
argjandit”
*Drama of Martin Camaj as a new experience of this artistic
gender*.....37

Zef GJETJA (Tiranë)

Trajtimi i vendlindjes në veprën e Martin Camajt
Native treatment in the work of Martin Camaj.....55

Behar GJOKA (Tiranë)

Gegnishtja - mallkimi dhe lavdia e Camajt
Gegnishtja curse and the glory of Camaj.....67

Alma HAFIZI (Shkodër)	
Relativizmi i Camajt në novelën “Jasminë”	
<i>Camaj in novel relativism "JESMINË</i>	81
Vjollca OSJA (Tiranë)	
Çështje të tipologjisë së llojit të madrigalet “Dranja”	
<i>The typology issues of genre in Dranja’sMadrigal</i>	89
Ledia DUSHI (Tiranë)	
Martin Camaj, larg dhe afër Shqipërisë	
<i>Camaj near and far Albania</i>	95
Baviola SHATRO (Durrës)	
Poezia si botëkrijim dhe estetika e ripërmasimit të kohë-hapësirës	
<i>Poetry as world-creation and aesthetics resizing of space-time</i>	101
Shaban SINANI (Tiranë)	
Refuzimi si dukuri e qëndrueshme në jetën dhe në veprën e Martin Camajt	
<i>Refusal as a stable occurrence in Martin Camaj’s life and work</i>	113
Valbona KARAKAÇI (Shkodër)	
Dukuri të letërsisë së izoluar nën vëzhgimin e Martin Camës	
<i>Occurrence of an isolated literature under Camaj’s criticism</i>	135
Laura SMAQI (Tiranë)	
Camaj - shkrimtari ideal në vizionin e Koliqit	
<i>Camaj – the ideal writer according to the Koliqi’s vision</i>	143
Arben PRENDI (Shkodër)	
Marrëdhënie të poezisë së Camajt me folklorin dhe letërsinë gojore shqiptare	
<i>The Relation of Camaj’s poetry to the folklore and the Albanian oral literature</i>	151
Viola ISUFAJ (Tiranë)	
Poezitë e Martin Camajt – rebus figurativ	
<i>Camaj poems - Visual conundrum</i>	159

Alva DANI & Lindita Kazazi (Shkodër)	
Dimensioni perëndimor i shkrimtarit dhe i albanologut	
<i>The Western dimension of the writer and scholar.....</i>	173
Ermira ALIA (Shkodër)	
Camaj në një këndvështrim pedagogjik	
<i>On a brighter Camaj education.....</i>	181
Elinda RAMADANI (Shkodër)	
Romani “Djella”- Gërshetim intertekstual midis prozës dhe poezisë	
<i>Romani "Djella". " Intertekstual weaving between prose and poetry.....</i>	189
Kolec TOPALLI (Tiranë)	
M. Camaj dhe albanologjia e gjymtuar	
<i>M. Camaj and disabled albanologjia.....</i>	201
Tomor OSMANI (Shkodër)	
Konsiderata gjuhësore të Martin Camajt për gjuhën letrare shqipe	
dhe ndihmesa e tij për një afrim ndër dialektor	
<i>Martin Camaj language considerations for albanian literary language</i>	
<i>and his contributions for a interdialectal rapprochement.....</i>	207
Adelina ÇERPJA, Emil LAFE (Tiranë)	
Sistemi foljor te vepra “Lehrbuch der albanischen sprache” dhe	
“Albanian Grammar with Exercises, Chrestomathy and Glossaries” të	
Martin Camajt	
<i>The verbal system in the books of Martin Camaj “Lehrbuch</i>	
<i>der albanischen sprache” and “ Albanian Grammar with Eercises,</i>	
<i>chrestomathy and glossaries”.....</i>	215
Gjovalin SHKURTAJ (Tiranë)	
Martin Camaj – figurë e shquar e albanologjisë dhe e letërsisë shqiptare	
<i>Martin Camaj – a well-known figure of the Albanian albanology</i>	
<i>and literature (Values, appreciations and memories).....</i>	233

Bardhyl DEMIRAJ (Gjermani)	
Jeta akademike e Martin Camajt	
<i>Martin Camaj's academic life</i>	243
Mimoza PRIKU (Shkodër)	
Rreth disa ndërtimeve e kuptimeve foljore në veprën e Martin Camajt	
<i>About some verbal constructions and meanings in Martin Camaj 's prose</i> ..	255
Tefë TOPALLI (Shkodër)	
Një vepër gjuhësore e panjohur, në dorëshkrim, e Martin Camajt	
<i>A work linguistic unknown Manuscript, Martin Camaj</i>	265
Evalda PACI (Tiranë)	
Pikëpamje të Martin Camajt për “Mesharin” (vështrim filologjik dhe	
testologjik mbi librin e parë në gjuhën shqipe)	
<i>Views of M. Camaj for "Mesharin" (look philological</i>	
<i>and testologjik on the first book in Albanian)</i>	271
Ina ARAPI (Austri)	
Pasuri leksikore të “Njeriu më vete e me tjerë” i Martin Camajt	
<i>The vocabulary of "The man on his own and with others"</i>	
<i>by Martin Camaj</i>	281
Rrezarta DRAÇINI, Esmeralda HOTI (Shkodër)	
Dimensioni psikolinguistik tek “Pishtari i Natës” i Martin Camajt	
<i>The psycholinguistic dimension of "Torches of the Night" of Martin</i>	
<i>Cama</i>	297
Matilda PARLLAKU (Tiranë)	
Sintaksa e Martin Camajt si pasuri gjuhësore e shqipes	
<i>Martin Camaj syntax as wealth of Albanian language</i>	307
Anisa KOSTERI (Shkodër)	
Disa veçori dialektore në romanin “Rrathë” të Martin Camajt	
<i>Some features of the novel dialect "Rrathë" of M. Camaj</i>	321

Irida HOTI (Shkodër)	
Martin Camaj në tekstet shkollore	
<i>Martin Camaj in school textbooks.....</i>	329
Aida URUÇI (Shkodër)	
Çështje të fjalëformimit në veprën “Dranja-Madrigale mbi fatin e një frymori të papërsosun” të Martin Camajt	
<i>The matters in the work "Dranja-Madrigal" on the fate of a non-perfect human" by Martin Camaj.....</i>	343
Orjeta DUSHI – Teuta ÇOKU (Shkodër)	
Konsiderata rreth sistemit foljor të një vepre letrare të Martin Camajt	
<i>Considerations on the verb system of a literary writing of Martin Camaj...358</i>	
Alketa KRAJA, Valbona SAKAJ, Albana KALOSHI (Shkodër)	
Fenomeni i mënjanimin të së ashtuquajturës nyje e përparme te Camaj	
<i>The phenomenon of avoiding of the so-called frontarticles in the Camaj's works.....</i>	365
Arjola HOTI –Aimir OSMAN (Shkodër)	
Risite në gramatikën e vitit 1984 të Martin Camajt	
<i>Innovations in Albanian grammar M. Camaj</i>	371
Majlinda BUSHAJ (Shkodër)	
Letërkëmbimi i Martin Camajt me Gjon Sinishtën	
<i>Correspondence Martin Camaj with Gjon Sinishtën.....</i>	379

Fjala e hapjes e prof.dr.Tomor Osmanit

E nderuara zonja Camaj,

Të nderuar autoritete vendore dhe pjesëmarrës,

Një nder i veçantë për universitetin tonë është që sot kremtojmë në një konferencë shkencore, me një pjesëmarrje të gjerë studiuesish nga Shkodra, Tirana, Durrësi, Gjermania, Austria etj. 85-vjetorin e lindjes së shkrimtarit dhe filologut, shkodranit nga Temali i Dukagjinit Martin Camaj, që në të kaluarën moniste emri i tij mbeste si legjendë, por shpejt pas viteve 90 filloi të trokasë në dyert e shqiptarëve nga Veriu dhe nga Jugu, duke u bërë një personalitet i dashur, i nderuar dhe i respektuar. Martin Camajn e njohu Evropa dhe Amerika, por jo Atdheu i tij, Shqipëria, e vlerësoi gjuhësia kontemporane evropiane, por jo gjuhësia shqiptare, botoi jashtë, por jo në Shqipëri.

Do të jetë Universiteti ynë që 17 vjet më parë, me rastin e 1-vjetorit të vdekjes së Martin Camajt, më 24 qershor 1993 që do të çelë veprimtaritë e para shkencore në rrethanat e reja politike pas përmbysjes së regjimit komunist, me një veprimtari të gjerë shkencore për birin e saj Martin Camajn. Kjo konferencë me titullin simbolik “Martin Camaj - tradita dhe bashkëkohësia”, hapi siparin për të kujtuar dhe vlerësuar edhe figura të tjera të kulturës shqiptare, si Gjergj Fishtën, Ernest Koliqin, Justin Rrotën etj. Njëkohësisht me këtë botim të përmbledhjeve të punimeve të kësaj konference u hap edhe kolana “Studime shqiptare” prej së cilës janë botuar deri tashti 16 numra.

Shkodra nuk e la me kaq Martin Camajn. Iu dha titulli Profesor Nderi nga Universiteti ynë. U krijua shoqata kulturore “Camaj-Pipa”, e drejtuar nga pedagogu Hasan Lekaj që filloi t'i japë lexuesit disa nga krijimet e shkrimtarit Martin Camajt. Botimi i veprave të Camajt eci edhe më tej, duke u botuar edhe

vepra të tjera, një përmbledhje prej 5 vëllimesh dhe së shpejti vepra letrare e Camajt do të botohet në 10 vëllime.

Martin Camaj, kjo figurë poliedrike, sa shkrimtar, aq edhe gjuhëtar i la trashëgim kulturës shqiptare vepra me vlera të veçanta letrare, por edhe shkencore jo vetëm të traditës, por edhe të bashkëkohësisë shqiptare.

Ka të drejtë të krenohet Shkodra me Martin Camajn, i cili ndonëse larg atdheut prej afro gjysmë shekulli, nuk e harroi Shkodrën, gjeti vend në krijimtarinë e tij të kujtojë atë natyrë përrallore dhe magjepse të saj, por mbi të gjitha duke përdorur një gegërishte letrare, të pasur, tingulluese, plastike dhe të zhdërvjelltë.

Sot më shumë se kurrë vepra e Camajt po studiohet me vlerat e vërteta letrare dhe shkencore, duke i dhënë Martin Camajt vendin që i takon në historinë e letërsisë dhe të gjuhësisë shqiptare. Por lexuesi dhe studiuesi shqiptar pret studime dhe monografi të tjera që të afirmojë Camajn e madh me përmasa të veçanta dhe patjetër ky 85-ujëtor do të plotësojë një dëshirë të tillë. Gjithashtu rreth 40 kumtesa që do të mbahen në këtë konferencë, në dy sesione në atë të letërsisë dhe të gjuhës do të sjellin një informacion të ri dhe fakte të panjohura deri tashti për veprën dhe jetën e shkrimtarit Martin Camaj, që autorët paraprakisht i falënderojmë për punën që kanë bërë. Po kështu edhe paraqitja që do të bëjmë në fund të kësaj konference të botimit prej 600 faqesh kushtuar kryesisht veprës së Camajt, do të ndriçojnë disa nga momentet më të rëndësishme të veprës së albanologut M. Camaj. Martin Camaj, ky intelektual i formuar, shkrimtar dhe gjuhëtar, albanolog, me dëshira të gjithanshme për të kontribuar në zhvillimin e kulturës shqiptare, radhitet në plejadën më të zgjedhur të shkrimtarëve dhe të gjuhëtarëve tanë.

Duke falënderuar edhe një herë zonjën Camaj për pjesëmarrjen në këtë konferencë shkencore-jubilarë dhe të ftuarit, ia jap fjalën e përshëndetjes zv. rektorit prof. as.dr. Fatmir Vadahi.

Ju faleminderit!

***Fjala e përshëndetjes, mbajtur nga Zv. Rektori i
Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi”,
prof.as.dr. Fatmir Vadahi***

*Të nderuar pjesëmarrës: pedagogë, studiues dhe studentë.
Të respektuar dashamirës dhe njohës të veprës albanologjike të
shkrimtarit Martin Camaj!*

*Kam kënaqësinë që, në emër të Rektoratit të Universitetit
“Luigj Gurakuqi” të përshëndes veprimtarinë shkencore
përkujtimore të Fakultetit të Shkencave Shoqërore, të Qendrës
kërkimore-shkencore albanologjike dhe të departamenteve të
Letërsisë dhe të Gjuhës shqipe, kushtuar njëres prej figurave
tashmë të njohura të kulturës shqiptare, shkrimtarit, poetit,
studiuesit dhe albanologut Martin Camaj, me rastin e 85 –
vjetorit të lindjes.*

*Martin Camaj, si pak të tjerë: Koliqi, Pipa, Resuli,
Repishti, rreshtohet ndër ata dijetarë që, ndonëse në mërgim,
gjithë jetën ia kushtuan letrave shqipe, duke na lënë vepra të
shënuara në fusha të ndryshme, si në gjuhësi, letërsi, histori dhe
sociologji e duke dhënë një ndihmesë të dukshme në njohjen e
popullit tonë dhe identitetit të tij. Me një bazë kulture të themeltë,
të fituar në vitet e para të jetës në Seminarin Papnor të qytetit
tonë, Camaj plotësoi dhe u thellua në studimet e veta nëpër
universitete të huaja, nga Beogradi, Roma dhe Mynihu, duke lënë
gjurmë sa në shkencat albanologjike, edhe në krijimtarinë letrare
artistike. Ai ishte përherë yni, siç e theksonte në prag të ndarjes
nga jeta më 1992 dhe ne ishim të tijtë. Trashëgimi kulturor i
Camajt është pa dyshim ndër më të shënuarit dhe, në pikëpamje
të gjuhës, ndër më të përparuarit e njerëzve të penës që jetuan e
krijuan larg Atdheut. Le të jenë ligjërimet e studiuesve tanë një
peng nderimi e përkujtimi për emrin e paharruar të shkrimtarit
në këtë jubile të 85-të të jetës së tij.*

Ju faleminderit!

***Fjala e përshëndetjes e bashkëshortes së Martin Camajt,
zonjës Erika Camaj***

Te dashtun miq!

Sot asht një ditë e mbarë për në. Na mblodhi rishtas ky qytet, të cilit im shoq i shkroi: “Të dhanë vetëm një emën: Shkodër”.

Ju nderoni në këtë tubim tim shoq, e bashkë me të të tanë ata qytetarë, intelektualë e shkrimtarë shkodranë që i kënduen Shkodërloces, edhe pse shumë sish u asht dashtë me hjekë e me vuejtun shumë. E ju më nderoni edhe mue.

Me këtë rasë po due t’ju falënderoj me gjithë zemër për miqësinë e dashurinë që më dhuroni prej vitesh. Të dyja këto dhunti tueja-miqësinë e dashurinë-unë i shof si pasunitë më të mëdhaja në jetën teme.

Këtë radhë kam sjellë me vete një libër. Botimin e këtij libri, që asht një dhuratë me rasën e tetëdhjetë e pesë vjetorit të tim shoqi, e organizoi profesor Demiraj. Ai i dha titullin “Na jemi te tutë”.

Këtë libër due me ia dhurue Bibliotekës së Universitetit “Luigj Gurakuqi” të Shkodrës dhe Shoqatës “Atdhetare-Dukagjini”.

Unë i uroj tubimit suksese dhe juve tanë të mirat.

Ju falemnderës që me dhatë fjalën.

***Fjala e përshëndetjes, mbajtur nga Kryetari i Shoqatës
“Atdhetare – Dukagjini” Ndue Sanaj***

*E nderuara Bashkëshortja e të madhit Martin Camaj,
doktoze Erika Camaj!*

Të nderuar pjesëmarrës në këtë Konferencë shkencore!

*Në cilësinë e kryetarit të shoqatës “Atdhetare-Dukagjini”,
kam nderin të përshëndes në emër të saj, punimet e kësaj
Konferencë, me temë “Martin Camaj për kulturën shqiptare,
shkrimtari dhe albanologu”.*

*Në të njëjtën kohë, përshëndes Fakultetin e Shkencave
Shoqërore, Qendrën kërkimore - shkencore albanologjike,
Departamentin e Letërsisë dhe Departamentin e Gjuhësisë, për
organizimin, përparatjen dhe zhvillimin e kësaj konference, që i
kushtohet njërit prej personaliteteve të shquara të Kombit
Shqiptar, në kuadrin e 85 vjetorit të lindjes së Tij, Martin
Camajt;*

*Përshëndes gjithë lektorët që kanë marrë përsipër të
përgatiten dhe të referojnë në këtë Konferencë!*

*Nëpërmjet kësaj Konferencë bëhen aktuale dhe
materializohen me punë konkrete, përpjekjet dhe dëshirat për
nderimin e jetës dhe veprës së Martin Camajt.*

*Por, në të njëjtën kohë, të gjithë ne, organizatorët,
lektorët, referuesit, me kujtimin e jetës dhe veprës së Martin
Camajt, po marrim përsipër përgjegjësinë dhe detyrën që na
takon ndaj kontributit që Martin Camaj la për ne.
Mospërmbushja e mospërgjegjshmëria ndaj cilës do të ishte një
faj.*

*Martin Camaj, si shumë mendje të tjera të ndritura që
kontribuan përmes penës, me shpirtin e tyre të palodhur me
dashuri ndaj atdheut, e vendlindjes, e kanë bërë punën e tyre,
ndërsa ne, na mbetet t'i njohim, t'i pranojmë mentalitetet dhe*

dijet e tyre avangarde, t'i hulumtojmë, dhe duke i studiuar, të mësojmë nga vepra e tyre.

Martin Camaj lindi dhe u rrit duke thithur ajrin e freskët të maleve të Dukagjinit, por u burrërua dhe u plak duke thithur ajrin e demokracisë evropiane; Ai asnjëherë nuk iu fsheh erës së ftohtë të Veriut të Shqipërisë, por dhe as luginës së Innit të Gjermanisë ku mbylli jetën e tij;

Ai, asnjëherë nuk iu fsheh diellit përvëlues – metaforik, kudo që jetoj dhe punoi;

Ai, e zbuloi veten para njerëzve, duke u treguar para tyre Martin Camaj komunikues, bujar, fisnik dhe atdhetar. Kudo shkeli, punoi shumë për të fituar dije, për të dhënë dije, për të përçarur dije dhe për të përfaqësuar denjësisht shqiptarin.

Vetëm kështu arriti të formatojë personalitetin e tij, njeriun, atdhetarin e përkushtuar, pa harruar asnjë momenat të jetës së tij, popullin, vendin dhe gjuhën që e lindi.

Kam bindjen, se te gjithë ne kemi çfarë të mësojmë nga jeta dhe vepra e Martin Camajt. Me këtë konferencë ne bëjmë përpjekjen e parë shkencore, për të zbuluar vlerat e veprës së tij, që duhen bërë pjesë e arsenalit të kulturës sonë, madje asaj më të mirës dhe të krenueshmes, e cila kulturë, si e tillë, është e domosdoshme për të siguruar prosperitetin e shoqërisë shqiptare.

Shoqata “Atdhetare-Dukagjini” nëpërmjet gazetës së saj modeste “Dukagjini” ka bërë përpjekje të publikojë jetën dhe veprën e Martin Camaj, me mbështetjen e Drejtorisë së Monumenteve të Kulturës në Shkodër. Shtëpia e lindjes së Tij është shpallur monument kulture;

Me Akademinë e Shkencave dhe Qendrën e Studimeve Albanologjike në Tiranë, kemi bërë përpjekje, që jeta dhe vepra e Martin Camajt të dekorohet nga Presidenti i Republikës me urdhrin e lartë “Nderi i Kombit”.

Shpreh kënaqësinë, që më jep besimi, se pas tre vjetëve përpjekje, t'ia kemi arritur qëllimit, që Martin Camaj, së shpejti të dekorohet me urdhrin e lartë "Nderi i Kombit".

Me lejoni që nëpërmjet kësaj tribune, të falënderoj: Keti Bazhdarin, Nik Mrinën, Pjetër Gjetën, Ndoc Bashotën dhe Tonin Gjonin, për mundësinë që i dhanë shoqatës "Atdhetare-Dukagjini" për të mbështetur realizimin e kësaj Konference.

Ju faleminderit!

Ledri KURTI, Mimoza PRIKU (Shkodër)

MARTIN CAMAJ - SHKRIMTARI DHE DIJETARI

Referat

Të dashun miq e vëllazën Shqiptarë, intelektualë, artistë dhe mbarë populli shqiptar, përshëndetjet e mija ju janë drejtue të gjithëve.

Gëzohem pa masë se keni vendosë të vlerësoni veprën time: ky vlerësim na afron.

Bátë burrinë të më shtini në rreshtin tuej. Ndonëse të ndamë për një gjysëm shekulli, unë jam i jueji e ju jeni të mijt.

7 mars 1992

Martin Camaj

Figura e Martin Camajt, ndonëse e panjohur disa dekada, dhe madje e paguxueshme për t'u cituar, ose studiuar qoftë dhe vetëm për kontributin shkencor filologjik në studimet e tij gjuhësore, apo njohur për kontributin e tij në katedrën e Albanologjisë në Mynih, tashmë është e legjitimuar në vendin e tij, mes njerëzve të gjuhës së tij amtare, për të pasur vendin e merituar në kulturën kombëtare shqiptare, me dhe pa dashjen e ndokujt apo me dhe pa dashjen e receptuesit të dembelosur në klishe të gatshme të modelit të kohës dhe vendit, në të cilin iu gatua shija dhe mendimi.

Me pak fjalë, Martin Camajt, që jetoi larg lexuesit të tij natyral, duke iu mohuar receptuesi dhe duke i munguar efektet e receptionit, iu mohua komunikimi me njerëzit e gjuhës së vet natyrore, ndërsa letërsisë në tërësi dhe kombit vetë iu mohua komunikimi shpirtëror me njeriun që e

dashuronte këtë gjuhë dhe lirinë e bukurisë së saj, në të gjitha përmasat e shprehësisë dhe tingujve nga rridhte mendimi shqip.

Fjala shqipe me mosdashjen për të njohur veprën e Martin Camajt i rivulosi vetes edhe njëherë vuajtjet e gjuhës, pasojat e së cilës i ndjejmë ende sot.

Lindi më 21 korrik 1925, plot 85 vite më parë. Në të ish ngjizur tharmi i një “poeta nascitur” pikërisht, në vendlindjen, rrafshet, luginat e bjeshkët, ku mrrizonin trashëgimitë e zanave, miteve e legjendave. Fillea e edukimit të tij, modeli i edukimit në shkollën jezuite, iu bë pjesë e qenies, si njeriu i meditimit, heshtjes, e më pas edhe shkrimtarit për të cilin, koncepti i poetit dhe i poezisë përmblihej në: “*Vargjet ... që janë për t'i lexue në heshtje*”; e jo të llojit deklamativ!

Papajtueshmërinë e tij me modelin e një regjimi, si ai komunist, i riu Martin Camaj do ta shprehte me përfshirjen e tij në grupimin social-demokrat, sipas dëshmisë së ish-gjimnazistit të Liceut të Shkodrës Ahmet Bushati. *Nga viti 1945-1953, pjesë e arrestimeve, burgosjeve të grupimeve të kësaj shkolle, do të bëheshin mbi 60 gjimnazistë, ndër to më pas do të vazhdonin internime dhe përjashtime, nga shkolla.* (Bushati Ahmet, *Gazeta Shqiptare*, 30-01-2002, gazetar Dashnor Kaloci).

Pjesëmarrja në veprimin kundër regjimit komunist, që u bë dhe shkaku i largimit të tij nga Shqipëria, shpëtoi jo thjesht Martin Camajn. Por bashkë me të dolën e mbijetuan nga nëndheu i murrme i fillesës së kulturës shqipe specifikisht kulturës gege, ku: “*gjarpinjtë u banë gur nën tokë për t'i qindrue dimnit*” (Gjarpinjtë).

Letërsia shqipe dhe pasuria e tharmit geg, gjeti të burojë e të vazhdojë rrjedhën e vet diku tej, sa në tokën e Kosovës, Romës, dhe Mynihut, duke shënuar dhe fazat përcaktuese të jetës evolutive të ritmit e shpërfaqjes së krijimtarisë si shkrimtar, punës filologjike dhe veprimtarisë së tij si albanolog.

Kështu, i prangosur me ikjen e detyrueshme dhe jo të dëshirueshme, mbeti me zemrën dhe sytë e mendjes të fokusuar në shpirt, të përkthyer në mall e kujtime për dheun dhe mbi fatin e “frymorëve të papërsosun”.

Reminiscencat, kujtimet e pashqitshme nga ai realitet i vendlindjes përbëjnë gjithnjë fletën e hequr të librit të parë të jetës - prej të cilit akt, i mbetën fjalë të paemën. *Hoqa fletën e librit të parë/ Prej faqes sime dhe mbetën fjalë të paemën. "Hoqa fletën e librit të parë/ aludojmë të jetës (!)".*

Me ikjen në një moshë kur i duhej të vendoste, për të ardhmen e fatit të vet prej të riu, vihet në ikje në fakt, nga kultura dhe gjuha shqipe (sikur kish ndodhur më parë edhe me Koliqin etj.), një tjetër e ardhme poetike e lindur nga gegërishtja.

Por paradoksalisht, për dëshirën e atyre që ia dhuruan këtë fat, do të shpëtohej, si dëshmi sfiduese, një tjetër mbijetesë e përkryer, e trashëgimisë për kulturën shqiptare, e përkorë dhe njëkohësisht e sofistikuar, me thjeshtësinë e vet të hershme.

Do të shpëtohej një nivel i munguar i gegërishtes, në shkallët e trashëgimisë për kulturën shqipe, po aq sa do shpëtohej dëshmia, e një modusi të arsyeshëm të bashkëjetesës së saj me normën letrare, në një koncept luajaliteti.

Camaj vjen, si poet, shkrimtar, dramaturg, studiues i letërsisë dhe kritik i procesit letrar, editor i "Shënjave" për disa vite me radhë, dhe gjithashtu botues i letërsisë shqipe në gjuhë të huaj; studiues i letërsisë më të vjetër shqipe duke filluar nga Buzuku e duke përfshirë edhe Bogdanin; studiues i dukurive gjuhësore të shqipes në rrafsh historik e aktual; autor kërkimesh dialektologjike në mjediset arbëreshe; autor studimesh të mirëfillta gjuhësore duke përfshirë dhe rrugën e formimit të shqipes letrare (pjesa më e madhe botuar në "Trofenik"); hartues i një gramatike të shqipes për të huajt; mësimdhënës titullar i lëndëve të albanologjisë në Ludwig Maximilian University të Muenchen-it; urë ndërlidhëse midis ishujve letrarë të sistemit jofunksionues të letërsisë shqipe: midis Kosovës dhe botës arbëreshe, midis mërgatës së Perëndimit dhe asaj të Botës së Lirë, midis tyre dhe makrosistemeve letrare të botës moderne.

Gjithashtu, vjen dhe si një pikë reference për qendrat e albanologjisë në botë, me një bibliografi të jashtëzakonshme dhe tejet intensive. Me të gjitha këto, Camaj pashmangshmërisht e vë në vështirësi studiuesin.

Me kalimin e viteve u bë krejt e qartë, se vepra e Camajt kërkonte një synergie për t'u integruar vërtetësisht në mjedisin kulturor dhe letrar që i takonte. Së paku duhej të ishin bashkë historiani i letërsisë dhe historiani i shkencës shqiptare, i albanologjisë.

Simbiozat dhe dualitetet

Simbiozat dhe dualitetet që shoqëruan qenien e tij jetësore dhe letrare, do të ishin :

- ikje dhe shpëtim;
- humus geg dhe traditë - edukim klasik dhe formim perëndimor;
- pasuri leksiku dhe hershmërie - mundësi bashkëjetese dhe luajaliteti me normën letrare;
- prirje dhe fillime letrare - diplomim në gjuhësi, me disertacion për Buzukun dhe Specializim po gjuhësor në Gjermani - sinteza pedagog (ligjërues) në një katedër albanologjie;
- shpirt, tharm, dhe pasuri leksikore, lindur në tokë legjendash e mitesh - mendim i moderuar për mundësi bashkëjetese dhe luajaliteti me normën letrare, në sintezë: akribi shkencore dhe ekonomizim i fjalëve gjer në shprehësi brilante të përzgjedhura si esencë.

Si tipar: në gjithë veprën e tij, të shkruar gjatë afro 35 viteve, a më shumë, Camaj është në kërkim të rrënjëve të të parëve, të atdheut të munguar, të vendlindjes që e nuk mund ta shohë dhe që e ndjek pas si një dënim.

Do të njihet si Uliksi, që merr udhët përtej Itakës. Po ashtu si soliditet i gjenezës së trashëguar, krijues i legjendës dhe mitit të thyer dallueshëm në thelb nga përmasat klasike të perceptimit, si “hermetik”, hermetizmi i të cilit vjen, jo përmes lëndës, apo semantikës së fjalëve, por përmes risisë së hijshmërisë, trajtës konvencionit të thatë dhe peshës së rëndë.

Originaliteti dhe Dominantja

Po të kemi parasysh, Barthes me konceptin e tij mbi tekstet e shkrueshme dhe të lexueshme, Martin Camën dhe fjalët e tij, të pastra me vesë e brymë, mund t'i klasifikonim, ndër ato tekste, të shkrueshme, që kërkojnë lexuesin e duhur. Tekste të ngritur mbi një strukturë, e cila denjësisht kërkon heshtjen, për ta mbarsur mendimin dhe koncentruar në shije të llojit të papërsëritshëm, për të cilën Martin Camaj është origjinal.

Ky origjinalitet do ta shoqërojë në stilin e formësuar nga lënda karakteristike shqiptare e letrarësuar, nëpërmjet edhe një sintakse karakteristike dhe gjetjes së pajtueshmërisë së hijshme, mes gegërishtes letrare dhe asaj jo të tillë.

Original do të njihet gjithashtu në mënyrën e sofistikuar me të cilën vjen, dhe kjo, vetëm përmes thjeshtësisë dhe hershëmrisë, rifunksionalizimit të pasurive, të ardhurave të gatshme nga paraardhësit, mbi të cilat ai, ngre trajtat e veta të ajthëta, *para derës së Veriut*.

Siç duket, morali i llojit të ligjërimit të tij, kishte një filozofi: atë të ndërtimit mbi shkallën zero të shkrimit.

Shembull klasik i Camajt - breshka, shembuj të tjerë, rrashta, gjarpri, uji, shiu.

Shembuj klasikë të tjerë të Camajt - thyerjet e koncepteve të llojit, madrigal, (në fillimet e veta, si këngë) apo dramat - tekste, (në klasikën e vet - marrëdhënie me skenën), proza ndërtekstualizuar me poezinë etj.

Botët e shmangura janë një tjetër qëllim i Camajt edhe kur shkruan për arbëreshët apo për Gazullët e kohës humaniste. Edhe aty, ndjek dominanten e vet, përpiqet të zbulojë njeriun e vjetër shqiptar, përkundër njeriut të ri, që kërkonte letërsia e realizmit socialist, por pa bërë polemika historike-letrare me askënd.

Pra, tek Camaj - shkrimtar gjejmë marrëdhënie me të gjitha detajet e strukturës së një vepre, gjejmë tekstin si “i tillë”, gjejmë rrëfime - ligjërime në prozë, ngritur mbi vizione dhe kode “Rrathë-sh”, bashkëjetesë me poeticitetin, gjejmë tituj dhe tekste sfiduese, si “Loja e mbasdrekes” ndaj mesazhit dhe lëndës, gjejmë këdo estetike, të shkrirë në gjuhë teksti, dhe jo përmes traktateve dhe parimeve të ngurta apo këshillave për t’u zbatuar, si në dramën “*Kandili i Argjandtë*” etj.

E gjithë tërësia e opusit të veçanësisë, si filozofi e lojës mes tekstit dhe lëndës, përbën një Quid Unicum tek Martin Camaj shkrimtar.

Veçanësia e këtij Quid Unicumi, ngrihet mbi zbukurimet e fjalëve, bëhet më solide me ekonomizimin dhe kërkimin e së bukurës dhe efektit, përmes thyerjeve, guximit, sesa përmes lëndës si qëllim, apo... Qëllimit për të transmetuar mesazh. Mesazhi vjen si, dhe përmes artit.

Camaj nuk kërkon autenticitetin si qëllim. Camaj, shkrihet në artin e fjalës dhe nëpërmjet tij ... në shtresat e paraardhura nga tradita. Kështu, krijoi modelin e ri dhe dëshminë e një gjuhe autentike për letërsinë shqiptare.

Për Camajn nuk do kishte kuptim Shqipëria, as vendlindja, pa artin, pa gjuhën, dhe endje-sh'endjet e pafund të pasurive të saj, atij tisi dhe degermie që hijeshonte fjalën e bukur geqe.

Shqipërisë dhe vendlindjes së tij, kulturës shqiptare dhe asaj geqe, do t'i mungonte pa praninë e kësaj lënde arti, vlere solide, pa të cilën do t'i mohonim vetes, shkallët e krenueshme të evolucionit të kulturës sonë.

Me njohjen e tij, kultura shqiptare plotëson thelbin e munguar nga ashti dhe humusi geg, si një prej dominanteve domethënëse të përmendores kulturore, që ajo, i ka dhuruar asaj, në historinë e vet.

Më vete dhe me të tjerët

Cili qe qëndrimi që mbajti ai ndaj zhvillimeve bashkëkohore në letërsinë shqipe, çfarë recensionoi, kritikoi e promovoi prej kësaj letërsie në shtypin albanologjik në Itali dhe Gjermani (më vonë dhe në SHBA), cila ishte konsiderata e tij për realizmin socialist dhe me ç'rrugë e refuzoi atë; deri ku shkoi qortimi i Camajt ndaj shkrimtarëve dhe poetëve të së njëjtës gjuhë; sa e vuajti mundimin e mungesës së lexuesit të parë dhe cili qe haraçi që i pagoi estetikisht vonesës dhe shumë pyetje të tjera. Në anën tjetër historisë së albanologjisë i duhet posaçërisht pikëpamja e Camajt për karakterin e letërsisë së vjetër, e quajtur kryesisht letërsi kishtar apo klerikale; për të cilën edhe sot ka diskutime shkencore të hapura; sikurse i interesojnë kontributet e tij shkencore në fushë të historisë së gjuhës së shkruar (pjesa më e madhe botuar në gjermanisht, italisht dhe anglisht); përfytyrimi për dialektet, për konvergjencën dhe dallimet midis tyre, për rrugën e formimit të shqipes standarde; qëndrimet praktike ndaj normës së shqipes normative, në veprat që botoi pas vitit 1972, domethënë pas mbajtjes së Kongresit të Drejtshkrimit. Për disa kontribute të Camajt nuk mjaftojnë studiuesi i letërsisë dhe gjuhëtari, shpesh herë duhet etnologu dhe antropologu ose bashkëpunimi mes tyre. Nismat për ndriçimin e plotë të personalitetit të Camajt do të kërkonin gjithashtu një historik të rrugës së

ritjes së njësisë shkencore-universitare të albanologjisë në Muenchen dhe të rolit personal të Camajt në mësimdhënien e shqipes dhe formimin e albanologëve të rinj në Gjermani, në vendin ku albanologjia u themelua dhe u kthye për së pari në shkencë të pavarur.

Vepra krijuese dhe shkencore e Martin Camajt është e tillë që gjithashtu shtron pyetjen se çfarë mund të bëjë një individ më vete dhe pa të tjerë, nëse do të perifrazonim titullin e njëres prej veprave të tij; një individ që ka në portretin e vet, shqiptarin e vjetër tradicional, njeriun evropian, por pa përjashtuar dhe fatin e një mërgimtari; që e kaloi gjithë jetën në mjedisin ku gjuhën e tij amtare nuk e priste asnjë lexues, që ishte dyfish i ndaluar dhe i kufizuar për këtë shkak, që bashkoi organikusht dhe në mënyrë gjenue fuqinë e brendshme të shqipes dhe procedimet moderne të fjalës së hijshme letrare në Evropën e lirë.

Vetëm disa qasje dhe përkime konceptuale dhe estetike me Koliqin!

1. Koliqi, do të thoshte, Në kshilla t'riut shkrimtar: *shkrimtari gjen mjete por veten s'e tradhton kurrë!*

Camaj do të shprehej, në poezi; *Ndër mija trajta ideja*

2. Koliqi shkroi autodafenë e tij, me vetëgjyqësinë e Poetit, ndaj heretikëve të artit.

Camaj, ndjen vrasjen e poetit, indirekt të poezisë, fjalës së bukur, bukurisë së shpirtit të lirë, duke ndjerë poetin si pengun, e kufijve të botës njerëzore, si pengun e lirisë së shpirtit të fshehun mbas vargjeve:

Pse mbas lirisë së shpirtit që fal arti, priste gijotina e vdekjes “*rrishin galuc roje shpend mishngranës me fytyrë njerëzore ndërkohë që vetë endësi i fjalëve të shpirtit, ishte për njerëzimin ... një bletë*” (“Vrasja e poetit”).

1. *Camaj hidhërohej kur ndjente të kalbej fara e kuptimit të fjalëve, në gjumë para se mu zgjue. Andaj - rezultonte Camaj - nuk kishte tinguj!* (“Bota e një gjuhe”).

2. Motoja udhëheqëse tij: *Ngadhnjim, ngadhnjim i frymës së ashtit, ngadhnjim!* (“Bota e një gjuhe”).

Diskursi

Diskursi i Martin Camajt përmes veprave të tij, këndvështruar dhe në kronologjinë e tyre, merr ridimensionime, përmes një estetike të re, një

shije të paprovuar më parë, një përzgjedhje të gjuhës dhe leksemave, me të cilat, përcillen lëndë dhe tekste, më saktë, përcillet modeli i "lojës" së llojit strukturoro-sintaksor, që fare mirë, mund ta quajmë të llojit Camaj. Dimensionet e së zakonshmes në tekstin, rriten, dhe të jashtëzakonshmes, konceptualisht zvogëlohen. Camaj njohu dhe përdori kirurgjinë fine të fjalës.

Përfundim

Formimi i tij kulturor i ndikuar nga njohja e shumë gjuhëve të huaja, dhe kontakti me kulturat e ndryshme perëndimore, vetëm sa e ngjizën me nivelin e kohës dhe arritjeve të kulturës gjuhësore dhe letrare në përgjithësi, që sundonte në Evropë, përfshi këtu edhe strukturalizmin, por në përmbajtje dhe thelb, në leksik dhe pasuri, gjithçka dhe gjithmonë, mbeti shqiptare, dhe vetëm shqiptare.

Përfundimisht, cila ishte figura dhe cili ishte koncepti i Martin Camajt për Shqipërinë e Lirë, kur ai nuk i afrohej as i qasej "së ashtuquajturës "Shqipëri e Re" dhe kur, letërsisë nuk i implikonte ideologjinë?

"Besoj se Shqipëria do të jetë me të vërtet e lirë, vetëm atëherë kur shqiptarët do të kenë mundësi të lexojnë, të studiojnë dhe vlersojnë veprat e shkrimtarëve të tillë të mëdhej si Arshi Pipa". Nga libri i Uran Karakulës "ARSHI PIPA, njeriu dhe vepra", Kapitulli II.

Për ta mbyllur me një citim nga At Gjergj Fishta, në 1. *Randsija e Folklores komtare*, nga Parathanje *Kanuni i Lekë Dukagjinit*: "...folklores do t'i siellesh, po deshte me shtue pasunin e gjuhës me fjalë të permvehtsueme, me frazeologji shprehore, me shembulltyra të gjalla, dramatike...".

M. Camaj – Filolog

Kontributi gjuhësor i M. Camajt shtrihet në disa fusha, duke nisur me historinë gjuhës, fokusuar kryesisht në studimin e autorëve të vjetër. Ndihmesë të veçantë në këtë fushë përbën studimi "Il Messale" di Gjon Buzuku. Contributi linguistici allo studio della genesi", botuar në revistën "Shêjzat" (1961).

Duhet theksuar fakti që në fushë të gjuhësisë kontaktet më të shumta i ka pasur me botën e kulturën arbëreshe. Prandaj, në studimet

dialektologjike një pjesë të mirë e zënë kryesisht punimet për të folmet arbëreshe, fushë ku Camaj ka kontributin më të madh në lëmë të gjuhësisë. Pjesë e kësaj trashëgimie janë monografitë “La parlata albanese di Greci in provincia di Avellino (Firenze, 1971), “E folmja shqipe e Falkonarës në krahinën e Kozencës”, studim i botuar në gjermanisht në vitin 1977, “La parlata arbëreshe di San Costantino Albanese in provincia di Potenza” (Calabria, Rende, 1991) e sa e sa artikuj e studime për të folmet të veçanta, botuar në organe të ndryshme.

Edhe gramatika e shqipes, në mënyrë të veçantë fjalëformimi nuk i ka shpëtuar fokusit të këtij filologu me punimin “Fjalëformimi i shqipes. Mënyrat e formimit të emrave të vjetër. (Albanisische Wortbildung. Die Bildungsweise der älteren Nomina, Wiesbaden, 1966).

Si lektor i shqipes ai nuk mund të linte jashtë vëmendjes edhe botime të posaçme për mësimin e shqipes. I pari botim i përket vitit 1969 (“Lehrbuch der albanischen Sprache”), për të vazhduar me “Albanian Grammar ...” (1984), e konsideruar kjo e fundit nga studiuesit si një ndër veprat më të rëndësishme në rrafshin gjuhësor “si një model për gegërishten letrare, por me prirje për afruese me toskërishten”¹.

Camaj ka bërë edhe disa vëzhgime me karakter sociolingustik për çështje që lidhen me bilinguizmin, diglozinë e plurilinguizmin, duke iu referuar më shumë kontekstit gjuhësor arbëresh. (“Il bilinguismo nelle oasi linguistiche albanesi dell’Italia meridionale”², “Aspetti del plurilinguismo presso gli arbëresh d’America”³).

Në bibliografinë e tij të gjerë nuk mungojnë as recensionet mbi botimet e ndryshme, të cilat i referohen shqipes, gramatikës së sotme e historike të saj, etimologjive parë më shumë në vështrim të gjuhësisë kontaktuale, por kanë tërhequr vëmendjen edhe botime manualesh për mësimin e shqipes.

¹ T. Osmani, “Martin Camaj dhe gramatika e gjuhës shqipe. Pikëpamjet për gjuhën letrare shqipe”, *Tradita dhe e sotmja në vështrim gjuhësor* 3, Shkodër, 2009, f. 240.

² *Bilinguismo e diglosia in Italia*, Atti del Convegno del Centro Studi per la Dialettologia italiana, Pacini, Pisa, 1974, pp. 5-13.

³ “Zjarri”, 1986, pp. 18-20, 1989, pp. 136-47.

Punimet me karakter gjuhësor të Camajt nuk i gjejmë vetëm në revistën “Shêjzat”, por në organe të tjera, si Südost-Forschungen, Zjarri. Ndeshemi me recensione të gjuhëtarëve e albanologëve, si: I. Ajeti, V. Polak, Jokl, C. Haebler, K. Gurakuqi, Decnickaja, Gabinski, Solano, Altimari etj.

Me të drejtë Camaj është konsideruar “në të gjithë këto vite një pikë të sigurtë referimi për të gjithë studiuesit e huaj të albanologjisë e intelektualët shqiptarë të diasporës”.⁴

Si përfundim, mund të themi se kontributi i Camajt edhe në gjuhësi duhet çmuar e vlerësuar për metodën e saj shkencore, origjinalitetin dhe urojmë që ky kontribut i tij të shpaloset më mirë përmes kumtesave të kësaj konference.

⁴ F. Altimari, “Profilo bio-bibliografico di Martin Camaj, insegne figura dell’albanistica e della letteratura albanese contemporanea”, *Albanica*, nr. 2, 1991.

Fatbardha HOXHA (Shkodër)

**MARTIN CAMAJ, NJERIU, POETI, DIJETARI, MIDIS
VATRËS DHE BOTËS DHE NOVELA
“GJON GAZULLI”**

Për njeriun, poetin dhe dijetarin Martin Camaj edhe pse është folur dhe shkruar, ende nuk mund të thuhet se është bërë aq sa duhet pas heshtjes së gjatë ndaj tij dhe veprës së tij letrare e diturore.

Padyshim ai tashmë ka zënë një vend të shquar në historinë e letërsisë bashkëkohore dhe sidomos të diasporës shqiptare.

Në 85 vjetorin e lindjes ai vjen me një krijimtari frymëgjatë, të përfshirë në një kolanë shumë të vëllimshme, me një tipologji gjinish dhe zhanresh për t’u lakmuar, si një shkrimtar produktiv dhe i një niveli të pazakontë.

Leximi dhe rileximi i veprës së Camajt është e pamundur pothuaj të mos japë ngasjen e natyrshme të reflektosh gjatë për shumë shfaqje dhe sidomos për atë që kushtëzon thelbin e veprës krijuese që e përfton krahas aq shumë faktorëve edhe ai i ikjes dhe i kthimit të përhershëm të njeriut, poetit, por edhe të dijetarit Camaj në atdheun e tij shpirtëror.

Është ky jo thjesht një rast, por një fenomen që ka shoqëruar letërsinë e njerëzimit po aq edhe shqiptare që nga fillimet e tyre. A nuk kishte ndodhur kështu me Barletin, Beçikemin apo me Gazullin, Tomeon, Marulin, që edhe nuk kishin lindur në Arbëri, dashuria, malli dhe kontributet për të u dhanë famë dhe shkëlqim emrit të tyre në të gjithë Evropën dhe më gjerë.

Individualiteti i çdo krijuesi lë gjurmë të patjetërsueshme në shprehjen e këtij fenomeni që nuk është vetëm shqiptar.

Në rastin apo më drejt në fenomenin e largimit nga vatra që është jo zgjedhje, por zgjidhje e Caamaj në rrethanat e pamundura për të vepruar ndryshe.

Por kjo ikje alternohet dhe sado paradoksale të duket, me kthimin e pandërprerë të Camajt në vendin e origjinës. Dhe kjo ndodh teksa ai është brenda hapësirës ballkanike. Teksa studion për romanistikë dhe balkanologji në Universitetin e Beogradit boton në Prishtinë vëllimin e parë me lirika “*Një fyell në male*” dhe “*Kënga e vërrinit* më pas teksa ndjek studimet për filozofi dhe letërsi në Universitetin e Romës, hulumton veprën më të hershme të shqipes Mesharin e Buzukut duke na dhënë më 1962, të parën monografi për këtë autor. Dhe si për të dëshmuar se sa i fortë është qëndrimi pezull midis vatrës dhe botës të njeriut, poetit dhe dijetarit Martin Camaj sërish të vjen si argument i pakundërshtueshëm vepra shumëvlerëshe, e veçantë dhe e papërsëritshme në artikulum, në gjuhë, në tingujt dhe jone, çfarë e kishte parandjerë e parashprehur vetë krijuesi në vëllimet e para kur e identifikonte krijimtarinë e tij me fyellin dhe këngën. E gjithë vepra e tij në poezi, prozë dhe dramaturgji shpreh identitetin e tij krijues sa tradicional aq modern, me burim folkun, etnokulturën e atdheut të origjinës, me letërsinë dhe artin modern evropian, në klimën e të cilit ai krijoi, pa mundësi komunikimi me bashkëvendësit e vendit të origjinës, praninë e të cilëve ai e kërkoi dhe e gjeti në shqiptarët e Kosovës, në komunitetin shqiptar në Itali dhe tek shqiptarët e diasporës. Tek ai vërehet po ai fenomen universal se identitetet e fituara nuk arrijnë të çbëjnë identitetin e parë krijues. I ndodhur shpirtërisht midis vendlindjes dhe metropolit ballkanik dhe evropian ku jetoi, jo rastësisht Beogradi, Roma dhe Mynchen, ishin qendra të albanologjisë. Edhe pse intelektual elitar i këtyre qendrave, vepra e tij është përjetim, ndjeshmëri, fantazi e performancë e shpirtit shqiptar që tek ai vezulloi në një format të rrallë e original përmes veprës së tij shumëplanshe. Me ndjesi të veçantë ai shkruan krijime me ngarkesë meditimi dhe emocioni të paparë shprehur në një gegërishte të punuar me prirje të fuqishme konverguese letrare, çfarë përbën një tjetër anë të modelimit të shpirtit shqiptar autentik, të cilin nuk e çfytyroi as mërgimi i gjatë, as komunikimi i munguar me dheun e origjinës.

Por veprës së Camajt nuk i mungon as edhe përmasa narrative epike. Këtë ai do ta shprehte në romanet e tij dhe novelat e tij që presin ende vrojtime kritike të hollësishme.

Novela “Gjon Gazulli” që është në vëmendjen tonë në këtë kumtim, edhe pse nuk është novela as më e shkurtër as më e gjatë e autorit, në serinë e novelave të shkruara prej tij, është një nga krijimet e fundit të shkrimtarit që ka ngjallur dhe zgjon interes edhe pse nuk ka kaluar pa u vënë re nga kritika e studimet.¹

Në ndryshim nga prirja e Camajt për të trajtuar tema aktuale, në novelën “Gjon Gazulli” edhe pse i referohet një figure historike, me sa dimë të patrajtuar më parë në letërsinë tonë, poeti dhe dijetari nuk reshtet së ballafaquari të realiteteve historike, të fateve të shqiptarëve ndër kohëra dhe të kohës së tij.

Leximi i kujdesshëm i saj e gjen të formuluar qartë dhe saktë kumtin e këtij krijimi nga studiuesi Ardian Klosi kur shkruan për të se mund të shihet “... Në shumë pikëpamje si një parabolë autobiografike. Tek Camaj si dhe te Gazulli kemi humanistin, dijetarin e shtruar që është i shqetë brenda kornizave filologjike dhe kërkon të shpërthejë në mënyra të ndryshme, pikësëpari përmes krijimit, kemi njeriun e iluminuar midis Perëndimit dhe Lindjes, kemi shqiptarin e çatdhesuar me mallin e përhershëm për dhenat e largëta”.²

Novela “Gjon Gazulli” edhe pse të befason në leximin e parë me fillin e subjektit, me pasurinë e gjuhës, konkretësinë e brilantë të përshkrimit, në rileximin e saj, është e pamundur të mos dallosh një procedim të përpiktë në pikëzimin e protagonistit dhe kohës që i përket.

Në pjesën e parë të novelës shfaqet profili i Gazullit si filozof humanist në një dialog me një filozof humanist tentonas. Personaliteti i ndritur i Gazullit gëzon adhurimin e humanistëve evropianë. Jo rastësisht bashkëbiseduesi ose dishepulli i Gazullit vjen nga veriu i Evropës. Në dialogun e tyre spikat vlera e latinishtes si gjuhë universale në kohë, si gjuhë klasike e artit dhe e shkencës. Në diskutim ata pajtohen për epërsinë e latinishtes, mirëkuptohen për raportin mendim-gjuhë, për rolin e ideve të reja në jetën e njerëzimit, shfaqin qëndrimin ndaj heretizmit si dukuri e shfaqur aso kohe.

“Kundrejt idesë – arsyetonte Gazulli – do pasë ai nderim si për shembëllesën e hyjnisë, si për një fugure ose objekt kulti”. Domethënës po aq edhe konkret është mendimi për epërsinë e latinishtes, si gjuhë e lëvruar e kultivuar ndër shekuj për të cilën Gazulli thekson: “ Jo pa

arsye te parët e mi e ruanin venën e kuqe në fuçia bungu, ndërsa të bardhën në dru të pishës, ka dije e doktrina si këto tonat, që mund të trashëgohen vetëm në gjuhë letrare”.

Jo vetëm përmes dialogut, të shëmbëlltyrave të shfrytëzuara mjeshhtërisht prej Camajt, por edhe përmes profilit të shqetësuar e përherë të trazuar të humanistit shqiptar, shfaqet fort geni shqiptar, etnotipi ballkanas.

“Pranoj – i thotë ai bashkëbiseduesit – se jam i shqetësuar. Si të mos isha i tillë, nuk do të kisha fare andje të arsyeve. Mandej edhe fisi nga rrjedh asht i shqetësuar. Shtroja jonë ku kemi ra ka kenë kurdoherë gunga gunga”.

Arsyeja e shqetësimit të brendshëm, apo të vrullit që përfaqësonte vetë lëvizja humaniste në rastin e Gazullit ndërthurej edhe me arsye edhe më të thella, më të hershme dhe ndoshta me atdheun e munguar që është shprehur jo pa kuptim në novelë. *“Pendohej se nuk i kishte thanë haptazi se ai Johannes Gasulius ishte i shqetësuar sepse vuante nga malli për dhena të largëta”*

Në pjesën e dytë të novelës plotësohet profili i humanistit, në një vështrim të thellë psikologjik, ku zbulohet etnopsikologjia shqiptare e njeriut që ikën e ikën, por që dëshiron pafundësisht kthimin në trojet e origjinës dhe që e vuan jashtë mase mërgimin. *“Gjithsesi ta marrësh Gjon Gazulli që një njeri i kapërthyem”.* Dhe si për ta shpjeguar natyrën komplekse disi të papërputhur të protagonistit thuhet: *“Mbas të gjithë gjasave ky humanist nuk mund të themi se që kënaqun me kohën me të cilën jetoi. Nga kjo rrethanë rrodhi që iu shtue edhe prirja për të gjallnue përgjithmonë pezull midis tokës dhe ujit, mes ujit e qiellit, me shqetësim të pandërprerë”.* Vetëm një shpirt që e kuptonte dhe e ndjente fatin e humanistit siç ishte Camaj, do të mund të gdhente në letër shpirtin e trazuar të Gazullit, të humanistit të shquar.

Mjeshtri Camaj përmes pasazheve ka gdhendur njeriun, dijetarin, humanistin.

Gjon Gazulli jo aq në famën që ai fitoi me veprën, por më shumë së brendshmi në atë qëndrim pezull midis vatrës ku s’u lind, por që e pati gjithmëmë me vete si gjënë më të çmuar dhe botës së madhe që i fali lavdi dhe famë, por që nuk i dha qetësinë shpirtërore.

“Si radhë kush, Gazulli ishte vetëdijës se shqetësimin që e mundonte e kishte prurë në shpirt prej brigjeve detare kundruell. Në ndërgjegjen e tij lëviznin sa mizë për kercunë kujtime, tinguj gjuhësh dhe këngësh të mbytura në mjegullën e kohës” dhe “Sa shtyhej në det shndërrohej në njeri tjetër. Kuptohej se vetëm kështu mund t’i bënte ballë shqetësimit... dhe të përcillte nëpër tru kujtime të ankthshme, si thirrjet cingrimë prej mali në mal të mirëditësve të vjetër Ooh! Ooh! e mandej fjalë të ndame në rrokje që lajmëronin vdekje a vrasje dhe në skaj.. nesër hyn në dhe”.

Vështirë bëjnë se mund të gjenden elemente të vetëdijes dhe nëndijes që aq të kapshëm dhe sugjestionues, e në të njëjtën kohë emocionues, faktin se Gazulli jeton pezull midis atdheut shpirtëror ku nuk u lind dhe tokës së huaj.

Në pjesën e tretë flitet për një udhëtim të mjeshtrit që e çoi jetën mes dy gadishujve, atij Ballkanik dhe të Apenineve. Dhe pikërisht në një udhëtim në Apenine, teksa shkon të ndihmojë të vejën e një luftëtari stratiot shqiptar që e shtyn jetën me shumë fëmijë atje lart në Apenine, papritmas ai takohet gjatë udhëtimit me një grua me bukuri të qelqtë që bën që humanisti të ndërpresë udhën e të kthehet në Padova. Mënyra si fanitet ajo krijesë plor hir e delikatesë që gjallon në krijimin e Camajt, bën që imazhi i saj farfuritës të hyjë si fashë drite në jetën e mundimshme e të vetmuar të humanistit.

Më shumë se etjen për bukuri femërore siç është shprehur ndonjë studiues ajo shpreh dobësinë, ndjeshmërinë, adhurimin për bukurinë njerëzore që kishin humanistët. Duke zhvilluar më tej idenë e lidhjes së njeriut me vendin, fisin apo kombin që i përket, edhe në këtë pjesë ai kërkon të afirmojë këtë ide. *“Tri ditë para se të mbyllte sytë përgjithmonë, i erdhi dëshira me recitue në vetevete vargje popullore në gjuhën amtare. U ndal tue thanë se shqipja mund të përdorej për t’u marrë vesh me vllazën dhe miq shqiptarë, por jo si mjet poetik mirakandës. Kështu i qëndroi deri në fund parimit të vet prej humanisti”.*

Simbiozën sa edhe kundërthënien që bart njeriu dijetari dhe humanisti i famshëm çfarë shpreh një shpirt sfide ndaj njerëzve dhe ndaj vetvetes e shpreh dhe ky pasazh i pjesës së katërt: *“Vdiq në Padovë, në*

moshën 65 vjeçare, në një dhomë me dritare të mbyllura në terr të shumë çështjeve, pa i zgjidhë as mbas një jete prore në ikje prej njerëzve dhe vendeve por edhe prej vetvetes, ngase gjallnoi midis dy botnave. Andej dhe barti dy trajta të një emri Gjon Gazulli dhe Johannes Gasulius”.

Padyshim figura historike e humanistit të njohur i ofronte Camajt modelin njerëzor, kulturor e dituror, por mbi të gjitha shëmbëlltyrën e shkëlqyer të shqiptarit evropian që i lidhur siç ishte me atdheun e origjinës ai kontriboi si rrallë kush për atdheun që dergjej në robëri për vendin, ku nuk u lind, por që se ndau asnjëherë nga shpirti i madh i tij.

Në zgjedhjen e prototipit letrar Camaj jo vetëm nuk qe gabuar, por ka arritur t’i japë krijimit të tij shumë domethënie interpretimi. Faktet që dimë për personalitetin e Gazullit për atdhetarizmin e tij në mbrojtjen e çështjes shqiptare dhe se ai shpenzonte të gjithë honoraret e tij për shërbime diplomatike për blerjen e armëve të luftëtarëve të Skënderbeut. Gazulli shquhej edhe për gojëtarin dhe stilin në të shkruar. Ai kishte marrë për veprën e tij astronomike dorëshkrim fjalë dhe vlerësime që flasin për vlerat e veprës. Në mungesë të njohjes së kolegët nga Hungaria i shkruajnë “... Na kënaqi më se tepërmi libri juaj... Vepra është e mbushur me kaq dije e gojëtarin, sa libri është i këndshëm për lexim dhe i dobishëm për studim”.

Modelin atdhetar, kulturor, dituror e humanist të Gazullit e plotëson edhe shëmbëlltyra e tij morale. Në testamentin që lë në fund të jetës me vetëdije të qartë, përveç shtëpisë u a lë të afërmëve. Shtëpia është ndërtuar prej tij në një tokë të dhuruar nga Senati i Raguzës për meritat e tij në lëmin diplomatik. Ndërsa për bibliotekën e tij personale, porosit që të ruhet në një institucion publik siç është kisha dhe aty të interesuarit të venë e t’i shfrytëzojnë ekzemplarët e saj pa i nxjerrë jashtë. Në novelën “Gjon Gazulli”, M. Camaj e ka plazmuar me art e finesë këtë portret real të humanistit të shquar duke e vënë në situata dhe mjedise që shquhen për konkretësi si endjet e filozofëve humanistë në sheshet e rrugët e zbrazëta të Padovës në vitet e vrullshme të katërqindës, udhëtimi i tij drejt Apenineve me karrocë, ndalesa në bujtinë që na e sjellin atë atmosferë dijesh, ndjeshmëri humaniste dhe koloritin e mënyrës së jetës.

Camaj është i pari dhe i vetmi që ka futur në një syzhe letrare një figurë poliedrike dhe enciklopedike si e Gazullit që ndan jetën dhe veprën në mes të të dy gadishujve të përflakur nga idealet humaniste. Fundi i novelës dhe persiatjet e protagonistit sado disi enigmatike janë ndër gjërat më mbresëlënëse që të shtyn të meditosh dhe bën që ky krijim nga më të arrirët e Martin Camajt, të mjeshtrit që jo vetëm krijon situata, mjedise të gjalla të një kohe historike edhe për ne shqiptarët, thuajse simbolike, që ishim pjesë e atyre zhvillimeve brenda dhe jashtë trojeve tona. Nën peshën e forcës së fjalës së Camajt këto kohëra dhe figura historike fitojnë një jetë të re.

Në leximin e veprës së Camajt në tërësi, por edhe të kësaj novele, ndjehet fort arti i fjalës, i gjuhës artistike të shkrimtarit. Një pasuri e pashoqe fjalësh, shprehjesh dhe mbi të gjitha kuptimesh e nuanca kuptimesh që ata bartin e bëjnë edhe këtë krijim të Camajt model të përcaktimit se letërsia paragjithçka, dhe pikësëpari është gjuhë, me të gjitha shfaqjet e saj jo vetëm si leksik, por si lidhje midis fjalësh në togfjalësha, në fjalitë e frazat, është ligjërimit dhe funksionimin e tyre të veçantë në prozën e shkrimtarit.

Shembuj shprehjesh të thuash proverbiale që ai shtin në punë në fillin e tregimit apo në gojën e protagonistit si *“si mos me pasë farën e fuqisë në kurm”*, *“se lodhja ishte ulë ndër gjuj”*, *“kur shqiptarët kishin nisë me kuptue se duhej të mblidheshin si kokrrat në shegë”*, *“shtroja jonë ku kemi ra me fjetë ka kenë kurdoherë gunga gunga”*, *“fijet merrnin me qitë krena gjarpërinjsh”*, *“si me dashtë t’i plasin rrashtën”*, *“si dardha bishtin”*, *“me krye në thes”*, *“mos me iu varë strojca as prej skarthi”*, *“as arra në lëvozhgë mos me iu marrë dore”*, *“ia paska çue ushël shtatin”*, *“zhytet fill në avullin e hamamit”*, *“e kapte djega për dhena të largëta”*, *“veshun për çudë”*, *“unë jam zemërpezull”*, *“flokë gjatë e mend pakë”*, *“me dorë në zemër”*.

Në qoftë se vepra e Camajt, tashmë e botuar e plotë në një korpus prej dhjetë vëllimesh flet për një jetë, shpirt dhe krijimtari që qëndron pezull midis vatrës shpirtërore shqiptare që ai mori me vete në mërgimin e gjatë sa vetë jeta, dhe botës së madhe ku u çmua, u nderua dhe fitoi famën dhe respektin e shkrimtarit, dijetarit dhe profesorit të shqipes,

novela Gjon Gazulli vjen si testament poetik i shkrimtarit Camaj, vlerat e të cilit u flasin lexuesve të të gjitha kohërave.

REFERENCA:

1. a. Ardian Klosi, Takimi me Martin Camajn, “M. Camaj” (Vepra letrare) 1, Tiranë, 1996, f.41
- b. Anton Nikë Berisha, “Martin Camaj” (1925-1992), “Jeta e Re”, Prishtinë, 1996, f. 100-101.
- c. Koçi Petriti, “Mbi poetikën e Martin Camajt”, “Studime për autorë të ndaluar”, Tiranë, 2008, f. 268-269.
2. Të gjitha citimet janë marrë nga vëllimi M. Camaj, Vepra letrare 5, Tiranë, 1996.

Martin Camaj man, poet, scholar, and between focal and the world & Novella "Gjon Gazulli"

In the article “Martin Camaj, man, poet, scholar and the world between focal” and novels "Gjon Gazulli" put in consideration the fact that all his work proves that he lived in limbo between the country and world.

This really follows the novel "Gjon Gazulli" which centered historical figure known distinguished humanist writer is the model for cultural and patriotic dituror. This novel is the most mellow of Martin Camaj.

Ledri KURTI (Shkodër)

**"DRAMA APO TEKSTE TË DRAMATIZUARA:
"LOJA E MBASDREKES" DHE
"KANDIL ARGJANDIT"**

Çanësimet e veprave vërte origjinale janë përherë të vishtira. Auktori, pa u kujdesue për gjinit letrare dhe tue lanë mbas dore mësimet e marruna në shkollë, e derdh landën në një kallep sui generis. Kjo tregon se i rrembyem prej dickahit të përmbrendëshem qi don të shpërthejë jashtë, kalon sipër modeleve të zakonshme dhe i shtjellon mendimet dhe ndiesit në trajtën ma t'udobët dhe të vetvetishme.⁵

E nis me këtë citim të Ernest Koliqit, më shumë për të pasur një mbështetje në fillimin tim me mendimet në të cilat më ka vënë tema, që unë kam marrë përsipër të trajtoj dhe që ngrihet mbi bazën e një dyshimi dhe pikëpyetjeje, e cila kërkon një analizë të tërësishme e të hollësishme të dramës si koncept, si zhanër në përgjithësi, ardhur nga Martin Cama si specifikë e këtij lloji, si trashëgim, jo më përmes aktrimit dhe skenës, por përmes teksteve të shkruara.

“Dramaturgjia është shkenca e konflikteve që ajo i trajton, sipas një tipologjie të “figurave tekstuale”. (Vinaver, 1993: 901).

Duke pasur të qartë, që nga natyrat më të njohura të konfliktit, në dramaturgji, janë: ngatërresë / zgjidhje; enigmë / zbulesë; ngatërresë / njohje, komplot / sqarim, për një 'dramaturgji mbyllur' klasike, kur lexojmë tektet e dramave të Martin Camaj, shohim se autori, zgjodhi për dramën “*Lojë e mbasdrekës*” natyrën e konfliktit enigmë/ zbulesë dhe për dramën e “*Kandili i Argjandit*” një tjetër natyrë të konfliktit, atë të ngatërresë

⁵ E. Koliqi, *Arti i Martin Camaj-t* në “*Jeta e Re*”, Revistë Letrare (Martin Camaj 1925 - 1992), Prishtinë, 1996, f. 9.

/zgjidhjes të bashkërenduar në brendësi të linjës së veprimit me llojin komplot / sqarim.

Si tekst, dramati e Camaj i shoqëron narrativitetin dhe të gjitha fazat e një skeme kanonike, të bëra të njohura nga Greimas. Këto faza, janë të respektuara dhe të aplikuara rigorozisht, po të kemi parasysh, se kjo skemë kanonike greimasiane, përmban katër faza, aplikimi përmes të cilave, realizon rrëfimin dhe marrëdhënien me lexuesin në fakt, dhe jo, audiencën përmes skenës.

Marrëdhëniet kryesore objekt - subjekt, startojnë me fazën e manipulimit të subjektit nga narratori, konkretisht tek "*Lojë e mbasdrekës*". Ky i fundit, narratori, kërkon të rrëfejë dhe dirigjojë, programin e vet narrativ.

Duke manipuluar dhe bërë pjesë të vetën, përmes bindjes, Zeka, si lloji i narratorit homogjen, brenda dramës, bind Bjeshkën – subjekt, për transmetimin e Objektit – variantit të "*Prronit të mbylltë*", sipas tij.

Ose narratori heterodiegetik, Camaj, përmes afeksionimit, ose bërit për vete të subjektit – lexues (faza manipulimit) për transmetimin e mesazhit – objektit – vepër letrare, që ai e quan dramë (e fut në marrëdhënie për ta bërë të pranueshëm) variantin e rrëfimit të tij, si dramë, jo përmes skenës dhe performancës, por përmes, tekstit.

Në fazat e mëtejme, subjektet, Bjeshka dhe lexuesit, të përfshirë në programin narrativ – të narratorëve përkatës dhe dirigjuesve njëkohësisht, zotërojnë aftësinë e kalimit në fazën e tjetër greimasiane, atë të kompetencës.

Faza e kompetencës, si provë kualifikuese e subjektit, tashmë i ndihmon ata, subjektet, të pajisen me formën mënyrore, që do të thotë, subjektet tashmë, pajisen me kërkesën ose nevojën për të ditur diçka që i pëlqen.

Lexuesi - subjekt me kompetencat që i jep autori, kërkon mënyrën se si rrëfimi i kategorizuar si dramë, do të arrijë përmes tekstit, dhe jo më, përmes skenës apo performancës skenike.

Ndërsa, brenda dramës “*Lojë e mbasdrekës*”, Bjeshka - subjekt, pajiset me tunikën e kompetencës, ose më saktë, ndjehet e detyruar ta zotërojë si të tillë, për hir të bashkëshortit.

Secila prej këtyre subjekteve (lexuesi tek drama e parë dhe bjeshka tek drama tjetër), ka drejtuesin e vet shpirtëror, i cili e udhëheq, sipas një skeme kanonike dhe modaliteteve të mundura të përzgjedhjes brenda kushteve që ajo i ofron.

Pikërisht, njohja dhe zbatimi i kësaj praktike narrative, i jep shanse autorit narrator, Martin Camës, të arrijë qëllimin duke bërë të nënkuptuarën të flasë përmes rreshtave të tekstit (skena përmes së cilës aktantët lëvizin përmes akteve) – si përmes dramës, si mundësia e vetme me të cilën, mund të arrijë aktualizimin e nënkuptimeve.

Por gjithnjë, Camën narrator e shohim, duke i përmbajtur sërish, parimit të tij për të cilin shkrintari nuk shpall artin e vet përmes deklamacioneve dhe e ndjejmë të arrijë të bërit efekt të topikës së vet të zgjedhur, përmes tekstit dramatik, dhe jo përmes skenës.

Faza e performancës, është pikërisht, kjo pikë në të cilën ne gjendemi, të bërit për të qenë. Veprimi i subjektit (lexuesit) dhe faza transformuese e nivelit më të lartë, që afirmon ekzistencën e dramës si e tillë, të Camajt.

Ndërsa, për Bjeshkën, tek “*Lojë e mbasdrekës*” ky modalitet, lidhet me fazën transformuese.

Transformimi ngjarjeve dhe jo sipas parashikimit (vënia përballë gjykimit të njerëzve të të shoqit dhe së kaluarës që ai mbante të fshehtë), shkakton reagimin e Bjeshkës, përballë gjyqtarit dhe Gjormit, apo edhe mjekut. Dhe kjo ndodh, për hir të kompetencave, që “autori” - Zekë i mveshi asaj (Bjeshkës), si tunikë për të mbrojtur variantin e tij, variantin, si fshehje e së vërtetës dhe po ashtu të bartjes së kompetencave që ligji kanunor i mishëronte asaj si grua.

Tashmë, faza e fundme - greimasiane, ajo e sanksionit. Kjo fazë, ka të bëjë me provën glorifikuese, ku autori – narrator (dirigjues) i skenave dhe akteve, të lexueshme, pret të dijë sa konform dhe në përputhje me

kontratën ose marrëveshjen fillestare për ta quajtur dramë, siç ai e quan, qëndron gjykimi i lexuesit.

Ndërsa për Bjeshkën- subjekt, se si ajo, do t'i qëndrojë marrëveshjes fillestare si kontratë me bashkëshortin, i cili në fakt ka vdekur gjatë gjyqit.

Duke ditur gjithashtu, se jo të gjitha mënyrat e përdorura në një program narrativ mund të jenë të përputhshme, pra ato, ndodh që mund të jenë në ndonjë rast, edhe devijuese nga rregulli i zakonshëm, në këtë linjë arsyetimi, edhe ne kemi të drejtë të vëmë në diskutim këtë lloj programi narrativ me të cilin autori, kërkon të na qasë si dramë, tashmë si përballë një kontrate narrative të mbyllur me sukses.

Atëherë: Dramat e Camajt u realizuan nga autori, si tekst me kriteret e një teksti dramatik, edhe me kriteret të respektuara të strukturimit të një drame, por edhe me devijime, shmangie dhe shije të re.

Duke anashkaluar kriterin bazë, që përbën një dramë, si tipar që e dallon këtë zhanër, performancën dhe skenën, si mjeti i cili e identifikon dhe e materializon qenësinë e saj si të tillë, përpiqemi të argumentojmë më tej: “*Loja e mbasdrekës*” dhe “*Kandili i Argjandtë*” si dramë:


Dihet tashmë, se drama, rrjedh nga greqishtja dhe do të thotë “veprim”, njëkohësisht është ndër zhanret që objektivist, vë në marrëdhënie dialoguese të folurin.

Drama e Camajt në këtë fillesë kriteresh përse i përket dialogut është e tillë. Njëkohësisht drama, shfaqet me nota realiste duke përsosur një prozë normale me një sharm të thellë, që i japin elementet simbolike, të ardhura me fjalën dhe përmes gjuhës së tij të hulumtuar si filolog dhe si bartës i një dialekti natyror geg, madje me aftësinë e të krijuarit të idesë, se realiteti i dramës së tij është një variant përfaqësimi i realitetit.

Në anën tjetër, nëse përpiqemi të gjykojmë dramën e Camajt, nisur nga struktura duke u mbështetur në skemën e dramaturgut dhe kritikut Freytag (Gustav Fraytag- dramaturg dhe kritik gjerman), i cili pasi ka analizuar dramat greke dhe dramat shekspiriane, tek drama, dallon një skemë solide të respektuar në vijimësi kohore, do të shohim:

- Analiza e Freytag: tek drama dallon:
 - 1.1 Expozicionin
 - 1.2 Rritjen e aksionit, veprimit
 - 1.3 Kulmi – pika kulmore
 - 1.4 Rënia e aksionit
 - 1.5 Zgjidhja ose katastrofa e ndodhur.

Piramida e Freytag



Struktura dramatike

Ka disa kërkesa që duhen përmbushur në dramë si zhanër i veçantë dhe dramaturgu ka për të respektuar rregulla të caktuara, që janë të rëndësishme për të bërë për vete audiencën.

Drama duhet të ketë një nivel të surprizës dhe suspensit.

Sipas për Freytag, një dramë është e ndarë në pesë pjesë, ose akte, që i korrespondojnë piramidës së tij strukturore, ideuar mbi bazën e harkut dramatik.

- Së pari, po t'i përmbahemi kësaj skeme kriter, për numrin e akteve dhe pjesëve, të studiuesit të dramave të ardhura që nga drama greke dhe ajo shekspiriane, menjëherë e kuptojmë, devijimin e parë të dramës tek Camaj. Dramat e tij ndahen secila në dy pjesë, me nga shtatë akte (ose Dukë) Le të kërkojmë strukturën dramatike sipas Freytag tek dramat në shqyrtim:

- Faza drejtuese: Tek dramati e Martin Camës respektohet përmes shënimeve dhe hyrjeve në kreun e çdo skene dhe pjese, për të na njohur dhe drejtuar në situatën përkatëse me vendin dhe gjendjen e ndodhur të personazheve, që do të hyjnë në veprim dhe komunikim me njëri-tjetrin, për të çuar më tej ecjen e dramës.

- Intriga:

Të hartuarit e intrigës, në dramën e Camajt, ecën përmes një serie ngjarjesh dhe modifikimesh të (akteve) dukjeve, nga pjesa e parë në të dytën, të cilat nuk ndjekin rigorozisht kronologjinë e pritshme, sidomos në dramën e parë.

Intriga ngre siparin që me Prologun. Në qendër të dramës ndodhet Zeka, që bart ose personifikon kanunin dhe “mëkatet” e ardhura prej tij si sistem rregullator i jetës malësore, ose paraqet dëshmitarin viktimë dhe xhelat njëherësh, të një sistemi të kthyer në kanun, mëkatet e të cilit, kërkojnë sqarimin dhe të vërtetën e sofistikuar gjendur brenda trillimeve gojore dhe jo të hetuara, prej 50 vitesh të ngjarjeve të zhvilluara simbolikisht tek “*Prroni i mbylltë*”.

Ndërkaq, Intriga, në dramën tjetër “*Kandili i Argjandtë*”, merr shkas si diskutim i çështjes së trashëgimit, menjëherë, në ditët e para të vdekjes së kryefamiljarit të një familjeje tregtare, e cila përveç kësaj, po jeton në situatën kohore të konfiskimit të arit nga shteti që po instalohej.

- Veprimi dhe konflikti

Në dramën e parë, është Zeka që fut në veprim dhe funksion, marrëdhëniet e kanunit me vitet e shkuara, vite të cilat bartin një të fshehtë dhe bëhen shkak i hyrjes në veprim dhe më pas në konflikt, sapo ai së bashku me to, duhet të përballen së bashku me të fshehtën me hetimin dhe ligjin.

Në dramën “*Kandili i argjandtë*” (familja tregtare) si njësi dhe që përfaqëson në quid unicum, individin – që simbolikisht ndodhet në dramën e vet, nga hyrja në konflikt të interesave të tij me sistemin / shtetin.

Konflikti i interesave të individit me shtetin hyn në veprim si përballje me të pamundurën. Një sistem që kërkon të ngrëjë themelet mbi pasurinë e tij dhe simbolikisht duke i rrënuar muret mbrojtës të tij.

Konfliktet e shfaqura në secilën prej dramave marrin formën e forcave kundërshtare. Përmes dramës individuale të personazheve – aktantë, tentohet të realizohet tendenca e vënies përballë të idesë së të vërtetës dhe moralit. Shpesh, vihet re dhe ideja e epërsisë që fitojnë në këtë kontekst herë njëra palë dhe herë pala tjetër.

Por gjithashtu, Martin Camaj tregohet shumë i kujdeshëm në gjetjen e ekuilibrit mes forcave.

Vëmë re, tek drama “*Lojë e mbasdrekës*”, do të kemi:

Zeka , Bjeshka, Djali dhe

Gjormi, Gjyqtari, njerëzit përreth,

Mjeku – mik (kumbar) i dhe armik i Zekës (dyshon se i ka vrrarë të atin), në moralin dhe të vërtetën, që ai përfaqëson si bartës dhe përçues i situatave dramatike, që barten prej tyre.

Tek drama “Kandili i Argjandtë” familja tregtare, si njësi më vete, përballë njeriut të huej, i cili gjithashtu është njësi më vete, si pjesa e dukshme e një eskorte të padukshme – shtetit dhe mekanizmave të tij. Ndërkohë, që edhe vetë pjesëtarët e familjes, brenda vetes, janë përballur me njëri- tjetrin, në ide dhe mendime të ndryshme. Edhe në këto marrëdhënie, të brendaqenësishme – familjare, Martin Camaj përpiqet të realizojë konfliktet dramatike, duke ruajtur edhe një ekuilibër kampesh dhe protagonistësh përfaqësues.

➤ Skena e hapjes

Ofron informata të mjaftueshme për të kuptuar çështjet e rëndësishme që do të vijnë. Përmes saj bëhet e qartë “Pika e sulmit”, thënë ndryshe çështja për të cilën do të bëhet fjalë në dramë, dhe që do të jetë pika e nxehtë drejt së cilës do të vijnë sipas një rendi të caktuar ngjarjet. Situatat do të kenë feedbackun (mbështetjen) e vet në krye të çdo pjese, përmes shpjegimeve paraprake hyrëse që Martin Camaj vendos në kreun e çdo akti dhe pjese. Në vetvete, këto hyrje të vogla ndihmëse, i shërbejnë autorit, si faza drejtuese, përmes të cilave shohim dhe presim se si dhe ku do ecë ngjarja, apo rrëfimi. Në skenat e hapjes shihet se ku konsiston rreziku.

➤ Ndërlikimi

Faza e ndërlikimit ndodh pikërisht kur karakteret përballen me pikëpyetjet, vështirësitë dhe pengesat, sikur ndodh me Zekën, i cili duhet të përballlet me të kaluarën e tij, të vërtetat dhe mëkatet e kryera, nëse ka pjesë apo jo, në gjakun e derdhur në zezonën e “Prronit të mbylltë”. Ky proces fillon me ardhjen e Gjormit në trevën ku përflitej për zezonën, dhe përpjekjet e tij për t’u takuar me Zekën. Më pas, ndërlikimi qaset këmbëkryq, kur vetë ai, Zeka, përballlet tek Jonja, si me gjyqtarin (ligjin e shkruar) dhe si me Gjormin (juristin e ardhshëm - perspektivën e ligjit).

Ndryshe (Kanuni i Lekë Dukagjinit, mbledhë e kodifikue prej A. Shtjefën Konst. Gjeçov, u botua në Shkodër më 1933), si ligji i kanunit, po përballej me fazën e rrënimit vet, përballë kurajos civile të kohës dhe atij brezi të ri që po kërkonte t’i ndalonte kufijtë e hijeve të saj në subkoshiencë e në të njëjtën kohë, të ndërgegjësonte memorien me të vërtetat që fshiheshin pas saj. Vetë vdekja e Zekës tenton pikërisht mbylljen e një kapitulli të kodifikuar për herë të parë si ligje të shkruara më 1933 nga At Shtjefën Gjeçovi, por jo të zbatuar për herë të parë. E kjo, ka të bëjë me përfaqësimin e një realiteti, por jo detyrimisht të realitetit vetë, si tërësi. E vëmë re këtë, sepse, në anën tjetër të medaljes së përfaqësimit të realitetit, nga autori, shfaqet një “kanun” i ri, me një sistem të zbatuar e ligjëruar 50 vjeçar.

Nëse tek “*Lojë mbasdreke*”, kërkohet përballja e heroit me të kaluarën, tek “*Kandili i Argjandtë*”, familjes tregtare i duhet të përballlet me të tashmen dhe me të priturat, që ajo i solli me vete.

➤ Kriza dhe kulminacioni (Klimaxi) – si katarsis

Karaktereve u duhet të përballen, *ndaj ato kthehen edhe në* qendra të tensionit.

Nga gjendja e tyre e re, gjendje e krijuar nga ndryshimi i rrethanave, këto karaktere vihen në krizë (si tek Zeka, po ashtu edhe tek anëtarët e familjes

tregtare). Në këtë pikë të vështirë për karakteret, ndjehet nga pena e Martin Camës një lloj lehtësimi për realizimin dhe përballjen me këtë fazë.

Konkretisht, ky moment i papritur lehtësimi, në dramën e parë, realizohet kur Gjormi shfaq keqardhjen se humbi mbrojtjen e parë (akt – juristi) në jetën të vet, në profesionin me të cilin ai pretendonte të kishte të bënte.

Ndërsa, tek Zeka ndjehet doza e vetëbindjes ndaj asaj, çka rezultoi si faj për të, si pjesëmarrës, dëshmitar dhe i përlyer në ngjarjen e ndodhur tek “Proni mbylltë”.

E pikërisht, ndonëse ishte karakteri brenda krizës dhe në kulmin e saj, pas shpalljes së tij si fajtor nga gjyqtari, në këtë moment Zeka i kthehet Gjormit: “*Të vjen keq se ke humbë pleqnimin, aspo?*”

Në çastin e tij më të vështirë, të shpalljes fajtor, Zeka, për një çast anashkalon situatën e vet në të cilën gjendet, ndonëse duket paradoksale, por që kjo mënyrë, shpreh lidhjen me mjeshtërinë e Camajt dhe me njohjen prej tij, të karaktereve malësore dhe të psikolingustikës së tyre. Këtu shfaqen dhe reflektimet e karakterit të tyre, që duke u shmatur nga kriza e vet dhe përpiqen të vënë në dukje, me sens maturie, pse – në e krizës, që mund apo duhet të ketë pësuar Gjormi, në kuvendimin e bërë, në mbrojtje ndaj tij dhe jo të merren me fatin e vet të përcaktuar tashmë.

Ndërsa në dramën “*Kandili i Argjandtë*”, kjo situatë lehtësuese që vjen si klimax me kulminacionin dramatik të ngjarjes, realizohet kur Prendi kërkon t’i ndizet gramafoni, si e vetmja pasuri (që i mbush shpirtin) e që nuk e lëshon edhe para *kandilit të argjandtë*.

Gramafoni me muzikën klasike, simbolikisht bart në konotacionin e vet, shpirtin – dhe të bukurën si pasuri, të cilat u bënë bashkudhëtare të Martin Camajt deri në vdekje, si dhe domethënien e shijes së tij të kultivuar me kulturën e formimin klasik.

Sërish edhe momenti, kur Prendi kërkon t’i ndizet gramafoni, duket si paradoks dhe absurd, i situatës në të cilën gjendet, pasi *njeriu i huej mori atë çka desht*, “*Kandilin e argjandtë*” (simbolikisht shkëlqimin e vobekët të pasurisë), por në fakt në derivatin e tij logjik, Martin Camaj e përdor këtë fakt, si element që të paktën në dukje i vë në “paqe” të gjithë, dhe tashmë në gjithçka e tek të gjithë ndjehet një lloj qetësimi.

Pas gjithë asaj krize që pësoi kjo familje dhe karakteret brenda saj, tashmë sikur identifikohen në qetësinë e lumtur të Prendit me magnetofonin.

Element tjetër i dramës, si e tillë:

- Antiklimaksi (ose dështimi, zhgënjimi ose zgjidhja sipas Freytag), si element i cili gjendet në të dyja dramat, por në mënyra të ndryshme për realizmin e saj.
- Në dramën “*Lojë e mbasdrekës*”: Zgjidhja, vjen përmes pranisë në dramë të një elementi - mjet shumë të përdorur në dramat klasike, që ka të bëjë me një *deus ex machina*, siç është vdekja e papritur e heroit, që bart intrigën, dramën, krizën dhe kulmin e krizës. Vdekja e heroit dramatik nga Perëndia, apo thënë ndryshe nga një element i jashtëm dhe jo nga dënimi i pritshëm, krijon një lloj kaosi, në aktor – personazhet e tjerë, si një sfidë e re tashmë para dhe ndaj tyre.
- Në dramën e dytë “*Kandili i Argjandtë*”, të duket sikur gjithë kjo dramë, e cila që në titull, të krijon idenë se gjithçka do të ndodhë brenda saj, do të jetë i lidhur dhe do të zhvillohet rreth një “kandili të argjandtë”(simbolikisht) pasurisë që duhet konfiskuar me dhunë.

Në fakt, pasi zhvillohet e gjithë drama, kriza e pritshme sjell me vete sqarimin, jo vetëm të qëllimit të marrjes së objektit simbol - intrigues, kandilit, por të gjithë pasurisë së familjes tregtare dhe rrafshimin e mureve simbolikë. Pasi ndodhin dhe gjithë ballafaqimet me njeriun e huaj (si mjeti – që funksionalizon qëllimin e një shteti, që kërkon të mëkëmbet mbi zhvatjen e pasurive private), pasuri, që në një kontekst më të ngushtë, bëhen dhe shkak i dramave të brendshme familjare, drama mbyllet me fjalët e Prendit:

Njeriu i huej kandilin e argjendit e unë gramafonin. Pak kush e di në këtë qytet se për mue gjaja ma e kushtueshmja në jetë ashtë Muzika (dhe tue dalë për derë – hyn autori për të sqaruar më tej, me - çon volumin e muzikës në gramafon.

Kështu, spektatorit i ofrohet procesi antiklimax, zgjidhja e shoqëruar me dozën e zhgënjimit (si paradoks), si element të cilin Camaj e përdor, si një

ndër elementet e ndërtimit strukturor të dramës, prej të cilit vërtetë di të përfitojë artistikisht.

Çfarë përfitoi?

Përfitoi

1. Dhënien e mesazhit të tij individual – për të treguar, se familje të tilla në thelb i shquan raporti me kulturën. Kultura dhe shpirti (muzika) ka vlerë mbi vlerat pasurore, në esencën e qenies dhe dallueshmërinë së tyre përtej mureve.

Ndërkaq që spektatori - lexues ndjehet i dështuar, se nuk arriti të kuptonte pikërisht këtë, në një dramë, e cila esencën e saj e ruan në fjalën e fundit dhe jo në gjithë situatën zhvilluar dhe krizën që u shkaktua për hir të pasurisë. Koha dhe Procesi i grumbullimit të arit nga shteti ishte koha e një drame, që lidhej më shumë me konceptet mbi të cilat po instalohesh një shtet.

2. Drama “*Kandili i Argjandtë*” ka të bëjë gjithashtu me aktin emblemantik të posedimit (zotërimit) të këtij objekti – simbol dhe figura e njeriut të huaj brenda kësaj drame, shtresëzon një të vërtetë historike, procesin e grumbullimit të arit dhe të instalimit të ideologjisë së rrafshimit të mureve – simbolikë, hyrjes në procesin e luftës së klasave, gjithashtu, së bashku me njeriun e ri që e zbatonte “kanunin” e instalimit të tij.
3. Realizoi obligimin shpirtëror dhe intelektual të transmetimit brezave, pjesën e dramave, që nuk duheshin harruar në analet e kujtesës kolektive. Duket se Martin Camaj, ia kishte vënë vetes me kohë këtë detyrë, fakt që të bie në sy, nga fjalët e Prendit, në *Duka shtatë, Pjesa e Parë*, f.120.

“Kam frikë se dramaturgët tanë në të ardhmen as që do ta përmendin periudhën e mbledhjes së arit...”

- Epilogu – përdoret si element i strukturës vetëm në njërin nga dramat e Martin Camës, konkretisht tek “*Lojë e mbasdrekës*”. Epilogu edhe këtu ruan po atë funksion që ka si të trashëguar, transmetimin e një mësimi moral, ku karakteret, në rastin konkret Gjormi mban një fjalim të gjatë, për të thënë atë që u duhet të dinë dhe të kenë të qartë lexuesit – spektatorët imagjinarë të Camajt.

Të tilla mësimet morale si:

1. *Edhe për ju që ndiqni këtë lojë një lutje: kur të mbetni vetëm, sonte ose nesër, as fjalët “gjak, gjakderdhje, zezonë, urrejtje” të mos ju bien ndërmend. Lëshoni përfytyrimet e idhëta në ujë të rrëmbyeshëm! Por mos na harroni ne, tue fillue prej një fmiye të vogël e të pagojë. Paraqiten të gjitha vehtjet ashtu si përmenden (metateksti) deri tek grueja mikpritëse, Jonja, mandej gjyqtari, mjeku i Prushit me gojtari malësore, kasapi nevrik i cili e çan dorën në thikë ndojherë, por ndalet, e tjerët.*
 2. *Këtu, tek më keni mue , andërrtar, bjerraditës të hutuem shpesh, por rrallë herë fjalëmadh e punëvogël. Shkurt: një që u përpoq me shfry trillime pa randsue askend aq fort e, sikur thonë në këto ana, gjithmonë në dyshim se po i shkon munda kot si atij që deshi me mbathë pelën me krande; ose me shkrue një tezë përmbi Kanunin e lekës për t’u ba doktor.*
- Dramat e Camajt – gjithashtu sikurse rregulli i përgjithshëm i dramave njeh, kanë një ose dy karaktere bazë: Zeka - Gjormi (“Lojë e mbasdrekës”) / Prendi (“Kandili i Argjandtë”)

❖ Cilët janë përjashtimet dhe çfarë vihet re në dramën e Camajt;

1. Numri i skenave, nuk është ai klasik i respektuar në pesë. Camaj i devijon këtij rregulli duke iu shmangur gjuhës të këtij standardi në dramë.
2. Aksioni, vendi, koha, si kodi i teorisë së tre uniteteve klasike për t’u respektuar në dramë si të tilla, janë të respektuara në dramën e Martin Camës.
 - Vendet: trevat e viseve, *përmbi se then qafën Drini/* dhe në dramën “*Kandili i argjandtë*”/ qyteti i Shkodrës.
 - Koha: në dramën e parë e shohim qartë të përmbushur si kriter të përcaktuar që në titull “*Loja e mbasdrekës*” (realizohet brenda një periudhe kohore të një pasdrekeje), që do të thotë se, ngjarja zhvillohet në rregullin e përfshirjes në harkun e brenda 24 orëve.

- Por, në dramën “*Kandili Argjandtë*”, kriteri klasik i kohës nuk respektohet. Harku kohor në të cilin zhvillohen ngjarjet përfshijnë gjatësinë e një jave, me ditë dhe netë.
- Në fakt, ajo që duhet vënë re është fakti, se të dyja dramat ngrenë topikën e vet, mbi një kohë të kapërcyer. Kështu lexuesit i nevojitet të kalojë përmes procesit të reminishencës, ose rivitalizimit të kohës.
- Duke ditur që veprat dramaturgjike si lloj, në përgjithësi nuk janë të destinuara për publikim por vetëm për paraqitje dhe duke pasur parasysh se principi themelor i teatrit klasik ishte pastërtisht paraqitja e ngjarjes / ndodhisë, dramat e Martin Camës vijnë mrekullisht bukur, përmes rreshtave të lexuar dhe hetimit, që lexuesi duhet të bëjë përmes tyre, për të shijuar plotmërinë dhe kuptuar topikën dhe konotacionet.
- Martin Camaj, funksionalizon në dramë edhe komunikimin gjestual. Djali i pagojë, është risia e përfshirjes së këtij komunikimi, si rinjohje dhe kujtesë e pranisë së një komunikimi të hershëm shenjor të njerëzimit, komunikim, i cili merr dhe jep kuptime përmes gjestualitetit dhe ka pozicionin e vet funksional në dramë.
- Në dramat e Martin Camës, gjejmë përdorimin e paratexteve dhe metatexteve, pothuaj në kreun dhe brendinë çdo akti (Duke)
- Duke u nisur nga postulati i postmodernizmit, i cili thotë se nuk ka text pa intertext, nëse ne do të gjykonim në këtë këndvështrim mbi dramat e Camajt, atëherë fare mirë do të vinim re këtë prani të intertexteve brenda textit të tij dramatik, si prani të komunikimit aktiv mes dy teksteve, atij letrar dhe joletrar që ekziston në to.

Konkretisht, në dramën “*Lojë e mbasdrekës*”: Zbulimi i mëkateve dhe pasojave, që solli shthurja e ligjeve të kanunit (përmes shkeljes së një rregulli të tij në ritin e përcjelljes së të vdekurit - konfrontuar me dëshirën e lënë amanet për sofrën e vdekjes) në kuptimin joletrar dhe gjykimi i së vërtetës së fshehur jo më pas shthurjes së kanunit, por pas shturjes së një sistemi – kuptimi letrar i tij.

Në “*Kandili i Argjandtë*”: Plotësimi i një dëshire të nënshtresëzuar nga femëria, për kandilin e argjandtë kuptimi joletrar, dhe aktualizimi i

filozofisë së instalimit të një sistemi duke shkelur mbi konceptet pronës private dhe hapur udhën e një sistemi të ri.

Më tej, po në këtë linjë, mund të themi se komunikimi veprës letrare (Dramave) të Martin Camës realizohet jo vetëm me tekste të tjera (siç ishin tekstet e kuptimeve me të cilat ato na qasin), por edhe me kontakte të tjera: të tilla si konvencionet, kodet, normat e ritet.

Në këtë logjikë, nuk më duket e rastësishme përzgjedhja e kanunit dhe e trevave të veriut si dhe qyteti i Shkodrës dhe familja pikërisht tregtare shkodrane, ato të cilat ai i bën objekt të topikave të veta.

Ku më shumë se ndër këto referime do të kishte arsye për t'u qasur për të qëmtuar dhe rimarrë në fokus konvencionet e të jetuarit, menduarit, gjykuarit apo të gjente pasurinë e atyre elementeve të domosdoshme si ritet, normat, kodet me të cilat më pas, do të mund të ngrinte skenën e tekstit ku të gjitha këto elementë përbërës intertekstualizohen për t'i krijuar mundësinë aktualizimit të topikës së përzgjedhur?

Po të gjykonim, nisur nga Roland Barthesi dhe konceptet e tij *lissible / scriptible* (e shkrueshme/ e lexueshme), do të thonim se tekstet e dramave të Martin Camës përfshihen në tekste, që nxisin lexuesin për t'i gërmuar, për t'i vendosur në botëra dialogjike.

Kështu, dramat e Martin Camës të ofrojnë të tria limitet e interpretimit që përcakton U. Eco, duke të krijuar mundësi fokusimi të ndryshme:
(f. 84)

Konkretisht:

1. Kuptimi letrar i tekstit - vjen përmes pasurisë leksikore, frazeologjive dhe shprehjeve.

Janë ato përmes të cilave, aktorët shndërrohen në atantë veprues përmes konstituimit të dimensionit semantik të modelit gjenerativ, nëse i referohemi termave të Greimas dhe rregullon aspektet e kuptimeve të ardhura nga struktura e thelluar, e quajtur ndryshe, ajo e nivelit semio – narrativ.

Marrëdhëniet e vendosura mes tyre, pra atatëve, janë marrëdhënie që materializojnë bashkëveprimin subjekt -objekt në rrëfim, përmes diskursit por edhe veprimeve.

Atantët dalin kështu, edhe si sinonime të veprimit që ndërmarrin, duke materializuar filozofinë e jetës dhe kodet përmes së cilave, ne si lexues, do mund të arrijmë të hyjmë në labirintin e semantikës së tyre.

Semantika e këtyre sinonimive dhe diskurseve mbështetet gjithnjë në idenë e ngjeshur në bërthamë të tyre, për të fituar kuptimin e esencës së këtij populli, që arriti të mbijetojë përmes aftësisë dhe fuqisë me të cilën u ushqye mbijetëtesa e individit shqiptar, si i tillë (malësor, qoftë ky, tregtar, apo edhe të kuptojmë, po përmes shprehjeve dhe cilësisë së leksikut të përzgjedhur, instalimet e filozofive të reja, të ofruara dhunshëm apo jo të tilla, jetëgjata apo jetëshkurtra paçin qenë ato (kanuni, apo sistemi ideologjik).

Përmes memories individuale ardhur si e trashëguar e asaj kolektive si filozofi e jetës dhe rrëfimit logjik të ngjarjeve të ardhura përmes konotimeve, që marrin idetë dhe gjithashtu përmes eksperiencës gjuhësore të bartur si pasuri dhe të kultivuar tek Martin Camaj si filolog, arrijmë të shijojmë përmes dramave të tij, të tilla kuptime letrare të cilat, u japin atyre, sharmin që s'mund t'u mungonte kurrsesi as kësaj pasurie që i lë thesarit të letërsisë dhe gjuhës shqipe ky autor.

Kuptimi i zakonshëm. Kuptimi zakonshëm, vjen përmes sipërfaqes së topikës, cila fokuson në vete, gjithçka lëviz dhe ndryshon, nga Duka në Dukë, e dy pjesëve nga Prologu në Epilog, tek njëra dramë, dhe nga pjesa e parë në të dytën, me secila nga shtatë dukë (skena / akte) tek drama e dytë, përmes një lehtësie manovrimi dhe bërit për vete të lexuesit, i cili priret të gjejë dhe shohë këtë kuptim, përmes të perceptuarit si lloj, dramë, sikur edhe autori vetë i quan.

Ky kuptim, që realizohet i konstituuar nga modeli gjenerativ i Greimas si dimension i sintaksor, i cili rregullon aspektet e ndërtimit formal të kuptimit, e që më pas, krijon ose më saktë përbën atë, që quhet struktura sipërfaqësore, e quajtur ndryshe diskursive ka të bëjë me kuptimin e dukshëm të tekstit, që Camaj na ofron në dramën e veta.

Dhe limiti i tretë i interpretimit:

Koherenca e tekstit. Koherenca është e pranishme në dramat e Camajt, si shfaqje dhe si unifikuese e qëndrueshmërisë dhe logjikës së zhvillimit të ngjarjeve të rrëfyera si nga narratori qoftë heterogjen apo edhe nga narratori homogjen (Zeka) në dramën “*Lojë e mbasdrekës*”.

Po aq koherenca, në dramat e Camës ka të bëjë me syrin vëzhgues të dramaturgut, që organizon dhe respekton si linearitetin edhe logjikën e llojit të tekstit që merr përsipër (si dramatike) përmes mjeteve narrative, po aq sa respekton edhe logjikën dramatike dhe tiparet e dramës si lloj, të cilat vijnë të zbatuara konkretisht, përmes kronotropeve (konceptit bachtian) të kohë – hapësirës gjeografike të menaxhuar dhe të akorduar me fjalët dhe shprehjet, me tërësinë dhe thellësinë e tyre. Koherenca, që ruan Cama në dramat e veta na ndihmon në zhvleftësimin e hipotezave të shpejta.

Së fundmi, rikthehemi në pyetjen, që kemi shtruar për zgjidhje: “A është dramë apo tekst dramatik, lloji i dramave të cilat Camaj vetë i quan të tilla”? Por, në bazë të asaj çfarë pamë deri më tani, do t’i duhet dramaturgëve, nëse do të marrin guxim apo jo, ta bëjnë dramën e Martin Camës të flasë përmes skenës, me nivelin dhe bukurinë me të cilat ato flasin përmes tekstit dramatik, ta vërtetojnë aftësinë e tyre, për ta provuar efektin skenik dhe nivelin e performancës përmes tyre.

Drama of Martin Camaj as a new experience of this artistic gender

Drama gender in general have not intended to be published in a writer book, but is only for presentation and interpretation in the public face through scena, giving in that way, that the underlying principle of purely classical theater: presentation of the event.

But, the beautiful drama of Martin Cama, come through rows of reading text and investigation that, the reader should do through them, to enjoy and understand topics and connotations. We can see, a new form of presentations of this gender, as author called, his artistic work, as drama.

Coherenca text - Coherence is present in Camaj dramas, as the unified display and development logic of events, as it is narrated by the heterogenous narrator of and when the other drama is be narrated by the narrator as homogeneous.

Through individual memory, coming as it inherits the collective philosophy of life and logical story Camaj comes through connotations and ideas, through specific language and experience, and he know well, as to transfer wealth and to be an example of cultivated philologist.

Key words.

Drama, classicc gender, new experience, narrator, interpretation, conotation, expression, etj.

Zef GJETJA (Tiranë)

TRAJTIMI I VENDLINDJES NË VEPRËN E MARTIN CAMAJT

Të nderuar kolegë, studiues, pedagogë, hulumtues dhe dashamirës të veprës, si dhe ju të afërm të Martin Camajt:

Ndjehem i nderuar që jam ftuar në këtë konferencë më vlera të veçanta që i kushtohet një figure komplekse, me kontribute të shquara në shumë fusha të trashëgimisë kulturore, pasurisë gjuhësore, vlerave intelektuale dhe njerëzore, dukagjinasit dhe shqiptarit: Martin Camaj.

Secili nga pjesëmarrësit në këtë takim, tashmë e dinë mjaft mirë që Martin Camaj bën pjesë tek ato figura të shquara, ku sa më shumë të hulumtosh në veprimtarinë jetësore dhe në krijimtarinë e tij, do të gjesh gjithmonë gjëra të reja, vlera që më parë janë kaluar shkarazi apo nuk janë vënë re sa duhet. Unë bëj pjesë tek ata njerëz që janë vënë në kontakt me veprën e Martin Camajt, relativisht vonë, për shkaqe tashmë të njohura. Por, kjo gjë më ka krijuar një avantazh (nëse mund ta quajmë të tillë): më ka krijuar mundësinë që veprën e Camajt ta lexoj e më pas ta studioj, në një moshë të pjekur, gjë që më ka ndihmuar të jem më i thelluar në përjetimet dhe vlerësimet rreth kësaj vepre. Por, nuk duhet harruar që vepra e Martin Camajt paraqet një univers të tërë, i cili mbetet për t'u eksploruar nga lexuesi shqiptar, e për pasojë nuk është e mundur që një studiues të deklarojë se tashmë e ka studiuar plotësisht këtë vepër.

Në këtë material të shkurtër, unë jam përpjekur të paraqes një aspekt të veçantë të veprës së Martin Camajt: pikërisht, trajtimin e vendlindjes në veprën e këtij krijuesi me vlera unikale në llojin e tij. Megjithëse nuk është një gjë e re, fakti që Martin Camaj ishte lindur e rritur në Temal të Dukagjinit, ka një rëndësi të posaçme për shkak se imazhet e fiksuara që në vogëlinë e vet për natyrën, njerëzit, atmosferën dhe gjithçka që e rrethonte,

e kanë shoqëruar Martinin në të gjithë hapat që ka hedhur në jetën e vet. Gjithë çfarë shkroi e bëri Martin Camaj është kërkim në kujtesë, reflektim artistik dhe me mendim të thellë, i vendlindjes së vet, i bashkëfshatarëve, të njohurve dhe të afërmëve të tij, të rrethuar nga ambienti karakteristik i Alpeve shqiptare.

Vepra e Martin Camajt mund të konsiderohet si një jetësim artistik, me shumë ndjenjë dhe mendim intelektual, i natyrës së mrekullueshme të vendlindjes. Ai u largua nga vendlindja e vet në një periudhë kritike për jetën e vet, dhe të familjes së tij, por edhe për fatet e kombit. Por, gjithë kah shkoi, Martin Camaj nuk ishte një krijesë e thjeshtë humane, përkundrazi, ai ishte një personazh shumë i rëndësishëm dhe mjaft kompleks, që mori me vete “katalogun” kulturor të krahinës së tij. Temat e mirëfillta janë përgjithësisht: natyra, vetmia, ruajtja apo edhe humbja e traditës, kërkimi i fatit dhe i suksesit, lidhja me vetë rrënjët e zonës, dokeve dhe traditave të njerëzve të kësaj zone. Mbizotërimi i karaktereve poetike letrare dhe komentimi i gjerë i problemeve të gjuhës, letërsisë dhe artit në përgjithësi, janë gjithashtu nëntema të veprës artistike.

Pamundësia për t’u kthyer në vendlindje ka rezultuar mjaft stresante dhe e vështirë për jetën personale të Martin Camajt, por, pikërisht kjo situatë e pafavorshme për krijuesin e talentuar, përbën burimin për prurje cilësore dhe mjaft të rëndësishme për letërsinë shqipe. Kjo, sepse atë që rrethanat nuk ia kanë lejuar që ta bëjë fizikisht, Martin Camaj e ka realizuar nëpërmjet artit të tij shumëplanësh. Është e vështirë që në ndonjë vepër tjetër të letërsisë shqipe të gjejmë kaq shumë atdhe, kaq shumë fëmijëri, kaq shumë vendlindje. Vepra e tij është dëshmia më e mirë e përpjekjes për të mos i humbur të afërmit, rrethin e tij shoqëror, atdheun, vendlindjen. Në të gjithë krijimtarinë e tij, Martin Camaj është aty, me të gjitha aromat, ngjyrat, shijet, dritëhijet, mënyrën e të menduarit dhe të sjelljes. Sa herë që ulej për të shkruar, një vegim i mbushte qenien e tij, duke e bërë njësh me kujtimin e vendlindjes së vet. Në këtë drejtim ka ndikuar edhe ambienti ku ai jetoi, në Mynih të Gjermanisë, ambient i cili kishte shumë pika të përbashkëta me ambientet e Temalit, Telumit, Kirit apo zonave të tjera të Dukagjinit.

Ndaj, mund të thuhet se vendlindja e Martin Camajt ka pasur një ndikim shumë të fuqishëm në gjithë krijimtarinë e tij. Dhe kjo gjë mund të shikohet në kompleksitetin e veprës që ka krijuar dhe na ka lënë si trashëgim Martin Camaj. Megjithëse nuk ka qenë e lehtë që të veçohen elementët e ndryshëm të pasqyruar në veprën e Camajt, mund të përmendim disa prej aspekteve më kryesore të elementëve ku vendlindja shfaqet dukshëm.

1. Fillimisht, bien menjëherë në sy titujt e veprave kryesore të Martin Camajt, të tilla, si: *“Kanga e vërrinit”*; *“Djella”* (novelë); *“Legjenda”*; *“Lirika mes dy moteve”*; *“Njeriu më vete dhe me të tjerë”*; *“Rrathë”* (novelë); *“Shkundullima”*; *“Nji fyell ndër male”*; *“Karpa”* (novelë), *“Drandja”* (madngale), *“Kandili i argjandit”* (dramë), *“Loja e mbasditës”*, etj. Pa u thelluar në analiza të hollësishme, këto tituj tregojnë në mënyrë të qartë dhe shumë shprehëse lidhjen që autori ka treguar me vendlindjen e tij. Ai për asnjë moment nuk është shkëputur nga elementët që i ka fiksuar në mendjen e tij, nga fjalët apo emërtimet me të cilat ai është ndeshur që në lindjen e vet.

Krijimtaria në prozë dhe në poezi e Martin Camajt përshkruhet plotësisht nga atmosfera e zonës së Temalit, Kirit, Prekalit, Cukalit, etj. ashtu siç e mbante mend autori. Nëse vërejmë dy vëllimet e para me poezi të Camajt (krijime në poezi "Një fyell ndër male", Prishtinë, 1953 dhe "Kanga e vërrinit", Prishtinë, 1954), duket qartë se ato ishin frymëzuar nga motivet e vendlindjes dhe ishin në frymën e së ashtuquajturës "Shkollë letrare e Shkodrës", pjesë e së cilës u bë gjatë periudhës së shkollimit. Në veprat e mëvonshme, ndikimi i vendlindjes ka qenë i vazhdueshëm, por mënyra e të shprehurit ka variuar, në vartësi edhe të llojit të krijimtarisë, si dhe të subjektit të saj. I ndjeshëm tej mase ndaj motiveve të vendlindjes e fëmijërisë, ai në gjithë poezinë e tij përpiket të universalizojë elementet thellësisht shqiptare, si peizazh, mitologji, mentalitet e karakter.

2. Shumë e lidhur me titujt e veprave të shkruara dhe të publikuara nga Martin Camaj, janë edhe elementët natyrore të pasqyruara në këto vepra. Kështu, majat e thepisuna, krojet, lugina e lumit, shkurret apo lisat që bëhen pjesë e veprës së Camajt, përshkruhen me elemente mjaft të

fuqishëm, që vetëm një njeri pasionant, i ngritur profesionalisht dhe shumë i lidhur me vendlindjen e tij, mund t'i përshkruajë në këtë mënyrë.

Gjithë kjo pasuri natyrore e kulturore që gjendej në krahinën ku u lind Camaj, sipas traditës së banorëve të zonës, ruhej brez pas brezi dhe u lihej amanet që të mos harrohej. Kështu, nga çdo pinjoll i zonës së Dukagjinit, çmohej kujtesa e thënë nga dikush dhe e dëgjuar diku, aq sa shikohej si detyrë transmetimi ndaj të tjerëve. Është ky shtrati i sjelljes së Camajt, ndaj edhe lugina e Kirit, shtrati i Drinit, Cukali madhështor, majëmalet, e shoqëruan gjatë gjithë jetës. Po në vendlindjen e tij, u ngjizën, strukturuan, por edhe e shoqëruan kujtesën gojëdhënat, legjendat, mitet etj., të cilat u bënë filli që përshkon veprën letrare të Camajt.

Dua të paraqes një vjershë të krijuar shumë vjet më parë nga Martin Camaj, kur ai ishte mësues në Prekal, që i kushtohet lumit Kir. Këtë vjershë e kujton Lulë Ndoja, ish nxënësja e tij:

Kirit

Rrnosh e kjosh more ti Kir,
Si k'to brigje i kalon
Ti gjithmon' si bab' i mir'
Djemt e tu kurr s'i harron.

Un' sa grima kur u bana
Me nrrue hapa, me shetit
Mue për dore tuj m'ajt nana
N'brigje tua jam flladit.

Ti je bab' e ti je nan'
Ti je shoqi i jetës time
Me u nda teje mos kjoft' than'
Due n' gji tan t'jetoj me g'zime.

Martin Camaj, 1948

Drama “Loja mbasdrekes” trajton disa shkaqe të shthurjes së kanunit të Lek Dukagjinit nga fillimi i shekullit XX. Ajo u shkrua në atë mënyrë që të lexohet lehtësisht, thuaj si novelë, për t’u kuptuar drejtazi dhe pa u vënë në skenë.

Romani “Karpa” e vendos subjektin në brigjet e lumit Drin në vitin 2338, ndoshta për këtë autori ka parapëlqyer ta quajë “Parabolë”. Ky roman si dhe vëllimi me proza “Shkundullima” shquhet për një kërkim strukturor në rrënjët e zanafillave, jo vetëm si përsiatje e vazhdueshme, por edhe si gjuhë, në të gjitha dimensionet e saj. Pesë novelat e vëllimit “Shkundullima” janë zgjedhur prej shumë shkrimesh, sipas disa cilësish të përbashkëta, por ato kanë dhe ndryshime. Këto proza paraqesin dy mjedise: i pari lidhet me atmosferën në disa vise të Shqipërisë së Veriut, ku thellësia e bjeshkëve ndahet nga qafa malesh prej fushave të gjera, ndërkohë që pjesa tjetër është e gërshetuar me përjetime të tjera.

Ndërsa vepra tjetër e rëndësishme e autorit, “Dranja” që filloi së shkruari rreth vitit 1975 dhe mbaroi më 1979. Në vetvete, kjo vepër pasqyron fatin e vetë poetit, i cili është i ngjashëm me fatin e Dranjës, breshkës së mitizuar në madrigalet e tij, perëndeshës së kujtimit të dalë nga Dheu: “Po e kapi dikush si për lojë ta marrë me vete ndër dhena tjera, ajo mbaron me të tana! Për Dranjen buzëhollë, lëpusha e laknës së huej nuk e ka shijen e duhun e njimsinë e avullit, i cili si me qenë pëlhurë, i mveshet bimësisë buzë Drinit në mëngjes. Larg këtij vendi edhe shpirtin e jep e s'prek gja me gojë”. Breshkë, rruzull më vete “s'prek gja me gojë” dhe “shpirtin e jep”, më vërtetësisht se në metaforë, ashtu si njeriu dhe shpirti i tij, që kur s'ka ç'të prekë me gojë mbahet me ngjizje.

3. Emrat e personazheve dhe në mënyrë të veçantë mentaliteti i tyre, janë pasqyrim shumë i qartë i elementeve që Martin Camaj kishte marrë nga vendlindja e tij. Martin Camaj, ka thanë për veten se “Qënia malësor s'ndahet meje”. Si rezultat i këtij pozicionimi, e gjithë vepra e tij është ndërtuar mbi strukturat e traditave gojore të vendlindjes së tij dukagjinase, duke mbetur thellësisht shqiptare dhe njëkohësisht evropiane. Drandja, Diella, Baci, Drenashi, Fetori, Agoni, Sosja, Zoja, Frani, e shumë emra të tjerë që përdoren nga Martin Camaj në veprat e tij, janë emra tipikë

dukagjinas. Ai i kishte të gjitha mundësitë që në veprën e tij të përdorte emra “modernë”, si të vendit apo të huaj, por Martin Camaj preferoi të përdorte emrat tipikë të zonës prej nga vinte. Në disa raste, ai ka përdorur edhe krijime të tij, si: Folkloristi, Drenashi, Agoni, etj., që i jep akoma më shumë vlera veprës dhe krijimtarisë së Martin Camajt.

Por, të një rëndësie të veçantë janë edhe figurat që janë marrë si simbolikë në veprën e Camajt. Si të tilla janë: breshka, dhia, delja, rrathët, gjak-nxehtë, pëllumba, gjarpër, orlat, ujku, lumi, shkrepat, piskamat, dallëndyshja, majat e thepisuna, karpa, nema, bualli, dheu i arbënit, e shumë të tjerë, që i japin vlera autentike veprës së Camajt. Në të njëjtën kohë, këto emërtime dhe përdorimi me vend i tyre, i japin vlera të veçanta veprës së Camajt, por njëkohësisht dëshmojnë lidhjen e fortë të autorit me vendlindjen.

Burrat e sjellnin në kuvend bindshëm, urtësisht e kuptimplotë, fjalën e kishin të ngarkuar me mendim mbresëlënës. Ky lloj elementi tipik i malësorit është mbartur dhe pasqyruar mjaft mirë në veprën e Camajt. Këngët në gëzime, ato të trimërisë, gjama e të vdekurit ishin veprime që demonstrojnë vlerat e pasurive shpirtërore e kulturore të krahinës dhe më gjërë.

Të gjitha këto u bënë nxitje që Martin Camaj që në rininë e tij të meditonte, e kështu filloi të krijojë vetë në mënyrë të figurshme këto madhështi që i rrethonin mendimet dhe idetë e tij. Gjithë kjo pasuri, u përdor me mjeshtri nga Martin Camaj, në veprën e tij, duke i dhënë karakter të theksuar kombëtar.

4. Figuracioni i përdorur në veprën e Martin Camajt është i pasur, i veçantë dhe shumë i lidhur me vendlindjen. Krahasimet popullore dhe frazeologjizmat, si dhe një variant i pasur gjuhësor i gegërishtes, fjalori i zgjedhur janë karakteristike për gjuhën që Martin Camaj ka përdorur në veprën e tij. Baza e tregimit qëndron në monologët e pasur, të brendshëm dhe bisedës së gjallë.

Modeli i lirikës dhe i legjendës i trajtuar edhe nga poetë modernë të parapëlqyer nga autori, si Ungareti, do të ketë begati zërash e ngjyrash, zogjsh e drurësh, jehonash e përfytyrimesh, shpellash e hapësirash,

strofullash e rroqaqiellash, gjithnjë në funksion të njeriut tragjik shqiptar, që “rri njëqind vjet vetmi, nën hijen e korbit të zi”.

Duke menduar se do të ketë edhe referues të tjerë që mund të kumtojnë rreth figuracionit të pasur të përdorur nga Martin Camajt në veprën e tij, nuk po zgjatem më tej në këtë aspekt.

5. Gjuha e përdorur në veprën e Martin Camajt, ka qenë dhe mbetet objekt diskutimi i shumë studiuesve. Natyra e veçantë dhe specifike, e shtrirë në morinë e teksteve letrare, aq të larmishme dhe magjike në pasqyrimin e realitetit letrar, përveç të tjerash, buron nga gjuha e përdorur prej tij. Gjuha poetike, e poezisë, por edhe e prozës dhe studimeve gjuhësore dhe letrare, formaton vazhdimin e ligjërimit të variantit letrar të gegërishtes, në një nivel të admirueshëm në përjasje me zhvillimin e letërsisë zyrtare, të mbytur në molin dogmatik letrar dhe gjuhësor.

Kjo sipërmarrje personale, që realisht tejkalon punën e kryer prej akademive të molepsura ideologjike, kaq e plotë dhe e gjithanshme, ka ndodhur me vetëdije të shpallur gjuhësore dhe letrare, me vetëdijen që shpërthen dhe vjen e plotë si dimension vertikal dhe horizontal, prej njohjes së vlerave shkrimore të këtijdialekti dhe të shqipes në përgjithësi, dhe në mënyrë të veçantë prej bindjes së thellë se larmia shkrimore është thelb i pasqyrimin të gjithë mundësive shprehëse, është materie letrare e papërsëritshme.

Le të sjellim këtu vetëm një fragment të shkurtër, të shkëputur nga “Drandja”: “Ishte verë e natë e shëndritun kur i ra në hundë një erë si e vezëve të breshkave të çeluna. E ndoq deri në strehën e një tëbane, hypi për një dërrasë që ishte zgripi i një korite e ra në qumësht. Si atij që ashtë tue u mbytë në Drin, i shkuen padashë disa cirka nëpër gërlac e iu kand; ma vonë u mësue në të”.

Ndërkohë që poezia e Camajt është e veçantë, mjaft e pasur dhe duket që ka marrë jetë thellë nga traditat gojore të Dukagjinit. Poeti duket si një shpuzë plot kangë, përralla, legjenda, fjalë të urta të malësorëve, në mesin e të cilëve është rritur e formuar. Stili i ngjeshun deri në formulë, stili plastik dhe plot imagjinatë i traditave gojore përbën themelin e poezisë së Martin Camajt, e cila stilistikisht paraqet simbiozën dhe tematikisht

përballimin e arkaikes me modernen, duke na dhënë një ngjizje që pasqyron individualitetin e autorit.

Studimet që Camaj mori në kolegjin Saverian, kanë qenë përcaktuese në orientimin e tij kulturor dhe intelektual. Në përshtatje me formimin që Camaj ka marrë aty, ai u bë vazhduesi më i denjë i veprës së autorëve të letërsisë shqipe në gegnisht nga Budi tek Mjeda e Koliqi, etj. Mund të thuhet se Camaj është ndoshta i vetmi autor modern shqiptar i denjë për të vazhduar trashëgiminë e ndritur të tyre. E zhvilluar në mënyrë të natyrshme dhe jashtë presionit të letërsisë dogmatike të realizmit socialist, vepra e Camajt është niveli më i lartë i zhvillimit të letërsisë moderne shqipe, duke na u paraqitur si një individualitet i veçantë.

Duhet thënë se formatimi i nivelit të mjeshtrit të fjalës poetike duke e harruar faktin e thjeshtë se jeta rinore, e mbushur me vrullime dhe ndodhi, gjer në moshën njëzet e një vjeçare, kanë lënë gjurmë të pashlyera në jetën e njeriut, e sidomos të artistit dhe shkrimtarit. Moshë e artë rinore është ajo pjesë e jetës, që ngulitet në thellësi të shpirtit dhe përndizet sa herë ta lyp nevoja për të derdhur magjinë letrare, si një frymim i vetvetishëm.

Siç është shprehur edhe vetë, ai ka qenë i dashuruar me gjuhën shqipe dhe i shfrytëzoi në maksimum mundësitë e saj shprehëse. Martin Camaj njihnte shumë gjuhë, por e veçanta ishte se i njihnte ato në thellësi, duke krijuar kushte të analizës gjuhësore. Ndër gjuhët që njihnte në thellësinë e tyre mund të veçojmë: italianistikë, romanistikë, gjermanistikë, sllavistikë, teori letërsie, gjuhë klasike, etj.

Njohja e poezisë moderne të poetëve më të njohur botërorë, ndikuan në formimin e tij kulturor, ndërsa vepra e tij, qoftë në prozë apo në poezi mbështetet tërësisht në gjuhën shqipe dhe si përmbajtje i ka rrënjët në kulturën shqiptare, sidomos në mitin e trashëguar. Siç shkruan studiuesi i njohur Robert Elsie: “Prandaj nuk është e rastit që Camaj zgjodhi për të banuar një vend të shkëlqyer, me atmosferë disi të paqme e të virgjër shtëpiake, si alpet e Bavarisë, që çdo çast i kujtonin malet e thepisura të vendlindjes, ku nuk mund të kthehej kurrë”.

Pasuria gjuhësore nuk i erdhi Martin Camajt në mënyrë të rastësishme, por ishte e lidhur me gjithë aktivitetin e tij jetësor, qysh nga

fëmiria e tij. Kulla e Camajve spikati që herët se djali i tyre mund t'i nderonte po t'i krijohej mundësi që të shkollohej – zbriti në Shkodër dhe shkollimin e filloi në Kolegjin Saverian. Kjo dha efektivitet të menjëhershëm. Djali spikati në talentin e tij. Kështu profesorët zbuluan talentin dhe nuk u gabuan. Dhënia mësim në shkollën e Prekalit (1946-1948) e bëri më ëndërrimtar dhe më të përgjegjshëm për misionin që duhej marrë përsipër.

Kalimi i kufirit, marrja e shkollës dhe mbrojtja e doktoraturës në Romë, në kërkim të modelit të gjuhës së Buzukut, aftësoi në shkallë të lartë poetin dhe shkrimtarin e ardhshëm, duke bërë të mundur që gjithë veprimtarinë gjuhësore e letrare ta përbënin kriteret shkencore të një hulumtuesi elitar. Këtu qëndron e gjithë puna që prodhoi mendja dhe shkroi dora e Martin Camajt. E në këto treva dëshmohet veprimtaria e pandërprerë në mijëra vjeçarë e njeriut.

Studimet e botuara nga Martin Camaj, kryesisht për gjuhën shqipe, të fokusuara në dialektin “gegnisht”, përbejnë një lidhje shumë të fortë të tij, me vendlindjen. Camaj është një ndër albanologët më të shquar, kryesisht me punimet e tij mbi gjuhën shqipe, historinë dhe të sotmen e saj. Studimet kryesore të tij: “*Meshari i Gjon Buzukut*”, Romë, 1960; “*Tekst mesimor i gjuhes shqipe*”, “*E folmja shqipe në provincën e Avelinos*”, Firence, 1971; “*Gramatika shqipe*”, Wiesbaden, 1984; si dhe antologjinë “*Këngë shqiptare*”, Düsseldorf '74, përshkruhen nga pasioni shumë i madh ndaj kësaj pasurie të vendlindjes së tij: gjuhës me të gjithë elementët e saj shprehës.

Përjetimet e autorit kanë qenë kaq të fuqishme, sa ai ka situar me kujdes në mendjen e tij gjithë natyrën, ambientin, madhështinë e panoramës, por edhe bukurinë shpirtërore të banorëve dhe elementë të tjerë. Gjithë këtë kompleksitet, autori e ka shfrytëzuar në mënyrën më efikase, duke jetësuar situata personazhe apo ngjarje, të cilat i ka paraqitur për lexuesin në mënyrën e tij tepër origjinale. Kjo ka qenë jo një paraqitje nëpërmjet riprodhimit të thjeshtë, por një përshkrim shumë profesional, duke ngjizur elementët e kujtesës nga vendlindja me aspektet krijuese, duke

i dhënë një origjinalitet që e bën veprën e Martin Camajt, shumë të lidhur me vendlindjen e tij.

Begatia dhe pasuria që la të shkruar Martin Camaj do të mbetet për të gjithë një model se çfarë mund të bëjë edhe një njeri i vetëm në dobi të kombit të vet e më gjerë. Kjo edhe për faktin, kur dihet mirëfilli, se çfarë pasurie shpirtërore e gjuhësore trashëgojnë shqiptarët dhe paraardhësit e tyre iliro - pellazgët. Fakti që Camaj boton edhe “Gramatikën e Gegënishtes”, tregon më së miri për një akt të vetëdijshëm në lëvizimin e plotë dhe kaq kualitative të gegërishtes letrare. Është pikërisht gjithë kjo vepër e lënë nga Martin Camaj, e cila në gjithë elementët e përmendur në këtë punim, por edhe më gjerë, tregojnë në mënyrë shumë bindëse, lidhjet e forta të autorit me vendlindjen e tij, dhe njëkohësisht pasqyrimin me mjaft sukses dhe në mënyrë artistike të elementëve të ndryshëm të vendlindjes.

Sot, jo vetëm që përkujtojmë 85-vjetorin e lindjes, por bindemi se autori përbën një shkollë për krijuesit e sotëm dhe për brezat që do të vijnë. Vlerat e këtij kollosi në fusha të dijes e krijimtarisë janë të papërsëritshme edhe përsa i përket gjetjeve e përdorimit të gjinive, të cilat ai i ka servirur me aq mjeshtëri duke u bërë model në llojin e vet. Martin Camaj, ky autor i shumë veprave, bir i paharruar i vendit që e lindi dhe i të gjithë Shqipërisë, ka lënë gjurmët e tij të pashlyera edhe për arsyen madhore se dëshmoi se ishte shumë i lidhur me vendin e tij, duke e pasqyruar gjerësisht në veprën e vet.

Është për këto arsye që Dukagjini ka përse të krenohet me këtë kollos të letrave dhe kulturës shqiptare dhe më gjerë. Nëse Martin Camaj, kishte një herë arsye të krenohet me origjinën e vet, ne kemi shumë herë arsye që të krenohemi me jetën dhe veprën e tij. Në të njëjtën kohë, kemi edhe më shumë herë detyrë që të bëjmë përpjekjet tona në njohjen, evidentimin dhe prezantimin ndaj të tjerëve, të vlerave të shkëlqyera të zonës së Dukagjinit, duke i mbrojtur e pasuruar sa të jetë e mundur këto vlera.

LITERATURA:

1. Camaj M, “Vepra letrare – përmbledhje, Vellimi 1, 2, 3, 4, 5”, Tiranë, 2006.
2. Gjoka B, “Martin Camaj i ndëshkuar gjuhësisht”, Tiranë, gazeta “Shekulli”.
3. Gjeta Z, “Dukagjini – historiku, gjeografia, kultura, burimet njerëzore, materiale, aktiviteti ekonomik dhe mundësitë e zhvillimit”, Tiranë, qershor, 2008.
4. Joachim Lanksch H, “Ç’ nuk ishte Martin Camaj”.
5. Joachim Lanksch H, “Martin Camaj, një djalë bariu bahet poet i rangut botnor”.
6. Joachim Lanksch H, “Ditët kur mësoja shqipen me Martin Camajn”.
7. Marku M, “Camaj ose poeti në kërkim të atdheut të mohuar”.

Behar GJOKA (Tiranë)

GEGNISHTJA- MALLKIMI DHE LAVDIA E CAMAJT

Tekstet letrare/joletrare, gjuhësore/studimore, pa asnjë përjashtim, **M. Camaj**, i realizoi në gegnishte, pra në variantin letrar më të hershëm të historisë së gjuhës shqipe. Përveçse këtij varianti në krijimtarinë e gjerë dhe të larmishme letrare dhe studimore, kemi të pranishme edhe një mori fjalësh të arbërishtes, një variant tjetër i hershëm dhe bashkëkohor i ligjërimit të shqipes. Madje, mund të themi se ky ligjërim, pra në gegnishten e përpunuar, shoqëruara edhe me leksik të arbërishtes, kaq i shtrirë dhe funksional në veprën e tij, përveçse shenjë e vetëdijes autoriale, është dëshmi e ruajtjes dhe pasurimit të gjuhës shqipe në harkun kohor të bashkëkohësisë. Prania e gegnishtes dhe arbërishtes, me ngjyresa shprehëse dhe sendërtuese, pasuruese dhe përplotësuese të shkrimit në gjuhën shqipe, figuruese dhe plasuese të teksteve letrare, ka ndikuar në shpalimin e një realiteti letrar të mëvetësishëm dhe unik, vetjak dhe origjinal. Në këto dy koine, padyshim më të hershmet letrare, ku gegnishtja promovohet me « *Mesharin* » e **Buzukut**, e shoqëruar edhe me praninë e stilemave ligjërimore të arbërishtes, e cila e ka nisur shtegtimin me « *E Mbasme e Kërshenë* » të **Matrëngës**, zë fill shkrimi i gjuhës shqipe, pamëdyshje edhe shkrim letrar, andaj vijimi i lëvrimin të tyre edhe në kushtet e ndalimit me ligj të pashpallur, por edhe në mungesë të atdheut dhe të shqiptimit të gjuhës amë, ndikon për ta parë kryekëput vetëm si një dukuri të vetvetishme dhe unike të letrave shqipe. Unike si gjuhëshkrim dhe shqiptim letrar, e ngjizur me vetëdije dhe dëshirë kreative, veçmas si më e spikatun për harkun kohor të lavrimin dhe shpalimit modern të shqipes, të ngjeshur më shumë, me sprova të dështuara, të shkrimit si shërbesë dhe antishërbesë joletrare, por edhe me eksperimentin e pandërprerë të sendërtimit të artit të fjalës. Aq më tepër, që me veprën letrare të **Martin Camajt**, kemi të bëjmë

jo vetëm me një zgjedhje të mirëmenduar autoriale, por edhe me një vetëdije shkrimore, shkencore dhe artistike, gjuhësore dhe letrare, të dëshmuar në morinë e kaq shumë teksteve letrare, ku edhe gjejmë të lëvruar të gjitha gjinitë dhe llojet letrare, mbase edhe me faktin e një përgjegjshmërie të lartësnuar shkrimore/letrare të mbajtjes gjallë dhe në lartësinë e merituar të këtyre dy varianteve të hershme të shkrimit letrar, pra të gegnishtes dhe arbërishtes, si një gjurmë ligjërimi e pashkëputshme, po kaq edhe e evoluimit të thellë dhe të plotë të gjuhës shqipe. ***Jeta ime është një luftë për gegnishten*** - thotë qartësisht **Martin Camaj**, mjeshtri i letrave shqipe jo vetëm sepse lëvroi gegnishten dhe arbërishten, porse si pak të tjerë shkrimtarë të letrave shqipe, e pa letraren si një proces të shumëfishtë dhe eksperimental:

- Që përfshin brenda vetes njohjen e përvojës së mëhershme, të letërsisë së përbotshme dhe asaj të shkruar në gjuhën shqipe, gjithëkohore dhe gjithëhapësinore, çka dëshmohet me tepri në përthithjen e shumicës së teksteve të shkruara prej tij.

- Që përmbledh në vetvete praninë e eksperimentit letrar dhe gjuhësor, të gjerë dhe të përfunduar në shumicën e teksteve të shkruar prej tij, si një akt që shkatërron rregullat fikse dhe njëherit edhe shpik të tjera, ku do të majftonte sjellja në vëmendje e teksteve poetike « ***Nema*** », « ***Buelli*** » dhe « ***Palimpsest*** », si dhe teksti më natyrë sinkretike letrare, ku janë bashkëlidhur në një situatë të pashqitshme, poezia me prozën, pra ***Dranja*** ose kryevepra e shkrimtarit, siç e përcaktojnë lexuesit dhe studiuesit.

- Që mbetet tekembranja vetëm se një akt shkrimor autorial, që i mbishtresohet arritjeve të letrares në të gjithë pentagramin e vet ekzistencial, gjë që preket sidomos nga lëvrimi i gegnishtes dhe prania e arbërishtes, gjithnjë në rrethanat e ndalimit të tyre, tashmë vetëm si akt letrar i pastër.

Prania dhe roli i tij si autor specifik dhe i papërsëdytshëm në letrat shqipe, si letrare dhe gjuhësore, sidomos i formatit të bashkëkohësisë, madje edhe si një nga rastet e vetëdijshme kur dëshiron dhe aspiron, që ta zbulojë universin letrar të sendërtuar jo rastësisht me variantet e gegnishtes

dhe arbërishtes, porse edhe si një fakt dhe dëshmi e kërkimit të vazhdueshëm të sprovës dhe eksperimentit letrar, që pa asnjë përjashtim përfundon me kualitet letrar në të gjithë tekstet e shkruara prej tij. Pohimi i bërë nga vetë shkrimtari, pamëdyshje në një çast dëshpërimi dhe vetëdije të plotë, më tepër ngjan me një thirrje dhe klithmë të mbrame të **Martin Camajt**, si një lajm dhe kumt i rrezikut të kanosur, sjell në fokus gjithë situatën e sipërmarrjes së ligjërit, letrar dhe gjuhësor, studimor dhe të kritikës letrare, pikërisht në këto dy variante, por edhe të qasjes për t'i përkushtuar gegnishtes, por jo më pak edhe arbërishtes, në të gjithë jetën, si dhe në të gjitha aspektet e shpërfaqjes së tyre. Këtë rrethanë e sqaron J. Lankshi, ish-student dhe përkthyes i disa teksteve të shkrimtarit, kur shkruan: *Puna s'është që nuk e njihje gjuhën e unjisueme. Ai i njihje fort mirë të gjitha varietetet e gjuhës shqipe. Nuk do kishte pasë telashe me shkruar tosknisht apo unjisuemisht. As nuk shkruente gegnisht për shkak të njifarë komoditeti ose të të kenët i mësuem me gegnishten. Camaj e përdori gegnishten në bazë të një vendimi dhe vullneti të kuartë e të vetëdijshëm – me luftue për gegnishten.* Pra, arbërishtja dhe gegnishtja, sidomos kjo e fundit, gjithnjë simbas Joakim Lankshit, është përjetuar dhe projektuar nga shkrimtari si një aspiratë dhe betejë në mbrojtje të gjuhës dhe kulturës shqiptare, në mbrojtje të hershmërisë dhe mbijetesës së vlerave të gjuhës dhe letërsisë shqipe. Këtu më tepër se gjithkund tjetër, në qasjet jo dhe aq të shumta ndaj autorit dhe veprës së tij, portretizohet figura madhore, letrare dhe gjuhësore, e **Martin Camajt**, si dhe vetëdija e plotë dhe e shpallur për të shkruar në këto variante letrare, e jo në gjuhën e njësuar. Po kaq rëndësi, në këtë kontekst dhe më gjerë se sa kaq, merr edhe pohimi i bërë prej tij, gati në mënyrë të drejtëpërdrejtë, që në fakt rreket të zbulojë tiparet më thelbësore të shkrimit të gegnishtes, si ligjërim shkencor dhe letrar: *Duhet theksue se lufta e Camajt për gegnishten nuk ishte një luftë qorre, për gegnishten e kohës së Fishtës. Camaj angazhohej për parimin jo të divergjencës, por të konvergencës së gegnishtes me “gjuhën e njësuar”, si një arsye edhe më e fortë, që e zbulon realitetin dhe rrethanat e ndalimit, por edhe i tipareve të ndryshme shkrimore, letrare dhe gjuhësore, krahasuar me shkrimin e **Fishtës**, padyshim patriarkut të poezisë epike shqipe, e*

mallkimit dhe sqarimit të mospërfshirjes së veprës së gjerë dhe përplot laryshi të **Camajt**, në meritën që bart letrarja e sendërgjuar prej tij, në vetmi dhe angështinë e mungimit të atdheut dhe njerëzve të dashur, ende edhe sot e gjithë ditën, në panteonin e letrave shqipe. Në mbështetje të kësaj teze, që nuk ka gjasa të lihet përleshë debatit përmbi gjuhën dhe letërsinë edhe për shumë kohë, në njëfarë mënyre është edhe A. Klosit, ku spikatet thënia e tij: *Vepra e një jete me produktivitet të pazakontë mund të ndahet në veprim letrar, veprim filologjik, veprim kulturor. Ndërsa të parit i rri kurorë mbi krye poezia, veprimi filologjik përshkohet fund e krye nga rezistenca gjuhësore, shprehur në ruajtjen e gegnishtes letrare për brezat më të rinj*, që në fakt e zbulon qartësisht kontributin e tij në prekjen e shenjave të gjithanshme dhe përfaqësuese të veprës dhe të figurës së shkrimtarit, si dhe hedh piketa të qarta të trajtimit dhe verifikimit të kreatives, letrare dhe gjuhësore të sendërtuar prej autorit. Lankshit, në një pohim tjetër, në pamje të parë krejt si një rast i zakonshëm, në fakt zbulon dhe shenjon edhe pengimin kryesor të teksteve të tij në marrëdhënie me lexuesin e sotëm, kur nënvizon: *Gjuha e Martin Camajt mund të jetë një si pengesë tjetër në përceptimin e veprës së tij e cila nga shumëkush apostrofohet si ikonë e lashtë dhe e vyer, por njihet bukur pak. Gjuha e kësaj vepre, ndonëse është një gegnishte mjaft e moderueme, prapëseprapi e ballafaqon lexuesin jo vetëm me pasuninë e pazakontë të frazeologjisë së gegnishtes, por në radhë të parë edhe me jo pak lekseme pak të njohuna a të panjohuna – kjoftë nga leksiku i letërsisë së vjetër shqiptare, sidomos i asaj të arbëreshëve të Italisë, apo kjoftë edhe neologjizma të krijuem nga vetë Camaj. Përcaktime të këtilla, sugjeruese dhe shpjeguese, tipizuese dhe karakterizuese, sa i përket natyrës së letrares së lëvruar nga **Camaj**, pra duke vijuar kështu me vetëdije dhe magji shkrimi lavrimin e gegnishtes, si ligjërimi letrar dhe studimor, porse edhe duke marrë dhe futur në tekstet e tij edhe shenja të përfillshme të arbërishtes, që në fakt jo vetëm në distancë kohore, por edhe në vijimësinë e qëndrimit të mbajtur ndaj tij, janë mallkimi dhe lavdia e shkrimtarit. Ligjërimi i gegnishtes, padyshim dhe përngjitazi me të, edhe i shenjave të shumta të arbërishtes, përbën një rast specifik dhe unik në harkun kohor të letërsisë bashkëkohore shqipe, madje*

të vetmin akt të konsekuencës dhe koherencës për të ligjëruar me anë të tyre, edhe në mërgim, madje edhe në kushtet e ndalimit të kthimit në dheun amë, por edhe të braktisjes absurde dhe pa një shpjegim logjik, i cili mund të mbetet në këmbë, së ligjërimit të gegnishtes edhe në Kosovë. Këtu, ndoshta me ndonjë përjashtim të vogël, siç ka ngjarë fillimisht me tekstet në prozë të **Anton Pashkut**, të cilat u shkruan dhe lëvruan në gegnishte, porse dikur-dikur, mbase trusuar edhe nga rrethanat e pazakonta të standardizimit të ligjërimit letrar dhe gjuhësor, mjerisht si mënyrë funksionimi më tepër në nivelin e një rregulloreje të njësuar, pjesërisht ato tekste edhe u përpunuan në situatën e ligjërimit të njësuar të gjuhës shqipe. Shkrimi letrar, në variantin e gegnishtes, por edhe me jo pak shenja të arbërishtes, përbën një akt dhe dëshmi të cilën lexues dhe studiues të ndryshëm e përjetojnë dhe trajtojnë në linja, shpesh krejt të përkundërta, midis tyre:

A - Linja zyrtare e të dy anëve të kufirit, pra qofshin profesorët dhe akademikët e Shqipërisë (të lëmit të studimeve letrare dhe gjuhësore), po ashtu edhe ato të Kosovës, faktin e shkrimit të gegnishtes dhe arbërishtes e përjetojnë si një akt i ndryshëm, madje krejt i përkundërt me zhvillimin normal që ka marrë gjuha shqipe, pamëdyshje edhe letërsia shqipe, fill mbas kodifikimit të saj, me norma dhe rregulla të një standardi detyrues (sa gjithnjë e më shpesh të përkujton një rregullore të mirëfilltë ushtarake, e cila në rrethanat e lirisë së shprehjes përfaqëson një pengojcë për shpërfaqejn e diversitetit gjuhësor dhe letrar), për gjuhën e komunikimit të gjerë, tipik në shkolla dhe administratë, në media dhe në mjediset shoqërore, por mjerisht me funksione unifikues edhe për gjuhën e letërsisë. Pasojë e këtij gjykimi dhe qëndrimi, thelbësisht përjashtues dhe ngushtimi të hapësirave të ligjërimit letrar, madje me mangësi shkencore në marrëdhënie me realitetin ekzistencial të gjuhës shqipe, pra që nuk e vë në lëvizje idenë e diversitetit (ndryshueshmërisë) gjuhësor, patjetër si shenjë e përfaqësimit të qenies, ndonëse e pashprehur hapur, jo prej padijes së tyre, por më shumë prej hipokrizisë së heshtjes bizare (nënkuptohet të botëkuptimit ideologjik dhe sociologjik), janë faktet e një formulimi të habitshëm të natyrës së krijimtarisë së shkrimtarit/**Martin Camajt**,

pra kryesisht si autor i së kaluarës, e më liksht ende si poet vetëm i gegnishtes, e jo i shqipes (sikur gegnishtja nuk i përket gjuhës shqipe), si poet cilësor dhe jo si prozator dhe dramaturg i letërsisë shqipe, pra gjithnjë duke ia mohuar ose harruar qëllimisht një pjesë të përfillshme të vlerave letrare të krijuara prej tij.

Linja e mallkimit dhe ndalimit të **Camajt**, si emër dhe vepër gjuhësore dhe letrare, për faktin e lëvrimit të gegnishtes, si dhe jo më pak shenja leksikore të arbërishtes, përpos tjerash ka të bëjë, më tepër:

- Me përjashtimin nga hierarkia letrare, e variantit më të hershëm të letrave shqipe, pra edhe të krijimtarisë së **Buzukut, Budit, Bardhit dhe Bogdanit** etj., si dhe e kundërimit të këtij formati të ligjërimit parak dhe zanafillor të shqipes, nga një masë e përfillshme e studiuesve të zyrtarshëm, të tyre si vetëm me vlera gjuhësore dhe historike, pra duke ia mohuar praninë e vlerave letrare. Për shqyrtuesit zyrtar të letërsisë shqipe, letërsia e mirëfilltë zë fill me De Radën dhe N. Frashërin, që i përkasin shekullit XIX, ku vetëkuptohet se kemi një shpikje të radhës, me termin letërsi e mirëfilltë. Prej këtu merret vesh se pjesa e mëhershme, duke mos qenë e mirëfilltë, gjithnjë simbas studiuesve të zyrtarshëm, nuk i përket letrares që do të duhet të lexohet dhe konsiderohet si e tillë.

- Me shpërfilljen e ligjërimit të gegnishtes (po kaq edhe të variantit të arbërishtes, porse edhe me një fakt të shpërdorimit të saj diç më tepër, sepse ajo tashmë është përkthyer në shumicën e vetë, e pothuajse është zhdukur gjuha e autorit) edhe më përtej sinoreve zyrtare, para dhe mbas lirim të vendit nga pushtuesit e radhës, që të shpien krejt natyrshëm tek moti jo fort i largët 1972, që kodifikoi njësimin e gjuhës shqipe, por bashkë më të realizoi, në mënyrë të fshehtë dhe të pashpallur me ligj, edhe ndalimin e ligjërimit të letërsisë me variantet e mëparshme, pra në gegnisht dhe arbërisht, që në fakt ligjërimin letrar të shqipes nga me shumë ngjyresa e unifikoi deri në shterpësi shprehëse, saqë shkrimtarët e periudhës unifikues ngjajnë si të ishin vëllezër siamez dhe pa asnjë nuancë dallimi të ndërmjetshëm.

- Me pikësynimin e realizuar, tashmë në fshehtësi dhe pa asnjë rezultat me vlerë dhe kodifikimi të shkrimit letrar, për përkthimin në gjuhën

e njësuar të shumicës së teksteve të shkruara në variantin e arbërishtes (të De Radës, Serembes, Darës, pra jo transliterim i teksteve të tyre, por ndryshim vargësh dhe konceptesh), ndërsa ka shpëtuar Z. Skiroi, thjesht dhe vetëm nga fakti sepse ka qenë anëtar i partisë fashiste, por edhe të ndonjë teksti në gegnishte, rrekte të cilat mbetën në zgrip për shumicën e shkrintarëve.

- Me ngritjen e nivelit gjuhësor, letrar dhe shkencor, veçmas të tjerëve, nga shkrintaria e **Camajt**, një ligjërim letrar modern dhe një eksperiment i pandërprerë në të gjithë gjinitë dhe llojet letrarë, madje duke dëshmuar kështu qartësisht, me tekstet të shumta dhe të larmishme, se koineja letrare e gegnishtes, natyrisht pa harruar edhe atë të arbërishtes, jo vetëm nuk ka vdekur, por ka të gjitha shanset e mbijetesës dhe të ligjërimit letrar në vijimësi, madje si një gjasë e përtrimjes së tij, në rrethanat e liritimit prej detyrimit zyrtar, pengues dhe përjashtues.

Kuptohet se kjo linjë, e pranishme si nëntekst i mosshqyrtimit, pra duke e lënë më tepër si të nënkuptuar faktin e ligjërimit letrar dhe shkencor në variantin e gegnishtes (me jo pak fjalë nga arbërishtja), e sheh këtë fakturë artistike nga më origjinalet e ligjëratës letrare në gjuhën shqipe, sidomos të harkut kohor të letërsisë bashkëkohore, si një mallkim dhe pengesë për t'u përfshirë realisht në rrjedhat e letrave shqipe, gjithëkohore dhe gjithëhapësinore, e veçmas për t'u përfshirë në to si risim dhe eksperiment, që e mbajti të ndezur kandilin e ligjërimit letrar edhe në variantin e gegnishtes, po kaq edhe të arbërishtes. Në mënyrë fare absurde, gjithnjë sipas gjasash më shumë të shpaluara me nëntekst dhe heshtje paradoksale, **Camaj** duke shkruar me këtë dialekt (variant letrar të hershëm dhe bashkëkohor), kinse ka shkuar kundër prirjes së unifikimit të gjuhës letrare shqipe, çka në fakt është e vërtetë vetëm në kuptimin rapsodik dhe jashtëgjuhësor të vështrimit të fatit të gjuhës shqipe. Porse, në mënyrë djallëzore dhe aspak shkencore, harrohet dhe nuk përfillet enkas, në këtë rast specifik të shkrimit letrar në gjuhën shqipe, posaçërisht në koinenë e gegnishtes dhe me praninë e leksikut dhe të trajtave ligjërimore të arbërishtes, fakti i shkrimit të letrares si gjuhë e autorit, e cila përgjithësisht i vë në dyshim dhe i rrëzon rregullat e shpikura të njësimi, dhe njëherit

edhe shpik dhe formaton disa mënyra të reja të shkrimit artistik, tashmë vetëm si gjuhë e letërsisë. Pra, duke mos i përfillur këto shenja, sidomos në nivelin e shkrimit letrar (poezi, prozë dhe dramatikë) rregullat e shkrimit të njësuar të letrares, ka gjasa që **Camaj** ta ketë vetëpërrjashtuar veten nga panteoni i letrave shqipe, pra ai ka hyrë dhe me gjasë do të mbetet si shkrimtari jashtë kohe, jashtë rrjedhave të ligjërimit letrar, madje edhe jashtë hapësirës së trojeve shqiptare, gjithnjë simbas optikës së pa artikuluar qartësisht dhe publikisht, së paku deri më tani, por edhe të mirëmenduar nëpër vite nga studimtaria zyrtare. Kjo mençuri dritëshkurtër dhe pa perspektivë të gjatë, mjerueshëm edhe e titujmbajtësve të shkencave letrare, akademikë dhe profesorë (të cilët rrëmojnë më kot nëpër letërkëmbime dhe thkellinat e biografizmit vulgar, me shpresën se do të zbulojnë atë që në fakt e bartin tekstet letrare, pra magjinë letrare), përgjithësisht dhe veçmas nuk ka lidhje me shkrimin e letrares, gjithnjë simbas teorive letrare, klasike dhe moderne, si gjuhë e letërsisë dhe gjuhë e autorit, dy tregues të vlerës së shenjimit të letrares, pavarësisht gjinisë apo llojit letrar.

B – Linja jozyrtare dhe diçka më tepër ajo antizyrtare, që zë fill dhe kulmohet me mendimet e **Arshi Pipës** mbi natyrën e krijimtarisë së **Martin Camajt**, përmbi përmasat dhe modelin letrar të këtij autori, fakti i ligjërimit në variantin e gegnishtes, pamëdyshje edhe prania e disa formave të arbërishtes (siç ngjet me faqe të tëra në tekstin e romanit “*Karpa*”, por edhe diku tjetër, sidomos në prozat “*Shkundullima*”, “*Fshati me gjuhë të fshehtë*” etj.), po kaq edhe si një tipar unik dhe adekuat i letrares së mirëfilltë të autorit, si një proces sprove dhe eksperimenti letrar, padyshim në shumësinë e vetë të përfunduar dhe me kualitet letërsishkrimor, shënon lavdi dhe mjeshtëri nga shkrimtari, gjurmë dhe dëshmi të shumta gjuhësore dhe letrare.

Lavdia dhe hyjnorja e **Martin Camajt**, si prani dhe frymë e teksteve letrare, bart edhe shenja të tjera të dukshme dhe me vlerë jetike për shqiptimin letrar në gjuhën shqipe:

- Me shpresën se gegnishtja nuk ka «vdekur» plotësisht dhe përfundimisht, siç edhe e menduan dhe projektuan ekspertët e prishjes së

normalitetit organik të ligjërimit letrar në gjuhën shqipe, nuk është tretur dhe shuar njëherë e përgjithmonë, ashtu siç e kanë dëshiruar dhe ëndërruar idhëtarët e zyrtarizimit të artit dhe gjuhës shqipe, pra në njëfarë mënyre edhe të prishjes së ekuilibreve të ligjërimit letrar si gjuhë e letërsisë dhe gjuhë e autorit.

- Me aspiratën që gegnishtja, padyshim edhe arbërishtja dhe çdo ngjyresë tjetër letrare, nuk ka asnjë shans që ta ndërpesë rrugëtimin e vetë, jo vetëm sepse flitet në një hapësirë të konsiderueshme, si shtrirje dhe gjuhë e folur, ku jetojnë shqiptarët, por mbi të gjitha sepse ky variant është shkruar kaq bukur në penën e **Camajt** dhe të disa autorëve të tjerë, pamëdyshje të të gjithë periudhave letërsishkrimore, saqë e vë në zgrip çështjen e njësimin të gjuhës së letërsisë.

- Me lartsynimin se gjuha e letërsisë, pra e thënë ndryshe, gjuha e autorit, si shenjë e literaritit në poezi a prozë, në dramatikë ose në verifikimin e studimtarisë, nuk ka gjasa që të njësohet deri në shkatërrimin përfundimtar të artikulimeve autoriale dhe artistike, siç e sugjeroi dhe bëri ç'është e mundur që ta realizonte modeli zyrtar, gjuhësor dhe letrar, i realizmit socialist.

Lavdia e **Camajt** lidhet, sidomos me faktin e shkrimit në koinenë e gegnishtes, si dhe në koinenë e arbërishtes, në kohën dhe kushtet e ndalimit të tyre, por mbi të gjitha emri dhe fama e tij, lidhet me sendërtimin e disa teksteve të befasishëm letrar, në poezi me librat "*Nema*", "*Buelli*", "*Palimpsest*", në prozë me novelat e thukta të shkrimtarit, por edhe me romanet "*Rrathët*" dhe "*Karpa*", doemos edhe me sinkretikën letrare, të pagjsshme në letrat shqipe, veçmas me tekstin "*Dranja*", një rast që e tejkalon nivelin e shkrimit të letërsisë në gjuhën shqipe, e cila pamëdyshje rrok edhe qiej të tjerë letrarë, pa harruar këtu edhe dramatikën me tekstet "*Lojë mbasdreke*" dhe "*Kandilja e argjandit*". Përjetimi i realitetit letrar, specifik dhe unik, etik dhe estetik, gjuhësor dhe filozofik, pikërisht ashtu siç e sendërton dhe ideon autori, pra në variantin e gegnishtes, si dhe me prekla të dukshme të arbërishtes, përbën një shkas për ta shijuar dhe kuptuar qartësisht letraren e sendërgjuar prej tij, me aq veçanësi dhe finesë shkrimi. Termat, kinse shpjegues, përdorur me një shkujdesje të

paadmirueshme, që nuk ka se si të të ngjallë shije pozitive, se i përket shkrimtarit të ekzilit, pra të mërgimtarit (të përjetshëm), është një tjetër rrekje mejrane për ta shmangur, njëherë e përgjithmonë, **Camajn** dhe çdo shkrimtar tjetër që nuk përfilli zyrtaritetin gjuhësor dhe letrar të gjysmës së dytë të shekullit të kaluar. Toeria letrare, sidomos ajo moderne, më se njëherë sugjeron se nuk ka peshë dhe rol parësor vendi se ku ka shkruar një autor, por gjuha dhe prania e shenjave letrare në një tekst, pra gjithnjë dhe vetëm në marrëdhënie me letraren. Shkrimtarët e ekzilit, pra mërgimtarët e përjetshëm, siç edhe janë emërtuar nga studimet letrare zyrtare të shqipes, **De Rada**, **Pashko Vasa** dhe **Sami Frashëri**, në të kaluarën e largët, **Martin Camaj**, **Bilal Xhaferri** dhe **Arshi Pipa**, kryesisht autorë të rrafsheve bashkëkohore të ligjërimit letrar, nuk ka gjasa që të mbeten përjetësisht në udhëkryqin ekzistencial, të shpërfilljes përfundimtare, sepse na u përmendkërkanë ndonjëherë nga burokracia letrare, në ndonjë përvjetor, që pafundësisht dhe metodikisht rreket vetëm se që t'i lërë jashtë rrjedhave të ligjërimit letrar në gjuhën shqipe si larmi dhe jo si unifikim mediokër dhe me vlera të dyshimta letrare. Zyrtariteti gjuhësor ka të bëjë më tepër me imponimin e shkrimit të letërsisë, kryesisht dhe vetëm sipas kodeve të rregullores drejtshkrimore të miratuar në Kongresin e vitit 1972, nëse mund ta quajmë kështu ligjërimin e njësuar, i cili ka vënë në zgripin e mbijetesës gjuhën e autorit dhe të letërsisë, pra duke i larguar bukurshumë nga gjasat e shprehësisë letrare, ngjyresat e ligjërimit në këto variante (kuptohet në gegnishte dhe arbërishte), po ashtu zyrtarja letrare, lidhet vetëm se me modelin e realizmit socialist, të cilin shkrimtari i ligjërimit në thyerje të gjuhës së standardit dhe i eksperimentuesit të formave të larmishme artistike, e përbuzi dhe as nuk e përmendi asnjëherë. Rrethimi i **Camajt**, por dhe i ndonjë shkrimtari tjetër të kësaj periudhe, pamëdyshje e sidomos i krijimtarisë së larmishme letrare, në poezi dhe prozë, në dramatikë dhe studimtarinë gjuhësore dhe letrare, në qarkun përjashtues të kësaj përvoje shkrimore nga më origjinalet në letrat shqipe bashkëkohore, pra si një mallkim krejt i pashembullt, në historinë e letërsisë shqipe dhe më gjerë se sa kaq, kryesisht për faktin e ligjërimit të variantit të gegnishtes (me shenja të dukshme edhe të arbërishtes), njëherit

nga ana tjetër edhe të lavdisë pikërisht për këtë fakt shkrimi, mbase edhe si një shans i mbijetesës së këtij varianti, e sidomos i diversitetit (ndryshueshmërisë) letrar, gjuhësor dhe kulturor, do të duhet të ndërpritet si një shenjë e keqkuptimit paradoksal të veprës së gjerë dhe plot laryshi të krijimtarisë së tij. Tekstet e **Camajt** dhe të ndonjë autori tjetër, që i shkuan, me vetëdije dhe funksion të shpallur, përkundër zyrtaritetit të gjuhës dhe të letërsisë së kohës së mediokritetit zyrtar, e shpëtuan gjuhën dhe letërsinë shqipe nga sterilizimi dhe përtharja e plotë si ngjyrim dhe shprehësi, si shenjë dhe magji letrare. Por, në kushtet kur gjendemi, të hapjes dhe mbylljes ndaj shenjave gjuhësore dhe letrare, pra vetëm të pengimit për disa variante dhe të folme të shqipes, dy-tre akte, sa më shpejt që të jetë e mundur, duhet të marrin fund:

- Redaktimi gjuhësor, nëpër shtëpitë botuese (madje edhe me ligje absurde mbi pengimin e ngjyresave të të folmeve përtej njësuarishtes, pra i teksteve të shkruara në gegnisht dhe arbërisht), i librave me poezi, në prozë dhe dramatikë, përmes një standardi që ka të bëjë më tepër me komunikimin publik (pra kryesisht me atributin e gjuhës zyrtare) dhe jo dhe aq shumë me gjuhën e letërsisë.

- “Përkthimi”, absurd dhe i pangjashëm, që të ngjasë përjetësisht, i veprave të autorëve arbëreshë dhe gegë, sipas normës gjuhësore të standardit, sepse përgjithësisht dhe veçmas letrarja buron, gjithnjë sipas ligjësisive të artit të fjalës, prej diversitetit kulturor dhe gjuhësor, pra ca më tepër edhe prej çunifikimit të rregullave të ditura, si dhe në shpikjen e rregullave të reja, gjithnjë në funksion të letrares dhe maturimit të saj me shenja estetike.

- Kthimi në gjuhën e njësuar të standardit të poezisë së **Mjedës, De Radës, Serembes, Fishtës, Migjenit, Camajt**, por edhe i prozës së **Pashkut** etj., si detyrë e nxënësve dhe studentëve të shkollave shqiptare, pavarësisht se janë publike ose private, të larta apo të mesme, kryesisht pa i lexuar dhe kuptuar, pothuajse fare tekstet e këtyre shkrimtarëve.

Zgjerimi i gamës së problemeve, që mbështjellë shkrimtari dhe vepra e tij letrare, vetëm sa zbulohet i plotë teksa sjell në fokus qëndrimin e vet **Camajt**, si një rruginë e munguar në shtjellimet letrare dhe gjuhësore të

akademizmit shqiptar, zyrtar dhe jo zyrtar, kur shprehet: *Besoj se tue ecë krahas gegnishtja e tosknishtja e shkrueme letrare, si dy motra të mira, pa ia pré rrugën njana-tjetrës, kanë vijue mâ me fryt të gjëjnë pikat e përbashkëta*, sugjerohet hapur se si do të duhet ligjëruar dhe lavruar gjuha e letërsisë. Mandje, kjo vetëdije e qartë, na zbulohet me akte të shkrimit letrar dhe gjuhësor, të variantit të gegnishtes prej dhjetëra shkrimtarësh, por edhe prej **Martin Camajt**, madje në rastin e tij, në një kualitet mjaft të ngritur letrar, që vetiu të shpie natyrshëm tek vetëdija letrare dhe shkrimore e sendërtimit të aq shumë tekstesh letrare dhe shkencore në variantin e gegnishtes, por edhe me ndoca dromca fjalësh të arbërsishtes.

Gjasat janë që rishtas dhe pashkëputshëm, në mjediset zyrtare dhe jo zyrtare të akademizmit shqiptar, brenda dhe jashtë kufijve shtetërorë, do të prekim vetëm se vijimin e dhunimit të gegnishtes dhe abërishtes, si dhe të përjashtimit të zakonshëm nga panteoni i letrave shqipe të shkrimtarëve të saj, qysh me **Buzukun, Budin, Bardhin, Bogdanin, Fishtë, Koliqin, Camajn, Reshen, Pashkun** etj., ose më liksht ende të përktimit të habitshëm (përshtatjes), në gjuhën e standardit të **De Radës, Darës, Serembes** etj. , si dhe të vënies dorë në njësimin edhe të gjuhës së **Konicës, Poradecit** dhe të **Paskos**, çka do të thotë, as më pak e as më shumë, veçse ruajtje e piketave të vlerave gjuhësore dhe letrare të shpallura nga sundimi monist. Në thelbin e vet gjuha e standardit, si gjurmë dhe dëshmi formale, nuk presupozon ndalimin e gjuhës së autorit, e larmisë që bart dhe përçon gjuha e letërsisë, përkundrazi janë gjuhëtarët dhe një masë doktorë-profesorësh të letërsisë, që duan t'i japin një atribut të pamundshëm për ta patur, për gjithnjë dhe për të gjitha hapësirat, si metodikë shkrimore, që në fakt do të thotë vyshkje dhe shkatërrim përfundimtar i letrares së ligjëruar në gjuhën shqipe, si larmi dhe diversitet gjuhësor dhe letrar, çka shpallon gjurmët e identitetit shkrimor të secilit autor, por edhe të vetë letrares, gjithëkohore dhe gjithëhapësinore.

Gegnishtja curse and the glory of Camaj

In this writing, the well - known scholar Behar Gjoka has produced some interesting estimations about Martin Camaj's literary works, in prose and poetry. Gjoka is focused especially on the relationship that Camaj's work establishes with the Albanian standard language as well as with the northern dialect and its written version. The author concludes that Camaj's work is an elevated model of the written gegë dialect, which should levels as a special asset of the Albanian language.

Alma HAFIZI (Shkodër)

RELATIVIZMI I CAMAJT NË NOVELËN “JESMINË”

Hyrje

Studimet kritike dhe hulumtimet e shumta mbi veprën e Martin Camajt shpjen në pohimin aksiomatik se ajo, si për nga forma, ashtu edhe nga përmbajtja, është e orientuar nga kultura dhe tendencat perëndimore: simbolika e veprës së tij, e formëzuar nga simbolika e jetës, nga filozofia dhe mjedisi shqiptar, mitet, legjendat, zhvillohet mbi bazën e letërsisë evropiane; poezia e tij gjen shtigje komunikimi e përfrimi me poezinë botërore moderne, sinkronizohet me shkollat letrare perëndimore, duke ruajtur origjinalitetin artistik, si individ por edhe të traditës kulturore që përfaqëson.

Kontributi im modest në këtë përvjetor jubilar të shkrimtarit të madh hedh dritë mbi shfaqje të relativizmit në novelën “Jesminë” të Camajt. Vitet e para të shekullit të kaluar janë periudha e kristalizimit të prirjeve depersonalizuese të shoqërisë falë instalimit të kapitalit monopolist që e frenon nismën individuale, zhvillimit të industrisë dhe përdorimit të makinerive, që mekanizojnë qenien njerëzore duke e privuar nga raportet me njerëzit dhe nga ndergjegjia, ngritjes së strukturave të fryra burokratike që e anashkalojnë individin, duke ia varfëruar botën shpirtërore dhe duke i lejuar funksione sipërfaqësore, krijimit të metropoleve të mëdha moderne, ku njeriu humbet lidhjet me të tjerët e shndërrohet në një copëz të izoluar, të tjetërsuar në turmën anonime. Mendimi klasik se individi është krijues i fatit dhe zotërues i botës së tij tashmë perëndon: në një fazë të parë këto procese shpjen në refuzimin e realitetit objektiv dhe përqaftimin e subjektivitetit për t’u svanitur në mënyrë graduale: individi s’ka më vlerë, dobësohet, humbet identitetin e tij, shpërbëhet e bashkë me të ndryshon

edhe mënyra se si e konsideron realitetin, jo më si një tërësi absolute por të shumëllojshëm e relativ, përderisa ekzistojnë shumë të tilla subjektive.

Perspektiva relativiste shfaqet edhe në fushën e letërsisë, kryesisht asaj ane dhe italiane me autorë, si: Pirandello, Svevo, Eliot, Joyce e Virginia Woolf, që falë përdorimit të teknikave inovative letrare, si asocimi i ideve dhe fluksi i ndërgjegjes, fokusuan vëmendjen e tyre në krizën e brendshme shpirtërore të njeriut të fillimit të shekullit të kaluar. Disa elementë të relativizmit i gjejmë edhe në veprën e Camajt, siç po mundohem ta shtjelloj në vijim.

Shfaqje të relativizmit tek Camaj

Protagonisti i novelës *Jesminë* është vetë autori, asokohe mësues i ri në profesion, i emëruar në një shkollë lokaliteti, emërtimi i të cilit si njësi administrative, shërben si pikë lidhjeje për ngjarjet në novelë. Realiteti merr kuptim falë perceptimeve tona. Çdo imazh i realitetit është një projektim subjektiv që përjashton të vërtetat absolute dhe objektive. Çdo individ ka të vërtetat e tija, këndvështrimet e tija, sistemin e vet të referimit të cilin e pasuron me përvojën vetjake. Nga interpretimi i asaj që në të vërtetë ekziston dhe i indentitetit si diçka poliedrike, rrjell *relativizmi* i Camajt.

Vargu i emërtimeve që autori përdor për lokalitetin ka natyrë ciklike, fillon dhe mbaron me metaforën *zgju bletësh*, për të vazhduar me etiketimet *katund*, *qendër* e *vogël*, *qytet*, *pazar*. Sipas botkuptimit të mësuesit ai vend quhej *katund*, por jo të gjithë e konsideronin të këtyllë. Secili sipas perspektivës së vet e quanin kush *qendër* e *vogël*, malësorët e kishin quajtur brez pas brezi *pazar*, vendasve në pjesën më të madhe të tyre u pëlqente ta quanin *qytet*. E ky katund-qytet s'ishte as më shumë e as më pak se një pazar, që si çdo vend tregu sjell me vete ndeshjen e së mirës dhe së keqes, e në rastin në fjalë vinte përballë dy grupime; nga njëra anë vendasit të sjellë aty, në atë pseudoqytet, nga forca e murrllanit që “nga mali e fusha binte gjithçka, gjunte me to mure, si me dashtë me depërtue teh më teh shtëpitë”, për të mbrojtur njëmendësinë, të vërtetën absolute dhe të

pandryshueshme se ai vend ishte qytet, dhe të huajt nga ana tjetër, të përfaqësuar nga autori, që i kundërvihen me mendimet dhe përshtypjet relative me mjedisin, zhvillimin ekonomik, administrativ e shoqëror të tij.

Këndvështrimi nga i cili autori e vlerëson realitetin është i ndryshëm nga ai i vendasve. Secili orientohet drejt sistemeve të veta të referimit duke sjellë kështoj *moskomunikimin* midis njerëzve, duke qenë se secili ka mënyrën e tij të të vështruarit të realitetit, të vërtetat e tij, gjë që nuk lejon ekzistencën e një baze objektive për komunikim. Moskomunikimi prodhon një ndjenjë vetmie e përjashtimi nga shoqëria, për pasojë personazhi ndjehet i huaj. Vendasit i kurdisën mësuesit një izolim të plotë se ai kryeneç fliste gjithmonë për katund e ata për qytet. Në perspektivën e tij vendi i ngjante një “zgjoni bletësh”, ku “shumica e banorëve merrej me bujqësi sepse toka gjithkund rreth e rrotull për nja pesëdhjetë kilometër ishte shumë e plehshme”, ku “nja pesëdhjet veta ushtronin tregtinë”, ku kishte “nja njëzet a tridhjet nëpunës, pjesa ma e madhe mësues e edukator të shkollës fillore e gjysmë-gjimnazit, të vendosur në kazermën e vjetër të ushtrisë”, ku ndjehej prania e një “tarikati zejtarësh” dhe syri të rrokte asgjë më shumë se një grumbull banesash, që gjallërohej ditëve të mërkura të pazarit edhe me malësorët e zbritur nga malet përreth.

Nga pikëpamja administrative, qyteti është qendër banimi në të cilën është përqendruar një sasi e madhe njerëzish, tregtia, kapitali dhe pushteti burokratik. A e përmbush kriterin bazë të të qenurit qytet ai vend që e habit të huajin aq sa të vihet para dilemës se a është e mundur që të pjellin shkaminjtë gjithë atë mori njerëzish me rraqe e bagëti? Camaj, filozofik e konçiz si përherë, me shumë pak rreshta e shpreh se çfarë zhvillimi të mangët ekonomik, administrativ e shoqëror kishte vendi. Ekonomia reduktohej ne atë pak prodhim bujqësor e tregti rruge, nga pikëpamja kulturore mungonte tradita, duke qenë qendër banimi e krijuar jo natyrshëm, e për pasojë edhe vlerat e trashiguara me të, nga pikëpamja sociale zotëronte një mentalitet i diktuar nga pushteti ideologjik, sipas të cilit jeta e individit i përkiste shoqërisë, të gjithëve, por jo atij vetë. Protagonisti i dëbuar nga katundi-qytet si person i padëshiruar, vetëm për

faktin se ai katund nuk mundej kurrë t'i dukej qytet, shprehet se “ në atë vend i hueji nuk mund të jetojë tue shikue punën e vet: o mik o anmik don me e pasë”.

Qyteti përfaqëson shkallën më të lartë të zhvillimit njerëzor. Në kuptimin sociologjik, qyteti si hapësirë specifike e organizimit, mund të analizohet si faktor përcaktues që ndikon mbi njeriun. Në novelën e Camajt, përkundrazi qyteti fantomatik, i pakapshëm, ekziston vetëm në mendjet e disa njerëzve, merr jetë nga imagjinata e tyre, pa mundur të shfaqet si strukturë dinamike, si organizëm, si produkt i ndërlojave të fuqive ekonomike e kulturore, pa mundur të sjellë zhvillim. Moskomunikimi si dukuri e relativizmit ka në thelb të tij diversitetin që karakterizon vizionin për jetën.

Vizioni i Camajt për jetën

Camaj ka në bazë të vizionit të tij për botën një koncept *vitalist*. Duket se rimerr idenë e filozofisë së Bergsonit, sipas të cilit realiteti i tërë është jetë, proces i vazhdueshëm krijimi, lëvizje jetësore e përjetshme. Këtë e dëshmon natyra ciklike e vargut të emërtimeve. Në sytë e mësuesit të porsardhur vendi i ngjan një zgjoni bletësh, diçka në lëvizje e gumëzhitje të vazhdueshme, në hallakatje për t'u shndërruar në qytet, e po i tillë i ngjan edhe në ikje, paçka se më i qetë, i sprapsur prej murrllanit kërdibërës, ku mund të dëgjohet vetëm fryma e bletëve, në pritje për të rimarrë hovin jetësor.

Autori konstaton se edhe identiteti i njeriut paraqitet në lëvizje të vazhdueshme. Personaliteti shfaqet si iluzion, si një nga shumë format në të cilat kristalizohet identiteti. Çdo individ e sheh mësuesin, të huajin, sipas perspektivës së tij dhe krijon imazhe të rreme për të. Ky pluralitet pikëpamjesh kushtëzon ekzistencën e po aq protagonistëve në novelë sa janë edhe vizionet e të gjithë vrojtuesve të mundshëm, pa pretenduar në vërtetësinë absolute të asnjërit prej tyre.

Fillimisht ai është për vendasit një “dijekeqas”, që sillej “me krye në tra, kinse intelektual”, që “nga mbushamendja u kundërshtonte se “ai

s'asht qytet, po katund". Mësuesi besonte në bindjen e tij, madje kishte guximin ta shprehte haptas e pa zhigla atë që mendonte, se "përderisa ajo fole kishte ma tepër gjela se sahata, nuk mund të quhej kurrën e kurrës qytet". Që në fillim vendosen raporte armiqësore. Përballë këtij fakti individi, protagonisti përdor *maskën*, që do të thotë imazhi që ai ia imponon vetvetes, apo i imponohet shpesh herë nga konteksti shoqëror në të cilin jeton Mësuesi tërhiqet nga qëndrimi fillestar, që paskësh qenë shenjë kryenaltësie të pabukur dhe fillon të ushtrojë zejen se si duhet të silllet njeriu në vendin e huaj, duke mbajtur gjithnjë një lloj largësie: nuk i zinte kujt dritën e diellit, përshëndeste i pari edhe nxënësit, por njerëzishëm e dinjitoz. Izolimi i përsosur në vetmi sikur e mban pezull në të tashmen dhe e hedh në kujtimet e së kaluarës, ku kërkon forcën vitale për ta çuar përpara qenien e tij. Gjeneruesi i kësaj force është bleta, lidhja me fëmijërinë por edhe me të tashmen. Shtëpia dykatëshe përballë banesës së tij ishte e mbushur me zgjoje bletësh e mësuesi, kur nuk kishte punë tjetër për të kaluar kohën, mbështeste bërrylat mbi murin e ulët që ndante rrugën nga vathi i bletëve për të vërejtur endjen e tyre. E vetmja lidhje që i lejon të çlirohet nga maska, e vetmja rrethanë në të cilën mund të komunikojë me një vajzë të vogël, Jesminën, për të cilën ai ishte thjesht e qartazi mësuesi i ri. Ajo ishte e vetmja dashamire e tij, siç e shpreh edhe emri i saj, e vetmja dhuratë nga zoti.

Në atë katund nuk ka kufi të prerë mes reales dhe ëndrrës, ekziston një osmozë mes tyre, saqë është e vështirë për t'u kuptuar. Sipas perspektivës relativiste gjithçka, në momentin kur fillon të marrë formë të dallueshme dhe individuale, fillon edhe të vdesë. Duket se mësuesi e ka gjetur normalitetin e tij në marrëdhënien me Jesminën, gjë që rezulton e dukshme edhe për banorët e tjerë. Më pas personaliteti i tij ndryshon, transformohet, duke u konsideruar si lakmitar grash të bukura të katundit, ndërsa sillet rrotull shtëpiave si merakli bletësh që ishte për t'i kundru ato. S'ka besueshmëri në miqësinë e tij të sinqertë me Jesminën, por aludohet për një taktikë afrimi me nënën e saj, që mësuesi se kishte parë kurrë. Protagonisti ndjehet i dobët, i pafuqishëm të provojë pafajësinë e tij, ndërkohë që pret ndëshkimin, për 'iu nënshtruar me një maskë ndryshe nga

e para. Çfarë mund të vinte pas izolimit e braktisjes totale që i kishte bërë katundi? Maska e radhës është ajo njeriut të realizuar në dëshirat e tij, sikur transferimi i komunikuar paskësh qenë kërkesë e tija dhe jo një lojë e kurdisur nga banorët.

Karakteri kontradiktor i realitetit

Falë pikëpamjeve dhe vështrimeve relativiste Camaj sjell situata paradoksale në të cilat personazhi apo situata janë e kundërta e asaj që duhej të ishin, ku alternohen e qeshura me keqardhjen dhe mëshirën. Është vërtetë qesharake këmbëngulja e banorëve për ta quajtur qytet vendin e tyre mjeran, naiviteti kalon caqet e imagjinatës, por në thelb të të gjithë kësaj skene lexuesi ligësohet për ata njerëz që prej kohësh jetojnë në një botë pa ndjenja dhe krijojnë iluzione, një seri pafund vetëmashtrimesh përmes të cilave kërkojnë t'i japin kuptim ekzistencës. Është komik fakti se protagonistin mëson i befasuar për transferimin e tij nga Jesmina e vogël, duke iu servirur fakti si vullnet i plotë i tij, por ther në shpirt vobektësia fizike, morale, intelektuale e të huajt për ta ndryshuar atë realitet, për të kontribuar sadopak në shndërrimin e atij katundi në qytet. Qiradhënsja shpotitëse shpreh keqardhjen e saj në emër edhe të katundit për largimin e mësuesit kur në të vërtetë lojën e kishin stisur ata vetë. Me mënyrat dhe sjelljet në dukje të një zonje metropolitane, që mendon e shikon punën e mikrobotën e saj, i bën me dije mësuesit se mbarë popullata e kishte zbuluar djegën e tij, lidhjen dashurore me nënën e Jesminës, gjë për të cilën ai vetë s' ishte kujtuar. Situata komike thyhet menjëherë në mes kur mësuesi në heshtje mendon ekstremin tjetër të kësaj ndjenje fisnike, vrasjen e kujdo që do të guxonte t'i thoshte dashamires së tij se ai sillej “andej pari për arsye të s'amës”. Në këtë perspektivë, efektet humoristike të shkaktuara nga situatat paradoksale që krijon Camaj, i përafrohen poetikës së humorizmit pirandelian, sipas së cilës ato janë tendenca e përhershme e artit për të zbuluar kontradiktat e realitetit.

Murlani që kishte fryrë si i çmendur natën para nisjes kishte marrë me vete edhe mësuesin për ta hedhë kushedi se në ç'katund–qytet tjetër.

Relativizmi i Camajt është psikologjik, shoqëror, që tërthorazi lidhet me kontekstin politik e ideologjik të kohës. Ai shfaqet në drejtimin horizontal, pra në raportet ndërpersonale. Personazhet lindin të lirë në një shoqëri paraprakisht të ngritur, ku secilit i rezervohet një rol që i dikton se si duhet të silltet. Secili është i detyruar të zbatojë rregullat që shoqëria ia imponon edhe nëse individi do të donte të shfaqej në një mënyrë tjetër. Vetëm rastësia mund ta sjellë që të çlirohet nga një formë për të marrë një tjetër, pa mundur të kthehet më tek e para. Camaj si autor përdor maskën e një mësuesi të thjeshtë, që përshkruan e tregon çuditë e një vendi të vogël, të prapambetur nga çdo pikëpamje, që nisët nga fakte banale në dukje, siç është rasti i emërtimit të atij lokaliteti, por që në thellësi mbartin e transmetojnë mesazhe kuptimplota. Pas maskës së autorit fshihet protesta për diversitetin e mendimit, lirinë e munguar të fjalës, ndryshjen e shpirtit, elemente karakterizuese këta të një shteti totalitar, që propagandonte të kundërtën e atij që ishte në të vërtetë.

KONKLUZIONE:

“Mbi të gjitha më vinte keq se kisha pasë rastin të mësoj si duhet të sillët një i huej në një katund aq të vogël. Kjo do të kishtë fletë përjetë, meqenëse fati im paskëshe qenë caktue të vij vërdallë nëpër botë pa gjet kund cak”.

Siç mund të kuptohet nga fjalët e autorit, Camaj është në kërkim të identitetit të individit, të aspekteve më domethënëse të tij, nga të cilat varet konceptimi që secili ka për veten, si edhe raportet që krijon me të tjerët. Ai vë në dukje kontrastet që ndeshen në rrjellën e jëtës, e ndryshme nga një moment në tjetrin, që na lejon të perceptojmë imazhe tek të cilat mundohemi të gjejmë vetveten dhe të tjerët, ato që jemi apo mendojmë se jemi. Ky refleksion bazohet në kontrastet mes jetes dhe formës, mes ekzistencës dhe maskave në të cilat shfaqet ajo.

Protagonisti pranon maskën që i vendos vetes ose me të cilën të tjerët e identifikojnë, i dorëzohet asaj duke jetuar në pezmën që shkakton hendeku mes jetës që do të dëshironte të bënte dhe asaj që të tjerët e

detyrojnë të jetojë. Fundja, pranon të interpretojë rolin e radhës në skenën e ekzistencës. Ky reagim tipik pasiv ndaj relativizmit është karakteristikë e personave të dobët. Trajektorja e tij përshkallëzohet drejt reagimit dramatik, por pa realizuar efekte të këtij ngjyrimi si çmenduria apo vetëvrasja. Protagonisti kufizohet me mbylljen në vetminë e tij duke u përpjekur të zotërojë situatën e krijuar. Ky ishte individi që kishte krijuar ideologjia e kohës, sistemi i njëmendësisë dhe uniformitetit, të cilin Camaj nuk e pranoi kurrë as politikisht dhe as artistikisht. Ndër shumë elementë që e dallojnë Camajn nga arti shqiptar monist është edhe perspektiva relativiste që karakterizon veprën e tij.

BIBLIOGRAFI:

1. M. Camaj, *Jesminë*, Camaj-Pipa, Shkodër, 2002.
2. S. Guglielmino, H. Grosser, *I classici del sistema letterario italiano*, a cura di Novella Gazich, Principato, Milano, 1995, f. 684-87.
3. Henri Bergson, *Saggio sui dati immediati della coscienza*, Cortina, 2002.
4. Ali Pajaziti, *Fjalor i Sociologjisë*, Logos-A & SEEU, Shkup, 2009.

Camaj in novel relativism "JESMINË"

Martin Camaj is in search of the person's identity, of his meaningful aspects from which depend the concepts that everyone has for himself, as well as the relationships he creates with the others. He highlights the contrasts that are encountered in the flow of life, different from one moment to another, which allows us to perceive images where we try to find ourselves and the others, the ones we are or what we think we are. This reflection is based on the contrasts between life and shape, between the existence and the masks in which it appears. His main protagonist is an offspring of his ideology of the time, of one minded and uniformity system which Camaj never accepted either politically or artistically. One the many different elements which distinguishes Camaj from the monist Albanian art is his relativist perspective which characterizes his work.

Vjollca OSJA (Tiranë)

ÇËSHTJE TË TIPOLOGJISË SË LLOJIT TE MADRIGALET “DRANJA”

Kur flasim për një vepër letrare, në mënyrë të drejtpërdrejtë apo jo gjykojmë se kemi përcaktuar edhe tipologjinë e zhanrit të cilit ajo i përket. Në fakt, ky konkludim na vlen për vepra që i brendashkruhen, konvencionalisht, paradigmës post-aristoteliane të zhanrit, ndërkohë që diskutohet gjithnjë e më gjatë, kur bie fjala për tekste që i ikin këtij modeli. Kujtojmë se, përballë këtyre teksteve jonormative, teoritë tradicionale të zhanrit janë gjendur, në vijimësi, duarbosh. Për pasojë, ardhja e një teksti që nuk i përmbush kriteret e gjinive të përcaktuara, e ka çuar shpesh në krizë mendimin teorik dhe kritik⁶, duke i tronditur jo pak kufijtë e zhanreve e duke i bërë të diskutueshëm kriteret e përkufizimit të tyre. Gjykojmë se rasti i poemave në prozë mund të shihet si ardhje e tillë.

Në një situatë amullie postzhanrore, poemat në prozë (si ajo që po marrim në shqyrtim) janë shfaqur si një zhanër relativisht i ri, një zhanër teknikisht i vështirë për t’u përcaktuar dhe përkufizuar, për shkak të abstraksionit formal dhe, si rrjedhojë, një ambiguiteti strategjik tekstor.

E pamë të udhës të bëjmë këtë hyrje, për të pohuar se me madrigalet e Camajt kemi të bëjmë me një tekst klasifikueshmërisht jo të lehtë. Kjo përforcohet nëse i referohemi përcaktimit që vetë autori bën për tekstin “*Dranja ka dalë si vepër mjaft e diskutueshme, sidomos për formë e*

⁶ Pa dashur ta rëndojmë temën me historinë e këtij lloji, po kujtojmë vetëm atmosferën jo miqësore me të cilën kritika, përveç të tjerash edhe për shkak të papërcaktueshmërisë së llojit, priti *Spleen i Parisit* të Baudelaire-it apo poemat në prozë të Oscar Wilde-it.

gjuhë.⁷ Ndaj nisur nga çfarë thamë më sipër gjykojmë se kjo vepër vlen të diskutohet në suazën e tipologjisë së zhanreve të ndërmjetme.

Së pari, sepse vepra na vjen si:

- a) Një tekst letrar që shtrihet mbi kuptimin muzikor të zhanrit (ndonëse nuk është në vargje si madrigali, në përmbajtje i përket kësaj gjinie⁸)
- b) një tekst shkrimor prozaik, por me imanencë të fortë poetike (gjuhë dhe ritëm)
- c) një tekst poetik, por me zë modelues narratori.

Kapërcimi i zhanreve artistike dhe inspirimi për të shkruar një tekst që ka primar tëhollimin e gjuhës nëpër derdhjet e frymëzimeve, përjetimeve e dijes më tepër sesa montimin e një lande (sado e madhe) brenda një forme të pranueshme, na e bën të qartë se vepra, si e tillë, i kundërvihet trajtave të tjera letrare, të përdorura deri më sot në gjuhën shqipe⁹. Në rastin tonë flitet për tekst dhe intertekst dhe jo për lloje të njohura e kufij. E vetmja gjë që e lidh tekstin e Camajt me të shkuarën e llojit të madrigalit është ritmi, një ritëm madhështisht muzikor, por edhe ky i ardhur jo në masat e veta klasike (organizimi strukturor), por si organizim i përsosur gjuhësor: aftësia për të kombinuar kontekstin e tekstit poetik me sfondin e përshtatshëm muzikal të fjalëve. (Duket se mjeshtërinë stilistike teksti e ka në organizimin muzikor të sintagmave dhe jo në shfrytëzimin paradigmatic të fjalës. Afërmendsh, ndërtime të tilla si: *U përhi veshlepuri mes hepeve të gurëve; Dranja fle fshe ndër gjeth; ngjitë për tule tufa ushujzash si flokë meduze; plasi dielli nga reja, vetim në rrashten e Dranjes mes librash*, e shumë të tjera, dëshmojnë preokupimin stilistik serioz të një mjeshtri që ka pasur fatin ta ushtrojë dhuntinë e krijimit mbi një gjuhë, e cila në formën më të thellë të saj është poetike¹⁰).

⁷ Martin Camaj, Individualiteti ynë shprehet në letërsinë e artit tonë, rev. "Nëntori", nr. 4, Tiranë, 1991, f. 116.

⁸ M. Camaj, vepra letrare 3, te Shënimi i autorit, "Apollonia", Tiranë, 1996, f. 7.

⁹ po aty.

¹⁰ V. Osja, Konceptime postmoderne të mitit në madrigalet "Dranja", Aktet e Seminarit Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, Prishtinë, 2007.

Së dyti, sepse *Dranja*, në mes luhatjes për përcaktimin e tekstit si prozë poetike apo poezi në prozë, duke u nisur kryesisht nga dominanca e instrumenteve stilistikë që kemi përcaktuar, i ofrohet më së shumti poezisë në prozë, pasi ajo i ka të gjithë elementet e lirikës, përveç aspektit tipografik. Secili prej madrigaleve ka gjatësinë e një poezie lirike, duke ruajtur kështu integritetin e një teksti poetik. Gjuha e tyre është më e ngjeshur në densitet imagjinate dhe figure sesa do ta kërkonte proza poetike¹¹.

Dy citimet e mëposhtme, mendojmë se mund të ishin një linjë e mirë ilustrimi për këtë ide:

*Ecte me sy ndër rreze, lanë mbrapa nga dielli që kapej përmbi lisa. U fik mendimi i ditës punëtore në mua*¹².

*Tisi, breu e pisha janë druj virgjën dhe e lypin vetminë. Por zogjtë nuk i lanë të qetë. Këta e dinë mirëfilli si ua merr dielli lulen e vajznisë ndër grykëza, si turpnohen degët kur u shkon e u vjen mushti nën lëvore e si ato i mjekojnë plagët e veta me ërrëshinë, Në vetmi asht shumë ma lehtë me njëhë në rrashtën e Dranjes, si në varzat e brinit të sqapit, motet*¹³.

Tekstet shpesh kanë rimë të brendshme dhe lëvizje të lehta metrike (*U përhi veshlepuri mes hepeve të gurëve; Ecte e shkëlqente nëpër bar të shkitshëm mbas shiut në mëngjes; ngjitë për tule tufa ushujzash si flokë meduze; etj*). Secili prej madrigaleve karakterizohet nga dominanca metaforike (jo metonimike) dhe ritmi. Shumë shpesh theksi ritmik ka përputhje me theksin logjik, duke përfutur sintagma poetike e kadenca të ndjeshme muzikale (*kalbej fara e kuptimit të fjalëve në gjumë para se me u zgjue. Andaj nuk kishin as tinguj*¹⁴. *Ecte e shkëlqente nëpër bar të shkitshëm mbas shiut në mëngjes*).

¹¹ Kjo shenjoheq që në titujt e madrigaleve. Tituj të tillë, si: *Pa sythin e ditës së qartë; Atje ku edhe hana asht pjellore; Me shijen e sisoreve në gjuhë; Vetmia nuk e len me marrë frymë kohën*, etj.

¹² M. Camaj, *Vepra letrare 3*, "Apollonia", Tiranë, 1996, f. 17

¹³ Po aty, f. 88

¹⁴ M. Camaj, *vepra letrare 3*, "Apollonia", Tiranë, 1996, f. 92.

Po kështu prania e sintaksës eliptike, si psh, te: *Hija e randë e femën, rrezja e parë ndër flokë, kur ndalemi midis blerimit përmbi livadhe në luginën e gjunjëve malorë. Trajta e dheut na grishë: larg zotave të rrejshëm që u vjen era djersë pegazash smirëzes e magrorë*¹⁵ dhe format gramatikore me inversione jo të zakonshme e bëjnë veprën t'i qaset poezisë.

Për ilustrim mund të zgjidhnim cilindo prej madrigaleve të librit, por jo rastësisht zgjodhëm madrigalet “Vjeshta po kalon” dhe “Si një hajmali”, të cilëve po t'u lëviznim diçka nga mekanizmi i strukturimit, do të përftonim një poezi të mirëfilltë.

Nga madrigali, “Vjeshta po kalon”:

Vjeshta po kalonte, por grethi me za të burrueshëm si kurrë kërkoi ndër lisa e gjeti çka lypte: pemë të çame përgjysmë me erën e athët në lang. Një lloj bretkose, thithlopa e ngime, i merr amë në hapësi qumështit që shkumbon në vedër mes gjujve të mjeltores, gërmuq në shkam, ende të pashtitëruem mirë për këtë zeje.

*Edhe pse tepër ngjyra në këtë vend, koha përputhet për kohë përkueshëm, pa u vra aspak sendi për send.*¹⁶

Nga madrigali, “Si një hajmali”:

Prapë ktheva atje ku isha.

Tash janë ide, jo ndjesi, xhixhillojat që ulen degësh si fryte e derdhen mbi trollin e pastër, mbas derës së moteve. Sosi koha e ravgimeve mbas Dranjes, koha e pritjeve e e mallëngjimeve!

*Nuk pres t'i dalin goje shkëndija që të më bien mbi krye*¹⁷.

¹⁵ po aty, f. 87.

¹⁶ po aty, f. 23.

¹⁷ po aty, f. 86.

Në këtë rast nuk bëhet fjalë vetëm për një “shkallë të matshme të dekoracionit stilistik dhe imagjnativ”, por edhe për një organizim të frazës drejt sintaksit poetik.

Së treti, duke iu referuar konceptit bahktinian për zhanret “dialoguese” dhe “monologuese”, mund të pohojmë se madrigalet e Camajt shfaqin karakter dialogues me tri zhanre të mëparshme:

1. me vetë madrigalin si zhanër muzikoro- letrar, dhe ky “dialogim” duket në ritëm;

2. me prozën si zhanër letrar, dialogim që duket në formën shkrimore të tekstit;

3. me poezinë (ky i fundit është edhe dialogimi më i rëndësishëm dhe më i fortë).

Argumentet e këtij dialogimi mendojmë se u dhanë më lart.

Siç kanë pranuar kritikët, shfaqja e poemës në prozë në një çast të caktuar historik si krijim që ka një karakter dialogjik, një fund të hapur dhe një liri të brendshme të formës e bën atë të qëndrojë si zhanër më vete.¹⁸ Për të konkluduar, mund të themi se me veprën “Dranja” Camaj shkatërron mitin e llojit letrar, përcaktueshmërinë e kufijve midis gjinive letrare, duke e konsideruar veprën më tepër tekst e intertekst sesa zhanër të ngulitur letrar, variacion gjuhe më tepër se sa zhvillime tradicionale të lëndës.

Në letërsinë shqipe tradita e lëvrimin të këtij zhanri s’ka qenë edhe aq e vonë, po të kemi parasysh vonesat sistematike dhe të forta që kanë shoqëruar zhanret e tjera apo edhe lëvizjet letrare: emrat e Lumo Skëndos e të Faik Konicës kanë projektuar lehtëzi e me sentimentalizëm sinoret e këtij zhanri, ndërsa me Koliqin (“Pasqyrat e Narçizit”) e Migjenin (“Bukuria që vret” e ndonjë tjetër), kemi një rafinim të formës, por me Camajn mendojmë se kemi arritjen e një kuote të lartë, duke çuar te formimi i një paradigme të këtij zhanri në letërsinë shqipe.

¹⁸ Në mungesë të një përkufizimi transhistorik të poemës në prozë, studiuesit e sotëm sugjerojnë se mund të pranohet arsyetimi i Tzvetan Todorov-it se nuk ka zhanre të pastra dhe madje një zhanër i ri bëhet automatikisht i pranuar nga referenca me një apo disa zhanre të mëparshme.

The typology issues of genre in *Dranja's* Madrigal

This article is an effort to analyze the text of Camaj in the frame of intermediate genres. Based mainly in the poetic dominance of the literary instruments that we have identified we have classified the Madrigals as prose poems. The text has all the elements of the lyrics, except of typographical aspect. Each of the Madrigals is in the length of a lyric, maintaining, in some way, the integrity of a poetic text. The language of Madrigals is more compressed in image and literary figure than would require poetic prose.

To conclude, we can say that in this work, Camaj destroys the myth of the literary kind, wipe of the borders between literary genres, considering the work as a text and intertext rather than embedded literary genre.

Ledia DUSHI (Tiranë)

MARTIN CAMAJ, LARG DHE AFËR SHQIPËRISË

Martin Camaj në poezinë e tij “Vendit tem” shkruan: “Kur të vdes le të bahem bar/ në malet e mija në pranverë,/ në vjeshtë do të bahem farë”. Kjo është ajo çka autori i ofron vendit të tij. Ndërsa në lidhje me Martin Camajn besoj se është shkruar e vlerësuar aq sa ai të konsiderohet një lloj fenomeni letrar me një prirje të vazhdueshme drejt përsosmërisë artistike; vepra e tij përmban shumësinë e mendimit, shumësinë figurative të fjalës dhe njëkohësisht vetëdijen e lartë estetike të ngritur deri në model.

Por Martin Camaj do të jetë afër Shqipërisë dhe në të, atëherë kur të ketë zënë rrënjë ideja se ai është njëri prej shkrimtarëve më të mëdhenj të letërsisë shqipe dhe se vepra e tij hyn në fondin më të shquar të letërsisë bashkëkohore shqiptare. Për këtë nuk mjafton vetëm të flasim, por duhet një përpjekje shumë më e gjerë. Flas pikërisht për atë përpjekje që është bërë me autorë të tjerë, të cilët kanë zënë vend në të ashtuquajturin panteon i artit shqiptar.

Poezia dhe proza e Camajt janë shkruar në gegnisht, në gjuhën e hershme të shkrimit të dokumentuar të shqipes në veprat e Buzukut, Bardhit, Bogdanit e Budit, është shkruar në gjuhën me anën e së cilës mendimtarët e poetët, si: Mjeda, Fishta, Shiroka, Koliqi, etj., e përsosin shprehinë poetike shqipe. Gegnishtja me Camajn është lëvruar e përsosur më tej, fakt ky që pati rrjedhoja të dyfishta: dha kontribut në zhvillimin e letërsisë shqipe, por edhe e largoi nga mjedisi zyrtar, i cili mban qëndrim të çuditshëm kundrejt kësaj shprehije aq të sofistikuar letrare.

Në një kohë kur zyrtarisht apo nga persona që s’dihet në emër të kujt flasin po bëjnë përpjekje duke hulumtuar ku mundin në hapësirën e letërsisë shqipe, me emra të njohur e të panjohur të grupit të vjetër apo me

emra "të afirmuar" të 20 viteve të fundit, e në këtë rrugë po mundohen t'i kombinojnë dhe t'i integrojnë mes veti për ta përcaktuar dhe krijuar nocionin "letërsi kombëtare" në gjuhën shqipe, disa nga studiuesit e Camajt, brenda dhe jashtë vendit, në mënyra të ndryshme, theksojnë se "Në vetëdijen e publikut të gjerë lexues", ai klasifikohet si "rast i veçantë - qoftë si autor që e shkruan gegnishten ekzotike, qoftë dhe si shkrimtar modern në mërgim, etj., kur ai duhet të figuronte si pjesë përbërëse e kulturës shqiptare".

Në ditët e sotme kur flitet për letërsinë krijohet një mjedis ku autori vlerësohet si aktivist shoqëror, ku ai vërtetë mund të ketë merita, por kur flasim për krijim letrar duhet të merremi me atë që e bën të tillë një krijim letrar, me vlerën apo antivlerën letrare të tij, dhe jo me jetën dhe veprimtarinë shoqërore e politike të autorit, me gjuhën në të cilën ai shkruan, ta vlerësojmë atë si vlerë letrare, pavarësisht se veprimtaria shoqërore mund të ndikojë. Duke rënë prë me dashje (dashakeqje) apo pa dashje, bëjmë që vlerat e vërteta artistike të autorëve të vërtetë përfundimisht të burgosen brenda veprës së tyre e kështu "gjykatësi i vetëm" mbetet lexuesi i cili, gjithsesi, bëhet prë e vlerësimeve pa kurrfarë vlerash, të dhëna këto përmjet mjetesh të fuqishme informacioni.

Martin Camaj në poezi dhe prozë rreh të zbulojë rrënjët e identitetit të shqiptarit të tij. Ndërtesën e artit të vet Ai e ngriti me gurët e tokës ku kishte lindur. Mundemi lehtësisht të themi se Camaj e mbrun poezinë. Camaj i qaset punës së tij poetike duke u shprehur në këtë mënyrë: "Poezia nuk lyp shpjegime, dhe ajo flet për veten në atë formë e strukturë që ka".

Duket se toka është ferri i një planeti tjetër e kur ndodh që nganjëherë t'i bjerë dielli, na bëhet se shohim gati në mallëngjim, tashmë shumë larg prej nesh atë çka mund të ishte e jona, atë që mund të na bënte të ndjeheshim mirë, atë që mund të na jepte emrin që kërkojmë.

E gjithë kjo gjendje na sjell ndër mend shprehjen, "në atë kohë...", e se si ishte ajo kohë, e mbi të gjitha kur ishte, nuk e dimë.

"Koha e largët", "shpirti i zgjedhur i sendeve", ka vetëm një mënyrë afrimi, vetëm nëpërmjet artit.

Një afrim të tillë na e bën vepra poetike e Martin Camajt. Të provosh t'i afroresh këtij thelbi këndellës, do të thotë të merresh fort me Kujtesën.

Gjithçka tek Camaj është Kujtesë; në fund të fundit Kujtesa dhe bartja e saj shpirtërore në mendje e në ndjesi, është thelbi i të bërit Art. Po cili është raporti mes veprës poetike të Camajt, e veçanërisht poezisë së tij me Kujtesën?

Camaj nuk është shënues ngjarjesh që dikur kanë ndodhur. Ai rrëmon në "plagën" që ajo çka ka ndodhur ka shënuar tek ai. Ato plagë cirkojnë gjak e aty Camaj ngjyen pendën e tij. Tek Camaj plagët nuk vdesin.

Ato janë Orët e Zanat e shpirtit të tij. Ato nuk shihen, vetëm kallëzohen. Ato nuk preken, vetëm ndjehen.

Ato janë aroma dhe ngjyra e lules, e jo ajo çka mbetet prej saj. Ato janë fshehtësia e ëmbël e dritës së hënës, e jo vetë hëna e ftohtë. Camaj shkruan për atë pjesë të kujtesës që quhet Mall, por nuk mallëngjehet. Është pjesa krenare e mallit. Camaj kujton dhe i lëshon fre ndjesive, por gjithsesi e mban në grusht veten; ia lëshon frymën shpirtit, por s'e përzien me erën. Ajo çka e përshkon poezinë e Camajt është përplasja mes dëshirës dhe mundësisë, ëndrrës dhe realitetit. Poezia e Camajt është sa frymë aq edhe dritë në vatrat hyjnore të trurit njerëzor. Ndoshta, për paradoks, prandaj ka njerëz që e kanë të vështirë t'i afrohen. Mendoj se shprehja "nuk e kuptojmë Camajn...", është e lidhur me faktin se Arti i Tij është pjesë e atij që e quajmë Arti i Madh, dhe se gjithsesi nuk është e lehtë që këtë art ta bësh pronë vetjake.

Camaj krijoi vepra letrare moderne mbështetur në traditën e vendit të tij duke ngritur në art shqetësimet e njerëzve në ambiente të ndryshme, që nga bjeshkët e Dukagjinit e deri në mjediset moderne të botës. Në poezitë e Camajt ndjehet fuqishëm poeti që nuk e kishte lexuar kurrë më parë e që ishte brenda tij, siç shprehet Borges.

Thuhet se Camaj ishte hermetik, në një kohë që hermetizmi është më tepër shprehje e ndikimit të jashtëm në letërsinë shqipe se sa një vlerë e saj. Kjo dukuri shfaqet në letërsinë e ngritura dhe është shprehje e lëvizjes

së poezisë nga sferat e njohura në të panjohurat, si pakënaqësi ndaj stadi ekzistues të saj.

Tek Camaj ka rëndësi mënyra se si ai e vendos fjalën në raport me vetë fjalën, për t'u thënë, për t'u ligjëruar. Mbase vetëm kur fillon të gjallojë së brendshmi, poezia e tij do të mund të fillojë të ekzistojë, bazuar në thelbin e vërtetë të saj. Në të mirë të kësaj ideje e më gjerë, mund të citoj shprehjen e prof. Pipës, kur thotë për Camajn se “Ai ka guxuar të “sfidojë” poetikën e së fundmes, karakteristikë e poezisë së mësuar, me poetikën e tij të së pafundmes, karakteristikë e poezisë gojore”.

Vargu i tij poetik është disiplinë, është filozofi në dukje e ashpër, por mbasi e lexon jashtë deklamacionit bosh e pakuptim, e merr vesh se mbron një shpirt të butë, një gjallesë të mrekullueshme që dalëngadalë merr formë brenda teje e bën që të ndjesh kënaqësinë e krijimit. Camaj e kërkon bukurinë në thellësi, në mënyrën më të thjeshtë. Nuk mund të jem në një mendje me shprehje të tilla që e nxjerrin Camajn si dy herë të përcaktuar; ai është një herë të vetme, qartësisht i përcaktuar.

Në njërën prej poezive të tij, “Mistika e lules” ai shkruan: “Tha njeriu: po qe se vdes bleta/ fryma e saj kthen ne lule/.....Sot një zogës blete i tha asaj në vesh/ diçka të mistershme/ dhe lule-trumza i dha asaj frymzën e vet/ me ia ruejtun për verën tjetër./ Tha bleta: këtë dimën nuk vdes/ pse kam frymën e lule-trumzës në vete. Ky fragment më shumë se të shtyn të analizosh, të sugjestionon. Është bukurtingëllimi i fjalëve, është “frika”e asaj çka fjala do të thotë, çka fjala do të jetë, çka fjala do të bëhet, për të ndodhur çfarë, për të jetuar të nesërmen me mistikën e artit, e dhuruar nga poetët tanë të shkëlqyer. Martin Camaj është poet lirik e poezia e tij na jepet me forma e përmbajtje moderne. Thuajse gjithë poezinë e tij e shoqërojnë motive të vendlindjes e fëmijërisë, ku kanë zënë vend elementet thellësisht shqiptare, si: peizazhi, mitologjia, simbolika e sendeve, metafora etj.

Siç përmenda edhe më lart, Camaj është vazhdues i veprës së autorëve të letërsisë shqipe që shkruan në gegnisht, nga Budi tek Mjeda e Koliqi, i vetmi autor modern shqiptar i denjë për të vazhduar trashëgiminë e

ndritur të tyre. Vepra e Camajt tregon se, jo vetëm që gegnishtja nuk ka reshtur së ekzistuari, por ka arritur kulme në ligjërimin letrar.

Ndonjë nga studiuesit shqiptar munden edhe të thonë se, Camaj është vërtetë i madh, por sinqerisht na vjen keq që ai shkruan në “gegërisht”. Po të ishin të shkruara në “normë” vepra e tij, pa diskutim do të ishte më i madhi. Sigurisht kjo gjë, që për fat të keq nuk është vetëm mendimi i një personi, qoftë ai edhe studiues, por është më shumë, është një grupim i tërë që mendojnë kështu, dhe sa më i madh dhe i fuqishëm të jetë grupimi, aq më shumë i largohet Camaj vendit të vet, Shqipërisë. Ta “afrojmë” Camajn, do të thotë të kuptojmë se, duke shkruar në gegnisht ai i ka bërë shërbimin më të madh e më fisnik poezisë shqipe, letërsisë shqipe, dhe vetëkuptohet, gjuhës shqipe. Për t’u arritur kjo gjë kërkon një përpjekje të dëlirë, pa mllefe primitive, pa fjali e sllogane të rrejshme, se gjoja duhet ndarë gjuha standarde nga ajo letrare, të cilat vërtetë janë të ndara, por janë, në një lloj këndvështrimi, në kushte më fort se të barabarta. Sa nxënës në një klasë, qoftë edhe në Shkodër munden ta thonë përmendësh ndonjë poezi të Camajt? A mund të vihet në skenën e teatrit “Migjeni” ndonjë pjesë dramaturgjike e Camajt, p.sh. Kandili i Argjendit? Dhe kjo jo për arsyen se teatri është shtetëror dhe aty flitet gjuha zyrtare, ndërsa “gegnishtja” nuk është shtetërore.

Është e rëndësishme të kuptojmë se poezia e Martin Camajt është kështu sepse është shkruar nga një poet i vërtetë, që përfaqëson fuqishëm vendin e vet e që arrin në pikat më kulmore të zhvillimit të artit.

Ashtu siç theksova me lart, poeti mbetet përfundimisht i “burgosun” brenda veprës së tij. E mendoj se duhet që të gjithë ne, e kam fjalën për të gjithë ata që e njohin dhe e duan poezinë e vërtetë, të përpiqen për ta jetësuar, jo për “hatër” të Camajt, por të poezisë shqipe, të traditës dhe pavdekësisë së saj.

Tek poezia “Dita e malit tem” Camaj shkruan: “Në muzg atje secili prek ballin e vet/ e ndien ndër gishta fillin e jetës/ e gëzohet.” Dhe u tregon të gjithëve se kjo gjë është: “Pendë e lehtë në dukje/ po e randë hekur në peshë,/tingull ose ngjyrë/ e kthjellët deri në dritë.”

Bavjola SHATRO (Durrës)

POEZIA SI BOTËKRIJIM DHE ESTETIKA E RIPËRMASIMIT TË KOHË-HAPËSIRËS

Në letërsinë shqipe, poezia e Martin Camajt paraqet një ndër femomenet më komplekse dhe njëkohësisht më të rralla. Në këtë fakt kontribuojnë estetika e saj dhe po aq edhe rrethanat e jashtme të shkrimit dhe receptimit (ose mosleximit) të saj, qofshin këto letrare dhe joletrare.

Si rezultat, qasjet ndaj poezisë së Camajt janë të shumëllojshme dhe të gjitha përballen me pasurinë dhe polivalencën e saj sfiduese kuptimore. Poezia e Camajt niset dhe mbërrin në përmasa të ndryshme të të kuptuarit të botës. Kjo zhvendosje në përmasat e kuptimit realizohet në kohë-hapësirë dhe ka ritmikën dhe logjikën e saj, e cila shkon përtej modelit të njohur në poezinë tonë përgjithësisht.

Në këtë poezi nuk mund të gjurmohen simbolet, metaforat, strukturat tekstore apo semantika e fragmentarizuar për hir të formave tradicionale të qasjes analitike. Copëzimi i saj na shkëput nga të kuptuarit e mirëfilltë dhe na kujton se poezia e niveleve të tilla, më së pari, përkapet përmes njohjes intuitive, pra drejtpërdrejt nga ndjeshmëria fine që lexuesi duhet të ketë për poezinë dhe më pas të hulumtohet imtësisht dhe me kujdes të posaçëm në rrafshet e saj kuptimore të shtresuara dhe të organizuara përpikmërisht brendapërbrenda saj. Kjo është një poezi që parakërkon ndjeshmëri estetike të lartë dhe zotërim të një trashëgimie dijeshe dhe të një sensi të hollë zbirues rreth zhvillimit të qytetërimit, duke përbërë kështu, një fakt ndoshta unik në tërë poezinë shqipe.

Vështruar nga pikëpamja e shtrirjes së saj si konceptim dhe estetikë, poezia e Camajt paraqitet si një hartë katërdimensionale e qenies në kohë. Prandaj, kontakti me të duhet bërë në mënyrë të tillë që të përkapë lidhjet asociative qarkulluese, të cilat thurin ngrehinën e perceptimit të botës çka në fakt, përbën mirëfilli një botëkrijim. *Ky fakt, botëkrijimi lidhet me idenë*

e shtresimit dhe zgjerimit të qenies në atë masë që ndodh shfaqja e saj në forma të ndryshme. Kjo përmbajtje e shfaqur është e pakrijuar, nuk përkiste më parë diku, por krijohet pikërisht në aktin e risisë absolute¹⁹.

Në këtë mënyrë brenda diskursit poetik krijohet një relacion shumëfaqësh me ekzistencën si të tillë. Ndër tiparet që i njeh diskursit Martin Heidegger-i gjejmë dy veçori që i zotëron Fjala në poezinë moderne dhe që i konfiguron në varg përmes bashkëveprimit të disa elementeve duke kaluar në ndërtimin e një atmosfere, realiteti, apo gjendjeje specifike, sikurse do të analizojmë më poshtë specififikisht. E thënë më konkretisht përmes Heidegger-it:

“Në diskursin ‘poetik’ komunikimi i mundësive ekzistenciale të gjendjes-së-mendjes së dikujt mund të kthehet në një qëllim në vetvete, dhe kjo rezulton në një hapje të ekzistencës.”²⁰

Poezia e Camajt, që në fillimet e saj, nis me afrinë plazmike ndaj mjedisit konkret nga i cili mendja dhe përjetimi, në fazat e mëvonshme të krijimtarisë, e zhvendosin unin drejt një përmase kujtimi. Ky i fundit paraqitet si zhbirim i vetes, i origjinës si etnos e si qenie dhe si një test para historisë, në të cilin e shkuara dhe e ardhmja ngjizen në një të tashme universale. Elementet konkrete hapësinore na shtyjnë drejt *mjedisit abstrakt të mendimit*. Sado gjenden mjaft tregues që të kujtojnë diçka epike, ai është një lloj epizmi, të cilin Koliqi e quante epiciteti anakronistik²¹, i ndërtuar posaçërisht në një dritë të tillë që të mos heroizojë, por të analizojë rrënjën e vetëdijes dhe të mbijetesës individuale të njeriut, e më së pari të njeriut shqiptar.

“[Camaj] ... din të harmonizojë në shkrime primitivitetin rrejtë në plotsinë ma të plleshme me një zotnim të mjeteve ma të rafinueme t’artit letrar modern.

.....

¹⁹ Parathënie e “Poesia e Ontologia” Gianni Vattimo. A cura di Diego Fusaro, f. 1. [përkthimi ynë, B.Sh.].

²⁰ Martin Heidegger, “Being and time” Harperennial Modern Thought, USA, 2008, f. 205. [përkthimi ynë B.Sh.].

²¹ Ernest Koliqi, “Arti i Martin Camajt” Revista “Kritika”, Tiranë, 2010, f. 113.

[Camaj].... i cili qysh tash mund të njuhet si përtrisi i një rrymbe të re në letrat shqiptare, rrymbë e shqueme prej një çveshjeje nga çdo zbunim retorik e për një prirje me zbulue në vetvete e në tjerë vetit ma të strukuna në skuta të vetedijes dhe n'errsit e misterëshme të nënvetëdijes.”²²

Që në vëllimet e para, *Një fyell ndër male* dhe *Kanga e vërrinit*, sikurse pohon Koliqi: “Nji shqetësim i pacaktuem shpirtnuer qarkullon në mbrendi të këtyne vjershave”.²³ Në vëllimet që pasojnë, kjo hije me polivalencë kuptimore do të bëhet shumë më prezente në poezinë e Camajt dhe ne do ta prekim këtë ecuri duke nisur tek *Legjenda*, për të sintetizuar më tej, në linja kryesore, kulmet e arritura në vëllimet e fazës së tretë të krijimtarisë në Martin Camajt.

Në vëllimin *Legjenda*, poeti kijon një kohë-hapësirë në të cilën përthihen në ironi, brengë, enigma dhe fragmente kujtese, ngjarje njerëzore me vlerë arketipale. Aty krijohet çasti kozmogonik i shfaqjes së universit duke përfshirë imazhet zanafillore të Adamit dhe Evës, çuar tashmë në bjeshkët shqiptare, në një Eden të ashpër malor, rënia nga i cili ngjan si reminishenca dhe kujtimi më i gjallë i unit që vetëremohet, për të mos humbur grimcat e pakëta të jetës së jetuar nga brezat dhe që është rrënjësor gjenetikisht si kujtesë gjaku, tek subjekti. Krijohet kështu historiku i njeriut në primordialitetin e instinkteve të tij, në të cilin vendoset paralelizmi mes burrit dhe lumit. Në këtë linjë arsyetimi, Drini është një koordinatë në kohë-hapësirë dhe po ashtu pikë referimi.

Legjendat janë zhbirim në gjenin njerëzor dhe në ontologjinë e tij. Koordinatat hapësinore tek këto poezi zhvendosen në përmasën e trefishtë mitike, e cila është e pranishme edhe në botën shqiptare:

- në qiell (re, mjegull, erë, fluturim, hëna, dielli, rrufeja, etj.)
- në tokë (lisat, shkëmbi, pemët, guri). Ky i fundit emërtohet si është e tokës dhe palca në të cilën njësohet njeriu që edhe vet është i lidhur pandashëm me tokën. I tillë është malësori që e kupton veten vetëm në raport me këtë të fundit, prandaj edhe gjarprin, tokësin thënë ndryshe, e

²² Ibid. f. 115.

²³ Ibid. f.114.

ka të shenjtë; edhe pas vdekjes hija e malësorit reflektohet në tokë, siç thotë Camaj në poezinë *Çdo gjë ngrihet kah qiella*, Vepra 2, f.130, etj.) - dhe nëntokë (shpella, gurra).

Ka edhe figura me konotacione të shumëfishta simbolike, të cilat gjenden si nyje lidhëse mes këtyre përmasave dhe përbëjnë një përmasë të katërt. Ato janë entitete që kanë aftësinë të udhëtojnë në kohë dhe të ndërtojnë një lloj dimension të katërt, tipik të poezisë së Camajt. Këto janë gjarpëri, hija, fryma, uji, lumi, liqeni, kalorësi, zjarri, dhia e egër, fyelli. Këto të fundit rrokin tokësoren dhe mbitokësoren jetën dhe pasjetën. Ato janë pika lidhëse për të kuptuar nocionin *kohë*, në vëllimin *Legjenda*. Në fakt, këtu koha pushon së qeni e matshme. Ajo është vetëm një e shkuar e përtejme, e cila mbart të ngjizura ndjesitë më primordiale njerëzore: misterin e krijimit, misterin e femrës, instinktin seksual, mbijetesën fizike, frikën e vetmisë, enigmën e vdekjes, mbinatyroren, vetëdijen e të parrokshmes që mbetet e ngjizur tek njeriu, si edhe etjen dhe joshjen nga e panjohura, qoftë edhe me çmim tragjik. Realiteti i botës shfaq përherë një *Diptik*:

“Pra, pas çdo pamjeje është një pamje tjetër, pas çdo kuptimi është një kuptim tjetër. Kjo luhatje, ky dyzim, ky ambiguitet, si shfaqje e pafundësisë, e dyshimit kritik, e lëvizjes, e kërkimit, janë veçoritë karakteristike të kësaj poezie...”²⁴, e ne do thoshim që në forma të ndërlikuara konceptualisht, por edhe estetikisht, kjo vlen për tërë poezinë e Camajt, e cila është një qenie e ndarë dyshaz, palcë që ndahet dhe sërish ruan materien e vet në kodin gjenetik të mbijetesës dhe të qeniesisë, për të verbalizuar të pathënëshmen. Në këtë mënyrë elementet ontike shërbejnë si ura lidhëse për të na hedhur në përmasën ontologjike të poezisë. Në këtë kohë-hapësirë të Camajt gjithçka paraqitet me përmasën e saj parake, dhe (te)shqisore, madje edhe vet Gjergj Kastrioti kur bëhet personazh i poezisë së Camajt. Kjo është harta e re konceptuale dhe materia e re kohë-hapësinore në poetikën e tij, për të na zbuluar jo vetëm relacionin gjuhë-poezi, por mbi të gjitha realitetin e poezisë si botëkrijim dhe gjenezë.

²⁴ Ymer Çiraku, “Bota poetike e Martin Camajt”, Albas, Tiranë, 2003, f. 56.

Konfigurimet e hapësirës në poezinë e Camajt janë të tilla që i krijojnë terren këtyre lidhjeve asociative që e endin tekstin poetik me ngjeshje, ndoshta ekstreme leksikore dhe kuptimore, por me një sens lirik dhe konfigurime estetike që sfidojnë lehtë interpretimin dhe çdo receptues të kësaj poezie. Hapësira shfaqet në trajtën e një shkrirjeje apokaliptike kur shprehet përmes figuracionit të ngritur mbi elementet e vatrës, prushit, pishës, bimëve të caktuara dhe flakës, thëngjillit, rrobës së hequr nga trupi. Dhe këtu rikthehen imazhet e një sensualiteti pothuaj ezoterik, ku në forcat e tij parake ndërtohet skena e krijimit të botës.

Të gjithë këtë gjërmim përbrenda vetes, përbrenda individit, uni e transmeton nën peshën e vetmisë. Vetmia arrin në tragjikë sidomos në figurën e kaut të mbytur në kohën e urisë, në poezinë me të njëjtin titull. Këtu nis përllogaritja e kohës së brendshme si një gjendje kapluese që i takon një të shkuare të parrokshme, por që njeriu e mbart me vete dhe përpiqet ta artikulojë verbalisht që ta bëjë të lexueshme për mendimin, për shqisat njerëzore dhe që ta historicozjë. Poetika e Camajt në raste të tilla e sintetizon mendimin deri në kufijtë e sfidës së imagjinatës gjuhësore:

*Lokja n`gurgullimet e tingujve
Të valave drinore ndien fjalën e gjakut
Të vjetër, të marrun prej urave druni,
Tue kërcllatë si n`djegie n`erë.*

Së jashtmi, asgjë nuk ndodh por së brendshmi, mendimi vlon për të vendosur komunikimin me pjesën e vetes të lënë diku përtej, në një tjetër hapësirë dhe kohë. Në poezinë *Natura Morta*, kjo përmblihet aksiomatikisht në vargun: *Njeriu ndrron fëtyrë vetëm përbrenda.*

Sikundër është e dukshme në binomin kohë-hapësirë, pesha abstraguese bie tek elementi i parë. Në poezi, dimensionin kohor arrin të tilla trajtësime, të cilat mund të rikrijojnë vetëperceptimin për hapësirën dhe në tërësi rendin kozmik të botës. Aporetika e kohshmërisë është tashmë një nocion i njohur, nga i cili do të marrim atë linjë trajtimi që na ndihmon të kuptojmë rikonceptimin e kohë-hapësirës në poezinë e Camajt.

E. Husserl-i njihet për përpjekjet e tij që të mund të jepte një shpjegim të drejtpërdrejtë në lidhje me *të shfaqurit* e kohës si e tillë. Ky nocion është vetiu tejet sfidues dhe e çon forcën abstraguese të mendjes njerëzore në skajet e mundshme. Në një nivel të tillë riformulohet edhe ndërgjegjia për kohën.

“Atëherë, ndërgjegjia për kohën duhet kuptuar në sensin e ndërgjegjes ‘*së brendshme*’ (*ineres*). Pikërisht në këtë mbiemër bashkohen zbulimi dhe aporia e krejt fenomenologjisë së ndërgjegjes mbi kohën. Ajo që e prodhon këtë ndërgjegje, e cila në fakt është saktësisht një ndërgjegje-kohë, është nxjerrja jashtë qarku e kohës objektive.”²⁵

Mes ndërgjegjes dhe kohës mungon intervali kohor. Ndërkohë që, nga të shfaqurit e kohës, si koncept, përmes termit kohë objektive rrëzohet pikërisht koha e botës, të cilën siç sqaron Rikëri, Kanti e quante presupozitën e çdo determinacioni të objekteve. Por njëpasnjëshmërinë mes kohës së brendshme dhe asaj të përjashtësisë, në rastin e poezisë e konceptojmë përmes një fenomenologjie, e cila sado abstrakte dhe në tone fragmentariteti të qëllimtë, e gjejmë në një formë të trupëzuar. Njeriu është sa i pavaruar aq edhe i vendosur paracaktueshëm në të. Rasti i poezisë së Camajt është një mundësi fatlume për një të kuptuar të tillë brenda poezisë tonë. Në vëllimet *Njeriu më vete e me tjerë*, *Nema*, *Buelli*, kjo realizohet përmes elementeve sinkopë, alkimisë së gjuhës, simbolikës së shumëfishtë të fjalës apo fatumit të mbartur në shpinën e natyrës, në rreze, ujë, lis, në zërin njerëzor në bjeshkë, në shtresat e nënvetëdijes të ngulitura nga gjenetika e individit dhe e bashkësisë dhe po aq nga forca të parrokshme, të cilat janë pjesë e botës së tij.

Në këto vëllime shfaqet nevoja e njeriut për të ndalur dhe për të rigjetur fillin e humbur të kohës së tij në raport me rrjedhën objektive nga e cila është shkëputur jonatyrshëm. Kështu, në shpërmasimin kohëhapësinor të një vetëdijeje të mbingarkuar dhe të një nënvetëdijeje të mpleksur me

²⁵ Paul Ricoeur, “Tempo e Racconto” Vol. III “Il tempo raccontato”, Jaca Book, Milano, 1999, f.38. [përkthimi ynë, B.Sh].

përhershmerinë, njeriu, si qenie mendore dhe frymore, synon të rizbulojë dhe ruajë origjinën. Ai riintegrohet kështu në kohën e brendshme të botës së tij zanafillore, ligjësitë e së cilës prekin jetën dhe pas-jetën.

Një aspekt më vete është ai, i cili dëshmon rikonceptimin kohë-hapësirë që rezulton në përmasën e shumëfishtë të poezisë së Camajt dhe në perceptimin e kalimit në jetën e përtejme. Kjo dukuri e paraqitur si *sosje* vërehet më së pari tek poezia *Kalorësi*:

*“Kalorsin me gjith gjog
i rrxuen sonte në Dri,
Kalorsin me gjith gjog!”*

Në këto tri fjalë: kalorës, gjog, Dri të konfigurohet kalorësi i Dyrerit, tashmë jo me vdekjen por me kujtimin e një joshjeje të vjetër dashurore, e cila i shkon përshtat mjedisit epik të bjeshkës: dëshira për të ndaluar, sfida ndaj të paprekshmes dhe ndaj tabusë pothuaj religjioze është mishëruar në figurën e fatisë, gruas në qelq, vajzës–zanë që është trupëzim i forcave të errëta por magnetike, të cilat përcaktojnë fatumim e njeriut shqiptar dhe kanë shenjuar nënvetëdijen e tij. Ndjesia është ajo e një kënge epike shqiptare dhe e jehonës së zërit në malësi.

Kur krijon përfytyrimin e hapësirës të shtrirë në qiell dallon ndjesia e enigmës së jetës dhe vdekjes, e cila i rri pingul mbi krye dhe në zemër njeriut të vdekshëm që është një udhëtar i etur dhe i përmalluar. Në këtë rast, hapësira ngjizur në figurën e korbit, pëllumbit e sidomos dallëndyshes me konotacionin e saj shtegtar e profetik, krijon rrafshin e katërt të poezisë së Camajt, kujtesën e brendshme përmes meditimit mbi fundin, mbi *sosjen*, siç e quan ai:

*Do të nsiem,
Krahi e dallëndyshes në fluturim
Për rrshqit puth oleandrat me buzë
Që kanë shijen hijes në vapë.
Kuptimi i sosjes më përndjek²⁶.*

²⁶ “Olenadrat” Vepra letrare 2, Apolonia, 1992, f. 87.

Sosja ose vdekja paraqitet si mendimi më i ngulët, më i kthjellët, më i thjeshtë gjithaq. Në fakt në të gjithë këtë, poeti duket se e lufton harresën sidomos sepse i kujton gjendjen e kllapisë që i paraprin vdekjes. Ai i shpëton kërcënimit të saj të dyfishtë për qenien në përmasën fizike dhe në atë mendore e shpirtërore; kërcënimi i saj vjen si harresë.

Jeta e përtejme këtu nuk është thjesht vdekja dhe misteri i rimishërimit apo i ravgimit të frymës, i njësimimit dhe i ringjizjes me tokën. Ajo është vetëkalimi në legjendë. Bota e brendshme e kësaj të fundit është dimension i kohë-hapësinor i poezisë së Camajt që në këtë vëllim fiton një gradacion abstragimi të lidhur me mistikën dhe besimet vendase, fryma e të cilave është thellësisht e gjallë tek poezitë e mëvonshme të Camajt, ndërsa në ato të vëllimeve të mëparshme është e gjitha e vendosur në një terren konkret shqiptar dhe kohësia është një subjektivitet kryesisht lirik.

Një dukuri e rrallë e poezisë së Camajt është raporti i tillë religjioz, i lidhur me paracaktimin njerëzor. Në poezinë e vëllimit *Legjenda, Flaka e Zotave*, gjejmë olimpin pagan politeist. Por raporti i vendosur me simbolikën e peshkut dhe rrjetave është tejet kristian. Ndërkaq, lënda pagane shqiptare duket se rishfaqet në strofën e fundit, ku njerëzit vendosin të flijojnë gurët e t'i hedhin në zjarr, duke shkaktuar vdekjen e perëndive të cilat dëshmojnë tërësisht të shpirtëzuara në palcën e tokës, mendësi dhe ndjeshmëri kjo tipike e njeriut malësor. Po ashtu, guri është simboli i shpirtit të të vdekurve që nuk humbet kurrë. Ai është kujtesa e kohës së vet dhe si rezultat është një lloj përjetësie e lidhur me vetëdijen njerëzore. Jo më kot edhe në lëndën biblike gjejmë specifikime me simbolin gur, si psh. emri i Pjetrit, ose emërtimi Guri i Qoshes etj.

*Në shkamb e n`gji të detit
delte një flake e hollë:
ndoshta prej zemrës së dheut.
Peshkatarët te bregu
Ulshin kryet e vrejshin
Zjarmin e tmerrshëm të gurit.²⁷*

²⁷ "Legjenda", f. 206.

E tërë bota dhe tërë përvojat e brendshme, që ravijëzojnë realcionin kozmik të kohë-hapësirës, Camaj i sintetizon në mënyrë impresionuese me vargjet në poezinë *Vajza me faculetë në krye*:

*E peshën e dëshireve të pashfryeme
Të breznive të pështjelluna në mote t`verdha*²⁸,

.....

Ai e sheh se kjo bartje jetësore e brendshme mbetet e ngulitur tek njeriu edhe pas vdekjes. Ato qëndrojnë në formën e imazhit të fundit që mbetet i pasqyruar në syrin e njeriut dhe që dëshmon çfarë ka parë për të fundit herë para vdekjes.

Tek Camaj mjedisi malor dhe ëndrrat e ngjizura e të ngulitura aty ose që udhëtojnë për aty, përbëjnë tërë qeniesinë e njeriut dhe gjithë sa ngelet thelbi i tij dhe brenga e përjetshme. Kështu krijohet një imazh i tërë kohës dhe hapësirës, e cila përmblihet në një pikë të vetme dhe syri bëhet alefi prej nga mund të shohësh tërë gjithësinë dhe historinë e saj në atë përmasë që i fshihet pamjes direkte. Në këtë mënyrë Camaj realizon botëkrijimin duke bërë të shfaqet në trajta tejet të rralla në poezinë bashkëkohore, jo më meditimi apo ndjesitë komplekse, por botëkrijimi, pra një realitet i tëri i ri, i cili ngrihet në përmasën e vetëdijes njerëzore e jo vetëm shqiptare.

Kjo është një botë e ndërtuar me tinguj, me frymë dhe me pamje sa të gjera aq edhe enigmatike; me jehona kujtimesh, në hijen e gjerë të mbijetesës së njeriut si qenie fizike dhe mbi të gjitha si entitet shpirtëror dhe psikologjik. Po aq konkrete bëhet mbijetesa e parë në planin e etnisë dhe përjetimi i njeriut të larguar nga pjesa më e thellë e vetvetes dhe e trashëgimisë lëndore dhe shpirtërore që e ka ‘prodhuar’. Po aq është konkrete kjo botë, e cila vjen si ridimensionim estetik dhe konceptual i kohë-hapësirës së ringjizur në poezinë e Camajt.

Një nga trajtësimet më të realizuara të kohë-hapësirës në botëkrijimin e njeriut shqiptar mbetet poezia *Leni lumenjtë*. Fryma e saj e

²⁸ “Vajzë me faculetë në krye”, Vepra letrare 2, f. 42.

përshkon krejt truallin shqiptar dhe ashtin e tij, simbolizuar në grurin dhe ullirin. Imazhi pagan, ku sërish këto simbolika nguliten në syrin e njeriut e të vashave, ngjizet tek prehja e shpirtrave në bjeshkët e bardha si për të treguar se më së mbrami shqiptari është njeriu i malit, i dëshirës për mbijetesë dhe që prej aty e projekton veten në botën e shtrirë të detit, të cilin e konkurren me frymën e vet.

Hapësira dhe bota është njëherësh në vatër, në gurin e vatrës madje, në shtëpi, në livadh në bjeshkë në det, në qiell, në përtej detit dhe e tëra brenda syrit dhe kujtesës vetjake dhe të trashëguar njerëzore. E në këtë trashëgimi ushtima e gjatë është fjala e gjuhës së vet:

*Fjalët e gjuhës seme- nji
udhtrimë e gjatë e gjatë në kohë,
nji ushtimë e gjatë e gjatë
ndër veshë.²⁹*

Dhe sintezën më të plotë Camaj e jep në vargjet e poezisë *Gjurimim mbi dritën*:

*Mes jetës e vdekjes rrin vetja
Ma afër sendeve
Pezull mbi rrymën e vrullshme t'ujit nën dhe':
Kësaj i thonë lëvizje pa dritë.³⁰*

Poezia e Camajt është quajtur edhe poezi topografike,³¹ por harta e kësaj poezie matet me hapësirat e brendshme dhe gjeopsikologjinë e individit për të përcaktuar kështu, në plan diakronik dhe sinkronik, gjeologjinë e qenies shqiptare dhe të asaj njerëzore në përgjithësi, e cila është po kaq e shtresuar dhe e lashtë sa tokës që e lindi këtë njeri dhe me të cilën lidhja e tij është gjenetike dhe frymërore.

²⁹ “Trashëgimi”, Vepra letrare 2, f. 88.

³⁰ “Gjurimim mbi dritën” ibid. f. 151.

³¹ Leka Ndoja, “Kritika”, Revistë letrare, Tiranë, 2010, f. 3.

Megjithatë, diskursi qëndron pashmangësisht i hapur, sepse Camaj pohon: *“Nuk janë caqet që përcaktojnë kohën, por mosha e njeriut të urtë!”*³²

PËRFUNDIM

Botëkrijimi i Camajt është një thyerje e pasqyrimeve të rrafshëta të realitetit dhe një zhbirim i tij në katër përmasa. Ky është një kalim që realizohet estetikisht në mënyrë graduale nga vëllimi *Legjenda* e deri tek *Palimpsest*, në fund të krijimtarisë së tij.

Në këtë qasje, sa komplekse aq edhe gjithëpërfshirëse, në poezinë e Martin Camajt gjendet thirrja e origjinës dhe po aq profecia e së ardhmes. E tashmja është përmasa më e kudogjendur dhe njëherësh më eterikja.

Në kohë-hapësirën e Camajt duket se rrjedh një mbihistoricizëm kaq i thellë sa janë në forcën dhe shtrirjen e tyre periudhat gjeologjike të tokës. Këtu fillon historika dhe gjeologjia e qenies në shkrirjen e kohës së brendshme me atë të përjashtësuar.

REFERENCA:

1. Camaj, Martin, Vepra 2, 3, Botime Apollonia 1992/// “Njeriu më vete me të tjerë”/// “Palimpsest”, “Camaj –Pipa”, Shkodër, 2005.
2. Heidegger, Martin “Being and time” Harperennial Modern Thought, USA, 2008.
3. Koliqi, Ernest “Arti i Martin Camajt”, Revista “Kritika”, Tiranë, 2010.
4. Ndoja, Leka, “Kritika”, Revistë letrare, Tiranë, 2010, f. 3.
5. Ricoeur, Paul “Tempo e Racconto” Vol. III “Il tempo raccontato”, Jaca Book, Milano, 1999.
6. Çiraku, Ymer “Bota poetike e Martin Camajt”, Albas, Tiranë, 2003, f.56.

³² Martin Camaj, “Njeriu më vete e të tjerë”, “Camaj-Pipa”, 2005, Shkodër, f. 95.

Poetry as world-creation and aesthetics resizing of space-time

In the following paper we aim to introduce and explain the multidimensional relationship of man and self and man and the other in the poetry of the well-known Albanian poet of the second half of the XX century, Martin Camaj. He constructs— through the fragmentizing of the main stylistic and conceptual units— those forgotten realities that represent the human consciousness.

The elements of the human conscience are analysed through the relationship of space and time. In such a way we unveil the state of being.

This relationship explains several sides of life for the Albanians. Their existence has historically lied between the physic, spiritual and cultural danger on one side and the deep will for life on the other.

This relationship between space and time forms the mysterious circle of meditation and silent dialogue with the origin and with the future, as well.

Key words: Time, space, re-creation, inner time, origin.

Shaban SINANI (Tiranë)

REFUZIMI SI DUKURI E QËNDRUESHME NË JETËN DHE NË VEPRËN E MARTIN CAMAJT

- *Me një vështrim të posaçëm për thyerjen
e kanonit të tipologjisë së llojit në prozën e shkrimtarit* -

Titulli i vëllimit me poezi “*Njeriu më vete dhe me të tjerë*”, që Martin Camaj e botoi për herë të parë në vitin 1980, mund të rezultojë si një sintagmë njësuere (identifikuese) e trashëgimit të tij letrar në përgjithësi: “*më vete*”, për shkak të largimit disiplinor prej së kryerës, së gatshmes; “*me të tjerë*”, për shkak të kushtëzimit të vetëdijshëm të mjeshtërisë krijuese të veprës së tij prej traditash, ndikimesh e prekjesh estetike-letrare të njohura.

Fati vetjak dhe vepra krijuese e M. Camajt, pavarësisht se ku zhvillohen, e kanë si dukuri të pandarë ikjen, refuzimin dhe mëvetësinë. “*Po të analizojmë jetën e tij në terminologjinë e kufijve, ajo është një spostim i vazhdueshëm i tyre*”³³. Arratisja, mërgimi, largimi prej një realiteti, duke përfshirë mohimin e kanoneve dhe termave, përbëjnë një rregullsi të tillë në gjithë jetën krijuese të M. Camajt, sa mund të quhen një ligjësi e brendshme e saj. Kjo është arsyeja pse shumica e veprave të tij janë jo vetëm të pangjashme e të pakrahasueshme me modele a gjedhe të trashëguara apo të krijuara prej të tjerëve, vendës e të huaj, por gati-gati të paskajuar terminologjikisht në pikëpamje të tipologjisë së llojit.

Ikja si refuzim tek Camaj është e shumëfishtë: ideologjike dhe politike, estetike dhe letrare, gjuhësore dhe stilistike. Refuzimi shfaqet në krye si mospajtim me një realitet politik dhe social në vendin e të parëve, të cilin e braktisi me dhimbje vetëm pasi humbi shpresën se mund ta

³³ A. Hafizi, “*Letërsia e kufijve: përjasja Magris - Camaj*”, “Camaj-Pipa”, 2008, f. 50.

ndryshonte. Shumë shpejt e kuptoi se kishte ikur prej një shoqërie vigjilence në një tjetër shoqëri të vigjilencës, dhe vendos të zgjedhë një *topos* të ri, kësaj radhe “*më vete dhe thuajse pa të tjerë*”, përfundimisht larg të vetëve, në një mjedis alogjen dhe aloglot, ku do të vazhdonte për afro katër dekada të shkruante, megjithatë, në gjuhën e të parëve. Ikja prej vendit të të parëve, por jo prej gjuhës së tyre: ky është një prej refuzimeve parësore të M. Camajt. Ai i qëndroi besnik lexuesit shqiptar deri sa pati fuqi të shkruajë, megjithëse koha ia kishte vlarë horizontin e pritjes dhe ishte e vështirë të përfytyrohej rikthimi.

II.

Që kur e nisi krijimtarinë e tij letrare, me dy vëllimet poetike të botuara në Prishtinë, “*Nji fyell ndër male*” dhe “*Kanga e vërrinit*”, megjithëse duke mos dalë prej rrjedhshëm prej traditës folklorizante, Camaj provoi se refuzimi do të ishte gjithashtu një konstante e përhershme e letrarësisë së tij. Siç do të pohonte miku i tij i fatit dhe i artit Ernest Koliqi, M. Camaj, duke hyrë në letrat shqipe si bashkëthemelues i letërsisë shqipe në Kosovë³⁴, çka i kushtëzoi edhe lidhjen e fortë me folklorin; njëherësh u iku dukshëm jo vetëm kodeve poetikë dhe hijes së mjeshtrove të dy shkollave apo “*rrymbëzave*” tradicionale dhe më të afërta ku pritej të rreshtohesh: shkollës së françeskanëve dhe shkollës së jezuitëve; por edhe rendit gjuhësor të tyre³⁵.

Megjithëse herë pas here në një mënyrë shumë të përkorë M. Camaj u bën vend zhvillimeve më të reja letrare në letërsinë shqipe të realizmit socialist në revistën “*Shêjzat*”, që e bashkëthemeloi dhe e drejtoi për afro dy dekada, duke shkruar edhe vetë artikuj e recensione për “*poetët e*

³⁴ R. Elsie, “*Histori e letërsisë shqiptare*”, Pejë, 1977, f. 448: “*Shtytje të ndjeshme zhvillimit të poezisë (në Kosovë) në fillim të viteve pesëdhjetë i dhanë dy përmbledhjet poetike të Martin Camajt (1925-1992)*”.

³⁵ A. Klosi: “*Takim me Martin Camajn*”, hyrje në: “*Martin Camaj - vepra letrare*”, vëllimi I, Tiranë, 1996, f. 34.

shkrimtarët e gjuhës së vet”³⁶; gjatë “periudhës italike” ai shfaq një arratisje tjetër, kësaj here të dyfishtë, kohore, si largim nga bashkëkohësia³⁷ dhe profesionale, si përqendrim në tradita të kulturës së shkruar me pak vëmendje ose pa vëmendje në studimet shqiptare, duke u vënë në kërkim të botëve të mbyllura³⁸, si ngulimet arbëreshe; dhe të kohërave të largëta, si periudha e letërsisë humaniste; me një vëmendje të përhershme ndaj të gjithë atyre që ishin edhe vetë të ngjuar, si shkrimtarët dhe studiuesit shqiptarë të mërgimit në Perëndimin e largët dhe të afërt.

Në kohën kur Camaj hyri në rrugën e konfirmimit si krijues ekzistonin dy letërsi shqipe paralele, me fare pak ndërlidhje mes tyre, gati-

³⁶ Ndër të tjera M. Camaj është autor i recensioneve dhe shkrimeve të botuar në “Shëjzat”: “Nëpër fletët e “Nëndorit”, revistë letrare-artistike, shoqërore-politike nr. 8, Tiranë, 1957”, nr. 3-4, f. 102-105; “Nji shikim poezis së vjetit 1957 në Shqipni”, 1958, f. 406-407; “Tonin Miloti: “Zanusha”, poemë, Tiranë, 1958”, 1958, 9-10, f. 342; “Rreth prozës së sotshme në Shqipni”, 1960, f. 291-299; “Mendime rreth zhvillimit të letërsisë së mbasluftës në Shqipni”, 1966, f. 511-514; “Pikpamje rreth periodizimit të letërsisë shqipe”, 1966, f. 265-272; “Dhimitër Xhuvani, “Midis dy netëve” (novelë)” 1967, f. 315; “Dasma”, roman i Ismail Kadaresë”, 1967, f. 469-472; “Fadil Paçrami, “Ngjarja në fabrikë”, 1968, f. 256-257; “Jakup Ceraja, “Djersa dhe gjak”, Prishtinë, 1968, f. 257; si dhe: “Botimi i veprës letrare në tetë vëllime të Dhimitër S. Shuteriqit”, botuar në “Dielli”, Boston, Mass., USA, 16 korrik 1979, f. 3, 8; dhe “Rugova, Ibrahim: “Kahe dhe premisa të kritikës letrare shqiptare 1504-1983”, Prishtinë, 1986”, botuar në: “Südost-Forschungen” 46, München, 1987, f. 511-512. Në vitin 1991 botoi shkrimin “Fundit i realizmit socialist në Shqipëri” - “Das Ende des Sozialistischen Realismus in Albanien. Eine Literatur, die aus der Isolation auszubrechen versucht”, që e botoi në “FAZ”, 1 gusht. Në arkivat e shkrimtarit ruhet skica e një artikulli me titull “Letërsia shqiptare sot dhe autorët e saj”, shënime të mbajtura prej shkrimtarit për një intervistë dhënë “Zërit të Amerikës” (1991).

³⁷ Rasti më identifikues i ikjes në kohë jo në formën prapavajtëse, por në formën e utopisë, është parabola “Karpa” (Romë, 1987), ngjarjet e së cilës zhvillohen në vitin 2338.

³⁸ Midis Drinit dhe Alpeve, prej lumit në mal. Këta janë kufijtë shenjues të gjeografisë letrare të Camajt. Mali dhe lumi, bjeshka dhe vërrini, përbëjnë dhe një interes studimor të tij. Mund të shihet për këtë: M. Camaj, “Fjalët bjeshkë dhe vërrini”, në “Serta Balcanica” - Orientalia Monacensia, Sonderband 1, 1981, s. 241-244. Për interesimin e Camajt ndaj botëve të mbyllura mund të shihen edhe: “Ndër katundet arbëreshe në Kalabris (përshtypje)”, në “Shëjzat” nr. 7-8, f. 281-283; “Udhëtim veruer nëpër Arbreshë të Kalabris”, në “Shëjzat”, nr. 7-8, f. 254-256; “Una frase in Arbëresh dell’anno 1483”, në “Zjarri”, nr. 26, 1979, f. 22-25; si dhe shumë studime për të folmet arbëreshe, të folmet arvanitase, “dialektet” e shqiptarëve të Amerikës etj.

gati si dy ishuj, për të mos thënë dhe si dy epistemologji: letërsia në Shqipërinë shtetërore dhe letërsia shqipe në Kosovë. Pikërisht kjo është koha kur M. Camajt, duke qenë një protagonist i fillimeve të letërsisë shqipe në Kosovë, pak nga pak i largohet dhe asaj tradite³⁹, pa folur për refuzimin e mënyrës si shkruhej në vendlindjen e tij; refuzim që ishte jo vetëm teorik dhe estetik, por dhe politik e ideologjik. “*Djella*” (“*Shêjzat*”, Romë, 1964), “*Legjenda*” (“*Shêjzat*”, Romë, 1967), “*Lirika mes dy moteve*” (Muenchen, 1978), shenjojnë përfundimisht baraslargimin e Camajt nga të dyja rendet letrarë që ekzistonin. Duket qartë se ai nuk do t’u mbivendoset traditave, rrjedhave, shkollave të gatshme.

Pozicioni i letërsisë së Camajt është jashtëqendror ndaj gjithë sistemeve të letërsisë shqipe, duke përfshirë dhe letërsinë e shkruar prej mërgimtarëve; dhe njëherësh po aq jashtëqendrore dhe ndaj makrosistemeve të letërsive të mëdha evropiane bashkëkohore, me të cilat u lidh vetëm përmes përkthimeve: gjithçka që shkroi në krijimtari ai ia drejtoi lexuesit shqiptar si lexues i parë, pavarësisht se e dinte mirë që pikërisht ky ishte lexuesi i ndaluar dhe i munguar i veprës së tij. Në mënyrë të vetëdijshme ai provoi të krijonte qendrën e vet, origjinale dhe të papërsëritshme, në shqetësimet letrare, në tematikë, në përvojën estetike-krijuese dhe në rendin gjuhësor. Cilësimi si “*shkrimtar shqiptar në diasporë*”⁴⁰, përveç faktit që i përgjigjet jetës në mërgim të autorit, biografisë së tij, fare pak ka të bëjë me pozicionin e Camajt si shkrimtar ndaj sistemeve letrarë. Lexuesi i tij nuk është mërgimtari.

Për pak kohë duket se gjen si gjedhe poezinë e *Ungaretti-t*, e cila diku-diku afrohej e ngjasonte dhe me mbylljen e detyruar të poezisë shqipe në Kosovë, që kishte krijuar fjalësin e shenjave të veta (guri, ashti, lumi, plisi, dheu, gjaku), por as kjo nuk zgjat shumë. Në fakt, ndikimi i Ungaretti-t në poezinë e Camajt ngjan se është zmadhuar. Karakteri i theksuar etnografik që fitoi letërsia e tij, interesimi parësor për mbijetojat e

³⁹ Në studimet e sotme për historinë e lindjes së letërsisë së re shqipe në Kosovë emri i M. Camajt nuk përmendet fare. Shih ndër të tjera: R. Qosja, “*Shndërrimet e letërsisë shqipe në Kosovë*”, në “*Semantika e ndryshimeve historiko-letrare*”, Prishtinë, 2009, f. 7-80.

⁴⁰ R. Elsie, “*Histori e letërsisë shqiptare*”, Pejë, 1997, f. 478 e vijim.

kulturave të ngushta lokale, prej lumit në bjeshkë, prej bjeshkës në vërrin; sidomos besnikëria ndaj lexuesit të vendit të lindjes, ku nuk kishte asnjë shpresë se mund të lexohej; përkundër rikuptimësimit të fjalës dhe deri agramatikorësisë së estetikës së hermetizmit, dëshmojnë se Ungaretti s'u bë ndonjëherë qëllim i tij, ca më pak mjeshtri që do të udhëhiqte epigonin. Këtë e përforcon fakti që Camaj, në gjithë kërkimet e tij shkencore, gjuhësore dhe letrare, është krejt i drejtpërdrejtë, eksplícit, ndërsa "kuptimet e fshehura" në letërsi janë ikje prej sipërfaqësisë, përshkrimi, qëllimësisë së deklaruar dhe angazhimeve të hapura që shfaqnin letërsitë e tjera shqipe.

III.

Ikja si refuzim konceptual mund të vërehet edhe më qartë në shqetësimet ekzistenciale që përshkojnë sidomos prozën e Camajt. Ai e njeh shumë mirë zotimin parimor të letërsisë shqipe në shtetin ku kishte lindur për temat e mëdha, madhështimin e historisë, hyjnizimin e qëndrësës, idealizimin e kështjellës; përdorimin dhe keqpërdorimin e lavdisë së shkuar. Por këtyre paradigmave të krijuara prej letërsisë së realizmit socialist në Shqipëri Camaj u largohet duke krijuar gjedhen e vet: historia si përvojë mbijetese, si breshka nën zhguallin e saj; historia si domethënie e shenjuar në fatin e "*nji frymori të papërsosun*"; kështjella si një bunker në miniaturë krijuar sa për zgjedhje të vetë shqiptarëve, aq edhe për detyrim prej rrethanave historike. Historia dhe qendresa në prozën e Camajt nuk janë aspak ideale, aq më pak idealizime prapavajtëse, por dhimbje e tragjizëm fatal.

Duke iu larguar madhështimit të historisë Camaj kishte mundësi të gjendej më afër një mënyre tjetër të sjelluri me historinë, të mbushur me alegori, shenja poetike dhe shqiptime vetjake, siç ishte miti i origjinës dhe i gjuhës amtare, lavdia e lashtësisë dhe e autoktonisë, prej kohës së gurit deri në epokën e raketave, kodifikuar në letërsinë shqipe në Kosovë. Por edhe kësaj epistemologjie Camaj i qëndron në baraslargësi, duke krijuar raportin e vet gjenuin me historinë, duke gjetur kënaqësi në zbulimin e mendësive të

kryehershme të trashëguara tek njeriu tradicional shqiptar, duke shtresuar një mbi një ligjërimin etnografik, ligjërimin ungjillor dhe atë gjuhësor gojor paraletrar. Duke qenë në këtë pikë, vlen të saktësohet se ndryshe prej Fishtës, që e vjetëroi artificialisht gjuhën e kryeveprës së vet, “*Lahutës së Malcis*”, për t’i theksuar përmasën e një epopeje historike të ngjashme me atë që kishte trashëguar gojarisht populli; M. Camaj themelon një ligjërim letrar që mbështetej në traditat e shkrimeve gegnisht, por me prirje një konvergencë mbidialektore.

Ndërsa në Shqipërinë politike bashkëkohësia ishte jo rekomandimi, por privilegji i letërsisë së re, për Camajn “tema e ditës” dekonsiderohet deri në vlerësimin si një realitet i papërfillshëm për letërsi. Në romanin “*Rrathë*”, një prej të paktave vepra të Camajt me një prekje në realitetin bashkëkohor të Shqipërisë, ndryshimet emancipuese të lëvizjeve revolucionare, që kishte për detyrë të shquante letërsia e realizmit socialist, përkundrazi, shihen si të pandërfutshme në mjediset tradicionale, jeta e të cilëve u ngjan rrathëve bashkëqendrorë: rrathët e ujit, rrathët e zjarrit, rrathët e gjakut, që ruajnë dhe mbrojnë një thelb ekzistencial mbikohor, i patrazuar prej “lëvizjeve të reja” popullore revolucionare të kohës. Në prozë e në poezi Camaj i largohet mitit më të rëndësishëm që krijoi kjo letërsi, mitit të heroit, në të shumtën e rasteve të njësuar me mitin e njeriut të ri, shpesh edhe në mënyrë prapavajtëse, për shkak të projektit politik. Në vend të heronjve letërsia e Camajt ka karaktere, jeta e të cilëve pavarësohet prej funksioneve të një letërsie qëllimore-moralizuese të refuzuar nga autori.

Në pjesën më të madhe të veprës madje Camaj i largohet Shqipërisë vetë, duke gjetur tek vendlindja, tek mjediset e ishullëzuara, tek botët e virtytit të kryehershëm, tek vendet e harruara prej qytetërimeve bashkëkohore, sidomos, po të ishte e mundur, prej atij që quhej “qytetërimi socialist”, gjithnjë diku midis lumit dhe bjeshkës, midis Drinit dhe Alpeve, një metonimi të shkëlqyer të atdheut⁴¹. Metoniminë e atdheut ai e gjen edhe

⁴¹ Shih ndër të tjera: Primo Shllaku, “*Nji Uliks që s’mbrriti kurr në Itakë*”, Lezhë, 2006, f. 150 e vijim.

në ishujt e fisnikërisë së kryehershme arbëre në një mjedis alogjen, tek arbëreshët e Italisë; edhe ata të rrezikuar jo prej asimilimit ideologjik, por prej ndëshkimit të kohës dhe shtetit të tjetrit.

Etnografizmi, që ka qenë çelësi i suksesit të letërsive shqipe në të gjitha kohërat, tek M. Camaj shumë shpesh ndërthuret me një frymë ungjillore dhe parrokiale, që janë bërë nyja të identitetit të njeriut tradicional shqiptar, aspak me fuqi kreshnike dhe zell luftarak kombëtar, por gjithnjë duke mbajtur me fuqi titanike vazhdimësinë e jetës. Karakteret e shprehin veten me fjalë të kursyera të të folmeve kanunore, me shembëlltyra; ata s'janë aspak "rragâj" të maleve, por qenie të zakonshme në dorë të vullnetit të Hyjit dhe miteve.

Mund të bëhej një shkallëzim i tillë: ndërsa letërsia e re që krijohet në Shqipëri hyjnizonte shtetin e vet, pa vështruar përtej kufirit, madje vetëm rrallë herë edhe në Kosovë; ndërsa letërsia e Kosovës shenjtëronte shenjat e mbijetesës kombëtare; letërsia e Camajt zbret në një shkallë më të thellë të vetëdijes shqiptare, në shkallën e fillimeve të etnosit, të cilin ai, ashtu si Naim Frashëri në kohën e romantizmit, e identifikon qysh në kohën e gjenezës së njerëzimit e të mitit të Babelit, a në kohën e krijimit të llojeve të gjallesave sipas teorive evolucioniste e biologjiciste. Camaj i ikën njeriut të ri si skemë e gatshme estetikisht e paarrirë, por pa idealizuar shqiptarin e vjetër të mbyllur në mjedise etnografike të ngushta; u shmanget dy epistemologjive që kishin marrë karakterin e rrjedhjeve të disiplinuar të njohjes dhe sjelljes me realitetin në Tiranë po aq dhe në Kosovë.

IV.

Largimi prej kanoneve të realizmit socialist dhe prej kodeve të letërsisë shqipe në Kosovë e gjen shpjegimin e vet në refuzimin teorik, estetik dhe ideologjik. Por refuzimi i Camajt nuk mbaron këtu. Ai u ikën rregullisht llojeve të pastra letrare dhe i vetëpërkufizon veprat e tij me terma të huajtura nga muzika (*madrigale*), nga paleografia dhe arti kishtar (*palimpsest, diptychon*), nga Shkrimet e Shenjta (*parabola*), nga folklori (*legjenda*) ose thjesht prej terminologjisë së letërsisë shkollorë-didaktike

(*copa letrare*)⁴². Sthurja e kufijve disiplinues të llojeve tradicionale të letërsisë është një dukuri e modernitetit në shkallë globale. Por në rastin e Camajt shartimi i llojeve me njëra-tjetrën, provimi i veprave ndërgjinore, më shumë se mani moderniteti është shprehje e kërkimit të origjinale, e largimit prej së gatshmes. Ka shumë të ngjarë që zgjedhja e termit “*madrigale*” për veprën “*Dranja*”, më shumë se termin e një mënyre mesjetare të vjershëruari dhe të kënduari, në vetëdijen e autorit të ketë pasë të bëjë me rrënjën e fjalës: *mater*, *materix*, prej nga dhe: *matricë*, *gjedhe*, e papërsëritshme, origjinale, e pangjashme me diçka tjetër. Largimi i Camajt prej gjinive e llojeve të pastra vërehet së pari prej Koliqit, i cili shtron pyetjen nëse “*Djella*” ishte “*nji romanx a dituer poetik*”⁴³. Ndërsa alternimi i tekstit poetik me rrëfimin në prozë brenda së njëjtës vepër është një dukuri tipike për letërsinë e tij⁴⁴. Shpërfillja e Camajt ndaj termave që ndajnë poezinë nga proza, dramën nga teksti letrar, një stil ligjërimit nga një stil tjetër, lirikën nga epika, historinë e lashtë nga bashkëkohësia, deri tek nënlllojet prej njëri-tjetrit, si shprehje e fuqisë krijuese që tejkalon jo vetëm disiplinën ideologjike dhe parimet krijuese, por edhe taknocracinë tradicionale të të shkruarit, është shkaku që studiuesve do t’u duhet një kohë shumë e gjatë për të vendosur për çështje të tilla fillestare, si tipologjia e zhanrit për shumicën e veprave të tij. Kjo është dëshmuar edhe në konfuzionin që vërehet në studime dhe botime në dy dekadat e fundme. Veprat e përfshira në përmbledhjen “*Shkundullima*” (Muenchen, 1981) autori vetë i quan “*proza*” (megjithëse në këtë libër gjendet dhe një pjesë teatrale) ose “*copa letrare*”; prej disa studiuesve përcaktohen si novela, por

⁴² Rasti më i qartë i papërcaktueshmërisë së tipologjisë së llojit nga vetë Camaj është nëntitullimi i përmbledhjes me novela, sipas shumicës së studiuesve, me titull “*Shkundullima*”: ato quhen thjesht “*proza*”. Shih ndër të tjera: Ledi Ikononi, “*Bibliografi e veprës së Martin Camajt dhe e shkrimeve për të*”, në “*Studime filologjike*” nr. 50, 1996/1-4, f. 179-200; po ajo, “*Një vështrim bibliografik veprës së Camajt*”, Tiranë, 2010, punë e pavarur, Shkolla e Masterit dhe Doktoratës pranë QSA.

⁴³ E. Koliqi, “*Arti i Martin Camajt*”, parathënie për romanin “*Diella*”, Romë, 1958. Ribotohet edhe në: “*Martin Camaj - vepra letrare*”, vëllimi I, përgatitur për shtyp nga A. Klosi, Tiranë, 1996.

⁴⁴ M. Camaj, “*Rrunggaja në mars*”, Muenchen, 1981: “*E kushedi, kush vjen maparë / Ngrija apo fryma e detit?*”.

nuk mungon dhe përcaktimi i tyre si tregime⁴⁵. Ndërsa “*Djella*”, në disa botime që ka njohur, herë është shenjuar si roman e herë jo; u cilësua roman nga autori vetë, *romanx a dituer poetik* prej Koliqit dhe *roman i gërshetuar me vargje* prej studiuesish të tjerë⁴⁶, çka i përgjigjet pamjes së jashtme të tekstit.

Pikërisht ikja si refuzim estetik, si largim prej së gatshmes, si kërkim i matricës dhe matricale-s, shpjegojnë dhe faktin pse Camaj, aq shumë i lidhur me rrënjët e të parëve, shkrimtari që ua kushtoi botëve më konservatore gjithë talentin e vet, njëherësh i ikën edhe totemit më tradicional shqiptar, totemit etnik, sikurse e quan Farlati (“*Hyllo filius serpentis est*”), duke e zhvendosur atributin dhe funksionin e tij në një shenjë tjetër të krijuar nga ai vetë, tek individi i papërkryem, breshka me emër lulje, Dranja. Sa u takon gjinive e llojeve të pastra letrare, ai u largohet atyre për të krijuar ndërthurje origjinale të ndërmjetme të tij dhe duke bashkuar shumë në një, duke krijuar gjedhe dhe vetje gjenuine. Disa prej këtyre ikjeve janë të diktuar edhe nga përfytyrimi për receptimin e veprës. Për shembull, kur shkruan dramën “*Kandil argjandit*” dhe “*Loja e mbasdrekes*” në fakt Camaj shkruan tekste të dramatizuara duke u ikur gjedheve dhe kanoneve klasike të zbatueshme në teatër, sepse e di mirë se ato drama janë shkruar për t’u lexuar dhe jo për t’u përfutur në teatër, ku ai nuk kishte shpresë ta shihte veten të realizuar. Së fundmi, prej vitit 1972 Camaj i ikën gjuhës letrare të njësuar, që kishte disiplinuar në një formë ligjërimi të vetme letërsinë shqipe në shtetin e vjetër dhe në Kosovë, por duke mos mbetur në ligjërimi dialektore, madje duke tentuar një gegërishte letrare mbidialektore, krejt të hapur edhe për dialektin tjetër, për të shtuar se shpesh i kontribuon edhe vetë gjuhës letrare unike. Le të vërehet me sa elegancë e shpreh qëndrimin e vet shkrimtari ndaj zgjedhjes gjuhësore: “*E kam thanë botnisht dhe askush s’i ka kundërshtue deri sot, as Tirana, as*

⁴⁵ R. Elsie, “*Histori e letërsisë shqiptare*”, Pejë, 1997, f. 482.

⁴⁶ R. Elsie, vep. cit., f. 481.

*arbëreshët. Nuk kishte me qenë keq të veket në jetë parimi i para '68, të lehet e lirë varianta geqe në sende letrare, sidomos në lirikë*⁴⁷.

Pikërisht kjo i ka çuar studiuesit të mendojnë se Camaj, megjithëse vetë një përdorues i gegnishtes letrare, kishte një “*tolerant and constructive linguistic spirit*”⁴⁸. Në fakt, edhe si studiues i gjuhës shqipe dhe mësimdhënës i saj për të huajt, pavarësisht prej pëlqimit vetjak, ai u mundëson atyre të mësojnë gjuhën letrare shqipe, krahas njohurive për dialektet, veçanërisht për gegnishten⁴⁹.

Të gjitha këto ikje, mërgime, refuzime, largime, shenjojnë qëllimin, tentimin dhe arritjen e papërsëritshmërisë në art prej Martin Camajt.

V.

Si shfaqet ikja nga tipologjia e llojit të “*Dranja*”, madrigale për autorin, prozë poetike për një pjesë të studiuesve, roman në vargje për një pjesë tjetër, *poezi e pavargnueme* për një tjetër grupim të tyre?⁵⁰

Në dy dekadat e fundme për veprën “*Dranja*” të Martin Camajt është shkruar jo pak. Në konferenca shkencore, në botime akademike e universitare dhe në teza disertacionesh, për këtë vepër janë nyjetuar e shqiptuar vlerësime themelore, që lehtësojnë rihyrjen e saj në komunikim

⁴⁷ M. Camaj, “*Letra*”, në “*Hylli i Dritës*”, 1-2/1996, f. 69.

⁴⁸ Eda Derhemi, “*The question of standard Albanian in 2009*”, botuar në “*Wir sind die Deinen*”, botim i *Albanische Forschungen* 29, përgatitur për botim nga B. Demiraj dhe botuar nga *Harrassowitz Verlag*, 2010, p. 391.

⁴⁹ Krhs ndër të tjera: M. Camaj, “*Albanian grammar with exercises, chrestomathy and glossary*”, Visbaden, 1984.

⁵⁰ Si proza poetike janë cilësuar edhe: “*Si doli emni prej gurit*”, “*Skotë me troje të veta*”, “*Në mitologjinë popullore*”, “*Te këmbët e kryezotit*”, dhe “*Shtatzanë*”, botuar nga autori në “*Alternativa*”, Ljubjanë, 1990, nr. 1-2, f. 45-47; si dhe “*Bota e një gjuhe*”, “*Plogësia në gjak*”, “*Kthimi te toka e thatë si buka*”, “*Murimi*”, “*Mes dritës e hijes*”, “*Qindresa*”, “*Ndërdyash si të huej mbi dhe*”, “*Në shtratin e marimangës*”, “*Një vetë e dy vetë*” dhe “*Fis i panjoftun*”, botuar në “*Jeta e re*”, nr. 1, Prishtinë, 1996, f. 35-40. Shih për këtë: Ledi Konomi, “*Një vështrim bibliografik veprës së Camajt*”, punë e pavarur, Shkolla e Masterit dhe e Doktoratës pranë QSA, Tiranë, 2010.

letrar e estetik me lexuesin popullor e të përzgjedhur. Mendimi se Camaj është i panjohur, i palexuar, i pabotuar, nuk i qëndron së vërtetës⁵¹.

Në këto studime “*Dranja*” është quajtur shprehje e përkryerjes së mjeshtërisë së Martin Camajt dhe një kryeshenjë e modernitetit të letërsisë shqipe. Me të drejtë është cilësuar vepra më e arrirë e autorit dhe një rekord cilësor i letërsisë shqipe dhe si një autobiografi e shkruar mbi një pergamenë tashmë të përdorur, e cila, ashtu si shkrimet e vjetra kishtare, duan një *codex subscriptus* për t’u lexuar e kuptuar, sepse teksti vetë përmban shumë qortime, fshirje dhe mister⁵². Të rishkruarit, ka qenë një proces i natyrshëm krijimtarie për Camajn. “*Lirika mes dy moteve*”, një përmbledhje poetike botuar më 1967 në Mynih, përfaqëson një rimarrje kritike të poezive të veta të vëllimeve të mëparshme.

Për një pjesë të studiuesve e errët dhe e mbyllur, në të kundërtën, për një pjesë tjetër “*Dranja*” është një vepër tradicionaliste dhe e mbështetur në ligjërime tipike etnografike popullore vendëse, që janë trashëguar prej autorit nga koha e fëmijërisë.

Në kushtet kur historishkrimi të letërsisë shqipe i doli detyra për t’u gjetur ngutshmërisht vendin e merituar Camajt dhe veprave të tij në trashëgimin letrar kombëtar, rruga më e shkurtër sigurisht ishte përqsja dhe analogjia, përngjasimi me më të njohurin, më të afërtin, më të ngjashmin. Në fillim *Jorge Luis Borhes*-i me prozat e tij të shkurtra poetike, me ndërthurjen e ëndrës, misterit, labirinteve, besimit, njerëzores, hyjnore; pastaj një gjedhe e mirënjohur e prozës poetike botërore si “*Thesaristi i natës*” - “*Gaspard de la nuit*”⁵³ e *Aloysius Bertrand*-it, nga e

⁵¹ Shih ndër të tjera disa prej botimeve përjashtimisht për Camajn, prej numrit special të revistës “*Albanica*”, nr. 2, Spring, 1991, Washington, *special issue dedicated to Martin Camaj*, përgatitur nga A. Pipa, deri tek “*Albanische Forschungen*” 29, Harrassowitz Verlag 2010, një përmbledhje elegante studimesh të albanologëve nga e gjithë bota, përgatitur dhe redaktuar nga B. Demiraj.

⁵² M. Mandalà, “*La vita d’un uomo in un palinsesto mai scritto*”, në: “*Der Dichter Martin Camaj (1925-1992)*”, në “*Wir sind die Deinen*”, botim i *Albanische Forschungen* 29, përgatitur për botim nga B. Demiraj dhe botuar nga *Harrassowitz Verlag*, 2010, p. 81.

⁵³ “*Gaspard*”, nga persishitja e vjetër, njeriu që ruan thesarin e mbretit, shahut: *le trésorier, thesaristi*.

cila *Maurice Ravel* mori motivin e një kompozimi me të njëjtin titull; kanë qenë referenca të zgjedhura më së shpeshti për të shquar “*Dranjen*” e Camajt përmes një modeli të tjetrit; ashtu sikurse nuk kanë munguar krahasimet e poezisë së tij me *G. Ungaretti*-n dhe thellësinë e kuptimeve me hermetizmin e tij traktativ. Me fjalë më të thjeshta, përcaktimi i tipologjisë u bë prej krahasimit me vepra referenciale, duke u përpjekur për t’i gjetur të ngjashmen.

Autori e ka nënquajtur veprën e vet “*proza poetike*”, në shumës, për çka në studime ka një pajtim të përgjithshëm të mendimeve, duke njohur fuqinë shprehëse të fjalës dhe dendësinë e mendimit që ka vepra⁵⁴. Por ka mbetur ende pa u shtruar pyetja nëse kjo mënyrë të pagëzuari (“*et pluribus unum*” - *shumë në një*), ka të bëjë me të kuptuarit e veprës si një vëllim pjesësh apo si një e tërë dhe e pandarë. Ky problem i stërllashtë i historisë së letërsisë, që ka ndarë unitarianë e separatistë edhe për çështjen homerike dhe të karakterit të poemave antike, rishfaqet dhe në përcaktimin terminologjik të veprës “*Dranja*” të Camajt, e cila, natyrisht, edhe pa një përgjigje të argumentuar të studiuesve, vazhdon tashmë jetën e vet letrare në përfitime vetjake prej lexuesit.

Më tej çështja ngatërrohet edhe ca. Camaj “*Dranjen*” e quan, sërish në shumës, “*madrigale*”, domethënë “*një tufë madrigalesh*”, dhe bëhet më e dukshme se jo vetëm çështja e tipologjisë së llojit, por dhe ajo e karakterit të njësuar / të konvergjuar të veprës së tij mbetet e pazgjidhur nga vetë autori. Sa i takon parapëlqimit të shkrimtarit për këtë tipologji, për t’ia dhënë “*Dranjen*” lexuesit si një tufë madrigalesh, kjo mbetet po aq e diskutueshme sa dhe trilli i *D. Alighieri*-t për ta quajtur poemën që shenjoi fillimin e Rilindjes Evropiane, trilogjinë e vet tmerruese, me titullin e papritur “*Komedia hyjnore*”; po aq jopërfundimtar sa vendimi i romancierit realist frëng *Honoré de Balzac* për t’i bashkuar të gjitha veprat e veta nën një emër të përbashkët, “*Komedia njerëzore*”; po aq i pakuptueshëm sa zgjedhja e *N. Gogoli*-t për ta pagëzuar kryeveprën e tij “*Shpirtra të vdekur*”

⁵⁴ Për historinë e zhvillimit të prozës poetike në letërsinë shqipe shih: A. Xhiku, “*Letërsia shqipe si polifoni*”, Tiranë, 2004, f. 193.

si poemë. Në letërsinë shqipe veçohet rasti i Migjenit, i cili skicat dhe tregimet e tij të shkurtra i quante novela, madje një cikël të tyre e titulloi “*Novela të qytetit të veriut*”. Mendimi se paraqitja e “*Dranjes*” si madrigale mund të ketë pasur një qëllim orientues për lexim dhe jo përcaktim të tipologjisë së llojit, sepse “*përveç shkurtësisë, nuk ka ndonjë gjë të përbashkët me me madrigalin*”, është shenjuar qysh në kohën e përgatitjes së botimit të parë të veprës letrare të Martin Camajt në Tiranë⁵⁵.

Duke huazuar një term të njohur të shkrimeve të hershme ungjillore dhe të ikonografisë mesjetare “*Dranja*” më së shpeshti është njësuar me një *palimpsest*, ndoshta dhe për shkak të një lidhjeje të vetvetishme idesh me librin tjetër të Camajt, vëllimin me poezi “*Palimpsest*”. Jashtë çdo dyshimi, “*Dranja*” nuk është as palimpsest, as madrigal, në kuptimin terminologjik që kanë këta nocione⁵⁶. Palimpsest jo e jo, sepse palimpsesti nuk është as gjini, as tipologji dhe as teknikë të shkruari. Madje nuk është as teknikë arti kishtar. Asnjë ikonograf nuk i ka thënë vetes se tani do të pikturoj një palimpsest, asnjë skrib (shkrues, *scribe*) nuk i ka thënë vetes se tani këtë dorëshkrim do ta bëj palimpsest. Sikurse dihet, palimpsesti është një gjendje rastësore e arritur për shkak të mbivendosjes së një shtrese/kumti ndaj tjetrës, të mëparshmes, për shkak të mungesës së pergamenës, të drurit të stazhionuar për ikona apo thjesht të vendit të lirë në muret e kishave. Palimpsesti nuk krijohet. Palimpsesti vetëm ndodh, sepse siç e thotë fjala në greqisht, “*παλιν + ψαω*”, është një fakt artistik që rezulton në një proces që mund të quhej: “*shkruaj përsëri*”, “*shkruaj në/mbi të vjetrën*”, “*shkruaj pasi fshij/zbardh*”. Dhe kur ndodh, palimpsesti nuk është çështje zgjedhjeje poetike, tipologjie, konvencioni letrar apo artistik, por thjesht rezultat i

⁵⁵ A. Klosi: “*Takim me Martin Camajn*”, hyrje në: “*Martin Camaj - vepra letrare*”, vëllimi I, Tiranë, 1996, f. 37.

⁵⁶ Shpesh ka ndodhur që letërsia të huazojë terma të llojeve të tjera të artit, sidomos prej muzikës. Ndër të tjera, *sonet* në letërsi dhe *sonatë* në kompozimin muzikor tentojnë të shprehin me mjetet e veta të njëjtën gjë, por më parë se të për afrohen mes tyre, kanë një ekzistencë të pavarur. Ndërsa *palimpsestet* në historinë e shkrimeve ungjillore dhe laike dhe në pikturë nuk janë projekte artistike, por një *emërtim prapavajtës*.

kohës, ose, më saktë, i mungesës materiale-fizike⁵⁷. Në letërsi palimpsesti mund të marrë vlerën e një termi vetëm në kuptimin e përkorjes poetike dhe të *diamantizimit* të ideve, nën një trysni të fortë mendimi. Përcaktimi si “*palimpsest*” mund të përdoret për “*Dranjen*” vetëm figurativisht, për të treguar një ligjërim shumështrësor, jo si term që njëson tipologjinë e zhanrit të veprës. Nëse letërsia është shprehje e një gjendjeje të brendshme emocionale të ngritur të subjektit; një përngjasim i saj me *palimpsestin* mund të pranohet vetëm në përkryerjen përfundimtare të një vepre, kur autori, mjeshtri, ia vë vetes për detyrë që në mënyrë racionale të ndërpusë në tekstin e tij gjurmët e mjeshtërisë së të tjerëve, ashtu si çdo qenie përsërit në embrion gjithë historinë e llojit⁵⁸.

“*Dranja*” nuk është as madrigal, siç ishte madrigali në Itali në shekullin e 13-të, një këngë me dy ose tre zëra, e pashoqëruar me instrumente muzikore; as siç ishte madrigali në traditën britanike të shekullit të 16-të e të 17-të, një këngë polifonike për katër apo pesë zëra mbështetur në tekste popullore (“*vernacular text*”), që u shfaq nën ndikimin e opozicionit të latinistëve dhe të vulgaristëve (“*gli latinisti*” e “*gli volgaristi*”), konservatorëve dhe reformatorëve.

Shumë e mundshme është që zgjedhja e këtij përcaktimi nga autori të ketë pasur të bëjë me kulturën e tij të gjerë filologjike-gjuhësore, me vetë burimin etimologjik të fjalës “*madrigal*”, ndaj të cilit Camaj nuk mund të ketë qenë i pavëmendshëm. Nëse do të ndiqnim vijimësinë e kuptimeve të kësaj fjale prej rrënjës në latinishtë “*mater*” - “*nënë*”, prej nga dhe “*matrix*” - “*gjedhe*”, “*matricë*”, “*model*”; më pas dhe “*matricalis*” (prej nga dhe “*madrigal*”) - “*origjinale*”, me siguri mund të kuptojmë qëllimin e fshehtë të autorit, për ta çuar lexuesin jo tek pastoralet dhe rustikalet evropiane të periudhës humaniste, por tek mëtimi i përligjur i tij për një vepër të

⁵⁷ “*Ju keni para syve tuaj 50 piktura, por duhet të dini se në këto telajo janë mbi 150 piktura, sepse në shumicën e rasteve kam qenë e detyruar të pikturoj mbi të vjetrën, për shkak të mungesës së kanavacës dhe telajove*”, u tha të pranishmëve piktorja S. Marko disa vjet më parë në fjalën e hapjes së një ekspozite vetjake. Ndoshta këto piktura janë shfaqja e fundme e *palimpsestit*.

⁵⁸ Shih ndër të tjera për më gjerë: Sh. Sinani, “*Ikja si refuzim në veprën e Martin Camajt*”, në “*Albanica*”, nr. 96, korrik-gusht, Prishtinë, 2010, f. 80.

papërsëritshme. Duket se me këtë term Camaj paralajmëron se pas “*Dranjes*”, ashtu si Hyji që i kënaqur me krijesën e vet vendosi të shtatën ditë të pushimit, ashtu dhe ai si shkrimtar po ofron veprën që edhe vetë do ta shohë me kënaqësinë e krijuesit dhe me sytë e së ardhmes.

Në lidhje me sa i takon kuptimit zanafillës të fjalës “*madrigal*” (lat. “*matricalis*” - e papërsëritshme), vepra e Camajt, pavarësisht se cili do të jetë mendimi i studiuesve për përcaktimin e tipologjisë gjinore: roman në vargje, poemë në prozë, proza poetike; duhet thënë se pa dyshim që e përlij. “*Dranja*”, libri me emrin e trëndafilin, është një prej veprave më origjinale të letërsisë shqipe të gjysmës së dytë të shekullit të 20-të dhe studiuesit do të kenë shumë punë për të çkodifikuar poetikën dhe teknikën artistike të saj.

“*Dranja*” mund të lexohet si një fabul naive alegorike; si një rrëfim pleqërishte me shembëlltyra krejt të ngjashme me ato të ligjërimit parathënës në Shkrimet; si një ushtrim i rafinuar hermeneutik mjeshëtor; si histori e mendimit, shpirtit dhe mundimit njerëzor; si histori e botës sonë, e rruzullimit ku ajo është pjesë dhe e gjithë rruzullimeve të tjera; si teori evolucioni të jetës dhe të gjallësisë prej kohës së akullnajave dhe të dinosaurëve deri në epokën e udhëtimeve nëpër galaksi; si shenjë e kullës malësore dhe e bunkerit të periudhës ideokratike; si dhimbje për vendlindjen e mbyllur në vete njësoj si breshka nën zhguall; si kërkim antropologjik dhe ontologjik deri në thelbin e vlerës së qenies njerëzore dhe të mbijetesës së saj; si hetim mbi etnotipin shqiptar dhe lidhjet e tij me tjetrin, afër a larg qoftë.

Në shekullin e 20-të përzjerja e llojeve, shartimi i tyre, thyerja e kanoneve të tipologjisë, është një dukuri shumë e përhapur, dhe kjo ndodh edhe në veprën “*Dranja*” të Camajt. Në këtë libër nuk ka kohë, por pakohësi, ose më saktë mbikohësi; nuk ka kalendar, por, ashtu si në epet e lashtësisë së thellë, si në “*Gilgamesh-in*” shumer, “*Vedat vedante*” sanskrite apo në “*Qadesh-in*” e egjiptianëve, dita mund të jetë sa një mijëvjeçar dhe anasjelltas, mijëra vjet mund të vetëtijnë si një sy gjumë trimash legjendarë. Sapo duket sikur përmes një detaji autori po don t’i largohet paskajimit, po aty nis një kriptim i ri. Fati i breshkës, “*kens i papërkryem*”, është i

ngjashëm me fatin e njeriut shqiptar, që, megjithëse ishte në zemër të kontinentit që kur “*Adhami dhë s’kishte lerë*”, në sytë e udhëpërshkruesve perëndimorë mbetej një botë krejt e panjohur, aq sa *F. Nopsca* pati propozuar që të kthehej në një muze të gjallë të virtytit dhe kalorësisë fisnike të kohërave të moçme. Njeriu shqiptar mbeti një enigmë për botën e madhe edhe në shekullin e 20-të, për shkak të mbylljes së vet në zhguallin e rrezikut të rrethimit. Por fati i breshkës është i ngjashëm dhe me fatin e vetë autorit, që e shkoi jetën në një mjedis alogjen, i mbyllur brenda vetes, pa rrënjët e të parëve, pa “*poetët e gjuhës së vet*”, duke u grindur për fatin vetjak dhe të të parëve.

Në fatin e breshkës ngjan të shohësh e të lexosh fatin e vetë globit, prej gjenezës dhe erërave paranjerëzore gjeologjike deri në kohën e bronzit, hekurit, amfiteatrit, teatrit klasik, heronjve epikë, statuteve e kanuneve, perandorive ushtarake e fetare, muzeve modernë, gjeoparqeve dhe stacioneve hapësinore. Aty të duket se po shfaqet rrezikshëm kultura prehistorike e gjallesave njeriingrënëse të maleve të *Jura*-s; aty për aty e sheh veten në një mjedis që vetëm *Jura* nuk mund të jetë, por thjesht shembëllimi modern e dëfryes i saj, i modeluar me kartona dhe lojëra multimediale për brezat shkollorë në formën e njohur të “*Jurassic park*”.

“*Dranja*” është një sintezë e dijeve të shëndosha të një albanologu me dhuntinë krijuese të një shkrimtari në moshën kur mendon se duhet të demonstrojë para lexuesit maksimalen e zotësisë dhe të talentit. Në një vepër letrare me tipologji të papërcaktuar, jo aq për faj të studiuesve të letërsisë por sepse e tillë është konceptuar prej autorit qysh në krye; në një prozë të shkurtër poetike me më pak se dy-tre fashikuj, eptohet thujse gjithë paradigma e shkencës shqiptare, me opozicionet e veta historike themelore, me nyjat e saj herë-herë tragjike. Dheasit dhe ardhësit, të vetët dhe ata të tjerët që janë ndryshe, primitivët dhe të qytetëruarit, të mbyllurit në kështjellë a brenda ashtit dhe të tjerët që bëjnë qesëndi me shkëlqimin e metropoleve, njeriu i natyrës së vrazhdë e trillane të vendlindjes dhe “*qenia e përsosun*” e stacioneve të eurotrenave, vetëtimthi ndriçojnë çështje ekzistenciale të jetës së popullit shqiptar, si i ka gjykuar ai vetë dhe si e kanë gjykuar të tjerët.

Në gjithë këtë parashtrim ka “*retrospection, intraspection and prospection*” - prapashikim, brendashikim dhe parashikim; vështrim në kohërat kur prej anarkisë lindi vetë koha, vështrim në thelbin e kuptimit të jetës së njeriut, vështrim në çka mund ta presë atë në kohën e përshtjellimit tërësor të rruzullit.

Brenda kësaj përmase biblike që ka vepra, një gjysmë shekull ideokraci përbëjnë shumë pak kohë dhe zhvillime për të tërhequr vëmendjen e autorit, qoftë dhe për të shprehur kalimthi një mospajtim, të cilin ai, në kushtet e një shoqërie të lirë, po të donte, mund ta bënte në formën e një pohimi publik, pa infektuar letërsinë e vet të fisme dhe qibare me të.

“*Dranja*” mund të jetë kështjella që nuk i është ndarë fatit të *ethnicum*-it shqiptar; mund të jetë identiteti i këtij *ethnicum*-i dhe “vetmia” e tij në kuadër të familjes gjenetike që i takon, ku në fakt nuk trashëgon ndonjë lidhje farefisnie, motërie, vëllazërie; mund të jetë mendësia e malësorit shqiptar mbyllur nën koren e kanuneve; mund të jetë natyra egocentriste e vetë qenies njerëzore; mund të jetë bota e sotme e kthyer në një “*little village*”, e kërcënuar nga katastrofat, kthimi në çastin e gjenezës dhe mospërkryerja; mund të jetë dhimbja e veçimit fatal të autorit që kurrë nuk mundi të kthehej dhe të shihte lumin dhe malet e vendit të lindjes; mund të jetë, gjithsesi, e papërsëritshmja në natyrë, në shoqërinë njerëzore, në botën e letrave vetë; krijesa e shkrimtarit, *Rose* dhe *Dranja* njëherësh⁵⁹, lule dhe breshkë, e hershme dhe e paplakur, e pastër si vesa e mëngjesit dhe mëkatore si breshka makute në fabulat e shqiptarëve, e turpshme dhe e përçmuar, e denjë dhe e padenjë për të qëndruar para syve të vizitorëve, e virtytshme dhe e qortueshme gjithaq. Pikërisht kjo e bën “*Dranjen*” një kryevepër, që çdo brez do ta lexojë ndryshe nga tjetri, që në çdo gjuhë do të lexohet pa kontekst historik dhe rrethanor, meditim mbi botën dhe njeriun, ndëshkim i së papërkryerës dhe tentim i idealit krijues, estetik dhe letrar.

⁵⁹ Shih ndër të tjera: Hans-Joachim Lanksch, “*Der Dichter Martin Camaj (1925-1992)*”, në “*Wir sind die Deinen*”, botim i *Albanische Forschungen* 29, përgatitur për botim nga B. Demiraj dhe botuar nga *Harrassowitz Verlag*, 2010, p. 40.

DISA PËRFUNDIME:

Refuzimi përbën një dukuri dominuese në jetën dhe veprimtarinë krijuese të Martin Camajt. Largimi nga Shqipëria politike dhe pastaj edhe nga Jugosllavia shprehin refuzimin politik të shoqërisë së vigjilencës dhe kontrollit ideologjik. Me fillimin e jetës krijuese, largimi prej dy shkollave tradicionale letrare të Shkodrës, në mjedisin e të cilave ishte formuar, shkollës françeskane dhe shkollës jezuite, e ndihmoi të bëhej një faktor parësor për zhvillimin e letërsisë shqipe në Kosovë. Shqipërisë politike Camaj i largohet sistematikisht edhe në letërsi dhe, ashtu si Itaka, vendlindja, në letërsinë e vjetër greke, kthehet në metonimi të atdheut, ashtu vendlindja e autorit, midis Drinit dhe Alpeve, kthehet në metonimi të Shqipërisë. Pozicioni letrar i Martin Camajt është jashtëqendror si ndaj letërsisë shqipe në Shqipëri, ashtu dhe ndaj asaj në Kosovë, duke mbetur ekodistant ndaj tyre. Camaj gjithashtu i largohet dhe letërsisë me funksione politike që shkruhej prej shqiptarëve në diasporë. Në pikëpamje të qëndrimit ndaj historisë, Camaj refuzoi monumentalizimin e së shkuarës në funksion të ideologjisë nacional-komuniste dhe e zëvendësoi atë me filozofinë e mbijetesës. Në pikëpamjen tematike ai përgjithësisht iu largua temës së ditës, që ishte më e preferuara për realizmin socialist, në mënyrë të veçantë kryemitit të saj, mitit të njeriut të ri. Një formë ikjeje është arratisja e shkrimtarit në kohë, qoftë në formën e retrospektivës (novela “*Gjon Gazulli*” në përmbledhjen “*Shkundullima*”), qoftë në formën e futurizmit apo të utopisë (ngjarjet në romanin “*Djella*” zhvillohen në vitin 2238). Ndonëse një prej themeluesve të letërsisë së re në Kosovë, në periudhën italice dhe në atë gjermanike, megjithëse me një preferencë të dukshme ndaj hermetizmit, i largohet kodit poetik të saj, të mbushur me shenja të mbushura me përmbajtje të re (guri, ashti, lumi, gjaku, mali). Letërsia shqipe në Kosovë dhe letërsia shqipe në Shqipërinë shtetërore shfaqin edhe dallime epistemologjike, të cilave gjithashtu Camaj u largohet dhe i refuzon. Por refuzimi i Camajt nuk është vetëm ideologjik, estetik dhe konceptual. Ai sillet në të njëjtën mënyrë me kanonet dhe termat e përkufizimit të llojeve letrare. Për të emërtuar veprat e veta përdor terma të

huajtura nga muzika mesjetare (“*Dranja*”, *madrigale*); nga Shkrimet e Shenjta (“*Djella*”, *parabola*, *shembëlltyra*); nga arti kishtar mesjetar (“*Palimpsest*” për një vëllim me poezi, “*Diptychon*” për një vjershë; një pjesë të vëllimit “*Lirika mes dy motive*” e përbëjnë poezitë e rishkruara prej vëllimeve të mëparshme); nga folklori (“*Legjenda*” për poezi); nga shkrimet didaktike (“*Shkundullima*” përcaktohet si “*copa letrare*”) ose nga terminologjia e përgjithshme e letërsisë (i njëjti vëllim nëntitullohet thjesht “*proza*”). Shumica e veprave të Camajt janë të paskajuara në pikëpamje të tipologjisë së llojit. Për “*Djellën*” Koliqi ishte në mëdyshje si ta quante “*romanz a dituer poetik*”, ndërsa disa studiues të tjerë e quajnë “*roman i përzier me vargje*”. Studiuesit afrohen në një mendje që “*Dranja*” nuk është madrigal, por nëse është prozë poetike, roman në vargje, prozë e pavargëzuar, diskutimi mbetet i hapur. Prozat letrare të përmbledhjes “*Shkundullima*” për një pjesë janë novela, për një pjesë tregime, madje ka dhe terma të ndërmjetëm (tregim i gjatë, novelë e shkurtër). Sthurja e gjinive dhe e llojeve është një dukuri e shekullit të 20-të në letërsinë botërore, por në rastin e Camajt kjo nuk ndodh për modë, por për të prishur kanonin dhe për të kërkuar atë që nuk e kanë bërë të tjerët, origjinalen, të papërsëritshmen. Qëndrim refuzues Camaj mban edhe ndaj gjuhës letrare, por në të njëjtën kohë duke iu larguar dialektit, aq më shumë nëndialektit, duke tentuar gjuhën letrare të njësuar dhe duke besuar në komunikimin me një lexues të mbarë shqipes.

Refusal as a stable occurrence in Martin Camaj's life and work

Refusal is a dominant occurrence in Martin Camaj's life and creative work. His departure from the political Albania, from Yugoslavia and so on, expresses the political refusal by the vigilance society and the ideological control. At the beginning of his creative work, he became the principal factor of the Albanian literature development in Kosovo, because he left two traditional literature schools, francescans and Jesuits in Shkodra where he studied. Camaj left systematically the political Albania and the Albanian literature. As in Ithaca, in ancient Greek literature, the birthplace is considered like the metonymy of someone's homeland, so it is the birthplace of the author between Drin and Alps the metonymy of Albania. The literal place of Martin Camaj in Albanian literature in Albania and Kosovo is eccentric. He stayed balanced between both of them. Camaj stayed away from the literature with political means which was generally written by Albanians living abroad. Camaj also refused to accentuate the glory of the past influenced by the national-communist ideology, and he substituted it with the philosophy of survival. His point of view was far away from the day's theme, which was preferable for the socialist reality, the socialist mythical New Man. His departure was expressed by his runaway in time, in a retrospective way ("*Gjon Gazulli*" novel, part of "*Shkundullima*") and in futurism or utopia (the story of the novel "*Djella*" is described as happening in 2238). He was one of the founders of the new literature in Kosovo, in the "italian" and "german" period, mostly orientated by the hermetism, besides the fact that he stayed away from its poetical code which was full of signs with new meanings like the stone, bone, river, blood, mountain.

The Albanian literature in Kosovo and the Albanian literature in the national Albania also show some epistemologic distinctions, but Camaj stayed away and refused them. It was not just an ideologic, esthetic and conceptual refusal. He took the same position for canons and other literal terms. Camaj used external terms of medieval music in order to denominate

his books (“*Dranja*”, *madrigale*), some Holy Writ (“*Djella*”, *parabola*, *effigy*), the medieval ecclesiastical art (“*Palimpsest*”, a tome composed with poetry, “*Diptychon*” for a poem, some part of the tome “*Lirika mes dy motive*” which recover some of his ancient poems), from the folk culture (“*Legjenda*”, for poetry), from didactic writings (“*Shkundullima*” is considered as a “piece of literature”), or from the general terminology of literature (the same tome untitled “*Proza*”, prose). Most of Camaj’s books are infinitized by the typology of his genre. Koliqi questioned himself about “*Djella*”. He couldn’t decide if it was a novel or a poetry book. Some other scholars said that “*Djella*” was “*a novel in verses*”. Scholars agreed that “*Dranja*” was not a madrigal, but if we suppose that it is a poetic prose, a novel in verses, the discussion remains opened. The litteral proses of the tome “*Shkundullima*” are considered in one hand as novels, in the other hand as tales (long tales, short novels). The dissipation of different kinds in the world literature during the 20th century was a new occurrence, but in the case of Camaj, it did not happen because of the trend of the epoqe. He wanted to broke the canons and looked for something that nobody else looked for; the originality, the unrepeatable. Camaj took a refusal position to the academical language. He also stayed away from the dialectical language, and under dialectical one. He tented to unify the language and to be read by good Albanian readers.

Valbona KARAKAÇI (Shkodër)

DUKURI TË LETËRSISË SË IZOLUAR NËN VËZHGIMIN E MARTIN CAMËS

Pas rrugëtimit nga Shqipëria në Beograd (1948-1956), Italia do të jetë pikëpjekja vendimtare e Camës me botën shqiptare. Doktorimi në Romë bëhet shkas për takimin fatlum me Ernest Koliqin, nën përkujdesjen e të cilit Camaj vihet në krye të revistës “*Shejzat*”⁶⁰.

“*Shejzat*” apo siç njihet ndryshe *Le Pleiad* bëhet e vetmja revistë e kohës, që do të ofrojë **shërbesë për gjuhën dhe traditat shqiptare jashtë kufijve administrativ**, që kishin filluar të rrudheshin edhe nga pikëpamja kulturore. Themeluesit e revistës, që në fillimet e saj patën deklaruar se drejtimi do të ishte kulturor, duke e parë kulturën si një mundësi më shumë “*për t’u përfshirë në vallen e përparimit njerzuer tue sjellë në strajcë të kulturës s’onë vetit ma të pikatuna të kombësisë shqiptare*”⁶¹.

Kontributi i Camajt, dishepull i Koliqit, në “*Shejza*” është i shumanshëm, por ne do të ndalemi në dy aspekte:

a) *Konstatime mbi dukuri të letërsisë shqipe në kapërcyell të vetizolimit*

b) *Pikëpamje mbi gjuhën e njësuar shqipe*

Lënda e shfrytëzuar i përket shkrimeve të Martin Camës në “*Shejza*”, pjesë e kontributit të këtij autori në lëmin e kritikës dhe historisë së letërsisë shqipe.

⁶⁰ Gusht, 1957.

⁶¹ Frascino Giosafat, *Unë, Profesor Koliqi dhe e përkohshme Shejzat*, “*Shejzat*”, 1978, (numër përkujtimor për vdekjen e Koliqit).

I. Vlerësime mbi dukuri të letërsisë shqipe në prag të vetizolimit

Pasi gjurmon historinë e letërsisë shqipe duke ndjekur me vëmendje publikimet: monografi, letërsi e kultivuar (prozë dhe poezi) dhe sprovat e para për një histori të letërsisë shqipe, Camaj rregullisht ngre në publicistikën dhe analizat e publikuara në radhët e “*Shejzave*”, disa çështje që në thelb përbëjnë parakushte për zhvillimin e prezantimin e një letërsie kombëtare, me potencialin e duhur për t’u përfshirë në lëvizjet e rrymat letrare evropiane.

Arsyet për t’u marrë me **parakushtet**, ndërkohë që Evropa e kulturës zhvillonte tendenca alternative në letërsi, qëndronin nga njëra anë në “prapambetjen” e saj që dukej se po balancohej nga një grup i ri shkrihtarësh të talentuar të pasluftës, si: I. Kadare, S.Spasse, D.Agolli, J.Xoxe, Dh.Xhuvani, dhe nga ana tjetër në disa **deformime** që po shfaqte letërsia duke shënuar kthim prapa krahasimisht me arritjet e brezit të viteve ’30-’40.

Cilat ishin këto parakushte?

1. Veçimi i historisë së letërsisë nga historia e kombit (e aq më tepër nga historia e partisë)

Fakti që përmbajtja e letërsisë në Shqipëri duhej të ishte sociale dhe forma kombëtare bën që subjekti letrar të instrumentalizohet dhe letërsia të humbasë prej funksionit të vet estetik. Kështu një nga revistat më të rëndësishme të kohës, së cilës i referohet edhe Cama “*Nëntori*” i përcillej lexuesit si një revistë letrare-artistike, shoqërore dhe politike gjë që shpjegon në miniaturë ndikimin e ndërsjelltë të artit tek shoqëria (tashmë me shenja të qarta ideologjizimi) dhe anasjelltas. Duke mos mohuar këtë simbiozë, Camaj mban qëndrim ndaj rrezikut të përgjithësimit e krijimit të një standardi të ngurtë, jo në favor të thelbit letrar.

- *Historia e një kombi ase e një bashkësi nuk përnjisohet kurr pikë për pikë me historinë e letërsisë së përparueme të atij kombi ase shoqnie, - shprehet Cama.*

2. *Nevoja për një periodizim të letërsisë shqipe që mbështet në kritere metodologjike që konsiderojnë **formën** pa përjashtuar qëndrimin estetik e ideologjik si frymë e kohës*

Nga përpjekjet e deri asokohe për periodizimin e letërsisë shqipe, Camaj konstaton se *asht e pamundur ndamja e letërsisë shqipe në periudha të ngjituna njena mas tjetrës si rrathët e një vargoni, për të sajuar një tanësi letërsie kombëtare*⁶². Si të vetmet kritere unifikuese ai konfirmon ato të G. Schiro-i dhe Koliqi-it⁶³: *vetëdijen kombëtare* si kriter ideor dhe *folklorin e gjuhën* si kritere formale, ndërkohë që zhvillimi apo kontinuiteti i etapave kulturore letrare ishte mundësuar kryesisht sajë metodës gjurmuese. Qëndrimi i Camajt vjen si reagim (shpjeguar në vijim) ndaj deformimeve që letërsia shqipe kishte filluar të demonstronte: *analiza formale si metodë hulumtimi në zbulimin e filleve lidhëse mes periudhave e rrymave letrare ka rëndësinë e vet. Sigurisht kjo asht rruga ma e vështirë, e përshtatshme sidomos për monografina, por edhe frytdhanëse*⁶⁴. Nevoja që letërsia shqipe pa dëmtuar traditën e mirë folklorike të përpiquej ta tejkalonte atë i brendashkruhet këtij qëndrimi, aq më tepër kur kriteri tjetër formal “gjuha” po kalonte një tjetër krizë (shih në vijim *Pikëpamje mbi gjuhën e njësuar shqipe: Letërsia si gjuhë*).

3. *Letërsi si model, alarmi për një letërsi të standardizuar*

Fakti që letërsia shqipe kishte zgjedhur me hir a pahir metodën e realizmit socialist, sipas Camajt, nuk përbënte ndonjë “krim”; në njëfarë mënyre edhe kjo zgjedhje nuk e izolonte atë, pavarësisht se e radhiste në një metodë të ndryshme nga rrjedha e zhvillimi që dukej se kishte arritur të krijonte një shtrat në kapërcyell të viteve 30-40, apo nga letërsia e shqiptarëve jashtë kufijve.

Në fakt më shqetësues sesa kjo zgjedhje deri diku e imponuar për arsye joletrare, ishte **ekstremizmi**, që dukej se do ta shoqëronte atë. Duke

⁶² Martin Camaj, *Pikëpamje rreth periodizimit të letërsisë shqipe*, nr. 5-8, 1967, 265 ff.

⁶³ Por të konfirmuara edhe nga St. Mann (London, 1955) dhe Zef Schiroi Junior.

⁶⁴ Martin Camaj, *Pikëpamje rreth periodizimit të letërsisë shqipe*, nr. 5-8, 1967, 272 ff.

përshkruar zanafillën e metodës⁶⁵ (Camaj e klasifikon realizmin socialist më afër metodës sesa rrymës letrare), Camaj përpiket të sugjerojë një alternativë të ndryshme, krahasimisht të moderuar nga “tendenca e frikshme ekstremizuese”, që kishte si bazë një **letërsi të modeluar në tipa e karaktere standarde**: tipi i komunistit, reaksionarit, kulakut, femrës së përparuar etj. Me përpjekjen e tij moderuese, Camaj arrin të heqë paralele dhe identifikojë udhëkryqe mes modelit sovjetik dhe modelit shqiptar⁶⁶. Duke arsyetuar mbi mundësinë e letërsisë shqipe për t’u identifikuar më afër rrymës së disa shkrimtarëve të tillë, si: Gorki, Vladimir Dudinçev, Pilnjakut e Leonovit e distancuar nga rryma teorike zyrtare.

⁶⁵ *Historia e kësaj rryme – ma pikërisht metode – të realizmit socialist fillon nga idenat dhe mendimet e shkëputuna të Marxit, Englesit e Leninit rreth artit në përgjithësi dhe posaçërisht letërsisë. Këta ideologë kishin kuptue me kohë se ç’rrol kishte luejtë e lonte gjithnji veprimtaria artistike në kritikën e drejtue kundra padrejtësive shoqnore.*

Mbas fitores së tetorit dhe vendosjes mandej të regjimit sovjetik, kritikuesit e shoqnis nuk u panë ma me sy të mirë. Por artistët që kishin ndihmue revolucionin nuk ishte kollaj t’eliminoheshin në kambë e në dorë, prandej përgatitet e vëhet në veprim një operacion sistematik për zhdukjen e tyre nga qarkullimi. (cituar nga Martin Camaj, Nji shikim poezisë së vjetit ‘57 në Shqipëri, nr. 7-8, 1958, 227 ff).

⁶⁶ *Shumica dërmuese e inteligjencës ruse qe përpi nga furra e revolucionit, kështu që shkëputja e zhvillimit normal e letërsisë, që s’u arrit ma të lidhet, ishte fatalisht e pashmangshme. Kështu ndodhi dhe në Shqipëri, por me një ndryshim themeluer: shumica e shkrimtarëve rus u zhdukën nësa ishte në kambë lufta kryengritëse, kurse në Shqipni ajo pak inteligjencë e jonë u eliminua mbas fitores dhe ardhjes në fuqi të shtetit komunist. Dhe mbas ardhjes së Stalinit në fuqi si dhe sot e kësaj dite ka pasë e ka grindje idenash e “kriza” në rrethet e artistëve sovjetikë, shej ky i një rëndimi shpirtnuer e sinqeriteti të saktë. Gjithë këta në Shqipni nuk ka ngja, prandej vetvetiu vihet në përfundim me e nda realizmin socialist në dy degë: a) rryma e disa shkrimtarëve rus, pjesërisht e Gorkit, e Vladimir Dudinçev, e Pilnjakut, e Leonovit me shokë që luhaten me hove të shfrenueme nga romantizmi, shpesh herë ekstrem i shpirtit rus, deri në verizëm b) rryma torike zyrtare që mbërthen grumbullin e disa normave mbi art, farkue ndër forumet e partisë bolshevike e cila ka bindjen se dhe arti, si çdo gja tjetër, asht pronë e saj. Në Rusi mbas këtyne urdhnave deri në sot ia kanë arrijtë t’ecin pa shmangie vetëm shkrimtarët e dorës së dytë. (cituar nga Martin Camaj, Nji shikim poezisë së vjetit ‘57 në Shqipëri, nr. 7-8, 1958, 227 ff).*

4. Premisa cenuese të artit të vërtetë

4.1 Të pamundurat e *Letërsisë si formë*

Gjurmimi i historisë së zhanreve (proza, poezia) na jep informacion mbi cilësitë e formës e varjimeve letrare. Kështu nëse në vitet 30 falë një plejade autorësh të talentuar, si: Kolqi, Shantoja, Kokona etj., qe shënuar kalimi i natyrshëm nga poezia në prozë, në kushtet e reja në të cilat lëvrohej letërsia, poezia kishte humbur terren duke u dominuar nga proza, porse vetë proza e pasluftës nga pikëpamja tekniko estetike dëshmohej në prapësim e jo përparim.

Camaj veçon disa prej shenjave të “*rënies së poezisë*” si trajta e paracaktuar, ritmi i mërzitshëm, toni tregues i thjeshtë, retorika deklarative, gjuha jo e pasur, e përpiktë dhe “e unjisueme” etj., ndërsa për prozën e gjatë ai konstaton - kthim prapa tek modeli i Nikajt e Gurrës, i karakterizuar nga përshkrim i thjeshtë pa depërtim të madh psikologjik, me elementë të shumtë folkloristikë, me një gjuhë të rëndomtë e të varfër, me fjali e periudha stilistike të një ngjyre e toni, pa nuanca apo reflekse ndjesishë, dominuar nga prolisiteti dhe stili gazetaresk, me monologë pa ngjyrë e dialogje të vakëta - humbjen e lidhjes me artin tregimtar (përfshi novelën), si një formë e ndërmjetme e zhvillimit të zhanrit, që kishte njohur cilësi të re në periudhën mes dy luftërave.

4.2. Të pamundurat e *Letërsisë si vehtje*

Ndërsa përvijon zhvillimin e letërsisë shqipe ndër vite, Camaj vlerëson se në 5-10 vitet e para të pasluftës letërsia nuk kishte ende një trajtë të caktuar. Nga një përpjekje karakterizuese tematike, studiuesi arrin në përfundimin se trajtat më të lëvruara ishin *reportazhi me temë nga Lufta Nacional Çlirimtare, kritika dhe tallja me të kaluarën, reforma e kolektivizimit etj.* Perceptimi i Camës: - *Më duket sikur këto mendime rrjedhin nga truni i auktorëve si ushtarë që dalin në deviza të njillojta në*

hap, një mbas një, prej kazerme⁶⁷, vjen si sintezë e një letërsie që kishte filluar të humbiste “hulumtimin psikologjik të vehtjeve”⁶⁸, sigurisht një situatë e tillë diktohej nga rregulla që e bënë të pamundur subjektivizmin në letërsi.

Ndërkohë Camaj zbulon pasojat e para të kësaj përqsasjeje: tiparet e dyta të personazheve (apo vetë personazhet dytësore), që nuk mbajnë peshën e vehtjeve kryesore për arsye të mosangazhimit ideologjik, janë të gjallë e interesante, dhe krijojnë hapësirën e nevojshme që autori të vetëshprehet pa censuruar “Unin” e vet.

Megjithatë vepra si *Romani i Eshtnave* i Kadaresë, vlerësuar si një prej sinjaleve më pozitive të letërsisë shqipe për kohën nga Camaj, jep shpresë se edhe në kushtet e krijuara mundësitë për një letërsi që synon t’i përqsaset thelbit të individit me të bukurat dhe shëmtinë e tij ekzistojnë.

5. Pikëpamje mbi gjuhën e njësuar shqipe: *Letërsia si gjuhë*

Letërsia si gjuhë është një prej “**frikërave**” të Camës, i cili konstaton se një nga novacionet e letërsisë së re, është edhe përpjekja për “gjuhë të unjisume shkrimi” për funksionalizimin e së cilës është vënë në lëvizje “aparati byrokrat shtetnuer”⁶⁹: *Shkrimja e dy dialekteve në një gjuhë të përbashkët letrare, që duhet të ketë përciptas trajtat e tosknishtes asht një masë e shtetit shqiptar që asht vu në fuqi n’adminsitratën e në letërsinë e mbasluftës*⁷⁰.

Nëse konsiderojmë afinitetin e Camës për “letërsinë si formë”, argumenti gjuhë bëhet akoma më i rëndësishëm, ndërsa fakti që unifikimi gjuhësor po bëhej sipas parimesh me “plotgojën revolucionare” edhe më alarmues. Kjo lloj njëanshmërie, që nuk merrte parasysh as faktorin historik e as traditën letrare shqiptare, mund të çonte në një letërsi “frymëshkurtër”. Por nëse kjo “frikë” ngelej në nivelin e pritshmërisë, ajo që autori konstaton

⁶⁷ Martin Camaj, *Nëpër fletët e “Nëndorit”*, revistë letrare-artistike, shoqërore-politike, nr.8, Tiranë, 1957, nr. 3-4, f.102, “Shejzat”, 1958.

⁶⁸ Formulim i Martin Camës referuar romanit të Petro Markos “*Hasta La Vista*”.

⁶⁹ Martin Camaj, “*Mendime rreth zhvillimit të letërsisë së mbas luftës në Shqipëri*”, f. 511, “Shejzat”, 1960.

⁷⁰ Martin Camaj: “*Rreth prozës së sotme shqipe*”, nr. 9-10, “Shejzat”, 1960.

e ilustron⁷¹ në studimet e tij është se letërsia po shkruhej me një “gjuhë laramane”, e cila duke qenë produkt i një shkrirjeje artificiale të *djalektiti të Jugut me një mori lande gjuhësore të Veriut*⁷² në fund kishte dhënë “përfundime të dobëta”. Sipas Camës gjuha që po synonte statusin e standardit të unifikuar nuk përfaqëson asnjë krahinë të Shqipërisë, madje as të folurën e Tiranës, ku amalgama gjuhësore ishte gjithnjë e më prezente për arsye të lëvizjeve demografike. Nga një përjasje e tillë, të humbur dilnin të dy dialektet, por më së shumti toskërishtja, e cila “*asht e shtrëngueme të pranoj në gjinin e vet trajta e konstrakte të papërshtatshme natyrës e shijes së vet*⁷³”. Qëndrimi i Camës në lidhje me gjuhën standarde letrare - *Besoj se tue ecë krahas gegnishtja e tosknishtja e shkrueme apo letrare, si dy motra të mira, pa ia pre rrugën njana tjetrës, kanë me vijue ma me fryt të gjejnë pikat e përbashkëta, si mbas një zhvillimi normal. Kjo rrugë asht e domosdoshme të ndiqet poqese dëshirojmë që novela e romani shqiptar të mbërrijë në sferat e një stili të kullutë artistik* - në fakt nuk i përgjigjet procesit që do të shoqërojë në vitet që do të vinin sanksionimin e gjuhës letrare, e cila ndryshe nga një përjasje natyralizuese do të rezultonte në një vendim të sforcuar.

⁷¹ Argumentet e mëposhtëm ilustrues janë cituar nga Martin Camaj: *Rreth prozës së sotme shqipe*, nr. 9-10, “Shejzat”, 1960:

Kin Dushit (1955): *Asht një gegë që shkruen tosknisht, shfrytëzon trashëgiminë letrare të Veriut të Shqipërisë dhe veçanërisht atë të Shkodrës.*

Kol Jakova: *Shkruan në gegnishte, por pranon shumë elementë të djalektit tosk e krijon një gjuhë laramane që ia vret synin e veshin toskës dhe gegës.*

Dhimitër Shuteriqi: *Shtjellon kujtimet e veta me një tosknishte të shortueme në trungun e djalektit gegë.*

Fatmir Gjata (1959): *Megjithëse asht toskë, në shkrimet e tija gjejmë dhe ndonji gegizëm, ashtu si bajnë shumë bashkëvendas të tij të kësaj periudhe letrare, të cilët sa ma fort që thellojnë zanatin e shkrimit i pasunojnë krijimiet e veta me pajën gjuhësore e stilistike të traditës letrare gege.*

⁷² Martin Camaj: *Rreth prozës së sotme shqipe*, nr. 9-10, “Shejzat”, 1960.

⁷³ Martin Camaj: *Mendime rreth zhvillimit të letërsisë në Shqipëri mbas luftës*, nr. 9-12, 1966, 511 ff.

REFERENCA NGA REVISTA “SHEJZAT”:

1. Camaj, Martin: “Një shikim poezisë shqiptare ’57 në Shqipëri”, nr. 7-8, 1958, 227 ff.
2. Camaj, Martin: “Nëpër fletët e Nendorit”, nr. 3-4, 1958, 102 ff.
3. Camaj, Martin: “Rreth prozës së sotme shqipe”, nr. 9-10, 1960, 291 ff.
4. Camaj, Martin: “Roman i i eshtnave “Gjenerali i Ushtrisë Vdekur”, nr. 7-8, 1965, 257 ff.
5. Camaj, Martin: “Mendime rreth zhvillimit të letërsisë në Shqipëri mbas luftës”, nr. 9-12, 1966, 511 ff.
6. Camaj, Martin: “Nëpër fletët e Nendorit”, revistë letrare-artistike, shoqërore-politike, nr.8, Tiranë, 1957, nr. 3-4, 1958, 102 ff.
7. Camaj, Martin: “Pikëpamje rreth periodizimit të letërsisë shqipe”, nr. 5-8, 1967, 265 ff.
8. Giosafat, Frascino: “Unë, Profesor Koliqi dhe e përkohshmja “Shejzat””, “Shejzat”, 1978 (numër përkujtimor për vdekjen e Koliqit).

Occurrence of an isolated literature under Camaj’s criticism

The paper aims to present Camaj’s criticism regarding some features occurred in the Albanian literature on the borders of isolations arguing how it lost the potential to follow the European literature movements and challenges related to the normative language. Martin Camaj stresses the preconditions which should exist in order for the Albanian literature to follow the European Streams and describes how these preconditions were deteriorating, like relation between history of literature and history of nation; the literature periods defined as well based on form and not only on ideological and esthetic criteria; the settled literature standard ignoring other alternatives etc. As far as concerns normative language, he alerts certain artificial efforts of imposing one dialect on the other one and favors the co-existence of both, until a natural co-existence will lead into a normative language used and enriched as well from the literature.

Laura SMAQI (Tiranë)

CAMAJ – SHKRIMTARI IDEAL NË VIZIONIN E KOLIQIT

Marrëdhëniet mes shkrimtarëve janë një aspekt mjaft interesant për t'u shqyrtuar, ndonëse në të shumtën e herës janë trajtuar vetëm në prizmin e miqësisë, korrespondencës, mbështetjes apo kritikave që i kanë bërë njëri-tjetrit. Koliqi dhe Camaj, paraqesin rastin më të veçantë ndër letrat tona, kur një shkrimtar sheh të trupëzuar tek një koleg, njëherësh nxënës e mik të tij, atë që mund të quhej e konsiderohej si shkrimtar i tij ideal. Le t'i referohemi krijimtarisë e mendimeve të shprehura të Koliqit në rrjedhë të viteve:

Origjina: Dukagjini e malësori i Dukagjinit

Dukagjini zë vend në titujt e dy krijimeve në prozë të Koliqit: “Kërcimtarja e Dukagjinit” e “*Hijes së Maleve*” dhe “Prrue në Dukagjin” e “*Pasqyrave të Narçizit*”

Tek “Kërcimtarja”, gjatë kremtimit të njëres prej fitoreve të Skënderbeut, një prej zanave të Dukagjinit, merr pamjen e mbesës së ngathët të Lek Dukagjinit e realizon një kërcim të mrekullueshëm, për me ia qitë zanin maleve të saj Sipas Koliqit, vetëm ruajtja e tipareve autentike shqiptare, që zbulohen nga kërcimi i Lules - zanë, do të bëjë të mundur triumfin mbi botën orientale. Zanat kërkojnë të nxjerrin në pah magjinë e tokës ku jetojnë, t'ua shpalosin shqiptarëve para syve, t'i bëjnë të vetëdijshëm për domosdoshmërinë e lidhjes me tokën, që do të jetë burimi i vetëm nga ku do të marrin forcë e energji.

“Zana e fundme”, një tjetër tregim i “*Hijes së maleve*”, mbyllet me pyetjet:

- *Kush ka m'e gjetë kangën e humbun?*
- *Kush ka me na i ngjallë Zanat?*

Në fund Reshidi pëshpëriri, si t'u jepte përgjegje mendimeve të thella të tij:

- *Kush e di!....*

Brenda konturit të një historie – përrallë, tregohet se ka humbur kënga e zanës shqiptare, që mban në vetvete tipiken e fizionomisë sonë. Që gjithçka të kthehet si më parë, duhet rikompozuar ajo këngë, duhen mbledhur vargjet e saj të shpërndara:

Duhet m'e zbulue varg për varg tue e nxjerrë nga kujtimet e pleqve, nga gjykimet e urta të burrave, nga buzët e njoma të vashave qi dashunia mbushë me të fshamë t'amblla, nga goja uruese e grave shqiptare, nga klithmat e hovshme të djelmohave.

Koliqi ka sigurinë se dita do të vijë qi një një kangatar arbnuer, mbasi të ketë bashkue vargjet e shpërndame të kangës së mrekulluëshme do t'i këndojë pa pritë në mes të popullit të çuditun e Lavdija e Fatbardhsia kanë me mbretinue ndër ne. Në 1929-ën, Koliqi vetidentifikohet me këtë këngëtar dhe gjithë vepra e tij gjakon në synimin e lartpërmendur.

“Prrue në Dukagjin” është njëra prej “*Shtatë Pasqyrave të Narçizit*” (e pesta në Variantin e parë dhe e katërta në të dytin). Duke parë malet që mbyllin nga pjesa veriore fushën e Shkodrës Koliqi ndien “plogtin e palavdi të jetës qytetare”. Një mbrëmje vere ai ngjitet e dëgjon zërin e maleve që e fton të shkojë pranë tyre, e bën të kuptojë se imazhin e vërtetë të vetvetes mund ta shohë vetëm pranë pasqyrave natyrore, siç janë krojet e burimet, e jo në pasqyrat e ëndërrimit.

*Eja midis nesh o Narçiz qi mje sot dashunove ma fort çezmet e mërmerta zbukuruese fytyrash se sa krojet e epërta të bjeshkëvet qi fytyrat i pasqyrojnë besnikisht ashtu si janë. Eja ke na, pse mbi këto naltësina rreh zemra e kombit. Në gjinin t'onë gurgullojnë të mshefta burimet e poezis arbnore.*⁷⁴

⁷⁴ E. Koliqi, “Prrue në Dukagjin”, “Shtatë pasqyrat e Narçizit”, “Gazeta shqiptare”, Bari, 12.12.1934, f. 2.

“Prrue në Dukagjin” shënon triumfin e realitetit mbi poetikën, po të mbahen parasysh “pasqyrat” pararendëse. Poeti ndërgjegjësohet si për distancën e theksuar që ka mënyra e tij e të vështruarit të mjedisit, ashtu dhe për domosdoshmërinë e një syri realist nga ana e tij, në rast se kërkon vërtet të realizojë synimet që ka.

Ah, Narçiz i pashpirt, plot kujdes vetëm për kënaqunin t'ande, ti erdhe mbi këto male si në një muze të gjallë për me argtue shiset të tueja e me gjetë një burim kangësh të bukura. U mashtrove. Shpatet e lulzueme, pyjet plot mystere të blerta, krojet kangatare janë suazë e mrekuellueshme rreth një piksimi të mjeruem. Motra të tueja. vllazën të tuej vuejnë në kët eden rrezesh ujnash erëzash. Ajo dritë lilash, qi vezullon n'agim me hare virgjinore mbi maje të guximshme e derdhet si lum i dridhëshem lugjeve, vishtrisht depërton nëpër kulla t'errta, qi kanë frangijjat për dritore, ku në tym e n'ajër të pandrruem gjallojnë këto banuesa malesh. Jashtë, ajr i shëndetshëm plot amsim pishë, e lule të puthuna prej flladi; mbrendë duhma frymësh të ndryme ku bin fara e smundjeve.⁷⁵

Vështrimi romantik dhe ai realist pranëvihen si dy përbërës që bashkekzistojnë brenda stilit të Koliqit. Atë që ka thënë në mënyrë simbolike rreth kontrastit të theksuar mes bukurisë natyrore dhe gjendjes aktuale shqiptare të “Kërcimtarja e Dukagjinit”, autori këtu e jep drejtpërdrejt, nëpërmjet ballafaqimit të dy pamjeve: asaj natyrore, e cila frymëzon vështrimin poetik, dhe realitetit jetësor që të bën të ndiesh veç dhimbje.

Identifikimi me vuajtjen e malësore është hapi i parë drejt një vetëdijeje të re, përpjekjes për të bërë diçka që gjendja të mos jetë e tillë. Megjithëse e kupton pafuqinë e vet, përsëri dëshira për t'u ngritur mbi të e për të dhënë një ndihmë sa modeste, aq dhe utopike, kthehet në synim. Pikërisht “Përroi i Dukagjinit” pasqyron imazhin e kësaj dëshire, e që simbolikisht është njëjtësuar me fytyrën e poetit.

⁷⁵ Po aty.

Pavarësisht dëshirës, Koliqi e ndiente qartë që nuk mund të ishte ai kangatari arbnuer që do të ndikonte fuqimisht në ndryshimin jetësor të vendit, kjo sepse i mungonte elementi themelor që duhet të ishte pjesë e brumit të këtij shkrimtari – origjina malësore e jeta e jetuar mes malesh jo si vizitor a mysafir, por si njeri që lufton çdo ditë mes atij mjedisi të ashpër për të mbijetuar, sepse jetesa e mbijetesa janë e njëjta gjë në atë mjedis. Studimet e hershme jashtë vendit e kishin ndihmuar të kishte një njohje të mirë të letërsisë, të zgjeronte horizontet e të synonte përsosjen e vazhdueshme të shijes së tij, por megjithë vullnetin admirues me të cilin “rinjohu e rimësoi” shqipen, megjithë njohjen e “detyruar” nga rrethanat të mjedisit malësor, ai arriti ta kuptojë që vetë jeta e rrethanat nuk do ia mundësonin të qenin një shkrimtar, përmes të cilit do të fliste vetë thelbi etnik shqiptar. Do t’i mungonte gjithmonë ndiesia e shfaqja e drejtpërdrejtë, jo e racionalizuar e shkrirjes me ata që i quan njerëzit më autentikë, megjithë dëshirën e mirë – nuk është si ta e pjesë e tyre. Njohja e jetuar, reale e jetës, bashkë me ligjërimin karakteristik e të lidhur ngushtësisht me këtë jetë do të jetë mungesa e tij e madhe. Atë që sheh se nuk e realizon dot natyrshëm, synon ta realizojë përmes njohjes e punës. Teza e tij e diplomës mbi Epikën popullore shqiptare është po ashtu pjesë e kësaj përpjekjeje.

Më 1956, Martin Camaj, një djalosh e shkrimtar prej Dukagjini, pas shumë peripecive shkon në Romë, ku mes të tjerësh njihet dhe me E.Koliqin. Për të mbetur vetëm në dëshmitë e dhëna përmes krijimeve e studimeve, po japim më poshtë disa fragmente nga shkrimi i Koliqit “Arti i M. Camajt”, botuar në vend të parathënies bashkë me romanin “Djella”, më 1958.

*Dukagjini, - ky vis ku u ruejtën të paprekuna doket e burrnija stërgjyshore dhe ku banorët mund të njehen mâ tepër se ngjeti tepricë katallâjsh ilirjanë kursye nga stuhija zvetnuese e kavaljetave, - Dukagjini, thom, tekembrâmja gjeti mjetin shprehës.*⁷⁶

⁷⁶ E.Koliqi, “Arti i Martin Camajt”, “Djella”, “Shejzat”, Roma, 1958, f 7-18.

Edhe ásht për t'u mrekullue s'pari dhe mendej për t'u gzue, tue pasun para sýsh pasunimin motivesh e trajtash të letresís s'onë, për mënyrën se si ky pinjuell malesh, sigurisht i pari i sojit të tij qi xën me shkrue e me këndue, din të harmonizojë në shkrime primitivitetin ruejtë në plotsín mâ të pllëshme me një zotnim të mjeteve mâ të rafinueme t'artit letrar modern....Camaj, qyshë tash mund të njehet përtrisi i një rrymbe së ré në letrat shqiptare, rrymbë e shqueme prej një çveshjeje nga çdo zbunim retorik e për një prirje me zbulue në vetvete e në tjerë vetit mâ të strukuna në skuta të vetëdijes dhe n'errsít e mystershëme të nënvetedijes.⁷⁷

Fisnikija e lashtë e Malsorve, kalorsija e natyrshme qi u a pajisë shpirtin, pikon papritmas edhe në vepër të këtij pinjulli të tyne, i cili din harresën e padrejtë në të cilen bota e huej dhe vendase la malet, qi ka para sýsh mosperfilljen e paevarëshme qi shumica e qytetarve ka diftue për këto fatosa të lindun të cilët si kalá e gjallë mpruen kombin nga sulmet e Slavëve⁷⁸

Gjithçka ka dashur të realizojë vetë, e sheh te ky shkrimtar i ri, të cilin do ta ketë bashkëpunëtor të ngushtë tek “Shejzat”.

Shkrimtari dhe roli i tij

Një ndër preokupimet me jetëgjata e koherente të Koliqit ka qenë përcaktimi e theksimi i “detyrave” të shkrimtarit

Artikulli “Misjoni i letrarve të rij shqiptarë”, “Leka”, Fruer, 1931, nr. 2, f. 43-51 mund të konsiderohet plotësisht si artikull programatik, në të cilin bëhet i qartë koncepti që kishte Koliqi për rolin e shkrimtarit dhe çështjet që duhet të orientonin punën e tij. Ky është shkrimi i parë ndër shumë të tjerë që Koliqi do të shkruajë mbi këtë temë gjatë jetës së tij, pjesa më e madhe e të cilëve do të botohen te “Shejzat”. Ajo që vlen të përmendet është fakti se të gjitha këto shkrime të Koliqit, megjithëse

⁷⁷ Po aty, f. 10.

⁷⁸ Po aty, f.15.

shkruar në periudha të ndryshme kohore, dallohen për koherencë të plotë mes tyre.

“E shkrimtari, ma tepër se çdo njeri tjetër, mund të rregullojë hovin e atyne ndjesive të shpirtit kombtar, të cillat, mos me i shti ndër caqe, bajnë ma dam se furija e ujnave të pakanalizuem. Shkrimtari duhet të teri kënetat shpirtnore, të lëshojë ura ndërmjet zemrave shqiptare, të çeli udha kah lavdija e kohës s’ardhëshme...”⁷⁹

Pak janë vendet e botës që u paraqesin letrarve, për ushtrimin e artit të tyre, lamë aqë të hapta sa Shqipnija. Shqipnija asht një mozaik zakonesh të ndryshme e t’interesueshme ... E asht dam që këto mënyra jete të jashtëzakonshme, ky lulzim i qëndrueshëm ndjesish omerike, kjo psikologji e çudiçme të një populli trim e bujar prej natyre, asht dam që gjith kjo pasuni shpirtënore etnografike të zhduket pa u përshkrue, pa u analizue, pa u ngulë në vepra që ngjasin ...nevoja me punue në çdo krahinë, në çdo skutë malsore të Shqipnis, për me ndalue në shkrim jetën që tash qinda vjetsh zhvillohet njilloj dhe ndoshta sot pesë vjet ka me qenë shumë e ndryshme. Por asht sidomos, analiza e jetës s’onë shoqnore që duhet të prodhojë një sasi të mirë rromanxash dhe librash me novela ... gjith ky materjal njerzuer lypë përshkruesin, psikanalizuesin.⁸⁰

Ky përshkrim, kjo psikanalizë perban misionin e letrarve të rij shqiptarë”⁸¹.

... një botë (bota shqiptare- L. S) që pret e kërkon interpretusat e hollë e të fuqishëm njiherit të vlerave të saja njerëzore dhe etnike. Përvoja e breznive të kalesës rrejtë në shkullma të gjakut nëper rrjedhje të shekujve lypë një vlerësim – vëmja në spikamë t’ethnosit kombtar, pasuni e misterëshme strukë në nënvetëdijën kolektive ku lëvizin thesaret e brumit të rodit arbnuer ngjeshë në magje të historis, don të shfaqet nëpërmjet të shkrimtarit – lakmtar – mishnimi i amshueshëm i vetive të kombit që

⁷⁹ E. Koliqi, “Misjoni i letrarve të rij shqiptarë”, “LEKA”, Fruer, 1931, nr. 2, f. 45.

⁸⁰ Po aty, f. 50.

⁸¹ Po aty, f. 51.

pertrihet prej etënvjet nëpër bij e nipa ka nevojë m'u gdhenë lumnisht në vepra arti e letërsije".⁸²

Se sa i përgjigjej krijimtaria e Camajt vizionit të Koliqit, shprehur në fragmentet e mësipërme, mjafton të shohim vetëm titujt e disa përmbledhjeve të tij poetike, e veprave në prozë: “*Nji fyell nder male*”, “*Kanga e vërrinit*”, “*Djella*”, “*Legjenda*”, “*Dranja*”, “*Shkundullima*”.

Së fundi, me vendimin për t'u larguar në Gjermani, Camaj s'bën tjetër veçse “vërteton” se është shqiptar po aq autentik në jetë sa dhe në krijimtari, gjithmonë në vizionin e Koliqit.

Vepra e Koliqit i përgjigjej pyetjes: Cilët jemi ne (shqiptarët) si individë dhe në marrëdhëniet me njëri-tjetrin. Ai kërkonte t'i ftonte lexuesit të shihnin brenda vetes dhe mjedisit, i ftonte të mos ishin pasivë, por të kuptonin vetveten dhe shoqërinë brenda së cilës jetonin, vepra e Camajt çon më tej e realizon synimin e vetënjuhjes individuale e etnike përmes Kohës si shumëkohësi e gjithëkohësi e gjuhës si mjet shprejeje e njohjeje.

Camaj – the ideal writer according to the Koliqi's vision

Koliqi and Camaj, represent one of the most particular cases in our literature, a case where a writer sees in flash at his colleague, and in the same time at his student and friend, what can be considered as his ideal writer. Everything that Koliqi lacks (the highlander origin and the experience gained in the mountains not as a visitor, but as a part of that environment); he finds it in this young writer. Koliqi's work answers the question: Who are we (Albanians) as individuals and in our relations with each other. He aimed to challenge the readers to search within themselves and the atmosphere surrounding them, invited them not to be passive but rather understand their being and the society they belonged to, while the

⁸² “*Shêjzat*”, 1970, nr. 1-3, f. 13-14.

work of Camaj progresses further and realizes the aim of individual and ethnic cognition through Time as multi-timing and all-timing dimension of language as an expressive and cognitive mean.

Arben PRENDI (Shkodër)

MARRËDHËNIE TË POEZISË SË CAMAJT ME FOLKLORIN DHE LETËRSINË GOJORE SHQIPTARE

Marrëdhënia mes letërsisë së shkruar shqiptare dhe folklorit e letërsisë gojore është një fenomen i njohur. Veçanërisht gjatë romantizmit ky fenomen e pasuroi letërsinë shqiptare si në aspekte të formës ashtu edhe të përmbajtjes e tematikës.

Por edhe gjatë gjysmës së parë të shekullit XX e në vijim, kjo marrëdhënie krijuese qe burim i vazhdueshëm frymëzimi dhe ndikimi, duke kulmuar me vepra të tilla si “Lahuta e Malcisë” e Fishtës apo rrëfenjat e Kutelit, tregimet e Koliqit etj. Nga këta shkrimtarë të letërsisë së shkruar elementet e folklorit dhe letërsisë gojore zbulohen dhe risemantizohen duke u përdorur si elemente me funksion semantik- estetik.

Kjo dukuri vazhdon me disa shkrimtarë edhe në gjysmën e dytë të shekullit XX, në veprën e Anton Pashkut, Ismail Kadaresë etj. e veçanërisht në veprën e shkrimtarit Martin Camaj, i cili megjithëse e kaloi pothuaj gjithë jetën e tij krijuese jashtë Shqipërisë, ruajti një marrëdhënie shpirtërore dhe artistike të përjetshme me atdheun e tij, përmes vegimit të vendlindjes Dukagjini, si një nga trevat burimore të folklorit dhe të letërsisë gojore shqiptare.

Folklori dhe letërsia gojore janë elemente të rëndësishëm të formimit kulturor të këtij shkrimtari. Këto marrëdhënie mund të jenë në nivelin e motiveve, të shprehjes poetike, të përqasjes së “mitikës” së përditshmërisë moderne me vegimet nga mitika e malësorit shqiptar tradicional. Kjo marrëdhënie është vënë në dukje edhe nga studimet e viteve të fundit mbi Camajn siç mund t’i referohemi këtu konsideratës së studiuesit Shaban Sinani: *“Camaj ka mundur të ndërthurë disa tradita, kombëtare e universale, për të krijuar një poezi origjinale. Në anën poetike*

në vjershat e tij gjenden ndikime të letërsisë kishtare, sidomos të librit të psalmeve; të cilave u mbivendosen ndikime të tjera prej ligjërimit klasik shqip të autorëve të periudhës humaniste (prej Buzikut deri te Bogdani, të cilat ai i njëjthe mirë); ndikime të fjalorit poetik të kohës dhe mjedisit ku ai mori shkollimin e parë (Migjeni, Koliqi, Fishta); si dhe ndikime të ligjërimit popullor etnografik, një prej ligjërimeve më konservative të shqipes.⁸³

Vetë Camaj, e vlerëson këtë ndikim të vëllimi poetik “Legjenda”:
“Edhe poezia jonë në pjesën më të madhe rrjedh prej këngëve popullore, ase më mirë të thom, kjo bëni dhe u rrit në dheun e letërsisë gojore, e cila tue qenë se është ende gjallë ndër ne, vijon të ndikojë edhe sot e kësaj dite, dashtë e padashtë, në çdo krijim të letërsisë reflektive. Shum shkrimtarë të mbashluftës tue pasë frigë që mos të cilsoheshin “anakronikë” u përpoqen të largohen nga folklori. Disa të tjerë përkundra shkojnë mbas parimit të pajtojnë tematikat e reja me trajtën popullore. Poqese i lëshohet një sy krijimit të dy palëve del në shesh se në shum pika perpiqen tue trajtue kështu një kuadër të përbashkët, ku ngjyrat e njanës e tjetrës rrymë puqen mjaft harmonikisht....Here mbas here pikrisht në këso rasash përtypa në mend aso tregimesh e vargjesh popullore që ndëgjova para shum vjetësh. Janë ngjarje shpesh gojëdhanash (prandej i quejta legjenda) të lidhuna më së shumti për vende të caktueme, në të cilat thohet, p.sh. në at bjeshkë ase në at vend ishte njëherë... Kur i shkrova pra këto vargje nuk kam pasë qëllime të caktueme, as të bëmë “ l’art pour l’art” me vargje e gjuhë të zgjedhun e të kumbueshme. Trajta e vargut populluer m’u prish pothuajse nder duer dhe u njësue ndoshta me at mënyrën se si i ndieva këto sende.”⁸⁴

Ky shpjegim i Camajt na paraqet edhe thelbin e marrëdhënies së poezisë shkruar me folklorin dhe letërsinë gojore shqiptare. Në poezinë e Camajt këtë marrëdhënie e pohojnë vazhdimisht edhe fjalë çelësa, si: “lahuta”, “fyelli”, “zamarja” “kanga”, “vallja”, “melodia”, “ritmi”,

⁸³ Shaban Sinani, “Çështje të stilit në ligjërimin e Martin Camajt” në “Për letërsinë shqipe të shekullit të 20-të”, studime, Qendra e Studimeve Albanologjike, I. GJ.L. Tiranë, 2010, f. 117.

⁸⁴ Martin Camaj, “Legjenda”, në vepra letrare 1, “Apollonia”, Tiranë, 1996, f. 149- 150.

“pleqnime”, “kallximi” i të Parëve. Referenca këto që shpjegojnë se komunikimi me letërsinë gojore është i ndjeshëm dhe pse jo edhe ndër elementët bazë mbi të cilët ndërtohet bota emocionale, motivore dhe artistike e kësaj poezie. Siç paraqitet poetikisht ky raport në poezinë: “Lahuta e vjetër”: *“Lahuta pushon në trá/ pse mixha vdiq ka mot/ e nipat s’dijnë me i rá./...Lahuta pushon në trá/ si gishtat e mixhës tash,/ por n’shpirtin e nipave mbet/ një tingull për kangën e ré.”*⁸⁵

Në vëllimin “Legjenda” kjo marrëdhënie është përcaktuese për atmosferën emocionale të poezisë, por edhe natyrën e vargut që përdor autori, me njaft nuanca të vargut të bardhë që shfaqet shpesh në eposin e kreshnikëve shqiptarë apo të këngëve të tjera legjendare si baladat. Në vëllimin “Legjenda” Camaj nuk i druhet një stilizimi apo risemantizimi të motiveve baladeske të epikës legjendare të vendlindjes, por këtë e bën me vetëdije duke endur mbi motive e subjekte të këngës së epikës legjendare fije e shtresa të reja, ku ndjesia e shqisa personale harmonizohen e ndërzanohen me ndjesinë e shqisën e paraardhësit të tij në poezi: këngëtarit popullor. Siç shprehet poetikisht kjo lidhje mes tij e këngëtarit popullor në poezinë “Ai që i bie fyellit në hanë” që korrespondon me këngëtarin popullor por edhe me poetin i cili në konceptimin popullor është vërtet një njeri me fantazi të shprishur që “i bie fyellit në hanë” ose edhe “lugat”, siç e përshkruan këtu autori këngëtarin endacak.

Me sigurinë e poetit që kapërcen mbi skemat e kufizimet teorike, Camaj përdor mjeshtërisht të gjitha shenjat, simbolet që trashëgon nga kultura gojore shqiptare duke konkurruar në këtë rast edhe fantazinë dhe mjeshtërinë e poetit gojor legjendar. *“Pse të vajtoj për atë/ që fluturoi në hanë?/ Që, në hanën e plotë/ n’oborr delni e shikonje/ hijen e tij sa një bind/ edhe polin e gunës/ si e ka vû mbi krye/ me u mbrojtë prej erës:/ një fyell të madh e ka në gojë/ edhe i bjen në zâ/ shum ma hijeshëm se gjallë/ kur i frynte ne mal...”*⁸⁶

⁸⁵ Martin Camaj, “Lirika mes dy moteve”, në vepra letrare 2, “Apollonia”, Tiranë, 1996, f. 47.

⁸⁶ Martin Camaj, “Legjenda”, vepra letrare 1, “Apollonia”, Tiranë, 1996, f. 157.

Në mjaft poezi Camaj e përdor arketipin folklorik gojor në mënyrë të drejtpërdrejtë si motiv, temë krijimi apo si teknikë artistike, si në vëllimin “Legjenda” në disa poezi të “Lirika mes dy moteve”⁸⁷ “Njeriu me vete e tjerë”⁸⁸ të ciklet “Kangë të vjetra”⁸⁹ “Pleqnime më vete”⁹⁰, “Nema” e “Buelli”⁹¹. Në raste të tjera e përdor si element i nëntekstit dhe si çelës për të reflektuar mbi jetën bashkëkohore si në vëllimet, “Njeriu me vete e tjerë”⁹² “Palimpsest”⁹³.

Në të dy rastet shprehja poetike, është e formuar veç elementesh të tjera, edhe nga takimi emblematik i shprehjes poetike të shkruar, vetjake, me shprehjen poetike gojore të letërsisë gojore, ligjërimin aq të larmishëm popullor të gjuhës së gjallë të folur të malësorit shqiptar, kumbimet e së cilës Camaj i njeh dhe i përpunon deri në përsosmëri. *“Poezia e Camajt mbështetet fort mbi figurën gjuhësore, mbi frazeologjinë dhe idiomatikën popullore dhe mbi të gjitha mbi një fond leksikor të paranjësuar”*⁹⁴ - thekson studiuesi Shaban Sinani.

*“...për botën nga vi unë, - shpjegon vetë Camaj te “Palimpsesti”, - zani ishte gjithçka, sinonim me përjetësinë, kujtesën, me kangën...Thuhet me mbetë në za “mos me u harrue”, dal në za “bahem i përmendun, me famë” e së fundi urimi ta ndiefsha zanin e mirë! “Ndëgjofsha mirë për ty!”*⁹⁵ Ndërsa në poezinë “Emnimi i sendeve” në po këtë vëllim: *“Etnit tanë*

⁸⁷ Po aty, “Zanat apo orët”, f. 145; “Kallximi i blegës së vjetër”, f. 33; “Tregimet e shqiptarëve të vjetër”, f. 113.

⁸⁸ “Gjarpni dhe grueja” f. 187, “Formulë mëngjie”, f. 207; “Legjenda e Shotës”, f. 210-211. “Gjarpijt e zez” vepra letrare 2, f. 230. në M. Camaj, vepra letrare 2, “Apollonia”. Tiranë, 1996.

⁸⁹ “Përbindshi”, në M. Camaj, vepra letrare 2, “Apollonia”, Tiranë, 1996, f. 248.

⁹⁰ Vihen re në këtë cikël ndikime nga struktura e gojëdhanave dhe fjalëve të urta gojore.

⁹¹ “Buelli emën mali”, në M. Camaj, vepra letrare 2, “Apollonia”. Tiranë, 1996, f. 157.

⁹² Po aty, “Aty si tash para se me ardhë fiset”, f. 193. “Kush i bani mëngji qytetit” f. 200.

⁹³ “Emnimi i sendeve” në M. Camaj, vepra letrare 3, “Apollonia”, Tiranë, 1996, f. 182.

⁹⁴ Shaban Sinani, “Çështje të stilit në ligjërimin e Martin Camajt”, në “Për letërsinë shqipe të shekullit të 20-të”, studime, Qendra e Studimeve Albanologjike, I. GJ.L. Tiranë, 2010, f. 118.

⁹⁵ “Palimpsest”, “Jo e gjithë jeta qenka burim poezie”, në M. Camaj, vepra letrare 3, “Apollonia”. Tiranë, 1996, f. 178.

në vetmi i thirrën shpirtën/ shkëndijat e zjarmit dhe gjurmën e e vet/ të gdhendun në gúr Drangue ose Shejt./ Ata ishin njerëz të dhanun mbas tingujsh/ dhe me mija zane në krye:/ ato ishin bletë që bijve të tyne sot/ u bien ndër karta të gjitha pa krena....”

Veçanërisht në vëllimin “Legjenda” dallojmë disa veçori të epikës legjendare gojore si: rrëfimi deri në kufijtë e ndërtimit të subjektit; ku poezitë marrin veçoritë e romancës apo baladës gojore⁹⁶; elementi mitologjik me bazë mitologjinë popullore,⁹⁷ legjendariteti, mungesa e përcaktimit të kohës dhe hapësirës,⁹⁸ hiperbolizmi, ndërkaq në aspektin emocional shpesh dominojnë dhimbja, pikëllimi, vetmia, vrasja dhe vdekja, metamorfizimi në situatat pa rrugëdalje⁹⁹; nga ana tjetër poezitë për cilësitë e mësipërme janë të gjata edhe për nga numri i vargjeve dhe natyra e tyre komunikojnë me baladat apo me këngët e eposit të kreshnikëve¹⁰⁰.

⁹⁶ Po aty, “Dy korba”, “Bletët”, “Korbi”, “Vada”.

⁹⁷ Po aty, “Ai që i bie fyellit në hanë”: “... n’oborr delni e shikonje/ hijen e tij **sa nji bind/ edhe polin e gunës/ si e ka vû mbi krye/ me u mbrojtë prej erës:/ nji fyell të madh e ka në gojë/ edhe i bjen në zâ** ; në përngjasim me flautin e mitit grek për Orfeun që me flautin e tij zbuste egërsirat; “Mbigjarpni, Ora gjarpën, Ora e Dhenave, vdes Ledja vashë dhe gjarpni”- poezia “Ledja”;te poezia “Liqeni i Prespës” “N’ujë mjeshtri u ba peshk./... n’ujë nusja u ba mjellme”, te “Zoti i lumit Sqapi” sqapi;”Nusja e bjeshkës” motivi i gjuetisë së pamundur: kënga popullore “Rriti nana dy jetima”- Nusja –Ora e bjeshkës; te “Qokthi”- motra që bëhet qyqe nga dhimbja për vdekjen e vëllait Gjokës: Zoja e natës, motër e hijeve të natës; “Guri i shpirtit”- mbi bestyyninë popullore se në një rrasë të bardhë me një birë në mes mund të pushojë edhe shpirti i atij që s’ka ba asnjë të mirë në jetë.” “Flaka e zotave”, përfytyrime mitike pagane sjell edhe kjo poezi mbi bestytninë se kur bie e shi dhe moti është i vranët zotat nuk shohin se çfarë ndodh në tokë. Poezia “Zanat apo orët” në “Lirika mes dy moteve”.

⁹⁸ “*Mot i lodhun ky i yni:/ del vera e verë s’âsht,/ rritet bari i tokës/ si lesh në mjekrën e burrit/ e nuk më gzon aspak.*” “Bletët” në “Legjenda”. Në Martin Camaj, vepra letrare 1, “Apollonia”. Tiranë,1996.

⁹⁹ Po aty, “Mjellma e nusja”, “Burri e lumi”, “Dy korba”, “Korbi”, “Vrasja e vetmitarit”, “Vada”, “Dita e pranverave”, “Ledja”, “Qokthi”, “Vajtorja” etj.

¹⁰⁰ Po aty, “Kalorsi”: “Më ndihmo, gjogu im!/ me të dy kambët e para/ të forta me çelik ndër thundra/ shtëngoje at shpi/ tue e mbajtë për dy ballnash/ për dy ballnash pa thye,/pse mbrendë asht ajo, / grueja lëmekun gjumit, guri i paçmueshëm në qelq.” Rrasave të shkambit, thik/ u kap kali flutër./ Por çdo gur i paçmueshëm asht i ruejtun prej Orëve./ prej gjarpijve të helmuem./ sikur grueja në shpinë e naltë/ prej burrash të zymtë e të mëdhaj/ që e dijnë pse leh qeni /,(qeni me sy të prishun,/ zemra e malsorit e

Lidhja e Camajt me folklorin dhe letërsinë gojore qëndron edhe në reflektimin e vazhdueshëm mbi botën natyrore, zakonore, morale, shpirtnore të malësorit të Dukagjinit: botë që e njeh nga përvoja jetësore, por edhe nga krijimet gojore, nga gojëdhënat, përrallat, këngët legjendare etj. për poetin është kjo “një parajsë e humbur”, të cilën e sheh nga larg si distancë hapësinore dhe nga afër si përjetim shpirtëror.¹⁰¹ Kthimet dhe rikthimet të kjo “parajsë” janë edhe kërkim i rrënjëve të identitetit, por edhe udhëtim transshendent në një botë origjinare, të thjeshtë, fisnike, ku njeriu gjendet në zemrën e natyrës, në një botë të paprekur nga teknika, industrializimi, sofistikimi filozofik i njeriut të kohës moderne në të cilën kafshët e egra “pijnë voj e uthull në lumë dhe dalin kukulla hekuri në breg”.¹⁰² Në këtë “parajsë” dëshiron poeti të kthehet qoftë edhe pas vdekjes, siç e shpreh ndër të tjera edhe poezia “Vendit tem”.¹⁰³ Shenjat, simbolet, shprehinë poetike të kësaj bote Camaj i bën pjesë e sistemit të tij të mjeteve artistike për ta shpëtuar përfundimisht nga harresa. Përpunimi poetik i ligjërimin etnografik të trevës së vendlindjes shërben edhe për ta përcjellë në mënyrë origjinale botën morale, zakonore të të parëve të poetit, por edhe për të ruajtur sentencat e urtësisë dhe kulturës gojore shqiptare si në këtë rast: *“Dy gjana print më thanë kur ishin gjallë:/ po qe se shkel ti bukën gand/ çoje prej toke, puthe e vëne në ballë/ ndëgjo ti djal, pse na jemi pleq./ Kur t’rrijsh te votra mbështetë tue pi duhan,/ Mos pshtyj në zjarm,/ Mos pshtyj në dritë, pse â keq!”*¹⁰⁴

Në vëllimet “Legjenda”, “Lirika mes dy moteve”, te ciklet “Kangë të vjetra”, “Pleqnime më vete”, “Nema” e “Buelli” kjo botë shpesh është e pranishme në mënyrë të drejtpërdrejtë ndërsa në vëllimet, “Njeriu me vete e

fyeme/ barat i djegun në fishek). // Në mëngjes shiu prani/ e dielli shëndriti ah at e malit,/ nalt ah at mbulue n’krahnjerr...” etj.

¹⁰¹ “Larg atyne që flasin si unë” në “Njeriu më vete e me tjerë”, M. Camaj, vepra letrare 2, “Apollonia”. Tiranë, 1996, f. 237.

¹⁰² “Qyteti i lodrave” në “Nema”, në M. Camaj, vepra letrare nr.3, “Apollonia”. Tiranë, 1996, f.131.

¹⁰³ “Lirika mes dy moteve”, në M. Camaj, vepra letrare 2, f , “Apollonia”. Tiranë, 1996, f. 65.

¹⁰⁴ “Djella”, në M. Camaj, vepra letrare 1, “Apollonia”, Tiranë, 1996, f. 71.

tjerë”, “Palimpsest” në mënyrë metonimike ose alegorike. “...bota shqiptare është edhe qëllimi i parë dhe i fundmë i autorit. Njeriu i vendlindjes dhe imazhet e saj; mitologjia, legjendat, mendësitë dhe gjuha e të parëve, kërkimi i rrënjëve; janë kulti i kësaj poezie”,¹⁰⁵ aq sa të krijohet bindja se autori i kësaj poezie nuk është larguar ndonjëherë prej këtyre viseve. Shpjegimi është i njohur: poezia lartëson e idealizon shpesh të munguarën, të ikurën, të pakthyeshtën, të kaluarën më fort se të pranishmen, të tashmen. Njeriu i poezisë së Camajt është shpesh malësori shqiptar tradicional që ruan dhe trashëgon normat dhe zakonet e vjetra të shqiptarëve.¹⁰⁶ Po të përdorim një titull të përmbledhjes poetike të Camajt, nga ky vështrim poezia e Camajt në tërësi është një palimpsest i botës shqiptare, me shenja e kode nga kohët mitike, pagane, në kohët më të reja.

¹⁰⁵ Shaban Sinani, “Çështje të stilit në ligjërimin e Martin Camajt”, në “Për letërsinë shqipe të shekullit të 20-të”, studime, Qendra e Studimeve Albanologjike, I. GJ.L. Tiranë, 2010, f.118.

¹⁰⁶ “Dangë voji”, në “Vargje të shpërndame”, në M. Camaj, vepra letrare 2, “Apollonia”, Tiranë, 1996, f.152.

“Dita e malit tem”, f. 19, “Elegji e parë”, f. 25. “Kallximi i blegës së vjetër”, f.33, “Vjeshtat e mixhës”, f. 39, “Drekë malsore”, f.83, “Disa herë në jetë”, f. 103, “Epshi ynë”. f. 111, “Mendimet e tim et”, f. 135 në “Lirika mes dy moteve”, etj. te M. Camaj, vepra letrare 2, “Apollonia”, Tiranë, 1996.

The Relation of Camaj's poetry to the folklore and the Albanian oral literature

Relation between Albanian written literature and folklore and oral literature is a known phenomenon. Especially during romanticism this phenomenon enriched Albanian literature as in formal side as well as contents and thematic side. Also during first half of twentieth century and following, this inventive relationship was continuous source of the inspiration and the influence. By Albanians written literature writers the elements of the folklore and oral literature are revealed and are retook semantics using as element in semantic and aesthetic function.

This occurrence continues with some writer also in the second half of twentieth century especially in the works of martin Camaj. Folklore and oral literature are important elements of his cultural formation. Relation to them is in the motives level, in the poetic utterance, in the comparison of the mystics between the everyday modern lives with the mythic vision of traditional Albanian highlander.

Viola ISUFAJ (Tiranë)

POEZITË E MARTIN CAMAJT - REBUSE FIGURATIVE

Në shkrimin e cituar të Frankfurter Allgemeine Zeitung thuhet se *Camaj është bërë një i Urtë; në rast se vargjet e tij nuk kuptohen menjëherë, kjo ndodh për arsye se i Urti flet me enigma, ka të drejtë të flasë me to*. Poezitë e tij janë rebuse figurative, dhe kjo ua fal magjinë; ato s'janë shpikje të mendjes por ndijim i të gjitha shqisave.¹⁰⁷

Rebusi ka të bëjë me përfaqësimin e një fjale ose rrokjeje me një pamje të një objekti emri i të cilit ngjan nga pikëpamja tingullore me fjalën ose rrokjen e përfaqësuar. Disa pamje a rrokje mund të kombinohen në një mekanizëm të vetëm ose në mënyrë të njëpasnjëshme, për të formuar një frazë apo fjali. Rebuset përdorin shkronja, numra, nota muzikore, ose fjalë të vendosura posaçërisht për të formuar fjali. Rebuset komplekse kombinojnë edhe figura dhe shkronja në të njëjtën kohë. Rebuset mund të përcjellin kuptime të drejtpërdrejta, sidomos për të informuar ose udhëzuar njerëzit pa nivel kulturor, ose mund të fshehin qëllimisht kuptimet, për të informuar vetëm fillim, për të të lënë në pikëpyetje dhe për të të argëtuar. Kështu, parimin e krijimit të rebusit e gjejmë në tekstin poetik të fazës të dytë dhe të tretë të krijimtarisë së Martin Camajt. Camaj ka zgjedhur një kombinim të elementeve gjuhësore dhe vizuale për të krijuar një kuptim më të madh deduktiv, si principi organizues i përfaqësimit të tij.

Sistemi i shenjave është i tillë tek Camaj: ashtu sikurse një rebus është një mister që përbëhet nga pamjet e objekteve, shenja, etj., të cilat nga tingujt e emrat e tyre sugjerojnë fjalë apo fraza, ashtu dhe sistemi poetik përbëhet nga shenja që sugjerojnë si pamje (pamjet e ndryshme të jetës së

¹⁰⁷ Klosi, Ardian; Vepra Letrare 1, "Djella" – "Legjenda", f.34.

vendit të tij dalin nëpër art të tij vizatuese me drita e me hije dridhëse), ashtu dhe tinguj duke bërë që parimi-rebus të luajë një rol të rëndësishëm në sistemet poetike si strategji kryesore për rritjen e fuqisë shprehëse dhe ndërtimit shumështrësor të shumëkuptimësisë.

Gjuha e rebuseve poetike tek Camaj është diku në kufijtë e gjuhës poetike dhe asaj shkencore dhe kjo, ndoshta, duke patur pika takimi dhe me gjuhën e zakonit (të përditshme) madje dhe me atë muzikore (sepse kanë një farë rezonance akustike), ndërkohë që vihen re mungesat (pamjaftueshmëritë) semantike në mënyrën e thurjes së “rrjetit” të rebusit. Karakterizohet nga procedime letrare stilistike të tilla, si: metafora, simboli dhe metonimia.

Do të paraqesim më poshtë disa elemente të gjuhës shkencore, asaj poetike dhe gjuhës së rebusit, një ndërthurje e së cilave karakterizon poezinë e Martin Camajt.

- **Hipotezat janë racionale** (si në gjuhën shkencore) **dhe emocionale** (si në gjuhën poetike)

Në poezinë “Fill i gjetun” shprehet gjendje e veçantë shpirtërore si shprehje e gjendjes konkrete - mbetjes së qytetit në terr deri në agim (qyteti shenjon dhe atdheun). Errësira që shenjon rrezikun dhe të keqen, fatkeqësinë, shkakton shqetësimin dhe dhimbjen shpirtërore të poetit, si pasojë e gjendjes kolektive. Për këtë arsye kjo poezi, pos të tjerash shpreh gjakimin e njësisimit të autorit me poezinë si krijim shpirtëror dhe si katarzë shpirtërore, shpreh vetëdijësimin jetësor dhe artistik.¹⁰⁸

Në nadje vrejta rrethin e andrrave

në truell

e gjeta fillin e tretun

në pkën e ndaljes s dritës.

(Fill i gjetun)

Për të dalë poezia sa më e këndshme për sy e veshë, për të dalë sa më e plotë si trajtë, si formë, si tërësi gjuhësore shprehëse e kuptimore, ajo duhet të krijohet nga mundime prej guri: procesi i krijimit të saj kërkon dije e

¹⁰⁸ Berisha, A. N., *Vepra letrare e Martin Camajt*, “Lajmëtari”, Tiranë, 2000, f.47.

flijime të pabesueshme. Meqenëse te poezia është e rëndësishme para së gjithash trajta -petk i endun prej një dore dhe tingull ose ngjyrë/ e kthjellët deri në dritë, në të duhet shkrirë tërë dija dhe aftësitë krijuese. Vështirë që mund të shprehet me tekstin diskursiv ndërliqësia e këtij procesi në mënyrë kaq të goditur siç është shprehur në poezinë *Trajta*.¹⁰⁹

*Petk i endun prej një dore
fund e krye, trajta,
e kandshme për sy e veshë.
Trajtë e tjeshtë e lindun
ndër mundime prej guri,
e përshkueme shtigjesh të parrahuna
me kambë ose patkoj.
Pendll e lehtë në dukje
po e randë hekur në peshë,
tingull ose ngjyrë
e kthjellët deri në dritë.*

... Fjala poetike ka shkëlqimin e mermertë, ndërsa fryti, poezia, është bërthamë ari.

Ciklet *Nëma* dhe *Buelli* paraqesin sublimime poetike, prandaj çdo gjë shprehet, ngjet e funksionon në rrafshin thellësor. Është reduktuar në pika të skajshme qartësia tematike kuptimore dhe leksiku i zakonshëm. I është dhënë përparësi shprehjes e mesazhit poetik, shenjave, shenjézimeve dhe parabolave kuptimore që ngrihen mbi një sistem të përfutur me përkushtim. Gjuhën e cilëson një shkallë e lartë e shumësisë shprehësore, e simbolikës dhe e abstaksionit; ndërlidhja e brendshme e rrafsheve kuptimore-bëhen prerje diakronike dhe sinkronike të botës shqiptare-është më e ndërligjshme dhe me mundësi të shumta konotuese. Autori sublimon çështje të konkretësisë jetësore dhe të botës fiktive ose i njëson ato; shpreh e plotëson shenjézime nga mitologjia në raport me përdishmrinë; herë-herë zhvendos kuptime tradicionale të magjive e të miteve, herë-herë, mbi bazën

¹⁰⁹ Berisha, A. N., *Vepra letrare e Martin Camajt*, "Lajmëtari", Tiranë, 2000, f. 48.

etyre, rindërton e funksionalizon kuptime të reja.¹¹⁰ Në qenësinë e tyre tematike ciklet shqiptojnë botën tonë; artikulojnë shqetësimin e poetit, ndjesitë dhe shqetësimin e tij ndaj së shkuarës dhe të tashmes. Nëpërmjet poezisë bëhet dialog dhe monolog me vetëdijen historike dhe vetëdijen mitike. Pra, kjo poezi, që është një njësim i modernes me poezinë tradicionale dhe i poezisë moderne dhe bashkëkohëse shqipton e shpreh shpirtin sa të qetë, të hareshëm e të devotshëm, por po aq të shqetësuar, fatkeq e tragjik. Poezitë i cilëson drejtpeshimi dhe stabiliteti, ritmi natyror, një rimë dhe ritëm i brendshëm që së bashku përbëjnë dhe shprehin fuqinë, burimësinë dhe veçantinë e shprehjes poetike, gjallërinë dhe plotninë-qenësinë e përfuturit të veçantë artistik. Imazhet poetike janë të pasura e tronditëse. Përplasjet kontrastike zbatohen e shprehen gjatë ballafaqimit të dukurive të ndryshme, që lidhen qoftë me fatin a fakeqësinë individuale ose kolektive, qoftë me botën fiktive, me qeniet mitike e me simbolikën e tyre shumëzore, që në poezinë e Camajit kanë funksion të shumëfishtë.¹¹¹

- Në poezinë e Martin Camajit ka **densitet logjik dhe sugjestion** (duhet të përdorë fare pak fjalë për të shpjeguar shumë-densiteti logjik), për ta bërë sqarimin të pashpallur, dhe për të hedhur dritë mbi dukuri e ndjesi emocionalisht. Temat fitojnë polivalenca semantike të pashpallura e të rralla, pa humbur kuptimin fillestar.

P.sh. tek poezia *Gjarpijt e zez*, në projektin poetik të Camajit hidhet dritë verbuese: *e jeta e tyne asht e bardhë/ e bardhë e bardhë nën diell/ e jeta e tyne asht e bardhë/nën diell e bardhë e bardhë*. Vetëm në pesë vargje mbiemri *i bardhë* përdoret shtatë herë, emri *diell* dy herë-insistimi i poetit është sugjektiv, gjuha nuk është më komunikim, por një gjenerator gjendjeje, posaçërisht drite, e ngjashme me pikturën moderne. Si piktura dhe poezia moderne, duke fituar tipare të reja i nënshtrohen provës së vështirë të interpretimit.¹¹²

¹¹⁰ Berisha, A. N., *Vepra letrare e Martin Camajit*, “Lajmëtari”, Tiranë, 2000, f. 55.

¹¹¹ Berisha, A. N., *Vepra letrare e Martin Camajit*, “Lajmëtari”, Tiranë, 2000, f. 56.

¹¹² Çiraku, Y., *Bota poetike e Martin Camajit*, Topçiu, L., *Hermetizëm dhe errësirë*, Albas, Tiranë, 2003, f. 80.

- **Sinonimia e reduktuar**, thujse e munguar –karakterizon poezinë e Camajt.

Në rebuse, sinonimia është tepër e reduktuar, pasi dy fjalë nga “rrjeti” i thurjes së rebusit, nuk mund të kenë më shumë se një përkufizim, por një përkufizim duhet të jetë i shprehur në mënyrë unike, prandaj sinonimia është thujse e munguar. Në poezinë e Camajt fjalët-shenja dhe strukturimi i tyre zëvendësojnë thurimën e rebusit dhe aty zor se gjenden sinonime.

- **Antonimi e dukshme** (kuptimi varet nga autori: por nëse lexuesi kupton diçka tjetër dhe krijon pamje pa fund, gjithsesi pjesa racionale do të ndërhyjë, dhe do ta drejtojë kah sistemi i Camajt- në rebus, fjala përmbush vendin e duhur në rrjet- nuk mund të ketë ndërtim kuptimesh në infinit, pasi, ndonëse kuptimet ndërtohen mbi përvoja letrare e vetjake dhe mbi shijet e lexuesve, kërkohet gjetja e një përgjigjeje që i afrohet sa më shumë asaj çka aludohet).

Kështu, në poezinë e këtij poeti, ndihet dukshëm kontrasti si simbol i kundërshtive universale në jetë, të cilat ndeshen kudo, nga gjërat më të thjeshta e të zakonshme e deri tek ato të ndërlikuarat e më ekzistencialet. Kjo trysni e kundërshtive, e trazimeve, gjendet tek njeriu si individ, por edhe tek tërë njerëzimi. Ky kontrast poetik krijohet p.sh., mes poezive “*Gjakmarrja*” dhe “*Dasma malsore*”. Tek e para vizatohet shkatërrimi i jetës nën praktikumin e zakonit të egër të gjakmarrjes. Gjithçka përjetohet si shkretëtirë e makth pas traumës që shkakton kjo energji e verbër negative. Kudo mbijnë udhë të çuditshme gjaku që gurgullojnë lemerishëm nën krrokatën e kobshme të korbave, që shfaqen përzishëm mbi drurët e qarreve të vjetër. Natyrshëm, paralelisht me tingëllimin fonetik të këtyre lloj drurëve, të krijohet ndjesia e qarjeve d.m.th, e vajtimit kozmik. Kurse tek poezia e dytë është e kundërta e vdekjes. Përshkruhet pikërisht një atmosferë dasme në malësi, ku krahas grisë, qetësisë e ftohtësisë së relievit malor, kontraston dyfish një ceremoni e beftë si një vetëtimë shkëlqimi e dritash. Mes këtij ndriçimi shfaqet nusja me krushq, një perëndeshë e vërtetë bukurie e virtytesh që terret në flakët e gëzimit dhe të haresë

dasmore. Dasma, doemos është simbol i pjellorisë, i përsëritjes së jetës, që sfidon shkatërrimin, luftërat e gjakmarrjet e lloj-llojshme.¹¹³

Në këtë hulumtim mbi kontrastin, zë vend dhe poezia “*Një ditë e ka dhe korbi*”, që vjen si rimarrje e motivit në poezinë “Korbi” të librit të mëparshëm “Legjenda”. Në variantin e parë korbi simbolizon kundërshtinë radikale. Konkretisht, ai shpend është i dënuar të mos zbresë dot kurrë në tokë dhe kur e provon, ndëshkohet me përflakje, kthehet në shkrumb edhe më të zi se ç’ ishte në gjallje. Kurse në variantin e dytë korbi përjeton afrimin me pëllumbat, pra prirjen për të provuar hirësimin nën ndikimin e modeleve sublime.¹¹⁴ Në këtë poezi dy janë fjalët më të hasura në përdorimin leksikor e në funksion semantik: korbi-pëllumbi, d.m.th. e mirae keqja, e ulta-sublimja, grabitqarja-paqësorja. Në këtë kundërshti kuptimësisht ndërtohen çiftet e fjalëve që shenjojnë veprime të kundërta: vallja e pëllumbave dhe korbi që s’lëviz (druan se prish ritmin e flatrave), gazullimi i pëllumbave dhe heshtja e korbit (druan se prish harmoninë e këngës). Pikërisht në këtë pikë ngrirje të korbit e lëvizjeve të hareshme të pëllumbave poeti krijon tablonë poetike.

Kontrasti mes ditës dhe natës, mes territ dhe dritës, e shpërndarë urtësisht herë në kundërvënie të qarta, herë në qasje të thjeshta e mënjanime të shkallëshkallshme, ngrihet në rrafshin e simbolit bazë të harmonisë dhe disonancës në një unitet të ndërligjshëm e të pandashëm të natyrës¹¹⁵. Por ajo që ngjan tipike për Camajn është ndjeshmëria e kontrastit, shpesh e dhimbshme, midis të vjetrës dhe të resë, midis traditës e kujtimit nga njëra anë dhe shpejtësisë me të cilën jeta nget kah e ardhmja, nga ana tjetër. Ja, pra, nga vjen dyndja, në njëfarë mase montaliane e pamjeve të prerjeve e të ndarjeve. Lulëzojnë në poezi ndjenja të kundërta si frika nga vetmia dhe njëkohësisht, dëshira për të qenë vetëm, për t’u trazuar pastaj nga një konflikt i përjetuar së brendshmi midis dëshirës për t’u hapur kah bota e

¹¹³ Çiraku, Y., *Bota poetike e Martin Camajt*, Albas, Tiranë, 2003, f. 26.

¹¹⁴ (Çiraku, Y., *Bota poetike e Martin Camajt*, Albas, Tiranë, 2003, f. 26).

¹¹⁵ Guxeta, Antonio, *Shqyrtime letrare, Poezia e Martin Camajt*, Ombra GVG, Tiranë, 2007, f. 209.

jashtme dhe prirjes për t'u mbyllur në vetvete, në pikën ku takohen e ndeshen dy realitetet, njëri i dëshiruar dhe tjetri i vrojtuar.¹¹⁶

- Ka një "përkufizim" në gjuhën e rebusit nëpërmjet sistemit figurativ dhe **fjalëve kyçe** për çdo dukuri, por i njëjti përkufizim mund të përdoret dhe duke ndryshuar nuancë-ndërkohë që një fjalë në rrjet mund të shenjojë diçka sipas një shumësie procedimesh letrare (tropet, etj)

Në analizën e tekstit letrar merr rëndësi përcaktimi i fjalëve-çelës, duke synuar të ndërtohet tipologjia e tyre në sistemin e krijimtarisë së një autori, për të dëshmuar në fund të fundit veçoritë e individualitetit. Fjalët-çelësa përftohen nga përdorimi i dendur i një vargu fjalësh të tekstit poetik, të cilat në vetvete mbartin një kuptimësi intensive, të qëllimtë, duke synuar të përcjellin tek lexuesi mesazhe e ide artistike të caktuara. Brenda lirisë aristike, tekstet janë struktura të organizuara mirë në kode e sisteme vlerash, ku bëhet e mundur hyrja me një sistem njohurish paraprake.¹¹⁷

Numri vargjeve tek "*Fatkeqësi rrugore*" (7) nuk mund të merret si i rastësishëm, por për të krijuar përmasën e atij segmenti kalendarik, prej të cilit krijohen muajt, vitet, mijëvjeçarët, gjithëkohësia. Vdekja në 7 vargje, dmth në shtatë ditët që përbëjnë kohën e madhe të krijimit të botës (sipas Biblës) dhe që në shumësinë e pafund të javëve përfton kohën e pafundme.¹¹⁸

Cikli "*Nema*" cilësohet me tërësinë tematike si dhe me shumësinë dhe me thellësinë e simbolikë poetike. Leksema *nëma* ka kuptim nyjor; shpreh brendësinë e njeriut, natyrën dhe shpirtin e tij, veçmas veset që e cilësojnë atë; shpreh gjendje të pazakonshme, shqetësimin, të keqen. Po me të njëjtën përmasë *nëma* nënkupton katarzën, nënkupton synimin, realitetin e dëshiruar, pra, nëpërmjet saj gjakohet e realizohet subjektiviteti i individit, sidomos në gjendje të rënda e të papritura. Nëma këtu nuk

¹¹⁶ Guxeta, Antonio, *Shqyrtime letrare, Poezia e Martin Camaj*, Ombra GVG, Tiranë, 2007, f. 209.

¹¹⁷ Çiraku, Y., *Bota poetike e Martin Camaj*, Topçiu, L., *Hermetizëm dhe errësirë*, Albas, Tiranë, 2003, f. 16.

¹¹⁸ Çiraku, Y., *Bota poetike e Martin Camaj*, Topçiu, L., *Hermetizëm dhe errësirë*, Albas, Tiranë, 2003, f. 13.

shprehet si mallkim i drejtëpërdrejtë, nuk është në mënyrë e jetës. Në thelb ajo shpreh pakënaqësinë, mospajtimin, ku ndërvënien me gjendjen e caktuar; tragjikën që e ka cilësuar dhe e cilëson botën tonë; vetëdijen tonë në rrjedhë historike dhe “mëkatet” e bëra brenda saj.¹¹⁹ Camaj e krijon strukturën tekstore poetike nga e cila rrezatojnë mendime që rrahin larg. Ndonjëherë jepen vetëm disa elemente të objektit të trajtuar (si në rastin e rebuseve), ndonjëherë brenda strukturës gjuhësore gjakohet ndonjë mendim i rëndësishëm, por ai nuk nxirret në rend të parë, prandaj në shumë raste nënteksti është përcaktues i pandërmjëmë i qenësisë kuptimore të poezisë së tij, i komunikimit poetik të saj. Jo rrallë Camaj del edhe "mashtues" ose përdor “lojën” poetike për të shprehur ndonjë ide ose qëndrim të vetin. brenda kësaj “loje” duhet zbuluar vargu ose fjala çelës ku mund të fshihet qenësia e poezisë përkatëse përndryshe receptimi i saj pezullohet deri në dështim të plotë. Kështu, në poezinë “*Kush i bani mëngji qytetit*” lexuesi pret në bazë të titullit që të shqiptohet ndonjë aspekt mitik i jetës, por ndodh e kundërta: shqiptohet realiteti i drejtëpërdrejtë, me gjithë tmerrin që e cilëson dhe në qoftë se në këto poezi nuk kuptohen togfjalëshat “nuska e mëngjisë” dhe “pe të kuq në qafë”, atëherë vështirë se do të kuptohet qenësia e poezisë e aq më pak vargu “shej i tmerrshëm për këtë qytet”. Nuska shpreh kukullën që nënkupton fytyrën e rreme, maskën. Nuska lidhet drejtpërsëdrejti me penin e kuq e ky pe me komunizmin më të keqen e me dhunën që i sollti ky sistem botës shqiptare. Kjo do të qartësohet sadopak pasi të lexohet poezia “*Kukullat në pushim*” me nëntitullin -motiv për një pikturë naive. Nëntitulli në esencë është mashtues. Poezia me asnjë element nuk ka të bëjë me një pikturë naive, por me naivitetin e përcudësisë së realitetit, i cili është i rëndë e tmerrshëm; në këtë realitet, kukullat si vesa mbulojnë dheun (gjerësia e veprimit të tyre), gjatë ditës ato janë të veshura me tesha të lulme (maskimi) dhe (mbasdite) enden dora-dorë (masiviteti i unitetit të keqes), ndërsa në terr bëjnë tmerrin dhe llahtarinë.¹²⁰

¹¹⁹ Berisha, A. N., *Vepra letrare e Martin Camajt*, “Lajmëtari”, Tiranë, 2000, f. 56.

¹²⁰ Berisha, A. N., *Vepra letrare e Martin Camajt*, “Lajmëtari”, Tiranë, 2000, f. 44.

*Po në muzg, ku shkelin ato kryevogla
nuk del ma bar.*

E njëjta mënyrë ndiqet edhe në vjershën *Mosha e qenit ose ditlindja*, që ka si strukturë gjuhësore poetike dhe nëntekst mjaft të veçantë. Autori ka dhënë vetëm skeletin e një drame, e cila në forma të ndryshme shfaqet e përshkohet në gjithë poezinë e tij të periudhës së tretë. Dy vargje janë qenësore për ta kuptuar ose për të bërë përpjekje më serioze për ta kuptuar këtë poezi, kuptimin shumë të thellë e të pasur: *kohën që vdiq e vrame në mue dhe Ajo nuk ishte festë, por drekë!* Vargjet e tjera e edhe vetë titulli, ndërlidhen me kontekstin ose e plotësojnë këtë kontekst, herë si kundërvënie e kundërshtim, herë si njësim në rrafshin e plotësimit. Që në vetë titullin e përbërë nga sintagma metaforë e pazakontë *mosha e qenit* dhe leksema *ditlindja* shprehet qenësia. Në të vërtetë në këtë krijim nuk bëhet fjalë për ditëlindjen e asnjë qeni, por në subjektin që është antipod i atyre që kremtojnë

kremtuen gjithnatën e ri e i vjetër

kohën që vdiq e vrame në mue

drekën (drekën mortore) përkatësisht vdekjen e tij. Gjithë kjo mund të na "lrrëshqasë" nga receptimi dhe konotimi i mundshëm i drejtë, nëse nuk lexohet me vëmendje vargu i thyer (për shkak të ritmit)-

E thanë: askush s'do të lypi gjak

për të

Pra, sipas studiuesit Anton Nikë Berisha, këtu bëhet fjalë për vdekjen e subjektit, cili kohën që ata e kremtojnë, kohën në të cilën ata sundojnë, e konsideron të vrame, të paqenë. Për këtë arsye sintagma poetike "mosha e qenit" mund të lexohet si "kohë e qenit" ose "kohë e qentë" ose "kohë e pa kohë", ndërsa leksema "ditlindja" mund të këmbehet me togfjalëshin - kremtimi i vdekjes.

Do të guxoja ta çoja më tej këtë mendim për shkak të leksemës së veçantë gjithnata- e cila, me sa duket aludon errësira e gjithhershme si dukuri, pra aludon për një periudhë të errët e të pasigurtë (ndoshta periudha nën diktaturë) dhe jo për një natë.

Po ashtu fraza "kohën që vdiq e vrame në mue" - të çon në përfytyrimin e

harresës dhe mohimit nga regjimi totalitar dhe nga letërsia e realizmit socialist. Camaj përdori një gjuhë të shkathët, të zhdërvjelltë e plastike, të pasur me shprehje e trajta...si njohës i mirë i modeleve të gjalla strukturore të shqipes, ai farkoi mjaft fjalë të reja e madje edhe shprehje të bukura, që e pasurojnë aq shumë veprën e tij.¹²¹

- Ashtu si rebuset, poezitë janë **gjysmë të errëta** (ose gjysmë transparente në rastin e rebuseve, në fillim përkufizimi duket i errët, derisa gjen përgjigjen). Poezia e Camajt artikullohet si një poezi e mirëfilltë moderne, me prirje për një abstraksion maksimal, dmth një poezi jo e shfaqjeve dhe e mesazheve të drejtpërdrejta, por të nënkuptuara, të mbuluara qëllimtazi, pra, poezi hermetike. Në interpretimin e poezive të këtij lloji synohet të rindërtohet e pathëna, por pa menduar se te ajo arrihet përfundimisht. Madje, në provokimin që i bëjnë këto poezi lexuesit për të kërkuar e hamendësuar pafundësisht, qëndron edhe vlera e origjinalitetit të këtyre poezive.¹²²

Errësira bëhet kështu një element estetik. Ajo duket se më tepër e bën të largohet lëçitësin sesa të afrohet, apo më mirë e lë atë pezull (sikurse rebuset). Lirika e errët flet për evenimente qenie apo sende, shkakun e të cilave, kohën, vendin, lëçitësi nuk është dhe nuk do të bëhet me dije.¹²³

Të gjitha poemat e Martin Camajt kanë si karakteristikë fragmentaren. Më qartë kjo manifestohet tek poemat e shkurtra.

- Ashtu si rebuset, poezitë kanë karakter **refleksiv** (“definicionet” janë të bazuara në lojërat e tropeve, në rendin e fjalëve, në shumëkuptimësinë dhe sintetizmin dhe sugjerojnë shumë). Të gjitha poezitë e fazës së dytë japin prirjen për refleksion dhe në poezitë e fazës së tretë forma e përmbajtja pajtohen për të shënjuar vlera që e kapërcejnë të rastësishmen, qoftë kjo e së sotmes ose e të djeshmes.

¹²¹ Berisha, A. N., *Vepra letrare e Martin Camajt*, “Lajmëtari”, Tiranë, 2000, f.144.

¹²² Çiraku, Y., *Bota poetike e Martin Camajt*, Albas, Tiranë, 2003, f. 11.

¹²³ Çiraku, Y., *Bota poetike e Martin Camajt*, Topçiu, L., *Hermetizëm dhe errësirë*, Albas, Tiranë, 2003, f. 79.

Poeti e gjen veten tek poezia përsiatëse me simbole e metafora, ku pothuaj i largohet strofës, rimës së rregullt dhe krijon me renditje të lirë të vargjeve e rimë të brendshme. Sigurisht, ky ndryshim në formë ka ardhur i sugjeruar nga ndryshimi i thellë i strukturës së brendshme të poezisë që nis të krijojë në fazën e dytë. Pra, në poezinë e tij meditative, shfaqet gjithnjë e më dendur pritja për të përcjellë sa më shumë mesazhe poetike brenda teksteve përgjithësisht, të shkurtër. Kjo përkorje ligjërimore realizohet përmes një figuracioni të ngjeshur ndhe gjuhës tejet të latuar. Camaj është nga ata poetë që e kërkon fjalën shqipe në të gjitha rrjedhat e saj: aktuale, historike, krahinore. Mund të thuhet se ai punon me fjalën si një mjeshtër i vërtetë, virtuoz. E nxjerr atë nga përdorimi i përditshëm dhe duke e futur nëpër kombinime mjeshtërore vargjesh, figurash e situatash, i jep asaj befasi e kumbim të mrekullueshëm.

Varësi në strukturën muzikore Fjalët duhet të receptohen si formula tingullore lirike. Poezia *Gjarpijt e zez* ndërtohet me disa efekte të qarta grafike bardh e zi, por që mund të sugjerojnë dhe më shumë ngjyra. Poeti ndërton mjaft figura tingëllore lirike, lëvizje abstrakte të ngopura nga misteri i pamjes së painterpretueshme, të cilën poeti projekton.¹²⁴

Camaj i dha fjalës një harmoni e një kumbim gati prej muzike. Muzikaliteti i kësaj poezie nuk është i zhurmshëm, por i brendshëm, për pasojë mjaft i thellë. Atë e krijon ritmi i vargut, gati si harmoni rituali, e krijon dhe gjetja dhe vendosja e fjalëve në pozicione tepër precize.¹²⁵

Lidhjet sintagmatike dhe paradigmatiske plot të fshehta e mistere, janë çifte të fjalëve të ndryshme, lojëra fjalësh, janë procedime të përdorura në poezi dhe e përngjasojnë poezinë me rebusin.

Duket se merret parasysh proverbi latin “Non multa sed multum”.

Poeti udhëhiqet nga një ideal klasik, ku një maksimum mendimesh shprehen me një minimum formulash të verbra, me një maksimum idesh

¹²⁴ Çiraku, Y., *Bota poetike e Martin Camajt*, Topçiu, L., *Hermetizëm dhe errësirë*, Albas, Tiranë, 2003, f. 79.

¹²⁵ Çiraku, Y., *Bota poetike e Martin Camajt*, Albas, Tiranë, 2003, f. 56.

vizionare.¹²⁶ **Varësi kontekstuale** (në rastin e rrjeteve motivore ka dhe një varësi të vogël; ekzistojnë edhe raste të rralla kur një përkufizim është i varur nga një përkufizim i mëparshëm (zakonisht definicionet me shkronja ose lojërat e fjalëve).

Në rebusin figurativ, rast se një shenjë do të zbulonte kuptimin e drejtpërdrejtë të një fjale, ne do të kishim përkufizime të drejtpërdrejta (si në një fjalor) dhe atëherë ne do ta humbnim totalisht “të papriturën”, “spiritualitetin” “naiven”, “spontanitetin” e rrjeteve tematike, përkufizimet do të ishin me karakter denotativ.

Dendësia e figuracionit apo episodet subjektore të dhëna në një plan të padepërtueshëm lehtë, të shtyjnë të zhbirilosh jo pa vështirësi në labirintet e poetikës së Camajt. Gjithashtu, parimi i përsiatjes zinxhir (përsiatja e parë përgatit apo i dorëzohet një situatë tjetër përsiatësh), bën që të shmanget ngushtësia dhe të krijohet hapësira poetike.¹²⁷ Rebuset figurative të Martin Camajt ngërthejnë krijim dhe përvojë - ato mund të duken steriotipe personale (deri diku ndoshta dhe “maniera personale”).

Të parrëfyeshme...-janë krijimet poetike të Camajt-i përngjasin formulësimeve shkencore apo ekuacioneve matematikore – me përgjigjet (vendosjen e konstanteve në vend të të panjohurave) bëhen të shpjegueshëm: Në përgjithësi rrjeti i rebusit paraqet po ashtu, një shkallë ambiguiteti (dy a më shumë gjurmë për orientim-përndryshe do të ishte një shkallë banale e pavendosshmërisë: shumë herë mund të provohet duke vendosur kuptimin e pastër në vend të atij figurativ, brenda logjikës së ndërtimit të rebusit, e cila bëhet e qartë, e prekshme menjëherë sapo gjendet përgjigjja).

Poezi e Camajt nuk jep aq dorë për analiza ritreguese. Kjo s’është aq e mundur, sepse, poezitë e Camajt iu largohen përshkrimeve realiste dhe nuk kanë pjesë narrative të mirëfillta e të lidhura mes tyre. Më i mundshëm e më i suksesshëm do të ishte komenti i përgjithshëm, duke transmetuar

¹²⁶ Çiraku, Y., *Bota poetike e Martin Camajt*, Topçiu, L., *Hermetizëm dhe errësirë*, Albas, Tiranë, 2003, f. 80.

¹²⁷ Çiraku, Y., *Bota poetike e Martin Camajt*, Albas, Tiranë, 2003.

frymën e brendshme të tekstit duke u përpjekur të ndërtohen urat e lidhjeve asociative mes kohëve dhe ideve qarkulluese.¹²⁸

“**Magjike**”- në fillim gjuha e rebusit dominon personin derisa gjendet çelësi që do ta bëjë dominante-gjuhën poetike. Në fillim është e paparashikueshme, dhe bëhet e parashikueshme pasi e zgjidh (e paparashikueshmja e konvertuar në të parashikueshme). Përveç kësaj, poezia e Camajt është e thirrur të rikrijojë një konfiguracion shpirtëror të vendlindjes së largët, në sajë të të cilit mund të thuhet se poeti ka mbërritur ta mbajë veten gjallë për shumë mote. Poezia e Camajt mund të përfilltet si një seancë e gjatë spiritizmi, si një tendosje shpirtërore e skajshme për të vendosur kontakt me gjithçka e gjithkënd që larg e pavarësisht vullnetit të tij vazhdonte në mënyrë të pakthyeshme të zhbëhej, duke u konservuar: “Eshtna ndër eshtna ndër shtresa patkash të leshta”. Tek dëshiron të rrokë fymën e gjithçkaje të gjallë të vendlindjes, Camaj në nevojën intime për ta shpirtëzuar botën e lënë pas depërton mu në shtalpin e shpirtit të kësaj bote, duke zbuluar vlerat e saj jetike, që është vetia e konservimit-si orientim kah identiteti, por edhe si qëndresë e hershme ndaj rrezikut të zhbërjes totale. Një konservim sa i nevojshëm aq dhe tragjik, por që tekembramja shpreh instiktin genital të Malësisë.¹²⁹ Parime të ndërtimit të rebusit shihen dhe në prirjen moderne të shformimit të realitetit jetësor dhe paraqitjes së tij përmes imazheve, shëmbëlltyrave subjektive, si dhe zbulimit, dhe, njëherësh, errësimit të mendimit. Metaforika e dendur dhe herë-herë “alogjike” veçanërisht simbolika historike legjendare e mjedisore shqiptare, mitizimi i temave përmes përsëritjes së shpeshtë, elipsa, parabola, e për pasojë çrregullimi sintaksor, vargu i lirë e i thyer, herë fort i shkurtër dhe herë tepër i gjatë, rrallimi dhe heqja fare e pikësimit, tipografia si përbërës i stilit modern janë disa risi - pjesë përbërëse të këtyre procedimeve.

¹²⁸ Çiraku, Y., *Bota poetike e Martin Camajt*, Topçiu, L., *Hermetizëm dhe errësirë*, Albas, Tiranë, 2003, f. 12.

¹²⁹ Berisha, A. N., *Vepra letrare e Martin Camajt*, “Lajmëtari”, Tiranë, 2000, Ardian Marashi, f. 148.

BIBLIOGRAFI:

1. Berisha, A. N., “*Vepra letrare e Martin Camajt*”, “Lajmëtari”, Tiranë, 2000.
2. Çiraku, Y., “*Bota poetike e Martin Camajt*”, Albas, Tiranë, 2003.
3. Çiraku, Y., “*Në zbërthim të kodeve letrare*”, “Toena”, Tiranë, 1998.
4. Florentin Smarandache, “*Linguistic-mathematical statistics in rebus, lyrics, juridical texts, fancies and paradoxes*”, University of New Mexico.
5. Guxeta, Antonio, “*Shqyrtime letrare, Poezia e Martin Camajt*”, Ombra GVG, Tiranë, 2007.
6. Klosi, Ardian; *Vepra Letrare 1, “Djella”- “Legjenda”*.
7. Petriti, K., *Në poetikën e Martin Camajt*, Tiranë, 1997.

Camaj poems - Visual conundrum

This is an approach to the poetical text of Martin Camaj and aims to study the structure of rebus in his poetry. Our investigation is concerned with the scientific aspect of the language used, the lyric one, the paradoxal one, puzzle and riddle one.

The aim of this section is the investigation of some combinatorial aspects of written language, within the framework determined by the well-known game of crossword puzzles.

Various types of probabilistic regularities appearing in such puzzles reveal some hidden, not well-known restrictions operating in the field of natural languages.

The correlation horizontal-vertical offers some suggestions concerning a bi-dimensional investigation of the poetic sing.puzzles’ language, therefore, another aspect of our research may be related to the reading in poetry.

Alva DANI, Lindita KAZAZI (Shkodër)

DIMENSIONI PERËNDIMOR I SHKRIMTARIT DHE I ALBANOLOGUT

Është e vështirë të flasësh në pak faqe për një personalitet të madh evropian me rrënjë të forta shqiptare, për një figurë poliedrike, një shqiptar të rafinuar. Martin Camaj është shkrimtari të cilit duhet t'i kthehesh dhe rikthehesh sepse kudo të shpëton një kuptim i fshehtë, është gjuhëtari mërgimtar që ka marrë gjuhën e vet në shpinë qyteteve të Evropës, si breshka Dranja zhguallin e vet. Ndonëse jetoi larg atdheut ai mbarti me vete dhe ruajti gjithçka nga vendlindja, në vetmi dhe vetizolim. Përveç, veprës letrare dhe kulturore që e dëshmoi këtë, mjafton të kujtojmë një fakt nga jeta e tij personale, kur ai në banesën e vet në Lengries të Gjermanisë, kishte rregulluar një kënd me gjithë pajisjet e kullës tipike dukagjinase. Atje ai gjente prehje, meditonte e ia kishte ënda të priste mysafirët më të nderuar. Apo edhe atmosfera e alpeve bavarese, ku kishte zgjedhur të banonte, i kujtonin në çdo çast malet e thepisura të vendlindjes, ku nuk mundi të kthehej më kurrë. Megjithë lidhjen e ngushtë të gjakut dhe traditës, te ky mërgimtar i vetmuar gjejmë jo vetëm tendencat më bashkëkohore, por edhe një seri situatash përmbysëse në mendësinë shqiptare. *“Jam munduar ta shkollis Camajn dhe ta vë diku në sfondin e kohës së tij, brenda botës shqiptare, - shkruan Primo Shllaku. - Nuk e kam parë si arbëresh, as si diasporë, por si njeri të përjashtuar prej gostisë së letrave shqipe. Një njeri që s’kishte vend ku të ulej dhe iku...”*. Veprat e këtij autori sjellin përvojën hulumtuese, mbështetur në mitet e letërsisë popullore shqiptare, por edhe në shkollat e poetikës perëndimore që ndikuan drejtpërsëdrejti në kulturën, artin, filozofinë, botëkuptimin evropian perëndimor, që autori i thithi gjatë edukimit të tij të vazhdueshëm universitar dhe jo vetëm.

Shumë elemente biografike, jo të rastësishëm ndikuan më së miri në formimin e tij si njeri e pastaj si poet e gjuhëtar perëndimor. Që herët shkollohet në gjimnazin klasik të etërve jezuitë, në këtë gjimnaz ku ishin

shkolluar edhe shumë emra të tjerë të njohur si Ernest Koliqi e Luigj Gurakuqi, për të mbetur përfaqësuesi i fundit i kësaj tradite të vjetër e të lavdishme shkodrane që nga shekulli 14-të. Ky kolegji ka shprehur gjithmonë gjatë shekujve - shkruan Altimari¹³⁰ - një angazhim intelektual të prirë vazhdimisht ndaj mbrojtjes së identitetit historik dhe kulturor të kombit shqiptar, por në përputhje të plotë me drejtimit e mendimit, me lëvizjet dhe prirjet kulturore që vinin aty nga qendrat kulturore më të rëndësishme të Evropës. Aty ndodhi përballja e parë me kulturën dhe artin që ofronte Evropa Perëndimore, për të vazhduar pastaj studimet filologjike në Universitetin e Beogradit, ku thellohet në romanistikë e italianistikë, në gjuhët e qytetërimeve të lashta evropiane, si edhe në fushë të sllavistikës. Vazhdon të sigurojë *mjetet* më të rëndësishme, që do ta ndihmojnë të depërtojë në teoritë më moderne të poetikës së kohës. Njohja shumë e mirë e gjuhëve të huaja dhe studimet e vazhdueshme rreth tyre e ndihmuan të dalë nga zhgualli i vjershërimit klasik e tradicionalist që i ofroi “*shkolla klasike e Shkodrës*”. Por jo vetëm studimi i gjuhëve të huaja, por edhe mjedisi letrar bashkëkohor që gjeti në vendet ku mërgoi, ndikuan në rritjen e personalitetit të tij si njeri i letrave dhe studiues i gjuhës.

E shohim shumë të lidhur me vendet ku jetoi dhe punoi, për Italinë shprehet se “... është atdheu im i dytë” ndërsa për Romën thotë se është qyteti ku “... nxuna me çmues artin e shekujve, si gja të çmueshme, pajë të njerëzimit.” Jo rastësisht aty mësoi të kuptonte dhe të lexonte edhe palimpsestet. Vitet që jetoi në Romë përkojnë me atë që Anton Berisha e quan fazën italiane të krijimtarisë, që do të thotë se krijimtaria e tij e asaj periudhe ngrihet mbi disa elemente të kulturës italiane. Me sa duket poeti hermetik italian Xhuzepe Ungareti ishte tepër mbresëlënëses në poezinë e tij, por jo vetëm. Arshi Pipa¹³¹ mendonte se ai lexonte ndër hermetikët italianë jo vetëm Ungaretin, por edhe Montalen, duke qenë se Montale është poet shumë origjinal dhe mendimtar mjaft i thellë, gjë që nuk mund të thuhet për

¹³⁰ F. Altimari, *Profili bio-bibliografik i M. Camajt*, revista “Jeta e re”, Prishtinë, 1996, f.45.

¹³¹ A.Pipa, *Poezia dhe poetika e Camajt*, në “Jeta e re”, Prishtinë, 1996, f. 14.

Ungaretin, shumë i ndikuar nga Malarmeja. Megjithatë Ungareti përmendet shpesh në lidhje me Camajn dhe Camaj vetë e përmendte gjithashtu shpesh. Ishte pikërisht Roma, apo kurset e letërsisë në “*La Sapienza*” e në veçanti leksionet e poetit italian që thyen akullin e thellësive të paracaktuara të aftësive të tij. Këtu – shkruan Ardian Klosi¹³² – Camaj arrin të zbulojë, më saktë të zhveshë dalëngadalë origjinalitetin e poezisë së vet duke lavruar në dy lumenj: në poezinë moderne evropiane dhe në letërsinë e vjetër shqipe. Arsimi që kishte marrë deri aty i jepte themele të shëndosha, por s’mund të mjaftonte kurrësi për fryte origjinale poetike, aq më shumë në mërgim. Ungareti është cilësuar për një përqendrim ndjenjash, përjetimesh dhe simbolesh, hapësirat e bardha që flasin sa vetë fjala, shprehjet e dendura që arrijnë deri në kufijtë e hermetizmit. Mjaft nga këto tipare Camaj i bën të vetat, duke qene se ato janë të afërta me gjendjen dhe synimet e tij poetike. Pa dyshim Camaj merrte shtysa nga leximi i tij i gjerë i letërsisë që nga “*La divina commedia*” deri te “*The waste land*”. Me siguri njohja me procesin eliptik të hermetizmit e nxiste Camajn të perfeksiononte udhën e tij poetike, që kishte ndërmarrë që më përpara, udhën e reduktimit të tekstit poetik në një minimum fjalësh, pa zbulurime të panevojshme, mbi themelin e vargut popullor shqiptar.

Është gjithmonë interesante të gjesh etërit ose vëllezërit shpirtërorë të një shkrimtari. Dhe për Camajn mund të përmendim edhe të tjerë sivëllezër, si Prever, Eliot apo simbolistët rusë, duke përjashtuar në mënyrë absolute plagjiaturën dhe skemat e tingëllimet e huaja¹³³. Nga ana tjetër nuk mund të përjashtojmë faktin se Camaj u ndikua nga teoritë moderne perëndimore letrare apo gjuhësore, po të kishte qëndruar në vendin e tij, nuk do të kishte mundur kurrë të shkruante “*Njeriu me vete e tjerë*” apo veprat e tjera poetike “*Nema*”, “*Buelli*” e “*Palimsest*”. Prej poezive fillestare tejet konvencionale, poezia e tij u zhvillua në poezi moderne dhe individuale, me vargun e lirë deri në kulmin e saj të prozës poetike tejet

¹³² A. Klosi, *Takim me Martin Camajn*, Vepra letrare 1, “Apollonia”, Tiranë”, 1996, f. 24.

¹³³ A. Klosi, po aty.

simbolike të vëllimit “Dranja”. Poezia e Camajt - shkruan prof. Sinani¹³⁴ – nuk i njohu kanonet e realizmit socialist, prandaj ka një liri formale dhe një përmbajtje që nuk mund të krahasohet me ato të poezisë së zhvilluar në atdheun e vet... Camaj nuk e shpërdoroi fjalën, të vetmin mjet që kishte për të shpallur individualitetin e tij krijues si pjesë e sistemit të letërsisë shqipe, duke refuzuar estetikisht dhe etikisht përzierjen në çështje të sistemit politik... Thellësinë e kuptimeve dhe mjeshtërinë për të ndërruar njëherësh ndikime prej shumë shtresash kulturore të traditës vendase e të asaj botërore Camaj ia lehtësoi mjaft kultura e përgjithshme filologjike.

Camaj përveç se një shkrimtar me vlera kulminante artistike, është edhe një gjuhëtar mjaft i zoti. Tashmë ai mund të radhitet si një nga albanologët më të shquar të gjysmës së dytë të shek. XX. Në Universitetin e Beogradit merr një arsimim filologjik nga profesorë gjuhëtarë të njohur si Henri Bariç, në Romë mbron doktoratën mbi “Mesharin” e Gjon Buzukut duke u ndalur në mënyrë të veçantë në sistemin vokalik të këtij shkrimtari të moçëm shqiptar. Studimet e vazhdueshme në gjuhësi i përfundoi në Universitetin e Mynihut, ku për herë të parë, nën kujdesin e tij albanologjia u ngrit në shkallën e një katedre. Punimet e tij rrokin fusha të ndryshme të shqipes, por kryesisht përfshijnë ato të gjuhës së shkruar të historisë së gjuhës shqipe, të dialektologjisë, veçanërisht të folmet e arbëreshëve të Italisë, të historisë së gjuhësisë¹³⁵.

Camaj shkruante në gegërishten letrare, e lëvruar nga shumë shkrimtarë e poetë të tjerë para tij. I ndërjegjshëm për dimensionet mbarëkombëtare të veprës së tij, ai u përpoq me sa është e mundur, të kuptohej nga një masë sa më e madhe lexuesish, nga Veriu dhe nga Jugu. Për këtë qëllim, në shumë raste iu shmang trajtave nëndialektore, duke fituar vepra e tij më tepër gjerësi e frymëmarrje – shkruan prof. Koleç Topalli. Gjuha e Camajt, - vazhdon profesori, - për nga drejtshkrimi dhe trajtat gramatikore, është një gegërishte letrare e kodifikuar me prirje afrimi

¹³⁴ Sh.Sinani, *Martin Camaj midis dy letërsive*, në *Përveçime*, LMG, Tiranë – Prishtinë, 2007, f. 278-279.

¹³⁵ P. Kotri, *Kontribute të Martin Camajt për historinë e gjuhësisë shqiptare*, në “Shkodra në shekuj”, Vëll. II, Shkodër, 2000, f. 47.

ndërdialektor¹³⁶. Të jesh konservator në një fushë është më e lehtë se të jesh novator. Martin Camaj ashtu si Ernest Koliqi, i përkasin grupit të dytë¹³⁷. Camaj në gjuhën e tij nuk shquhet për ngurtësi, përkundrazi, përpiket të jetë sa më afër gjuhës së popullit. Kodi bazë në të cilin u mbështet Camaj për të shkruar një gegërishte të zbutur dhe me prirje afruese, ishte zbatimi me përpikmëri i rregullave të caktuara nga Komisia Letrare Shqipe. Përgatitja e tij filologjike bëri që vepra e tij të lexohet e vlerësohet nga studiuesit¹³⁸. Për gegërishten Camaj vetë thoshte se “... *Jeta ime ashtë një luftë për gjuhën letrare gegë dhe për kulturën e saj; gegnishtja a ma e bukur, ma e pasun dhe ma e thjesht... se sa gjuha të – të – të.*”¹³⁹ “*Ai i njihte fort mirë të gjitha varietetet e gjuhës shqipe. Nuk do kishte pasë telashe me shkruar tosknisht apo unjisuemisht. As nuk shkruente gegnisht për shkak të njifarë komoditeti ose të të kenët i mësuem me gegnishten. Camaj e përdori gegnishten në bazë të një vendimi dhe vullneti të kuartë e të vetëdijshëm – me luftue për gegnishten*”¹⁴⁰. Promovimi i tij në gjuhësi, thellimi në gjuhën amtare do të ecte paralel me botën poetike, me pjekjen e tij si shkrimtar. Camaj është një shkrimtar që e përdor gjuhën me një shkathtësi të madhe, e cila është njëkohësisht mjet dhe objekt i aktivitetit të tij të përditshëm. Gjuha, me thesarin e saj, gjithmonë ka *mjete* për të përcaktuar individualitetin e artistit. Është detyrë e studiuesve pastaj t’i zbërthejnë veçoritë thelbësore të artit të tij.

Bardhyl Demiraj, pasardhësi i Camajt në katedrën e Albanologjisë së Mynihut, dikur, në varrimin e tij, pati thënë se Camaj ishte një Akademi shqiptare në mërgim, një akademi alternative që mendohej të mbushte gjithë atë zbrazëti që linin mistifikimet, gënjeshttrat dhe heshtjet e

¹³⁶ K. Topalli, *Vepra e Martin Camajt në aspektin gjuhësor*, në përmbledhjen “Martin Camaj-tradita dhe bashkëkohësia”, Shkodër, 1994, f. 88.

¹³⁷ T. Osmani, *Vëzhgime gjuhësore për veprën e Martin Camajt*, në “Shkodra në shekuj”, Vëll. II, Shkodër, 2000, f. 58.

¹³⁸ Po ai, po aty, f. 58.

¹³⁹ Hans – Joachim Lankch, *Jeta e një njeriu – homazh për Martin Camajn*, “Hylli i dritës”, nr. 1-2, Tiranë, 1994, f. 10.

¹⁴⁰ Hans-Joachim LANKSCH, *Camaj pa kapele bavareze*, Gazeta “Albania”, www.shqiperia.com.

Akademisë së RPSSH dhe të Krahinës Autonome të Kosovës. Këtë punë ai e pat nisur që në Romë me revistën “Shêjzat” që e drejtoi së bashku me Ernest Koliqin, një enciklopedi e vërtetë e botës shqiptare¹⁴¹.

Camaj si gjuhëtar dhe sidomos si shkrimtar, është një emër tepër i veçantë, ndërsa tekstet e tij letrare, të para veç e veç, po edhe si tërësi, janë një gurrë e rrallë, nga e cila mund të vilet një thesar *sui generis* gjuhësor, një thesar i mburjtur me fjalë e shprehje frazeologjike që tashmë pothuajse kanë kaluar në pjesën pasive të leksikut të shqipes së sotme, por që te ky autor gjithëherë janë dhënë me një origjinalitet të theksuar dhe me një natyrshmëri të papërsëritshme¹⁴². Gjuha është mjete i letërsisë – thotë Sapiri – siç janë mermeri, bronzi apo argjila materiale të skulptorit. Meqë çdo gjuhë ka veçoritë e saj dalluese, përkufizimet dhe mundësitë e brendshme formale të një letërsie kurrë nuk janë të njëjta me ato të një letërsie tjetër. Letërsia e modeluar nga forma dhe substanca e gjuhës, ka ngjyrën dhe thurjen e vet. Atë ngjyrë dhe thurje që Camaj diti t’i jepte artit të tij origjinal dhe të pakrahasueshëm me asnjë tjetër.

Hans – Joachim Lanksch¹⁴³, përkthyesi i poezive të tij në gjuhën gjermane mendon se Camaj, për nga përmasa evropiane dhe botërore i takon kategorisë së klasikëve të modernes, që mund të përcaktohet nga emra të tillë, si: Jorge Guillen, Vincente Aleixandre, Octavio Paz, Ossip Mandelshtam, Eugenio Montale, Salvatore Quasimodo, Giuseppe Ungaretti etj., por ai ishte njeri i qetë dhe mjaft modest, dhe nuk ishte në karakterin e tij të trumbetonte pareshtur veprën e tij letrare në të katër anët e botës.

Në dhë të huaj, Martin Camaj mbeti përherë po ai malësor shpirtmadh e fjalëurtë. Dëshmi për këtë kemi gjithë veprën e tij, sidomos poezinë. Mbi struktura të stërlashta Camaj krijoi vepra letrare kryekëput moderne që i pasqyrojnë shqetësimet, ankthet, izolimet, vetminë e njeriut në ambiente nga më të ndryshmet, prej bjeshkëve dukagjinase gjer te mjediset urbane të Evropës, duke qenë sa shqiptare aq edhe universale.

¹⁴¹ B. Demiraj, *Albanologjia dhe gjuha shqipe*, www.forumishqiptar.com.

¹⁴² Xh. Beqiri, *Stili dhe gjuha e Martin Camajt*, AIKD, Prishtinë, 2007, f. 16.

¹⁴³ H. Joachim Lankch, Intervistë me Hans – Joachim Lankch.

Martin Camaj mbetet një personalitet i fuqishëm i letrave shqipe, një pikë referimi për shume studiues, një shartim i goditur i traditës kulturore shqiptare në më të gjërin dhe dinamik dimension evropian.

BIBLIOGRAFI:

1. A.Berisha, *Vepra letrare e Martin Camajt*, Kozencë, Itali, 1994.
2. “Jeta e re”, nr i posaçëm, *Martin Camaj 1925 – 1992*, Prishtinë, 1992.
3. P.Shllaku, *Nji Uliks që s’mbrriti kurr në Itakë*, Gjergj Fishta, 2006.
4. A.Klosi, *Takim me Martin Camajn*, në *Vepra letrare 1*, “Apollonia”, Tiranë, 1996.
5. Y.Çiraku, *Bota poetike e Martin Camajt*, Albas, Tiranë - Tetovë, 2003.
6. Xh.Beqiri, *Stili dhe gjuha e Martin Camajt*, AIKD, Prishtinë, 2007.
7. Sh.Sinani, *Martin Camaj: midis dy letërsive*, në *Përveçime*, LMG, Tiranë-Prishtinë, 207.
8. Simpozium, *Martin Camaj, tradita dhe bashkëkohësia*, 1993, Shkodër.
9. P. Kotri, *Kontribute të Martin Camajt për historinë e gjuhësisë shqiptare*, në “Shkodra në shekuj”, Vëll. II, Shkodër, 2000
10. T. Osmani, *Vëzhgime gjuhësore për veprën e Martin Camajt*, në “Shkodra në shekuj”, Vëll. II, Shkodër, 2000.

The Western dimension of the writer and scholar

Martin Camaj, the writer on whose work one has to go over and over again so as to grasp every possible hidden meaning, West-oriented poet, linguist and scholar, one of the best known specialist in Albanian studies of the second half of the twentieth century, product of the Albanian culture of a dynamic European dimension, remains a powerful personality of Albanian Literature and a cornerstone for several other scholars. During the so-called “Italian phase of literary production” we see him closely bound to Italy which he would later regard as a second homeland.

The influence of the Italian “hermetics” particularly that of Ungaretti, was quite remarkable and especially obvious in his poetry. Camaj used to write in the Gheg dialect aiming at reaching a wide audience of readers. He deliberately used a soft version of this dialect.

Ermira ALIA (Shkodër)

CAMAJ NË NJË KËNDVËSHTRIM PEDAGOGJIK

Gjithnjë më ka intriguar fakti i ballafaqimit të letërsisë si disiplinë shkollore me letërsinë si art.

A ka humbje letërsia si art kur “disiplinohet” brenda një lënde shkollore? Po brenda një ore mësimore? A mund të themi se ka shkrimtarë që “edukojnë më shumë” apo “edukojnë më pak”? Nga ç’argumente përcaktohet vendi i tyre në programin e letërsisë: nga vlera artistike, cilësia e mesazheve, nga kontributi kompleks që ato kanë dhënë për emancipimin e kombit të tyre, apo nga impakti aktual që marrin veprat e tyre në situata të caktuara?

Të gjithë këto pyetje kanë të njëjtin thelb, por edhe mbartin një rrezik të madh të përbashkët: nënshkrimin e letërsisë ndaj pedagogjisë e, pse jo, në rastin tonë edhe të Camajt..., pasi në momente të tilla kur politika e ka shtypur artin për shumë kohë, reagimi ndaj shtypjes në formën pedagogjike të renditjes së natyrshme të cilësive dhe të analizave, mund të bëjë të njëjtën gjë që ka bërë edhe politika, por në një formë tjetër... Ne e dimë, në fakt, se shpeshherë me trajtimin që i bëjmë tërësisë së veprës të një shkrimtari si një sistem vlerash artistike, leksikore, frazeologjike, etj., e kthejmë pa dashur letërsinë në një vasale të pedagogjizmit. (Kam lexuar diku se të rinjtë italianë nuk kanë dëshirë aspak të lexojnë “Të fejuarit” e Manxonit, pavarësisht se i kanë “të gjithë arsyet” për ta bërë këtë)

Pikërisht duke pasur parasysh këto, do të donim të shikonim poezinë e Camajt, në një këndvështrim disi të ndryshëm.

Në fakt, shkolla është një institucion edukues dhe edukimi plotëson dhe mbështetet përmes mësimdhënies. “Edukim”, sipas një këndvështrimi të përbashkët pedagogjik klasik e modern, do të thotë të formësosh

zhvillimin e karakterit me pikësynim përmirësimin e njeriut, (Herbart) ...të ndjesive të nalta shpirtërore të tij (në kërkim të së mirës, të vërtetës dhe të bukurës) ¹⁴⁴Anton Harapi.

Duke e parë shkollën si institucion edukimi dhe letërsinë si lëndë shkollore, dhe kur na duket se e kemi analizuar dhe kuptuar plotësisht atë, “shfrytëzojmë” vargje pa fund e proza të tëra të mrekullueshme për të edukuar me shembuj, por ndodh atëherë që letërsia rebelohet dhe hakmerret ndaj dhunave të tilla, ... ajo na *mban enigma*, ose *na shfaqet përmes një ndryshueshmërie perceptimesh* dhe ne s’na mbetet veçse të pranojmë.. se e tepruam diku e ndoshta shumëku, duhet të kthehemi mprapsht, dhe duhet të kujtohemi..apo të justifikohemi se *është.. produkt i aktivitetit emotiv të artistit*¹⁴⁵

Dheu im është i përmendun
për humneret e thella
ndër banorët e malit e të fushës
deri në dé. Mbramjeve atjë
ndëgjohet klithma e grizhlës
ndër kthetrat e shqipes e shpirti i sáj
u flijohet hijevet.

Atje lot drita në sytë e njerzve tash e parë
e epshet s’i njeh kurrkush me emën.
Shpagimi me gjak është, për shembull,
gjarpën nën gúr e gjarpni vetë
na qenka mende femne
nën rubën e bardhë ose të kuqe.

¹⁴⁴ UNESCO, Byroja Ndërkombëtare e Edukimit. Mendimtarët për edukimin. Plejad, 2008.

¹⁴⁵ Freud Sigmund, Psikanaliza e artit dhe e letërsisë.

Në muzg atje secili prek ballin e vet
e ndien ndër gishta fillin e jetës
e gëzohet.

Dita e malit tem

Studiues të tjerë pohojnë se edukimi është një qëndrim dëgjues ndaj “qenies” së një tjetri, derisa ky i fundit të gjejë mendimin e vet, të gjejë dhe të rinjohë të vërtetën e vet gjatë një procesi konstant kërkimi të gjetjeve të bindjeve dhe sigurive në disa të vërteta gjithnjë e më problematike.

Në të vërtetë, nuk janë pak “të vërtetat problematike” tonat shqiptare, qoftë edhe brenda vetëm një poezie, si “Dita e malit tem”: dheu, humnerat e thella, kthetrat e shqipes, flijimi, shpagimi me gjak, gjarpni nën gur e ruba e bardhë, apo e kuqe, kështu që s’mund të themi se letërsia dhe edukimi s’janë afër, pavarësisht se letërsia flet për të vërtetat jo në emër të edukimit. Ajo tregon se “stili është njeriu”. Ajo nuk të “mbërthen” me fjalë, nuk të ngarkon, di të presë; dhe pavarësisht se as që ia ka idenë se tani edhe për shkencat natyrore, mësuesit këshillohen të flasin pak dhe t’i drejtojnë fëmijët të mendojnë, poezia e ka bërë këtë qysh e qysh më parë; gjithnjë ka bërë kështu; tani ajo ka një lidhje të fortë me lexuesin dhe nuk ka frikë as prej të kuptuarit e as prej mos të kuptuarit të tij, nuk ka frikë prej gjuhës së vet. Kjo gjë më kujton thënien e një pedagogjisti artist, Rusosë: *
“Natyra ua jep stimulim vetëm qenieve plotësisht të zhvilluara të cilat duan të thyejnë guaskat e tyre” “Natyra pret çastin e duhur”, “ajo e ndihmon vetveten në çfarëdo mënyre të mundshme”.

Kështu, për shembull, kur poezia e Camajt solli ..“ditëlindjen” me “moshën e qenit”, letërsia i kujtoi pedagogjisë të kapërcejë nivelin e asaj çfarë “unë kam fuqi ose mund të mendoj ... brenda caqeve shkencore, filozofike a politike” duke na treguar se fjala mund të humbasë konceptin e gjithëpushtetshmërisë, në favor të ... ndjeshmërisë, le ta quajmë.

E megjithëse në pedagogji kohët e fundit flitet gjithnjë e më shumë për heshtjen si zgjidhje didaktike, për intiligjencën ndjesore të njeriut, për

rolin e psikës, letërsia e kishte bërë këtë me kohë, pa bujë. Tani vetëm po e rafinon këtë shprehje me natyralitetin që vetëm ajo di ta bëjë.

Duke e ndihmuar lexuesin të pranojë dhe të pranohet, letërsia e ndihmoi njeriun për t'u ndier "individ". Ajo i dha dorë atij të rindërtojë ose të rizbulojë të vërtetat me anë të veprimit mendor individual të brendshëm (dhe shoqëria shqiptare e sëmurë nga "kolektivizmi" kishte shumë nevojë për këtë, ndoshta vazhdon të ketë edhe tani). Kështu ajo u bë potencë për të zhvilluar personalitetin e pavarur brenda secilit.

Vetë përmbysja e modeleve që Camaj solli me artin e vet ishte dëshmi e një çlirimi intelektual:

Burrat nuk kërcejnë tashti:
dikur i hoqën vigut të luftëtarit të vramë
mbulesën e kuqe,
hynë ndër valle dhe e suellnë n'ajr.

Largimi i poezisë

Janë vulgare, po nuk dua që të më humbasin në harresë pa përmendur, disa fjalë që duke shkruar m'u kujtuan se i kisha dëgjuar diku herët në fëmijëri " - E dëgjove MIRË SI të thashë unë?"

Kurse letërsia tregoi se ajo që lexohet është në fakt shpesh më pak e rëndësishme sesa ajo që nuk është thënë. Kështu letërsia përmbysi aksiomën e vjetër pedagogjike, "Nuk është patjetër i rrituri, ai që duhet të tregojë rrugën" duke vënë një raport të ri mes moralitetit dhe bindjes, mes "orës së brendshme" të individit dhe "orës biologjike" të tij.

Në lidhje me këtë, në kritikën tonë, konceptet e kohës së jashtme dhe kohës së brendshme kanë vënë në dukje *ritmin vetiak të letërsisë shqiptare* dhe e kanë vënë atë në raport me *ritmin letrar të gjithëkohshëm*¹⁴⁶. Duke e parë poezinë si raport me lexuesin, ne mund të

¹⁴⁶ Kurti, Ledri. "Dimensione të mendimit kritiko-estetik në kohë dhe tipologji", Monografi, Shkodër, ShB "Camaj – Pipa", 2009.

shtonim edhe kohën interiore të individit, ose siç mund ta quajmë ndryshe “kohën subjektive” të lexuesit.

Para një poezie me fjalë të pakta, ku stimulimi i kuriozitetit dhe i shpirtit vëzhgues ngjallet më së shumti nëpërmjet kodeve me fuqi të madhe asociative me karakter mitik e kombëtar, kur fjalët e saj, ashtu si vajzat te vallja arbëreshe e Camajt, në fillim të “*lëmojnë*” e mandej “*lëshojnë ritmin*” (“Largimi i poezisë”), ku mitet vijnë si fshehtësi e thellësive e si shkrirje filozofish, ku fjala vjen si pasqyrë e psikes, nuk është e thjeshtë të qëndrosh e të kesh një model ku të pasqyrohesh. Duhet pak kohë për të fituar autonominë mendore dhe për të ridimensionuar mendimin. E nëse flasim për këtë, ndoshta do të duhej t’i shtonim fenomenit “katarsis” edhe efekte të reja të letërsisë.

Përdoret fjala *ndikim* për shkrimtarët dhe unë provoj një ndjesi jo shumë dakorduese, në kuptimin se më duket një term disi thjeshtëzues i një procesi kompleks *mendor* qoftë edhe për një njeri të thjeshtë, e aq më tepër për një artist, që mendohet se mbart një individualitet dhe kompleksitet të patjetërsueshëm, sepse unë besoj se artisti lind para artit të vet, prandaj edhe zhvillimet e sipërpërmendura të poezisë së Camajt nuk i shoh si një ndikim të jashtëm prej hermetizmit, po si një tendencë të brendshme natyrale të Camajt e të vetë letërsisë.

Duke iu rikthyer edhe një herë arsimit, më pëlqen të citoj:*** “Nëse arsimi është një çështje zemre, ka një rrezik përherë të pranishëm të tejngopjes së fëmijës me dashuri.....atëherë është e rëndësishme që dashuria të mbahet brenda kufijve... nëse arsimi është çështje e kapjes së një kuptimi pozitiv të subjektit, si dhe i faktorëve nga të cilët përcaktohet, atëherë rreziku i trajtimit të këtij subjekti si një produkt i thjeshtë i këtyre përcaktorëve, është me të vërtetë i madh.... Në qoftë se arsimi është me të vërtetë një çështje veprimi, atëherë qëndron rreziku që ta kthesh atë në një çështje thjesht të prodhimit teknik.”

Letërsia e mirë i paraprin demokratizimit të shoqërisë, i paraprin edhe demokratizimit të arsimit dhe të mësimdhënies duke ndërgjegjësuar pa kuptuar për mendësinë pedagogjike me forma që përtërijnë lirinë dhe pavarësinë, përshtatur me statet e zhvillimit.

Nuk e përmenda shumë shpesh emrin e Camajt, pasi nuk mund t'ia delegojmë disa përmendje të sotme viteve të kalueme. Fola për letërsinë, për tendencat dhe ndjeshmëritë e reja të saj duke pasur parasysh se këtë e bëjnë personalitetet e forta dhe m'u kujtuan vargjet:

Uliksi e Itaka pa grue – dy krena binjokë dhie
Me një bri të thyem: punë e pakryeme.

Çka i duhej Uliksit Itaka pa grue?

dhe bashkë me vargjet në këtë paralelizëm kontradiktor në dukje të pedagogjisë me letërsinë edhe një citim mbi edukimin: "... njeriu është në thelb i lirë dhe të gjitha përpjekjet për ta dashur, për ta kuptuar dhe për ta përfshirë atë ..., pa e përfillur këtë liri, në fund janë të dënuara të dështojnë.."

Në fund të fundit vetë poetët ...shpesh mendojnë se, çdo njeri, në thellësi është një poet dhe se poeti i fundit do të vdesë vetëm me njeriun e fundit. E sa më shumë poetë, apo thjesht njerëz të vërtetë, aq më e sigurt statuja e Camajt "me një bri të thyem".

LITERATURA:

1. Aliu Ali, Sinani Shaban, Çapaliku Stefan, Çobani Tonin, "Letërsia bashkëkohore shqiptare", Albas, 2001.
2. Freud Sigmund, "Psikanaliza e artit dhe e letërsisë".
3. Kurti, Ledri. "Dimensione të mendimit kritik-estetik në kohë dhe tipologji, monografi", CP 2009.
4. UNESCO, Byroja Ndërkombëtare e Edukimit. "Mendimtarët për edukimin". Plejad, 2008.

INTERNET

5. Molinari, Luca, "Il novecento e gli autori del sospetto, Un campo aperto tra arte e pedagogia".

On a brighter Camaj education

The article, as a complex parallelism of literature and pedagogy, tries to attach the actual impact that Camaj's poetry offers the reader as a perceivable attitude of the human being towards a distortable perception, as a developing stage conditioning a breakage of the shell, as an existing space where each one feels like being on his own even in a collectivism-sick society, as a potential to germinate the independent personality inside the individual entity, as a upcoming ratio between morality and abeyance, between the "insider" and "biological" hour, as a mystery of the profundity and philosophy dissolving with the word coming as a psychic mirror, as a mental autonomy and a new dimension of the thought, as an intellectual deliverance... etc

Describing this impact should be underlined the fact that skilled literature calls up pedagogy about transcending the level of "I have the power or I can evaluate... inside the scientific, philosophic, or politic boundary..." by showing us that words could lose the omnipotent concept to favor a lot of complicated processes that could add to "catharsis" phenomenon of literature some other new effects, among them that of preceding social, educational, and teaching democracy by raising impalpable awareness of pedagogical psychosis with constitutionals innovating liberty and independence.

Elindë DIBRA (Shkodër)

ROMANI “DJELLA” - GËRSHETIM INTERTEKSTUAL MIDIS PROZËS DHE POEZISË

“...Ndër libra kisha lexue se vetëm në sipërfaqe të dheut mund të përzihej poezia e saktë e bukurisë. p.sh. në pikëzat e ujit mbi fletëzat e tërfonjës n’agim, në bucat e dheut e deri në fytyrat njerëzore. Asull, asull ato janë shkëndija. Kur fillova me i mbledhë ato shkëndija nëpër landët e jetës, u kujtova se për veprën time të madhe, që dojsa me shkruie, poezia ishte e pakët...

Martin Camaj

Romanin “Djella” autori e botoi në Romë (1958), mbasi kishte publikuar në Prishtinë dy vëllime me poezi, “Nji fyell ndër male” (1953) dhe “Kanga e vërrinit” (1954). Poetika e këtij romani paraqet tekst proze, gërshetuar me poezi. Objekti i këtij punimi janë marrëdhëniet intertekstuale midis poezisë dhe prozës së Martin Camajt, ku teksti burimor është poezia, e cila transmeton elemente të sajat tek proza. Këto elemente janë të larmishme, shtegtojnë nga poezia nëpër subjekte, personazhe, situata, deri edhe në detaje. Kjo qasje në raportin intertekstual midis poezisë dhe prozës së Camajt kërkon në radhë të parë mbështetjen në mendimin teorik të Barthes-it, sipas të cilit “çdo tekst ka intertekst”. Studiuesi Kujtim Rrahmani kur shtjellon tezën “Intertekstualiteti dhe oraliteti te Koliqi, Kuteli dhe Pashku”¹⁴⁷, mendimin e Barthes-it, që çdo

¹⁴⁷ Kujtim Rrahmani, “Intertekstualiteti dhe Oraliteti”, AIKD, Prishtinë, 2002.

tekst ka intertekst, e shtjellon më tej, duke shtuar se çdo tekst a shkrim ka oralitet si artikulum paraprak antropologjik i Fjalës, i Verbit. Edhe në temën tonë është pasur parasysh metoda e intertekstualitetit për të hulumtuar raportet e poezisë me prozën e Camajt.

Pothuajse të gjithë studiuesit janë të një mendimi, që intertekstualiteti në kuptimin e sotëm si dije e metodë, si teori dhe si praktikë analitike buron nga fundi i viteve '60 nga shkrimet e Julia Kristevës, e cila i referohet Mihal Bahtinit. Kur studiuesit ngulmojnë që praktikat e shkrimit intertekstual datojnë që prej Platonit dhe më herët dhe pastaj kalojnë nëpër palimpsestet, për të ardhur në modernitet me teorizimet e Barthes-it dhe Ecos dhe veprën letrare të Joyces dhe Borgesit, ne kemi arsye që këtë ta konkretizojmë me veprën e Camajt, i cili e ka shtresëzuar atë simbas konceptit të palimpsestit. Që në 1957-61, kur studionte në bibliotekën e Romës të parin libër të shqipes së shkruar "Mesharin" e Buzukut, Camaj mësoi se ç'janë palimpsestet. Dhe jo vetëm u vu në kërkim të tyre, po e konceptoi edhe tekstin e vet letrar me mbi shtresa e nënshtresa shumëkuptimore.

Intertekstualiteti në krijimtarinë e Martin Camajt, është kthyer në një nga parimet organizuese të ligjërimit të tij. Me këtë temë do të synojmë të zbulojmë e të konkretizojmë pika kontaktesh mes prozës dhe poezisë së Camajt dhe të bëjmë interpretime të kalimeve të ndërsjellta. Çfarë elementesh ka shtuar rrëfimtari nga kalimi poezi - prozë, çfarë ndryshimesh vijjnë si rezultat i zhvillimit dhe evoluimit të vetë autorit, apo edhe çfarë elementesh ndryshojnë për shkak të kalimit nëpër gjini të ndryshme.

Kalimi i shpeshtë nga njëra gjini në tjerën, ka bërë madje, që Camaj të provojë të ngërthejë edhe elemente të poezisë, si p.sh. rima të brendshme, figuracion eliptik, aliteracione, në prozën e tij, duke eksperimentuar me prozën poetike. Karakteristikë e përgjithshme e prozës së Martin Camajt është mëtimi i cili vihet që në faqet e para. Dimensioni i shtresës së fabulës arrin të modelojë artin tonë. E veçanta e veprave e tij është *arti i ligjërimit*, që ndërtohet me semiotikën e sipërfaqes së kompozicionit të shtruar urtë e butë. *Gjithnjë sipas Genette*, dallimi midis narracionit dhe përshkrimit është vetëm një kufi i brendshëm dhe padyshim

mjaft i pasigurt.¹⁴⁸ Vetë, Camaj për veprën e tij shprehet: “*Djella*” ka tiparet e “*Këngëve të Milosaut*”, si roman “*dyfish lirik*”, siç thotë De Rada për veprën e vet “*Këngët e Milosaos*”, “*Për romanin tim dyfish lirik*”. Nëse për “*Këngët e Milosaut* do të thonim se kemi të bëjmë me një roman në vargje, në rastin e “*Djellës*” kemi të bëjmë me një roman i cili na shfaq një lirizëm poetik. Këtë çështje e ka interpretuar edhe shkrimtari. Ernest Koliqi, ku mes të tjerash shkruan: “*Vargjet janë si ushima e ambëlsueme e ngjarjeve disi të zymta qi përmbajnë t’endëmen e tregimit.*”¹⁴⁹ Kjo formë të shkruarit është hap i guximshëm i autorit, në përpjekjet që poetika e romanit t’u afrohet formalistëve, si edhe artit eksperimentues evropian. Ai synon t’i thyejë kornizat klasike në shkrimin e romanit tonë. Për të depërtuar në poetikën e Martin Camaj, perifrazojmë mendimin e Ernest Koliqit, që në 1958 në parathënien që i bën “*Diellës*”, një libër në prozë, gërshetuar me poezi: “*Eshtë për t’u mrekullue e mandej për t’u gëzue se si ky pinjuell malesh din të harmonizojë primitivitetin me një zotnim të mjeteve ma të rafnueme t’artit letrar modern*”. Ndërsa, njohësi i thellë i letërsisë moderne, Giuseppe Valentini, ndër faqet e revistës kulturore “*Shejzat*”(*Le pleiadi*), ndër të tjera shënon: “*Duket, vepra si një kalim prej llojit poetik në lloj të prozes, prej fazes historike letrare të poezisë e atë të prozës, sidomos me ato lirika që mbyllin çdo kaptinë; n’anë tjetër, shi kto lirika janë aq moderne sa me na kujtue má fort fytyrën e Camajt se sa atë të njenit a tjetrit nder dy mësuera Kjo konsideratë thelbësore do të vijë deri në ditët e sotme, kur kemi në duar gjithë krijimtarinë gjysëm shekullore të Camaj dhe njohim sistemin e tij krijues.*”¹⁵⁰

Nga “*Djella*”, sprova e parë e Camajt në fushën e prozës, në procesin e përpunimit dhe të krijimit, autori hoqi gjithë atë që rëndonte veprën, futi ide e kuptime, e ngriti dhe pasuroi sistemin e shprehësisë poetike, por pa i humbur freskinë e mëparshme.

Lindin pyetjet:

¹⁴⁸ R. Uellek, O. Uoren, “Teoria e Letërsisë”, Tiranë, 1993, f. 203.

¹⁴⁹ E.Koliqi - Parathënia e romanit “*Djella*”, Romë, 1958.

¹⁵⁰ Giuseppe Valentini, Revista “*Shejzat*” III, f. 139, Romë, 1959.

- Si gërshetohet proza me poezinë?
- Në ç' rrafsh shihen këto lidhje?
- Mbi ç' bërthamë poetike është ndërtuar ky roman?

Para se të hyjmë në zhvillimet konkrete në këtë roman, do të flasim për llojin e veçantë të marrëdhënieve intertekstuale në këtë rast. Kemi marrëdhënie intertekstuale ku interteksti lidhet me:

- Diskursin, që do të thotë me atë çka rrëfëhet. Pra rimarrje të subjektit.
- Personazhet, që ripërfshihen në një tekst, duke sjellë një intertekstualitet të elementit personazh.
- Intertekstualitetin i situatave dhe imazheve, pra thjesht situata apo momente të caktuara të cilat rimerren nga teksti në tekst.
- Intertekstualitetin i ideve¹⁵¹, etj.

Më se shumti në romanin “*Djella*” do të shohim që intertekstualiteti është i llojit të rimarrjes së subjektit. Do të shohim më poshtë, që një motiv shumë i shkurtër nga poezia e Camajt, është rimarrë dhe shtjelluar padyshim me një zhvillim më të gjerë. Romani është në esencë rrëfim poetik i jetës djaloshare të Bardh Qerretit, në ambientin fshatar, ku ai si mësues vihet para sprovave të rënda e të shumta. Konkretisht objekt artistik është vetë bota fshatare dhe drama e jetës, vuajtjet dhe pësimet në procesin e shtegtimit, veprimin dhe të gjallërimit të malësorit në vorbullën e marrëdhënieve të vjetra në raport me të renë, dilemat dhe shqetësimet e vijueshme, virtytet, si: krenaria, urtia, nderi, sakrificat etj. Po vetë autori, ç'mendon për këtë roman?

“Ndër libra kisha lexue se vetëm në sipërfaqe të dheut mund të përzihej poezia e saktë e bukurisë. p.sh. në pikëzat e ujit mbi fletëzat e tërfonjës n'agim, në bucat e dheut e deri në fytyrat njerëzore. Asull, asull ato janë shkëndija. Kur fillova me i mbledhë ato shkëndija nëpër landët e jetës, u kujtova se për veprën time të madhe, që dojsha me shkruaj, poezia ishte e pakët...”. Poeti na thotë se i është dashur të mbledhë ato shkëndija, por për veprën e madhe që donte të shkruante poezia ishte e pakët. Dhe është

¹⁵¹ Kujtim Rrahmani, “Intertekstualiteti dhe Oraliteti”, AIKD, Prishtinë, 2002, f. 3.

detyruar t'i futet prozës. Në rrafshin tematik "Djella" lidhet me "Një fyell ndër male" dhe pjesërisht me "Kanga e Vërrinit".

Ideja e motiveve që zhvilloheshin në një ambient të caktuar, Camajt, i erdhi si reagim kundrejt propogandës së viteve '50 në diktaturat e reja komuniste të Lindjes: thuhej se një shkrimtar i saktë nuk duhej ta lente kurrë vendin, duhej të jetonte brenda popullit të vet, përndryshe mund të humbiste talentin: "Mirë, thosha unë me vete, propogandë kundër mërgimit të autorëve që ikin prej vendeve të tyre për të gjetë lirinë në perëndim, lirinë e fjalës së shkrueme , por megjithatë diçka të vertetë mund të ketë në këtën thanje!"¹⁵² Për t'i treguar vetes se nuk ishte shkëputur nga problemet shqiptare, Camaj kompozoi në "Djellën" dukurinë e dyndjeve të popullatës së Veriut, drejt fushave e qyteteve të Shqipërisë. Shpërngulja e njerëzve që si motiv e shoqëroi deri në fund të krijimtairsë së tij tek "Djella" sipas vetë Camajt u shpreh mbas një perdje edhe për t'u ra ndesh trajtave të anshme apo pajmbajtëse të realizmit socialist.

Pavarësisht se qëllimet e një autori mund të jenë shumë më të gjera se vepra e përfunduar, përsëri vepra vetë (në rastin tonë "Djella") mund të jetë ose nën nivelin e këtyre qëllimeve ose në krahasim me idenë fillestare. Camaj i ka qëndruar besnik idesë fillestare, hedhur që në poezinë "Para vargjeve të vjetra":

*"Ai rresht i vjetër krah-thatë
Më rrin përpara me shkrola të thyeme.
I prekun aty-këtu shpesh me penë të kuqe kullon gjak.
Atëherë isha mësuës katundi
E shkruesha për nxansen teme të sëmundë
Si mbas tingllit t'zhurmës së murrllanit
Që ulej mbi shakën e tërbueme tue vjellë
Gjak e qelb, buzë Kirit.
E më përlyente fëmijët
Varg i pazbutun*

¹⁵² M.Camaj, "Djella", Romë, 1958, f. 51

Dardhë e egër në shkamb. ¹⁵³

Lidhja është e qartë në vargun “*Isha mësues katundi*”, që në roman organizohet në strukturën “Subjekt-kompozicion-personazhe”¹⁵⁴.

“*Djella*” shquhet nga një renditje elementësh të subjektit. Fillimisht, dy kolegë që bisedojnë, Bardh Qerreti dhe Blerim Bushli. Bardhi vendos të tregojë. Këtu autori bën një kthim prapa.

Ai i tregon kolegut për ato që kanë ndodhur në fshatin e Ndërsanës. Pastaj variohet në skemën përmyllëse të përfundimit të bisedës mes tyre. Tani poeti nuk shkruan më për “nxansen teme t’smundë”, por për një “vashë që për lehtësi po e quajmë Djellë”.

Rrëfimi i personazhit është në thelb i vetë autorit. Kjo mënyrë bën që Camaj të jetë i përfshirë në gjendjen emocionale të personazhit. Tërësia e detajeve të zgjedhura, të proceseve të të menduarit të personazheve, të ndjenjave, të fizionomisë së tyre, përbëjnë procesin e analizës. Në roman mbizotëron emocioni dramatik. Ky parim i ndërtimit të tyre, i shkon për shtat zbulimit të botës së brendshme të Camajt, që i ngjan, “*një reje që ka mbetë në qiellën e hapët, barkë e vetmueme në det, një shkamb në shpirt.*”¹⁵⁵

Gërshetimi i poezisë dhe prozës e bën veprën një strukturë të ndërlikuar dhe fragmentare: “*Krijimi im letrar ka diçka fragmentare në vetvete, dhe për këtë fajin e ka koha jonë, edhe ajo ishte fragmentare, aritmike në rrjedhën e vet.*”¹⁵⁶

Ndryshe nga poezia “Para vargjeve të vjetra”, në “Djellën” përshkrimi merr gjallëri. Këtë e vë re dhe Koliqi kur shprehet:

“*Tue shqyrtue imtë tekstin, vërehet se në prozë, ai paraqet përshkrimet veriste me një çiltërsi guximtare.*”¹⁵⁷

Pra “Djella” është pasqyrë e jetës së tij, të cilën e mediton herë në formën e poezisë, herë të prozës.

¹⁵³ M. Camaj, “*Djella*”, Romë, 1958, f. 58.

¹⁵⁴ Uoren dhe Uellek, “*Teoria e letërsisë*”, Tiranë, 1993, f. 137.

¹⁵⁵ Anton Berisha, “*Hylli i dritës*”, Tiranë, 1994, nr. 1-2, f. 23.

¹⁵⁶ M. Camaj, *Vepra letrare 2*, f. 153

¹⁵⁷ E. Koliqi, *Parathënia e “Djellës”*, Romë, 1958.

Romani ka njëzet e një kapituj të shkruar në formë të shkurtër, me po kaq poezi. Në faqet e kapitullit të fundit (XXI) paraqitet një dialog konkret, ku heroi i jep fund “*historisë së poezive të veta*”, kurse mësuesi i ri merr rolin e dëgjuesit, lexuesit e rrëfyesit.

Thurja e romanit “*Djella*” është e lidhur ngushtë me emocionet e rrëfyesit që ka njohuri mbi artin, ëndërron të bëhet poet. Vetë autori-rrëfyes e konsideron veprën “*si nye e pazgjidhun në vargun e veprave në prozë*”. Ndërsa Kadare do të shprehej: “... *Në art asgjë e epërme nuk është e përjashtuar, e aq më pak përjashtuese. Kështu janë poezitë e Camaj, romani i shkurtër "Djella", me shoqërimin poetik, që si një pasqyrë iu hap udhë rreshtave të prozës...*”¹⁵⁸

“Romani ka dy linja rrëfimi; një në veten e parë dhe një në veten e tretë, që ndryshe mund të quhet edhe narracion me perspektivë e retrospektivë. Pastaj aty shfaqen edhe dy gjini letrare në prozë e poezi. Metafora konsiderohet figurë e poezisë, ndërsa të shprehurit në metonimi është figurë e prozës.”¹⁵⁹

Ribotimi i dytë i romanit “*Djella*” është i përmirësuar nga autori më 1990, prandaj edhe shkruan: “(...) *më rroku shija e shkoklimit të motiveve dhe të trajtave gjuhësore. Thellimi në teksturën e vjetër u përzie vetvetiu prej faqe në faqe me trajtat e stilit që kam sot, mbas 35 vjetësh.*”¹⁶⁰ Me sa shohim më lart, nuk kemi të bëjmë vetëm me një rimarrje, por një ripërpunim jovetëm në kuadër të përfshirjes në një gjini shumë të ndryshme nga poezia, siç është proza, por edhe me ndryshime të shumta konceptuale. Padyshim që shkrimtari ka ndier një shqetësim dhe nevojë për të rimarrë këtë motiv, që do të thotë se ai e dinte se duhej plotësuar.

Na duhet të vemë në dukje se këto marrëdhënie ndërmjet teksteve nuk janë të dukshme, të drejtpërdrejta. Do transferonim në lidhje me rastin e Camajt, një vërejtje të bërë nga studiuesi

¹⁵⁸ Kadare Ismail, gazeta “*Panorama*”, 11 shkurt 2010.

¹⁵⁹ Hyrjet Berisha - Proza e Martin Camajt.

¹⁶⁰ M.Camaj- Vepra letrare 1, “*Apollonia*”, Tiranë, 1995.

Kujtim Rrahmani për Koliqin. “Në aspektin vizual, ato nuk dallohen me ndonjë shenjë tipografike, si me italike apo diçka tjetër që ka të bëjë me shenjat e jashtme tekstore. Madje, te Koliqi nuk ka citate, kolazhe e brilokazhe të tekstit që shkojnë kah moderna eksperimentuese, në kuptimin e ekstravagantes: këtu diskurset heterogjene jepen të shkruara në intertekst së brendshmi, gradualisht dhe pahetueshëm.¹⁶¹ Karakteristikë e përgjithshme e prozës së Martin Camajt është mëtimi i cili, vihet re që në faqet e para. Dimension i shtresës së fabulës arrin të modelojë artin tonë. “Djella nuk asht një romanx çfaredo Asht një vepër qi po u lexue me vëmendje e me kujdes, sikur e meriton, të ban me u mendue thellë.... Asonancë e kundërpiktë e mrekullueshme qi e harmonizon dhe e kuilibron krejt shtjellimin e romanxit tue i dhanë këtij një rythem lirik të përkryem”¹⁶². Studiuesi dhe miku i ngushtë i Camajt Ernest Koliqi shkruan: “N asnjërin, veç prej tyne nuk tingëllon ende në mënyrë aq të spikatun si ke Camaj, i cili qysh tash mund të ndjehet përtrisi i një rrymbe së re në letrat shqiptare, rrymbë e shqueme prej një çveshjeje nga çdo zbunim retorik e për një prirje me zbulue në vetvete në të tjerë vetit ma të strkuna në skuta të vetdijes dhe n errsit e mystershme të nënvetdijes”.

Intertekstualiteti është kthyer në një nga parimet organizuese të ligjëritimit të tij.

Edhe në prezantimin e këtij punimi është pasur parasysh metoda e intertekstualitetit për të hulumtuar raportet e poezisë me prozën e Camajt. Edhe Camaj “si shëmbues i të tijve”¹⁶³, është shembulli i prozatorëve, që e kanë nisur me poezi dhe pasi kanë debutuar me sukses aty, me fillin e motiveve të saj, kanë endur prozë, duke e zgjeruar e shndërruar vargun në rresht dhe vjershën në novelë, apo në roman.

Në këtë kontekst Camaj mund të cilësohet si shkrimtari, të cilit asnjëherë brenda vetes nuk iu nda poeti nga prozatori, së pari se vazhdoi të shkruante e të botonte poezi gjer në fund, krahas lëvritimit të prozës dhe së

¹⁶¹ Kujtim Rrahmani, “Intertekstualiteti dhe Oraliteti”, AIKD, Prishtinë, 2002, f. 55-56.

¹⁶² Viktor Koliqi, “Tue lexue Djellen”, revista “Shejzat”, Romë, III, nr . 3-4, f. 102-107.

¹⁶³ Aurel Plasari- “Camaj si shëmbues i të tijve”, gazeta “Drita”, 22 qershor 1967.

dyti, çka është dhe më e rëndësishme, proza e tij asnjëherë nuk qe pa indin e poezisë si thurje metaforike, simbolike, etj. Vetë Camaj shprehet: “*Nuk do veçue proza nga poezia, sadopak në rastin tim. Në “bazë” e mbaj veten lirik dhe proza është mjet për zgjanimin e mundësisë shprehëse , diçka eksplikative.*”

Marrëdhëniet e intertekstorësisë kanë një lidhje shumë të fuqishme me kontekstin në të cilin u krijua romani “*Djella*” dhe në të cilin ishin krijuar poezitë e mëparshme. Padyshim që nuk mund të mos e rikontekstualizojmë situatën në këtë ndërveprim, pasi është i rëndësishëm fakti se më parë është botuar poezia, për të dalluar tekstin nistor nga teksti mbërritës. Është e dukshme që në një rast të tillë nuk ka mundësi të mos e lëmë pa përmendur kontekstin, edhe nëse do ishte një konstatim intuitiv.

Ndaj, themi se një marrëdhënie e tillë ndërmjet dy teksteve, njërit poetik dhe tjetrit në prozë, është bazuar në një ndryshim koherent që qëllimisht Camaj ka realizuar ndërmjet dy teksteve. Në rastin e Martin Camajt intertekstualiteti është edhe më i theksuar, sepse kemi të bëjmë me një autor që luajti me tiparin modern, duke qenë i vetëdijshëm për atë çka bënte.

Studiuesi Arshi Pipa shkruan: “*Djella*’, asht një pjesë e episodeve narrative, e përcjellë me vjersha të cilat shpërftyrojnë narracionin përmes lirizmit.”¹⁶⁴

PËRFUNDIM:

Kjo formë të shkruari është hap i guximshëm i autorit, në përpjekjet që poetika e romanit t’u afrohet formalistëve, si edhe artit eksperimentues evropian. Ai synon t’i thyejë kornizat klasike në shkrimin e romanit tonë. Nga “*Djella*”, sprovë e parë e Camajt në fushën e prozës, në procesin e përpunimit dhe të krijimit, autori hoqi gjithë atë që rëndonte veprën, futi ide e kuptime, e ngriti dhe pasuroi sistemin e shprehësisë poetike, por pa i humbur freskinë e mëparshme.

¹⁶⁴ A. Pipa, “*Hylli i Dritës*”, Tiranë, 1994, f. 23.

Më sa parashtruam në romanin “Djella”, shënuam që, intertekstualiteti paraqitet në llojin e rimarrjes së subjektit. Një motiv shumë i shkurtër nga poezia e Camajt, është rimarrë dhe shtjelluar padyshim me një zhvillim më të gjerë në romanin “Djella”.

Në këtë kontekst nuk kemi të bëjmë vetëm me një rimarrje, por një ripërpunim jovetëm në kuadër të përfshirjes në një gjini shumë të ndryshme nga poezia, siç është proza, por edhe me ndryshime të shumta konceptuale. Padyshim që shkrimtari ka ndier një shqetësim dhe nevojë për ta rimarrë këtë motiv, që do të thotë se ai e dinte se duhej plotësuar. “*Thellimi në teksturën e vjetër u përzi vetvetiu prej faqe në faqe me trajtat e stilit që kam sot mbas 35 vjetësh. Ballafaqim edhe me struktura shpirtnore të lashta. Përblumja e tyne më solli bindjen se kjo vepër edhe në këtë trajtë të përpunueme qëndron si nye e pazgjidhun në vargun e veprave në prozë që ndoqën , shegë e mbyllun së cilës i ka plasë vetëm lëvorja*”.¹⁶⁵

Martin Camaj, është poet dhe prozator modern, që u pranua shumë vonë në Shqipëri. Hartuesi i jë vepre të hapur sërish paraqet shtigje të reja në këndvështrime të ndryshme interpretimi dhe njohje.

BIBLIOGRAFIA:

1. Martin Camaj , “Djella”, Romë, 1958.
2. Martin Camaj , Vepra letrare 1, “Apollonia”, Tiranë, 1995.
3. Kujtim Rrahmani, “*Intertekstualiteti dhe Oraliteti*”, AIKD, Prishtinë, 2002.
4. R. Uellek, O. Uoren, “Teoria e Letërsisë”, Tiranë, 1993, f. 203.
5. A. Pipa, “Hylli i Dritës”, Tiranë, 1994.
6. E.Koliqi - Parathënia e romanit “Djella”, Romë, 1958.
7. Revista “Shejzat” (le Pleiadi), Romë, 1958-59.
8. Kujtim Rrahmani, *Intertekstualiteti dhe Oraliteti*, AIKD, Prishtinë, 2002.
9. Ismail Kadare, gazeta “Panorama”, 11 shkurt 2010.

¹⁶⁵ Martin Camaj, Vepra letrare 1 (parathanie), “Apollonia”, 1995.

10. Anton Berisha, “Hylli i Dritës”, Tiranë, 1994, nr.1-2.
11. Maria Pia Pozzato, “Semiotika e tekstit” (përktheu Dhurata Shehri), UET/PRESS. Tiranë, 2009.

Intertexture relationship between Martin Camaj’ poetry and prose. “Djella”

The object of this paper is the intertexture relationship between Martin Camaj’ poetry and prose, where the source text is poetry, which transmits its elements to the prose. These elements are different, migrating from poetry to subjects, characters, situations, even details. This approach to the intertexture relationship between Camaj’ poetry and prose requires at first support in the theoretical opinion of Barthes according to which "*every text contains intertext*". Intertextuality in Martin Camaj’s creativity has become one of the organizing principles of his speech. Through this paper we try to discover and materialize the points in common between Camaj’s prose and poetry and make interpretations of bilateral crossing. What elements has the narrator added through this crossing - prose, poetry what changes are the result of the development and evolution of the author himself, or even what elements change due to the passage through various genres .

MARTIN CAMAJ DHE ALBANOLOGJIA E GJYMTUAR

Për të dytën herë qyteti i Shkodrës dëshmon dashamirësinë e vet për të përkujtuar figurat më të nderuara të kombit, që diktatura komuniste me të padrejtë i njollosoi, i përçmoi dhe i la në hije, me qëllim që të harrohen duke mohuar kontributin e tyre. Me këtë akt Shkodra dëshmon ndjeshmërinë e saj jo vetëm për personalitetet e ndritur, që punuan për vendin, gjuhën dhe kombin, por edhe për ata që u denigruan e u mohuan në regjimin diktatorial të së kaluarës. Me këtë rast qyteti i lashtë verior me tradita kryen detyrën e tij qytetare ndaj intelektualëve të persekutuar nga regjimi 50-vjeçar komunist.

Martin Camaj bën pjesë në elitën intelektuale, me një prodhimtari shkencore e artistike të admirueshme, të zhvilluar larg vendlindjes, i shkëputur nga fijet legale që mund ta lidhnin me atdheun dhe gjuhën shqipe. I larguar në moshë të re nga Shqipëria, ai pati rastin të merrte një formim gjuhësor e letrar të plotë, të pandikuar nga ideologjitë totalitare. I ndodhur në mjediset më të kulturuara të emigracionit shqiptar, punoi me ndjeshmërinë e një artisti dhe me këmbënguljen e një shkencëtari.

Fushat e albanologjisë që lëvroi, janë historia e gjuhës dhe shqipja e sotme, në veçanti, dukuritë historike në fushë të fonetikës, morfologjisë dhe fjalëformimit, autorët e vjetër, gramatika e sotme, të folmet arbëreshe, dokumentet e lashta, analiza etimologjike etj. Camaj na ka dhënë në një botim të plotë njëherë nga veprat më të rëndësishme të letërsisë e gjuhësisë shqiptare, “Çetën e profetëve” të Pjetër Bogdanit, që ka shërbyer si burim studimi për shumë albanologë. Për autorët e tjerë spikasin studimet për shkrimtarin e parë shqiptar, Gjon Buzukun, veprës së të cilit i ka kushtuar një monografi dhe disa artikuj. Në fushë të gramatologjisë ka hartuar anglisht veprën “Albanian Grammar”, si përpunim i një vepre të botuar më

parë gjermanisht, “Lehrbuch der albanischen Sprache”. Kjo vepër përfaqëson një rën nga gramatikat më të mira të botuara për gjuhën shqipe deri në ditët tona. Vepra tjetër, “Albanische Wortbildung”, nëpërmjet analizave të hollësishme etimologjike, trajton rrugët historike të krijimit të fjalëve të reja në gjuhën shqipe nga dukuri të lashta morfonologjike. Në të është trajtuar me tërë gjerësinë e saj apofonia, si mjet i krijimit të fjalëve të reja, duke pasur kështu vepra vlera të shumëfishta jo vetëm për formimin e fjalëve, por edhe për fonetikën e morfologjinë historike, për etimologjinë dhe vendin e shqipes në prehrin e gjuhëve indoevropiane sipas tipareve të saj dalluese. Së fundi, vëmë në dukje veprat me karakter dialektologjik, që shkroi ai pas kontakteve që pati me të folmet arbëreshe të Italisë, kontakte të shpeshta me karakter shkencor, që i dhanë mundësi të trajtonte në monografi të veçanta të folmet e Barilit dhe të Shën Konstantinit në krahinë të Potencës, të folmen e fshatit Gréqi në krahinë të Avelinos dhe të folmen e Falkonarës së Kozencës. Për dëshmitë e vjetra të gjuhës shqipe, ai bëri të njohur dokumentin “Letra e Gashit”, të cilin me komentet përkatëse e botoi në revistën “Zeitschrift für Balkanologie” në bashkëpunim me historianin Peter Bartl; kurse në revistën “Zjarri” botoi një dëshmi të vitit 1483 nga dialekti arbëresh, që flet për lashtësinë e gjuhës shqipe.

Krahas këtyre veprave me peshë në albanologji, Martin Camaj ka dhënë një kontribut të vyer edhe si kryeredaktor i revistës “Shêjzat”, revista më e njohur e emigracionit, por edhe më e anatemuara nga komunizmi, rreth së cilës u grumbulluan personalitetet më të shquara të emigracionit me Ernest Koliqin në krye. Kontribut tjetër të vlefshëm ka dhënë ai edhe në katedrat albanologjike të emigracionit, në fillim në Romë dhe pastaj në Mynih, kjo e fundit e krijuar me nismën dhe punën e tij këmbëngulëse.

Por, mjerisht, me gjithë këto kontribute kaq të vyera, emri i Martin Camajt nuk përmendej askund në botimet albanologjike deri në vitin ’90, që shënon rënien e komunizmit dhe të pushtetit diktatorial. Arsyeja dihet: ndaj këtij gjuhëtari u mbajt qëndrim politik. Arratisja e tij nga Shqipëria më 1948 ishte e mjaftueshme për të përcaktuar qëndrimin e tërë albanologjisë që zhvillohej brenda kufijve të shtetit shqiptar ndaj këtij personaliteti të letrave të shqipes. Ai nuk mundi asnjëherë gjatë jetës së tij të vinte në

Shqipëri. Kontaktet e tij me gjuhën dhe shqiptarët i mbante vetëm me arbëreshët e Italisë dhe shqiptarët e emigracionit; kurse në atdheun e tij kishte heshtje të plotë. Askush s'mund ta përmendte emrin e atij që kishte sfiduar regjimin për të fituar lirinë.

Në heshtje të plotë lihet emri i Camajt në "Fjalorin enciklopedik shqiptar", të botuar më 1985, një fjalor tejet i politizuar. Emri i Martin Camajt nuk figuron gjëkund as në "Bibliografinë e studimeve dhe të artikujve për gjuhën shqipe", ku përfshihet periudha 1945-1974 dhe është hartuar nga studiuesi Palok Daka. Është e pamundur që autori i kësaj vepre të mos i ketë njohur veprat e artikujt gjuhësorë të Martin Camajt, vendlindjet e të cilëve nuk ishin larg njëra-tjetrës. Por heshtja ndaj këtij personaliteti të letrave shqipe, e diktuar nga autocensura dhe vetëmbrojtja, kishte nisur shumë më herët në lagjen e albanologëve. Më 1966 botohet nga Selman Riza "Pesë autorët më të vjetër të gjuhës shqipe", dhe, megjithëse në bibliografi janë shënuar edhe vepra të pabotuara, emri i Martin Camajt, që për shkrimtarin më të vjetër kishte botuar monografinë më të plotë deri në atë kohë, nuk përmendet gjëkund. Më 1968 botohet nga Eqrem Çabej "Meshari" i Buzukut, por përsëri emri i Martin Camajt dhe studimet që kishte bërë për këtë autor të lashtë lihen në heshtje. Ai mungon gjithashtu në bibliografinë e studimeve etimologjike të Çabejt, ndonëse është ndër gjuhëtarët e pakët që është marrë me këtë fushë. Megjithatë, emri i tij nuk ishte i panjohur për etimologun e shqipes, gjë që del nga leximi i veprës së tij, ku në disa raste përmendet emri i gjuhëtarit të mërguar, por vetëm për ta kundërshtuar. Vetëm kjo i lejohej Çabejt.

Në "Dialektologjinë shqiptare" të botuar më 1975 nga Jorgji Gjinari nuk përmenden gjëkund veprat e Martin Camajt, i cili deri në atë vit kishte botuar disa studime të rëndësishme në këtë fushë për të folmet e dialektit arbëresh. Se sa i është kushtuar Camaj fushës së dialektologjisë para dhe pas këtij viti mund ta konstatojmë nga bibliografia e të njëjtit tekst, të botuar më 1997 në vitet e demokracisë, ku janë përfshirë gjithsejt tetë zëra, monografi e artikuj, të këtij albanologu.

Në "Gramatikën historike të gjuhës shqipe" të botuar nga Shaban Demiraj më 1986 nuk figuron gjithashtu emri i Martin Camajt, ndonëse ai

kishte botuar disa studime me vlerë në këtë fushë, sidomos monografinë “Albanische Wortbildung” dhe artikullin “Ich bin” und “ich habe” im Albanischen”.

Nuk mund të fajësojmë autorët e këtyre veprave, që të gjithë shkencëtarë të shquar, për këtë gjymtim që i bëhej albanologjisë, i cili rridhte nga orientimi i detyruar zyrtar i shtetit totalitarist për këdo që donte të botonte në atë periudhë. Dhe e keqja e kësaj politike të mbrapshtë heshtjeje dhe denigrimi 50-vjeçar vijoi edhe në vitet e mëvonshme pas vendosjes së demokracisë, diku nga mosnjohja, nga mungesa e materialeve ose nga inercia për të mos e përmendur. Kështu, në “Gramatikën e gjuhës shqipe , pjesa I”, të shkruar nga një grup autorësh dhe të botuar më 1995, nuk përmendet gramatika e Martin Camajt, ndonëse ajo është ndër më të mirat e kësaj fushe. Në veprën “Fonologjia historike e gjuhës shqipe”, të botuar më 1996 nga Shaban Demiraj, nuk përmendet gjithashtu emri i tij, ndonëse në këtë fushë ai ka disa studime me vlerë, sidomos për apofoninë e metafoninë, për zanoret hundore, për jotizimin e bashkëtingëlloreve qiellzore etj. Dhe për të qenë objektiv deri në fund, kësaj rryme nuk i ka shpëtuar as lexuesi i këtyre radhëve. Në bibliografinë e monografisë “Për historinë e zanoreve hundore në gjuhën shqipe”, megjithëse janë shënuar dy zëra të këtij albanologu, “Il “Messale” di Gjon Buzuku” dhe “Zur Entwicklung der Nasalvocale der slavischen Lehnwörter im Albanischen”, është lënë jashtë artikulli “Për vokalin nazal ke Buzuku”, botuar në revistën “Shêjzat”, nr. 5 - 6, 1959, koleksioni i së cilës është zhdukur nga Biblioteka e Institutit të Gjuhësisë që në vitin ’92 dhe nuk është zëvendësuar as sot e kësaj dite. Kjo mangësi është korrigjuar më vonë në veprën “Fonetika historike e gjuhës shqipe”.

Kjo politikë e mbrapshtë që u ndoq ndaj këtij gjuhëtari brenda vendit tonë, u ndoq edhe në Kosovë, ku siç pohon Esat Mekuli, nga Dushan Mugosha ishte dhanë urdhën për mos me botue asnjë send nga Martin Camaj te “Jeta e re”. E megjithatë, ka pasur gjuhëtarë që në veprat e tyre e përmendin gjuhëtarin e madh duke ia njohur vlerat. Kështu, në bibliografinë e veprës “Rruga e formimit të fleksionit të sotëm nominal të shqipes”, të botuar në Prishtinë më 1980 nga Besim Bokshi gjendet edhe

monografia e Camajt “*Il “Messale” di Gjon Buzuku*”. Edhe Rexhep Ismajli e citon atë në artikullin “Sistemi i bashkëtingëlloreve të gjuhës së “Kuvendit të Arbënit” (1706)”, botuar në Prishtinë më 1984.

Vala denigruese dhe e mosnjohjes nga regjimi totalitar ka përfshirë edhe albanologë të tjerë. Namik Resuli, një tjetër albanolog i shquar i diasporës që mundi t’i shpëtojë ferrit komunist, u rrethua gjithashtu nga heshtja dhe mohimi. Filolog, gramatikan, historian i letërsisë, studiues i teksteve të vjetra, drejtor i Institutit të Studimeve Shqiptare në Universitetin “La Sapienza” të Romës, punën e tij më të madhe ia kushtoi transkriptimit, komentimit dhe botimit të veprës më të hershme të shkruar në gjuhën shqipe, “Mesharit” të Buzukut, e cila u shërbeu shumë dijetarëve nga vende të ndryshme për vite me radhë, madje, edhe pas botimit të saj 10 vjet më vonë nga Eqrem Çabej, vepra e të cilit mbeti e kyçur në depot e Institutit të Gjuhësisë, e cilësuar si “vepër me përmbajtje fetare”. Edhe vepra e Resultit, ashtu si e Martin Camajt dhe shumë albanologëve të tjerë të emigracionit, mbetën të panjohura, të pashfrytëzuara dhe të pavlerësuara shkencërisht. As atij nuk iu lejua asnjëherë të shkelte në atdhe.

Një tjetër albanolog që pati të njëjtin fat ka qenë Arshi Pipa. I arratisur edhe ky nga shteti i telave me gjemba, zhvilloi aktivitete të shumta në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, por mbeti krejt i panjohur në Shqipëri, ku çdo vepër a artikull që mbante emrin e tij, ishin tepër rezervate. I panjohur mbeti në Shqipëri edhe Zef Valentini, historiani, etnologu, gjuhëtari, botuesi dhe dijetari me zemër shqiptare, njohësi i rrallë i historisë, etnologjisë, gjuhës dhe çdo gjëje shqiptare, botues i veprës madhore në 27 vëllime “*Acta Albaniae Veneta*”. Edhe ky u denigrua dhe u sulmua keqas nga diktatura. Mund të radhiten edhe mjaft emra të tjerë me kontribute në albanologji, ndaj të cilëve u mbajt i njëjti qëndrim, si: Ernest Koliqi, Mustafa Kruja, Jakë Marlekaj etj.

Duke mbajtur diktatura një qëndrim të tillë ndaj albanologëve që punuan në emigracion, albanologjia brenda kufijve të shtetit shqiptar mbeti si një trup i gjymtuar, së cilës i mungonte njëri krah i saj. Dhe ky krah i gjymtuar sot ka nevojë të shërohet. Le të shërbejë ky simpozium si një sinjal për njohjen më të mirë të veprave albanologjike të Martin Camajt. Le

të shpresojmë që vepra e tij, e shpërndarë në libra e revista të huaja, e shkruar, një pjesë në shqipe, e pjesa tjetër në 4 gjuhë të huaja, të shohë më në fund dritën e botimit, për ta bërë më të afërt veprën e këtij shkencëtari për lexuesin shqiptar kudo që ndodhet, meqenëse fondi i tij gjuhësor gjendet me të njëjtën vështirësi si ai i albanologëve të huaj, në një kohë që ai qe një shqiptar i madh, që tërë jetën ia kushtoi atdheut dhe kombit, ai që me gjallje të tij kishte shkruar:

Kur të vdes le të bahem gur
në skajin e vendit tem
që qindroj kufi.

M. Camaj and disabled albanologjia

Martin Camaj, with his remarkable scientific research and huge artistic creations, is part of the intellectual elite of Albania. He lived away from his birthplace, disconnected from the legal lines that might have jointed with his own country and the mother language. But however, his significant contributions, unfortunately, has never been mentioned in the albanological publications until 1990, the period of the collapse of communism and the dictatorial power. This attitude has been of political character, and this denigrating wave of the totalitarian regime has as well included other albanologists as Namik Resuli, Arshi Pipa, Zef Valentini, Ernest Koliqi, Mustafa Kruja, Jakë Marlekaj etc.

Tomor OSMANI (Shkodër)

KONSIDERATA GJUHËSORE TË MARTIN CAMAJT PËR GJUHËN LETRARE SHQIPE DHE NDIHMESA E TIJ PËR NJË AFRIM NDËRDIALEKTOR

Martin Camaj, ky albanolog me emër erdhi vonë në vendin tonë, por jo në letërsinë shqiptare. Vdiq larg atdheut, pa mbushur 70 vjet, duke jetuar në mërgim më shumë se gjysmën e jetës. Megjithatë dashuria për atdheun, malli për vendlindjen, si dhe pasioni për gjuhën dhe letërsinë bënë që atdheun e tij të dashur të mos ta kujtojë vetëm në emisione radiofonike, por duke shkruar vepra letrare në gjuhën shqipe, si dhe duke u marrë me studime gjuhësore dhe me botimin e tyre. Kështu interesat e tij gjuhësore kanë rrokur një spektër të gjerë sa në grafi, fonetikë, morfologji, tekstologji, duke i parë dhe përshkruar dukuritë gjuhësore të shqipes si në rrafshin sinkronik, ashtu edhe në atë diakronik.

Veprimtaria gjuhësore e Martin Camajt mund të fokusohet në këto drejtime:

- Studime gjuhësore për autorët e vjetër dhe fjalëformimin-
Studimet dialektore- Tekste gramatikore;

Një ndër aspektet më të rëndësishme të M.Camajt është se veprën nuk e shkroi për një lexues të zgjedhur, por përmes saj desh të komunikojë me të gjithë shqiptarët, ndonëse kontaktet me ta ishin tepër të kufizuara. Camaj, krahas problemeve të tjera që ka ngritur në studimet e tij, ka dhënë edhe disa konsiderata gjuhësore për gjuhën letrare shqipe, kryesisht në gramatikën e tij të botuar në anglisht në vitin 1984 dhe të përkthyer në italisht në vitin 1995, si dhe në letërkëmbimin që ka pasur me kolegët e tij. Është për t'u vlerësuar Camaj se nuk ka qenë një shkrimtar as konservator dhe as fanatik që veprën ta shkruajë me një gegërishte arkaike, larg shqipfolësit të sotëm të saj. Me të vërtetë e vlerëson traditën e largët

shkrimore, por di të çmojë atë që është racionale. Gjithashtu ka ndjekur përfundimet e Kongresit të Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe të vitit 1972. Sigurisht që nuk është pajtuar me të gjitha zgjidhjet, kryesisht me bazën dialektore të tij. Duke qenë një njohës i mirë i gjuhës së autorëve të vjetër, pasi pikënisja e studimeve shkencore të tij fillon me gjuhën e tyre dhe veçanërisht me *“Mesharin”* e Buzukut dhe pastaj vazhdon me pasardhësit. Kështu ai i ka të qarta të gjitha evoluimet gjuhësore të shqipes gjatë shekujve. Për këtë arsye, ndoshta, duke u nisur edhe nga historia e gjuhëve letrare evropiane, mbron tezën se gjuha e mirëfilltë letrare fillon me veprën e Pjetër Bogdanit *“Çeta e profetëve”*, me poezitë popullore dhe fetare të veprës së Pjetër Budit, me *“Gjellën e Shën Mërisë Virgjër”* të Jul Varibobës(1762). Zbërthimi i kësaj teze është me vlerë për historinë e gjuhës së shkruar shqipe. Problemin autori e çon edhe më tej, duke kërkuar që normalizimi i gjuhës letrare shqipe duhet ta kërkojmë që në shekullin XVI me Gjon Buzukun.

Po ta vërejmë veprën e Camajt në këtë rrafsh, njëkohësisht, duke u mbështetur edhe në pohimet e tij, ai është për gjithëpërfshirjen e pasurisë gjuhësore të shqipes së shkruar në strukturat themelore sipas shembullit të gjuhëve më të zhvilluara evropiane. Por, për Camajn një dialekt nuk i përmbush nevojat e një gjuhe kulture. Gjuha duhet të pasqyrojë gjithë arealin gjuhësor. Dhe këtë e mbështet duke iu referuar veprës madhore për kohën të Pjetër Bogdanit *“Çeta e profetëve”*, i cili e pau të pamundshme që e folmja e krahinës së tij të plotësojë të gjitha dëshirat e autorit, prandaj iu drejtua *“dheut të Shkodrës”* jo vetëm për rritur leksikun e veprës së tij, për të pasuruar fjalorin, por edhe strukturat sintaksore dhe stilistike. Dhe dihet se vepra e Bogdanit në këtë rrafsh dallohet qartë nga veprat e paraardhësve.

Për autorin *“njohja e plotë e teksteve të vjetra, veçanërisht atyre gegërisht, që janë afër me strukturën e toskëristes, do të kishin ndikuar për të zgjidhur shumë probleme për standardizimin e gjuhës letrare lehtë dhe pa dhimbje.”* Autorin e shqetëson fakti se gegërishtja nuk u shfrytëzua me atë potencial të madh që kishte, duke ditur se ai i përkiste atij grupi që përdorte variantin letrar verior. Edhe Camaj ka parasysh atë vlerësim që i bënte shkrimtari Ernest Koliqi gjuhës shqipe, e cila *“asht gjuhë e pasun*

edhe sqimatore. Ka në vetvete gjallni kromatike dhe hire muzikore...” Në veprën “*Shija e bukës së mbrueme*”(1960) Koliqi jep këtë këshillë : “*Me 200 fjalë të mësueme në rreth shpiak nuk krijohet një letërsi.*” Dhe Camaj e pati parasysh një fakt të tillë, pasi vepra e tij shquhet për një leksik të pasur, vjelë nga ligjërimi popullor, por edhe duke krijuar fjalë të reja sipas gjedheve të gjuhës popullore. Kështu që vepra mund të vlerësohet në këtë aspekt, pasi ai nuk shquhet për ngurtësi, por përpiqet të jetë sa më afër gjuhës së popullit, ta paraqesë atë në nivelet e kërkuara, të pasqyrojë vetë zhvillimin e gjuhës shqipe në këtë shekull. Prandaj ai zbatoi disa kriere që e udhëhoqën në hartimin e veprës, si për drejtshkrimin, strukturën gramatikore, fjalëformuese dhe leksikore. Camaj krijoi fjalë të tilla, si: *kuvendtar, mbresje, heshtoj, kunuroj, qellimoj*, i veshun *kombtarisht, nynyrim* onomatope, flas pa kuptim *përdhimbët* = ngushëlloj, *gjygjërim* = arsyetim, *prapoj*=largoj, *kërkloj*=kërcas, *hyzjoj* (jetën fshatare), *përkënaqej*. Është e vështirë të caktohet kufiri për autorësinë e mjaft fjalëve të trashëguara, si: *i plajtë*= i shtrirë, *plang*=truall, *mên*= hesht, *ngjom* = njom, *mëngji* = magji, *gjamatar, shqekë, idhnia* etj.

Camaj kërkoi të shkruajë një shqipe me prirje afruese. Ky është kodi që zbatoi në veprat e tij. Fillimisht u nis nga zgjidhjet që kishte bërë në këtë fushë Komisia Letrare Shqipe e Shkodrës (1916-1918), si në rrafshin drejtshkrimor dhe gramatikor. Autori, duke pasur sens gjuhësor dhe përgatitjen filologjike, duke studiuar veçoritë fonetike-drejtshkrimore dhe gramatikore, si në aspektin sinkronik, por edhe diakronik, arritjet e KLSH të Shkodrës i çoi edhe më tej. Në sajë të këtyre faktorëve gjuhësorë dhe jashtëgjuhësorë, vepra e Camajt pati dhe ka jehonë, lexohet pa vështirësi dhe për mendimin tim, sot për sot është një gjedhe e gegërishtes letrare, fakt që e kanë venë në dukje edhe studiues të tjerë, se “*gegërishtja* (e M.Camajt, T.O.) *paraqitet si gegërishte letrare e standardizuar*”(B.Beci) dhe se “*gjuha e Camajt, për nga drejtshkrimi e trajtat gramatikore është një gegërishte letrare e kodifikuar me prirje afruese ndërdialektore*”, ku te Camaj vërehet “*përprjekja e tij për kodifikim në lëmin e drejtshkrimit dhe të gramatikës.*”(K.Topalli).

Përpyekjet për kodifikim, kryesisht për të mënjanuar në shumë raste trajtat e ngushta dialektore vihen re si në drejtshkrim, fonetikë dhe në strukturën gramatikore. Të shohim qëndrimin e Camajt në përdorimin e zanores ë, ku autori ka pasur parasysh edhe traditën, si autorët e vjetër, ashtu edhe ata rilindës. Kanë qenë këta autorët e traditës që patjetër kanë pasur ndikim të veçantë te gjuha e Camajt. Kështu zanoren ë e ruan jo vetëm në pozicion fundor, por edhe në mes të fjalë kur ajo është paratheksore, si: *fëmijë, këpurdhë, vëlla, pëllambë* etj.

Ndonëse ë-ja paratheksore si në fjalët e parme, të prejardhura e në trup të fjalës, shqiptimi i saj po reduktohet dukshëm jo vetëm në të folmet veriore, por edhe në disa treva jugore. Kështu ajo me një bazë dialektore deri-diku të kufizuar, nuk përliqjet në disa fjalë. Camaj e ndiente dhe e vërente një dukuri të tillë, megjithatë ai këto fjalë i shkruan me ë, qoftë edhe kur ajo është mbështetëse, si: *bërryl, dërrasë, mjekësi, hapësinë, miqësi, kombëtar* etj. si dhe në fjalët që drejtshkrimi i sotëm i shkruan pa ë, si *tregëtar*. Camaj, përveç bindjeve të tij, por edhe të jetuarit në një mjedis me tradita gjuhësore, edhe përsa i përket shkencave albanologjike, mund të ketë ndikuar që ai të jetë racional dhe i bindshëm. Me interes janë edhe disa forma shumësi të emrave të gjinisë mashkullore që në standardin e sotëm nuk janë dysi drejtshkrimore dhe Camaj i përdor si të tillë: si *studentë-studenta*, por *pensionistë*. Në këtë rast autorin tanë e gadsin dy faktorë: origjina nga vjen Camaj dhe ndikimi i letërsisë bashkëkohore të atdheut të vet, por edhe përgatitja filologjike që ka. Kur themi se Camaj është për një afrim ndër-dialektor, kjo vërehet edhe në disa forma gramatikore që i ka standardi i sotëm, duke iu larguar ligjëritimit krahinor, si shumësi i emrave që dalin me i-të theksuar në trajtën e pashquar njejës: *shtëpi-të, fotografi-të*. Kështu mund të vazhdojmë me rritje tjera në sistemin emëror, si *-ve, -vet* mbaresa e rasës gjinore-dhanore shumësi ku autori përparësi i ka dhënë mbaresën *-ve, dygjinisia e shtrirë edhe në shumësin e emrave me a* etj. po kështu edhe në sistemin foljor që përgjithësisht ka zgjedhur atë formë që janë të mbarë shqipes si të pakryeren me mbaresën *-ja* etj. ndonëse mbizotëruese janë trajtat geqe, kryesisht në format e pashtjelluara etj.

Nuk mund të themi se Camaj ka shkruar në standard, por ka prirje të theksuara për të shkruar një gjuhë sa më të thjeshtë, të kuptueshme, në shumë raste duke zgjedhur me përparësi format më të përbashkëta, duke iu larguar nga përdorimi, në mjaft raste të theksit hundor etj. por gjithnjë me bindje në mbrojtje të gegërishtes dhe nuk kishte se si të ndodhte ndryshe. Le ta mbylli këtë kumtesë duke cituar një fragment nga letra që Martin Camaj i dërgonte Anton Berishës, më 12 maj 1985 nga Lenggresi ku ai jetonte: *“Qendrimi im kundrejt gjuhës që përdor , besoj mbas botimit të Gramar nuk paraqet ma asnjë problem; nuk prapoj ose këshilloj të ndiqet asnjë variantë, secili letrar duhet ta vendosë vetë. Unë këtë njoh ma mirë dhe këtë përdor , ndonëse për dike ngjan se me qenë kjo variantë “jashtë modës”. E kam thanë botnisht dhe askush s’i ka kundërshtue deri më sot as Tirana, as arbëreshët, nuk kishte me qenë keq të vohet në jetë parimi para ’68 të lehet e lirë varianta geqe në sende letrare , sidomos në lirikë. Nuk e fsheh se kjo më shkon për shtat.”*

Në këtë 85-vjetor të lindjes së shkrimtarit Martin Camajt, një kënaqësi tjetër për këtë auditor është paraqitja e botimit të fundit të kolanës “Albanische Forschungen”(Hulumtime shqiptare), themeluar nga prof Stadtmuler.

Ne jemi të tutë

“Studime mbi gjuhën shqipe, letërsinë, historinë e kulturës shqiptare”, kushtuar kujtimit të Martin Camajt, botuar nga prof. Bardhyl Demiraj.

Kjo kolanë u drejtua nga një redaksi e përbërë nga Peter Bartl për Institutin e Shqipërisë, me bashkëpunimin e Bardhyl Demiraj, Titos Jochalas dhe Oliver J. Schmitt.

Në këtë përmbledhje studimesh me vlera të veçanta shkencore, kanë paraqitur rezultatet e tyre 34 autorë në 32 studime nga Gjermania, Austria, Italia, Maqedonia, Rusia, Zvicra, Amerika, Greqia, Shqipëria etj.

Kjo vepër dinjitoze me 600 faqe, e botuar në këtë vit në Wiesbaden në një nga Shtëpitë botuese më prestigjoze, është ndarë në pesë rubrika:

1. Të dhëna bio-bibliografike;
2. Letërsi;
3. Gjuhë;
4. Filologji dhe histori e shkrimit;
5. Popuj dhe Kulturë historike dhe popullore

Në këtë përmbledhje kanë marrë pjesë persoalitete evropiane dhe shqiptare me një rezume të pasur shkencore, si: W. Breu, Hans Jurgen Sasse, Hans Joachim Lanksch, Christine Korne, B.Demiraj, M.Mandala, F. Altimari, Michail Schmidt –Neke, Giovanni Belluscio, Monica Genesis, E.Glaser, Michiel de Vaan, Larisa Kaminskaya, Wilfried Fiedler, Victor Friedman, Rolf Kodderitzsch, Aleksandër, Novik, Joachim Matzinger, Jonida Xhyra, Lumnije Jusufi, Besim Kabashi, Elton Prifti, Markus Peter. Nga Shqipëria: Sh.Demiraj K.Topalli, S.Mansaku, Sh.Sinani, R.Memushaj, V.Kamsi, A.Omari, si dhe një studim i at Viktor Demaj dhe At Donat Kurtit

Shkrimet e botuara në këtë përmbledhje janë kryesisht në gjermanisht, por edhe në shqip, anglisht, italisht etj.

Vepra e posabotuar është më shumë interes për shumë tema të trajtuara ndonëse jo çdo studim është i lidhur me kontributin e shkrimtarit dhe gjuhëtarit Martin Camaj, por përfshihet në interesat shkencore që ka pasur autori ynë. Një përmbledhje e tillë me autorë kaq të përmendur, ndonëse nga Shqipëria duhet të përfaqësoheshin më shumë, sjellin një kontribut të rëndësishëm për jetën dhe veprën e një personaliteti kaq produktiv, kur ai vdiq në kulmin e veprimtarisë letrare dhe shkencore, pa mundur të vijë në vendlindjen e tij të dëshiruar dhe amanetin e tij po e plotëson zonja Camaj.

Këtë botim e karakterizon origjinaliteti, faktet dhe interpretimet që janë bërë nga autorët, punë e cila ka dashur kohë, kërkime dhe hulumtime, si dhe përgjithësime për ta paraqitur Camajn në vlerat e vërteta letrare dhe gjuhësore. Nuk mund të veçojmë ndonjë shkrim, por në veçanti interes paraqesin ato studime që janë të lidhur drejtpërdrejt me veprën dhe personalitetin e M.Camajt, gjë të cilën do ta bëjë studiuesi kur do ta marrin veprën në dorë,

E themi me plot gojë se kjo vepër është një botim shumë serioz, i cilësisë së lartë si nga ana shkencore, por edhe tipografike dhe estetike, gjë që e nderon kujtimin e Martin Camajt, por njëkohësisht edhe punën e redaksisë dhe në veçanti të profesorit të apasnuar Bardhyl Demiraj, i cili kohë pa kohe po na jep vepra që e pasurojnë inventarin e botimeve shkencore për gjuhën shqipe të traditës dhe të sotmes, dhe në përgjithësi për kulturën shqiptare.

I përgëzojmë të gjithë ata autorë të cilët kontribuan me shkrimet e tyre në këtë botim, si dhe botuesit e kësaj vepre madhore.

Le të shërbejë kjo vepër për të nxitur instancat shkencore edhe për botime të tjera të figurave të shquara të kulturës shqiptare, ku mungojnë botimet e kësaj natyre.

Me këtë rast e përshëndesim edhe një herë dr. Erika Camaj për ndihmesën që po jep që bashkëshorti i saj të jetë gjithnjë e më afër lexuesit shqiptar, për ta njohur dhe vlerësuar objektivisht shkrimtarin M.Camajn.

Martin Camaj language considerations for albanian literary language and his contributions for a interdialectal rapprochement

In this article the author gives some of Martin Camaj considerations for Albanian literary language and notes the assistance that gives his work for a interdialectal rapprochement although worries that Gheg wasn't used with great potential that it had.

He tried to write a approached affinity Albanian in many cases removing the narrow shape dialectal..His language is simple and in most cases take priority the common shape although Camaj has no written standard.This author concludes with considerations of the author's writing that one must settle its own literature for the variation to be used.

Adelina ÇERPJA, Emil LAJE (Tiranë)

SISTEMI FOLJOR TE VEPRË “LEHRBUCH DER ALBANISCHEN SPRACHE” DHE “ALBANIAN GRAMMAR WITH EXERCISES, CHRESTOMATHY AND GLOSSARIES”¹⁶⁶ TË MARTIN CAMAJT

I. Sistemi foljor i gjuhës shqipe karakterizohet nga një pasuri e madhe mënyrash dhe formash kohore, të cilat dyfishohen sipas zgjedhimit vepror e pësor. Këto forma paraqiten të larmishme nëpër dialektet e të folmet e ndryshme, duke pasur parasysh se mjetet me të cilat shqipja ndërton format foljore janë të shumëllojshme. Një pjesë e këtyre mjeteve janë të trashëguara nga indoevropianishtja, një pjesë janë zhvillim i brendshëm i shqipes dhe pjesa tjetër janë kombinim i tyre.

Në sistemin gramatikor të shqipes dallimet më të mëdha midis të folmeve janë ato në sistemin foljor, të cilat mund të grupohen në: a) dallime të formuara nga ndryshimet fonetike në një kategori foljesh (*lanj - laj, lidhëm - lidhim*); b) dallime të formuara me anë të analogjisë (*pij* në analogji me *laj* për *pi*); c) dallime të formuara nga ndryshime të mirëfillta strukturore (*u thajsha* për *thahesha*) etj. Me studimin e trajtave dialektore të shqipes janë marrë studiues e dialektologë të njohur, por një trajtim më të përimtuar të dallimeve dialektore, sidomos në sistemin foljor e gjejmë te vepra e Jorgji Gjinarit “*Dialektologjia shqiptare*”¹⁶⁷. Ai i jep të grupuara këto dallime sipas dukurive të ndryshme; disa prej të cilave po i rendisim më poshtë:

¹⁶⁶ M. Camaj: “*Lehrbuch der albanischen Sprache*” Otto Harrassowitz – Wiesbaden, 1969; “*Albanian Grammar with Exercises, Chrestomathy and Glossaries*”. Collaborated on and translated by Leonard Fox. Otto Harrassowitz. Wiesbaden, 1984.

¹⁶⁷ J. Gjinar. *Dialektologjia shqiptare*. Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë. Shtëpia Botuese e Librit Universitar, Tiranë, 1988, f. 78-98.

- Paskajorja ekziston në të dyja dialektet, por dallon në mënyrat e ndryshme të ndërtimit dhe të përdorimit: paskajorja e tipit *për të punuar* është tip i vetëm në gjithë toskërishten; paskajorja e tipit *me punue* kryen dhe shumë funksione të lidhore dhe mbizotëron në të folmet e gegërishtes veriore e qendrore, si dhe ka një përdorim të madh edhe në të folmet perëndimore të Shqipërisë së mesme; në gegërishte, sidomos në atë jugore, përdoret dhe një formë e ndërmjetme e paskajores *për me punue*.

- Në të folmet e shqipes ekzistojnë variante strukturash për pjesoren. Në përgjithësi në të folmet e Jugut përdoret forma e plotë e pjesores, ndërsa në të folmet e Veriut përdoren për shumicën e foljeve forma të thjeshtuara, pa prapashtesën përkatëse: *vjel - vjelë, thân - thënë, li:dh - lidhur*.

- Lidhur me format foljore aspektive, J. Gjinari vëren se trajta e të folmeve jugore *jam duke punuar* dhe gjegjësjë e të folmeve të Veriut *jam tue punue* përdoren në të gjitha të folmet e shqipes, por jo në mënyrë të njëjtë. Në të folmet jugore kjo trajtë përdoret më pak, duke u zëvendësuar nga trajtat *po + dëftore: po punoj, po punoja*, ndërsa në gegërishten verilindore përdoren dhe trajtat e tipit *jam + ka + dëftore (jam ka prashiti)*.

- Në dallimet e së tashmes, të pakryerës dhe të së kryerës së thjeshtë vihen re mbaresa të ndryshme në të folme të ndryshme, si: *punonj - punoj, hapi - hap, mërztitna - mërztitem; qepja -- qepnja - qepshe, u lajshe - u lajshta - lahështa; lavi - lau, lagi - lagu, u lodhësh - u lodha*.

- Krahas formave të përbëra të kohëve të shkuara, studiuesi vëren se në të gjitha të folmet e gegërishtes hasen dhe kohët e dyta të përbëra (*kam pas punu*).

Një material me interes për format foljore në dialekte e të folme të ndryshme ndeshet te “*Atlasi dialektologjik i gjuhës shqipe*”¹⁶⁸, që është një vepër e gjithanshme, ku jepet një pasqyrë përgjithësuese e dialekteve dhe e të folmeve të gjuhës sonë me veçoritë e tyre dhe tiparet e përbashkëta për dukuri të ndryshme gjuhësore.

¹⁶⁸ *Atlasi dialektologjik i gjuhës shqipe*. Akademia e Shkencave e Shqipërisë. Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë. Vëllimi I. Università degli Studi di Napoli L’Orientale. Dipartimento di Studi dell’Europa Orientale, 2007.

II. Veprat e M. Camajt “Lehrbuch der albanischen Sprache” dhe “Albanian Grammar with Exercises, Chrestomathy and Glossaries” (më tej me shkurtime “Lehrbuch ...” dhe “Grammar ...”), janë tekste mësimore jo thjesht të shqipes standarde, por të shqipes në tërësi. Autori i ka konceptuar ato si vepra që të paraqesin strukturën fonetike e gramatikore të shqipes dhe të shërbejnë jo vetëm për zotërimin e shqipes standarde dhe për leximin e teksteve të shkruara me të, por edhe për leximin e veprave të traditës së mëparshme, qoftë të gegërishtes, qoftë të toskërishtes.

“**Lehrbuch ...**” është përdorur si tekst për mësimin e gjuhës shqipe në Universitetin e Mynihut. M. Camaj shpjegon se gjatë përdorimit të këtij teksti me studentë dhe këshillimit me kolegë ka vënë re disa të meta e mangësi, të cilat mendoi t’i korrigojonte e t’i plotësonte në një botim tjetër, e pikërisht në “Grammar ...”. Vetë M. Camaj e konsideron këtë gramatikë jo si ripunim të “Lehrbuch ...”, por si një vepër të re në të cilën ka përfshirë forma gramatikore të nxjerra nga letërsia tradicionale, nga letërsia e autorëve të vjetër e nga gramatikat. M. Camaj është përpjekur që në këtë vepër, pavarësisht nga pikëpamjet dhe parapëlqimet e veta, të respektojë disa aspekte të ‘gjuhës së njësuar’¹⁶⁹ dhe të normës letrare të miratuar në Kongresin e Drejtshkrimit më 1972. Ai ka pasur si qëllim që në këtë gramatikë të japë një imazh të plotë të gjuhës jo vetëm në aspektin leksikor, por dhe në atë gramatikor në të tri variantet e saj më të rëndësishme: në gegërishte, toskërishte dhe arbërishte.

Në parathënien që ka shkruar albanologu Alois Schmaus për veprën “Lehrbuch ...”, thekson ndër të tjera se “M. Camaj është përpjekur të marrë parasysh brenda mundësive realitetin e sotëm gjuhësor, i cili gjendet në udhë e sipër drejt formimit të një gjuhe të njësuar mbidialektore. Po veçoritë e dialekteve kryesore janë pasur parasysh në shkallë të gjerë, në mënyrë që leximi i teksteve të mëparshme të mos paraqesë vështirësi të ndjeshme.” Vetë M. Camaj pohon në hyrjen e “Lehrbuch ...” se ka marrë si bazë projektin e ri të drejtshkrimit të njësuar (1967). Megjithatë, ndonëse

¹⁶⁹ M. Camaj, “*Albanian Grammar...*”, f. VII.

në projekt nuk shënohen theksi dhe zanoret hundore, autori ka përdorur shenjat ' dhe ^ për të bërë më të lehtë theksimin dhe shqiptimin.¹⁷⁰

“Lehrbuch ...” është strukturuar në tre kapituj kryesorë: Fonetika, Morfologjia dhe Sintaksa. Më pas jepen disa tekste me njohuri të përgjithshme për Shqipërinë, si dhe një fjalor shqip - gjermanisht dhe gjermanisht - shqip. Vepra mbyllet me një hartë të Shqipërisë. Pas çdo leksioni M. Camaj jep një fjalorth shqip - gjermanisht, si dhe ushtrime për njohuritë e reja.

Në kapitullin e morfologjisë, që është dhe më i rëndësishmi në këtë vepër, folja zë vendin më të madh krahasuar me pjesët e tjera të ligjëratës (32 % të kapitullit të Morfologjisë dhe 19% të gjithë veprës). Njohuritë për foljen jepen pasi lexuesi është njohur më parë me pjesët e tjera të ligjëratës: emri, mbiemri, numërorët, përemrat, ndajfolja, dhe parafjala. Kjo është një zgjidhje metodike origjinale. Me sa duket, autori ka menduar se duke shtjelluar më parë pjesët e tjera të ligjëratës, lexuesi do ta ketë më lehtë të kuptojë kategoritë e foljes, që paraqesin mjaft vështirësi për të huajt. Foljet autori i përkufizon si fjalë që shënojnë: a) një veprimtari fizike ose fiziologjike (*punoj, shoh*), b) një veprimtari psikologjike (*mendoj, idhnohem*), c) një gjendje (*jam, gjindem*). Më tej ai paraqet shumë shkurt mënyrat e foljes, që i ndan në mënyra të shtjelluara: diftore, lidhore, kushtore, dëshirore, habitore e urdhnore, dhe të pashtjelluara: paskajore (*me + pjesore*), pjesore, përcjellore (*tue g., duke t. + pjesore*). Kohët e foljes janë: e tashme, e pakryeme g. / e pakryer t., e kryeme e thjeshtë, e kryeme, e kryeme e plotë, e kryeme e tejshkueme, e ardhme¹⁷¹, e ardhme e përparme.

Ai i ndan foljet në tre zgjedhime kryesore dhe brenda tyre dallon disa klasa, duke u nisur nga format e së tashmes, të së kryerës së thjeshtë dhe të pjesores. Në zgjedhimin I përfshihen foljet që në vetën e parë njëjës të së tashmes marrin -j dhe në vetën e dytë e të tretë marrin mbare të -n (*bâj, prîj, frÿj; thaj, blej, shkruej/shkruaj; pi, shtie*). Në zgjedhimin II

¹⁷⁰ M. Camaj. “Lehrbuch ...”, f. X.

¹⁷¹ M. Camaj i jep të dyja format e kohës së ardhme (dhe të së ardhmes së përparme): *kam + paskajore kam me qenë* dhe *do + lidhore do të jem (kam me pasë qenë, do të kem qenë)*.

përfshin foljet më bashkëtingëllore në vetën e parë, të dytë e të tretë të së tashmes (*vesh, ngjesh, mbath, hap, vendos; pjek, hedh, vjel, vjerr*). Në zgjedhimin III bëjnë pjesë foljet me temë më -t, d.m.th. foljet që në vetën e parë njëjës të së tashmes dalin më -s, dhe në vetën e dytë më -t (*shëtis, godis, kullos; përkas - përkita, shes – shita; gjej, gjeta, gjetë/gjetur; ngrej, ngrita, ngritë/ngritur*).

Pas formave pësore e vetvetore të foljeve në tri zgjedhimet e mësipërme, M. Camaj trajton foljet e parregullta, të cilat i ndan në dy grupe: në foljet supletive: *bie (ra, rënë), bie (pru, prurë), ap, rri, ha, shoh, vij*; dhe në grupin e dytë foljet e tjera të parregullta: *due, drue, mundem, vdes, zâ, lâ, vê, thom*. Për secilën prej këtyre foljeve jepen format e së tashmes, të së pakryerës, të së kryer të thjeshtë dhe të së ardhmes në mënyrën dëftore si dhe format e mënyrave të tjera.

“**Albanian Grammar ...**” hapet me një parathënie ku autori shpjegon arsyet e këtij botimi të ri, rëndësinë e tij dhe bën një përshkrim të shkurtër të gramatikës. Në hyrjen që vijon jepen njohuri të përgjithshme për gjuhën shqipe dhe zhvillimin e saj, si dhe për Shqipërinë. Edhe kjo gramatikë ruan pak a shumë të njëjtën strukturë si “Lehrbuch ...”, d.m.th. përmban si kapituj kryesorë Fonetikën, Morfologjinë dhe Sintaksën. Pas tyre jepet Çelësi i ushtrimeve, Krestomacia, Fjalori shqip - anglisht e anglisht - shqip, si dhe Treguesi i fjalëve.

Në këtë gramatikë ndërthuren njohuritë gramatikore dhe zbatimi i tyre në ushtrime. Në fund të çdo seksioni të njohurive gramatikore autori jep fjalorin, ushtrimet dhe pjesë në shqipen më të fundit, për të cilën thekson se është e re dhe ende në proces formimi¹⁷², si dhe pjesë në gegërishten letrare. Ai ka përzgjedhur me kujdes njohuritë gramatikore, ushtrimet dhe fjalorin për ta bërë sa më ndërveprues mësimin e shqipes.

Krahasuar me “Lehrbuch ...”, në “Grammar ...” njohuritë për sistemin foljor janë më të organizuara. Ashtu siç ndodh rëndom nëpër gramatikat e shqipes, dhe në këtë gramatikë sistemi foljor zë pjesën kryesore të kreut të Morfologjisë (47% të tij dhe 31% të gjithë gramatikës).

¹⁷² M. Camaj, “Grammar ...”, f. X.

Pasi shtjellon kategoritë gramatikore të foljes, numrin, vetën, kohën, mënyrën, formën, si dhe bën dallimin mes 3 formave sintetike nga 5 të tjerat analitike, M. Camaj përshkruan mjetet gramatikore që përdoren për ndërtimin e formave foljore në gjuhën shqipe:

- ndryshimet fonetike të zanoreve: apofonia: *e/o: bredh - brodha; je/o: mbjell - mbolla; a/o: dal - dola; â(ë)/a: lâ (lë) - lashë; ê(ë)/u: vê (vë) - vuna (vura)*; metafoia: *a/e: marr - merr; e/i: pres - prita – prit*; diftongimi: *o/ue(ua): due (dua) - doni, bluej (bluaj) - blova; e/ye: kreva – kryej*; monoftongimi: *ue(ua)/u: due (dua) - duhem; ye/y: lyej - lyhem; ie~je/i: shtie – shtihem*;
- ndryshimet fonetike të bashkëtingëlloreve: qiellzorizimi: *k/q: pjek - poqa - piqem; g/gj: djeg - dogja – digjem*; asimilimi: *l/ll: dolla (tosk.) - dal; r/rr: mora- marr*; asibilimi: *t/s: prit – pres*;
- mbaresat vetore;
- bashkëtingëlloret që zhdukin hiatin: *-v-* për të kryerën e thjeshtë dhe *-h-* për format joveprorë;
- pjesëzat: *me: me qenë* (vetëm në gegërishte); *për të: për të qenë*; *pa: pa qenë*; *me të: me të shkuar*; foljet ndihmëse *kam e jam* dhe foljet modale *due (dua) e mund*.

Më tej M. Camaj vijon me paradigmat e plota të foljeve ndihmëse e modale në zgjedhimin vepror e jovepror. Ai thekson se tri funksionet e foljes, koha, aspekti dhe modaliteti (nevoja, mundësia) mund të kuptohen qartë vetëm në lidhje me njëra-tjetrën.

Kategoria gramatikore e kohës ndahet në 8 nënkategori, të cilat gjenden të gjitha në mënyrën dëftore. Tri kohët themelore janë e tashmja, e shkuara dhe e ardhmja. Me interes janë vëzhgimet e tij për vlerat aspektore. Ai vëren se në gjuhën shqipe ka një prirje për korrelacion të dyfishtë të aspektit: veprim i kryer (koha e kryer e thjeshtë) / veprim i pakryer (koha e pakryer), veprim i çastit në kuptimin “që vijon të kryhet në çastin e ligjërimit” (*po + forma e së tashmes: unë po sjell* ose *jam + përcjellore: unë jam tue/duke sjellë* / veprim i zakonshëm (e tashme *unë sjell*). Në gegërishten veriore kryerja e veprimit në çastin e ligjërimit shprehet dhe me

ndërtimin *jam + kah + foljen* (në të cilën zgjedhohen të dyja foljet): *jam kah sjelli, jeni kah sillni ...*

Dhe koha e pakryer paraqet të njëjtat veçori për kryerjen e një veprimi në çastin e dhënë të së shkuarës apo kryerjen e një veprimi të zakonshëm: (*unë*) *haja, po haja / isha tue hangër (duke hëngër), isha kah haja.*

E ardhmja është një kohë analitike e ndërtuar në dy mënyra, që kanë të njëjtën funksion kohor, por që ndryshojnë nga modalitetet: e ardhmja me *do + të tashmen e lidhore (do të sjell)* shpreh një qëllim ose detyrim; e ardhmja me *kam + paskajoren (kam me sjellë)* ka një kuptim të papërcaktuar ('indetermination'). Në këtë mënyrë ndërtohet dhe e ardhmja e përparme: *do të kem sjellë* dhe *kam me pasë sjellë.*

Një vend të rëndësishëm në njohuritë për sistemin foljor M. Camaj u kushton foljeve modale *do, mund; duhet, mundet* dhe *mundem, mundesh ...* Krahas ndërtimit të së ardhmes dhe të kohëve të mënyrës kushtore, pjesëza me origjinë foljore *do* shpreh modalitetin e nevojës kur shoqërohet nga pjesorja: *do sjellë.* Në këtë rast ajo mund të zëvendësohet nga folja pavetore *duhet: duhet sjellë.* Për të shprehur modalitetin e mundësisë ose të qëllimit përdoret *mund* e shoqëruar nga lidhorja *mund të sjell*, ndërsa urdhri, leja, miratimi e ndonjëherë dëshira ose indiferenca shprehen me pjesëzën *le*, që vjen nga veta II njëjës e urdhërores *lâ*, shoqëruar nga lidhorja: *le të sjell.* Me formën e vetës së tretë njëjës të formës joveprore të foljes *dua* ka tri mënyra ndërtimi: *më duhet + lidhore (më duhet të vij - që shpreh nevojë), duhet + të kryerën e lidhore (duhet të kem qenë - që shpreh mundësi), duhet + pjesore / paskajore (duhet ardhë, duhet me ardhë - që shpreh nevojë).* M. Camaj veçon si një karakteristikë të formave analitike të dialektit jugor zgjedhimin edhe të foljes së dytë (*mund të vij, të vish, të vijë ...*), pra të asaj që bart kuptimin leksikor të këtyre formave. Këtë ai e shpjegon me mungesën në këtë dialekt të një paskajoreje tipike.

Vëzhgimet e M. Camajt për semantikën gramatikore të mënyrave të foljes janë një ndihmesë e çmuar e tij në këtë fushë, por mjerisht kanë mbetur ende pak të njohura, gati të papërmendura edhe në ditët tona, prandaj e quajmë të nevojshme të themi disa fjalë lidhur me to. M. Camaj

shoh pika të ngushta takimi midis foljeve modale dhe mënyrës lidhore, katër kohët e së cilës, siç shprehet ai, kanë më shumë prirje të tregojnë përbërës të modalitetit, sesa shkallë të përcaktuara kohore. Dy kohët e mënyrës kushtore shihen si një zgjerim formal i së ardhmes, dhe ashtu si e ardhmja, dalin me dy forma: *do* + e pakryer e lidhore (*do të kisha sjellë*) dhe në gegërisht *kisha* + paskajore (*kisha me sjellë*).

Ashtu si në mënyrën kushtore, edhe funksioni i mënyrës dëshirore me dy kohët e saj (e tashmja *qofsha* dhe e kryera *paça sjellë*) lidhet ngusht me lidhoren, e cila dhe mund ta zëvendësojë: *rroftë - të rrojë*.

Habitorja, një mënyrë jo e zakonshme (që vjen nga një e kryer e përmbysur) dhe e integruar jo fort lehtë në sistemin foljor të shqipes, ka marrëdhënie formale dhe funksionale me dëftoren, por dallon nga ndjenja e habitës dhe e çudisë që shpreh folësi. Kjo mënyrë përdoret dhe për të raportuar një veprim (*Fshatari ankohet se nuk paska bukë në shtëpi*) ose për të shprehur ironi (*Fshatari s'na paska bukë në shtëpi*)¹⁷³.

Dy format e vetës së dytë njëjës e shumës të mënyrës urdhërore përdoren për të shprehur një urdhër, dëshirë, këshillë ose kërkesë. Krahas këtyre formave, si një urdhërore e mirësjelljes përdoret dhe mënyra lidhore (*le të bini*).

Përveç këtyre mënyrave, M. Camaj dallon dhe format e pashtjelluara të foljes, të cilat nuk dallojnë sipas vetës, numrit, mënyrës, kohës dhe formës. Ato shfaqin ngjashmëri formale dhe funksionale me mbiemrat dhe emrat. Pjesorja shërben për të ndërtuar kohët e përbëra, si dhe format e tjera të pashtjelluara. M. Camaj dallon disa variante të paskajores: *pa sjellë*, *me të sjellë*, *për të sjellë*, si dhe paskajoren gege *me sjellë*. Përcjellorja formohet nga *tue (duke)* + pjesore: *tue (duke) sjellë*.

Ndryshe nga klasifikimi në zgjedhime që ka bërë në “Lehrbuch ...”, në “Grammar ...”, M. Camaj i ka ndarë foljet në dy zgjedhime (që i quan

¹⁷³ *Po aty*, f. 162.

më fort “klasa”) kryesore nisur nga rrënja e së tashmes: folje me temë më zanore dhe folje më bashkëtingëllore¹⁷⁴.

Zgjedhimi i parë, ku përfshihen foljet me temë më zanore, ndahet në 3 nënklasa:

a. Foljet më *-o* ose *-ue (-ua)* dhe *-e* ose *-ye* (johundore). Këto folje e ndërtojnë të kryerën e thjeshtë me *-v-*, ndërsa pjesoren me diftong: *jetoj, jetova, jetue (jetuar); shkruaj (shkruaj), shkrova, shkruaj (shkruar); thej ~ thyej, theva, thye (thyer)*. Këtu bëjnë pjesë dhe foljet që pësojnë zhvendosje të theksit *ndiej, ndjeva, ndie (ndier)* dhe foljet më *-e, -a, -i, -y* (johundore) që nuk diftongohen: *blej, bleva, blé (blerë); çaj, çava, çá (çarë); pi, piva, pí (pirë); ndyj, ndyva, ndý (ndyrë)*.

b. Në nënklasën e dytë bëjnë pjesë foljet që në të tashmen dhe pjesore kanë zanore hundore dhe në të kryerën e thjeshtë marrin *-n-* (toskërisht *-r-*): *bâj, bëna (bëra), bâ (bërë); fryj (fryj), fryna (fryra), fry (fryrë)*.

c. Në nënklasën e tretë përfshihen foljet më zanore që të kryerën e thjeshtë dhe pjesoren e formojnë më *-t-*: *gjej, gjeta, gjetë (gjetur); mbaj, mbajta, mbajtë (mbajtur)*. M. Camaj vëren se ka një prirje të foljeve më zanore që i përkasin nënklasës *a* dhe *b* për të kaluar në nënklasën *c*: *mbroj, mbrojta, mbrojtë (mbrojtur), luej (luaj), lúejta (lúajta), lúejtë (lúejtur)*.

Në zgjedhimin e dytë bëjnë pjesë foljet që mbarojnë më bashkëtingëllore në vetën e parë, të dytë e të tretë njëjës të së tashmes. Ato ndahen në dy grupe kryesore:

¹⁷⁴ Dihet se klasifikimi i foljeve të gjuhës shqipe në zgjedhime paraqet shumë vështirësi, që janë shkaktuar nga ndryshimet fonetike dhe lëvizjet e brendshme të tipave të zgjedhimit. Autorë të ndryshëm kanë zbatuar klasifikimi në dy, tri e katër zgjedhime, por sidoqoftë dy janë tipat kryesorë: foljet me temë më zanore e foljet me temë më bashkëtingëllore në shqipen e sotme. Edhe Sh. Demiraj në diskutimin e këtij problemi ka parapëlqyer klasifikimin me dy zgjedhime, por ka dhënë edhe klasifikimin me tri zgjedhime, ku zgjedhimi i dytë dhe i tretë i takojnë tipit të foljeve me temë më bashkëtingëllore. (Shih: Sh. Demiraj, “Rreth klasifikimit të foljeve në zgjedhime”. *Studime filologjike*, 1969, nr. 3, f. 193-201; shih gjithashtu edhe F. Agalliu, “Diskutim rreth problemit të klasifikimit të foljeve në zgjedhime”. *Po aty*, f. 203-205).

a. Në grupin e parë përfshihen foljet që nuk pësojnë ndryshime në temë gjatë zgjedhimit: *sos, sosa, sosë (sosur), vendós, vendosa, vendosë (vendosur)*.

b. Në grupin e dytë bëjnë pjesë foljet më bashkëtingëllore që pësojnë ndryshime fonetike, si apofoni, metafoni, diftongim, qiellzorizim dhe asibilim. Ato ndahen në 3 nënklasa: folje që pësojnë apofoni: *bredh, brodha, bredhë (bredhur)*; *dal, dola, dalë*; folje që pësojnë apofoni dhe ndryshime bashkëtingëlloresh: *pjek, poqa, pjekë (pjekur)*; *djeg, dogja, djegë (djegur)*; *nxjerr, nxora, nxjerrë*; *marr, mora, marrë*; foljet e quajtura foljet më -t që pësojnë ndërrimin karakteristik t/s, të cilat ndahen në folje që pësojnë vetëm ndërrimin: *kalís, kalita, kalitë (kalitur)*; *pyes, pýeta, pýetë (pýetur)* dhe folje që përveç ndërrimin, pësojnë dhe ndryshimin e zanoreve a~e/i në të tashmen dhe të kryerën e thjeshtë: *zbres, zbrita, zbritë (zbritur), përkás, përkita, përkité (përkitur)*.

Më tej M. Camaj vijon me paradigmën e foljeve të zgjedhimeve të ndryshme, si dhe me zgjedhimin jovepror. Një leksion të veçantë i kushton formimit të foljeve. Ai dallon foljet e thjeshta (*ble, di, njoh*) prej foljeve të prejardhura, që mund të formohen nga parashtesat (*përçaj, zbardh*), prapashtesat (*pikoj, shtresoj, gjurmoj, ajros, llogaris*) ose nga kombinimi i tyre (*përdorj*).

Te foljet e parregullta M. Camaj përfshin: foljet supletive: *bie, bie, (j)ap, shoh, thom ~ them, ha, rri, vij* dhe foljet josupletive: *lâ (lë), vdes, drue (druaj)*. Për secilën prej tyre ai jep të tashmen, të pakryerën, të kryerën e thjeshtë të dëftores, të tashmen e lidhore, dëshirores e habitores, urdhëroren dhe pjesoren.

III. M. Camaj, si folës i lindur dhe lëvrues i gegërishtes, ka bërë një përzgjedhje të kujdesshme të paradigmave foljore të gegërishtes letrare, duke mënjeluar disa forma foljore nëndialektore, që janë pasqyruar në gramatika të mëparshme të hartuara në bazë të atij dialekti. Me këtë rast po theksojmë edhe një herë se, sipas të dhënave të dialektologjisë (jemi mbështetur te veprat përgjithësuese “Atlasi dialektologjik i gjuhës

shqipe”¹⁷⁵ dhe “Dialektologjia shqiptare” e J. Gjinarit), format foljore të gegërishtes janë mjaft të larmishme, por një pjesë e tyre nuk kanë gjetur pasqyrim në traditën gramatikore.

Nga vëzhgimet tona kemi nxjerrë disa forma foljore që M. Camaj nuk i ka përfshirë në gramatikën e tij:

- për të tashmen e dëftores: formën e vetës së parë njëjës *ishna, ishesh, ishte* (“Atlasi ...”, harta 268, f. 339); formën e vetës së dytë njëjës *ishne* (“Atlasi ...”, harta 269 f. 340); formën e vetës së parë shumës *ishmi, ishna* (“Atlasi ...”, harta 271, f. 342);
- pjesëzën që shërben për të formuar përcjelloren: *tuo, tu, tuj, tye* (“Atlasi ...”, harta 314, f. 385);
- format me mbaresën *-i* në vetën e parë të së tashmes njëjës të foljeve më bashkëtingëllore: *hapi, lidhi, nisi, qepi; këputi, mbyti* (“Dialektologjia ...”, f. 79-80).
- formën e vetës së tretë të së pakryerës më *-(j)ke* (kryesisht të gegërishtes verilindore): *ardhke, dalke, vrajke* (“Dialektologjia ...”, f. 84-85).
- formën më *-u* të vetës së tretë njëjës të së kryerës së thjeshtë për foljet me temë më zanoren *-o*: *fillou, kalou, pagou* (“Dialektologjia ...”, f. 86).
- formën më *-i* të vetës së tretë njëjës të gegërishtes verilindore të foljeve me temë më bashkëtingëlloren *k, g* dhe *h*: *preki, fshehi* (“Dialektologjia ...”, f. 86).
- formën e vetës së parë njëjës të së tashmes joveprore me mbaresën *-(h)na*: *mërzitna, lidhna, afrona* (“Dialektologjia ...”, f. 91).
- formën e vetës së parë njëjës të së pakryerës joveprore me pjesëzën *u* + formën e së pakryerës veprorë: *u lajsha* (“Dialektologjia ...”, f. 93).

Po kështu, në të mirë të formave më të përgjithshme, M. Camaj nuk i ka dhënë disa forma foljore nëndialektore të pasqyruara në gramatikat e mëparshme të gegërishtes. Kemi marrë për krahasim tekstin “Gramatika e Ré e Shqipes” të Osman Myderrizit (1944), dhe veprën e Justin Rrotës

¹⁷⁵ *Atlasi dialektologjik i gjuhës shqipe*. Akademia e Shkencave e Shqipërisë. Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë. Vëllimi I. Università degli Studi di Napoli L’Orientale. Dipartimento di Studi dell’Europa Orientale, 2007.

“Gjuha e shkrueme ase vërejtje gramatikore” (1964). Kemi ndërtuar për këtë qëllim një pasqyrë të krahasuar (që jepet në fund si shtojcë) të paradigmave të foljeve *jam, kam, dua, them* dhe të foljeve *jetoj, qep* e *pi* si përfaqësuese të zgjedhimit I, II e III. Nga ky krahasim vihet re se M. Camaj ka prirjen të paraqesë format më të përgjithshme, duke mënjanuar disa forma anësore që nuk kishin gjetur një përdorim të mjaftueshëm letrar. Kështu, ai ka lënë mënjanë format e mëposhtme:

- formën dytësore *â* (O. Myderrizi) të vetës së tretë njëjës të së tashmes, duke mbajtur vetëm *asht*;
- format dytësore *jimi, jena* (O. Myderrizi) të vetës së parë shumës të së tashmes, duke mbajtur vetëm *jemi*;
- format e vetës së parë të së pakryerës *ishe; kishë* (J. Rrota), *ishem, ishe; kishem, kishë* (O. Myderrizi), duke mbajtur vetëm *isha, kisha*; po ashtu format e vetës së dytë shumës të së pakryerës *ishi, kishi* (J. Rrota, O. Myderrizi), duke mbajtur vetëm *ishit, kishit*;
- format e shumësit të së kryerës së thjeshtë *patmë, pattë, patnë* (J. Rrota; te O. Myderrizi si forma dysore), duke mbajtur vetëm *patëm, patët, patën*;
- formën dysore të pjesores *qenun, pasun* (J. Rrota), duke mbajtur vetëm *qenë, pasë*; po kështu edhe për foljet e tjera janë lënë mënjanë pjesore si *jetuem, qepun, pim*, duke mbajtur vetëm format *jetue, qepë, pi*.
- formën me mbaresën *-i* të vetës së parë njëjës në të tashmen për foljet e zgjedhimit II: *qepi* (J. Rrota)
- format e së pakryerës joveprore të ndërtuara nga pjesëza *u* dhe forma veprore *u-rritshem* (O. Myderrizi dhe J. Rrota), duke mbajtur vetëm formën *rritesha*.

Këto janë disa shënime të përmbledhura brenda caqeve të një kumtese, me të cilën kemi dashur të vëmë në dukje ndihmesën e M. Camajt si gramatikan, mendimin i tij teorik për çështje problemore të gramatikës shqipe, që ende nuk është përvetësuar e nuk pasqyrohet në studimet tona gramatikore. Krahas kësaj jemi përpjekur të vëmë në dukje prirjen e tij për të ndjekur zhvillimin e strukturës gramatikore të shqipes dhe për të thjeshtuar sistemin paradigmantik të foljes në gegërishten letrare, duke e

afruar, për aq sa ka qenë e mundshme, me format paradigmatiche të gjuhës standarde.

BIBLIOGRAFI:

1. *Atlasi dialektologjik i gjuhës shqipe*. Akademia e Shkencave e Shqipërisë. Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë. Vëllimi I. Universita degli Studi di Napoli L'Orientale. Dipartimento di Studi dell'Europa Orientale, 2007.
2. Camaj, M. *Albanian grammar with exercises, chrestomathy and glossaries*. Collaborated on and translated by Leonard Fox. Otto Harrassowitz – Wiesbaden, 1984.
3. Camaj, M. *Lehrbuch der albanischen Sprache*. Otto Harrassowitz - Wiesbaden, 1969.
4. Gjinari, J. *Dialektologjia shqiptare*. Universiteti i Tiranës “Enver Hoxha”. Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë. Shtëpia botuese e librit universitar, Tiranë, 1988.
5. *Martin Camaj - tradita dhe bashkëkohësia*. Simpozium 24 qershor 1993, Shkodër. Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi” Departamenti i Letërsisë & Departamenti i Gjuhës, Shkodër, 1994.
6. Myderrizi, O. *Gramatika e Ré e Shqipes*. Për shkollat e mesme. Vëllimi I. Fonologji e morfologji. Shtypun në Shtyp. “Gutenberg” - Tiranë, 1944.
7. Osmani, T. “Martin Camaj dhe vepra e tij gjuhësore”. *Gjuha jonë*, 20/2000, 1-2, 107-113.
8. Rrota, Át J. *Gjuha e shkrueme ase vërejtje gramatikore*. Akademia e Shkencave e Shqipërisë. Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë. Biblioteka

françeskane “At Gjergj Fishta”. Kolana e shkrimtarëve françeskanë. Botimi I. Botime Françeskane, Shkodër, 2006.

9.Sedaj, E. “Integraliteti gjuhësor në gramatikën shqipe të M. Camajt”. *Seminari ndërkombëtar për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare*. Prishtinë, 2002, f. 455-466.

Shtojcë

Në pasqyrën e mëposhtme janë dhënë format foljore të kohës së tashme, të pakryer, të kryer të thjeshtë dhe të pjesores për foljet: *jam, kam, dua, them*, si dhe nga një folje përfaqësuese për secilin zgjedhim (*jetoj, qep, pi*) sipas M. Camajt, J. Rrotës dhe O. Myderrizit.

	M. CAMAJ	J. RROTA	O. MYDERRIZI
	JAM		
e tashme	jam	jam	jam
	je	jé	je
	asht	ashtë	asht (a)
	jemi	jemi	jemi (jimi, jena)
	jeni ~ jini	jeni	jeni (jini)
	janë	janë	janë
e pakryer	isha	ishe	ishem (ishe, isha)
	ishe	ishe	ishe
	ishte ~ish	ishte	ishte (ish)
	ishim	ishim	ishim
	ishit	ishi	ishi (ishit)
	ishin	ishin	ishin
e kryer e thjeshtë	qeshë	qeshë	qesh
	qe	qé	qé
	qe	qe	qé
	qemë	qémë	qemë
	qetë	qetë	qetë
	qenë	qénë	qenë
pjesore	qenë	qenë (qenun)	qenë

KAM			
e tashme	kam	kam	kam
	ke	ké	ke
	ka	ka	ka
	kemi	kemi	kemi (kimi, kena)
	keni ~ kini	keni	keni (kini)
	kanë	kanë	kanë
e pakryer	kisha	kishe	kishe (kisha)
	kishe	kishe	kishe
	kishte	kishte	kishte (kish)
	kishim	kishim	kishim
	kishit	kishi	kishi (kishit)
	kishin	kishin	kishin
e kryer e thjeshtë	pata	pata (patshë)	pata a paç
	pate	pate	pate
	pati~pat	pat	pat (pati)
	patëm	patmë	patëm (patmë)
	patët	pattë	patët (pattë)
	patën	patnë	patën (patnë)
pjesore	pasë (pasur~patur)	pasë (pasun)	pasë
DUA			
e tashme	due (dua)	due	due
	do(n)	do	do
	do(n)	do	do
	duem (duam)	duem	duemë
	doni	dueni	doni
	duen (duan)	duen	duenë
e pakryer	doja	dueshe (dojshe)	dojshem
	doje ~doshe	dueshe (dojshe)	dojshe
	donte	duente (donte)	donte (dojte)
	donim ~ doshim	duejshim (dojshim)	dojshim
	donit ~ doshit	dueshi (dojshi)	dojshi

	donin ~ doshin	duejshin (dojshin)	dojshin
e kryer e thjeshtë	desha ~ deshta	desha	desha
	deshe ~ deshte	deshe	deshe
	deshi ~ deshti	desh	desh
	deshëm ~ deshtëm	deshmë	deshëm
	deshët ~ deshtët	deshtë	deshët
	deshën ~ deshtën	deshnë	deshën
pjesore	dashë (dashur)	dashë-un (-ur)	dashë
THEM			
e tashme	thom ~them	thom	thom (them)
	thue thua	thue	thue
	thotë	thotë	thotë
	themi	thomi	thomi (themi)
	thoni	thueni (thoni)	thoni (thueni)
	thonë	thonë	thonë
e pakryer	thoshja (thosha / thoja)	thojshje	thojshem
	thoshje	thojshje	thojshje
	thoshte	thonte	thonte
	thoshnim	thojshim	thojshim
	thoshnit		thojshi
	thoshnin		thojshin
e kryer e thjeshtë	thashë	thashë	thash
	the	thae	thé
	tha	tha	tha
	thamë	thámë	thamë
	thatë	thátë	thatë
	thanë	thánë	thanë
pjesore	thanë thënë	thanë	thânë
JETOJ – zgjedhimi I			
e tashme	jetoj	jetoj	jetoj
	jeton	jeton	jeton
	jeton	jeton	jeton
	jetojmë	jetojm	jetojmë

	jetoni	jetoni	jetoni
	jetojnë	jetojn	jetojnë
e pakryer	jetoja, jetosha g.	jetojshe	jetojshem (jetonja)
	jetoje, jetoshe g.	jetojshe	jetojshe (jetonje)
	jetonte	jetonte	jetonte
	jetonim, jetoshim g.	jetojshim	jetojshim (jetonim)
	jetonit, jetoshit g.	jetojshi	jetojshi (jetonit)
	jetonin, jetoshin g.	jetojshin	jetojshin (jetonin)
	e kryer e thjeshtë	jetova	jetova
jetove		jetove	jetove
jetoi		jetoi	jetoi (jetovi)
jetuam		jetuemë	jetuemë
jetuat		jetuetë	jetuetë
jetuan		jetuenë	jetuenë
pjesore	jetue (jetuar)	jetue, jetuem (jetuar)	jetue
<i>QEP</i> – zgjedhimi II			
e tashme	qep	qepi	qep
	qep	qepë	qep
	qep	qepë	qep
	qepim	qepim	qepim
	qepni	qepni	qepni
	qepin	qepin	qepin
e pakryer	qepja, qepsha g.	qepshe	qepshem (qepnja)
	qepje, qepshe g.	qepshe	qepshe (qepnje)
	qeppte	qeppte	qeppte
	qepnim, qepshim g.	qepshim	qepshim (qepnim)
	qepnit, qepshit g.	qepshi	qepshi (qepnit)

	qepnin, qepshin g.	qepshin	qepshin (qepnin)
e kryer e thjeshtë	qepa	qepa	qepa
	qepe	qepe	qepe
	qepi	qepi	qepi
	qepëm	qepmë	qepëm
	qepët	qeptë	qepët
	qepën	qepnë	qepën
pjesore	qepë (qepur)	qepë (qepun, qepur)	qepë
PI – zgjedhimi III			
e tashme	pi	pí	píj
	pi	pí	pín
	pi	pí	pín
	pimë	pijm	pijmë
	pini	pini	pini
	pinë	pijn	pijnë
e pakryer	pija	pishe	pijshem (pinja)
	pije	pishe	pijshe (pinje)
	pinte	pinte	pinte
	pinim	pishim	pijshim (pinim)
	pinit	pishi	pijshi (pijshit)
	pinin	pishin	pijshin (pinin)
e kryer e thjeshtë	piva	piva	piva
	pive	pive	pive
	piu	piu	piu (pivi)
	pimë	pimë	pimë
	pitë	pitë	pitë
	pinë	pinë	pinë
pjesore	pi (pirë)	pí (pim), pirë	pí

The verbal system in the books of Martin Camaj “*Lehrbuch der albanischen sprache*” and “*Albanian grammar with exercises, chrestomathy and glossaries*”

M. Camaj as grammarian has made a great contribution to his own opinion on theoretical problems of Albanian grammar, but this contribution has not yet been reflected in our studies about grammar. In his grammar it is noticed the trend to follow the development of the grammatical structure of Albanian and to simplify the paradigmatic system of verb in Gheg variant, bringing it, as close as it has been possible, to the paradigmatic forms of the standard language.

Gjovalin SHKURTAJ (Tiranë)

MARTIN CAMAJ - FIGURË E SHQUAR E ALBANOLOGJISË DHE E LETËRSISË SHQIPTARE

(Vlera, vlerësime dhe disa kujtime)

Nuk është e lehtë, natyrisht, që në një kumtesë të shkurtër si kjo, të paraqesim me plotërinë e hapësirat e nevojshme një figurë poliedrike dhe shprehëse të kulturës e të shkencës shqiptare, siç është Martin Camaj. Në këtë jubile të rëndësishëm të 85-vjetorit të ditëlindjes së tij, ndonëse ai tashmë prehet nën dhe, të pranishmit në këtë tubim, po edhe masa e gjerë e studiuesve dhe e shkollarëve shqiptarë e më gjerë, e përkujtojnë me nderim e vlerësime të larta meritore për atë çfarë bëri e la **mbi dhe e për këtë dheun tonë** të vuajtur e të pleksur me mall e lot, pavarësisht se që i shtrënguar të rronte për pjesën më të madhe të jetës në Itali e në Gjermani dhe, as mbas viteve '90, ndonëse liria tashmë kishte ardhur, ai nuk e pa kurrë më Shqipërinë dhe do t'i mbyllte sytë larg Temalit të vet, në Gjermaninë e madhe, ku të tilla (të mëdha e të të vyera) qenë edhe bëmat e ndihmesat që kreu ai si studiues e si profesor në Universitetin e Mynihut. Diku në poezinë e tij, Camaj thotë në mënyrë metaforike se ndërsa kishte lindur në një vend të varfër e ku, kur vdiste dikush, bëheshin drekë të mëdha “*me ngi të unshmit e thneglat e lamit*”, ai u nda së gjallësh “*në një vend të ngimë*”, në Gjermaninë e pasur, ku në drekët mortore japin “*vetëm kafe të hidhëta*”.

Martin Camajn e përkujtojmë sot si studiues dhe si poet e shkrimtar të përmasave të mëdha, si profesor të disa universiteteve me emër të madh, si Universiteti i Romës “La sapienza”, ku ai që edhe “krahu i djathtë” i Ernset Koliqit në Institutin e Albanologjisë e bashkë me të cilin drejtoi edhe revistën e mirënjohur “Shejzat” (Le Pleiadi); në Mynih e gjetë kë universitete gjermane ku themeloi qendrën albanologjike dhe katedrën e

shqipes e përgatiti atje një çetë studiuesish, ish-studentë të tij, sot albanologë të mirënjohur, si: Waletre Breu, Armin Hetzer, Elvira Glaser, Gabirele Birken -Silverman etj., të cilët kanë hulumtuar me kujdes e zell në lëmin e filologjisë e të albanistikës arbëreshe e shqiptare, duke ecur me nderim e mirënjohje në hullitë e mjeshtrit e mësuesit të tyre, prof. Martin Camajt.

Martin Camaj jetoi e punoi kryesisht në dhe të huaj, sepse vetëm vitet e fëmënisë e të rinisë i kaloi në vendlindjen e tij, në Shqipëri, porse ai kudo që u gjend diti të mbahej fuqishëm në rrënjët shqiptare dhe pohoi aq fisnikërisht kudo e kurdoherë se i përkiste një visi të vogël, por të shtrenjtë për të: malësisë shqiptare, Dukagjinit malor e Shkodrës sonë, të dalluar ndër shekuj për bijtë e saj të mëdhenj që ka nxjerrë e që e kanë nderuar dhe e nderojnë në botën e jashtme. Lindi në Temal dhe mësimet e para i mori në Kolegjin Saverian të Shkodrës, në atë qendër të shquar të kulturës shqiptare, prej nga kishin dalë edhe më parë breza veprimtarësh e atdhetarësh, që i dolën zot shqiptarisë. Mendoj se ka të drejtë studiuesi arbëresh F. Altimari, që thotë se “*Camaj ishte eksponenti i fundit i asaj tradite të lashtë e të lavdishme kulturore shkodrane*”.

Në vitin 1946, kur u mbyllën Kolegji Saverian dhe të gjitha shkollat fetare në Shqipëri, Martini u detyrua t’i ndërpriste studimet dhe më 1949 la atdheun, u arratis në Jugosllavi, ku menjëherë u regjistrua në Universitetin e Beogradit. Atje studioi sllavistikë dhe u njoh me poezinë popullore ballkanike. Pikërisht në atë kohë shkroi edhe vjershat e para dhe nisi t’i botojë ato në Prishtinë. Më 1950 doli përmbledhja e tij e parë me vjersha, e cila do të kishte ndikim të mirë në formimin e brezit të parë të shkrimtarëve shqiptarë në Kosovë. Më 1956 Martin Camaj shkon në Itali dhe regjistrohet në Universitetin e Romës “La sapienza”, në Fakultetin e Letërsisë e të Filozofisë, ku më 1960 mbron tezën e laurës me një temë rreth “Mesharit” të Gjon Buzukut. Në vitet që studioi në Romë ai ndoqi ligjeratat e Giuseppe Ungaretit dhe ra në kontakt me hermetizimin, rrymë letrare që pati një farë ndikimi në krijimtarinë letrare të mëpastajme të Martinit. Gjithashtu, asokohe, u njoh me kulturën dhe me letërsinë e arbëreshëve të Italisë e me disa nga përfaqësuesit e tyre në zë, si: Antonio

Guxeta (Guzzetta), Françesko Solano, Xhuzepe Gradilone etj. me të cilët lidhi miqësi dhe bashkëpunoi ngusht e për kohë të gjatë. Në Romë Martini jetoi dhe veproi për një kohë të gjatë, bashkëpunoi me shkrimtarin e njohur Ernest Koliqi dhe me revistën e tij "Shejzat", duke u bërë, më vonë, edhe kryeredaktor i saj. Për disa vjet në Romë Camaj punoi si ligjërues (lektor) i gjuhës shqipe në katedrën që drejtonte Koliqi dhe nisi, kështu, karrierën e tij të shkëlqyeshme letrare si poet e si romancier, po edhe u bë i njohur si studiues i problemeve letrare dhe i dialekteve të shqipes, sidomos të arbëresheve të Italisë. Në vitin 1965 Camaj u transferua në Gjermani, ku do të vazhdonte edhe më me fryt karrierën e tij akademike në fushën e albanologjisë, duke u emëruar, në fillim, docent e më 1971 profesor titullar i katedrës së gjuhës shqipe në Universitetin e Mynihut.

Në Gjermani Camaj gjeti një mjedis të përshtatshëm për studime dhe ku, qysh para se të mbërrinte ai atje, kishte pasur edhe një kah të mbarë studimesh të dialektologëve gjermanë me theks e prirje të veçanta ndaj të folmeve të diasporës arbëreshe të Italisë. Mund të përmendim se, në vargun e romanistëve, për interesimin që tregoi për të folmet arbëreshe të Italisë, vend të veçantë zë gjuhëtari gjerman **Gerhard Rolfs** (Rohlf) (1892-1986). Fusha e përhershme e studimeve të tij, siç dihet, kanë qenë gjuhët romane, por ai, në këtë kuadër, kur studioi dialektet dhe onomastikën e Italisë Jugore, u ndesh edhe me mjediset aloglote të arbëreshëve dhe jo vetëm nuk u kaloi anash, por u dha vend të mirë në veprat e tija. Përmendim se, Rolfsi, si anketues dhe realizues i pikave të Italisë Jugore dhe të Sicilisë për "*Atlasin gjuhësor dhe etnografik të Italisë dhe të Zvicrës Jugore*" (që u botua midis viteve 1928 dhe 1940 nga Jakob Judi e Karl Jabergu), midis tetëdhjetë pikave të anketuara futi edhe një ngulim arbëresh e pikërisht **Firmozën** (*Acquaformosa*), që figuron në hartat e AIS me numrin 751.

Mbi të dhënat e mbledhura nga Rolfsi në Firmozë, një tjetër dialektolog gjerman, Rypresht Ror (Ruprecht Rohr) përpunoi një studim doktorati me titullin *Firmoza, një ngulim arbëresh në Veri të Kalabrisë, Pika 751 në AIS* (*Acquaformosa eine albanische Kolonie in Nord Kalabrien, Der Punkt 751 auf dem Sprach- und Sachatlas Italiens und*

Sudschweiz), që e mbrojti më 1954-n në Universitetin e Lirë të Berlinit. Më pas, Rori e zgjeroi edhe më tej kërkimin e tij rreth së folmes arbëreshe të Firmozës, duke u përqendruar më fort në sistemin morfologjik të saj, po edhe në një varg dukurish të tjera të sintaksës e të leksikut. Ai jep, gjithashtu, shqyrtime interesante e të hapëta me karakter sociolinguistik dhe historiko-kulturor, si dhe përsiatje rreth arbërishtes si gjuhë në kontakt e nën ndikimin e italishtes.

Fryt i kësaj vëmendjeje të posaçme që Rori u jepte të folmeve arbëreshe në Italinë e Jugut e në Sicili ka qenë edhe vijimi i kërkimeve në ato mjedise nga prof. Martin Camaj dhe nga nxënës të Rohrit e të tij, si Gabriele Birken-Silverman, e cila me shumë përkushtim po merret me studimin dialektologjik e sociolinguistik të së folmes arbëreshe të Piana deli Albanezit e të Kuntisës. Gjithashtu, këto vitet e fundit, me shumë interes po kërkojnë nëpër të folmet arbëreshe të Italisë disa studiues të rinj gjermanë, ish- nxënës të Martin Camajt, si Valter Broi (Breu) dhe Elvira Glaser.¹⁷⁶

Martin Camaj për të folmet arbëreshe të Italisë

Në kuadrin e ndihmesave dhe punës për njohjen, studimin dhe vlerësimin e të folmeve arbëreshe të Italisë nga ana e studiuesve gjermanë, meritë të veçantë ka edhe Martin Camaj (1925-1992), i cili nuk qe gjerman, por jetoi dhe punoi për shumë vjet në Gjermani dhe ku, prej vitit 1965 deri në vitin 1990 drejtoi katedrën e gjuhës e të letërsisë shqipe në Universitetin e Mynhenit. Martin Camaj, një nga albanologët më të shquar të fundshekullit tonë, para se të shkonte në Gjermani si profesor e titullar i katedrës, kishte marrë një formim të gjerë filologjik e gjuhësor në Universitetin e Romës, në fillim si nxënës e pastaj si asistent i Ernest Koliqit pranë katedrës së gjuhës e të letërsisë shqipe. I përket pikërisht asaj periudhe "romane" të tij njohja e parë me mjediset dhe të folmet e diasporës

¹⁷⁶ Po ai, *po aty*, f. 437- 439.

arbëreshe të Italisë. Pasi u transferua në Mynhen, për rreth tridhjetë vjet, Camaj pjesën kryesore të kërkimeve të tija ua kushtoi pikërisht gjuhës, folklorit dhe letërsisë së arbëreshëve të Italisë. Kështu, që nga fillimi i viteve '60 deri në fund të viteve '80, ai kreu një hetim sistematik rreth të folmeve të ndryshme arbëreshe dhe arriti të përshkruante tipin më përfaqësues të zonave të ndryshme dialektore, sidomos të atyre më anësore (periferike) dhe më të ekspozuara ndaj ndikimit asimilues të italishtes. Këto studime dialektologjike të Camajt, të mbështetura në metodologjinë gjuhësore strukturale sipas modelit të gjuhësisë funksionale të A. Martinesë etj., përbënin një ndryshim rrënjësor në kërkimet dialektologjike në trevat arbëreshe e përgjithësisht në dialektologjinë shqiptare. Mund të përmendim këtu studimin për të folmen e Greçit "*La parlata albanese di Greci*" (1971), që është monografia e parë e plotë e një të folmeje arbëreshe dhe që u ndoq pastaj me një numër përshkrimesh të tjera dialektologjike.¹⁷⁷ Ai ka botuar, gjithashtu, një numër të madh artikujsh e ndihmesash rreth dukurive të veçanta të të folmeve arbëreshe të Italisë, si p. sh. rreth dygjuhësisë italo-arbëreshe, rreth tipologjisë së arbërishtes, mbi disa mbeturi të së folmes arbëreshe të Villa Badesës, si dhe rreth plurilinguizmit ndër arbëreshët e Amerikës.¹⁷⁸

Prof. Martin Camaj e mbajti postin shefit të katedrës së shqipes në Universitetin e Mynihut për njëzet vjet radhazi, deri më 1990-91, kur doli

¹⁷⁷ Shih, punimet për të folmet e Falkonarës, shkruar gjermanisht "*Die albanische Mundart von Falconara Albanese*" (1977), për të folmen e Shën-Kostantinit "*La parlata albanese di San Costantino albanese*" (1993), si dhe një korpus tekstesh gojore arbëreshe me titull "*Racconti popolari di Greci e di Barile*" (1972) të mbledhura prej tij gjatë viteve që hetonte rreth të folmeve përkatëse.

¹⁷⁸ Shih: M. Camaj, *Zur albanischen Mundart von Barile in der Provinz Potenza*, in "Dissertationes albanicae, XIII. Band, Dr. Rudolf Trofenik, Munchen, 1971, f. 127-140; *Il bilinguismo nelle oasi linguistiche albanesi dell' Italia meridionale*, në "Bilinguismo e diglossia in Italia", Centro Studi per la Dialettologia Italiana, Pacini Editore, Pisa, 1974, f. 5-13; *Sprachreste der albanischen Mundart von Villa Badessa in der Provinz Pescara*, në "Sudesteuropa unter dem Halbmond, Festschrift Georg Stadtmüller, Munchen 1975, f. 37-43; *Per una tipologia dell' arbëresh*, në "*Etnia albanese e minoranze linguistiche in Italia* (a cura di Antonino Guzzetta), Palermo, 1982, f. 151-158; *Aspetti del plurilinguismo presso gli Arbëreshë d' America*, në "*Zjarri*", 1986, nr. 30 dhe 1989, nr. 33.

në pension. Rasti e kërkon të theksjmë se, për hir të veprimtarisë së tij të zhvilluar në atë qendër, si dhe nga emri i mirë e reputacioni i gjerë që kishte Martin Camaj në Gjermani, u arrit që në Universitetin e Mynihut albanologjia të bëhej një “Fachstudium” dhe është i vetmi universitet i Evropës Perëndimore që lëshon tituj pasuniversitarë “Magister-artium” dhe “Doctor philosophie”. Ky, sigurisht, është nder i madh dhe krenari për kombin e popullin shqiptar, nga gjiri i të cilit kanë dalë pinjoj të tillë të shquar. Mjerisht, ai nderoi Shqipërinë dhe shqiptarët me veprat që u blati e me një jetë të tërë vepruese e të përkushtuar ndaj gjuhësisë, letërsisë dhe kulturës sonë kombëtare, kurse atij, sa qe gjallë, në Shqipëri studiuesve dhe shkollarëve nuk iu lejohej as t’ia lexonin veprat, as t’ia përmendnin emrin në radhën e shkrimtarëve dhe studiuesve. Pa dyshim, një qëndrim i tillë ka qenë dhe mbetet një njollë e zezë e një turp për historinë e Shqipërisë, në faqe e zezë që urojmë të mos përsëritet kurrë me asnjë krijues a studiues, po edhe që duhet rikuperuar me aq sa është e mundshme në kohën tonë. Kurrë nuk është vonë për t’ua vënë në vend nderin që u takon bijve më të shquar të kombit shqiptar. Pa dyshim, një prej atyre bijve të shquar është edhe prof. Martin Camaj, poet, shkrimtar, dramaturg dhe albanolog i dallaur shqiptar, që punoi e jetoi kryesisht në dhe të huaj, porse ai, me zemrën e tij të pavdirë, qe kurdoherë në Shqipëri e në çdo vis të saj.

Ky bir i maleve tona, i gjatë e i pashëm si pak të tjerë, qe edhe i pajisur me zell për studim e talent për shkrimtari dhe, mbi të gjitha, me vullnetin e shpirtin e papërkulshëm e me zemër liridashëse, kishte një personalitet vetanak ku takohen dy përmasat njerëzore për të cilat fliste shpesh studiuesi i madh rumun Mircea Eliade: “*dimensionin diellor, që synon në njohjen shkencore, dhe dimensionin hënor, që synon krijimin artistik*”. Është fakt që, shkenca dhe letërsia, apo sipas përfytyrimit eladian: dielli e hëna, shkrihen në zotimin intelektual të kësaj figure të shquar të kulturës shqiptare të gjysmës së dytë të shekullit XX, i cili gjakoi në një impenjim të drejtuar në mënyrë konvergjente mbi hulumtimin e një kulture mijëravjeçare, që për shumë shekuj kishte rrojtur vetëm si traditë gojore, e pashkruar dhe që Camaj i qaset, nga një anë, me kërkimet e tij gjuhësore mbi tekstet e vjetra të shqipes e mbi të folmet arkaike të diasporës

arbëreshe dhe, nga ana tjetër, me shfrimin e ndjeshmërisë së tij moderne në krijimtarinë letrare si poet e prozator. Pra, në sajë të dy palë dhuntive: shkencore e letrare, Martin Camaj do të lëvronte në drejtime të ndryshme, por me një bosht e taban të përbashkët mbarëshqiptar: në albanologji e në fushën e letërsisë dhe, për të dyja fushat, jep vepra të mëdha e që për hir të tyre ai u njoh dhe mbeti si figurë e shquar në botën e qytetëruar evropiane ku jetoj dhe qe, për shumë kohë, si një dëshmitar e pohues i vlerave dhe i historisë së popullit shqiptar, pavarësisht se (për një paradoks që ndodhi vetëm nën diktaturën komuniste të kohës) emri dhe veprat e tij konsideroheshin krejt të ndaluara në Shqipëri deri në periudhën e shndërrimeve demokratike. Kjo gjë, sigurisht, e hidhëronte dhe e brengoste krijuesin e shquar, por nuk e ligshtonte e nuk rreshti për asnjë çast nga puna e tij e palodhur për t'ia bërë të njohur botës së qytetëruar të mirat dhe virtytet e Shqipërisë së lashtë. Ai shkruan për vlerat e pavdira të kulturës së popullit shqiptar, që ishte mbërthyer në “rrathë gjaku” nga pushtuesit e huaj në të kaluarën e nga diktatura e kuqe në gjysmën e dytë të shek.XX, por që, prapëseprapë, ishte popull vital e që meritonte tjetër të ardhme, tjetër hapësirë kulturore, tjetër hapësirë jetike.

Kështu, autori ynë merr pjesë në të tashmen historike të kombit shqiptar, por tashmë edhe në një përmasë të kohës më komplekse në të cilën kujtimi i së shkuarës dhe projeksioni i së ardhmes shkrihen në një ideim të vetëm dhe vërtet original, siç e gjejmë në vjershat dhe sidomos në romanet e tij “Rrathët”, “Karpa”, “Diella” etj.

Gjatë gjithë viteve të karrierës së tij akademike, si docent e profesor i gjuhës shqipe në universitete të ndryshme të Evropës, si dhe me veprën e tij letrare, Martin Camaj ka përfaqësuar një pikë referimi të sigurtë për të gjithë studiuesit e huaj që merren me albanologji dhe për intelektualët e diasporës.

Martin Camaj nuk la trashëgimtarë, as djalë as vajzë, porse ai na ka lënë veprën e tij në shumë vëllime: në poezi, në prozë dhe studimet shkencore rreth gjuhës e dialekteve arbëreshe e më gjerë, një përmendore e artë dhe vërtet e shndritshme, për hir të së cilës, emri dhe lavdia e tij do të

jenë përherë të gjalla në zemrat e mendjet e breznive të sotme e të atyre që do të vijnë.

I lumtë Universitetit të Shkodrës “L.Gurakuqi”, Departamentit të Gjuhës Shqipe dhe Sektorit shkencor dhe Shoqatës atdhetare “Dukagjini”, që na mboldhën sot në këtë tubim jubilear për nder të Martin Camajt e na dhanë mundësinë të shprehim vlerësimet e nderimin që i takojnë një burri të shquar si ai.

**Martin Camaj – a well-known figure of the Albanian albanology
and literature
(Values, appreciations and memories)**

Marin Camaj was commemorated today as a researcher and as a poet and writer of great values, as a professor in some well-known universities, such as Rome University “La Sapienza”, where he was the “right hand” of Ernest Koliqi at the Institute of Albanology, and they together run the well-known magazine “Shejzat” (Le Pleiadi). He taught in Munich and other German universities and in Munich he established the center on albanology and the Albanian department and he taught there to a team of researchers, some of them were his former students, who nowadays are well-known researchers on albanology such as: Walter Breu, Armin Hetzer, Elvira Glaser, Gabriele Birken-Silvermann etc., who have carefully and earnestly probed in the field of philology and of the Albanian and arbëresh albanology by following with great respect and gratefully the same tracks of their master and professor Martin Camaj.

I think that the arbëresh researcher F. Altimari is right when he states that “*Camaj was the last member of that cultural - ancient and glorious tradition – of Shkodra region*”.

Martin Camaj, one of the most distinguished albanologists of the end of our century, before going to [Germany](#) as a professor and head of the department, had gained a wide philosophical and [linguistic knowledge](#) at the [University of Rome](#), at the beginning as a student and later on as an

assistant of Ernest Koliqi at the department of [Albanian language](#) and literature. It is exactly at this “roman” period that he came for the first time into contact with the culture and language of the arbëresh diaspora of [Italy](#). After that he was transferred to Munich, for about thirty years. Most of Camaj’s researches were focused on the language, folklore and literature of the arbëresh of Italia. These researches on dialectology, conducted by Camaj, based on the structural linguistic approach according to the model of functional linguistics of A. Martinee?? etc. constituted a fundamental change in dialectological researches on the field of dialects in the arbëresh regions and, in general, on the Albanian dialectology. We might mention here the research in the Greç dialect, "*La parlata albanese di Greci*" (1971), which is the first full monograph of an arbëresh dialect which was later on followed by a number of dialectological descriptions. He has also published a large number of articles and contributions on specific occurrences of the [spoken language](#) of the arbëreshi dialects of Italy such as: on the Italian-arbëresh bilingualism, on the typology of arbëreshi language, on some remnants of the arbëreshi language of Villa Bades, and on plurilinguism among arbëreshs of America.

This son of our mountains, tall and handsome like only a few people, he was eager to study and had a talent in writing. Above all, he was characterized by a strong-will and a determined freedom-loving spirit. He had his own personality where usually two human dimensions would meet, often mentioned by the great Rumanian researcher Mircea Eliade who stated: "*the solar dimension, which aims at knowing science, and the lunar dimension, which aims at artistic creativity*". It is a fact that science and literature, or according to the eladian imagination: sun and moon, are merged into the creation of this well-distinguished intellectual personality of the Albanian culture of the second half of the XX century.

During all his academic career, as a PhD and Professor of the Albanian language in different European universities, and through his literature studies, Martin Camaj was a secure referral point for all the

international researchers dealing with Albanology and for the intellectuals of diaspora.

Martin Camaj did not leave any heirs behind, but he has left us his studies in many volumes: in poetry, prose and scientific studies on the arbëresh language and dialects and further a golden and shiny monument and his name and glory will always be in the hearts and minds of the today's generations and of the coming ones.

I would like to congratulate the University of Shkodra "L.Gurakuqi", the Department of the Albanian Language and Scientific Sector, that brought us all together here into this jubilee activity to honour Martin Camaj and that gave us the possibility to express our appreciation and honour for such a distinguished personality like him.

Bardhyl DEMIRAJ (Gjermani)

JETA AKADEMIKE E MARTIN CAMAJT

Ky studim ka karakter biografik dhe trajton si i tillë një aspekt të jetës së Martin Camajt, të cilën e përcjellim sot e gjithë ditën thuajse në çdo artikull përkujtimor publicistik, apo në ese e studime të mirëfillta shkencore që shtjellojnë përgjithësisht dy pamje të aktivitetit të tij intelektual: a) si shkrimtarin më të spikatur në letërsinë e mërgatës shqiptare gjatë gjysmës së dytë të shek. XX; dhe b) si studiuesin albanolog me prurje kryesore në fushat e gjuhësisë diakronike e sinkronike, të filologjisë shqipe dhe të dialektologjisë arbëreshe. Në funksion me objektin dhe qëllimin e këtij studimi lejohemi të saktësojmë që në fillim se të gjitha këto trajtesa i bashkon në thelb një emërues i përbashkët: jeta akademike e Martin Camajt prezantohet gjithëherë me stil telegrafik e me të dhëna të përgjithshme që kufizohen në stacione të ndryshme të jetës së tij private.

Një paraqitje të tillë e kushtëzojnë pas gjase disa rrethana objektive dhe subjektive: së pari, mungon një autobiografi e detajuar, e hedhur në letër nga penda e vetë Martin Camajt, apo e ndonjë bashkëkohësi ose bashkëpunëtori të ngushtë në gjallje të tij; së dyti, materiali arkivor e dokumentar që mëton saktësi dhe siguri në të dhëna të mirëfillta biografike, mbetet ende i shpërndarë dhe/ose i panjohur, në mos i rrëgjuar njëherë e përgjithmonë. Këto vështirësi feksin sidomos në fazën e parë të formimit shkollor-universitar si edhe të punës së tij në arsimin fillor në Shqipëri (Shkodër – Prekal), apo në ish-Jugosllavi (Tuz – Pejë, Beograd – Sarajevë); së fundi mund të shtojmë se edhe materiali ekzistues në jo pak raste përmban të dhëna kundërthënëse. Mjafton të citojmë këtu si rast diskutimi ditën e lindjes së autorit, e cila kumtohet zyrtarisht si data 21 korrik 1925, ndërkohë që rrethi i ngushtë familjar ruan të fiksuar në kujtesë datën 13 korrik 1925.

Studimi ynë rreket si i tillë të mbushë pikërisht boshllëqe të kësaj natyre, të përfuara prej rrethanave të parashtruara më lart, dhe është rezultat i krehjes dhe i sistemimit të materialit burimor, të mbledhur gjatë kërkimeve tona në Gjermani pranë arkivit të familjes Camaj (Lenggries, = AFC), përkatësisht të ballafaqimit të tij me dokumentacionin origjinal të depozituar në arkivin “Monacensia” të qytetit të Munihut (= AMM). Kërkime plotësuese janë zhvilluar gjithashtu pranë arkivit të Universitetit Ludwig-Maximilian të Munihut (= AULM), ku është e depozituar dosja “Camaj”, shih dosja e punës së profesorit të dikurshëm të këtij universiteti. Krahas materialit dokumentar zyrtar i kemi kushtuar vëmendje të veçantë edhe një pjese të korrespondencës së tij private si edhe kujtimeve të lëna në dorëshkrim prej miqsh e bashkatdhetarësh të mërgatës shqiptare në Evropë dhe USA ose prej kolegësh dhe ish-studentësh të tij, ndër të tjerë: At Daniel Gjeçaj, dr. Tom Koka, Gjon Shllaku, Bik Pepa, prof. Peter Bartl, Hans-Joachim Lanksch, Gjelosh Gjoka e ndonjë tjetër.

Sa i përket metodikës së studimit mund të përmendim shkurt se për sistematizimin dhe klasifikimin e materialit dokumentar e burimor i jemi përmbajtur përgjithësisht ndërthurjes dhe zbatimit të kriterëve a) kohë, dhe b) hapësirë. Në këtë hulli jemi rrekur gjithashtu të dallojmë brenda jetës akademike të Martin Camajt faza të caktuara të formimit ndaj sosh të ushtrimit të profesionit, edhe pse në një periudhë bukur të gjatë (sidomos në vitet 1948 – 1965), formimi shkollor-universitar dhe ai pasuniversitar është zhvilluar paralelisht me karrierën e tij akademike.

Stacione në formimin intelektual dhe aktivitetin akademik të Martin Camajt

A. Në Shqipëri

1. Në Temal (1925 - 1935)

“Kam lindë në një vis të egër ‘ku s’ka shkelë kurrë kamba e kalit’, kaq i thyeshëm ashtë ky vend”, përshkruan vetë Camaj vendlindjen e vet¹⁷⁹,

¹⁷⁹ Martin Camaj: “Palimpsest”, “Biblioteka shqipe”, nr. 7, Michigan, 1991, f. 1: “I was born in a wild country “where a horse’s hoof never trod“, because the place is so precipitous.”

Temalin, një katund i zonës së thellë malore të Dukagjinit¹⁸⁰. Këtu ai lindi më 13 korrik të vitit 1925¹⁸¹ në një familje të thjeshtë me prindër katolikë të ndershëm, Terezën dhe Kolën. Aty ai i kalon dhjetë vitet e para të fëmijërisë, ku nuk dallohet aspak për ndonjë aftësi apo shkathtësi në përmbushjen e detyrave të ditës në një ekonomi familjare të zakonshme. Përkundrazi, aftësitë e tij shfaqen në tjetër drejtim: ai fiton në mënyrë autodidakte njohuritë e para në shkrim dhe lexim shqip si edhe në matematikë,¹⁸² çka i bie njëherësh në sy edhe ish-pagëzuesit të tij, P. David Pepës OFM,¹⁸³ duke e nxitur kështu të ndërmerretësojë pranë instancave eprore në Shkodër, në mënyrë që të ndërmerreshin përçapje konkrete lidhur me arsimimin dhe përgatitjen – pse jo! – për meshtari të cullakut inteligjent Martin Camaj. Zgjuarësia e Martinit, përpos skamjes në familje, duhet të kenë qenë gjithsesi dy arsye të forta që mundësuan dërgimin e tij në shkollë¹⁸⁴ në qendrën kryesore urbane të Shqipërisë Verilindore.¹⁸⁵

¹⁸⁰ Në dokumentacionin zyrtar apo në letërsinë dokumentare (në ndonjë rast të firmosur nga vetë Camaj) njihemi edhe me vendlindje të tjera, si p.sh.: Shkodër (~ Scutari), Dukagjin, Telum (-Temal) dhe Dushman.

¹⁸¹ Në rrethin familjar të Camajt mëtohet që data 21 korrik – e njohur zyrtarisht si data e lindjes së Camajt –, të ketë qenë në fakt dita e emrit, përkatësisht e pagëzimit dhe regjistrimit të tij në kishë. Dr. Tom Koka – bashkëkohës i Camajt – në kujtimet e tij shkruan gjithashtu: “Me tregoi se kishte lindë ne Temal me 13 korrik 1925 nga një familje bujqish.” Në ndonjë dokument zyrtar nuk mungon të shkruhet gabim muaji i lindjes, pikërisht si 21 giugno (= qershor) 1925 (AFC, AMM).

¹⁸² Në një bisedë të lirë me Martin Camajn, Ndoc Volaj e kujton se si humbi nga kontrolli lopën që duhej të bariste në bjeshkë, meqë rrekej gjithë kohës t’i mësonte edhe atij shkronjat shqipe. [kumtim me gojë nga Erika Camaj – B.D.]

¹⁸³ AMM: MCB 86 - letër Camajt prej Bik Pepës (13.02.1992).

¹⁸⁴ Camaj nuk mungon të përcjellë në mënyrë poetike shkëputjen prej trungut familjar në poezinë “Tregim i thjeshtë”: *Im vëlla gjak-nxehtë / Si ma njofti mendën / befas nisi të pleqnojë e tha: / « Dy duer na jemi e një krye, po i ndajmë na punët: / unë shpatën — ti pendën! »* (“Njeriu më vete e me tjerë”, në: “Biblioteka shqipe”, Nr. 2, Romë, 1978, f. 82.

¹⁸⁵ Sipas Tom Kokës (kujtime): “Veshtiresite ekonomike e te jeteses ne ate kohe. Bien ne ujdj etenit jezuite e franceskane me prindenit e e çuene ne Kol. Saverian, ku perpose shkollimit, prirja per meshtari.” (AFC)

2. Në Shkodër (1935 – 1946)

Në vitin 1935 Camaj vendoset përfundimisht në Shkodër dhe fillon të marrë arsim të rregullt pranë kolegjit jezuit “Xaverianum”, i mirënjohur atëbotë gjithkund në Shqipëri për formimin e plotë klasik, krahas atij fetar. Rektor i kolegjit ishte historiani i shquar erudit P. Giuseppe Valentini SJ, prej të cilit mësojmë më vonë se Camaj kish përfunduar në katër vjet arsimin fillor 5-vjeçar, ndërsa pesë vitet në vazhdim ai kishte ndjekur rregullisht gjimnazin, duke fituar kështu të drejtën për të vijuar studimet në liceun klasik të atij kolegji. Këto studime ai detyrohet t’i ndërpresë në vitin e tretë, pikërisht në vitin 1946, kur regjimi komunist ndaloi përfundimisht aktivitetin e kolegjit.¹⁸⁶

Lidhur me jetën e tij në kolegji, të dhënat dokumentare që njohim deri sot janë të paka dhe fragmentare. Përpos ndonjë rasti korrespondence të vonuar me ish bashkënxënës të kolegjit,¹⁸⁷ kemi fituar ndërkohë informacion lidhur me mbarëvajtjen e studimit të nxënësit dhe gjimnazistit Camaj në kolegji. Listat e notave të marra gjatë viteve akademike 1937 – 1946 dëshmojnë për dhunti të spikatura të Camajt në lëndët e gjeografisë, të historisë dhe në doktrinën fetare, si edhe për rezultate të mira në disa lëndë të tjera, si gjuhë shqipe, latinisht, italisht etj.¹⁸⁸

3. Në Prekal (1946 – 1948)

¹⁸⁶ Ja teksti i plotë i deklaratës së dhënë nga P. Giuseppe Valentini SJ: “Dichiarazione: Io sottoscritto, P. Giuseppe Valentini S.J., dichiaro a tutti gli effetti che il signor MARTIN CAMAJ, nato a Scutari (Dukagjin) in Albania il 21.7.1925 da Kolë e da Teresa Vukaj, è stato alunno del Collegio „Saveriano“ dei Padri Gesuiti di Scutari dal 1935 al 1946 (anno in cui detto Collegio fu chiuso dal Governo comunista) e vi ha frequentato le cinque classi elementari (in quattro anni), le cinque classi ginasiali e il liceo classico fino al terzo corso. In fede (nënshkruar: Giuseppe Valentini [...] Milano, 6.11.1961“ (AFC).

¹⁸⁷ E tillë është p.sh. një letër e shkruar nga Gjon Shllaku, i cili risjell kujtime nga koha që kanë kaluar bashkë në kolegjin Saverian (AMM: MCB 104).

¹⁸⁸ Shih Markus Peters: *Die jesuitischen Bildungseinrichtungen in Shkodra als Hintergrund der geistig-geistlichen Bildung Martin Camajs*, në: Bardhyl Demiraj (Hrsg.) „Wir sind die Deinen“, Wiesbaden 2010, 586 vv. Autori citon në këtë rast burimin e materialit që ndodhet në AQSH, Fondi i Arkidioqezës së Shkodrës 132A, dosja 74, viti 1937 (sic!).

Dy vitet në vazhdim Camaj ka kaluar një periudhë të vështirë, e cila mbetet ende për t'u hulumtuar. Duhet të ketë punuar si mësues në zonën e thellë të Prekalit, derisa vendos të largohet njëherë e përgjithmonë nga dheu i të parëve,¹⁸⁹ të cilin nuk ngurron ta kujtojë më vonë si “bota e vjetër për mos me i thanë vendlindje”.¹⁹⁰

B. Në ish-Jugosllavi

1. Në Tuz dhe Pejë (1949 – 1950 ?)

Pas arratisjes nga vendlindja Martini vijon të ushtrojë për do kohë profesionin e mësuesit në shkollën fillore “Mahmut Lekiq” në katundin shqiptar të Tuzit në Mal të Zi;¹⁹¹ gjithashtu nuk mungon të plotësojë dhe zyrtarizojë edhe aftësitë e tij në mësimdhënie në vendndodhjen e re. I tillë është rasti i ndjekjes së një kursi intensiv tremujor në Pejë (1 korrik – 30 shtator 1949), ku Camaj fiton “Diplomën e pjekunis për mësuesi”. Në listën e notave të marra në provimet e detyrueshme feks rezultati “shkëlqyeshëm” në lëndën e gjuhës dhe të letërsisë shqipe.¹⁹²

1. Në Beograd (1950 – 1955)

Viti 1950 e gjen Martin Camajn në Beograd, ku fillon studimet e larta pranë universitetit të kryeqytetit të atëhershëm jugosllav. Këtu ai diplomohet pas pesë vjetësh (2[0] korrik 1955) duke dhënë provime diplome në degën e filologjisë romane me fusha kryesore gjuhë dhe letërsi italiane.¹⁹³

2. Në Sarajevë (1955/1956 ?)

¹⁸⁹ Tom Koka (kujtime): “Martini gjen pune si arsimtar ne Prekal per dy vjet. Kujtohet se parimet ma fillestare e levizja ishin cungue e krijue pabesimi per te kuqet per nji kontroll ma te perpiket. Martini kishte njoftë prind femijesh e nje grue te veje, te shoqin hjeke qafet pa asnji arsye. Ishte ma se i bindun se ne Shqipeni ishin sose ato ato parime, pa te sillat jeta s’ka veshtrim. Pra arseja me u largue nga vendi. Nuk u shtyena ne hollesina pse s’ ishte as koha as vendi e vazhdueme ne subjekte te tjera.” (AFC)

¹⁹⁰ AMM: MCB 125: Camaj drejtuar A. N. Berishës (12.05.1985).

¹⁹¹ Me rastin e festimit jubilar të 100-vjetorit të saj, në dhjetor 2007, kjo shkollë e nderon Camajn (pas vdekjes) me diplomën e “Mirënjohjes” (dokumenti origjinal – AFC).

¹⁹² Diploma (nr. 71, nr. prot. 646) me listën e notave përkatëse është lëshuar më datë 30 shtator 1949 (dokumenti origjinal – AFC).

¹⁹³ Diplomë nr. 3425, lëshuar më 2 korrik 1955 (dokumenti origjinal – AFC).

Menjëherë pas mbylljes së studimeve universitare në universitetin e Beogradit, Camaj fillon të përgatitet për një kualifikim pasuniversitar në albanologji në fakultetin filozofik të Universitetit të Sarajevës pranë albanologut të njohur kroat prof. Henerik Barić. Në bashkëpunim me të, si edhe me mentorin e dytë, prof. Rikard Kuzhmić, ai vendos të promovojë në filologji duke përzgjedhur si temë doktorate “Gjuha e Gjon Buzukut”. Kërkesa përkatëse e mentorëve të tij miratohet prej këshillit shkencor të atij fakulteti në mbledhjen e vet të datës 16 shkurt 1956.¹⁹⁴

Përpos një vërtetimi zyrtar për pranimin të kërkesës për të doktoruar pranë atij universiteti, na mungon çdo lloj informacioni që tumir qëndrimin e tij dikur në Sarajevë. Gjithsesi ky qëndrim, edhe në rast se do të vërtetohet si i tillë, duhet të ketë qenë i përkohshëm,¹⁹⁵ meqë më 20 shtator¹⁹⁶ të po atij viti Camajn e ndeshim në Romë, pranë prof. Ernest Koliqit, i cili drejtonte atëkohë Institutin e Studimeve Shqiptare, përkatësisht Katedrën e Gjuhës dhe të Letërsisë Shqipe pranë Universitetit të Studimeve të Romës.

C. Në Romë/Itali

¹⁹⁴ Në AFC ruhet shkresa origjinale (kroatisht) e sekretarisë së fakultetit filozofik me nr. prot. 4647/55, lëshuar më 14.03.1956 me adresim adresën e tij në Beograd (Djevdjeliska br. 29), në të cilën shkruhet shprehimisht: “Shoku Martin Camaj. Në mbledhjen e tij, më dt. 16 shkurt 1956, këshilli i fakultetit filozofik në Sarajevë pranoi kërkesën e dr. Henerik Barić-it, prof. ordinar, dhe Rikard Kuzmić-it, prof. joordinar i po këtij fakulteti për të njohur temën „Gjuha e Don Gjon Buzukut“ si temë doktorate. Po jua bëjmë paraprakisht të njohur. Vdekje fashizmit – liri popullit!. Sekretar: Miro Dimitrijević“.

¹⁹⁵ Arsyet e largimit të Camajt nga ish-Jugosllavia mbeten ende për t’u hulumtuar shterueshëm. Parë nga perspektiva e formimit të tij akademik, nuk duhet të përjashtojmë si arsye të fortë vetë sëmundjen e rëndë dhe të pashërueshme, prej së cilës lëngonte ndërkohë mentori i tij Barić dhe prej së cilës vdiq një vit më vonë.

¹⁹⁶ Lëvizjen e tij për në Itali e mësojmë nga dokumentacioni dhe kartat e identitetit të Martin Camajt, të cilat ruhen në AFC. Në një dokument, lëshuar më datë 26 mars të vitit 1957 prej zyrës së komisionit të lartë për refugjatët pranë Organizatës së Kombeve të Bashkuara, mësojmë se Camaj fiton më 22 mars 1957 statusin e refugjatit politik me vendim të këtij komisioni. (AFC)

Bashkëpunimi i Camajt me Koliqin do të jetë afatgjatë dhe si i tillë kalon nëpër disa faza, të cilat vetë Koliqi i përmbledh disa vjet më vonë në një referencë (= “Dichiarazione”), që po e riprodhojmë të plotë:

Il dott. Martin Camaj, in possesso di una licence és lettres, ottenuta nell’Università di Belgrado, nel 1956 si iscrisse ai corsi del terzo anno di questa Università dell’Urbe e in capo al secondo conseguì con la votazione di centodieci e lodo la laurea in lettere e filosofi[a] con una tesi di argomento albanologico. Nel tempo intercorso fra il 1956 e il 1958, il dott. Camaj, per conto dell’Istituto di Studi Albanesi, si occupò di ricerche scientifiche, di sopralluoghi folkloristici nei paesi italo-albanesi dell’Italia Centrale e Meridionale e di studi linguistici comparativi fra la lingua d’Albania e le parlate degli albanesi d’Italia. Nel 1959 venne da me nominato Lettoressa volontario, e con questa qualifica dedicò la sua attività all’Istituto che dirigo fino all’anno accademico 1963-64, come risulta dagli Annuari dell’Università degli Studi di Roma.

Sento l’obbligo di aggiungere concludendo che il dott. Martin Camaj, durante il periodo che lavorò sotto la mia direzione, si distinse per eccezionale inclinazione agli studi linguistici e per rare doti di intelligenza, volontà e per una esemplare diligenza nell’assolvimento dei compiti affidatigli.

In fede

(Prof. Ernesto Koliqi)

Roma, li 3 agosto 1965.

Nga referenca e mësipërme, sikurse edhe nga materiali dokumentar origjinal që është depozituar pranë AFC, mësojmë pra se Camajt i njihen studimet e kryera në Universitetin e Beogradit dhe se menjëherë pas ardhjes në Romë (shtator 1956) regjistrohet në Universitetin e Studimeve të Romës në vitin e tretë studimor. Gjithsesi këtu ai e zgjeron paletën e studimit universitar, duke studiuar me sukses përpos fushave të dikurshme: letërsi italiane dhe filologji romane, edhe degët gjuhë dhe letërsi shqipe si edhe

filologji sllave¹⁹⁷ pranë docentëve të atij universiteti, si: Koliqi, Maver, Gianelli, Sapegno etj.

Nën mentoratin e Koliqit Camaj përfundon zyrtarisht kualifikimin universitar më 15 mars 1960 duke laureuar si “Dottore in Lettere con lode”,¹⁹⁸ pikërisht me po atë temë që kish përzgjedhur mirëfilli në Sarajevë gjatë bashkëpunimit me studiuesin indoevropianist dhe albanolog Henerik Barić. Teza e tij e doktoratës me titull “Il ‘Messale’ di Gjon Buzuku. Contributi linguistici allo studio della genesi” sheh dritën e botimit po atë vit në Romë si një fletore e veçantë në “Shêjzat”, në revistën kulturore-shkencore më e rëndësishme të mërgatës shqiptare gjatë periudhës së pas Luftës së 2-të Botërore.¹⁹⁹

Prej referencës së mësipërme mësojmë gjithashtu se Camaj gjatë periudhës së studimeve i përkushtohet edhe kërkimeve me karakter të mirëfilltë kërkimor shkencor në terren, pikërisht në viset me fshatra arbëreshe,²⁰⁰ ndërkohë prej vitit 1959 Koliqi i mundëson të japë mësim vullnetarisht si lektor pranë katedrës së gjuhës dhe letërsisë shqipe në Universitetin e Studimeve të Romës.²⁰¹

¹⁹⁷ Rezultatet konkrete në këto fusha i mësojmë në një certifikatë të noterizuar të sekretarisë së Universitetit të Romës, të lëshuar më datë 3 gusht 1965, ku përpos kumtimit mbi laurean e “Dottore in lettere” me notën “110 e lode” (fituar më datë 15 mars 1960, dhe dorëzuar më 20 mars 1962), marrim informacion edhe mbi rezultatet konkrete në secilën fushë studimi: letërsi italiane – 28/30; filologji romane – 28/30; gjuhë dhe letërsi shqipe – 30 “e lode”, filologji sllave – 30 “e lode”.

¹⁹⁸ Diploma dorëzohet zyrtarisht gjatë një akti ceremonial pranë rektoratit të atij universiteti më datë 20 mars 1962.

¹⁹⁹ Bashkëpunimi intensiv dhe afatgjatë me Koliqin sendërtohet edhe në përgatitjen dhe botimin e kësaj reviste, të cilën Camaj e drejtoi në funksionin e kryeredaktorit deri në mbyllje të saj në vitin 1973 (fletore e veçantë 1977).

²⁰⁰ Nuk duam të lemë pa përmendur këtu edhe punën e bërë ndërkohë për botimin kritik të fjalorit shqip-greqisht të Kristoforidhit (Athinë 1903), temë të cilën Camaj e përmend shpesh në korrespondencën me Mustafa Merlikën (Krujën). Shihni më hollësisht për këtë punimin e Tefë Topallit në këtë vëllim.

²⁰¹ Emërimi si lektor vullnetar zyrtarizohet një ditë pas diplomimit të tij (më 16 mars 1960) me anë të një shkresë-dekreti të firmosur nga zyra e rektoratit të universitetit më 13 qershor 1960 (AFC).

Gjithsesi qëndrimi i Camajt në Romë dhe aktivizimi i tij si lektor pranë katedrës së gjuhës dhe të letërsisë shqipe nuk do të vijojë më gjatë se fundi i vitit 1960. Dëshira për t'u thelluar në hullinë e formimit akademik, por edhe synimi për të siguruar një perspektivë afatgjatë në karrierën e ardhshme profesionale e nxisin Camajn të zhvendosë rishtas atdheun e vet "portativ". Ndër mundësitë që i kërkon dhe i krijohen aso kohe përzgjedh Munihun, shi në Universitetin Ludwig-Maximilian të këtij qyteti.²⁰²

D. Në Muni/Gjermani

Në Muni Camaj vjen në fund të dhjetorit të vitit 1960,²⁰³ fillimisht me një bursë dhjetëmujore të akorduar prej fondacionit gjerman DAAD (= Shërbimi Gjerman për Shkëmbimin Akademik), për të cilën hyn dorëzanë me rekomandimin e vet folkloristi dhe etnologu i njohur Alois Schmaus, që drejtonte atëkohë Seminarin e Sllavistikës pranë Universitetit Ludwig-Maximilian. Gjatë kontakteve intensive me të,²⁰⁴ Camaj përzgjedh si vend studimi Seminarin e Gjuhësisë (= *Sprachwissenschaftliches Seminar*),²⁰⁵

²⁰² Tom Koka citon në kujtimet e veta (AFC) edhe Londrën/Anglinë si edhe SHBA-të si dy zgjidhje të tjera alternative për emigrimin e Camajt, përkatësisht për vijimin e karrierës së tij profesionale-akademike.

²⁰³ Tom Koka shkruan në kujtimet e tij: "Martini mbrijne ne Muenchen ne vjetin 1960. Ne stacion Hauptbahnhof i kishte dale para Hilë Topalli. Ajo mbramje aq e ftofte sa per pak Martini nuk u kthye në Romë." (AFC)

²⁰⁴ Fillimin e bashkëpunimit intensiv me Alois Schmaus-in arrijmë ta datojmë në një kartë postare (dt. 27.11.1960 – shkruar në kroatisht), ku ai - krahas këshillave të rastit, se si duhet të veprojë për hedhjen e kandidaturës për bursë pranë DAAD-së – i jep Camajt edhe udhëzimet për perspektivën e re që i hapte ardhja në Muni. Sipas tij: "... Për hir të formaliteteve të rastit ishte dashur që të drejtoni lutjen sa më parë kërkesën në emrin tuaj, duke shënuar saktë qëllimin e studimit tuaj. E kam cekur [në rekomandimin tim – B.D.] se ju dëshironi të thelloheni në studimet gjuhësore (indogjermane), dhe se duke marrë parasysh folklorin arbëresh, doni të njiheni me metodat e këtushme [të kërkimit – B.D.]; Nga numri i fundit i revistës "Shejzat" – për të cilën ju jam mirënjohës – shoh se ju përcillni me interes letërsinë moderne shqipe. Prandaj shtoni [në kërkesë – B.D.] se jeni i interesuar edhe për metodologjinë në shkencën (e teorisë) së letërsisë. Mendoj se gjithë kjo është vërtetë qëllimi juaj – duke marrë parasysh këtu studimet tuaja të mëtejshme në albanologji. Mirë do te ishte të thoni se mendoni për karrierë akademike (në ndonjë universitet) dhe se kohën në Muni doni ta shfrytëzoni në punë të habilitimit. Kërkesën tuaj e kam rekomanduar aq mirë sa kam ditur..."

²⁰⁵ Kërkesa e Camajt për bursë është bërë më datë 3 dhjetor 1960 dhe miratimi i saj nuk zgjat më shumë se tri javë, pikërisht më 21 dhjetor 1960. Në shkresën zyrtare lexojmë

me synimin që të përvetësojë metodat e studimit gjuhësor historiko-krahasues, të cilat do t'i shërbejnë gjatë punës për të fituar gradën akademike të habilitacionit në albanologji.

Për përfundimin me sukses të kësaj ndërmarrjeje Camaj mbështetet për disa vjet me radhë nga fondacioni i DFG-së (Shoqata e Kërkimit Shkencor Gjerman), i cili i akordon një bursë kërkimore për të mbrojtur gradën akademike të habilitacionit.²⁰⁶ Këtë gradë ai e fiton më datë 21 janar 1965 me *venia legendi* në albanologji²⁰⁷ e duke fituar në të njëjtën kohë edhe të drejtën e ushtrimit të profesionit si docent privat. Gjithsesi Camaj nuk kish munguar ta ushtrojë edhe më parë këtë funksion, pasi ishte angazhuar që në fillim vullnetarisht si lektor në realizimin e programit universitar të seminarit në fjalë duke dhënë kurse hyrëse për gjuhën shqipe.²⁰⁸

Vitet 1965 deri 1971 do të jenë vendimtare si në karrierën akademike të Martin Camajt, ashtu edhe në fatin e ardhshëm të vatrës albanologjike që po i ravijëzonte konturet e saj falë angazhimit të tij. Doktor i habilituar i mbetet gjithherë besnik albanologjisë, duke e vështruar atë si fushë komplekse të kërkimit shkencor. Ambicia e tij profesionale pra as nuk fillon dhe as nuk mbaron vetëm me shqipen si gjuhë sa moderne aq edhe e lashtë ballkanike dhe indoevropiane. Në programin universitar të këtyre viteve vërejmë se ndeshim edhe lëndë nga fusha të tilla, si etnografi, letërsi dhe filologji shqipe, të cilat zgjerojnë dukshëm spektrin e veprimtarisë akademike të Camajt, duke profilizuar *de*

se fondacioni DAAD mbështet qëndrimin e Camajt me një bursë dhjetë mujore për periudhën 1 janar – 31 tetor 1961 me një shumë të përgjithshme prej 5000,-- DM (materiali dokumentar nga dosja “Camaj” – AULM).

²⁰⁶ Kjo bursë i akordohet me disa zgjatje për periudhën nga marsi i vitit 1962 deri në gusht të vitit 1965. Në këtë ndërkohë Camaj ka bërë edhe nostrifikimin e diplomës “Dottore in Lettere” të marrë në Universitetin e Romës, me gjegjësen gjermane “Doctor philologicum” (dokument i dt. 4 qershor 1962; Dosja “Camaj” – AULM).

²⁰⁷ Camaj habilitoi me temën “Fjalëformimi shqip” (= *Albanische Wortbildung*), e cila u botua një vit më vonë në serinë “Albanische Forschungen” vëll. 6, Harrassowitz, Wiesbaden 1966.

²⁰⁸ Angazhimi i tij i rregullt në mësimdhënien e shqipes fillon qysh prej semestrit të dimrit të viteve 1961/1962.

facto edhe fushën e albanologjisë si degë e veçantë studimesh universitare. Megjithëse ligjëron si docent në degën e indoevropianistikës, leksionet e tij i ndjekin tashmë me interes krahas studentëve të indoevropianistës edhe syresh të sllavistikës dhe romanistikës, balkanologë e filologë të rinj, studentë e doktorantë të gjuhësisë së përgjithshme, të historisë së Evropës Juglindore etj.²⁰⁹

Në kapërcyell të viteve akademikë 1970-1971 aktiviteti ndërdisiplinor i Seminarit të Gjuhësisë hyn në një fazë të re. Dega e hetitologjisë i bashkohet seminarit të asiologjisë. Vendin e saj e zë *de jure* dega në Gjermani gjermëatëherë “e pazakontë” e albanologjisë me profesor titullar Martin Camajn, i cili do ta drejtojë atë me sukses për 20 vjet me radhë.²¹⁰ Synim kryesor i Camajt është tashmë konsolidimi i degës si qendër e re studimesh shkencore-universitare. Ndërsa programi mësimor i shqipes kishte përvijuar prej kohësh fizionominë e tij, paleta e programit universitar bëhet gjithnjë e më e larmishme. Në programet semestrale ndërkëmbejnë rregullisht vendet lëndët e ndryshme të gjuhësisë diakronike e sinkronike me ato të letërsisë shqipe dhe të folklorit shqiptar. Leximin kritik të shkrimeve të vjetra shqipe, shqyrtimin e aspekteve të ndryshme të normës gjuhësore letrare, e sidomos hulumtimin e shqipes së diasporës arbëreshe në Greqi dhe Itali e ndeshim në programin e thujtë çdo semestri. Interes të veçantë paraqet edhe organizimi i seminareve dhe i kolokuiumeve të përbashkëta me specialistë si edhe doktorantë të fushave të ndryshme, të cilët do të debutojnë më pas me sukses edhe në albanologji.²¹¹ Dhe vërehet edhe një interesim gjithnjë në rritje i albanologëve të vendeve të ndryshme, të cilët vijnë të thellojnë njohuritë e

²⁰⁹ Hollësisht për programin e larmishëm universitar që ofron Camaj gjatë kësaj periudhe shih B. Demiraj *Një qendër albanologjike në përvjetorin e saj*, në: “Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare” 20 (1) [2001] 129-135, Prishtinë, 2002.

²¹⁰ Më datë 16.07.1971 merr emërimin si profesor joordinar në albanologji, ndërsa më datë 14.09.1978 ai emërohet profesor ordinar në marrëdhënie punësimi të përhershëm (dokumentet origjinale – AFC).

²¹¹ Më hollësisht për këtë program shih B. Demiraj *op. cit.*

tyre e të specializohen ose të punojnë pranë kësaj qendre (F. Altimari, G. Bevington, Z. Mirdita, A. Berisha, L. Mulaku etj.).

Në verën e vitit 1990 bursanti i dikurshëm shqiptar përfundon karrierën e tij akademike si profesor ordinar²¹² në një universitet evropian perëndimor, duke lënë pas një traditë të mirë universitare dhe një qendër të mirëfilltë të kërkimit shkencor në lëmin e albanologjisë.

Martin Camaj's academic life

This biographical study addresses aspects of Martin Camaj's life, of which very little is known, due not only to the lack of a detailed memoir by the author himself or by any of his contemporaries, but also to the fact that the biographical data have not yet been exhaustively collected. It is precisely these gaps that this study tries to fill and as such it is the result of combing and organizing the source material, gathered in Germany at the Camaj family archive, its confrontation with the original documents deposited in the "Monacensia" archive in Munich, the archive research at the Ludwig - Maximilian University in Munich, where is stored the folder "Camaj", the former professor of this university. Special attention is also devoted to a part of his private correspondence and memoirs, left in manuscript by friends and compatriots.

²¹² Camaj lirohet nga detyra si profesor i emerituar më dt. 30.09.1990 (dokumenti origjinal – AFC).

Mimoza PRIKU (Shkodër)

RRETH DISA NDËRTIMEVE E KUPTIMEVE FOLJORE NË VEPRËN E MARTIN CAMAJT

Pasuria e çmuar letrare e gjuhësore që kemi trashëguar nga një prej personaliteteve të letrave shqipe, Martin Camajt, ka vite që ka tërhequr vëmendjen e studiuesve e kritikëve. Por, sot në këtë 85-vjetor të lindjes së tij, na takon që të kthejmë sadopak sytë nga ajo çfarë Camaj la pas, *fjalën shqipe*, të ngulitur në sa e sa vargje e fraza, armën e tij të vetme që sa e lidhte gjuhësisht me vendlindjen, aq e largonte fizikisht prej saj.

Mallkimi i personazheve të Camajt “*vofsh e mos kthefsh ma në plang*” duket se e ka prekur edhe vetë shkrimtarin, po ai vazhdoi të mendojë shqip, të krijojë shqip me një gjuhë biles të lëmuar e të pastër jo vetëm letrarisht, por mjaft interesante edhe nga pikëpamja gjuhësore. Studiuesit e shqipes kanë vërejtur se e gjithë vepra e Camajt, por sidomos proza e tij, e parë në periudha të ndryshme rezulton me “variacione jo të vogla drejtshkimore brenda variantit gegë, sidomos sa i përket drejtshkrimit dhe përdorimit të theksave”.²¹³

Por, vepra e Camajt është mjaft e larmishme edhe sa i takon ndërtimeve e kuptimeve kohore, në disa prej të cilave do të ndalemi në këtë kumtesë, përqëndruar kryesisht në prozën e këtij shkrimtari të madh.

“Gjuha e prozës së Camajt, megjithëse në parim ishte kundër një gjuhe letrare të njësuar mbi ato parime që u ndërtua, është rreptësisht e

²¹³ R. Ismajli, “Rreth shqipes standarde, kodeve të tjera dhe kontestimeve”, *Studime filologjike*, nr. 1-2, 2003, f. 17.

pastër, e kuptueshme, me figurshmëri që buron prej frazeologjisë dhe idiomatikës së vetë ligjërit të folur shqip”.²¹⁴

Le t’i marrim me radhë disa prej këtyre ndërtimeve.

Mënyra dëftore

Në kohët e thjeshta të mënyrës dëftore do të ndalemi vetëm në kohën e pakryer dhe atë të kryer të thjeshtë për të dhënë disa veçori morfologjike të këtyre formave gramatikore.

Kështu, në të pakryerën Camajt nuk përdor as tipin e hershëm me *-nj* dhe as atë sigmatik me *-sh*, por përdor “trajta të së pakryerës me mbaresa që janë karakteristike edhe për të folmen e jugut”²¹⁵, si *mbanin*, Forma joveprore përveç mbaresës, nganjëherë del edhe me formanin **u**, si *..derisa u lodhte ..*”(për *lodhej*)

Në kohën e kryer të thjeshtë zakonisht autori nuk e ruan togun *-ue*, prandaj ai shkruan *mori* e shumë rrallë *muer*, *doli* e jo *duel*. Veta e tretë e numrit njëjës të kësaj kohe zakonisht del me mbaresën *-i*, si *priti*, *ngiriti*, por folja *mbet* në të shumtën e rasteve del pa këtë mbaresë.

Kohët e përbëra

Mjaft interesante për nga variacionet ndërtimore e kohore na paraqiten në prozën e Camajit kohët e përbëra. Fillimisht do të ndalemi tek disa kohë të mënyrës dëftore. Si veçori të gjuhës së Camajit veçojmë se në përdorimin e mbaresës së vetës së dytë të kohës mëse të kryer, ai nuk është gjithmonë konsekuent, pasi folja ndihmëse njëherë del pa mbaresën vetore e herë tjetër e zgjeruar, si *kishe dalë*, *kisha sjellë*, *kishte qitë*, *kishte udhëtu*, por edhe *kish qenë*,

Mund t’i ilustrojmë me disa shembuj:

“*..ta kish nemë për pabesinë...*”(Loja e mbasdrekës, f. 10)

“*...kish nisë t’u ndryshket mendja.....*”(Rrathë, f. 22)

²¹⁴ Sh. Sinani, “Çështje të stilit në ligjërimin e Martin Camajit”, *Studime filologjike*, 1-2, 2007, f. 35.

²¹⁵ K. Topalli, “Vepra e Martin Camajit në aspektin gjuhësor”, në *Martin Camaj. Tradita dhe bashkëkohësia*, Shkodër, 1994, f. 89.

Forma kohore të mbipërbëra

Përdoren rrallë edhe e kryera e dytë *kam pasë punu* dhe e kryera e plotë e dytë *kisha pas punu*, të cilat më tepër janë karakteristikë e gjuhës së folur, por që Camaj i përdor edhe për variacione gjuhësore:

“...gjyshi juej **paska pasë qenë** zemërbardhë... “(Kandili i argjandit, f. 140)

“...kishte **pasë qenë ndalue**...” (Karpa, f.38)

“...në atë kohë im atë i **ka pasë kalue** të 80-at... “(Kandili i argjandit, f. 140)

Ndërtime të mënyrës habitore

Në ndërtimin e temës së kohëve të mënyrës habitore Camaj i ruan zakonisht të plota grupet e zanoreve dhe nuk shihet ndonjë tendencë e thjeshtimit të tyre, si *eckam*, *përkitkam*, *ndëgjueka*, *marrkam*, *dalkam*, *shpërndakam*, *rrënuetakam*, *shkueka* etj., si në rastet:

“...mbrenda atyne dërrasave njeriu **kthye**ka në pafajsin e djepit... “(Kandili i argjandit, f. 84)

“...rreziku iu **kërcnue**ka kësaj familje... “(Kandili i argjandit, f. 104)

“...se këto mandej medoemos **u dashkam** përzi dijekeqas me pasojat... “(Kandili i argjandit, f. 89)

“...atëherë e **ditkesh** se kush ashtë ai?...” (Loja e mbasdrekës, f. 25)

Edhe në të pakryerën ruanë si në standard zanoren –ë, si

“...**jetuekëshin** atje nën fushë...” (Rrathë, f. 29).

Rrallë e tashmja dhe e pakryera e kësaj mënyre shoqërohen me pjesëzën *po*, forma të cilat në gramatikën e shqipes shikohen si ndërtime ku veprimi i shprehur nga folja vazhdon të kryhet në çastin e ligjëritimit, por tek Camaj duket se kjo pjesëz luan edhe një fuksion tjetër, përforcon ironinë, si një nga kuptimet e kësaj mënyre.

Le ta ilustrujmë me shembuj:

“...se ai njeri i huej **po dashke** me u vu në lojë... “(Rrathë, f.100)

“edhe për kreshnik **po dashkëshi** të mbajnë ty...” (Rrathë, 174)

Kohët e përbëra të mënyrës habitore

Në ndërtimet kohore të kësaj mënyre në vetën e tretë, Camaj, si në kohët e thjeshta edhe ato të përbëra preferon mbaresën *-ej* në vend të *-kësh*, si *paskej qenë, qenkej shkye, njohkej*.

Tek kohët e përbëra shpesh ndeshemi me ndërkëmbime formashe kuptimesh. Kështu në kohët e përbëra të mënyrës habitore, folja ndihmëse *kam* e shoqëruar me pjesëzën *u* përdoret me kuptim pësor p.sh.

“...ia *paska* vjellë *pushkën* atij *krah-thati* sepse **iu *paska* *dashtë***...(për i *qenka dashur*) (Rrathë, f. 184).

“...gjyshi *juej **paska pasë qenë*** zemërbardhë... “(Kandili i argjandit, f. 140)

Megjithëse në pjesën më të madhe të rasteve në pjesore Camaj ruan të plota grupet e zanoreve *ye ue* etj, si në gegërisht, nga ana tjetër në disa raste shkrimtari përdor edhe forma më prapashtesën *-ë*, *paska vrojtë* (Karpa, f. 24) dhe jo *paska vrojtue*.

Format e mbipërbëra të së kryerës, të cilat megjithëse rrallëherë të përdorura, janë pranuar edhe në shqipen standarde. Këtë fakt diti ta shfrytëzojë edhe shkrimtari ynë, në ndërtime, si *paska qenë plehnue*, (e) ***paska pasë qitë cekën***, *paska pasë mbetë* etj. p.sh.

...dy *gjana iau **paskan pasë pre*** hovin atyne të malit.. (Rrathë, 97)

Format e pashtjelluara

Sa i takon pjesores, siç e theksuam edhe më lart, Camaj ruan zakonisht të plota grupet e zanoreve, si në foljet *jetue, rrënue, udhëtue, plehnue, pleqnue, mallkue* etj. , por largohet nga gegërishtja në temat e pjesoreve kur ato i ndërton me prapashtesën *-ë (-në)*, si p.sh. *qitë, qenë, mbajtë, humbë, gjetë* etj.

Paskajorja

Në prozën e Camajt gjejmë të përdorur tipin e paskajores *me punue, për të punue, për me punue*. Këto formime kanë denduri të ndryshme, pasi nëse tipi i parë, i cili është karakteristik për gegërishten ka një denduri më të

madhe, pas tij vjen tipi *për të punue* (p.sh. *për të ndërru, për të zbulue, për të zbërthye* etj.) dhe ndërtimi i tretë gjendet më rrallë p.sh.

“..me qenë gurë i latuem përgjysmë për mos me hy kurrë në shtylla madhështore...” (Dranja, f. 16)

Bukur ndërthur Camaj edhe dy paskajore gege, si:

..i zen gjarpni me ba e me e marrë vesh unë... (Loja e mbasdrekës, f. 25)-
me funksion kushtor.

Por, nga shqyrtimet e bëra më parë nga M. Gero²¹⁶ rezulton se përdorimi i lidhore në prozën e Camajt krahasuar me paskajoren e forma të tjera foljore, rezulton me denduri më të madhe se të gjitha të tjerat, e mëpas vjen paskajorja e tipit *me punue*.

Për të mos përdorur njëra pas tjetrës dy paskajore autori e ndërkëmben njëren prej tyre me mënyrën lidhore, si në shembullin:

“...s’ka me mundë të bajë të lumtun..” (Karpa, f. 198) e mund të prisnim *“s’ka me mundë me të ba të lumtun...”*.

Interesante janë disa fraza ku shkrihen mjaft bukur dy tipet e paskajoreve, si në shembullin:

“...Balli e buza i kish vu rreshk e plasë prej etjes, pa mundë me hy në shpellë gjithditën për të mbledhë ndoj curril uji për të lagë e shpërla gojën e shkrumuem...” (Karpa, f. 123).

Përdorimi i dy formave foljore të ndryshme nga pikëpamja dialektore (njëra tipike gege e tjetra e toskërishtes dhe e standardit njëkohësisht), ka ndikuar jo thjesht në gjallërimin e frazës, por na bën të kuptojmë që në gjuhë asgjë nuk është e prerë. Kështu, nuk është e thënë që kjo formë i përket njërit dialekt dhe jo tjetrit, por ato na shfaqen në marrëdhënie përplotësuese.

Në disa ndërtime Camaj përdor edhe të ashtuquajturën të kryerën e paskajore si, *me pasë qenë ndreqë*:

²¹⁶ M. Gero, “Lidhorja dhe paskajorja në prozën letrare të Martin Camajt”, në *Martin Camaj. Tradita dhe bashkëkohësia*, Shkodër, 1994.

“...më duket si **me** i **pasë lexue** dikund këto fjalë...” (Kandili i argjandit, f. 85)

Për të ndërtuar të ardhmen Camaj përdor si tipin *do të laj*, si *do të ngjante*, *do të rjepin* etj., por sidomos format e paskajores duke paravendosur foljen ndihmëse **kam**, si:

“...bukuria e lypun i del për hundësh, **ka me thanë** dikush...” (Dranja, f. 21) për *do të thotë*;

...si **kishte me qenë** sikur...” (Karpa, f.106) për *do të ishte*;

“...**ke me u mërzitë**..” (Karpa, f. 106) për *do të mërzitesh*

...**kishte me qenë** mirë që ajo me shkue në dhomën e vet.. (Kandili i argjandit, f. 83) për *do të ishte*;

...**kisha me thënë** nesër... (Kandili i argjandit, f. 92) për *do të thoja*;

...**kanë me ardhë** edhe dit ma të këqia... (Kandili i argjandit, f. 85) për *do të vijnë*.

Më rrallë gjysmëndihmësja *kam* del para paskajores së tipit *për të punue* duke ndërtuar format e së ardhmes:

“...**keni për t’u kujtue** edhe ju...” (Loja e mbasdrekës, f. 11) për *do të kujtoheni*;

“...**ka për të mbajtë** nxehtë...” (Karpa, f. 205) për *do të mbajë*.

Përcjellorja

Këtë formë të pashtrelluar Camaj e ndërton duke i paravendosur pjesores së foljes formantin tue, si *tue folë*, *tue nxjerrë*, *tue kujtue* etj. p.sh.

...**ndjeva si me qenë tue më nxjerrë** dikush... (Dranja, f. 15)

Do të ndalemi në ndërtimet foljore *jam+përcjellore* të cilat megjithëse kanë depërtuar në standard, janë kryesisht të gegërishtes dhe janë të hershme, pasi ato ndeshen shumë në poezinë e prozën popullore. Ato na paraqiten na paraqiten me mjaft variacione në prozën e Camajt. Në gramatikën normative shikohen si togje të gramatikalizuara të barabarta me *po laj*, *po laja*, por studiuesit nuk kanë ndarë gjithmonë të njëjtin mendim. Kështu për

gjuhëtarin A. Dhrimo këto trajta përdoren për të shprehur aktualizimin e veprimt, ndërta M. Çeliku ndërtimet *jam+përcjellore dhe isha+përcjellore* i quan e tashmja e gjendjes dhe e shkuara e gjendjes.²¹⁷ Tek Camaj gjejmë: *janë tue ardhë, janë tue më kapë, ishte tue kalue* etj.:

“...*jam tue shembë përdhë fatin tim...* “(Kandili i argjandit, f. 102) për *po shemben*.

Në gramatikën e tij Camaj ka shënuar edhe një strukturë të tretë për ndërtimin e kësaj kohe në gegërisht: *jam kah sjelli* apo *isha kah sjelli* për të tashmen dhe të pakryerën.

Forma e pashjelluar mohore

Në këto forma foljore interesante për nga përdorimi janë sidomos disa ndërtime të përbëra të saj, të cilat “rrallëherë në gjuhën e shkruar”²¹⁸ në shqipen standarde, por duke qenë me origjinë geqe, Camaj e ka përdorur për larmi, si

“...*pa i pasë mushë të tridhjetat...*” (Rrathë, f. 36)

“...*nuk të lëshon pa të pasë qëruë si derkun...* “(Loja e mbasdrekës, f. 17)

“...*s’ mund të kuptohet pa e pasë përjetue...* “(Rrathë, f. 55)

“...*pa pasë pritë përgjigje...* “(Rrathë, f. 314).

Një vëmendje i duhen kushtuar edhe disa ndërtimeve foljore të paraprira me folje gjysmëndihmëse, të cilat në prozën e Camajt na paraqiten me larmi. Gjejmë të përdorura foljet si **do** në trajtën e ngurosur (*do përjashtue, do zbulue, do zgjidhë*), por edhe e pangurosur në trajtën **don(ë)** për *duhet* e më pak **duhet** :

“...*Leka do thirrë e të shkojë t’i thotë se...* “(Kandili i argjandit, f. 115)

“...*kjo ndërtesë do bâ..* “(Kandili i argjandit, f. 152).

Por, edhe:

²¹⁷ M. Çeliku, *Format e pashtjelluara të foljes në gjuhën e sotme shqipe*, Tiranë, 2006, f. 166.

²¹⁸ *Gramatika e gjuhës shqipe I*, f. 335.

“...leni thimkat kundër atyne që **donë nderue**...” (Kandili i argjandit, f. 83)-
për duhen nderuar;

“...dokat **donë mbajtë**...” (Kandili i argjandit, f. 84).

Këto folje vendosen para pjesoreve, por edhe formave vetore të mënyrës lidhore, si

“...**duhet të mbledhemi krye në krye**...” (Kandili i argjandit, f. 102)

Gjithashtu i gjemë edhe para formave të pashjelluara paskajore e përcjellore, siç tregojnë edhe shembujt:

“...**due me u këshillue për disa çështje**...” (Kandili i argjandit, f. 91)

...**dashka me ditë si ka qenë puna**... (Loja e mbasdrekës, f. 26)

Në prozën e Camajt të bie në sy përdorimi i disa foljeve me kuptim të zbehur të cilat shprehin mënyrën e kryerjes së veprimit. Një denduri më të madhe kanë sidomos foljet **vu, mori** për të treguar fillimin e një veprimi, të ndjekura nga lidhorja ose paskajorja, si p.sh. *u vu ta lexojë, u vu me ecë* (në kuptimin *nisi të lexojë, nisi të eci*) **mori me folë, morën me tregue, mori**

me arsyetue etj. p.sh.

“...tash **mori me u sjellë**...: (Karpa, f, 24)

Me interes në prozën e Camajt në sistemin foljor paraqiten edhe disa leksema të stilit bisedor, të rralla për standardit, ose të gjallëruara nga autorët e vjetër, por pa munguar edhe krijime të tij. Në këtë fjalës tërheqin vëmendjen foljet me prapashtesën *-o*, si **ditova** për “kalova ditën” **bishtonte** për “bëj bisht”, **heshtonte, erantonte** “merrte erë, nuhaste”, **etshonte** (duket krijim i autorit për shuante et), **prapapohej** ose me ndajshtesën *për-*, si **përnjësue, përkënaqem, përdijtë; tëhollue**. Në lidhje me këtë çështje prof. R. Ismajli është i mendimit se Camaj “sa i takon

leksikut, sintaksës dhe formave të përgjithshme që përdorte ai, nuk mund të mos vërehet një afri më e madhe me gegnishten që po kristalizohej në Kosovë”.²¹⁹

Shumëllojshmëria e ndërtimeve kohore e modale, por jo vetëm të tyre, e radhisin Camaj në vazhden e atyre krijuesve, vepra e të cilëve meriton vëmendje në shumë aspekte, por veçanërisht atë gjuhësor. Camaj në veprat e tij e përdori shqipen me gjithë pasurinë e larminë e saj, por sidomos gegërishten. Gjuha e veprave të tij është një gegërishte e kodifikuar, “duke ecur në gjurmët e autorëve të vjetër, të rilindasve e të Komisionit Letrar”.²²⁰ Fraza e prozës së Camajt nuk është aspak e sforcuar, por në të janë shkrirë natyrshëm trajta e ndërtime as geqe e as toske, por thjesht shqipe dhe si i tillë ka hyrë në thesarin e kulturës shqiptare.

LITERATURË E SHFRYTËZUAR:

1. Akademia e Shkencave të Shqipërisë, *Gramatika e gjuhës shqipe I*, Tiranë, 2002.
2. Akademia e Shkencave të Shqipërisë, *Fjalor i gjuhës shqipe*, Tiranë, 2006.
3. Akademia e Shkencave të Shqipërisë, *Dialektologjia shqiptare*, VI, Tiranë, 1990.
4. CAMAJ, M., *Albanian grammar*, Harrassowitz, Wiesbaden, 1984.
5. ÇELIKU, M., *Format e pashtjelluara të foljes në gjuhën e sotme shqipe*, Tiranë, 2006.
6. DHRIMO, A., *Për shqipen dhe shqiptarët I*, Tiranë, 2008.
7. GJINARI, J.- SHKURTAJ, GJ., *Dialektologji*, Tiranë, 2009.
8. ISMAJLI, R., *Gjuhë standarde dhe histori identitetesh*, Tiranë, 2005.
9. *Martina Camaj. Tradita dhe bashkëkohësia*, Shkodër, 1994.

²¹⁹ R. Ismajli, *Gjuhë standarde dhe histori identitetesh*, Tiranë, 2005, f. 205.

²²⁰ T. Osmani-N. Gogaj, “Çështje të shqipes së sotme letare në “Gramatikën” e M. Camajt”, në *Tradita dhe bashkëkohësia*, Shkodër, 1994, f. 113.

LETËRSI E VJELË:

1. CAMAJ, M., “*Rrathë*”, München, 1978.
2. CAMAJ, M., “*Dranja*”, Roma, 1981.
3. CAMAJ, M., “*Karpa*”, Roma, 1987.
4. CAMAJ, M., *Vepra 5*, Tiranë, 1996.

About some verbal constructions and meanings in Martin Camaj ‘s prose

Literary and linguistic wealth that we have inherited from one of the personalities of Albanian letters, Martin Camaj, there are years that has attracted the attention of researchers and critics. Camaj’s work is very interesting in the verbal constructions and the meanings.

Camaj feature's prose is that he, although the northern writer, is not limited in using of the forms and patterns of Gheg dialect, but has gone beyond these bounds. Consequently, he uses three types of infinitive: *me punue*, *për të punue*, *për me punue*. The first type is very useful.

The varieties of modal constructions of time, but not only them, rank Camaj in the wake of those artists, whose work attracts attention in many aspects, but especially in the linguistic aspect.

Tefë TOPALLI (Shkodër)

NJË VEPËR GJUHËSORE E PANJOHUR, NË DORËSHKRIM, E MARTIN CAMAJT

Së pari, për këtë kumt të shkurtër, drejtoj një falënderim familjes qytetare kosovare, Imami, nga Beogradi: dok.Petrit Imami, Dekan në Fakultetin e Arteve të Bukura (dramaturgjisë), dhe Ma. Naile Imami, as/ped. në Fakultetin Filologjik të Universitetit të Beogradit. E dyta, për këtë fakt të thjeshtë informativ, s'është çudi që të ketë njohje edhe ndonjë nga salla, ndoshta zonja Camaj, të cilën e lus të dëgjojë me durim.

Gjatë punës një mujore në katedrën e Gjuhës Shqipe të Fakultetit Filologjik të Beogradit (katedra më e vjetër e shqipes në Evropë, themeluar më 1924), si lektor, së bashku me kolegun e respektuar, poetin e studiuesin Alfred Çapaliku, u njohëm me familjen e nderuar Imami, të cilët, mikpritës si gjithë shqiptarët, na ftuan në *shtëpinë e tyre – bibliotekë*. Themi kështu sepse, në vend të Bibliotekës Albanologjike të Katedrës së Shqipes në Fakultet, pothuajse të rrënuar këto vitet e fundit, ajo mund të shërbente aq mirë si burim informacioni shkencor e letrar për gjuhën dhe kulturën shqiptare. Kjo familje intelektuale e kryeqytetit serb që krenohej me këtë pasuri të ngritur gjatë gjithë jetës, kishte ç'të tregonte për libra e dokumente shqipe të vjetra, për ekzemplarë të rrallë, monografi kushtuar historisë së popullit shqiptar, siç është vepra e Harry Silasiçit, për gazeta e revista më shumë se njëshekullore, siç ishte gazeta "Albania" e Beogradit, e vitit 1901 etj. Midis këtyre relikeve, intelektualët Imami ruanin edhe një vepër albanologjike, të daktilografuar, me autor shkrintarin, poetin dhe gjuhëtarin²²¹ Martin Camaj, me titull:

²²¹ Camaj, madje quhet edhe *albanolog i spikatur*, Fjalor Enciklopedik Shqiptar – 1, Tiranë, 2008, f. 355.

FJALOR I GJUHËS SHQIPE PERPILUE NGA KOSTANTIN KRISTOFORIDHI ME GERMA GREQISHT,

transliterue në germa shqipe nga Martin Camaj, që kuptimin e fjalëve shqipe në greqisht, transliteruesi e ka përkthye në frëngjisht. Në faqen II, majtas, libri mban shënimin: *Këtë kopje të dorëshkrimit ma fali transliteruesi me datë 29 korrik 1955, në Beograd. Pronë e Sitki Imamit, ish diplomat, shok dhe mik i autorit. Nuk dimë nëse studenti i ri, me largimin nga Beogradi për në Romë, mori me vete ndonjë kopje të dorëshkrimit të mësipërm, a një tjetër ndodhet në dorë të dikujt, apo duhet menduar se studenti mërgimtar pati shtypur vetëm një ekzemplar, në mungesë të letrës a mjeteve të tjera të shkrimit.*

Libri, me **638** faqe (shkruar në një rën anë), është i lidhur me karton, me ngjitje artizanale, me letër të vjetër, po mirë të lexueshme. Përveç kësaj, dorëshkrimi ka një shtojcë me titull: *Fjalët e huaja në shqip*, prej **23** faqesh. Nga shikimi i parë, bindesh se studenti i vitit të 4-t të romanistikës e ballkanologjisë në Universitetin e Beogradit²²², 28 vjeçari Martin Camaj, kalonte ditë të vështira të jetës së tij, së paku, në ngushtësi ekonomike. Nëpër faqet e Fjalorit të transliteruar prej tij, në faqet verso të dorëshkrimit gjejmë disa poezi të shkruara, si: *Zadja te kroni, Dhima e Zanës, Nata në mal, Mokna*, dhe *Andrra e mbrame* (balladë), të cilat janë përfshirë në vëllimin “*Poezi*” (1953-1967)²²³.

Fjalori shqip-greqisht i Kristoforidhit, me 11.675 fjalë (shitur 3 herë derisa ngeli në arkivat e Ministrisë së Jashtme të Greqisë), si dihet, u botua në Athinë më 1904, pas shumë kundërshtimesh, vlerësimesh kulturore,

²²² Fjalor Enciklopedik Shqiptar – 1, Tiranë, 2008, f. 354.

²²³ Martin Camaj, POEZI (1953-1967), Varg librash letrarë “Biblioteka Shqipe”, Nr. 5. Më tej: Varg librash letrarë (Literarische Bücherreihe), “Biblioteka Shqipe (Albanische Bibliothek), Nr. 5, Martin Camaj: Poezi (Gedichte, 1953-1967); Im Selbstverlag Martin Camaj c/o Albanien-Institut, Aimillerstr.8; D-8 München 40; Umschlagzeichnung: Gjelosh Gjokaj.

shkencore dhe politike. “*Sido me qenë, shkruan Aleksandër Xhuvani, ky Fjalor me vlerë i Kristoforidhit mbas botimit të tij mbeti si një gjâ e çmueshme arkeologjike, e lanë më nj’anë, që u hynte në punë për studime vetëm atyneve që veç shqipes dijshin edhe greqishten. Për pjesën tjetër të Shqiptarëvet, për t’u hymë në punë studentëve, punëtorëve e intelektualëve, i shkruem si ishte me alfabetin greqisht, ishte i papërdorshëm. Kam dyzet e sa vjet, vazhdon citimi, që e kam pasë nëpër duer këtë Fjalor për studimet e mia të gjuhës.*”²²⁴ Ky thesar i gjuhës sonë, transkriptuar dhe përpunuar prej një mjeshtri si Xhuvani, qysh prej nandorit të vitit 1953, e botuar në Pragë më 1961, në 397 faqe, me shpjegime shqip dhe greqisht, është një vepër themelore e leksikografisë shqiptare, bazë referuese edhe për shumë fjalorë të tjerë dygjuhësh e normativë, që prej Fjalorit të Shoqërisë “Bashkimi”, hartuar një shekull më parë në Shkodër e këndeje.

Pa dyshim që këto vlera gjuhësore historike të Leksikonit të Kristoforidhit i ka njohur prej kohësh edhe studenti Camaj, i cili, falë formimit filologjik klasik e modern të Seminarit Papnuer të Kolegjës Saveriane, i kishte të gjitha mundësitë ta trajtonte shkencërisht këtë vepër, duke plotësuar qëllimet që i kishte vënë vetes: ta bënte të përdorshëm për studiuesit këtë fjalor dhe, me përkthimin frëngjisht të fjalësisë së tij, ta përcillte edhe në botën shkencore perëndimore. Është e padyshimtë se seminaristi i Kolegjës e ka studiuar hollësisht veprën e Kristoforidhit në bibliotekën e pasur të etërve jezuitë. Pa pasur të dhëna kur e filloi punën i riu Camaj, krahasuar me atë që dimë për mjeshtrinë Xhuvani, përfundimi i transkriptimit dhe shpjegimit të Fjalorit u bë 7 muaj përpara elbasanasit të madh. Të dyja parashtrimet, si hyrje, të Fjalorëve (të Camajt e Xhuvanit), natyrisht ndryshojnë mjaft nga njëra-tjetra. Xhuvani publikonte një vepër shkencore të mbështetur nga një institut i një universiteti të sapothemeluar, siç ishte ai i Tiranës, kurse studenti Camaj hartonte një vepër individuale, por Fjalori i Kristoforidhit, mbetur deri më sot dorëshkrim i gjuhëtarit të ri,

²²⁴ Universiteti Shtetëror i Tiranës, *Fjalor shqip-greqisht prej Kostandin Kristoforidhit*, Çekosllavaki, 1961, f. 8.

është punuar sipas kriterëve mjaft të thukëta filologjike. Duke lexuar këtë parathënie, që këtu quhet *Parathania e punës*, kuptojmë se Martin Camaj nuk kishte dijeni për ndërmarrjen e Xhuvanit dhe nuk mund të kishte në kushtet e jetës e studimeve të tija larg atdheut. Dorëshkrimi i daktilografuar i Camajt përmban në faqen III parathënien e botuesit, Athinë, 1904, si dhe pasqyrën e fjalëve të *shkurtueme*: gjuhë, dialekte, vende dhe shkrimtarë. Po sjellim para jush çfarë shkruhet në të ashtuquajturën *Parathanie e punës*, jo vetëm për kriteret shkencore të përdorura nga autori, por për interesin tjetër, që të vërejmë mjaft karakteristika të vetë gjuhës së Camajt, në formë e përmbajtje, për ta krahasuar me verbin e tij të mëvonshëm, kur do të provojë aftësitë krijuese të shqipes në prozë e poezi :

“Qëllimi i kësaj pune është të qitunit në dritë para mase veprën e K.Kristoforidhit me të tana cilsinat, që ka.

1. *Pjesa shqipe e origjinalit e shkruese me alfabetin grek është e transkriptuemen'alfabetin tonë të sotshëm, tue ruejtë të tana cilsinat ortografike të Kristoforidhit.Origjinali shqip i transkriptuem është me germa të mëdhaja të maqinës.*

2. *Megjithëse është shëndrrue alfabeti, shenjat fonetike janë po ato t' origjinalit.Kam veprue kështu për dy arsylene : a)në “Dhjata e Re”, ku përdoret alfabeti latin, shenjat fonetike, në përgjithësi të njajtat dhe në Fjalor, ku përdoret alfabeti grek;b) Kristoforidhi përdor dy cirkon flenksa, të gjatë e të shkurtë ~ ndërsa na sot përdorim një cirkon flenks ase hundore. ^*

3. *Çdo fjalë kryesore shqipe e kam përkthye në gjuhën frëngjishte po me atë kuptim që ka origjinali në greqishte. Fjalët ndër kllapa (.....) frëngjisht janë ndër kllapa /.../.*

4. *Aty kur kam mujtë me gjetë fjalë shqipe sinonime me fjalët e origjinalit, këto termine i kam vû ngjit mbas fjalës frëngjishte me germa të vogla të maqinës. Këto fjalë ekvivalente i kam marrë nga Fjalori i “Bashkimit” dhe “Dizionario italiano-albanese”i Cordignano-s dhe nga fjalorët shqip, sidomos të gegënishtes, tue shfrytëzue njëkohësisht, sa kam mujtë, edhe shkrimtarët gegë.*

5. *Frazeologjia ase shembujt i kam shpjegue në gjuhën shqipe me fraza e fjalë ekuivalente, simbas shpjegimit greqisht të Kristoforidhit.*
6. *Kristoforidhi, kur shpjegon fjalët, ashtu si veprohet në leksikone, këtë e bân në greqishte, kryesisht, ndërsa në ket punim çdo shpjegim, fjalë ase rregullë âsht përkthye besnikisht shqip. Pra, krejt në përgjithësi, pjesa me germa të vogla âsht interpretimi i bâmë prej meje në bazë të greqishtes, kurse pjesa tjetër me germa të mëdhaja âsht origjinali i transkriptuem.*
7. *Shumë fjalë botanike ase zoologjike, të cilat auktori i shpjegon shkurtimisht tue thanë “një lloj bime, frymori etj.”, i kam shpjegue ase u kam gjetë kuptimin përkatës ndër fjalorë të tjerë.*
8. *Fjalët, qi gjinden ndër kllapa kvadra janë pjesa etimologjike, pjunë e Kristoforidhit, shpjegimin që ai e ban greqisht, unë e përkthej shqip.*
9. *Renditja e fjalëve n’origjinal âsht natyrisht si mbas alfabetit grek, punimi që paraqes âsht si mbas alfabetit të sotshëm.*

Beligrad, 12. IV. 1953

Po ju paraqes dy fjalë nga shkronja **F** e punimit të Camajt, krahasuar me atë të Xhuvanit:

C a m a j:

FANTAZIJ – A, Bud. - / imagination f., fantaisie f.

FANITETË, T, - v. Impërs. MË – TË – I FANITETË / greq. / apparaitre se montrer en vision/; m’u fanit im – atë, pava hijën e tim eti; m’u duk, m’u shfaq, m’u fanit Krishti, Shën – Mëria, Shejti-iu fanit ay që ka vrarë. Thonë kur vdes njeriu, i fanitet engjëlli.

X h u v a n i: fanadazij – a (Bd.) ef. = fantazia (me alfabet grek).

fanitetë (t.) – është i njëjti shpjegim së më sipër, por edhe me grafi greke, pa përkthimin frëngjisht.

Pyetjes *pse ka mbetur dorëshkrim kjo vepër e shënuar gjuhësore*, kur Camaj, me kalimin në Romë e më vonë në München (Gjermani), fillimisht e gjithë jetën është marrë edhe me gjuhësi (krahas krijimit letrar),

mund t'i përgjigjesh: ose autorit i kanë munguar përherë mjetet financiare për ta botuar, ose, në një farë mënyre, nuk "ka guxuar" t'i afrohet autoritetit shkencor të Aleksandër Xhuvanit, që kur ka mësuar publikimin zyrtar të Universitetit të Tiranës.

Sido që të jetë, forumet dhe institucionet shkencore të vendit sot i kanë të gjitha mundësitë për ta njohur dhe nxjerrë në dritë këtë Fjalor të Konstandin Kristoforidhit, përpunuar në mënyrë origjinale prej njeriut me emër të madh që është sa shkrimtar e poet, edhe gjuhëtar e filolog, Martin Camaj, qoftë edhe për t'i bërë jehonë thirrjes së tij përnderuese para ndërrimit të jetës, 18 vjet më parë: *"Gëzohem pa masë se keni vendosë të vlerësoni veprën time: ky vlerësim na afron. Batë burrninë të më shtini në rreshtin tuej. Ndonëse të ndamë për një gjysmë shekulli, unë jam i jueji e ju jeni të mijt."*

A work linguistic unknown Manuscript, Martin Camaj

In this article Topalli has pointed out that when Martin Camaj, the writer and linguist, was a student of Philologic Faculty, he had worked for the dictionary of Kristoforidhi translating it in French. After he translated and transliterated it, he made it ready for publishing since 1953. Petrit and Naile Imami have the typed dictionary in their house. The author himself gave it to them as a special gift nearly 60 years ago. Prof. Topalli appeals to the Academy of Science and the Institute of Linguistics to publish this work of M. Camaj which would highlight thoroughly the linguistic character of this dissident writer.

Evalda PACI (Tiranë)

**PIKËPAMJE TË MARTIN CAMAJT PËR “MESHARIN”
(VËSHTRIM FILOLOGJIK DHE TEKSTOLOGJIK MBI
LIBRIN E PARË NË GJUHËN SHQIPE)**

Punimi i mirënjohur i Camajt *Il Messale di Gjon Buzuku, contributi linguistici allo studio della genesi*, 1960, përbën një studim serioz dhe origjinal në drejtim të ndriçimit të problemeve themelore që paraqet për gjuhëtarët, filologët dhe studiuesit e historisë së letërsisë së shkruar shqipe libri i shkruar prej Gjon Buzukut (1555). Me botimin e kësaj vepre që përmbledh një sërë trajtesash të vyera mbi aspektet themelore të gjuhës së Buzukut, ndikimet e mundshme nga gjuhët e huaja si latinishtja, sllavishtja, greqishtja, venetishtja etj.; aspekte krahasuese të gjuhës së Buzukut me atë të autorëve të tjerë të letërsisë së vjetër shqipe etj., përforcohet tradita e studimeve specialistike mbi *Mesharin* dhe i jepet rrugë sqarimit të disa çështjeve kyçe që lidhen me të parin libër të shkruar që njihet deri më sot nga tradita e studimeve në fushë të historisë së letërsisë së shkruar shqipe.

Problematika e librit të parë në gjuhën shqipe shtrohet me të drejtë nga studiues si Jokl, Rrota, Roques, Çabej, Ressuli, Riza, Marlekaj etj. në studimet përkatëse apo parashtresat që shoqërojnë botimet kritike që qe e mundur të realizoheshin mbi *Mesharin* në shekullin e kaluar.²²⁵Një hap të

²²⁵ Në *Hyrje* të punimit Camaj vlerëson përpjekjet e bëra për ta transkriptuar librin e Buzukut. Një vlerësim i veçantë i bëhet botimit të plotë kritik të realizuar dy vjet para botimit të këtij punimi nga Namik Ressuli. Camaj M., *Il “Messale” di Gjon Buzuku, contributi linguistici allo studio della genesi*, Shëjzat, Romë, 1960, *Introduzione*, f.7: *Solo nel 1958 vide la luce l’edizione completa dell’opera buzukiana*(Ressuli N.,

rëndësishëm në këtë drejtim përfaqëson edhe ky punim i Camajt, i strukturuar në paragrafe e kapituj të veçantë, dëshmi e ndërgjegjshmërisë së autorit jo vetëm për metodologjinë e punës që diktonte ndërmarrja e një pune të thelluar mbi problematikën e librit të Buzukut, por edhe për rëndësinë e madhe që studimi i këtij libri kishte për ndriçimin e çështjeve më të rëndësishme të morfologjisë historike, tekstologjisë dhe filologjisë shqipe.²²⁶

Camaj paraqitet si njohës i mirë i traditës së studimeve të kryera mbi librin e Buzukut. Kjo traditë konsiderohet pandërprerë dhe ndonjëherë edhe në mënyrë kritike nga ana e tij. Ai ka trajtuar edhe shkallën e arritjes apo thellimit të duhur në çdo problem që parashtron vepra para studiuesve që janë marrë me të, duke pasur parasysh edhe pengesat reale objektive: *mungesën e të dhënave të mjaftueshme arkivore si dhe mosnjohjen e identitetit të autorit të librit.*

Objekt diskutimi bëhet çështja e emërimit të librit nga studiues buzukianë, vendi i mundshëm ku mund të jetë botuar vepra së bashku me hipotezat e bëra *ad hoc* nga studiues si Roques,²²⁷ Çabej etj.; grafemat e

Il "Messale" di Giovanni Buzuku, Città del Vaticano, Biblioteca Apostolica Vaticana, 1958) in fotocopia, con accanto la traslitterazione nell'ortografia moderna albanese (cfr. uno studio critico a questa edizione fatto da G.Marlekaj: La più antica pubblicazione in lingua albanese, "Quaderni dell'Istituto di Glottologia", III, (1958), Bologna, 1959, pp.35-52.

²²⁶ Camaj M., *Il "Messale" di Gjon Buzuku, contributi linguistici alla genesi*, Shëjzat, Romë, 1960, *Considerazioni conclusive*, f.71: *Il noto linguista albanese E.Çabej, parlando sull'opera del Buzuku, afferma che chiarire esaurientemente i problemi filologici della lingua del "Messale" buzukiano significa risolvere tutte le questioni fondamentali storiche della lingua albanese. Nel corso di questo mio studio ho constatato che l'affermazione del Çabej è ben giusta, e per questo mi sono limitato per tempo su pochi problemi filologici del "Messale" con il fermo proposito di procedere sempre cautamente in una sì difficile e vergine materia.*

²²⁷ Camaj M., *Il "Messale" di Gjon Buzuku, contributi linguistici alla genesi*, Shëjzat, Roma, 1960, *Introduzione*, f.8: Anche circa il posto della pubblicazione si è argomentato moltissimo, piuttosto per ipotesi, senza sufficienti documentazioni. M.Roques (*Recherches sur les anciens textes albanais*, Paris, 1932) pensa che sia stampato a Venezia come tutti i testi sacri croati e in parte serbi dell'epoca. La tesi del Roques ultimamente è stata accettata anche dallo studioso albanese E.Çabej. Lo scienziato francese porta come argomento anche il risultato dello studio fatto sulle

përdorura nga Buzuku, në veçanti prania e shenjave grafike të ndryshme nga gerrat latine; mundësia e ndikimit të Buzukut nga tekste ekzistuese paralele, në veçanti ndikimi në nënsisteme të caktuara si sintaksa e fjalisë, e periudhës, e sintagmës; përfaqja me autorë të tjerë pasardhës të Buzukut dhe me poezinë epike popullore etj. Këtyre çështjeve në punimin e cituar u janë kushtuar kapituj të veçantë që përfaqësojnë në vetvete kontribute origjinale në drejtim të studimit rigoroz, të matur dhe serioz të librit të Buzukut.

Ashtu si studiues të tjerë paraardhës, në lidhje me librin e Buzukut Camaj ka përdorur emërtesën *Meshar*. Duke qenë krejtësisht e qartë përbërja konkrete e këtij libri, përdorimi i këtij emërtimi bëhet më tepër në kushtet e domosdoshmërisë së gjetjes së një termi të përshtatshëm për ta përmendur a cituar atë në kushtet e trajtimit të problemeve të ndryshme. Për sa i përket emërtimit të pjesëve përbërëse të librit ai përdor terminologjinë latine: *Officium Parvum B.M. Virginis* (ff.IX-XVI); *Septem psalmi poenitentiales* (ff.XVI-XVIII); *Litaniae* (XVIII-XIX); *Ad vespas officii defunctorum* (XIX-XXI)²²⁸; *Rituale Baptismi cum Cathecesi*(XXI-XXX); *Missale* (XXX-CX); *Colophon*.(cx).²²⁹

Përveç se linguist, filolog dhe studiues i hollë i veprës së Buzukut, Camaj paraqitet në këtë punim edhe si njohës i mirë i traditës së shkrimeve të shenjta të asaj kohe në arealin serbo-kroat. Njohuritë e tij në këtë fushë ai

filigrane della carta per scopirne la provenienza: “Le papier don’t on s’est servi est italien: Briquet nous le montre employé en Italie au XVI siècle, à Naples et Syracuse, à Vicence et Treviso”. Roques, trattando delle filigrane, dice: “Dans le corps du volume on trouve en écusson (fol.xlij, xliij), mais surtout (f. 92, 95) la sirène à double queue courbée et redressée, enfermée dans un cercle, telle qu’on en trouve des exemples dans Briquet (IV, p.685, n.13880-895).

²²⁸ Gjithnjë sipas Camajt deri në këtë pikë renditja e pjesëve të veprës përkon me tekste të tjera paralele të asaj kohe shkruar në gjuhën popullore kroate dhe serbe. Për të ilustruar këtë fakt, Camaj citon dhe burime konkrete (shih Camaj M., *Il “Messale” di Gjon Buzuku, contributi linguistici allo studio della genesi*, “Shëjzat”, Romë, 1960, *Introduzione*, f.8.)

²²⁹ Kjo ndarje paraqitet fillimisht në *Hyrjen* e punimit, por citohet më tej edhe në gjykimet përmbyllëse ndërsa studiuesi ynë mëton të gjejë përfaqje në drejtim të mënyrës së strukturimit të librave të shenjtë që ekzistonin edhe në gjuhën sllave.

i vë në shërbim të sqarimit të përmbajtjes së teksteve buzukiane e siç do të vërehet në momente të caktuara, edhe në funksion të gjetjes së analogjive në lidhje me strukturimin konkret të veprës nga ana e Buzukut.

Martin Camaj i ka kushtuar vëmendje edhe studimit në pikëpamje tekstologjike të veprës së Buzukut. Pikëpamjet e shprehura prej tij në kapitullin *Aspetti della lingua di Gjon Buzuku*²³⁰ bazohen në një hulumtim të thelluar dhe të krahasuar të teksteve biblike apo të lutjeve që përmbahen në *Meshar*. Kur flasim për hulumtim të krahasuar kemi parasysh jo vetëm përfaqshen e domosdoshme që ai si filolog, gjuhëtar dhe njohës i disa gjuhëve u bën teksteve të sipërpërmendura, por edhe qasjes së vetë teksteve të Buzukut me njëri-tjetrin.²³¹

Në këtë kapitull trajtohet në veçanti fakti i përsëritjes së pjesëve të caktuara brenda së njëjtës vepër, madje edhe me modifikime të konsiderueshme.

Camaj ka përjasur mes tyre edhe tekste biblike, me qëllimin e qartë që të vinte në dukje disa elemente të rëndësishme që hedhin dritë mbi kuptimin e tekstit me të cilin ndeshet studiuesi i filologjisë biblike apo i morfologjisë historike të shqipes, mbi cilësinë apo origjinalitetin e përkthimit nga ana e Buzukut e fragmenteve të tilla.

Që në hyrje të këtij kapitulli studiuesi ynë shtron pikëpamjen e diversitetit dhe diferencimit gjuhësor të dukshëm të pjesëve të caktuara në

²³⁰ Camaj M., *Il "Messale" di Gjon Buzuku, contributi linguistici allo studio della genesi*, Shëjzat, Romë, 1960, f.33-53.

²³¹ Përsëritja apo rimarrja e teksteve të caktuara brenda veprës së Buzukut është cituar dhe vënë në dukje edhe nga prof. Çabej në notat përkatëse të botimit kritik të përgatitur dhe të botuar në vitin 1968. Dihet që në pjesën e parë të veprës Buzuku rimerr disa herë himne të njohura të liturgjisë katolike si *Memento rerum conditor*, *Salve Regina* etj. Disa pjesë nga *Ungjilli sipas Lukës* që kanë të bëjnë me shfaqjen e engjëllit lajmerues për ardhjen e Mesisë dhe që përmbahen edhe në leksionarët e Meshës së ritit katolik roman rimerren disa herë te Buzuku edhe për t'iu përshtatur natyrës së tekstit që Buzuku kishte ndër mend të sillte në librin e tij. Përsëriten gjithashtu pjesë nga *Testamenti i vjetër (Kënga e këngëve, Ekleziastiku* etj.), meqë kanë edhe funksion *antifonar*. Këto përsëritje janë të pashmangshme në të cituar kur bëhet fjalë për një kuptim të thelluar dhe të mirëfilltë të pjesëve të librit të Buzukut si dhe për dallimin e pjesëve nga njëra-tjetra.

vepër. Ai ka parasysh në këtë rast pjesë nga *Ungjilli* e nga *Besëlidhja e vjetër*, gjuha e të cilave ndryshon dukshëm nga gjuha e lutjeve në mbarë veprën e sidomos në *Oficen* dhe *Ritualin*.²³²

Çështje të ndikimit nga gjuhë të huaja në tekstet e *Mesharit*

Camaj rendit dhe trajton pikësëpari ndikimin nga latinishtja dhe tekstet në gjuhë sllave të gjuhës së Buzukut. Këtu nuk flitet thjesht për një influks gjuhësor në leksikun e veprës, por shtrohet edhe çështja e ndikimit të gjuhës së liturgjisë nga termat kishtarë në gjuhë të huaj. Camaj flet ndërkohë dhe për rrethanat e depërtimit të elementeve të caktuara leksikore në gjuhën e Buzukut dhe gjykon për domosdoshmërinë e pranisë së tyre në tekstet e hartuara nga vetë Buzuku.²³³ Ai i konsideron si elemente që kanë hyrë në procesin e përkthimit, duke përsëritur kështu për të satën herë si studiues të tjerë buzukologë faktin që autorit të këtij libri i është dashur të përkthejë tekste liturgjike nga gjuhë të tjera.

Në këtë trajtesë mbi ndikimin e elementeve të gjuhëve të huaja në gjuhën e Buzukut Camaj ka gjetur mundësi edhe të klasifikojë në pikëpamje të shtresëzimit kohor forma të caktuara emërore si në rastin e emrit *fragilitat*, që sipas tij ruan formën venete.²³⁴ Në fakt, çështja e dallimit

²³² Camaj M., *Il "Messale" di Gjon Buzuku, contributi linguistici allo studio della genesi*, Shêjzat, Romë, 1960, *Aspetti della lingua di Gjon Buzuku*, f.33: *Come si è già notato, molti brani del Vangelo e del Vecchio Testamento, eccettuando qualche salmo, differiscono in lingua e in stile in primo luogo dalle preghiere di tutta l'opera e poi dagli Uffici e dal Rituale cum catechesi. Difatti le preghiere del "Messale" risentono molto dell'influsso del testo latino sia nel lessico, sia nella costruzione, così che assomigliano più a un primo abbozzo che a una vera e propria traduzione. Perciò dopo un attento esame del "Messale" non mi convince affatto l'affermazione del Çabej che tutto questo libro sia l'opera individuale di un solo scrittore.*

²³³ Camaj M., *Il "Messale" di Gjon Buzuku, contributi linguistici allo studio della genesi*, Shêjzat, Romë, 1960, f.54: *I termini latini entrati nel testo albanese, per così dire imposti nel corso della traduzione- spesse volte senza bisogno- secondo un mio calcolo ammontano all'incirca a cinquecento.*

²³⁴ Camaj M., *Il "Messale" di Gjon Buzuku, contributi linguistici allo studio della genesi*, Shêjzat, Romë, 1960, f.54:.. per fragilitat tane the munde vengoime= Deus, qui nos in tante periculis constitutos, pro humana scis fragilitate.. vincamus. (Po aty, shënimi i

dhe e trajtimit të elementeve latine dhe atyre latino-romane në librin e Buzukut përbën në argument të rëndësishëm që është trajtuar dhe nga studiues të tjerë të leksikut të autorëve të vjetër të shqipes.

Në këtë kapitull mbi ndikimin e gjuhëve të huaja në tekstet e Buzukut Camaj ka dhënë mendime në lidhje me traditën e përkthimit të teksteve të caktuara liturgjike në gjuhën shqipe. Ai diferencon praninë e latinizmave në tekstet ungjillore, në ato të *Ofices së Zojës* me të cilat edhe hapet libri i Buzukut dhe me ato të lutjeve që përmbahen në vepër. Duke krahasuar dendurinën e pranisë së latinizmave në *Ungjijtë* dhe *Oficen e Zojës* ai shprehet se për këtë fakt kjo pjesë e librit duhet të jetë përkthyer për herë të parë nga Buzuku, duke përjashtuar ekzistencën e varianteve të tjera të përkthyer më parë në gjuhën tonë.²³⁵

Ndikimi i latinishtes konstatohet nga Camaj edhe në drejtim të modeleve fjalëformuese të fjalëve të caktuara. Merren në shqyrtim emra veprimi (*nomina agentis*), sintagma të ndryshme:

Bāsi krahasohet me termin latin përgjegjës *creātor* (siç dihet, në himnin përgjegjës latin ndeshet edhe emërtimi *conditor*, themelues); *i pari lenë* është përqasur me lat. *primogenitus* etj. Përqasën me përgjegjësit latinë sintagma të tëra, si në rastin e *diali e njëj ame ën fëmejësh* me sintagmën latine përgjegjëse *filius matrisfamilias*.

Camaj ka sjellë edhe disa shembuj mbiemrash kryesisht të prejardhur dhe që mund të përmbajnë parashtesa privative. Përqasja me latinishten në këtë rast bëhet pikërisht për të shënuar kalkimin e elementit morfematik inicial: *i pāfe* krahasohet me *infidelis*; *i pāpërmortshim* me *incorruptus* etj. Kujtojmë që mbiemra të tipit *i pāfë*, *i pāfrujt*, *i pāujë* etj., përbëjnë një model të veçantë formimi në sistemin mbiemëror në librin e Buzukut.

Camajt në lidhje me trajtën emërore *fragilitat*: *come si vede il Buzuku preferisce la forma veneta*).

²³⁵ Camaj M., *Il "Messale" di Gjon Buzuku, contributi linguistici allo studio della genesi*, Shëjzat, Romë, 1960, f.55: *I latinismi sono nel Vangelo in minor numero rispetto allo Off.B.M. Virginis e alle preghiere in genere, per cui sono indotto a credere che questa parte del libro è stata tradotta per la prima volta dal Buzuku, senza aver innanzi precedenti traduzioni*.

Në drejtim të sintaksës, Camaj vë re përdorimin e formave të caktuara të pashtjelluara dhe koincidencën me përdorime të ngjashme me variantin përgjegjës latin.²³⁶ Ai vë në dukje edhe rendin e vendosjes së pjesëve përkatëse në periudhë dhe krahason gjithashtu me rendin përgjegjës në periudhën latine.²³⁷

Ai flet për ndikim nga latinishtja jo vetëm në ndërtime të caktuara sintaksore në veprën e Buzukut, por edhe për kalkimin e terminologjisë kishtare nga latinishtja:

*Edhe para Buzukut, duke gjykuar nga forma e shqipëruar e disa fjalëve, kjo gjuhë kishte huazuar tashmë nga latinishtja pothuaj gjithë terminologjinë liturgjike, si p.sh., meshë- missa, hostja – hostia, sakramend – sacramentum, peendohem – poenitet me, shëlbues – salvator etj.*²³⁸

Pa përjashtuar mundësinë e konsultimit nga ana e Buzukut të leksionarëve apo Mesharëve të përshtatur në gjuhë popullore sllave, ai vlerëson rolin e rëndësishëm që duhet të ketë pasur në këtë mes *Vulgata* në gjuhën latine:

Natyrisht tekstet sllave nuk kanë për përkthyesin shqiptar (e këtu bëhet fjalë pikërisht për Buzukun) autoritetin e origjinalit latin, por shërbejnë si objekt konsultimi në punën e vështirë të përkthimit apo të

²³⁶ Camaj M., *vep. e cit.*, f.55: *Confrontando il testo albanese con l'originale latino, constatiamo che riguardo alla sintassi del periodo la traduzione si mantiene di regola fedele alla costruzione latina: così p.es. l'infinito nelle proposizioni dipendenti, caratteristica del ghego in contrasto col dialetto toscano che preferisce il congiuntivo, viene conservato in generale anche nel "Messale" albanese: (Buz.130, 31) e duoneh me clene grissuneh miestreh= amant ...vocari ab hominibus Rabbi; (Buz.182, 60) nuche duoih meh praticuom endeh iudeet= non enim volebat in Iudeam ambulare; (Buz.188, 3) Simon, u cam zdo caphse meh dhane= Simon, habeo aliquid dicere.*

²³⁷ Camaj M., *vep. e cit.*, f.56: *Il traduttore non di rado lascia inalterato l'ordine delle parole del testo latino: (Buz.182, 17) E the madh te murmuruom is endeh sumicet en si= et murmur multum erat in turba de eo.*

²³⁸ Camaj M., *Il Messale di Gjon Buzuku, contributi linguistici allo studio della genesi*, Shëjzat, Romë, 1960, f.54: *Però anche prima di Buzuku, giudicando dalla forma albanesizzata di alcuni vocaboli, questa lingua aveva già mutuato dal latino quasi tutta la terminologia liturgica, come p.es. meshë – missa, hostja – hostia, sakramend – sacramentum, peendohem – poenitet me, shëlbues – salvator ecc.*

*përshatjes. Në fund të fundit edhe sot e kësaj dite kush përkthen Ungjillin ose çfarëdo lloj vepre klasike konsulton përkthime në gjuhë të tjera në mënyrë që të zgjidhë vështirësi eventuale teknike.*²³⁹

Në këtë punim të Camajt përballen midis tyre dhe pjesë të ngjashme nga Buzuku si dhe nga të tjerë autorë të vjetër të shqipes: sillen tekste edhe nga Budi e Bogdani. Sillen gjithashtu tekste këngësh popullore me qëllim përjasjen e formave të caktuara me përdorime të ngjashme të Buzuku. Camaj në këtë punim nuk lë jashtë vëmendjes ngjashmërinë e formave të caktuara të Buzukut me disa të folme të vendit tonë si dhe përpiket t'u gjejë një impostim të caktuar nga pikëpamja dialektologjike tipareve gjuhësore të veprës së Buzukut.

Megjithëse trajtohet në mbyllje të punimit, duhet konsideruar e një rëndësie të veçantë përjasja e gjuhës së Buzukut me tekstet e Budit (*Rituale Romanum*) si dhe mundësia e njohjes së tij nga autorët pasardhës të letërsisë së vjetër shqipe. Camaj shpreh mendimin se Budi duhet ta ketë njohur veprën e Buzukut.²⁴⁰

Edhe në lidhje me këtë argument Camaj tregohet objektiv meqë vë në dukje jo vetëm pikat e përbashkëta, por edhe ndryshimet që i dallojnë këta dy autorë nga njëri-tjetri.

²³⁹ Camaj M., *Il Messale di Gjon Buzuku, contributi linguistici allo studio della genesi, Shëjzat*, Romë, 1960, f.66: *Naturalmente i testi slavi non hanno per il traduttore (e qui penso si tratti proprio del Buzuku) l'autorità dell'originale latino, ma servono come oggetto di consultazione nel difficile lavoro di traduzione e di adattamento. Del resto anche oggi è in uso di chi traduce il Vangelo o qualsiasi opera classica di servirsi di traduzioni in altre lingue per risolvere le eventuali difficoltà tecniche.*

²⁴⁰ Camaj M., *Il Messale di Gjon Buzuku, contributi linguistici allo studio della genesi, Shëjzat*, Romë, 1960, f.74: *Per concludere credo sia opportuno accennare per sommi capi ai riflessi o addirittura agli influssi della lingua del "Messale" nelle opere degli scrittori posteriori ecclesiastici, Budi, Bardhi e Bogdani. I legami sono più che evidenti specie in Budi, anzi chi legge di seguito il "Messale" e poi il Rituale o Speculum Confessionis ha la netta impressione che quest'ultimo abbia non solo conosciuto l'opera del Buzuku, ma adoperi vocaboli e forme, che ad ogni passo incontriamo nel "Messale". Se poi raffrontiamo la grafia e i criteri ortografici dei due, i legami appaiono evidentissimi.*

Puna e Martin Camajt me librin e Buzukut jo vetëm përforcon traditën e studimeve shqiptare në këtë drejtim, por plotëson gjithashtu edhe personalitetin e tij si studiues i spikatur i historisë së shqipes së shkruar.

BIBLIOGRAFI:

1. Buzuku Gj., *"Meshari"*, I,II, (botim kritik përg. nga E.Çabej), Tiranë, 1968.
2. Camaj M., *Il « Messale » di Gjon Buzuku, contributi linguistici allo studio della genesi*, Shêjzat, Romë, 1960.
3. Çabej E., *Rreth disa çështjeve të historisë së gjuhës shqipe*, BUSHSHT, n.3, 1963.
4. Çabej E., *Studime shqiptare, Vepra të zgjedhura*, ASHAK, Prishtinë, 2008.
5. Demiraj Sh., *Gramatikë historike e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1986.
6. Riza S., *Nyjet e shqipes*, BUSHT, SShSh, n.4, 1958.
7. Riza S., *Pesë autorët më të vjetër të gjuhës shqipe(krestomati thjesht gjuhësore)*, Tiranë, 1961.
8. Riza S., *Probleme të nyjeve të shqipes*, SF n.1, 1982.
9. Riza S., *Vepra 3*, Prishtinë, 2002.
10. Riza S., *Pesë autorët më të vjetër në gjuhën shqipe*, Toena, Tiranë, 2002.
11. Riza S., *Vepra 4*, Prishtinë, 2004.

Views of M. Camaj for "Mesharin" (look philological and testologjik on the first book in Albanian)

Camaj's study on "Meshari" constitutes deep and original research as to the clarifying of the most fundamental questions that this book

represents. Camaj studies the graphemes that Buzuku used, some aspects of the language, dialect features along with the influence of foreign languages, such as Latin and Ecclesiastical Slavic on Buzuku.

Camaj also plays special attention to both Venetian and Tosk dialect elements in the "Meshari". In this essay Buzuku's language and style is compared to those of other pioneers of early Albanian literature such as Budi, Bardhi and Bogdani.

This complex study by Camaj is most significant amongst other studies dedicated to Buzuku's "Meshari". Still today it's held in great consideration by the many scholars interested in Albanian philology and literature.

Ina ARAPI (Austri)

**PASURI LEKSIKORE TE
“NJERIU MË VETE E ME TJERË” I MARTIN CAMAJT**

I kushtohet M. Camajt si mësues i gjuhës shqipe

Martin Camaj është i vetmi shkrimtar shqiptar me një njohje complete të gjuhës shqipe. Si gjuhëtar dhe si mësues ai e studioi mekanizmin e gjuhës në planin diakronik dhe sinkronik. Si shkrimtar, duke shfrytëzuar edhe njohuritë gjuhësore që kishte, ai e përpunoi atë si mjet artistik. Martin Camaj gjuhëtar e ndihmoi dhe e inkurajoi Martin Camajn shkrimtar për të na dhënë atë objekt kompleks që është krijimtaria artistike. Prandaj vepra e tij letrare paraqet interes jo vetëm për studiuesit e letërsisë shqipe, por edhe për gjuhëtarët shqiptarë.

Një nga meritat dhe vlerat e M. Camajt shkrimtar është se nëpërmjet letërsisë ai e afron lexuesin me atë segment të gjuhës shqipe që i takon të folurës së vendlindjes së tij. Për ta nxjerrë në pah këtë kam marrë si shembull vëllimin e tij poetik “Njeriu më vete e me tjerë”, botuar për herë të parë në Mynih në vitin 1978. Preferova botimin dygjuhësh shqip - gjermanisht botuar në Klagenfurt më 1999, sepse përkthimi gjermanisht i bërë nga nxënësi i tij dhe përkthyesi i poezisë shqipe Hans-Joachim Lanksch ndihmon për të zbërthyer më qartë semantikën e fjalëve shqipe. Fjalët me interes gjuhësor i kam ndarë në tri grupe:

1. Në grupin e parë bëjnë pjesë ato lema që i përkasin të folmes së autorit, pra të folmes së krahinës së Dukagjinit²⁴¹, dhe që pjesa më e madhe e shqipfolësve i njeh vetëm në mënyrë pasive ose i kupton në mënyrë intuitive. Këtë përcaktim e kam bërë duke u mbështetur në “Fjalorin e

²⁴¹ Për tiparet kryesore gjuhësore të kësaj të folmeje shih Beci (2009: 1-11).

gjuhës së sotme shqipe” (1980)²⁴² dhe në “Fjalorin e Gazullit”. Këto fjalë mund t’i ndajmë më tej në:

1. 1. Fjalë që nuk gjenden në FGJSSH, gjithsej 65:

ajthtë (i, e) ‘i brishtë, delikat’: Doli agimi e avulli / zbuloi trajta të ajthta / para derës së Veriut (52, 1)

ale ‘bulevard / Allee’: Njerëzit enden aleve me lule (142, 3)

balçëm ‘balsam, balç / Balsam’: me balçmin e përjetshëm në zgur (154, 2). Krh. **balç** në FGJSSH dhe te Gazulli.

binjok ‘binjak /Januskopf’: Uliksi e Itaka - dy krena binjokë dhie “Januskopf eines Ziegenbocks“ (38); Pa qenë trimneshë, kam dy zemra / në parzëm, plot me dëshira binjoke ‘Bin keine Heldin und habe doch in der Brust / zwei Herzen voll zwiefältiger Wünsche (94). Shih te Gazulli **binak**.

bishtajzë ‘bishtajë / Hülsen’: Pranë votre ndigjoj plasje / bishtajzash / gjineshtre në parzëm (66, 2)

blerë (i, e) ‘i blertë’: Kam lanë përmbas zamarën e blerë (158, 1). Krh. **blerë** me kuptimin ‘blerohet’ te Gazulli. Shih edhe Bogdanin II 88, 15: e tue pām së largu një lis të fiqet plot me gjeth **të blera** ju avit...

bujqit e natës ‘bulkth / Zikaden, Nachtgrillen’: cicrojnë bujqit e natës (66, 1); shoh bujqit e natës (96, 1)

bymohet ‘bymehet’: Natën veshtuen zogjtë në terr si bymohet shtalpi i gjumit nën dhé ‘Nachts hörten die Vögel im Dunkel, wie der keimende Brei des Schlafes aufging unter der Erde’ (182, 1)

çmendore ‘çmendinë / Irrenhaus’: Çdo hymje n’ishull u mbyll / spitali dyer hekuri u mbyll / e çmendorja për qen, pranë (176, 1)

damtar ‘ogurzi’: Bariu krah-thatë te ura e zjarmit lodhet / ndërmend / për dhitë damtare përjashta /an das Unheil der Ziegen draußen... (40, 1). Shih te Gazulli **damtuer**.

djegë ‘djegie / Brennen’: Djega e vjeshtës së dytë (172, titulli i poezisë); Djega e lashtë, egoiste (172, 3)

dytenik ‘i dyfishtë’: Motive dytenike ‘Dualistische Motive’ (192, pika 3)

²⁴² Më poshtë citohet si FGJSSH.

erëtim ‘erë, kundërmim / Geruch’: një erëtim rraqesh të motnueme (90, 1); erëtim ngjyre rraqesh të përmykuna ‘Geruch der Farbe von schimmligem Zeug’ (132, 1). Por edhe **u vjen era** rrëshinë (144, 1) dhe **era u vjen** dgersë qeni (176, 3)!

faculetë ‘shami koke’: vetoi ndër rreze faculeta e bardhë / në krye të saj (120, 3)

fejhtë²⁴³ ‘hell akulli / Die Eiszapfen’: Fejtë e akullit pëlsasin (116, 2)

furq ‘thepa / Zacken’: Në rrafshinën e akujve qëndrojnë ndër furq ‘Auf dem Plateau der Eismassen steh’ ich zwischen Zacken’ (154, 2)

gjallnoj ‘jetoj, gjalloj’: Kundër thanjes së Herodotit si mbas të cilit andej Istrit nuk gjallnuekëshin bletë (52); e me gjallnue me plagë të mbulueme (146, 3); Shqarthe fle në bigën e shkambit e gjallnon me dhjamë të vet (180, 1). Por në fq. 96 **jetonte!**

gojfile ‘lloj luleje (?) / Silberdistel’: Agimi lind fijesh të gojfileve mbi karma (184, 2)

grizhë ‘grizhël, laraskë’: zemra i plastë sy-grizhës ‘Elsteraugen-Herz zerbreche’ (88, 3). Shih te Gazulli **grizë**.

gryckë ‘kurora e pemëve / Baumkrone’: Flokët e borës ndër gryckat e lisave (42, 1); ndër gryckat e tyne fantazma (72, 2)

heshton ‘hesht’: mbasi ta ketë mbytyë njëni shoqin, / heshton gjithçka (142, 2)

hylleshë ‘hyjneshë’: Hylleshë e natës verore ‘Venus, Stern der Sommernacht’ (124, titulli)

jeremi ‘vetëm’: n’barka druni palnje ishim endë / mbi të, jeremi (164, 1)

kamin ‘vatër / Kamin’: pranë kaminit (132, 2)

këputë ‘çorape’: Ai s’asht Drini i vjetër me këputë / të bardha për rrugë, pa u ndalë! ‘Das ist nicht der alte Drin / weißbesockt rastlos unterwegs!’ (96, 2). Po kështu edhe te Gazulli **këputë**.

koc ‘kockë’: Koca e eshtna na i qëron moti (44, 2)

²⁴³ Sipas FGJSSH shumës i **fyell**.

corp ‘trup / Körper’: Vetmia shkallave guri ngreh hap mbas hapi / korpin me avull përpjetë / e nuk mbaron kurr (120, 1); Shpirtët e rinisë larg korpit endeshin (138, 3). Këtë fjalë e përdor rregullisht Buzuku, p. sh.: Duhetë se kyy corp qi anshtë vutë përndenë mort, aj të nvishetë i pāmort (fq. 381, kollona e majtë, rrjeshti 21-22).

kullem ‘qëroj zërin, fytin / Räuspern’: Homeri i përngeshëm u kull kujtueshëm e tha (38)

kunoruem (i, e) ‘i nderuar me kurorë / bekränzt’: Ulet balli e prek zemrën e lules / e çelet një botë e tanë / para tamthave të kunoruem ‘... vor den bekränzten Schläfen’ (130, 1)

latrac ‘plënc / Wanst’: Ishte një latrac dje e sot / me të lanë pamend.../ përpijës gjellnash e pije / sa i tanë një vend (162, 1). Shih edhe te Gazulli **latrâc**.

lezëm (i) ‘i druajtur / scheuer (Geist)’: e di se nuk jam vetëm, parandjenje, shpirt i lezëm si frika! (180, 2)

lodhet ndërmend ‘vret mendjen / grübelt sich müde’: Bariu krah-thatë te ura e zjarmit lodhet / ndërmend / për dhitë damtare përjashta (40, 1)

lulmë (i, e) ‘me lule’: Gjatë ditve të javës dalin heret / me tesha të lulme në ballkon (58, 1)

mend ‘mendim’: Në mende të pangjashme përlyhen / linjat e ndeme për m’u tërë n’ballkone (120, 2)

mëngjishme (e) ‘e magjishme / schwarze Kunst’: në sheshin e madh të qytetit milionësh / gdhui nuska e mëngjishme / me një pe të kuq në qafë (76, 1)

mëngohen ‘pakësohen, vdiren / nehmen ab’: Mëngohen ditët e bora resh (146, 1)

mys ‘cep, buzë / Steinkanten’: Lulet dalin plasave të gurve / e myseve të shtegut deri në shkamb (56, 1). Krh. në FGJSSH **mysët (i, e)**. Shih edhe **mys** te Gazulli.

ngrohësi ‘ngrohtësi’: ngrohësia e pejve të leshtë (78, 3)

nusi ‘nusëri’: Në shtëpinë e lashtë e të lëshueme / erëtim ngjyre rraqesh të përmykuna / i mori pafajninë / petkut të vjetër të nusicë ‘Die Unschuld nahm er / dem alten Brautkleid’ (132, 1)

palueme (të) ‘që nuk lëviz / reglos’: Nji za i bardhë kapet për tesha... / e bie mbi gurë me flatra të palueme ‘und fällt auf Stein mit reglosen Flügeln’ (102, 1)

parkat ‘Perënditë e fatit në botën antike’: Parkat janë fytyrat ma të shëmtueme / të miteve klasike (74, 1)

pëllaz ‘pallat / Palast’: Mbasdite enden dora-dorë / kopshtijeve rreth pëllazit të vet (58, 1)

përfrikshëm (i, e) ‘turispërdredhur / fratzenhaft’: ndejë në karrigë të gdhendun në embleme të përfrikshme (186, 1)

përmaje ‘përsipër / darüber, obenauf’: ... e filiza shumë / me krena gacash përmaje... (160, 2); pa kambë e krye, / me gërmaz përmaje (162, 1). Edhe te Gazulli **përmaje**.

përmykun (i, e): ‘i mykur / schimmlig’: Në shtëpinë e lashtë e të lëshueme / erëtim ngjyre rraqesh të përmykuna (132, 1)

puta ‘ëngjëllush, eros’: Përqethje mishi engjujsh puta (26, 2)

qeth ‘tavë’: në duer sa qethi ‘in den backblechgroßen Händen’ (84, 2); Banorët e ishullit enden / shkushullueshëm / nëpër ishull sa një qeth buke ‘... auf der Insel die so groß ist wie ein Brotschieber’ (176, 3)

s’i vjen ngoje ‘s’më vete goja, s’më pëlqen të them diçka / Homer kam es nicht auf die Zunge’: Homerit s’i erdhi ngoje me thanë / përse Penelopa endte për të me duer të veta / petkun magjik të kthimit (38, 2)

sendegja ‘sende’: Njomza në vjeshtë, e shkurtë, / rrezja e fikun në sy të ligshhtë / nuk ishin sendegja të trishta! (172, 2). Por në fq. 184, 2 dhe 192, 4 **gjasende!**

shkurtë (i, e) ‘i shkurtër’: e mbeti mallëngjimi i shkurtë / mbi krahët e fluturës së thame (90, 1); dhe mbeti mallëngjimi i shkurtë / mbi krahët e fluturës së thame (132, 2); Pra poezitë, ndonëse të shkurta, sëbashku paraqesin një botë sikur të ishte një poemth i vetëm (192, pika 3).

Shotë ‘Floçkë, një lloj ninfe’: Shota apo Floqka, si e quejnë banorët e rrjedhës së poshtme të Drinit, asht si mbas besimit popullor lloj Ninfe në pamje grueje shumë të bukur (96, shënim i autorit)

shqimth ‘prag’: Dola jashtë e ndeja në shqimthin e derës ‘Ich ging hinaus und saß an der Schwelle der Tür’ (138, 2). Shih Gazullin te **shkim-i**.

fik hindi ‘fik deti (?)’: Dola jashtë e ndeja në shqimthin e derës / dhe vrejta fiqtë e hindit me ferra „und besah die stachligen Feigen’ (138, 2). Shih edhe **fik-hindi** te Gazulli.

shtjerri ‘prish’: Në ravgime të paskaje /shtjerri edhe të mbramin petk ‘hatte auch das letzte Gewand verschliessen’ (38, 1). Shih edhe te Gazulli **shtjerrë**.

stërdjegun (i, e): Mbrendë të vjetrit ndezin / mbramjeve zjarme në hinin / e stërdjegun (122, 1). Shih edhe **përdjegë**.

therë ‘gjemb / Stachel’: Iriqi me therra të nguluna n’mish (42, 2)

timba ‘shkëmbinj’: Katund i lanun mbas dore ... / me shpi e rrugza që sosin / në timba ‘mit Häusern und Gassen / die in Felsen enden’ (122, 1)

timtë ‘sekondë, çast’: dhe hana as dielli s’u ndalën / një timtë (168, 2)

topra ‘sëpatë, sakicë / Äxte und Beile’: Dhe u çue krejt dheu në kambë / me lata e topra e armë të vjetra (40, 3)²⁴⁴

ujce ‘ujëse’: bimët ujce në gjiun e Drinit ‘Wasserpflanzen im Schoß des Drin (96, 1). Shih te Gazulli **mëlli-ujce**.

vërri ‘kullotë në vende të ngrohta / Winterweide’: Barijtë tradhtisht e lanë shkret bjeshkën / për ngrohësinë e vërrijeve (92, 1)

vetimë ‘vetëtima’: Natë e vetima plastë (88, 4). Shih edhe **veton**.

zgur ‘zhavor / Schotter’: me balçmin e përjetshëm në zgur (154, 2)

1. 2. tetëmbëdhjetë fjalë, të cilat te Camaj përdoren me një kuptim tjetër nga ato që dalin në FGJSSH. Shpjegimi i kuptimit në këtë rast është bërë duke u mbështetur te përkthimi gjermanisht dhe te Fiedler-Klosi (2001):

ballë ‘mur / in den vier Wänden der Erde’: Iriqi me therra të nguluna n’mish / digjet pa flakë / mbrenda katër ballnave të dheut (42, 2)

bigë ‘e çarë / (Fels)ritze’: Shqarthe fle në bigën e shkambit (180, 1). Krh. **bigë** në FGJSSH.

brez mali ‘vargmal / Bergkette’: Zjarme në brezin e malit ndër andrra (68, 1). Krh. FGJSSH te fjala **brez**.

²⁴⁴ Shembujt nga botimi dygjuhësh “Weißgefiedert wie ein Rabe / Me pendlat e korbit të bardhë” (Klagenfurt, 1999) janë cituar sipas faqes dhe strofës ose paragrafit ku gjendet fjala. Në çdo rubrikë fjalët renditen alfabetikisht.

bulëz ‘gonxhe / Knospe’: Në lulimin e mbramë / drandofillja ndrroi bulzën / prej saj zbërthyen fletë zezake (172, 1). Krh. në FGJSSH **bulë** me kuptimin ‘syth’. Ndoshta është përdorur edhe këtu me këtë kuptim, pavarësisht nga përkthimi gjermanisht?

grimcoj ‘nduk telat e një instrumenti / anriß’: i grimcoi tejjat kripi mazi (30, 2). Krh. në FGJSSH me kuptimin ‘e bëj thërrime’.

gurgull ‘gurgullimë / Glucksen’: Malli, dëshirë e përjetës / e jo mallëngjimi, gurgull frymëshkurtë / e joshi Uliksin (38, 1). Në FGJSSH me kuptimin ‘gurmaz, grykë’.

krande ‘shkarpa / Reisig(feuer)’: ngrohet mbas flakës së krandeve (186, 1). Krh. **krënde** në FGJSSH.

kullon ‘pastron / reinigt’: Dielli kullon fjalën prej çdo vështrimi të dyshimtë (184, 4)

lëshuem (i, e) ‘i braktisur / verlassen’: Në shtëpinë e lashtë e të lëshueme (132, 1)

palaré ‘tigan bakri / Kupferpfanne’: plasin sytë e sqepve grimë-grimë / nën dhambët e ujqve / kokrra groshe e drithi në palaré (40, 2); ngurzohen edhe duert e foshnjeve / në palaré (84, 3)

përdjegë ‘stërdjegur / verbrannte und abermals verbrannte’: ndezi zjarmin e fikun në hinin djegë e përdjegë në votër (188, 1). Shih edhe (hinin) e **stërdjegun**.

plaf ‘shami koke / Kopftücher’: si plafa të murmë (8, 2)

shark ‘pjesa anësore e një instrumenti / Zarge’: ...ky e mori veglën në dorë / e i preku sharkun lëmueshëm / me bulzat e gishtit të vrashtë (30, 2)

të përçamë ‘të çarë’: Ra dielli e ndriti dhenë e ri, / rrajë të shkyeme, lisa të përçamë (34, 2). Krh. në FGJSSH ‘që është përçarë nga grindjet dhe mosmarrëveshjet’.

tejë ‘kërrmi, krimb druri / Holzwurm’: dhe teja iku druni (90, 1); dhe teja iku drunit (132, 2). Krh. FGJSSH te **tenjë**.

thep ‘gjemb / Dorn’: mbi thepa drizash (170, 2)

vullaj ‘gonxhe’ (24, 1) Krh. FGJSSH me kuptimin ‘lehe’. Shih dhe **bulëz**.

zogëz ‘femra e zogut’: Zogëza mat trollin me kambë të zeza / para se me u nisë për Jug (86, 1)

2. Në grupin e dytë përfshihen 28 fjalë të krijuara nga vetë autori, pra që nuk gjenden as te FGJSSH dhe as te Gazulli. Predominojnë kompozitat përcaktore, të cilat gjymtira e dytë përcakton të parën, dhe ndajfoljet me prapashtesën **-shëm**, me sa duket një model fjalëformimi tepër aktiv në të folmen e autorit. Te kompozitat është vënë shpesh edhe një vizë ndarëse, çka përkon ndoshta me drejtshkrimin e autorit.²⁴⁵ Sqarimi i kuptimit të këtyre fjalëve është bërë mbi bazën e përkthimit gjermanisht.

buzë-përgjakun: ... Fiqtë e ambël, / buzë-përgjakun u bien mbi krena / flijim ‘... Süße Feigen / blutrotgelippt fallen auf ihre Häupter / als Opfer (144, 2)

dheas, siç shpjegon vetë autori: ‘vendas, jo i huej’: Njerëzit enden aleve me lule / parqeve në blerim / e çdo njeni sish asht dhéas. (142, 3)

duer-fortë ‘i fuqishëm / robust’: Lulet kurm-këputuna me qafë sa peni / veshtojnë kuvendin e grave duer-forta (56, 1)

frymëshkurtë: ‘që zgjat një grimë’: Malli, dëshirë e përjetës / e jo mallëngjimi, gurgull frymëshkurtë / e joshi Uliksin... (38, 1)

gjallnesë ‘ekzistencë: Shota... jetonte shpirtnisht ndërduzash mes gjallnesës mbi dhë e mallit të shpellave të ujit në Dri (96, shënim i autorit)

grimë-grimë ‘copë e thërrime / in tausend Scherben’: mbi rrasat e gurit në Mertur / plasin sytë e sqepve grimë-grimë / nën dhambët e ujqve (40, 2)

gzhatshëm ‘duke tharë / dörrend’: Në tempon e dytë gzhatshëm era / përkuli grunin deri në tokë (18, 3). Shih te Gazulli **gëzhatë** me tjetër kuptim.

i përngeshëm ‘i hutuar / zerstreut’: Homeri i përngeshëm u kull kujtueshëm e tha (38, 2)

kërçllatje ‘kërcitje, kuitje / Quietschen’: Qentë mbas dyerve gërvishtin drunin / e ciasin për t’i lirue dikush kërcëllatjesh / telash të ndryshkun në shtrat (120, 2)

krip-bardhë ‘i thinjur / Weißgewordener’: Shkatrruesi i vetes, një krip-bardhë (166, 1)

²⁴⁵ Këtë e gjejmë shpesh edhe te Gazulli.

kryevogla ‘vogëlushe / Knirpse’: Po në muzg, ku shkelin ato kryevogla / nuk del ma bar (58, 3)

kujtueshëm ‘me mendjemprehtësi / ein scharfsinniges (Räuspern)“
Homeri i përngeshëm u kull kujtueshëm e tha (38, 2). Krh. **kujtueshëm (i, e)** në FGJSSH.

kurm-këputun ‘i brishtë / zerbrechlich’: Lulet kurm-këputuna me qafë sa peni (56, 1)

lëmueshëm ‘duke e lëmuar’: e i preku sharkun lëmueshëm / me bulzat e gishtit të vrashtë (30, 2)

mërgues ‘shtegtar’: Krahët e zez i rrah / ... dallëndyssha / mërguese e vonueme / për Jug (108, 1)

mjekër-pakrehun ‘Wirrbartig’: Mjekër-pakrehun plak / dhe i shkujdesun (168, 1)

motnuem (i, e) ‘i brerë nga moti / verwittert’: Në vilën e lashtë e shkret / një erëtim rraqesh të motnueme (90, 1)

ngurzoj ‘ngurosen / versteinern’: ngurzohen edhe duert e foshnjeve / në palaré (84, 3)

pafajni ‘pafajsi / Unschuld’: Në vilën e lashtë e shkret / një erëtim rraqesh të motnueme / i mori pafajninë / petkut të vjetër të nusnisë (90, 1)

pavëmendshëm ‘pa vëmendje / unachtsam’: Pavëmendshëm në kalim (150, 1)

përjetë ‘përjetësi’: Malli, dëshirë e përjetës ‘Die Sehnsucht, der Drang nach Ewigem’ (38, 1)

shkokrrueshëm ‘kokrra-kokrra / ausgekörnt’: Mendimet ranë shkokrrueshëm (118, 1). Krh. te Gazulli **kokrrue**.

shkushullueshëm ‘pa mundur të ngushëlloheshin / trostlos’: Banorët e ishullit enden / shkushullueshëm / nëpër ishull... (176, 3)

shum-dritaresh ‘er geht buntbesohlt / wie einer der im Norden über Winter / hinter vielen Fenstern haust’ (86, 1)

shum-dritaresh: ai ec në shputa të larme / shpendësh dimnues në Veri / nëpër banesën.

shungullueshëm ‘me shungullimë’: Fjala i jehonte ndër ne / shungullueshëm ‘Sein Wort hallte in uns / sich brechend’ (104, 2); Plasi

sirena shungullueshëm ‘Plötzliches Aufheulen der Sirene’ (136, 1). Shih te Gazulli **shugullue**.

vëshë-imët ‘die Ohren gespitzt’: Ndëgjuesit vëshë-imët mbyllën sytë (18, 3)

vjetmirë ‘që i takon një viti të mirë’: Te dera plaka tregon / për arin e kallëzve vjetmirë ‘An der Tür erzählte die Alte / vom Gold der Ähren / der guten Jahresfrucht’ (110, 2)

zhgrehshëm ‘duke u turrur’: ...e qeshin / me ujin e prronit zhgrehshëm tue u derdhë ‘... und ihr Lachen / ergießt sich wie ein Sturzbach’ (92, 1)

3. Në këtë grup bëjnë pjesë 59 fjalë që gjenden në FGJSSH, por që në raport me sinonimet e tyre të përmenduar atje, përdoren përgjithësisht rrallë, pra kanë një frekuencë më të ulët përdorimi:

amëz ‘kundërmim’: Në ravgime të paskaje / shtjerri edhe të mbramin petk që kishte / amzën e pashlyeshme të vegëve ullini / dhe të duerve të grues (38, 1); me amzë qiriu (114, 1); amza e arkës së kalbun ‘... der Geruch des morschen Schreins’ (112, 2)

bahe ‘hobe / Steinschleuder’: Në dorë mban një bahe (82, 1)

bjerraditës ‘ai që e humb kohën kot / Vagabunden’: Bjerraditës shekujsh mesjetarë, / rrugaçë pa trasta në krah (44, 1). Formime të tilla janë shumë të vjetra në shqip, krh. edhe Bogdani II 109, 25: aqa sa për të vërtetë mujti me u thanë *u bâshë të shamitë e nierëzet, e shkalëbalta e polemit*.

botë ‘lloj dheu, deltinë / aus rotem Lehm’: mbi kodrinën bote të kuqe (78, 1); Me thoj e sqepa gërmuen në botë (182, 1)

bulëz ‘mollëza e gishtit’: me bulzat e gishtit (30, 2)

curr ‘shkëmb / Felsen’: Aty si tash para se me ardhë fiset / ishe / me tambël në plasaritjen e currave / e me themele në ujin e njelmë. / Të dhanë vetëm një emën: Shkodra. Por në strofën e dytë gjejmë fjalën **shkamb**: ...dhe ndeje me petka të reja / në shkamb...(62, 1); rreth një curri binjok (70, 2); currat u shkoqën vendi (106, 1)

diftojsi ‘pasqyra e lëndës’ (6)

dirgjem ‘zbres’: Dirgjen shtigjeve tue folë me za të naltë (92, 1)

feks ‘pasqyrim / Widerschein’: Në mjedis shndriste tempulli / i librit n’pergamenë - biblioteka – me fekse idesh madhështore (118, 3)

heshtim „heshtje“ (30); Përmbas horizontit – heshtimi (176, 2)

kapet „ngjitet“: Akrobatja në fillin e penit / u kapet reve përpjetë ... (26, 1); Nji za i bardhë kapet për tesha / e i shkyyen si res-keqja ‘und zerreißt sie wie schwarzer Neid’ (102, 1); u kap te gryka e vorrit (114, 1); ... e hija më kapet në qiell mbas kthimit të diellit / përmbas shtatores sime... (154, 3)

karmë ‘Shkëmb i madh që ngrihet thikë në bregun e një lumi a në breg të detit / felsige Abgründe’: nën karmat e vendit tim (84); as me qenë ulurimë ujku t’unshëm / ndër karma ‘und war wie das Geheul / des hungrigen Wolfes / im kahlen Fels (104, 2)

kënaqje ‘kënaqësi’: e dridhi në kënaqje të paskaj (78, 3)

kortarë-kortarë ‘copa-copa’: dhe dielli u ndejt në perëndim / me rreze të lodhuna / në mishin e ujqve mbi dhambët e majeve / kortarë-kortarë (40, 4)

krah-thatë ‘i mjerë’: Bariu krah-thatë te ura e zjarmit (40, 1). Krah në FGJSSH krahëthatë.

krip “flok”: i grimcoi tejzat kripi mazi (30, 2). Kjo fjalë del që te Buzuku, p. sh.: zū me lagunë kambëtë e tī e me i puthunë, e me **kript** të saj po ja dëlirën (fq. 195, kollona djathtas, rrjeshti 33-35). Shih edhe **krip-bardhë**.

kulluem (i ,e) ‘i pastër’: Malli... / e joshi Uliksin me kthye i kulluem / atje kah ishte nisë (38, 1).

larmë (i, e) ‘i larmishëm / Scheckiges Wundwasser’: Nji zezak i verbët / me një qen në mantel lëkure...../ qëndrojnë palëvizë në kambë. / Njerzia u vjen rrotull / ujë rreth një curri binjok... / Ujë i larmë përreth plagës / në trupin e një gjiganti (70, 3); ai ec në shputa të larme ‘er geht buntbesohlt’ (86, 1)

latë ‘sëpatë’: Dhe u çue krejt dheu në kambë / me lata e topra e armë të vjetra (40, 3)

lëpizë ‘raft / Regal’: Ndër bebza ka gdhendun fytyra / guri rilindësish / varg mbi lëpiza si mbas kohe (128, 1)

lulim ‘lulëzim / Erblühen’: Në lulimin e mbramë / 172, 1)

marr vesh ‘dëgjoj / hörten’: Në sallën e koncertit edhe diktatorët / marrin vesh masën e instrumentave (18, 2). Foljen **ndigjoj** e përdor vetëm një herë në fq. 66. Në vend të saj gjejmë **marr vesh** dhe **kap**.

mazë ‘ajkë qumështi / Rahm’: e pi qumësht n’vedra lanun jashtë / për me vu mazë (148, 2)

mbramë (i, e) ‘i fundit’: Në ravgime të paskaje / shtjerri edhe të mbramin petk... (38, 1); Prej të mbramit rresht në fund / u shkëputa... (54, 2)

mehet ‘pushon’: Mejt shiu në Merturin e Gurit (40, 4)

mëngji ‘magji / Zauber’: Kush i bani mëngji qytetit? (76, titulli); Formulë mëngjie ‘Zauberspruch’ (88, titulli); Grueja me mëngji ‘Die Frau mit Zauberkraft’ (150, titulli i poezisë); Grueja s’e përdori mëngjinë (150, 2)

mjaltëz ‘bletë’: Mjaltëzat lagin me mjaltë / gurzit e projeve të thata (134, 2)

mungët (i, e) ‘i errët / dunkel, düster’: bletë përpara zgjonit me krahë ari / gati me u lëshue fluturim / kah rrezet për net të mungëta (52, 3); një kripbardhë / e gjeti se koha e mungët / mes dritave / i hyn për palcë gurit / dhe ashtit njerëzor (166, 1). Krh. edhe **i mugët** në FGJSSH.

ndër krahë ‘në gjoks / in Ihrem Inneren’: Mandej sheh andrra si rriten / dega lisash ndër krahë (36, 2).

ndërdyash ‘ndërdyshas / hin- und hergerissen’: Shota... jetonte shpirtnisht ndërdyash mes gjallnesës mbi dhë e mallit të shpellave të ujit në Dri (96, shënim i autorit)

njuh ‘numëroj: e njeha shkallët një nga një / deri në fund (54, 2)

njelmë (i, e) ‘i, e, kripur: Harroi se shtini kambë ndojherë / n’ujin e njelm (36, 1); ndër ujna të njelmë si gjak (126, 1); e jo në detin e njelmë (144, 3). Krh në FGJSSH **i njelmët**.

pangjashëm (i,e) ‘i pahijshëm / schamlos’: Në mende të pangjashme përlyhen / linjat e ndeme për m’u terë n’ballkone (120, 2)

parzëm²⁴⁶ ‘kraharor’: Je barrë e vrame / në parzmin tim! (48, 1); e lëvizja e fëmijës në parzëm / e dridhi në kënaqje të paskaj (78, 3); e krisi një hap grueje n’shkamb / me jehonë në parzmin tim (120, 3)

pendël ‘pendë e vogël’: Me pendlat e korbit të bardhë (titulli i veprës); me pendlat e korbit... (28, 3), pendlat – bletë e gretha bashkë (40, 3), Pendël e

²⁴⁶ Në FGJSSH si emër femëror **parzëm, -ma**.

lehtë në dukje (46, 3); sqepi i dukej i verdhë, gati i bardhë / mes pendlave të zeza (84, 1)

përqeth²⁴⁷ ‘rrërqeth / jagt Schauder’: amza e arkës së kalbun / përqeth mishin e mishit të saj (112, 2)

pos „përveç”: Në sallën e koncertit edhe dirigjenti / symbyllë s’pau tjetër pos tingujsh (18, 4) **rrotull** “rreth, disk / Rund, (Sonnen)scheibe”: ... pos tingujsh/ të ndezun mbrenda një rrotulle terri (18, 4), me rrotulla dielli n’prendim (110, 1)

qokth “gjon” (22, 2)

ravë ‘orbitë, gjurmë / Bahn, Spur’: rrugaçë pa trasta në krah ecën / mbas ravës së diellit skajeve / të dheut (44, 1); e flutura lëshon ravën e drejtë / në fluturim mbi tryezë (102, 1); dhe mbaj për vete / skaj buzës një rrudhë, / ravën e gazit mbi vete e tjerë (158, 2)

ravgime (let. rravgim) ‘endje’: Në ravgime të paskaje / shtjerri edhe të mbramin petk (38, 1).

resh ‘bien reshje / Schnee rieselt’: Mëngohën ditët e bora resh (146, 1)

res-keqja ‘smirëzezë’: Një za i bardhë kapet për tesha / e i shkyen si res-keqja ‘und zerreißt sie wie schwarzer Neid’ (102, 1). Shih në FGJSSH **resëkeq** nga resë ‘smirë’ + keq.

rogë ‘lëndinë / Lichtung’: Dielli djeg mjedrat në rogë (100, 2)

rrëshiq ‘kacek, rrëshek, shakull / Weinschlauch’: Dhe u plasarit reja si rrëshiq (100, 3)

rrokaqiell “ndërtesë shumëkatëshe” P. sh: faqet e rrokaqiellëve²⁴⁸ (14, 3)

rrugëz ‘rrugicë / Gasse’: Katund i lanun mbas dore ... / me shpi e rrugza që sosin në timba (122, 1)

shi ‘pikërisht’: Shì në maje, te pallati i lashtë (120, 3); Shì te kambët e përmendores (76, 1)

shkoq „shkul”: shkoqi lahutën vendi / e ia lëshoi mikut në prehën me i ra (30, 2); Në orën gjashtë t’agimit / i qindronte aty shtërgatës. / Në mjesditë u

²⁴⁷ Është formuar nga **për** + **ngjeth** sikurse **rrërqeth** nga **rrë** + **ngjeth**.

²⁴⁸ Shumësi në gjuhën letrare është **rrokaqiej**, t.

shkoq pylli, / mollza e faqes, e ra në lumë (34, 1)
shtërpi ‘zvarranik / Schlange’: Shtërpia tha se vjen prap, ajo, / deri mbasdite (50, 2)
syzë ‘syth’: syzit e hardhiave / die Knospen der Weinstöcke (40, 1); preku rrezet e diellit në syzit e bimës në dritare (188, 1)
tejpashëm (i, e) ‘i tejdukshëm: Lyp dashuninë e syve të mbyllun, / dy molla të tejpashme / me bërthamë zjarri në mes. (32, 1)
tejzë ‘tel i një instrumenti’: i grimcoi tejzat kripi mazi (30, 2)
trandet ‘dridhet, tundet / behte’: a mos u trand nga krizma dheu (118, 2)
verbët (i, e) ‘i verbër’: Nji zezak i verbët / me nji qen në mantel lëkure (70, 1); A thue i verbët? (128, 3)
veshtoj ‘dëgjoj me vëmendje, përgjoj / lauschen’: Lulet kurm-këputuna me qafë sa peni / veshtojnë kuvendin e grave duer-forta (56, 1); veshtoj... / se si i falen dreqit shpirt e korp (148, 1); Natën veshtuen zogjtë në terr (182, 1). Krh edhe te Gazulli **vesht**.
veton ‘vetëtin’: vetoi ndër rreze faculeta e bardhë / në krye të saj (120, 3)
vutë (i, e) ‘i sheshtë, i rrafshët’: ‘mërgues për vendet e vuta e bar dimni (92, 3)

Interesant është fakti që në krahasim me sinonimet e tyre në FGJSSH shumë fjalë si: **koc**, **grizhë**, **shkurtë (i, e)**, **blerë (i, e)**, **njelmë (i, e)**, lulim < **luloj**, **larmë (i, e)** kundrejt i larmishëm etj. këtu dalin pa prapashtesë. Por edhe e kundërta është e mundur: **pendël**, **heshtim**, **bulëz**. Varianti **i verbët** dëshmon qartë origjinën latine.

Bie në sy që huazimet janë shumë të pakta dhe lidhen me sende e koncepte të hapësirës jashtëshqiptare. Autori ka treguar kujdes deri edhe për prapashtesat. Kështu ka preferuar **rrugëz**, fjalë e ndërtuar me prapashtesën zvogëluese shqipe **-zë**, dhe jo **rrugicë**. Me ndihmën e autorit edhe lexuesi fillon të depërtojë në një botë që e njeh kryesisht nga librat dhe në një seri fjalësh, të cilat shkallë-shkallë arrin t’i përvetësojë edhe aktivisht. Siç na dëshmon H.-J. Lanksch (203) Camaj vinte gjithmonë si kusht që përkthimet e poezive të tij, qofshin nëpër revista apo libra, të dilnin dygjuhëshe, pra që përkthimi të vihej përballë origjinalit. Veç kërkesës për një nivel të lartë përkthimi, kjo tregon që autori i përmbahej me ndërgjegje të folmes së

vendlindjes duke na lënë kështu një monument të paçmuar gjuhësor dhe letrar të zonës së Temalit. Fjalori që shoqëron botimin e plotë të veprave të tij do të ndihmojë për t'ua bërë të njohur këtë pasuri leksikore të gjithë lexuesve.

BIBLIOGRAFI:

1. Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë. Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë. 1980. *Fjalori i gjuhës së sotme shqipe*, Tiranë. Cit. : FGJSSh.
2. Beci, Bahri. 2009. *Vendi i të folmeve të Malësisë së Madhe në strukturën dialektore të shqipes*. Në: Genesin, M. & Matzinger, J. (botues). 2009. Nordalbanien – L'Albania del Nord. Hamburg.
3. Bogdani, Pjetër. 2005. *Cuneus Prophetarum (Çeta e Profetëve)*. Botim kritik përgatitur nga Anila Omari, Tiranë.
4. Buzuku, Gjon. 1968. «Meshari i Gjon Buzukut (1555)». Punuar nga Eqrem Çabej, Tiranë.
5. Camaj, Martin. 1999. *Weißgefiedert wie ein Rabe / Me pendlat e korbit të bardhë*. Klagenfurt-Wien-Ljubljana-Sarajevo.
6. Cimochoowski, Waclaw. 1951. *Le dialecte de Dushmani*, Poznan.
7. Gazulli, Nikoll. *Fjalori i Gazullit*. 2005. Botim anastatik, Tiranë.

The vocabulary of "The man on his own and with others" by Martin Camaj

Camaj's literary work is a historical testimony of his native dialect and, as such, is of interest not only for scholars of Albanian literature but also for the Albanian linguists. To highlight some features of this dialect's lexicon (that of Temali) was analyzed the poetry volume "Man on his own and with others" and the words of interest are divided into three groups.

The most evident fact is that the number of loanwords is very small and

they generally relate to foreign objects and concepts. The author, whose care extends even to the suffixes, preferred eg. **rrugëz**, which is a word that contains the Albanian diminutive suffix **-zë**, to the more general version **rrugicë**. In this way, through this work, the reader penetrates into a series of words, which he can absorb and, in certain circumstances can use actively.

Rrezarta DRAÇINI, Esmeralda HOTI (Shkodër)

DIMENSIONI PSIKOLINGUISTIK TEK “PISHTARI I NATËS” I MARTIN CAMAJT

Gjuha ka pasur dhe do të vazhdojë të ketë një domethënie të veçantë për studimin e natyrës njerëzore. Aspekti krijues i përdorimit të gjuhës është paraqitur shpesh si shembulli më i qartë i aspektit themelor të natyrës njerëzore. Sipas Çomskit aftësitë dhe zotësitë kthehen në shprehje dhe rregulla për t'u sjellë në një mënyrë të caktuar, në rrethana të caktuara²⁴⁹. Vepra e Martin Camaj padyshim që është prova që vërteton këto pohime. Tregimi “Pishtarët e Natës” është dëshmi e një përshkrimi të zhvillimit evolucionist të jetës njerëzore, e cila kalon nga marrëdhëniet fillestare në kontekstin familjar, ku formohet ideja mbi veten, vetëvlerësimin dhe botën afektive, dëshmi e marrëdhënieve të para shoqërore dhe sociale, me konfliktet që ata sjellin. Gjithçka jepet e qartë dhe e fortë mes gjuhës së Martin Camaj. Në këtë punim ne do të ndalemi në dimensionin psikolinguistik të kësaj vepre.

Për një shkrimtar fjala e përdorur për të shprehur emocionet dhe qëndrimet mbi një fenomen të caktuar, mbetet arma e vetme dhe e padiskutueshme me të cilën zëbërthen përjetimet më të fshehta të psikikës humane. Martin Camaj ka treguar që jo vetëm zotëron fjalën me pushtet të padiskutueshëm, por edhe dinamikat e psikologjisë njerëzore. Tek “Pishtarët e natës” shpreh nëpërmjet forcës së gjuhës, figurave letrare dhe përshkrimeve lidhjet e ndryshme njerëzore e më në veçanti lidhjet e protagonistit Nikë me familjen e origjinës (me vëllezërit), me gruan e tij “reale” Lenën, me gruan “imagjinare” dhe me djalin e madh, Palin.

²⁴⁹ Noam Chomsky, *Gjuha dhe problemet e njohjes*, Tiranë, 2008, f. 9.

“Pishtarët e natës” hapet me këtë fjali: “*E ama kishte thanë për Nikën se ky e kishte fillue grindjen me të vëlleznit qysh në djep, atëherë kur kishte kujtue se ajo po ia pret gjijtë për të nisë përsëri të kuate të parin djalë, Kolën*²⁵⁰”. Ky është momenti i parë i braktisjes për Nikën. Pastaj vazhdon “*...vjet për vjetë ... i ngushtohej drita e diellit mbi krye... dhe i mbeti ne krye se e padrejta i bahej gjithkund*”²⁵¹.

Autori vë në shërbim të idesë tij funksionin kohë, duke treguar mjeshtërinë e përdorimit të formave kohore, kombinimit të tyre, duke bërë që lexuesi të zhvendoset me imagjinatën e tij. Lokalizimi në kohë i veprimeve përcaktohet qartë duke u nisur nga koha e realizimit të thënies. Kategorinë e kohës Camaj e përdor për të fiksuar momentin e ngjarjes në kohë të universit. Kjo realizohet nëpërmjet tri ndryshoreve. E para është ngjarja që shënon vendin e saj në kohë. E dyta është origjina a koha e ligjërit që përkufizohet si pikë në boshtin kohor nga nisemi për përcaktimin e kohës së ngjarjes dhe e treta është pikëreferimi që përcaktohet si pikë nëpërmjet së cilës mendja e lexuesit e kundron ngjarjen.

Koha në vepër është një shprehje e marrëdhënies në mes këtyre tri pikave. Camaj arrin ta realizojë këtë marrëdhënie duke bërë lexuesin të përjetojë jo vetëm ngjarjen e ndodhur vite larg, por forca e saj ta kthejë në aktualitet, duke lejuar lexuesin “të imagjinojë” dhe “të fluturojë” me mendjen e tij në malësitë e Shkodrës, madje të hyjë dhe në botën e personazheve, të hyjë në psikologjinë e tyre. Gjejmë të përdorur dendur foljen në kohën e pakryer, e cila lexuesit i krijon hapësira pa fund. Nga vepra veçojmë:

... “*Nika nuk shante, por nemte e truate tue thirrë gjamë e vetëtimë që t’i gjuente ... , e të çfaroste cdo send të gjallë që i shkelte dhenë.*”²⁵²

Tafil Kelmendi shprehet kështu për të pakryeren e shqipes “Në kuptimin themelor ajo nuk përmbart as fillimin, as fundin e veprimit. E pakryera shpreh një veprim që inkludon një moment a periudhë të njohur të

²⁵⁰ Martin Camaj, “Shkundullima”, proza, “*Pishtarët e natës*”, Romë, 1981, 67, f. 7.

²⁵¹ Po aty.

²⁵² Martin Camaj, “Shkundullima”, proza, “*Pishtarët e natës*”, Romë, 1981, 67, f. 10.

shkuar ose që është identike me të; e shkuara vendoset jashtë sferës së kohës reale qenies me kohën e ligjëritimit.”²⁵³

Ekziston një raport i veçantë mes strukturës së një fjalie, rregullave të brendshme të formimit të saj dhe të kuptimit domethënës. Studimi i këtij raporti në një vepër letrare mundëson njohjen më të saktë të procesit të shndërrimit të shenjave e të simboleve në domethënie, në kuptimin përkatës. “Është e pamundur që të arrijmë të ndajmë procesin e perceptimit gjuhësor me atë të të kuptuarit”²⁵⁴. Ndaj gjuha e veprës letrare është kaq e rëndësishme. Camaj nëpërmjet forcës së strukturës së fjalisë nuk “luan” vetëm me personazhet e tij, por “luan” dhe me lexuesin sepse arrin ta çojë aty ku ai synon: në botën e malësisë, në madhësinë e maleve dhe këtë e bën vetëm me fjalën që në penën e Camaj kthehet në diamant. Me një metaforë të mrekullueshme “*i ngushtohet drita e diellit mbi krye*” na tregon se si xhelozitë vllazërore ia ngushtonin hapësirën e veprimit Nikës, se si i ngushtohet e drejta për të poseduar diçka në familje, sepse vëllezërit nuk ia lejonin. Pas vdekjes së të atit Nika braktiset për herë të dytë dhe shkon në Gurrë. Ky moment tragjik për Nikën e ri transformohet në sjellje impulsive dhe ngutje në çdo gjë që bënte. Shkëpusim këtë fragment:

“E shihthe si të ishte mbrapsht, e lente atë punë, kapte një tjetër, bahej dami atje ku e kishte nisë së pari, pendohej dhe egersohej me vete!”

Është interesante se si ritmi i periudhës të jep ndjesinë se si tillë është edhe përjetimi i protagonistit. Përdorimi i presjeve pas çdo fjalie me kallëzues, që tregon se po kryen një punë, dhe kalimi në një punë tjetër pa mbaruar të parën, është dëshmi e impulsivitetit dhe e paaftësisë së Nikës që ta organizojë agresivitetin. Dinamika e veprimit brenda periudhës, përdorimi i shumë foljeve - kallëzues është një nga veçoritë e veprës. Brenda kësaj dinamike përfshihet dhe lexuesi. Veçojmë nga vepra:

²⁵³ Tafil Kelmendi, “Këshjellat e Sintaksës” (Kohë foljore dhe njësi tekstore), Studime, Prishtinë, 2006, f. 42.

²⁵⁴ Robert E. Owens, “Language Development”, An introduction, Angli, 1988.

.. *“Për mot të mirë e të lig, lagu e teru jashtë ,ndotu e ndragu në botë të kuqe e gur , të tre ma së fundi e humbën duresen; lanë punën në Fundinë dhe ia nisen pa cak e qëllim nëpër fis”.*

“ Kudo hynin e delnin nëpër fis, priteshin e qiteshin dhe nderoheshin si të bijtë e filan filanit”²⁵⁵

Camaj luan me kundërvënien e gjatësisë së fjalisë: kemi një radhë periudhash të gjata, të cilat shoqërohen nga fjali të shkurtra. Tek periudha kemi folje të shumta që lejojnë një hapje të mendjes së lexuesit në imagjinatën e tij, ndërkohë që fill pas saj vjen një fjali njëkryegjymtyrëshe foljore apo emërore me forcë emocionale duke shprehur mes të tjerash urdhër, nxitje, mallkim apo dëshirë duke bërë kështu lexuesin ta perceptojë edhe ai thënien si një përjetim emocional.

“ Nika që e kishte lypë aq fort vetminë, tash viente ngase grue e fëmijë e kishin lanë mbasdore. Shkretnim! Fshante me vete, sidomos kur i delte gjumi...”

“Shkretinim! Shkretnim!”.....

Forca e artit të të shkruarit është një nga armët e Martin Camaj, pasi është përdorues shumë i mirë i të dy mjeteve: nënkuptimit, që gjendet poshtë sipërfaqes dhe qartësisë në sipërfaqe: qëllimi i nënkuptuar dhe ai i drejtpërdrejtë shkrihen në një. Komunikimin me lexuesit Camaj e realizon me anë të

1. forcës transmetuese
2. parimeve të shkëmbimit të mesazhit
3. nënkuptimeve

Komunikimi bëhet i mundur kur marrësi është në gjendje të dekodojë atë çka ka koduar dhënësi. Gjuha në një veper është si një urë në mes dhënësit e marrësit, pra autorit të veprës dhe lexuesit.

Ndërsa perceptojmë një veper ndërmarrim veprime të tilla psikolinguistike, si: izolimin, segmentimin e fjalëve, të frazave dhe të thënieve të gjata. Aftësia e autorit shihet në mundësinë që i krijon lexuesit që këto procese

²⁵⁵ Martin Camaj, “Shkundullima”, proza, “Pishtarët e natës”, Romë, 1981, 67, f. 66.

psikolinguitike të jenë në një linjë. Lidhjet perceptuale janë të niveleve të ndryshme: që nga rrokja, te fjala, fjalia, fraza, pjesët e varura etj. Nëse do të shihnim anën strukturore dhe funksionale, atëherë vendin e parë e zënë fjalët. Camaj është i suksesshëm, pasi është një njohës shumë i mirë i fjalës, që në lemë.

“...mbledhë edhe ma të voglën grimcë druje ose guri”²⁵⁶.

“ Ndonëse nuk ua shpërblente goja, përjetonin ditët ma të bukura të jetës, tue ndie edhe ngrofësinë e pranverës që vinte, diçka të fshehun me shekuj në zemra të forta e të ndezuna si vullkan pa flakë në gjiun e dheut.”²⁵⁷.

Një forcë të veçantë kanë çiftet e fjalëve. Bashkimet e fjalëve me domethënie të thellë e bëjnë lexuesin që të futet në atmosferën që prezantohet nga vetë fjalët.

“Vetmitari i Fundinës”²⁵⁸

... “vetëm në vetminë e Fundinës”²⁵⁹

“ me gojë e paska kafshue dhenë...ndoshta prej dhimbjes së madhe...”²⁶⁰

“Dheu po më bie për së gjalli mbi fytyrë”²⁶¹

“As përkufizimet e zakonshme në fjalorët njëgjuhësh apo dygjuhësh nuk arrijnë t’i afrohen karakterizimit të domethënies së një fjale, as kanë nevojë ta bëjnë këtë gjë, pasi hartuesi i fjalorit mund të supozojë që përdoruesi i fjalorit zotëron fuqinë gjuhësore të përfshirë brenda aftësisë gjuhësore të mendjes/trurit”²⁶². Në rastin tonë Martin Camaj është një përdorues i gjuhës me një fuqi ekzekutimi gjuhësor të jashtëzakonshme, i aftë që të na përcjellë botën e brendshme të tij, por jo vetëm.

Psikologjia e fortë, e prerë e malësorit jepet me anë të fjalive urdhërore të shkurtra, pa shumë fjalë. Urdhëroren e fortë e bën psikologjia brenda pak fjalëve:

²⁵⁶ Martin Camaj, “Shkundullima”, proza, “Pishtarët e natës”, Romë, 1981, 67, f. 62.

²⁵⁷ PO aty, f. 61.

²⁵⁸ PO aty, f. 51

²⁵⁹ PO aty, f. 61.

²⁶⁰ PO aty, f. 66.

²⁶¹ PO aty, f. 28.

²⁶² Noam Chomsky, *Gjuha dhe problemet e njohjes*, Tiranë, 2008, f. 27.

“Shko, more në punë tande!”²⁶³

“Ma thoni troç!”²⁶⁴

“Shihni burra!”²⁶⁵

“Urti po flet!”²⁶⁶

Personazhi ynë kryesor vendos të tërhiqet i vetëm në një kasolle në Gurra. Një malësor që nuk “ngujohet” në kullën madhështore, por në një kasolle të thjeshtë. Simbolikisht përfaqësohet thjeshtësia për të cilën shpirti i njeriut ka nevojë. Shpesh herë vetmia është i vetmi melhelm ndaj një bote që të përjashton.

Lena vazhdimisht ndihet në vështirësi dhe këtë ndjesi e shpreh me pshehrëtimin dhe thirrjet “*Mó, bre burrë*”. Lutja femërore dhe forca shpirtërore gërshetohen natyrshëm tek një grua malësore. Ndërkohë djemtë rriteshin dhe siç ka qenë karakteristikë e familjeve patriarkale shqiptare, femra fillon të fitojë pushtet. Nuk i bindej më burrit. Në këtë moment del në pah edhe një herë paaftësia e Nikës për të kontrolluar agresivitetin e tij, duke rrahur gruan. “*Mos më bie ma! Mó, bre burrë, sepse të dëgjojnë vëllezërit në anën tjetër të shtëpisë!*”. Pikëçuditësja tregon një moment të fortë emocional për Lenën e cila tani guxon dhe kundërshton.

Gradualisht edhe lidhja burrë - grua shkon drejt fundit dhe zë vend braktisja e tretë. Nika veçohet edhe me shumë duke e quajtur tokën ku jetonte “fundinë”, ashtu sikurse kishin përfunduar edhe dashuritë e tij. Parehatia dhe dhimbja shpirtërore shprehet në këtë mënyrë “*Shkretinim! Shkretinim!*”.....

Pasi veçohet totalisht nga bota fillojnë trillimet e para.

Zana e malit “*i ka nxjerrë palcën e kurrizit te shpinës me një gjilpanë*” dhe ia ka zëvendësuar me “*një lang të ambël*”. Ishte e nevojshme një gjest kirurgjikal i skajshëm që Nikës t’i kthehej besimi tek vetja. Heqja e palcës kurrizore simbolikisht tregon se si për të bërë ndryshime rrënjësore në jetë duhen transformime rrënjësore në mendje dhe në trup. Po ata

²⁶³ Martin Camaj, “Shkundullima”, proza, “*Pishtarët e natës*”, Romë, 1981, 67, f. 10.

²⁶⁴ Po aty, f. 52.

²⁶⁵ Po aty, f. 46.

²⁶⁶ Martin Camaj, “Shkundullima”, proza, “*Pishtarët e natës*”, Romë, 1981, f. 46.

asnjëherë nuk arrihen vetëm. Njeriu është qenie sociale dhe si e tillë ka nevojë të ndërveprojë me të tjerët dhe jo të izohet nga ata si e vetmja mënyrë rritjeje personale.

Dhe duke e ditur këtë pas 20 vjetësh largësi të Lenës dhe Nikës, Camaj i afron. Ata rizbulojnë magjinë e të qenit çift, magjinë e raporteve fizike edhe mbi moshën 40 vjeçare. Pishtarët fillojnë e ndizen tek kasollia e vetmuar, por që tani ka dritë dhe jetë. Dy njerëz po dashurohen. Dy njerëz po thyejnë tabutë shekullore: mund ta duash gruan edhe kur nuk je adoleshent²⁶⁷.

Një moment tjetër i rëndësishëm në tregim është dialogu i Nikës me djalin e tij Palin. Vërejmë se gjuhësisht përshkrimet janë më të ëmbla, fjalitë më të gjata e mbi të gjitha Nika flet shumë. Gjatë gjithë tregimit ai më shumë ka monologje, por kur do t'ia transmetojë të birit vlerën e tokës dhe të jetës ai papritur gjen fjalën.²⁶⁸

Zbutja e tij del në pah tek kjo fjali: *“Edhe mue, toka e egër si bisha ma ka pru shpirtin në fyt, por kur të zbutet e qet vjetin... tue e marrë me të mirë!”*. Fjala “bisha” presupozon agresivitetin e malësorit, por *“me e marrë me të mirë”* ai edhe mund të “zbutet”.

Nika vazhdimisht braktiset në vepër, ndaj dhe dëshpërimi e ndjek. E vetmja gjë që mund t'ia lejojë vetes është që këtë dëshpërim ta drejtojë nga vetja e jo nga ata që e kanë shkaktuar. Ndjesia e fajit, çensura dhe normat shoqërore i imponojnë individit mënyrën e interpretimit dhe të përballimit të realitetit.

“...Kur u avitej strofujve ndër shpellza të nëndhenshme , i nuhaste si arushë në erën e raandë si ajo shpell”

Në tregim shumë metafora dhe krahasime bëhen në lidhje me tokën dhe shumë fjalë kanë peshë emocionale vetëm po të njohësh rëndësinë e tokës për një malësor.

Nika vetëm pasi gjen veten duke reflektuar mbi gjërat e rëndësishme në këtë jetë, vendosi të kthehej në shtëpi. Pas më shumë se 20 vjetëve punë

²⁶⁷ Po aty, f. 36.

²⁶⁸ Po aty, f. 31.

ai bëhet pronar i shumë tokave në Gurraj. Boshllëku i brendshëm duket se gjeti material për t'u mbushur: *“dashuria familiare më ka munguar, por tani kam dashurinë e gruas dhe tokën që më plotëson”*.

Pas vdekjes së tij Lina pret përsëri një fëmijë. Lind djalë dhe emrin ia vënë Nikë. Duket se legjenda e Nikës nuk ka të mbaruar. Për Camaj është shumë e vështirë që normat, dogmat, paragjykimet e malësorit të zbuten befasisht.

Sado të shkruhet dhe të thuhet për forcën e gjuhës së Camajt asnjëherë nuk mund të arrijmë të japim plotësisht madhështinë e saj. Ndaj dhe këtë punim ne kemi menduar ta mbyllim pikërisht me një fragmet të shkurtër të shkëputur nga vepra, momentin kur të bijtë e sjellin Nikën në shtëpi tashmë të vdekur. Ajo që përshkruhet mes këtyre rreshtave është thuajse e pamundur të përshkruhet por thjesht përjetohet:

“Kur të bijt e shtrinë Nikën në ballin e votrës, nuk ndien pikëllim: u dukej si mos me qenë i jati . Si me pasë përprara një burrë të madh që dheu i vet e kishte qitë përjashta për të mos e kalbë dhe, jo, në shej mospranimi, por për të mos e damtue. Ndaj tij ndienin vetëm tmerr e nderim të pamasë”²⁶⁹.

BIBLIOGRAFI:

1. Camaj, M., “Shkundullima”, proza, *“Pishtarët e natës”*, Romë, 1981.
2. Chomsky, N., *“Language in a Psychological setting”*, Angli, 1997.
3. Chomsky, N., *“Gjuha dhe problemet e njohjes”*, Tiranë, 2008.
4. Field, J., *“Psycholinguistics”*, London, 2002.
5. Kelmendi, T., *“Studime Sintaksore”*, Prishtinë, 2008.
6. Kelmendi, T., *“Këshjellat e Sintaksës”* (Kohë foljore dhe njësi tekstore), Studime, Prishtinë, 2006.

²⁶⁹ Martin Camaj, “Shkundullima”, proza, *“Pishtarët e natës”*, Romë, 1981, 67.

7. Owens, E., R., "Language Development", An introduction, Angli, 1988.
8. Marchesan, R., "*Psikologji e shkrimit*", Tiranë, 2002.

The psycholinguistic dimension of "Torches of the Night" of Martin Camaj

Language has had and will always have a special significance for the study of human nature. Creative aspect of language use is often presented as an example of fundamental aspect of human nature. The work of Martin Camaj certainly is a proof that confirms these statements. The story "Torches of the Night" is evidence of a description of the evolutionary development of human life. Everything is given clearly between the language of Martin Camaj. In this paper we will focus on the psycholinguistic dimension of "Torches of the Night". Martin Camaj has shown that not only he owns the word with unquestioned power, but also the dynamics of human nature. Camaj, in "Torches of the night", expressed through the power of language and literary figures the various of human relationships.

Matilda PARLLAKU (TIRANË)

SINTAKSA E MARTIN CAMAJT SI PASURI GJUHËSORE E SHQIPES

«Një dimër në vendin tënd është më i ëmbël se 100 pranvera në
vend të huaj»

Ndoshta është pikërisht kjo ëmbëlsi për të cilën do të kishte nevojë Martin Camaj, të cilit vetëm dija iu bë mik në vend të huaj, shok në vetmi dhe mbështetje kur ishte “Larg atyre që flisnin si ai” dhe kur “Zemra ia ndiente se nuk do të ishte një zog që rrah flatrat vetëm një verë!»

Leximi i veprave-thesar që ai ka lënë pas, na zbulon mendimet e fshehura në shpirt dhe pikërisht prej tyre dhe prej faktit që ai nëpërmjet tyre ka ditur t’i bëjë vend vetes, përkujtohet tashmë prej disa vjetësh në përvjetorët e tij të lindjes.

Ndihmesa e çmuar e këtij poeti, prozatori, dramaturgu, dialektologu, gramatikani të shquar, falë vullnetit të tij për të hedhur në letër gjithçka që përjetonte, na vjen e përkryer nëpërmjet veprave të tij në shqip, në gjuhë të huaj ose në variantin dygjuhësh. Secila prej tyre, ka arsye mjaft bindëse për të justifikuar gjuhën në të cilën është botuar. Ecejaket e tij jo të paqëllimta në shtete të tjera, nuk mbetën pa lënë gjurmë në kulturën dhe krijimtarinë e tij që, në çdo rast, pavarësisht gjuhës në të cilën është shkruar apo përkthyer, përshkohet nga ndjenja e tij e dashurisë për shqipen, gjuhën e tij amtare. Ndjenjat për të e ushqyen dhe e mbajtën gjallë, edhe larg vendlindjes. Etja për t’u shkolluar e për t’i shtuar dijet, e bëri të kalonte nga një shtet në tjetrin dhe në të gjitha rastet u dha përparësi prirjeve të tij letrare, duke vazhduar studimet në fillim për gjuhë dhe letërsi sllave dhe

latine në Universitetin e Beogradit, e më pas duke synuar gjithnjë më lart me specializimin në gjuhësi e pikërisht duke e ngritur në pedestal gjuhën shqipe, edhe pse në një vend të huaj, në Universitetin e Romës.

Me shumë gjasa mbrojtja e temës së disertacionit për «Mesharin» e Gjon Buzukut, si e para vepër e shkruar në gjuhën shqipe, për cilëndo prej arsyeve që të ketë tërhequr vëmendjen e Martinit 31 vjeçar për t'i dhënë vlerat që i takonin para një komisioni të huaj, nuk duhet të ketë qenë e rastësishme. Ai, siç është shprehur edhe vetë e dashuronte gjuhën shqipe. Këtë e dëshmoi në mënyrë të vazhdueshme jo vetëm në këtë rast, por edhe me gjithë shkrimet e veta, jo vetëm letrare, por edhe gjuhësore, më pas, me mësimdhënien e gjuhës shqipe si lektor i saj në Universitetin ku u doktorua. Është pikërisht dashuria e tij për gjuhën shqipe që e bëri që, edhe kur shkoi në Mynih të shkruajë përsëri për gjuhën shqipe e pikërisht për fjalëformimin e emrave të vjetër të saj. Për të argumentuar e mbështetur variantin dialektor, gegërishten veriperëndimore që përdorte, për të thelluar njohuritë e veta dhe studimet për dialektet e gjuhës shqipe si edhe për të na bërë të njohura disa prej të folmeve me të cilat ishte ndeshur, ai u mor edhe me disa studime dialektore të së folmes shqipe të Grecit në krahinën e Avelinos, të Falkonares në krahinën e Kozencës dhe të së folmes arbëreshe të Shën Kostandinit në krahinën e Potenzës. Nuk kishte si të ndodhte ndryshe, që gjithë ajo dashuri për gjuhën shqipe të mos shprehej edhe në dëshirën që, një gjuhë kaq të bukur, jo vetëm për të, t'ua mësonte edhe studentëve të vet. Për këtë qëllim ai hartoi një tekst për mësimin e gjuhës shqipe prej të huajve jo vetëm për të dëshmuar sa e donte vendin e vet, edhe pse ndodhej larg tij, mallin e dashurinë për të cilin e shpreh në vargjet e poezisë «Vendit tem» (marrë nga vëllimi me poezi «Lirika mes dy moteve», Vepra Letrare 2, f.65

...«Kur të vdes le të bâhem gúr
në skajin e vendit tem
të qindroj kuffi.»

por edhe për të bindur lexuesin se kjo dashuri është e pandarë nga ajo për gjuhën e vet, të cilën duhej ta linte si trashëgimi për brezat që do të vinin, siç shprehet në poezinë «Trashgimi» (marrë nga po i njëjti vëllim, në f. 88).

«Tri fjalë më la tezja arbreshe
te dheu i eshtnave tonë.
Fjalët e gjuhës seme – një
udhtimë e gjatë e gjatë në kohë,
nji ushtimë e gjatë e gjatë
ndër veshë»

Ai nuk ishte një gjuhëtar i mirëfilltë, por punoi e shkroi për gjuhën shqipe shumë më tepër se një i tillë. Këtë e bëri krejt natyrshëm, jo vetëm duke shkruar poezitë, novelat, prozën e vet me një mjeshteri gjuhësore për t'u pasur zili, por edhe duke hartuar metodën për mësimin e gjuhës shqipe për të huaj, duke i përmbledhur studimet e tij gjuhësore gramatikën e gjuhës shqipe që edhe sot, shërben si pasuri gjuhësore e shqipes për mënyrën se si është hartuar dhe për gjithçka që trajton në të. Në parathënien e saj ai flet për prejardhjen e gjuhës shqipe si gjuhë indoevropiane dhe për historinë e formimit të saj dhe, një pjesë të mirë të këtij teksti gjuhësor, të mirëfilltë gramatikor për nga rregullat që jep e ka mbushur me shembuj dhe ushtrime gramatikore.

Qëllimin e përfshirjes së sintaksës në gramatikën e tij, Martin Camaj e paraqet në këtë mënyrë: «Vështrimi i shkurtër në sintaksën e gjuhës shqipe synon:

a) t'i shtohet asaj që është paraqitur në seksionin morfologjik të sintaksës që është karakteristike për pjesët e ligjëratës.» Me sa duket këtu e ka fjalën për lidhjen dhe paralelizmin jo të plotë që ekziston ndërmjet gjymtyrëve të fjalisë dhe pjesëve të ligjëratës, në përcaktimin e natyrës së të cilës merret parasysh edhe ana sintaksore, bashkëlidhja me njësi të tjera të ligjërimit dhe përdorimi i saj në të folur, ashtu sikurse përcaktimi i llojit të gjymtyrës së fjalisë dhe vendi që zë në raport me të tjerat në fjali, varet nga fakti se cilës pjesë ligjërata i përket dhe:

b) «të sjellë një numër rregullash dhe shembujsh në mënyrë të organizuar, si për sa i përket vendit dhe lidhjeve të elementeve bazë të fjalisë, ashtu

edhe të fjalisë në lidhje me një tjetër.» Martin Camaj: Albanian grammar: with exercises chrestomathy and glossaries, Wiesbaden, 1984, § 285, f. 233. Që në fillim ai bën të ditur se shembujt që do të sillen për të konkretizuar këto rregulla do të jenë nga letërsia dhe frazeologjia popullore. Megjithëse teksti i gramatikës është hartuar prej tij për t'u përdorur nga studentë të huaj dhe nga shqiptarët e diasporës, nëpërmjet çështjeve të mirëfillta gjuhësore që ka trajtuar në të, ashtu si edhe nëpërmjet shembujve të sjellë nga dialekti geg, me prirjen për t'i ndërthurur ata edhe me gjuhën letrare, edhe me atë popullore, madje edhe me shembuj nga të folmet arbëreshe, e bëjnë këtë tekst, megjithëse në gjuhë të huaj të renditet krahas me gramatikat e mirëfillta të gjuhës shqipe të hartuara dhe të botuara në gjuhën shqipe.

Megjithëse *sintaksa* në tekstin e gramatikës zë vetëm 23 faqe, Camaj ka arritur të përfshijë në të konceptet kryesore për: përkufizimin e fjalisë si: “*Njësia më e vogël relativisht e pavarur me të cilën shprehen mendimet*”²⁷⁰; për foljen kallëzues si bërthama e fjalisë; për fjalinë dykryegjymtyrëshe, për gjymtyrët e së cilës, kryesore apo të dyta, në përbërje ose jo të grupeve përkatësisht emërore dhe foljore, nëpërmjet shembujsh, jep edhe raste të përdorimit të tyre dhe konstaton: -“përshtatjen e foljes kallëzues me kryefjalën në numër dhe vetë; -përshtatjen e mbiemrave foljorë me kryefjalën në gjini, numër dhe rasë dhe -përshtatjen e emrave foljorë me kryefjalën në rasë e numër” (f.237), edhe ndarje të mëtejshme të gjymtyrëve të dyta. Ndarja e periudhave në: me bashkërenditje dhe me nënrenditje, megjithëse nuk bëhet duke iu përmbajtur ndonjë kriteri të veçantë të ndarjes së tyre, pasohet edhe nga ndarja e mëtejshme e tyre në lloje të fjalive të bashkërenditura në asindetike dhe sindetike dhe më pas në llojet e fjalive të bashkërenditura (duke iu përmbajtur kryesisht kriterit kuptimor të lidhëzave me të cilat bashkohen

²⁷⁰ Camaj, Martin: Albanian grammar: with exercises chrestomathy and glossaries, Wiesbaden, 1984, § 286, f. 233.

ato) ndarje kjo që përputhet me atë që u bëhet këtij tipi të periudhave në Gramatikën e gjuhës shqipe II, Sintaksa, Tiranë, 1997, f. 464 e në vazhdim. Në ndarjen e periudhave me nënrenditje, Camaj thekson se lidhjet semantike dhe formale ndërmjet fjalisë kryesore ose drejtuese në një të anë dhe asaj të nënrenditur në anën tjetër kërkojnë një metodologji më “elastike”, por e vlerëson si mjaft të rëndësishëm faktin që të dy aspektet si ai kuptimor, ashtu edhe ai formal-gramatikor plotësojnë njëri-tjetrin. Bazuar në këto kritere ai dallon si lloje fjalish të nënrenditura të grupuara në një grup të veçantë ato që zëvendësojnë gjymtyrët e fjalisë (duke zbatuar kështu kriterin e paralelizmit me gjymtyrët e fjalisë), pra fjali kryefjalore, kundrinore dhe cilësore. Këto të fundit ai i barazon me fjalitë përcaktore që bashkohen me përemër lidhor: “*Ujin që rrjedh, s’e pi lopa*” (Martin Camaj: “Albanian grammar: with exercises chrestomathy and glossaries”, Wiesbaden, 1984, f. 248) ose një shembull tjetër ku, sipas tij, fjalia është e shprehur me formë të pashtjelluar foljore: “*Grueja i la një vajzë me ia pasë lakmi gjithkushi.*” (po aty, f. 248) Këtij grupi i shtohet edhe një grup tjetër i fjalive të nënrenditura, pikërisht ai i fjalive ndajfoljore, të cilat i shtohen foljes së fjalisë kryesore. Në këtë grup ai numëron periudhat: kohore, shkakore, mënyrore, kushtore, lejore, qëllimore dhe krahasore. Për secilën prej tyre jep lidhëzat kryesore me të cilat bashkohen fjalitë brenda periudhës më nënrenditje, duke sjellë shembuj (si nga gjuha e folur, ashtu edhe nga ajo e shkruar në këngë popullore, proverba, këngë arbëreshe apo nga autorë si Migjeni, Mjeda, Noli, Poradeci, Naim Frashëri, Fishta) edhe për rastet kur fjalia e nënrenditur shprehet me formë të pashtjelluar foljore. Për periudhat ndajfoljore, siç i emërtoi ai rrethanoret, krahas me dhënien e mjeteve lidhëse me të cilat fjalitë e nënrenditura bashkohen brenda tyre me drejtueset, qofshin këto kryesore ose jo, jep edhe bashkëlidhjen kohore e mënyrore të foljeve kallëzues të të dyja fjalive që janë pjesë e periudhës në fjalë. Pak më të zgjeruar se llojet e tjera të periudhave me nënrenditje gjejmë të trajtuar në gramatikën e tij periudhën me nënrenditje kushtore. Në fillim të trajtimit të periudhës me fjali të nënrenditur kushtore Camaj na bën me dije që, sipas tij, kushtëzimi në gjuhën shqipe mund të shprehet dhe shpjegohet në mënyrë të plotë vetëm në nivel sintaksor (f. 245). Formalisht

dhe funksionalisht, në faqen 251 të tekstit në fjalë, ai numëron dy lloj fjalish brenda periudhës kushtore: 1. fjalinë e nënrenditur në të cilën kushti është i shprehur, nëse ndodh ose jo një veprim dhe 2. fjalinë kryesore në të cilën rezultati përcaktohet nëse konkretizohet ose jo kushti. Protazat dhe apodozat e periudhës kushtore, terma këta që Camaj i zgjedh për të zëvendësuar përkatësisht termat: fjali e nënrenditur dhe fjali kryesore, i ndan në dy grupe kuptimore: Periudha kushtore reale, kushti i të cilave është i mundshëm dhe, për të konkretizuar këtë lloj të periudhës me fjali të nënrenditur kushtore reale, jep edhe shembuj nga Kanuni: “*Burri i vejë, po s`pat prind, ka tager me folë vetë për martesë të vet*” (f. 251)

Periudha kushtore joreale, kushti i të cilave, i shprehur në fjalinë e nënrenditur të tyre duket të jetë i pamundshëm sipas gjykimit ose mendimit të folësit. Për të konkretizuar këtë tip periudhe, ai jep shembullin: “*Po të kisha krahët e zogut, do të fluturoja.*” (f. 251). Ndër lidhëzat me të cilat fjalitë: kryesorja dhe e nënrenditura, bashkohen mes tyre në periudhën me nënrenditje kushtore numëron: *në, nëse për në, po qe se, në qoftë se (në qoftë që), sikur të, po të* (ose thjesht *të*, që vendos lidhje me foljen në mënyrën lidhore; për lidhëzën *nëse* thekson që përdoret në të nënrenditurat kushtore reale me mënyrën dëftore dhe për *po të* thekson që përdoret me mënyrën lidhore. Për të pakryerën dhe mëse të kryerën e mënyrës lidhore dhe të pakryerën e dëftores ai thotë se përdoren më shumë në të nënrenditurat kushtore (protazat) joreale, kurse, e tashmja dhe e pakryera e kushtores përdoren në fjalitë drejtuese ose në kryesoret (apodozat). Më poshtë ai jep edhe bashkëlidhjen kohore sipas llojeve të periudhave me nënrenditje dhe llojeve të lidhëzave me të cilat ato bashkohen mes tyre, duke theksuar gjithashtu edhe faktin tjetër që periudhat me nënrenditje kushtore mund të ndërtohen edhe me mënyrën kushtore. Trajtimin e këtij tipi periudhe e mbyll me numërimin e lidhëzave kushtore që përdorin arbëreshët për bashkimin e fjalive në periudhën kushtore në të folmen e tyre: *ndë*, të cilën e shoqëron me foljen në të pakryerën dhe mëse të kryerën e lidhores dhe lidhëzën *ndëç* të cilën e shoqëron me të pakryerën e dëftores: “*Ndë (të) vije ti, vija edhe u; ndë (të) kishe ardhur, kishe par tët vllá; ndëç isha trim i ri, dot hipia murgjarin.*” (f. 253).

Gjatë studimit të vëllimeve “Vepra letrare 1, 2, 3, 4, 5” të Martin Camajt ne vlerësuam mjeshtërinë e të shkruarit si nga ana gjuhësore, ashtu edhe nga ana letrare ku na tërhoqi si leksiku i pasur, ashtu edhe mënyra e ndërtimit dhe e renditjes së fjalive për të shprehur sa më bukur mendimet si në prozë, ashtu edhe në poezi mjaft të ndjera.

Përshkrimet mbresëlënëse që ai i bën natyrës në çdo stinë të saj me struktura sintaksore paralele, të ndërtuara nga gjymtyrë kryesore e të dyta të zgjeruara, e sjellin para syve tanë bukurinë e pamasë të natyrës së viseve shqiptare. Mënyra e ndërtimit të fjalive qofshin ato të thjeshta të tipave të ndryshëm, sipas llojit të kumtimit, qofshin të lidhura me njëra-tjetrën në periudha me nënrenditje me ose pa mjetin lidhës që i jep emrin e vet secilës prej tyre, e bindin lexuesin se, pavarësisht informacionit jo shumë të zgjeruar teorik që ai ka dhënë në gramatikën e tij, Martin Camaj e njihte mjaft mirë gramatikën praktike të gjuhës shqipe.

Përftesa stilistike të tilla si përdorimi i fjalive asindetike me mungesën e lidhëzave që i bashkojnë, alternimi i periudhave të shkurtra, me të cilat synon të nxitë vëmendjen dhe të përshpejtojë rrjedhën e ngjarjeve, me ato të gjata dhe të zgjeruara me një numër më të madh gjymtyrësh, me të cilat synon të ketë përqendrim më të madh të lexuesit duke e futur në brendësi të ngjarjes që përshkruan: «*Mbasi ulej në va me ta, Nika xhveshej, lente teshat në këtë anë të lumit ndërsa të huejve ua lidhte plaçkat e tyne për krye, po qe se ujnat ishin aq të thella sa mos me u përpyjekë kamba në fund dhe tue i mbajtë përdore në anën e epër të rrymës i shtynte me not përtej dhe shpejt e shpejt i kthente dalë, mbasi që kishin shndërrue, tue u kërshitë dhambët prej të ftohtit: udha e mbarë! të mirë u pafshim!*», e bëjnë stilin e tij të veçantë.

Disa ndërtime karakteristike për sintaksën e Camajt, janë: - përdorimi i lidhëzave polisemantike, megjithëse në gramatikën e tij nuk i përmend, ato ndeshen gjatë leximit të veprave të tij: p.sh.: *si* – e përdorur si lidhëz kushtore: “*Si të mos kisha këtë gaz të keq në fytyrë, ia prita, ndoshta do të kishte shkue mendja me përpyjekë shtatin me mue para se të lâ katundin.*” Vepra 1, f. 110; *Si të kisha pasë duert e tija të fuqishme, do t`ia kisha marrë frymën si lepurit të zanë në kurthë.*” Vepra 1, f. 106; *kur* – e

përdorur si lidhëz kushtore: “Kur një brezni a popull i tanë e humb drejtimi, s`ka zot që e ndih.” Vepra 3, f. 62; Gjejmë gjithashtu periudha me fjali të nënrenditura lejore të ndërtuara pa mjet lidhës, por me paskajoren geqe që, në këtë shembull është përdorur në funksion të mënyrës lidhore: “Një fis me u çue, s`ia ndërron mendën tim shoq, jo ma unë grueja e tij!” Vepra 5, f. 20. Në veprat e tij gjejmë edhe kundrinorë me parafjalë të ndërtuar me parafjalën në në vend të parafjalës te: “E para gjâ që më ra në sy në Shpresën qe se...” Vepra 1, f. 115, ose “Ndoshta në plakun, thom gjithmonë, fshehet vdekja”, po aty, f. 117. Zëvendësimi i gjymtyrës emërore të kallëzuesit emëror të shprehur me mbiemër, me një gjymtyrë emërore emër: “Si rrallë kush, Gazulli ishte vetëdijës (ishte i vetëdijshëm) se shqetësimin që e mundonte, e kishte pru në shpirt prej brigjeve detare kundruell.” Vepra 4, f. 267; ashtu si edhe ndërtimi i kallëzuesit të përbërë me folje gjysmëndihmëse që përdoret më tepër në gjuhën e folur për të treguar fillimin e veprimit dhe folje në paskajoren geqe, në funksionin e lidhore: “M`u avit , më mori librin që isha tue e lexue dhe nisi me i sjellë faqet në mënyrë nënvleftësuese...” M. Camaj, Vepra 1, f. 69, në vend të ndërtimit të kallëzuesit të përbërë me folje gjysmë ndihmëse që tregon fillimin e veprimit dhe folje në mënyrën lidhore (nisi/filloi t`i shfletojë faqet) duket se janë veçori të sintaksës së Camajt.

Anasjella përdoret shpesh për shprehësi stilistike: të mbramen herë, Vepra 1, f. 56 ; “Gjerza e vetmja njollë/ në qiellin e ndritun të Jugut” Vepra 2, f. 141; “Dhe na sillemi me njimij rruzullime/ në parzëm rreth sáj e ndezemi e digjemi/ e me flakën tonë ushqehet koha...” Vepra 2, f. 71; Dalja e rrethanorit të vendit para kallëzuesit duke u ndërruar kështu vendin gjymtyrëve në rendin asnjanes karakteristik për gjuhën shqipe: “Natën veshtuen zogjtë në terr si bymohet shtalpi i gjumit nën dhé.”, Vepra letrare 2, f. 255; “Poshtë fijet e telefonit masin gjatsinë e rrugave...” Vepra 2, f. 63; apo ndërtimi i rrethanorit të shkakut me emër në rrjedhore pa parafjalë: “kam pi ujë prej kovës në duert e saja si kafshë e djegun etje” Vepra 1, f.108; jam një jush Vepra 4, f. 99; “...i ditun apo i paditun, i pasun ose i vorfën, qekej një sish, njëlloj si ata, arbëresh.” Vepra 4, f. 101; me një të sjellun kreje – “me një të kthyer të kokës” Vepra 4, f. 113; ... “për t`u

çlirue çdo dileme”, po aty f. 114 u shtohen veçorive stilistike të gjuhës së Camajt. Në disa shembuj, në përbërje të një paskajoreje që ndërton një fjali të nënrenditur qëllimore, gjejmë të përdorur një emër, në vend të një foljeje në pjesore: “*Për ta mbresë mirë në tru, iu avit afër, i shpërvoli velin e hollë.*” Vepra 4, f. 115; Jo i rrallë është edhe përdorimi i veprores për joveproren dhe anasjelltas: “*Me mendim të kthejë edhe një herë para se me ardhë Ntonia, mbylli dritare e dyer...*”, po aty, po atje; “*Nuk ia mori mendja se ajo kishte kthye aq herët.*” Po aty, f. 116; Herë të tjera pjesoren e foljes ndihmëse jam, formën *me qenë*, e gjejmë të përdorur si lidhore, formë foljore me të cilën në veprat e veta mund të fillojë një fjali e nënrenditur kushtore ose mënyrore: “*Shtatuja, e ndritun prej llampës...dukej as me qenë grue katundëse e lëngueshme që çohet në spital*” Vepra 4, f. 117; (sikur të ishte) “*Me qenë unë si zotnia jote, nuk kisha me hapë asnjë libër e me lexue në dritën e zbehtë të pishtarit...*” Vepra 4, f. 274 (po këtu vëmë re edhe të tashmen e kushtores të ndërtuar me të pakryerën e foljes ndihmëse kam+paskajoren geqe të foljes *hap*); Fillimi i fjalive me emra prejfoljorë me parafjalë: “*Me shtimin e vapës, kah mbarimi i majit e fillimi i qershorit, zunë të vijnë në katund...*” Vepra 4, f. 126; “*Mbas zgjimit të asaj pranvere erdha në përfundimin se unë si njeri...*” Vepra 1, f. 79; “*Mbas kthimit të qetësisë,... edhe mizën tue fluturue e kishe ndëgjue.*” Vepra 4, f. 134. Në veprat e tij gjejmë gjithashtu rrethanorin e mënyrës të shprehur me ndajfolje në rastet kur folja kallëzues kërkon emrin me parafjalë: “*Por nëse vëren vëmendshëm, (me vëmendje) këto poza i gjen edhe në popullatën e katundit...*” Vepra 4, f.129

Krijimtaria e Martin Camajt, kaq e pasur sa paraqitet, kërkon një vëmendje më të madhe, qoftë për atë çka sjell te lexuesi nga ana letraro-artistike, qoftë edhe për pasurinë gjuhësore që përfaqëson nëpërmjet ndërthurjes së ndërtimeve sintaksore të gjuhës letrare me format dialektore sinonimike me to. Në këtë mënyrë ato ndikojnë pozitivisht në ndjeshmërinë e lexuesit, në përfytyrimin dhe shijet e tij duke i shtuar vlerat stilistike dhe shprehëse veprave të tilla letrare dhe duke i bërë ato të shërbejnë në të njëjtën kohë edhe si krijime gjuhësore.

Le të mendojmë për një çast për rastësinë e këndshme që, në një datë (7 Mars 1992) që ne nderojmë me respekt e mirënjohje mësuesit tanë, ndër më të mirët prej të cilëve renditet edhe Camaj, ne ndiejmë përmes fjalëve të fundit të tij kënaqësinë që ai provon duke mësuar se, pas një gjysmë shekulli të ndarë, mund ta pohojë me gojën plot si burri, hyrjen në rreshtin tonë që e afron më në fund me familjen e tij të madhe shqiptare.

Tingëllon me plot kuptim në rastin e Martin Camajt thënia “Një trëndafil i vetëm që ia dhuron një njeriu sa është gjallë, është më i dobishëm se një tufë me trëndafila mbi varrin e tij”, por le të shërbejnë kumtesat e referimet tona në aktivitete të tilla për të përkujtuar ata që nuk ditëm t’i duam e t’i vlerësojmë sa ishin gjallë dhe për t’i “shkëputur” jetës si i vetmi libër, fletët e të cilit nuk mund t’i kthesh mbrapa, faqet e shkruara për të cilat kemi nevojë.

BIBLIOGRAFI:

1. Ardian Klosi, “Martin Camaj përherë me ne”, gazeta “Shekulli”, 21.07.2010, f.18-19.
2. Behar Gjoka, “Camaj i pahumbun ose Atlantida e rigjetun”, Gazeta “Standard”, rubrika “Logos & Art”, e mërkurë, 19.08. 2009, f. 14
3. Camaj, Martin: Albanian grammar: with exercises chrestomathy and glossaries, Wiesbaden, 1984, 337 p.
4. Camaj, M.,Vepra letrare 1, Tiranë 1996 lënda: “Djella”, “Shejzat”, Poezi (Mynih 1981) “Djella” versioni i dytë i romanit, Prishtinë, 1994, “Legjenda” “Shejzat” Romë,1964.
Vepra letrare 2, Tiranë,1996 lënda:
“Poezi 1953-1967” Mynih, 1981,
“Njeriu më vete e me të tjerë” Mynih, 1978 ,
dorëshkrime. “Lirika mes dy moteve”, “Vargje të shpërndame”,
“Njeriu më vete e me të tjerë”
Vepra letrare 3, Tiranë, 1996 lënda:

- “Dranja” Mynih, 1981, “Selected Poetry” Nju Jork-Londër, 1990,
 “Palimpsest” Nju Jork-Mynih, 1991
 Vepra letrare 4, Tiranë, 1996 lënda:
 “Shkundullima” Mynih, 1981 “Pishtarët e natës” – “Shkundullima”,
 “Rrunggaja në mars”, “Katundi me gjuhë të fshehtë”, “Gjon Gazulli”.
 Vepra letrare 5, Tiranë, 1996 lënda:
 “Shkundullima” Mynih, 1981, “Kandili argjandit”, “Radhonjtë e
 zjarrit”, Kozencë, 1993, “Loja e mbasdrekës”, “Kandili argjandit”.
5. GRAMATIKA e gjuhës shqipe II, Sintaksa, ASHRSH IGJL, Tiranë, 1997.
 6. “Martin Camaj ky korife i mendimit dhe letrave shqipe”, gazeta “Koha jonë”, rubrika “Koha Letërsi dhe Art”, e hënë 27 korrik 2009, f.19.
 7. Yrjet Berisha, “Proza e Martin Camajt, ndikim në studimin ndryshe të letërsisë shqipe”, Gazeta “Tema”, rubrika “Kultura”, e shtunë 5 shtator 2009, f.14.
 8. Yrjet Berisha, “Pse novelat e bouara të Martin Camajt nuk janë marrë në shqyrtim”, gazeta “Tema”, rubrika “Kultura”, e diel 6 shtator 2009, f. 12.
- Artikuj të konsultuar nga interneti:*
9. Behar Gjoka, “Martin Camaj i ndëshkuar gjuhësisht” .
 10. Oliverta Lila, “Camaj, i paragjykuar prej gegërishtes”.
 11. “Camaj në Mynih pret shqiptarët ta pronësojnë”.
 12. Xhevat Lloshi “Njohuri për stilistikën e gjuhës shqipe”, Tiranë, 1987.

Martin Camaj syntax as wealth of Albanian language

*A winter in your own country is more sweet than 100 springs
 in a foreign land »*

Perhaps it is this tenderness, needed by Martin Camaj, who’s only friend in a foreign land was the knowledge,

a companion in solitude and support when he was "far from those who spoke like him" and when "his heart felt that would not be a bird that beat their wings just a summer!"

Reading his masterpieces reveals the hidden thoughts in spirit and precisely because of them and through them he made himself well-known, commemorated for several years on his birth anniversaries.

It is precisely his love for the Albanian language, that even when he went to Munich to write again, he wrote for the Albanian language and precisely about for the word formation of its old names. He was not a real linguist, but he worked and wrote for the Albanian language a lot more than one of them.

This was done quite naturally, not only by writing poems, novels, his prose with a linguistic virtuosity to be enviable, but also by writing the textbook for learning Albanian language by the foreigners, while summarizing his linguistic studies, the Albanian language grammar that even today, serves as a linguistic wealth of Albanian language for the way how it is developed and everything treated in it. Martin Camaj: Albanian grammar: with exercises chrestomathy and glossaries, Wiesbaden, 1984.

Although syntax in the grammar book is covered only in 23 pages, Camaj has managed to include key concepts for sentence definition: "The smallest unit relatively independent by which thoughts are expressed", for the predicate verb as sentence core; for the complete sentence, for parts of speech, primary or secondary, in composition or not of nominal and verbal groups, respectively, through examples displays their usage and finds: "matching the predicate verb in number and person with the subject; matching the verbal adjectives in gender, number and case with subject; matching the verbal nouns with the subject in case and number (pg. 237) and further division of secondary parts of speech.

The division into coordinate and subordinate, though not done according to any particular criteria, is followed by their further division into types of coordinated sentences in *sindetiks* and non *sindetiks* and later in the types of coordinative sentences (mainly being based

on semantic criteria of conjunctions which join them) This division matches the one done for this type of clauses in the Albanian language grammar II, Syntax, Tirana 1997, p. 464 onwards.

In the division of subordinate sentences, Camaj highlights that semantic and formal division between the main sentence in one side and the subordinated on the other require a more “flexible” methodology, but considers as very important the fact that both aspects the semantic and the formal- grammatical one complement each other.

Based on this criteria he distinguishes as types of subordinate sentences grouped in one special group, those which replace the parts of speech (applying this way the criteria of parallelism with the parts of speech) so subject, object and qualitative sentence.

He equalizes the later ones with relative sentences connected with a relative pronoun “*Ujin që rrjedh, s`e pi lopa*” (Martin Camaj: “Albanian grammar: with exercises chrestomathy and glossaries”, Wiesbaden, 1984, f. 248) or another example where according to him, the sentence is expressed with a participle form of the verb: “*Grueja i la nji vajzë me ia pasë lakmí gjithkushi.*” (pg.248). to this group is added another group of subordinate sentences, namely that of adverbial sentences, which are added to the principal clause. In this group he counts clauses of time, cause, manner, condition, concessive, comparative and of purpose.

Adverbial clause as he named adverbials , together with provision of conjunctions which join subordinate sentences with principal one, whether main or not, gives the manner and time relation of the verbs which are part of that clause. Slightly expanded to other types of subordinate clauses, the conditional clause is dealt with in his grammar.

Let us think for a moment, for a pleasant coincidence that, on a date (7 March 1992) that we honor with respect and gratitude our teachers, we rank Camaj as one of the best of them, we feel through his last words, the pleasure he experiences learning that, after half a century apart, could claim in loud voice, his entrance into our line that finally brings him to his big Albanian family.

Sounds meaningful in the case of Martin Camaj the saying "A single rose given to someone alive, is more useful than a bouquet of roses on his grave", but let's serve our papers in such activities to commemorate those whom we did not know how to love and appreciate while alive and to "detach" written pages which we really need from the only book of life, pages which can never be rewritten.....

Irida HOTI (Shkodër)

MARTIN CAMAJ NË TEKSTET SHKOLLORE

Figura e Martin Camajt si studiues dhe shkrimtar zë një vend të shquar në kulturën kombëtare shqiptare. “Mungesa për afro gjysmë shekulli në programet mësimore të Camaj, Fishta, Koliqi etj., ka krijuar një boshllëk të madh në letërsinë shqiptare. Pavarësisht se këta shkrimtarë sot janë të pranishëm në lëndën e letërsisë, paraqitet tepër e vështirë hyrja në kodin artistik të veprave të tyre.”²⁷¹

Në këtë kumtesë, do të pasqyrohet një panoramë e përgjithshme e fragmenteve të shkëputura nga krijimtaria e Camajt në tekstet shkollore në këndvështrim gjuhësor, kryesisht leksikor.

1. Camaj në tekstet e shkollës 9-vjeçare

Në tekstet e shkollës 9-vjeçare²⁷², nga krijimtaria e Camajt përfshihen: “Tingujt e parë” (kl.VII), “Vendit tem” (kl.VII), “Mbramja ashtë larg” (kl.VIII), “Mos pështyj në zjarr” (kl.VIII), “Jesmine” (kl.IX), “Kthimi i vjeshtës” (kl.IX).

Përgjithësisht në këtë cikël nuk ka një trajtim të veçantë të leksikut të tij, ndërkohë që nxënësi, më parë duhet ta njohë atë si “Një poet, që ka qenë i dashuruar me gjuhën shqipe dhe i shfrytëzoi në maksimum mundësitë e saj shprehëse.”²⁷³ Nëse hedhim një vështrim në leksikun e këtyre fragmenteve

²⁷¹ Ymer Çiraku, *Bota poetike e Martin Camajt*, lexim plus, Botimet Albas, Tiranë, 2003, f.3.

²⁷² Krijimtaria nga Martin Camaj në ciklin 9-vjeçar përfshihet në klasën VII, VIII, IX.

²⁷³ S. Hamiti, A. Marashi, Xh. Lloshi, Sh. Sinani, A. Aliu, *Letërsia dhe gjuha shqipe 4*, Borime shkollore Albas, f.278.

*do vërejmë se shpjegohen 9 fjalë në 6 poezi, ndërsa kemi një leksik të gjerë,
i*

cili mund të ishte shpjeguar²⁷⁴:

²⁷⁴ Leksiku i pashpjeguar, paraqitet në fund të kësaj kumtese në një apendix, me fragmentin dhe tekstin nga është shkëputur.

<p><i>Leksiku i shpjeguar</i></p>	<p><i>i</i></p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ <i>Ortek, mote, currila, lugje. (Tingujt e parë, VII, f.117.)</i> ➤ <i>I ndërkryem, veja, bokë, gjollat, cof, kisha lënue. (Jesminë, kl.IX)</i>
<p>Leksiku i pashpjeguar</p>	<ul style="list-style-type: none"> ➤ <i>Çurruk, pipëz, shullaje. (Tingujt e parë, VII, f.117.)</i> ➤ <i>Gjuajt, tram, mandej. (Mbramja ashtë larg, VIII, f.66.) birnore, gjindje, kryekreje, mundimçar, palatume, posepo, sall, sendegja, storina, shoq. (Mos pështyj në zjarr, VIII, f.26)</i> ➤ <i>Balonat e larme, flakë e vojturtë, korrilat e qiellës, ret e bilurta, rrasë. (Kthimi i vjeshtës, IX, f. 129)</i> ➤ <i>Dijekeq, dliрте, gjallnesë, hap llapën, kah, i pasherr, pos, unshëm, zu.....të më tregojë. (Jesminë, kl.IX, f. 79.)</i>

Rezulton se në klasën VII kemi 10% të fjalëve të shpjguara, në klasën VIII nuk ka shpjegim të leksikut, ndërsa në të IX rreth 20% e fjalëve të shpjguara.

Krahas shpjegimit të cekët leksikor të poezive të Camajt në tekstet e gjuhës shqipe:

Përveç pyetjeve të përmbajtjes së poezisë nuk ka rubrika me pyetje gjuhësore si: “Gjuha”, “Gjuha dhe stili”, “Studiojmë gjuhën e tekstit”, si tek autorët e tjerë: Kadare, Fishta, Agolli, Xoxa etj., ku mund të evidentoheshin:

- Fjalë dialektore me gjegjësen e tyre në gjuhën standard si: (**duer, tue, kah, mandej, mbas, gjindja, të qindroj**, etj.).
 - Përdorimi i dendur i përcjellores geqe në vargjet e Camajt si: tue bajtun, tue kalu, tue hy (Tingujt e parë) etj.
 - Përdorimi i përemrave në forma të ndryshme si: **eme** (fryma eme), por malet e **mia**, njerëzit e **mi**, vendet e **mia**, këmbët e **mija**; **tim** - vendit tem, **Tyre** - fletet e tyne etj.
- Nuk ka asnjë pyetje për stilin e Camajt.

Mendojmë se në këtë cikël nxënësi duhet të njihet me më tepër veçori gjuhësore dhe leksikore, për ta pasur më të perceptueshme mesazhin e fragmenteve të përçuara nga Camajt, sepse duke e njohur dhe kuptuar mirë këtë krijimtari në ciklin 9 – vjeçar, atëherë do të jetë në gjendje ta analizojë, sintetizojë dhe të vlerësojë stilin e tij në shkollën e mesme.

Natyrshëm lind pyetja: A përbën pengesë për të komunikuar me lexuesin – nxënës, fakti që Martin Camaj ka shkruar në gegërisht?

“Shkrimi i variantit letrar të gegënishtes prej Camajt, në atë qasje dhe model shkrimor, vërteton se ky dialekt vijon mbijetesën e vet edhe në kushtet më të vështira, në kushtet e ndalimit zyrtar”²⁷⁵, por për nxënësin i cili lexon, flet, analizon në standard, gjuha e Camajt paraqet vështirësi dhe

²⁷⁵ Behar Gjoka, *Martin Camaj i ndëshkuar gjuhësisht*, Gazeta “Tema”, E diel, 6 qershor 2010.

kjo si rrjedhojë më tepër e mangësisë së autorëve të teksteve, të cilët duhet të pasqyrojnë vlerat që mbart vargu dhe pesha e fjalës së Camajt.

2. Camaj në tekstet e shkollës së mesme

Në tekstet e shkollës së mesme Camaj shihet në këndvështrime të ndryshme në botime të ndryshme. “Pavarësisht se jetoi larg lexuesit të tij natyral, letërsia e Camajt vazhdon të mbetet një kuriozitet i madh për brezat e sotëm, si një kështjellë e paeksplorueshme e modernitetit shqiptar.”²⁷⁶

Në vitin 1998 në vëllimin “Maja e çelur”²⁷⁷ dhe në atë të vitit 2002 “Letërsi bashkëkohore shqiptare”, ka më shumë fragmente, (ndonëse pa analiza gjuhësore, e në veçanti leksikore,) se sa ç’ndodhen në tekstet aktuale (2007-2010).

Konkretisht në tekstin “Maja e çelur” paraqiten 8 poezi: “Nji vjetë”, “Vendit tem”, “Marsi në gjinin e S. Eufemies”, “Mburrje”, “Pranvera”, “Nji mall më këput, bre vëlla”, “Trashëgimi”, “Elegji e parë” dhe një fragment shkëputur nga romani “Rrathë”.

Në këtë tekst M. Camaj krahas si shkrimtar pasqyrohet edhe si mësues i gjuhës shqipe, profesor në katedrën e gjuhës shqipe dhe studiues në fushën e gramatikës dhe të dialektologjisë së gjuhës shqipe.

Në rubrikën “Analizë dhe detyra” përgjithësisht ka analiza të shkurtra dhe pyetje mbi përmbajtjen e poezisë, por asnjë pyetje mbi leksikun apo shpjegim të tij, ndërsa në fragmentin shkëputur nga romani “Rrathë” shpjegohen 13 fjalë: pohenike e mohenike, i ndërsyeshëm, pajambajtja, fantastë, me rrebe, zeje, aversion, konsideracion, por lihen pa shpjeguar: gjithnduersh, e pavend, përlij, përbamësve, s’u dihet kurrë të ramit, me bart ujë me shoshë, përndal, heshtonte, kundërparimor, nergut, kinse, tekembramja, gjysmëterr, bashkëfjalim etj. Megjithatë, sot nxënësi nuk ka nevojë për një shpjegim leksikor të tillë me botimin e vitit 2001 të

²⁷⁶ Aliu, A.; Sinani, Sh.; Çapaliku, S.; Çobani, T., *Letërsia Bashkëkohore Shqiptare*, Shtëpia Botuese Albas, Tiranë, 2002, f. 97.

²⁷⁷ Gjergj Zheji Natasha Xhafka, *Maja e Çelur*, Antologji e letërsisë Bashkëkohore Shqiptare, Për shkollat e mesme, III-IV, SHBLU, Tiranë, 1998, f. 157 – 168.

romanit “Rrathë”²⁷⁸, ku përfshihet një Fjalorth në fund të veprës, me rreth 300 fjalë të rralla, që shërbejnë për të kuptuar më mirë veprën.

Në botimin e vitit 2002, duke u përcaktuar si “Shkrimtari i dashuruar me gjuhën shqipe’ krahas, shpjegimit të veprave dhe të poezive ai pasqyrohet edhe si një ndër albanologët më të shquar kryesisht me punimet e tij mbi gjuhën shqipe, historinë dhe të sotmen e saj.

Këtu analizohen: vëllimi “Njeriu me vete e të tjerë”, romani “Rrathë”, “Dranja” si dhe fragmente të zgjedhura “Elegji e parë”, “Moshë e të qenit” apo ditëlindja, “Mbramja ashtë larg”, ndërsa jepen pa analiza, komente e pyetje rreth 10 poezi: “Lule”, “Drekë malsore”, “Fill i gjetun”, “Aty si tash para se me ardhë fiset”, “Gjarpni e grueja”, “Motiv arbëresh”, “Retë e oqeanit”, “Fuqia e konës”, Motiv i vjetër në kthim”, “Hoqa fletën e librit të parë”, dhe dy fragmente nga romani “Rrathë” dhe “Dranja”.

Në tekstet aktuale përfshihen poezitë “Korbi”, “Një ditë e ka dhe korbi” (Klasa X);

Në poezinë “Korbi”²⁷⁹ shpjegohen fjalët: kres do arave, e n’trup të vdekunit u shujtue, n’shkullojë,, n’mullzë, iu ern, me fletë të zgjatuna sa dy qetha, por nuk shpjegohen: padesh, curr, zgur, dishka, pendla, ndoj, mbrame, asi, porse etj.

Në klasën XII²⁸⁰ analizohet poetika e Camajt, proza në përgjithësi dhe madrigali “Dranja” në veçanti, si dhe poezia “Qyteti i lodrave” për komentim, ndërsa “Dita e gjyqit” dhe “Vargu im nuk ishte” vetëm për lexim.

Një ndër poezitë që ka paraqitur më shumë vështirësi në kuptueshmëri është “Qyteti i lodrave”²⁸¹, ndoshta sepse “Karakteristikë e

²⁷⁸ Botim i shtëpisë botuese “Camaj – Pipa”, Shkodër, 2001.

²⁷⁹ **Petro, Gjokutaj, Pepivani, Marashi, Rrokaj, Çerpja**, *Letërsia dhe gjuha shqipe 10*, Botime shkollore Albas, Tiranë, 2004, f. 127 – 129.; **Petro, Mëniku, Marashi, Shehri**, *Gjuha shqipe dhe letërsia 10*, Botime shkollore Albas, Tiranë, 2009, f. 308-309.

²⁸⁰ Hamiti, A. Marashi, Xh. Lloshi, sh. Sinnani, A. Aliu, *Letërsia dhe gjuha shqipe 4*, Borime shkollore Albas, f. 285.

²⁸¹ Hamiti, A. Marashi, Xh. Lloshi, sh. Sinnani, A. Aliu, *Letërsia dhe gjuha shqipe 4*, Borime shkollore Albas, f. 285.

poezisë së Camajt është thellësia dhe shumështrësi i kuptimit të saj”²⁸².

*Duhet thënë se “Receptimi i veprës së tij nuk është i lehtë. Është i nevojshëm një formim i gjerë etnofolklorik për të kuptuar dhe interpretuar elementet burimore dhe botën shumë të pasur poetikën e Camajt, që karakterizohet nga një strukturë shprehëse bashkëkohore origjinale.”*²⁸³

Në këto tekste hasen pyetje të tilla si:

- *Vini re sa e pastër është gjuha e Camajt, megjithëse ai jetoi larg lexuesit shqiptar.*
- *Nxirrni fjalë nga poezia, të cilat ju mendojnë se janë pasuri leksikore e gjuhës letrare shqipe.*
- *Parafrazojeni poezinë “Korbi” në gjuhën letrare.*

Mendojmë se duhej të theksohej:

- *Përdorimi i fjalëve të krijuara nga ai ose me origjinë popullore, si: heshtoj, qëllim, gjegjësisht, komtarisht, mbresje, i ngjyrshëm etj.*
- *Fjalë të vjetra e krahinore, si: gjalloj, plang, vrumulis, terratis, periqan, mujsha etj.*

Ndonëse Camaj e shikonte pasurinë leksikore të shqipes në drejtime të ndryshme, duke u përpjekur të dëshmonte shkencërisht lidhjet e qëndrueshme historikisht midis formave gjuhësore të vjetra dhe të reja.²⁸⁴ fragmentet e Martin Camaj në tekstet shkollorë janë më pak të interpretuara, të komentuar dhe të analizuar nga ana leksikore.

E gjithë vepra e tij është një bashkësi ndikimesh sa nga burimi popullor, nga krijimtaria e autorëve vendas më në zë si: De Rada,

²⁸² Koçi Petriti, “Mbi poetikën e Martin Camajt”, në *Studime për autorë të ndaluar*, Qendra e Studimeve Albanologjike, Tiranë, 2008, f.261.

²⁸³ Anton Berisha, *Botë burimore dhe botë e pasur artistike*, Simpoziumi “Martin Camaj, Tradita dhe bashkëkohësia”, Shkodër, 1994, f.35.

²⁸⁴ Petrit Kotri, “Probleme të gjuhësisë krahasuese në veprën shkencore të Martin Camajt”, në Seminari Ndërkombëtar “Shkodra në shekuj”, Shkodër, 2004, f.89.

*Serembe, Konica, Fishta, por aq ka edhe përthithje nga poetë të përmasave botërore.*²⁸⁵

<p>Leksiku i shpjeguar</p>	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Pohenike e mohenike, i ndërsyeshëm, pajambajtja, fantastë, me rrebe, zeje, aversion, konsideracion. (“Rrathë”, Maja e çelur, f.163.) ➤ <i>Kres do arave, e n’trup të vdekunit u shujtue, n’shkullojë, n’mullzë, iu errn, me fletë të zgjatuna sa dy qetha.</i> (“Korbi” Letërsi 10, 2009, f.308.)
<p>Leksiku i pashpjeguar</p>	<ul style="list-style-type: none"> ➤ <i>Gjithnduersh, e pavend, përlij, për bamësve, s’u dihet kurrë të ramit, me bart ujë me shoshë, për ndal, heshtonte, kundërparimor, nergut, kinse, tekembramja, gjysmëterr, bashkëfjalim etj.</i> (Rrathë, “Maja e çelur, f.162.) ➤ <i>Paresh, curr, zgur, dishka, pendla, ndoj, mbrame, asi, porse.</i> (“Korbi” Letërsi 10, 2009, f.308.) ➤ <i>Currat</i> (“Dita e gjyqit”, Letërsi dhe gjuha shqipe 4, f. 286.) ➤ <i>Triskull</i> (“Vargu im nuk ishte” Letërsi dhe gjuha shqipe 4, f. 286.)

²⁸⁵ *Miaser Dibra, “Përftesa poetike burimore në poezinë e Martin Camajt”, në Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare, 24/2, Prishtinë, 2004, f.174*

Në përfundim e gjithë kjo gamë gjuhësore, letrare, poetike, hermetike, përftuar nga pena e Martin Camajt mund të identifikohet me mendimin e prof. K. Topallit, i cili e krahason atë me Çabejn për nga njohja e thelluar e shqipes dhe me punën e tij prej gjuhëtari.²⁸⁶

Vepra e tij cilësohet si një univers i përbotshëm, tejet i pangjashëm me të tjerët, d.m.th. original, që do të vazhdojë të tërheqë me magjinë e vet lexues e studiues të shumtë.²⁸⁷

APENDIX

Leksiku i pashpjeguar në tekstet e gjuhës shqipe (Cikli 9-vjeçar)

Fjala	Fragmenti dhe teksti nga është shkëputur
Bilurtë (i,e)	(Këtë verë shfletova ret e bilurta e fletet e tynë m'ushprishën ndër duer.) <i>Martin Camaj "Kthimi i vjeshtës" Mimoza Gjokutaj 9, f.129.</i>
birnore	(Butësia birnore e mirënjohja më shtynë ma vonë, mbasi që ranë në fashë mallëngjimet e përflakta, të shkruiej:...) <i>Martin Camaj "Mos pështyj në zjarr", Bahri Beci, f.26.</i>

²⁸⁶ Kolec Topalli, *Vepra e Martin Camajt në aspektin gjuhësor*, Simpoziumi "Martin Camaj, Tradita dhe bashkëkohësia", Shkodër, 1994.

²⁸⁷ Ymer Çiraku, *Bota poetike e Martin Camajt*, Albas, Tiranë, 2003, f.7.

çurrk	(Tue hy në t'shtatën vjet, ujkun e pava n'ikje me bisht ndër kambë e meveshë të çuem çurrk përpjetë.) <i>Martin Camaj "Tingujt e parë" Mimoza Gjokutaj 7. F.117.</i>)
gjindjes	(Ti edhe pak e ke me ua dhanë dorën gjindjes ndejun, si në Evropë <i>Martin Camaj "Mos pështyj në zjarr", Bahri Beci 8. F.26.</i>)
gjithnduersh	(Rrethue me shkresa e fletore gjithnduersh , s'di të ketë ma zemër t'i thotë troç.) <i>"Maja e çelur", f. 163.</i>
gjysmëterr	(Kur shoh si ju i rreshtoni idetë ndërtuese, ndijat e ndjesitë e mia ëndërrojnë në gjysmëterr .) <i>"Maja e çelur", f. 166.</i>
kajherë	(Kajherë e vë dorën në tamth e pyes:...) <i>Martin Camaj "Mos pështyj në zjarr", Bahri Beci 8, f. 26.</i>
korrilë	(Korrilat e qiellës janë nisë për Jug, kambët e mija s'i ndjej nëpër dhe.) <i>Martin Camaj "Kthimi i vjeshtës" Mimoza Gjokutaj 9, f.129.</i>

kryekreje	(Unë për atë isha vetëm i biri i tim eti, i cili duhej rritë e ba i zoti i vetes, posepo, por kryekreje ²⁸⁸ për të mbajt Plakun.) <i>Martin Camaj “Mos pështyj në zjarr”, Bahri Beci 8, f.26.</i>
kundërparimor	(... .. i erdhi me dyshue se recension i paska qenë kundërparimor .) <i>“Maja e çelur”, f. 165.</i>
larme (i,e)	(Ngritën prej kodrave balonat e larme , zotat ulën në lumej.) <i>Martin Camaj “Kthimi i vjeshtës” Mimoza Gjokutaj 9, f.129.</i>
mundimçar	(Shpesh më binte në sy si ajo e ruente kafshatën ma të mirë për mundimçarin e shpisë.) <i>Martin Camaj “Mos pështyj në zjarr”, Bahri Beci 8, f.26.</i>
nergut	(..por Agoni këto fjalë i morri si të shpikuna nergut për rastin e tij). <i>“Maja e çelur”, f. 165.</i>
	(Përgdheljet e mia ishin të vona, të palandë ,

²⁸⁸ Ndajfolje me gurrë popullore geqe, e cila ka depërtuar e po bën udhë mjaft dukshëm në shqipen standarde. Të së njëjtës gurrë janë edhe kryengulthi, kryepingulthi, kryeposhtë që i përdor Kadareja. (Teufik Çausi, Gjovalin Shkurtaj, *Kadare dhe fjala shqipe*. Albas, 2004, f. 39.)

palandë	rnendim që s’gjen kurrkun fjalë.) <i>Martin Camaj “Mos pështyj në zjarr“, Bahri Beci 8, f.26.)</i>
palatueme	(M’u duk se hyna në shpirtin e tij e gjeta pjesën e palatueme , t’ashpër e të shëmtueme të vetes.) <i>Martin Camaj “Mos pështyj në zjarr“, Bahri Beci 8, f.26.)</i>
përbamësve	(... në qarqet e rrathët e shoqnisë sonë, tue përligjë gjithnji luftën e përbamësve përparimtarë.) <i>“Maja e çelur”, f. 163.</i>
përndal	(Edhe një tjetër arsyetim e përndali Agonin të heshtonte.) <i>“Maja e çelur”, f. 165.</i>
pipëz	(E zani monoton i pipëzës fëminore, me mote në mue janë rritë.) <i>Martin Camaj “Tingujt e parë” Mimoza Gjokutaj 7, f.117.)</i>
posepo	(Unë për atë isha vetëm i biri i tim eti, i cili duhej rritë e ba i zoti i vetes, posepo , por kryekreje për të mbajt Plakun.) <i>Martin Camaj “Mos pështyj në zjarr“, Bahri Beci 8, f.26.</i>

sall	(Sa për kaq, bane se nuk dij send në këtë punë, sall fjalët e mia mos i ban n'asgja.) <i>Martin Camaj "Mos pështyj në zjarr", Bahri Beci 8, f.26.</i>
sendegja	(M'u avit, më mori librin që isha tue e lexue dhe nisi me i sjellë faqet në mënyrë nënvleftësuese, si t'ishte libri im një sendegja si lodër.) <i>Martin Camaj "Mos pështyj në zjarr", Bahri Beci 8, f.26.</i>
storina	(Merret vesht: ke këndue plot libra e storina , por unë kam pa e ndie ma tepër se ti, a di sa? <i>Martin Camaj "Mos pështyj në zjarr", Bahri Beci 8, f.26.</i>
shkaftas	(... i hodhi shkaftas në rrugë një dangë tutkalli të freskët.) <i>"Maja e çelur", f. 168.</i>
shoq	(Dishroj me kuvende me ty si me një shoq , por ndoshta nuk kemi me mujtë asnjani.) <i>Martin Camaj "Mos pështyj në zjarr", Bahri Beci 8, f.26.</i>
shullaje	(lule gjakut në shullaje për të dalun kangë një ditë.) <i>Martin Camaj "Tingujt e parë" Mimoza Gjokutaj 7. F.117.)</i>

tekembramja	Tekembramja hapi gojën e tha... “ <i>Maja e çelur</i> ”, f. 166.
tram	(E ndër gjuajt e mi ndieva, peshën e tramit tue u ndalue me turr.) <i>Martin Camaj “Mbramja ashtë larg” Mimoza Gjokutaj 8, f.66.</i>
vojgurtë (i,e)	(Ti ende je e vetmja flakë e vojgurtë në rrasë që jeton me mue.) <i>Martin Camaj “Kthimi i vjeshtës” Mimoza Gjokutaj 9, f.129.</i>

BIBLIOGRAFI:

1. *Berisha, A., Botë burimore dhe botë e pasur artistike, në Simpoziumi “Martin Camaj, Tradita dhe bashkëkohësia”, Shkodër, 1994.*
2. *Çiraku, Y., Bota poetike e Martin Camajt, lexim plus, Botimet Albas, Tiranë, 2003.*
3. *Gjoka, B., Martin Camaj i ndëshkuar gjuhësisht, Gazeta “Tema”, E diel, 6 qershor 2010.*
4. *Peçi, A., Martin Camaj: I mohuar e i mënjeluar... njëlloj si në diktaturë, Proletari Forum, & Italia Forum, 21/07/2009.*
5. *Qendra e Studimeve Albanologjike, Insituti i Gjuhësisë dhe Letërsisë, Studime për autorë të ndaluar, Shtëpia Botuese “Fan Noli”, Tiranë, 2008.6.*
6. *Tufa, A., Shtegtimi i klisheve në tekstet shkollore, Gazeta Start, 03, 05, 2010.*

Tekste mësimore:

1. *Aliu, A.; Sinani, Sh.; Çapaliku, S.; Çobani, T.*, Letërsia Bashkëkohore Shqiptare, *Shtëpia Botuese Albas, Tiranë, 2002.*
2. *Petro, R.; Gjokutaj, M.; Pepivani, N.; Marashi, A.; Rrokaj, Sh.; Çerpja, A.*, Letërsia dhe gjuha shqipe 10. *Botimet shkollore Albas, Tiranë, 2004.*
4. *Hamiti, S.; Marashi, A.; Lloshi, Xh.; Sinani, Sh.; Aliu, A.*, Letërsia dhe gjuha shqipe 4, *Botime shkollore Albas, Tiranë, 2007.*
5. *Petro, R.; Mëniku, L.; Marashi, A.; Shehri, Dh.*, Gjuha shqipe dhe letërsia 10, *Botime shkollore Albas, Tiranë, 2009.*
6. *Gjokutaj, M., Ballhysa, A., Saliaj, F.*, Gjuha shqipe 9, *Shtëpia Botuese "Shkronjë pas shkronje", Tiranë, 2007.*
7. *Gjokutaj, M., Ballhysa, A., Bishqemi, A.*, Gjuha shqipe 7, *Shtëpia Botuese Shkronjë pas shkronje", Tiranë, 2008.*
8. *Petro, R.; Metani, I.; Çerpja, A.*, Gjuha shqipe 8, *Botimet shkollore Albas, Tiranë, 2008.*
9. *Petro, R.; Metani, I.; Çerpja, A.*, Gjuha shqipe 9, *Botimet shkollore Albas, Tiranë, 2009.*
10. *Petro, R.; Metani, I.; Çerpja, A.; Vreto, Sh.*, Gjuha shqipe 7, *Botimet shkollore Albas, Tiranë, 2007.*
11. *Zheji, Gj., Xhafka, N.*, *Maja e Çelur*, Antologji e letërsisë. Bashkëkohore Shqiptare, Për shkollat e mesme, III-IV, SHBLU, Tiranë, 1998.

Martin Camaj in school textbooks

Martin Camaj is a wellknown writer in albanian culture. The absence of Camaj, Fishta, Koliqi's work in school programs for many yeears has created an enormous emptiness in albanian literature.

Evenwhile these authors today are included in literature subject, it's too difficult the entrance in the artistic code of their books. In this article will be reflected a general view of school textbooks' fragments detached from Camajt's works, seen in linguistic view, especially lexical, because his fragments are less interpreted, commented and analized from lexical view in school textbooks.

(Shkodër)

**ÇËSHTJE TË FJALËFORMIMIT NË VEPRËN
“DRANJA-MADRIGALE MBI FATIN E NJË FRYMORI
TË PAPËRSOSUN” TË MARTIN CAMAJT**

Shkrimtarët janë mjeshtrit e fjalës. Ato përpiqen të gjejnë fjalë e shprehje të goditura, ndërtime sa më të përshtatshme për të shprehur idenë mes figurash konkrete, e tablosh jetësore. Ata janë mjeshtrë të palodhur të gjuhës, fjalëgdhendës e krijues, por edhe gjurmues e studiues të fjalëve e shprehjeve të bukura popullore.

Pikërisht tek fjala, tek ajo që ishte e para, sipas Biblës, beson dhe përkulet Camaj, pasi me anë të saj ai shkon te drita, gjithësia dhe bën gjëra të pakrahasueshme me asgjë tjetër, brenda kohës e jashtë saj. Camaj ka besimin e gjithëhershëm tek fjala shqipe, që është” zjarr në Jug e qumësht në Veri” dhe i përulet asaj me devocion të shenjtë.

Personaliteti krijues i M.Camajt shfaqet në shkallë të lartë përkryerje në prozë, por vlen të theksohet përpjekja që bëri autori në prozën poetike “Dranja” në mënyrë që *gjuha t’i përshtatet lakueshëm çdo situatë*.

“Dranja” është ndërtuar në një varg rrëfimesh të shkurta, të cilat nuk kanë lidhje kushtëzuese me njëra-tjetrën, ato mund të lexohen secila më vete.

A.Klosi, botuesi i një pjese të korpusit të veprës së shkrimtarit në Shqipëri, tregon se shqipja e Camajt në prozë është një muzikë e gjallë prej fillimi në fund (Dranja) është në të vërtetë një himn për mundësitë e gjuhës shqipe të veriut...²⁸⁹

Në këtë punim do të ndalemi kryesisht në fushën e fjalëformimit ku Camaj na shfaqet si një krijues i pasur dhe i larmishëm. Ai vepron në

²⁸⁹ A.Klosi, *Martin Camaj , Vepra letrare 1, f. 37.*

fushën e fjalëformimit si druvarët e drulatuesit e shquar, zgjedh qysh para se ta presë pemën, d.m.th.e sjell fjalën pikërisht në aso kontekstesh që sqaron edhe pse-në e krijimit e të rikrijimit. Duke qenë një njohës i modeleve të gjalla strukturore të shqipes, ai arriti të krijojë mjaft fjalë të reja e madje edhe shprehje që e pasurojnë aq shumë veprën e tij. Shkrimtari u mbështet në gjuhën popullore dhe shfrytëzoi ato elemente që janë prodhimtare në gjuhën e sotme shqipe. Nga këto krijime, më të shumta janë fjalë të prejardhura (sidomos me anë të parashtesave e prapashtesave) e kompozita duke ndjekur kështu prirjen e shqipes.

Formimi parashtesor

M. Camaj, ashtu si çdo krijues tjetër u drejtohet atyre mjeteve fjalëformuese që njihen e që përdoren gjithandej në ligjërimet e folura e në krijimtarinë e sotme e të mëparshme.

Te formimet me parashtesim mbizotërojnë ato me parashtesat pa-, për-, sh-, zh-, mbë- e të tjera shumë më pak. Shtrirje më të gjerë kanë ato me temë emërore, pastaj ato mbiemërore e foljore. Parashtesat pa- e për- janë më të përdorurat, dhe interesante përdorimet dhe vlerat e realizuara prej tyre.

Parashtesa pa- del dendur në *mbiemra të nyjshëm* që tregojnë mungesën ose mospasjen e një cilësie a tipari dhe, ashtu si në mbarë shqipen. Kjo parashtesë u është shtuar **temave mbiemërore** si:

e paturbullueme (...ku mbërrin fryma e paturbullueme e detit...f. 12)

e padrejtë (...egërsohet për ndonjë të padrejtë si gjarpni...f. 13)

i panjoftun (...e vendi i panjoftun dhe i pastrehë si frymorët e tjerë të përvujtë...f. 28)

i padashtun, e papërsosun (...frymor i padashtun dhe fare e papërsosun në ndjenja...f. 68)

Vlen të theksohet mjeshtria e Camajt, ai arrin të krijojë sinonimi me dy mbiemra të prejardhur të formuar me parashtesën pa- si në shembujt e mësipërm.

të panjehuna (...rrashta të panjehuna breshkash...f. 69)

e papritun (...një thirrje e papritun në telefon...f. 91)

e pamirë (...asht punë e pamirë për Dranjen...f. 70)

e pabukur (...punë e pabukur kjo...f. 39)

Të dy mbiemrat e pamirë dhe e pabukur kanë të njëjtin kuptim e pahijshme, por shkrintari i vendos këto mbiemra në kontekste të ndryshme për qëllime stilistikore.

të pakryeme (...fletët e librit të pakryeme...f.106, FGJSSH e ka të pambaruar.)

të parruem (...sado lëkurë murmë të jemi e të parruem...f. 48)

Ndërsa nga **tema emërore** janë formuar *mbiemrat*:

i pavlerë (...breshka e paza, send i gjallë dhe i pavlerë kaq fatlumësi në jetë nuk do nënçmue...f. 29)

Autori nuk resht së përdoruri epitete të ndryshme për të cilësuar breshkën, ai e arrin atë me përdorimin e mbiemrave të prejardhur të lart përmendur.

i paemën (...përroi i paemën me ujë shkumbëzonte...f. 59)

i paskaj (...qielli i paskaj...f. 59)

(...ku secila vishkull ndan prona të paskaje...f. 73)

Camaj mbiemrin i paskaj e përdor mjaft bukur jo vetëm për të treguar qiellin që s'ka fund, por edhe trojet ku shkel Dranja janë të paskaje. Por hasim edhe mbiemrin e pafund.

të pafund (...tue rrëshqitë mbi ujna të pafund...f.53)

e papërvojë (...Dranja ende e re dhe e papërvojë u fsheh...f. 54)

të pangjyrë (...më sy të ngulun në një katror të pangjyrë...f. 63)

Dhe si përfundim vlen të theksojmë mjeshtrinë e shkrintarit, ai arrin të zgjerojë korpusin e fjalëve me parashtesën pa-

Parashtesa për-, del zakonisht në fjalë të njohura e të përdorura gjithandej në krijimtarinë shqiptare. Kjo parashtesë u paraviihet **temave foljore** e u jep *foljeve* të krijuara një kuptim intensiv e në mjaft raste ngjyrimë të reja kuptimore.

përpoqën (...u përpoqën t'i qesin fare...f. 77)

Ndërsa përdorimi i po kësaj folje, në konteks tjetër ka kuptimin me u rrit.

përpjeku (...mbasi ajo përpjeku shtatin për blerim...f. 15)

përziën (...mori fjetet e shtratit të merimangës me krye dhe i përziën ndër gishta...f. 17)

përputhet (...në këtë vend koha, koha përputhet për kohë përkueshëm, pa u vra aspak sendi për send...f. 23)

Mjeshtëria e këtij gjuhëtari e letrari s'ka të sosur, ai arrin të përdorë mjaft bukur në mënyrë të njëpasnjëshme fjalë të ndërtuara me këtë parashtesë. Camaj xhonglon me fjalën në mënyrë të magjishme duke i dhënë asaj ngjyime të bukura stilistikore.

përlyhet (...përlyhet shpesh petku i pafajnisë...f. 39)

përvodh, përvidhej (...u përvodh barkazi drejt kodrës...f. 55)

(...herë mbas here përvidhej kah shqimthi...f. 58)

përdredhë (...tue u përdredhë majë gishtave si pula e dreqit...f. 59)

përpiu (...përpiu njomëzën e frymës së detit...f.59)

përngjan (...i përngjan timtës ma të vogël të minutit...f. 62)

përvlohen (...si digjen e përvlohen në ranë...f.20)

përdogjën (...si u dogjën dhe u përdogjën sa herë në cikun e fijos së bungut...f.78)

përmallue(...t'ia dalë me përmallue breshkën...f.14)

M.Camaj në krijimtarinë e tij u mbështet edhe në gjuhën stantarde, kjo vihet re në fjalët e sipër përmendura të cilat i gjejmë të përdorura në gjuhën letrare.

Parashtesa sh-

M.Camaj duke u mbështetur tek e folmja e vendlindjes, përdori mjaft fjalë të trajtës dialektore, kjo gjë vihet re edhe tek përdorimi jo sipas stantardit të parashtesës sh- në vend të ç-së.

Nga **tema foljore** janë ndërtuar *foljet*:

shmatë (...tue i matë e shmatë gjymtyrë për gjymtyrë...f. 25. FGJSSH e ka çmatë.)

shlirojë (...të shlirojë shushuritjen e tallazeve të ndaluna...f. 63. FGJSSH e ka çlirojë.)

Parashtesën mbë - e kemi hasur tek fjala **mbërrudh**, në FGJSSH është pasqyruar me parashtesën m-: mrrudh.

mbërrudh (...mandej u mbërrudh pakëz përmbrenda...f. 42)

Me **parashtesën më**- kemi fjalët:

mëveshet (...i mëveshet bimësisë buzë Drinit...f. 73)

mëkambë (...për të mëkambë ndoj tempull...f. 20)

Këto fjalë të formuar me parashtesa, po t'i vështrojmë nga pikëpamja e shtresëzimit që u takon mund të themi se mjaft prej tyre, edhe pse janë shkruar në variantin letrar gegë tërheqin nga “aroma e standardit”, sepse janë leksema të njohura e të dendura në mbarë letërsinë e shkrimtarinë e kohëve të reja.

Formimi prapashtesor

Formimi prapashtesor është një ndër mënyrat më prodhimtare në formimin e fjalëve në gjuhën shqipe, kjo gjë duket edhe nga numri i madh i formandeve fjalëformuese prapashtesore që ka shqipja. Edhe në materialet që kemi vjelë nga proza poetike “Dranja”, prapashtesimi na del si një nga rrugët kryesore për formimin e fjalëve të reja, natyrisht që ato mund të jenë edhe të trashëguara, por që dëshmojnë jetësi e prodhimtari të sotme dhe paraqesin interes leksikor dhe gramatikor.

Dhe në fjalët që po analizojmë ashtu siç kemi theksuar edhe tek formimi prapashtesor, këto fjalë jo të gjitha janë krijime të autorit M.Camaj, ndonjëra prej tyre haset edhe në autorë të tjerë paraardhës, bashkëkohës ose që i përkasin ligjërit me prejardhje të dukshme krahinore. Prapashtesat më të përdorura tek kjo vepër janë: -im, -o, -or, -shëm, -isht, prapashtasat zvogëluese e përkëdhelëse z-, th-.

Prapashtesa –as formon emra të prejardhur dhe etnika e është identike me –ës.²⁹⁰

M.Camaj me anë të kësaj prapashtese ka krijuar *emra* të prejardhur nga **tema emërore**.

dheas (...dëshmoi se skota e Dranjes, atje, nuk ishte erdhacake, por dhease...f. 25)

Ndjenjën e fuqishme të tërheqjes, prej tokës e dheut, autori e jep pikërisht me anë të Dranjes, ajo është dhease,se e tillë dhease(tokësore) është edhe krejt krijimtaria e tij.

²⁹⁰ A. Xhuvani, E.Çabej, *Prapashtesat e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1962, f.21.

Këtë fjalë siç thotë edhe M. Elezi e hasim tek Camaj, jo vetëm në këtë prozë, por edhe në krijime të tjera të këtij autori.

dukagjinas (...je i dukagjinas - i thanë- ... f. 24)

Me anë të kësaj prapashtese janë formuar edhe *ndajfolje* si: tërthoras, lehtas, verbtas, ndamas etj.

tërthoras (...më shikon tërthoras...f. 35)

lehtas (...të mos dilnin aq lehtas jashtë...f. 50)

verbtas (...kërkonte verbtas dritën mes qiellit...f. 65)

ndamas (...një cope dhe ndamas, mbi të...f. 102) etj.

Gjithashtu me këtë prapashtesë na kanë dalë edhe kompozitat: kambë-sharavelas, gazakeqas që në FGJSSH nuk janë të pasqyruara, e duken se janë krijime të autorit.

kambë-sharavelas (...si u lëshue breshka teposhtë nëpër mjellazën e borës kambë-sharavelas... f. 51)

gazakeqas (...ai nuk më mori vesh dhe qeshi gazakeqas... f. 91)

Në romanin “Rrathë” ne kemi hasur kompozitën mirakandas me prapashtesën –as, ndërsa këtu ajo na del me prapashtesën –es:mirakandes.

mirakandes (...Dranja ashtë një breshkë që duket e zhduket simbas mirakandes së vet... f. 68)

Prapashtesa –im, dokumentohet për gjuhën shqipe që në shekullin XV²⁹¹. Kjo prapashtesë u bashkohet kryesisht **temave foljore** që mbarojnë me–o. Në materialin që kemi vjelë na kanë dalë këto *emra* si:

flakim (...një flakim peshe larg...f. 23, në FGJSSH kemi fjalën flakërimë.)

tringëllim (...në katue ndëgjohej tringëllimi i gazit të vajzave...f. 27)

Këtu autori e ka përdorur me nuancë të re kuptimore, ndërsa në FGJSSH e kemi me kuptimin tingull i hollë, i kumbueshëm që lëshon diçka kur e godasim etj.

mrekullim (...por mrekullimi mue më kaloi në tmerr...f. 53).

M. Elezi në fjalorin e tij thotë që kjo fjalë gjendet tek I. Kadareja, “Hija”, por atë e gjejmë edhe tek M.Camaj, ndërsa në FGJSSH nuk e gjejmë të

²⁹¹ A. Xhuvani, E.Çabej, *Prapashtesat e gjuhës shqipe*, Tiranë, f.53.

pasqyruar.

flijim (...breshkani, me kokë të çame tue rigue gjak flijimi...f. 57)

verim (...mbas verimit në majë të Barcolës...f. 64)

avullim (...mes avullimit të vapës...f. 68)

thellim (...i qenka ndërpre thellimi ndër tinguj...f.71)

gërshetim (...gërshetim gardhi me thupra e thoj...73)

gulshim (...tërfateshin tue nxjerrë prej rrashtës kryet, po ashtu si të kishin gulshimin dhe u delnin sytë kokërr...f.75, FGJSSH e ka gulçim,-i)

gjinimi (...kushtet jetësore ndër to ishin të vështira, si gjinimi gjashtëmujor...f.77, në FGJSSH kjo fjalë nuk është e pasqyruar,tema foljore gjino nuk është e pasqyruar, por kemi emrin gjini.)

vlim(...larg në detin në vlim të shkëlqyeshëm...f.79) Autori emrit vlim i ka dhënë një nuancë mjaft të bukur stilistikore.

kundrim (...atë e acaronte kundrimi i rrashtës...f.89)

kumbim (...ndjeu mbi krye dridhjen e ajrit, përziëshëm si mes fortunës, kumbim muzike...f.71)

Kemi përdorimin edhe të mjaft fjalëve të tjera si: **premtim, besim, theksim, vezullim, dyshim, dështim, marshim, largim, shpjegim, qëndrim, pushtim, kalim, kufizim etj.**

Prapashtesa –isht

Me këtë prapashtesë janë formuar *ndajfolje* nga **tema emërore** si :

trimnisht (... ishte mirë me u shkri ashtu trimnisht...f.24)

parimisht (...parimisht nuk ashtë gabim...f.40)

hajnisht (...ia ngjiti me gojë e iku hajnisht...t.49)

Prapashtesa –o gjindet që në ilirisht tek emrat e burrave si: Bato, Testino.²⁹² Kjo prapashtesë paraqitet mjaft prodhimtare në formimin e foljeve. Nga **tema emërore** +prapashtesën –o janë krijuar *foljet*:

mrizon (...ku mrizonte në vapë... f.32)

acaron (...atë e acaronte kundrimi i rrashtës...89)

varrohej (...varrohej për së gjalli me atë natyrshmëri prej bujku... f.18)

mjegullohej (...vetëdija gjithnjë në mue mjegullohej... f. 34)

²⁹² A.Xhuvani, *Vepra I*, f. 521.

mrekullohet (...Dranja i merr anën e mrekullohet... f. 49)

dimnonte (...ajo dimnonte aso here në tokë... f. 51)

andërrova(...andërrova dhe u thashë... f. 53)

Ndërsa nga *mbiemrat i rrallë, i thartë* kemi ndërtimet: *rrallohet, thartohe*.

rrallohet (...rrallohet në vargun e reptilëve... f.55)

thartohe (...ashtu si thartohe edhe vena e re... f. 39)

Me **prapashtesën –ore** nga **tema emërore** janë formuar *emra e mbiemra që tregojnë një vend sipas karakteristikës së temës fjalëformuese* si:

gungore (...për të mos i ra kambëve gungoret e mureve në rrënim... f. 20)

hamulloret (...hamulloret e djeguna andej- këndeje... f. 37)

krypore (...ishte grimcë ndër dhena të hueja krypore... f. 69)

qumështore (...kur sheh çdo shtazë qumështore... f. 72)

lotore (...qenë lotore dhe... f. 74)

Prapashtesa –shëm është e kohëve të reja të gjuhës së shkrimit, se të shkrimtarët e vjetër të veriut e gjejmë me trajtën –shim. –shëm, –çim..²⁹³

Kjo prapashtesë na ka dalë mjaft prodhimtare dhe aktive. Me anë të kësaj prapashtese M.Camaj ka krijuar më tepër *ndajfolje* nga **tema emërore, foljore e pak mbiemrore**.

drithshëm(... nga frika blegëruen drithshëm... f. 51. Në FGJSSH është e pasqyruar si folje: drithëroj, si emër: drithërimë, e si mbiemër: i drithëruar.)

mundueshëm (...tue gërrye botën mundueshëm rrethazi...f. 67, FGJSSH e ka si mbiemër: i mundueshëm.)

pusishëm (...rana e lagun që i humbaste pusishëm nën kambë... f. 70, në FGJSSH nuk është e pasqyruar.)

mjegullueshëm (...atëhere i priren mjegullueshëm ndërmend bij e bija...f. 76)

hareshëm (...dridhi zanin hareshëm.. f. 79)

përkundshëm (...tue ecë ashtu si përhera përkundshëm... f. 19)

mejtueshëm (...këqyr përpara hundës dhenë mejtueshëm...f.21,në FGJSSH është pasqyruar mendueshëm.)

ngulshueshëm (...zogjtë marrim frymë ngulshueshëm... f. 47)

²⁹³ Po aty, f. 540.

kërcënueshëm (...dridheshin në flakë kërcënueshëm... f.101)
ndërrueshëm (...vjeshta po kalon ndërrueshëm... f. 23, në FGJSSH është pasqyruar si mbiemër:i ndërrueshëm.)
mendueshëm (...e rrin mendueshëm... f. 390)
madhnueshëm (...madhnueshëm shikonte baloshi...f. 60, FGJSSH e ka madhërishtëm.)
ngathshëm (...e këqyra ngathshëm...f.85, në FGJSSH na del me prapashtesën –ësi,-sht: ngathtësi, ngathtësisht.)
gëzueshëm (...vehet gëzueshëm në marshim drejt rrugës... f. 33)
 Por kemi edhe krijimin e mjaft mbiemrave me anë të kësaj prapashtese nga **tema emërore dhe foljore** ku kemi të përdorur mënyrën nyjzëzim e prapshesim si:
të burrueshëm (... grethi me za të burrueshëm... f. 23, në FGJSSH është e pasqyruar me prapashtesën –ishte si mbiemër i panyjshëm: burrërishte, burrënishte, veshje burrërishte, qëndroi burrërisht (si ndajfolje).)
i unshëm (...isha i unshëm e sy –kuq si zjarrmi...f. 85, FGJSSH e ka i urishëm.)
i dhimbshëm (...rueju, se je i dhimbshëm për të gjithë...f. 24)
të marrshëm (...vargun e shtrembët e të marrshëm...f. 105)
e vetueshëm (...nalt, mbi maje në avullin e vetueshëm...f.47, kjo fjalë s’është e pasqyruar në FGJSSH.)
të shkëlqyeshëm (...larg detin në vlim të shkëlqyeshëm...f. 79)
të shkitshëm (...ecte e shkëlqente nëpër bar të shkitshëm...f.74, edhe kjo fjalë s’është e pasqyruar në FGJSSH.)

Prapashtesa –z.

Edhe kjo prapashtesë është e moçme, atë e gjemë që tek autorët e vjetër të veriut si te Buzuku vashëza, te Budi arkëza, te Bardhi urëza etj.²⁹⁴
 Kjo prapashtesë përdoret më tepër në letërsinë artistike për t’i dhënë fjalës ngjyrim emocional e kryesisht kuptim zvogëlimi e përkëdhelie.

²⁹⁴ A. Xhuvani, *Vepra I*, f.555.

Në materilet që kemi vjelë themi që prapashtesa –z është përdorur me mjeshtëri nga autori për t'i dhënë fjalës nuancë sa më shprehëse. Mjaft prej këtyre fjalëve vazhdojnë e përdoren edhe sot, ato janë të trashëguara që nga autorët e vjetër e deri në ditët tona si: pakëz, njomëz, gropëz, dritëz, figurz, ashkëz, dhambëz, çapojz, gurëz, grykëz, lundërz, fletëz, bishtajzë, morrëzit, thojzit etj.

Prapashtesa –th i jep fjalës nuancë emocinale të përkedhelisë, të përbuzjes, përqeshës a keqësues. Kështu kemi fjalët:

zokthin (...mbërrinte bimësia deri në zogthin e kambës...f.17)

sythin (...pa sythin e dritës...f. 28)

shqimthi (...shqimthi i bimëve si zogj morrash...f. 32)

grithte (...breshka grithte me thoj, si tue e bre me dhambëz...f. 37)

shkrethin (...qëndron në shkrethin druni...f. 86) etj.

Kompozimi

Fjalët e përbëra në prozën poetike të Camajt janë të shpeshta, edhe pse në mjaft raste nuk kanë zënë një vend ato kanë vlerë të madhe për arsye se ato, duke qenë të formuara mbi baza të drejta e sipas modeleve ekzistuese të gjuhës shqipe tregojnë se shqipja ka mundësi e mjete të mëdha shprehëse. Shumica e fjalëve të përbëra që gjenden në këtë vepër janë emra, mbiemra e ndajfolje. Vihet re denduria e përdorimit të kompozitave me vizë në mes, ku ndonjëra është e pasqyruar në fjalor e shkruar bashkë.

Në fillim po ndalem tek kompozitat, ku autori kërkon të cilësojë personazhin e veprës së vet **Dranjen**.

gojëplakë (...i andshëm për dardha të egra mëndafsh për Dranjen gojëplakë... f. 12, kjo kompozitë nuk është e pasqyruar në FGJSSH.)

dritë-shkurtë (...nuk e lirojnë breshkën prej zanit të keq si parasite, e për ma tepër dritë-shkurtë...f. 13)

shkurt-pamëse (...breshka e vogël ende shkurt-pamëse e ndjeu rrezikun...f. 8)

Të dy këto kompozita kanë të njëjtin kuptim, por Camaj i përdor me mjeshtëri duke i dhënë ngarkesa emocionale të ndryshme. Kompozitën shkurt-

pamëse nuk e kemi të pasqyruar në FGJSSH. Camaj arrin të krijojë antonimin sipas modelit largpamëse.)

kambë-shkurtë (...Dranja kambë-shkurtë i ngjitej për pishë të diellit rrëpinës...f. 59)

Nëse do të bënim një krahasim me të motrën që është me kërqikë të gjatë e qafë-hollë.

zgur-plote (...për breshkën zgur - plote ara buknore ishte vendi ma i mrekullueshëm...f. 66)

buzë-hollë (...për Dranjen buzë-hollë, lëpushka...f. 730)

lukth-shtjerrë (...rrashta e breshkës lukth-shtjerrë...f. 86)

gojë-hapë (...në rrashtën gojë-hapë të Dranjes...f.101, FGJSSH e ka gojëhapur.)

Në materialin që kemi vjelë na kanë dalë edhe mjaft **kompozita mbiemrore** të ndërtuara sipas skemës *emër+mbiemër*.

lëpushë-gjanë (...shëgën e butë e pjeprnin lëpushë-gjanë...f.12,në FGJSSH kemi të pasqyruar emrin lëpushë, ndërsa kompozitën jo.)

zgur-përgjakun (...dhe i ujkut me fulqij si dana dhe zgur-përgjakun...f. 12)

vesh-mprehta (u tregonte burrave mikpritës e grave vesh-mprehta...f. 14)

frymë-mirë (...roje frymë-mirë e dheut të rrëpijtë...f. 14. Me emrin frymë në fjalor hasim ndërtimet mbiemrore si: frymëkëputur, frymëmarrës, frymëmbarruar, frymëprerë, frymëshuar, ndërsa ky ndërtim nuk është pasqyruar.)

Tre kompozitat e lart përmendura nuk janë të pasqyruara në FGJSSH.

za-shtjerrun (...jo si grethi za-shtjerrun...f.16, në FGJSSH është zështjerrur.)

shtat-naltë (...drejtues, shtat-naltë nga viset nordike...f. 25, FGJSSH e ka shtatlartë.)

krye-thinjun (...mos me u grindë me moshatarë krye-thinjun...f. 38, në FGJSSH nuk është e paraqitur.)

sy-kuqe (...bretkosa sy-kuqe...f. 58, në FGJSSH është bashkë sykuqe.)

Kompozitat sy-zbrazët, brijë-lëmuët s'janë të pasqyruar në FGJSSH.

Sy-zbrazët (...sy-zbrazët e pa mallin që kishte Dranja...f. 62)

brinjë-lëmuet (...që të mos ia thyejë shlliga brinjë-lëmuet...f. 66)
lëkur-hollë (...përmse gilacash lëkurë-hollë të breznisë së re...f. 69)
lëkur-murme, bishtmëdha (...atje banonin breshka të shëmtueme, lëkur-murme e bishtmëdha...f. 77)
vithgjanë (...doli prej shtëpisë grueja vithgjanë...f. 102)
kambë-hollë (...nusja kambë-hollë...f.103)
 Po ashtu, me denduri përdoren ndajfoljet e përbëra nga bashkimi i përsëritur i së njëjtës fjalë, zakonisht emër, si: grima-grima, grumbuj-grumbuj, danga-danga, lara-lara, dredha-dredha, valë-valë, ngjyrë-ngjyrë, kambë-kambë, grimë-grimë etj. Le të shohim disa në kontekste të caktuara, përdorimet e vlerat stilistikore të tyre:
grima-grima (...pëlset grima-grima përreth thelbi i bardhë... f.49)
grumbuj-grumbuj (...nga njëzet breshka bashkë, grumbuj-grumbuj... f.75)
thepa-thepa (...emblema të fshehta në kurrizë thepa-thepa...f. 89)
vende-vente (...si të preme me thikë, anash vende-vente... 99)
ngjyrë-ngjyrë (...i dolën në pamje vija si dej ngjyrë-ngjyrë... f. 41)
kambë-kambë (...u sos kambë-kambë me të në kashnjet... f. 49) etj.

PËRFUNDIME:

Proza poetike "Dranja" është një vepër me vlera të mëdha gjuhësore e letrare.

M.Camaj, siç është shprehur edhe vetë, ka qenë i dashuruar me gjuhën shqipe dhe shfrytëzoi në shkallën më të lartë e të mundshme cilësitë dhe pasuritë e saj shprehëse. Vetëm me anë të gjuhës dhe plastikës së saj shkrimtari e bën krijimtarinë e vet, siç shkruan K.Petriti, shqiptare nga humusi, nga shkëmbi e lisi, nga gjarpri e korbi, shqiponja e breshka etj.²⁹⁵

Të gjitha e gjithçka shkrimtari-poet i arrin me anë të gjuhës, përdorimit të saj me mjeshtri dhe efekt të lartë shprehësie.

²⁹⁵ K.Petriti, *Fjala poetike-kuti e Pandorës*, Globus R, 2008, f. 248.

Nga një analizë e shkurtër bërë prozës poetike “Dranja”, ku u ndalëm kryesisht tek fjalëformimi e kompozimi mund të themi që:

- M.Camaj vepron në fushën e fjalëkrijimit e fjalëformimit në mënyrë të përsosur, duke shfrytëzuar ato mjete fjalëformuese, që janë karakteristike për gjuhën shqipe.

- Ngjyresat më të bukura krahinore (sidomos të vendlindjes së tij Temalit), treten e shkrihen natyrshëm me trajtat normative letrare, duke e bërë këtë veper të pasur, kumbuese e me peshë të madhe tek lexuesi.

- Camaj si një shkrimtar e gjuhëtar krijues arriti të fusë në përdorim mjaft bukur shprehje popullore e fjalë të vjetra të trashëguara nga e kaluara ose nga bashkëkohësit.

Po e mbyllim këtë punim me një vlerësim të kritikëve të kohës për gjuhën e N.Gogolit, ku mendoj se vlen një gjë e tillë edhe për Camajn, ata thoshin se fjalët e tij “*nuk janë thjesht fjalë, ato gjëmojnë si bubullima dhe shkrepëtijnë si rrufeja*”.

BIBLIOGRAFI:

1. M.Camaj, *Dranja- Madrigale mbi fatin e një frymori të papërsosun*, Munchen,1981.
2. *Fjalor i gjuhës shqipe*, Tiranë, 2006.
3. *Gramatika e gjuhës shqipe*,1, Morfologjia, Tiranë, 2002.
4. A.Xhuvani,E.Çabej, *Parashtesat e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1975.
5. A.Xhuvani, E.Çabej, *Prapashtesat e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1962.
6. A.Xhuvani,*Vepra 1*, Tiranë, 1980.
7. A.Klosi, *Martin Camaj,Vepra letrare 1*, Tiranë, 1996.
8. K.Topalli, *Vepra letrare e Martin Camajt në aspektin gjuhësor*.
9. K.Petriti, *Fjala poetike- kuti e Pandorës*, Globus R, 2008.

The matters in the work "Dranja - Madrigal" on the fate of a non-perfect human" by Martin Camaj

The poetic prose "Dranja" is a work of great value of literary language. M. Camaj, as expressed by him, has been enamored with the Albanian language and used in the highest degree possible of his qualities and expressive properties.

All and everything writer - poet achieves is through language, its mastery usage and high effect of expression. From a brief analysis made at the poetic prose "Dranja" where we mainly stopped on the word formation we can say that:

Martin Camaj - operates in the area of the word formation and word formation so perfectly, using those formative tools, which are characteristic for the Albanian language.

The best provincial coloring melt naturally with the normative literary contraction, making this work rich, and with great weight to the reader.

- Camaj as a creative writer and linguist managed to put into use quite beautifully old expression and old inherited words from the past or contemporaries.

Orjeta DUSHI, Teuta ÇOKU (Shkodër)

KONSIDERATA RRETH SISTEMIT FOLJOR TË NJË VEPRE LETRARE TË MARTIN CAMAJT

M.Camaj në veprën e tij ka shpalosur gegërishten letrare duke realizuar dhe një afri ndërdialektore në sistemin foljor të shqipes. Kategoritë gramatikore të foljes paraqiten me të gjitha ndarjet, si dhe me një larmi formash në fjalëformim e në forma të pashtjelluara.

• **Mënyra dëftore** paraqitet me të gjitha kohët e saj, në të tre zgjedhimet. **E tashmja:** mendon, ban (Zgj1), z bathnin, gjindej (ZgjII); rri/n, due/dua (Zgj III). Në përgjithësi mbaresat dalin si gjuha standart, me përjashtim të foljes: due, duen, duem (veçori e gegërishtes ku z bërthehet zanorja e theksuar O në UE në vetën I njëjës e vetën I, III shumës të zgjedhimit III) përkundrejt, dua, duam, duan. Vihet re ndërtimi i kohës së tashme me pjesëzën “po” p.sh., po thom, po flas, po e zen; dhe veçoritë fonetike me karakter morfonologjik si ndërtimi i t|s: përkas|përket, flas | flet dhe metafoia: dal-del; njoh-njeh. Grupi i foljeve të parregullta i afrohet normës letrare sidomos në vetat e shumësit, bën përjashtim vetëm veta e tretë njëjës: asht|është tipike e gegërishtes. Në formën joveprore s’ dallohen veçori dialektore.

E pakryera: Ndryshe nga autorët e tjerë të veriut që kanë përdorur mbaresat-jshe, -jshim, Camaj i afrohet standardit me mbaresat-ja, -je, -nte. P.sh., shkruente, bante/bënte (Zgj I); priste, delte/dilte, përplaste (Zgj II); ngrante/hante, zente/zinte (Zgj III). Vihen re ndërrimet e tingujve E-I (vente\vinte) dhe foljet e parregullta “jam, kam”, që formojnë të pakryerën pa mbaresën –TE-p.sh.: ish/ishte, kish/kishte. Bie në sy edhe përdorimi i

togut zanor UE (gegë) në temat foljore i pazëvendësuar me UA(tosk) p.sh.: shkruente;

E kryera e thjeshtë ka një përdorim të dendur në vepër dhe paraqitet me këto ndryshime në temat e foljeve: **a)** Shihen forma të njëjta mes temës së të kryerës së thjeshtë me të tashmen p.sh.: fut(e tashme)/fut-a(kr.thjeshtë); **b)** vihet re dukuria e supletivizmit: p.sh., vij/erdhi, them/tha,ha/hangri; **c)** shihet ndryshimi fonetik me karakter morfonologjik A-O; E-I, p.sh: dal/doli, marr/mori, pres/prita, **d)** disa folje e zgjerojnë temën: bani, zuna; **e)** veta e tretë njëjës del e ndërtuar me dy mbaresa: **-i:**lindi,vuni; **-u:** iku. Forma joveprore është përdorur me pjesëzën –u. **E kryera** si kohë foljore në vepër është formë analitike e tipit: kam ba p.sh.: kishin dhanë, kam dorzue, ka mohue (Zgj I), ke shti (fus) (Zgj II), kam dasht, kishin lanë (Zgj III), kishin dhanë, kishin ardhë, ka hangër (zgj i parregullt). Në vepër janë prezente të gjitha vetat. **Mëse e kryera** në vepër ka kuptim gramatikor (kohor-aspektor). P.sh.: kishte qindrue, kish thanë, u kish hjek (folje në formën veprorë), ishte ul, ishin vllaznue (folje në formën joveprore). Vihet re që temat foljore në këtë kohë në pjesore s’kanë mbaresa: qindrue/qëndruar, vllaznue/vllazëruar. Bie në sy një kohë e mbipërbërë e tipit të mëse të kryerës së dytë psh: kishin ken forcue, i kish pas than, e kishpasqitë,etj.

E kryera e tejshkuar ka një përdorim të vogël në krahasim me kohët e tjera të dëftores p.sh.: pata punue, pata lexue, pat thanë.

E ardhmja në vepër është formë analitike e ndërtuar me pjesëzën do+të tashmen e lidhore p.sh. (do të shkruente, do të sos), por edhe me trajtën perifrastike due+paskajoren e tipit “me ba”. P.sh.: donte me gjetë, donte me thanë. Ndeshim edhe format “kam me punue”; “kam për të ba”. Shfaqet edhe forma joveprore: do të përpiqesh, do të cilësohet.

E ardhmja e përparme përdoret në dy forma foljore, p.sh. do t’i ket tretë (veprorë), do të jetë shprish (joveprore). Vihet re një kohë e mbipërbërë e së ardhmes në formën joveprore (e ardhme e përparme e dytë), p.sh: do të kishte qenë prapue. **E ardhmja e së shkuarës:** do ta mbronte, do të merrte.

E ardhmja e përparme e së shkuarës: do të kishte shkue, do t’i kishte dalë.

● **MËNYRA LIDHORE** paraqitet me kohët: **E tashme** p.sh.: të mishnojë, të gënjejë (forma veprare), ku mbaresa -(j)ë del në të gjitha zgjedhimet në vetën III njëjës si e përfutur nga zhvillimi historik i shqipes për formën veprare; foljet në të tre zgjedhimet në formën joveprare të kohës së tashme të mënyrës lidhore dalin si forma e së tashmes dëftore+pjesëzën e lidhores TË p.sh.: të përnjisohej, të zhibihej, t’u bahet, të fshihej, etj. **E pakryer** psh.: të lëshonte. **E kryer**: të kam thanë; të kanë dhanë. **Mëse e kryera** në vepër na paraqitet në formën joveprare p.sh.: të ishte qenë.

● **MËNYRA HABITORE** paraqitet në kohët: **E tashme**: ditke, gjetkam (forma veprare); u shtueka (forma joveprare). **E pakryera** p.sh.: jetuekëshin, njohkej, etj. **E kryera** p.sh.: paska qenë, qenka ba. **E kryera e dytë**: paska qenë ba.

● **Mënyra dëshirore** na paraqitet me folje të parregullt. p.sh.: -Gjithmonë të dhafshin!(jap); Puna e mbarë ju qoftë! (jam).

● **Mënyra urdhërore** paraqet forma gramatikore vetëm për vetën e dytë njëjës e shumës, tipike për ndërtimet në formë urdhri, ku kryefjala s’është e shprehur po e nënkuptueshme. P.sh.: Lene jashtë punëve tua! Mirë e ke!

● **Mënyra kushtore**: **E tashme**: do të përgatitesha; **E kryer**: do ta kishte përlligj.

Format e pashtjelluara, grupimi dhe ndërtimi i tyre.

Përdorimi i madh i foljeve dhe formave të tyre mbart rrëfimin në vepër. Format e ngurosurat të foljes kanë një vend jo pak të rëndësishëm. **Pjesorja** në vepër na shfaqet e ndërtuar si në gjuhën standard me: **a)**formantin-NË p.sh.: thanë, dhanë, lanë, qenë, nxënë; **b)**formantin-Ë p.sh.: veshë, ardhë, ulë, rrekë, marrë, tretë, zhdukë, gjetë. Foljet që dalin me temë në zanore, në pjesën më të madhe e zërthejnë formantin 0 (zero) në forma, këtu formanti 0 (zero) nuk është zërthyer në tog zanor p.sh.: kishte pra(pushuar). **Mohorja** na paraqitet në vepër në dy kohë që formalisht i quajmë: **Koha e tashme** e tipit pa+pjesore (si gjuha standard) psh: pa ngurrue (forma veprare), pa u diktue (forma joveprare e ndërtuar nga pjesëza U), etj. **Koha e kryer** e tipit pa+kohën mëse të kryer të foljes psh:pa pasë lypë, pa i pasë çelë fat vetes. **Përcjellorja** është një formë e pashtjelluar analitike e tipit DUKE+pjesore (duke mohuar, duke u

frikësuar), por që në vepër na shfaqet edhe në formën TUE+pjesore (tue u ngucë, tue e drashtë, tue peshue, tue ngrehë, tu trillue). Përcjellorja na shfaqet dhe në ndërtimin e një forme perifrastike e tipit jam+përcjellore p.sh.: qenë tui mbetë, duke i dhënë mundësi foljes që në këtë kohë të tregojë një veprim të caktuar që ishte duke u zhvilluar në një çast të caktuar të së shkuarës. Përcjellorja ndeshet edhe në ndërtimin e shprehjeve frazeologjike foljore p.sh.: tue i ardhë gjaku n'krye, tue hy e tue dalë, tue ra moh etj. Kjo gjë tregon një përdorim të gjerë të gegërishtes veriore, ku trajta dialektore TUE është e barasvlefshme me DUKE. **Paskajorja** na paraqitet si formë analitike e foljes me dy ndërtime: ***E tipit PëR Të+Pjesore** (si gjuha standard), p.sh.: për të këqyrë, për t'u hetue, për të prapsue, për të zbulue (në pjesoret e foljeve vihet re ndërtimi i formës gege me prapashtesën UE në vend të UA) në funksionin sintaksor të një rrethanori qëllimi në fjali p.sh.: Për të qitë poshtë (thanjen); ***E tipit ME+pjesore** p.sh.: me pritë, me qenë, me dashtë, me i thanë, me bre (me pre hekurin), me gjetë, me ditë, me më pre, me vdekë, me dalë, etj. Ky tip mbart një peshë kallëzuesie në fjali dhe të pazëvendësueshme me një formë tjetër foljore si e mënyrës lidhore, që shfaq afri kuptimore, apo zëvendësimi me gjuhën standard, p.sh.: (ai) me dashtë (paskajore gege) - (ai) për të dashur (paskajore e gjuhës standard) - (ai) të dojë (mënyra lidhore). Siç shihet nga ana kuptimore asnjëra nga format nuk e zëvendësojnë njëra-tjetrën. Vetëm në grupet emërore të tipit emër+paskajore gege (me ba) p.sh.: kohë me lujtë, zëvendësimi i saj me standardin s'do të prishte kuptimin e sintagmës p.sh.: kohë për të luajtur, e barasvlershme edhe për shembujt kohë: për të shue ujen, për të qitë poshtë pikëpamjen, për të prapue pishën e vapës etj. Shfaqet edhe forma joveprore e paskajores e tipit: me **u** ba, me **u** kuptue, por krahas saj përdoret edhe e kryera e paskajores: me pas kujtue. Kjo formë e pashtjelluar ka një përdorim të dendur në vepër, sepse e gjejmë edhe në shprehjet frazeologjike foljore, p.sh.: sa me të vra syt, me të çue të pështjellët, me i zanë me presh në dorë, me bre hekur me dhambë, etj. Paskajorja gege është një prej formave të veçanta dialektore, që mungojnë në dialektin tosk, prandaj ruhet për forcën shprehëse në situata të ndryshme si një pasuri gjuhësore.

Formim i foljeve

Në veprën e M.Camajt folja shfaq një larmi në fjalëformin duke na tipizuar veprime e gjendje të personazheve e mjediseve ku ato ndodhen. Dallojmë për nga formimi këto tipa:

A) Folje të thjeshta: mbaron, dolën, matën, gjindej, kthejnë, rriten, etj

B) Folje të prejardhura: *me parashtesë, *me prapashtesë,* parashteso-prapashtesor.

●Parashtesat: **për**: përsillej, përkënaqej; **mbi**: mbizotëronte; **ndër**: ndërpres; **nën**: nënshtroj dhe parashtesa antonimike: **z**-zbathnin (këpucët); **sh**-shliron, **zh**-zhbërthenin;

● Prapashtesat tipike për formimin e foljeve: **-o**: punoj, **-to**: caktohet, **-so**: frikësohet; **-ro**: mishërohej si dhe prapashtesa **-at** (tipike për emrat): tue turfullatë;

● Tipi parashteso - prapashtesor: përjashtoj, përfytyronte.

C)Me përngjitje: Donmethanë /don me thanë/domethënë (përdorimi i sotëm).

D)Me kompozitë: mundshtohem, mbarështoj, kundërshtoj.

Rishtë në sistemin foljor

Camaj me veprën e tij, e shkruar në gegërishten letrare, si një variant i gjuhës shqipe sjell risi në sistemin foljor: *Afrimi ndërdialektor si p.sh.: #Ruajtja e zanores Ë në të gjitha pozicionet e saj në fjalë p.sh.: ndëgjoj(e jo-ndigjoj- si formë gege); të arsyetojë, ishte veshë (e jo-ishte vesh-si formë gege) # Përdor të dy trajtat e paskajores p.sh.: me ardhë, për të dalë, etj., duke i zëvendësuar herë-herë me folje në mënyrën lidhore, e cila përdoret dendur në dialektin e toskërishtes. Përdor fjalët: mejtohej, njohkej, si njëjtësi foljore me toskërishten.*Ndërton kohë të përbëra të dyta të mënyrës dëftore: a) Mëse e kryera e dytë: I kish pas thanë; kishte pas marrë; b) E kryera e tretë: ka pas ken njoftë; c) Mëse e kryer e tretë: kishte pas ken bashkue. d) E ardhmja e përparme e dytë: Do të kishte qenë prapue. *Ndërtimi i të ashtuquajturave kohë në format e pashtjelluara: a) Mohore e tashme: pa ngurrue; b)Mohore e kryer: pa pasë lypë. *Përdorimi i

paskajores gege: me ba, si një formë përfaqësuese dialektore me vlera gramatikore në sistemin foljor e pazëvendësueshme me format e lidhore apo me paskajoren standarde. *Camaj përdor forma të vjetra foljore të vlefshme për studimin e historisë së gjuhës shqipe: p.sh.: gzhateshin-zgjtateshin; tue u rrekë-duke u përpjekur; ngjasin-zgjasin; kish hjekë-kishte hequr; ndëgjonte-dëgjonte; zhublohet-rrudhet; për të këqyrë-mbikqyrë; do të kish sosë-do të kishte mbaruar; asht-është; tërnoheshin-ndërroheshin; msheli-mbylli; grinin-ngrante-hangri përkatësisht hanin-hante-hëngri; të zhibi - të zhdukej; tue u ngucë - duke u ngacmuar; kaptohet-shikohet; janë idhnue-janë hidhëruar; njuhet-juhet; tue i ra moh-duke i mohuar, zbatnin (këpucët), heshtnin, bishtonte, gjallnova, të mishnojë, të përnjisohej, garendnin, zinte fill, do të ishte shprishur, etj. *Në sistemin foljor përfshijmë edhe kallëzuesin e përbërë nga folje gjysëmndihmëse +folje në mënyrën lidhore, p.sh.: filloi të ndërtojë, u vu të vërente; soste tu punue, mund të kapet, don të zhduket, duhej të rrahte në makinë. Vihet re edhe ndërtimi me dy folje (e para në kohët e përbëra të mënyrës dëftore dhe e dyta në mënyrën lidhore) në funksionin e kallëzuesit të përbërë, p.sh.: kishte nxanë me heshtue, kishte nxanë të humbte, kam caktue me shkue etj. Kallëzuesit e përbërë i ndeshim edhe në shprehje frazeologjike: Mund tu kërcente delli për tu transferue. *Shpesh hasim në vepër edhe çifte antonimike në një sintagmë foljore si kallëzues homogjen. Kjo është e veçanta në prozën e Camajt, p.sh.: Të humbte e të fitonte, kthjellte e vrante, shkonin e vinin, shkel e shko, tue hy e tue dalë, herë fryhej herë zvogëlohej, çel e mbyll synin, ngriteshin e uleshin ndjesitë, etj.* Vihen re edhe çiftet sinonimike foljore: sillej e përsillej, hap e çel synin. Një pasuri të madhe gjuhësore në sistemin foljor të bazuar në folklorin e alpeve gege na tregojnë shprehjet foljore: E kish pas qitë cekën, banin be e rrëfe, ia kish qëllue pikë, marrin kallë, për të qitë poshtë, kishte qitë në dritë, ngrehin veshët, të lëshonte hije mbi dhe', u rroku syni, etj.

Camaj me larminë gjuhësore të pasqyruar në vepër i dha jetë gegërishtes së shkruar, të fjetur prej kohësh, duke shpalosur vlerat e këtij thesari shpesh të pazëvendësueshëm prej dialektit tosk. Format foljore paraqesin një sistem të zhvilluar të gegërishtes, i cili mbulon çdo formë

foljore të gjuhës standard. Përdorimi i paskajores, si e veçantë e gegërishtes, tregon përsëri për vlerën shprehëse e larminë e formave që ka ky dialekt në përcjellje të ndjenjave e ideve. Ruajtja e fomantit -UE të pjesores gege të foljeve tregon për lashtësinë e këtij dialekti përpara se grupi zanor -UE të kthehet në -UA në gjuhën standard. Camaj si letrar e gjuhëtar na sjell me veprat e tij jo vetëm vlera artistike, por edhe gjuhësore në trajtimin e gegërishtes drejt standardizimit të saj për të ndihmuar të gjithë ato krijues, që duan ta përdorin në veprat e tyre dialektin e gegërishtes, por edhe studiuesve të historisë së gjuhës si bazë shkrimore e një zhvillimi gjuhësor.

Considerations on the verb system of a literary writing of Martin Camaj

This article aims to evidence some of the innovations in the verb system. Martin Camaj makes an inter dialectic approach. He uses overabundant tenses of demonstrative and admirative moods. The subjunctive mood is widely used in all its tenses. The unexplained forms: negative, gerundive, infinitive are presented in two moods. He uses the gege infinitive that may not be replaced with the forms of subjunctive or with the standard infinitive. From the word formation point of view, Martin Camaj uses simple verbs, compound and derivative.

**Alketa KRAJA, Valbona SAKEJ,
Albana KALOSHI (Shkodër)**

FENOMENI I MËNJANIMIT TË SË ASHTUQUAJTURËS NYJE E PËRPARME TE CAMAJ

Duke studiuar sistemin emëror të romani “Rrathë” na ra në sy një *fenomen të cilin do të donim ta sillnim në vëmendje*. Është fjala për mënjanimin e së ashtuquajturës nyje e përparme nga Camaj sidomos të përemrat, të gjinorja e emrit e të mbiemrat prejfoljorë.

Nyjat janë morfema që qëndrojnë në ballë të disa fjalëve ose formave të fjalëve të eptueshme. Ato janë kryesisht morfema trajtëformuese, por shërbejnë edhe për të formuar fjalë të reja...
...Si morfemë fjalëformuese (duke qenë njëherazi edhe trajtëformuese) nyja shërben për të formuar mbiemra nga pjesë të ndryshme të ligjëratës, qoftë vetëm, qoftë në bashkëveprim me prapashtesa e parashtesa.²⁹⁶

Çështja e nyjave e në veçanti e së ashtuquajturës nyje e përparme është akoma e hapur për diskutim në gjuhësinë shqiptare. Kompleksiteti i saj vjen si pasojë e mospërcaktimit përfundimisht të funksionit që ajo ka si dhe të origjinës dhe të përcaktimit të kohës së formimit të saj në raport me nyjen e prapavendosur.

Nga pikëpamja diakronike studiuesit janë ndarë në dy grupe në lidhje me origjinën e saj. Në grupin e parë hyjnë ata gjuhëtarë që përkrahin tezën se nyja e prapme ka dalë nga nyja e përparme. Në gjysmën e dytë të shekullit të kaluar përfaqësues të saj janë: Pedersen (1894, 248v. dhe 1900, 311), Selman Riza (1958, 11v., 27) dhe Besim Bokshi (1980, 328vv) etj.

²⁹⁶ Gramatika e Gjuhës Shqipe, A.SH., Tiranë, 2002, f. 48-49.

Teza tjetër përfaqësuar nga Çabej (1963,78v) dhe me pas përkrahur nga Demiraj (1986,331vv) konsiston në mendimin se “postpozicioni i artkullit është më i vjetër se pozicioni proklitik dhe ky i fundit ka rrjedhur prej atij në ngërthim të fjalisë me anë të një përshtatjeje”

Nga pikëpamja sinkronike, ndryshe nga nyja e përparme e gjuhëve të tjera i.e. si gjermanisht, frengjisht, italisht, ku shërben si mjet që ndërton kuptimin gramatikor të shquarsisë, nyja e përparme e shqipes në përdorime të ndryshme shfaq funksione të ndryshme.p.sh.

- Në gjinore ajo shërben si mjet për ndërtimin e formës rasore dhe nuk ka aspak kuptimin gramatikor të shquarsisë pasi përdoret në të dy trajtat.Ajo bën lidhjen me emrin para me të cilin përshtatet në gjini e numër.
- Tek emrat e ditëve të javës apo te përemrat e tipit *i tillë* apo *i cili* ajo është një morfemë e një tipi të veçantë që nuk ka mëvetësi.
- Tek emrat e farefisnisë ajo merr kuptimin e përkatësisë dhe jo të shquarsisë.

Vetë Camaj kur sqaron përdorimin e nyjes në “Gramatikën e shqipes” shprehet: “Ka një tendencë që nyjet e përparme **i** dhe **e** të vetme të shihen si përemra pronorë, kështu që termat e marrëdhënieve familjare të Klasës së parë po kthehen ngadalë por plotësisht të integruar: nip-i, mbesë-a..”²⁹⁷

Ndërsa për nyjen e përparme të emrave abstraktë dhe ditëve të javës(Camaj për këto thotë se vijnë nga sintagmat: dita e hanë etj.²⁹⁸ dhe mbiemrave e pjesoreve të emëruara ai shprehet se nyjat e përparme të tyre nuk kanë një funksion përcaktues dhe sillen si formante të fjalës –si parashitesa-pavarësisht formave të pandryshuara²⁹⁹.

Tek emrat e farefisnisë të tipit *i shoqi, e shoqja, e ama* në përdorimet pa nyje të përparme ndryshon kuptimi (shoq-i, shoqe-ja, amë-a). E njëjta gjë ndodh edhe me emrat zot-i e zojë-a përkundrejt *i zoti, e zoja* ku

²⁹⁷ “Albanian Grammar”, Camaj, M. , 1984, f.38.

²⁹⁸ “Albanian Grammar”, Camaj, M. , 1984, f.40.

²⁹⁹ “Albanian Grammar”, Camaj, M., 1984, f.38.

koncepti ka lidhje më shumë me pronësinë sesa me marrëdhënien (krhs: *i zoti i shtëpisë, e zoja e shtëpisë me i zoti i kalit, e zoja e punës.*)³⁰⁰

Në lidhjet sintagmatike të tipit *frymë të ftohti* Camaj thekson se nyja të nuk duhet marrë si një morfemë lidhëse ndërmjet elementit të parë e të dytë, por duhet konsideruar si një përbërës i pandarë i *ftohtë*.

Mundet që si pasojë e këtij kompleksiteti funksional, apo për ndonjë arsye tjetër që do mundohemi ta sqarojmë më poshtë, te Camaj shfaqet një tendencë për shmangien e kësaj të ashtuquajture nyje të përparme.

Rastet kur haset shmangia e kësaj nyje janë:

1. Disa ndërtime të gjinore:

“...u përkul mbi tue iu rrasë ma afër tryezës së madhe kah Novelisti në kryet vendit e ia nisi të shfaqë me imtësi rreth ngjarjes...” (291)

“...së parit diktohet ma lehtë se kush asht ky që lot atje malit, dhe së dyti prapohej efekti i propagandës të pakënaqunve të brendshëm se gjoja sistemi qenka në rrezik...” (“Rrathë”, 23)

Një dukuri të tillë K.Topalli e quan: “dukuri që ka ndodhur me emrat e rasës gjinore, ku nyja e përparme shpeshherë nuk shfaqet kur ajo është e njëjtë me nyjen e prapme” duke e krahasuar me shembuj nga Formula e Pagëzimit, Budi e Bardhi.³⁰¹

Në një shënim të Gramatikës së tij vetë Camaj shprehet se ka një tendencë ndërmjet shkrimtarëve që në ndërtimet e tipit “*i një portofoli i të hollave të të vëllait*” të reduktohen nyja e përparme të dhe mbaresa –*t* si më poshtë “*i një(një) portofoli të hollave(t) të vëllait*”. Le të shpresojmë,- thotë ai,- që kjo tendencë të arrijë një përdorim të përgjithshëm.³⁰² Kjo vërteton shmangien e qëllimshme nga ana e Camajt të nyjave në rastet e sintagmave me tre elemente.

2. Te përemrat pronorë:

“Por shikuesi i rendomëtn para saj humbte me fantazi në mote dhe mbeste para shprehjes saj tmerruese i shtangun” (“Rrathë”,11)

³⁰⁰ “Albanian Grammar”, Camaj, M.,1984, f.39.

³⁰¹ “Nyjat e shqipes”, Topalli, K., Tiranë, 2009, f. 159.

³⁰² “Albanian Grammar”, Camaj, M., 1984, f.44.

Në këtë rast mund të jetë pikërisht ai fenomen që Fatmir Agalliu e quan “...tërheqje të saj (nyjes- sh.ynë) nga trajta homorfone e mbaresës shquese dhe me shkrirjen e tyre në një trajtë të vetme...”³⁰³

3. Te përemrat e pacaktuar

“...pa fjalë tjera ata iau mbathën kambëve përpjetë, njëherë sa për të zbulue vendin...” (“Rrathë”, 7)

“Këto ishin plot e përplot me vargje duhani, qepësh e *perime tjera* vjeshtore...”(90)

“Si kokrrat në shegë janë të kapun e rrinë në heshtje; edhe dhia putë fshehet në tufë *përmbas tjerave*...” (105)

“*Pyetjeve tjera* rreth Qytecës e shtëpive rreth e rrotull Rapsodi s’iau vuni veshin e la t’i marrë era pa u dhanë përgjigje” (119)

Një sqarim për këtë përdorim që tregon paqëndrueshmëri të nyjes së përparme para përemrit të pacaktuar *të tjerë* mund jetë ai që K.Topalli e lidh me moshën e re të saj.³⁰⁴

4. Te mbiemrat prejpjesorë

“Rruga e plajtë në fillim erdhi tue u ngushtue gjithnjë e ma tepër mes dy mureve të gjana, *veshë* në lerth e lëmashk.” (8)

“Mbas derës që të shpie në dhomën e pritjes Folkloristi kishte vendosë një vigël fëmijësh, *gjetë* dikund ndër viset jugore të dheut të tij” (9)

“Në të ishin të rreshtueme dy vargje papuçesh, *sosë* për bukuri prej zejtarësh qytetarë aty e pesëdhjetë vjet ma parë” (9)

Mundet që një zgjedhje e tillë me përdorimin e pjesores bëhet për të theksuar tiparin kallëzuesor të këtyre mbiemrave, apo si një prirje për sintetizëm.

Prirja për sintetizëm bie në sy edhe në përzgjedhjet që Camaj bën në sintagmat e tipit “*ecte maje gishtave*” apo “*më shihte kokërr ndërsy*” në vend të “*ecte në majë të gishtave*” e “*më shihte në kokërr të syrit*”.

Me këtë prirje argumentojmë edhe shmangien e përdorimit të mbiemrave të nyjshëm dhe përdorimin e ndajfoljeve nga të cilat këto emra rrjedhin në

³⁰³ “Çështje të morfologjisë së gjuhës së sotme shqipe”, Tiranë, 1988, F. Agalliu, f.122.

³⁰⁴ “Nyjat e shqipes”, Topalli, K., Tiranë, 2009, f.154, fenomene që ajo shfaq.

fjalitë e tipit:

“Tash rri *qetë* dhe *dëgjo*”(224), “Zoga e kishte *vështirë*”(219) “Ajo e ka shumë ma *lehtë*”(265)

Shmangia e nyjes haset edhe në **numërorët** “Ishte rreth *njëzetave*”(235) dhe “Ai asht fëmijë gjithnjë edhe pse i kalue *tridhjetat*” (35), ku duket se Camaj nuk e sheh si të nevojshëm përdorimin e nyjes për të treguar tërësinë në rastet e moshës.

Kështu do arrinim në përfundimin se fenomeni i shmangies së nyjes te Camaj nuk është rastësor, pasi ai dëshmohet në gjinore, përemra, mbiemra e numërorë. Kjo shmangie mund të ketë lidhje me kompleksitetin që paraqet e ashtuquajtura nyje e përparme, me ndikimin e Camajt nga autorët e vjetër si dhe me prirjen për sintetizëm, por duhet theksuar se krahas këtyre formave të shmangies te Camaj haset edhe përdorimi i rregullt i nyjeve të përparme.

Vepra e Camajt është një hartë ku studiuesi i gjuhës mund të gjejë rrugën drejt zbulimit të thesareve që fsheh shqipja dhe meriton studime më të thelluara pikërisht në këto fenomene që ajo shfaq.

BIBLIOGRAFI:

1. “Rrathë”, Camaj M. München, 1978.
2. “Gramatika e Gjuhës Shqipe” A.SH. Tiranë, 2002.
3. “Albanian Grammar”, Camaj.M., 1984.
4. “Nyjat e shqipes”, Topalli, K., Tiranë, 2009.

The phenomenon of avoiding of the so-called frontarticles in the Camaj's works

Since the issue of so-called articles that go in front of a noun are still an open problem in the Albanian language, we thought that in this paper we should treat the phenomenon of these articles when they are non usable by using the works of Martin Camaj.

We will present examples taken from his works where we come across these non usable articles, as for example in: pronouns, possessive case, adjectives originating from verbs, ordinal numbers.

These non usable articles in the works of Camaj are not random, however it could be as a result of: the impacts of old authors, the complexity that characterizes the phenomenon or the tendency for synthetics.

Arjola HOTI, Aimir OSMAN (Shkodër)

RISITË NË GRAMATIKËN E VITIT 1984 TË MARTIN CAMAJT

Gjuha është një kërkesë e domosdoshme për një popull, e cila vjen e pasurohet pareshtur, sidomos nga kontributi i pashtershëm i shkrimtarëve që arrijnë të realizojnë një shkrirje të punës së tyre letrare me atë të fushës gjuhësore.

Të tillë personalitete të shquara që kanë hyrë në historinë shqiptare përmendim: Frashërin, Fishtën, Mjedën, De Radën, Kristoforidhin, Koliqin e në mes tyre edhe Martin Camaj.

Autori ynë fillimet e krijimtarisë i fillon me punime letrare, dhe i vazhdon më tej me ato gjuhësore.

Martin Camaj radhitet tashmë ndër albanologët më të shquar të shekullit të kaluar.³⁰⁵

Personaliteti i tij dëshmohet nga rruga që ndoqi, duke nisur nga formimi në kolegjin Saverian në Shkodër, në studimet në Beograd në vitet 1949-1955, dhe më pas me studimet pasuniversitare në Universitetin e Romës duke vazhduar me punën e tij si lektor i shqipes në katedrën albanologjike në Romë. Si temë disertacioni zgjodhi veprën e parë të gjuhës shqipe, “Meshari” i Gjon Buzukut. “Kontribute linguistike me një studim për origjinën e tyre”, duke u bërë shtysë kryesore për vazhdimin e studimeve gjuhësore. Me këtë studim autori shënon një hap në fushën e studimeve diakronike.

Camaj pëlqeu idenë të merrej me parahistorinë dhe historinë e shqipes. Këtë e dëshmon edhe vepra “Albanisch e Wortbildung. Die Bildungswese der olteren Nomina”, botuar më 1966.³⁰⁶

³⁰⁵ Petrit Kotrri, *Kontribute të Martin Camajt për historinë e gjuhësisë shqiptare*, “Shkodra në shekuj”, Shkodër, 2000, f.47.

³⁰⁶ Po ai , po aty, f. 48.

Kjo vepër u pasua me një sërë veprash të tjera në këtë fushë.

Ai dha kontributin edhe në fushën e etimologjisë, ku interesohet gjerësisht për gjenezën e gramatikës dhe varianteve morfologjike.

Njëkohësisht Camaj bën një ndryshim rrënjësor në fushën e dialektologjisë me kërkimet e tij në trevat arbëreshe, që e pasqyron edhe në monografitë e botuara “E folmja shqipe e Greçit”, “E folmja e Shën Konstantinit” e të tjera studime e monografi.

Përmendim edhe një varg recensionesh për vepra të ndryshme gjuhësore të studiuesve e dijetarëve shqiptarë apo të huaj.

* * *

Martin Camaj është hartues i një gramatike shqipe, duke zënë një vend të rëndësishëm në historinë e gramatologjisë shqiptare, me veprën “Gramatika e gjuhës shqipe, ushtrime dhe krestomaci.”

Në fillim kjo gramatikë botohet në gjermanisht me 1969 dhe 15 vjet më vonë, me 1984 në anglisht me titull: “Albanian Grammar with exercise, Greslomathy and Glossarris Wishaden 1984”, i cili konsiderohet si një botim më i plotë dhe më i gjerë.

Gramatika është përkthyer edhe në italisht nga Ardian Vehbiu, me 1995.

Martin Camaj e shkruan këtë gramatikë për studentët e degës së gjuhës shqipe të Universitetit të Mynihut, si dhe për shqiptarët e diasporës. Gramatika kishte karakter deskriptivist, dhe ajo studiohej jo vetëm në rrafshin sinkronik, por edhe në atë diakronik.

Vepra ka këtë strukturë të ndarë në tri pjesë: fonologji, morfologji dhe sintaksë. Përfshihet edhe një hyrje dhe parathënie. Në fund ndodhen krestomaci dhe fjalorthi.

Në hyrje ngrihet teza se gegërishtja kishte ndikuar direkt në gjuhën e shkruar, dhe se gjuha e mirëfilltë letrare ka filluar që me veprat e autorëve të vjetër Bogdani, Budi të cilët, sipas mendimit të Camajt, ishin mbështetur në dialektin e Shkodrës për të shkruar veprat e tyre.

Duke studiuar gramatikën e Camajt mund të dallohet pasuria në **rrafshin leksikor**, me përdorimin e fjalëve që ai i kishte trashëguar nga vendlindja, si: hep, i cokatun, mëngji, rëmore, tëbanë, i plajtë, grafulloj, kaptoj, etj.

Në këtë gramatikë autori u tregua prodhimtar, ku vihet re përdorimi i mjaft fjalëve të reja të krijuara nga vetë autori dhe që i përkasin tipave të ndryshëm fjalëformues. Ai u mbështet në gjuhën popullore, dhe përdor edhe ato elemente që përdoren edhe në gjuhën e sotme.

Nga këto krijime kemi më dendur fjalë të formuara nga prapashtesa si: kuvendar, keqësoj, gurishte, qëllimuj, rinoj, amësisht, tërbueshëm, trillueshëm, etj

Në ndonjë rast të izoluar Camaj ia ngjit prapashtesën edhe ndonjë fjale joshqipe si: profiloj.

Vepra shfaq vlera të plota duke u dhënë në tri variantet e shqipes, gegërisht (flasim për një gegërishte perëndimore, konkretisht të folmen e Shkodrës), toskërisht e arbërisht.

Vetë autori pohon: "... në këtë gramatikë paraqita në vija të përgjithshme rrugën dhe cakun ku ka arritur gjuha shqipe në tri variantet shkruese."

Pavarësisht faktit se Camaj u rrit në Temal të Dukagjinit, një zonë e ashpër në Veri të Shqipërisë, kjo nuk e ndaloi t'i, shmangej përdorimin të trajtave ndër-dialektore. Prandaj është cituar shpesh se "gegërishtja në këtë vepër paraqitet si gegërishte letrare e standardizuar".³⁰⁷

Përdorimi i zanores ë. Në pjesën ku trajtohen **dukuritë fonologjike** Camaj ndalet në trajtimin e disa shkronjave të gjuhës shqipe, sidomos të zanoreve, ku spikat përdorimi i zanores ë. *Ndryshe nga përdorimi nëndialektor i zonës së Veriut, autori zbaton rregullat drejtshkrimore të Komisionit Letrare.* Në ligjërimin e folur, si në Veri ashtu edhe në Jug, përdorimi i zanores ë është një çështje e trajtuar gjerësisht.

³⁰⁷ Bahri Beci, *Probleme të gjuhës letrare në etapën e sotme*, "Martin Camaj – Tradita dhe bashkëkohësia", Shkodër, 1994, f. 96.

Këtë problem e sheh edhe Camaj i cili mban qëndrimin e tij gjatë studimeve të veprave të autorëve të vjetër, sidomos të Gjon Buzukut e Pjetër Bogdanit.

Në gramatikë përdorimin e kësaj zanoreje Camaj e ruan jo vetëm në pozicionin fundor por edhe në trup të fjalës në fjalë të tilla: fëmijë, këpurdhë, vëlla, nëpunës, nxanës, kambë, bukë, etj.

Përdorimin e kësaj zanoreje në pozicionin fundor e gjejmë edhe tek disa emra të gjinisë mashkullore si lumë, kalë.

Veçojmë se Martin Camaj në botimin e tij nuk përdor theksin hundor, që siç duket, është karakteristike për shkrimet gege, gjë që e afron më afër standardit.

Sipas Kolec Topallit në vepër rrallë dallohen edhe përdorimi i theksave të tjerë, që i gjejmë te paraardhësit e tij, që shënojnë kuantitetin e zanoreve, duke dhënë një shembull të shkrimit të gegërishtes pa shenja.³⁰⁸

Në planin fonetik. Camaj bën një përpjekje për njësim e kodifikim në trajtat e përbashkëta fonetike në fjalët që përdor duke mënjanuar në shumë raste trajtat ndërdialektore.

Kështu autori ynë shkruan shikoj dhe jo shikjoj; gjysmë dhe jo gjysëm, dasëm dhe jo darsëm; ndaj dhe jo daj etj.

Gjatë vështrimit të paradigmes në këtë gramatikë vërehen edhe disa veçori fonetike me karakter morfonologjik.

Në disa folje të zgjedhimit të dytë që dalin me temë në –t dhe që e kanë asimiluar atë në –s, si në mbarë shqipen edhe te Camaj pësojnë metafoninë –a në –e. P.sh. *përkas-përket; godas- godet.*

Dukuria e metafonisë vihet re edhe në disa folje të zgjedhimit të dytë. P.sh. *dal-del; marr-merr;*

Njëkohësisht veçojmë zbërthimi i zanores –o- në togun zanor –ue-\-ua- në veten e parë njëjës dhe në vetën e tretë shumës. P.sh. *do – due\dua; thom – thue\thua.*

³⁰⁸ Kolec Topalli, *Vepra e Martin Camaj në aspektin gjuhësor*, “Martin Camaj –Tradita dhe Bashkëkohësia”, 1993, f. 88.

Edhe në **planin morfologjik** përpjekjet e Camajt për të sjellë risi duken në disa drejtime.

Për lakimin e emrit nuk ruan traditën. E ndan atë në dy klasa, duke u mbështetur në nyjat e përparme dhe të prapme që dalin gjatë lakimit. P.sh.:

	Klasa e parë.		Klasa e dytë.	
E .	mal-i	motr-a	I nip-i	e mir-a
Gj.	mal-it	motr-ës	të nipit	së mir-ës

Ndalet në studimin e shkallëve të mbiemrit, duke i kushtuar rëndësi skemave të ndërtimeve perifrastike.

Përsa i përket zgjedhimit të foljeve, autori bën një ndarje të mbështetur në temën e së tashmes, të së kryerës së thjeshtë dhe pjesores. Njëkohësisht Camaj i ndan foljet në dy zgjedhime që i quan klasa. Në klasën e parë përfshin foljet me temë në zanore, ndërsa në të dytën foljet që dalin me temë në bashkëtingëllore, p.sh.:

Klasa e parë. (Zgjedhimi i parë).

Tashme.	E kryer e thjeshtë.	Pjesore.
Jetoj	jetova	jetue
Dërgoj	dërgova	dërgue
Thyej	theva	thye
Rrëfej	rrëfeva	rrëfye
Shqyej	shqeva	shqye
Ndiej	ndjeva	ndie (ndier)

Klasa e dytë. (Zgjedhimi i dytë).

Tashme	E kryer e thjeshtë.	Pjesore.
Hedh	hodha	hjedhë (hjedhur)
Dredh	drodha	dredhë (dredhur)
Rjep	ropa	rjepë (rjepur)
Pjek	poqa	pjekë (pjekur)
Marr	mora	marrë
Avis	avita	avitë (avitur)

Në zgjedhimin e foljeve ndihmëse Camaj u largohet të folmeve dialektore. Përdor në vetën e parë shumës foljet me zgjedhim në –mi (*jemi\kemi*), që është formë e standardit të sotëm.

Edhe zgjedhimin e foljeve *due* dhe *mund* autori e jep në të dy trajtat, gegërisht dhe toskërisht. Sipas mendimit të Tomor Osmanit, Camaj i përzien dy trajtat e gegërishtes me toskërishten duke dhënë si formë primare për vetën e dytë dhe të tretë njëjës trajtat e standardit të sotëm, konkretisht *due, do(n), do(n), duem, doni, duen*.³⁰⁹

Ndërsa për zgjedhimin e foljes *mund* paraqet zgjedhimin në toskërisht, në kohën e pakryer, në formën: *mundja, mundje, mundte, mundnim, mundnit, mundnin*.

Në gegërisht paraqiten trajtat: *mujsha, mujshe, mujte, mujshin, mujshit, mujshin*.

Një veçori që bie në sy është se Martin Camaj kërkon që format e ngushta dialektore të mos mbisundojnë mbi ato më të përgjithshmet. Këtë veçori e vëmë re në të gjitha kohët e lidhore. Autori parapëlqen të përdorë *të dojë* në vend që *të dashtë*. Dhe format që janë më arkaike i shumon si variante të gegërishtes.

³⁰⁹ Tomor Osmani, *Tradita dhe e sotmja në vështrimin gjuhësor*, 3, Shkodër, 2009.

Njëkohësisht autori parapëlqen përdorimin e më se të kryerës së lidhore, përkundrejt paskajores së kryer, që është trajtë e vetme e gegërishtes. Sipar Kolec Topallit autori mund të ketë pasur dy burime ndikimi: letërsinë shqiptare bashkëkohore, që është shkruar mbi bazën e toskërishtes, si dhe autorët e vjetër të Veriut, gjuha e të cilëve për kohën kur u shkrua qëndronte më afër toskërishtes sesa sot.³¹⁰

* * *

Në përfundim mund të theksojmë se mjafton të shfletosh faqet e gramatikës të hartuar nga Camaj, për të kuptuar punën serioze që kryente kjo figurë e shquar në shërbim të kombit të vet, veçanërisht të vendlindjes së tij. Me përpjekjet e shumta për lëvrimin e çështjeve gjuhësore ai tregoi pikëpamjet e tij prej gjuhëtari, duke na lënë një vepër e cila paraqet vlera të dobishme dhe të shrytëzueshme në çdo studim.

The news of the 1984 grammar of Martin Camaj

The aim of this speech was to deal with some news of the 1984 Albanian grammar of Martin Camaj that is offered by him. It was noticed that this Albanian scholar is storm in a strong personality of the Albanian letters anociated with a rich culture. During the study it was noticed the descriptive character of the grammar and the richness of the lexic field in the usage of the different secitences. Special uses are the usage of the vowel ë and the codification of the common phonetic cases. We may say that Camaj can be the one of the first and most powerful Albanian scholars who toot the courage and attempted to show a standardized literary geg dialect. As for as morphology is concerned he brought the news or the case for the appereance of Adjective Degrees with schemes and the division of the verbs in two Conjugations.

³¹⁰ Kolec Topalli, *Vepra e Martin Camajt në aspektin gjuhësor*, “Martin Camaj-tradita dhe bashkëkohësia”, 1993, f. 88.

Majlinda BUSHAJ (Shkodër)

LËTËRKËMBIMI I MARTIN CAMAJT ME GJON SINISHTËN ³¹¹

Korrespondenca e Martin Camajt me mikun e tij të ngushtë, Gjon Sinishtën, daton nga nëntori i vitit 1981 deri në prill të vitit 1991. Ndër këto letra miqësore shpalosen në mënyrë të qartë shumë pikëpamje të Camajt për probleme sociale e kuturore të kohës, për problemin nacional të shqiptarëve të Kosovës etj, etj. Në këtë mes ne do të ndalemi e të sqarojmë vetëm njërin prej tyre, pikëpamjet e Martin Camajt për gjuhën letrare kombëtare, ose siç quhet sot “gjuha standard”.

Në letrën e datës 27 mars 1991, drejtuar Gjon Sinishtës nga Mynheni, Camaj do të shkruajë: “Prej 1952 e kam ndjekë kambë për kambë zhvillimin apo imponimin e tosknishtes si gjuhë zyrtare. Nuk kemi polemizue fort, por jemi përpjekë ta përfekcionojmë gegnishten, tue u mbështetë në tekstet e vjetra tona, tue i dhanë gegnishtes vendin që i përket në kurset universitare. Pa modesti e për hir të vertetës shfaqim se kontinuitetin e përdorimit të gegnishtes letrare në poezi, prozë artistike dhe ekspozitive ... mbas mbylljes së “*Shêjzat*” (1975) me plot vetëdije e çova përpara unë, vepra e fundit letrare në këtë variant të shqipes asht “*Palimpsest*” (München, New York, 1991). S’po hy me levdue veten në gjurmime gjuhësore, por po vë në dukje “*Albanian Grammar*”, që përdoret si tekst kudo në perëndim në mësimin e shqipes në universitete, bile edhe në Bashkimin Sovjetik³¹²”.

³¹¹ Ky letërkëmbim është botuar i plotë së pari në revistën “Hylli i dritës”, nr. 1-2, Tiranë, 1996.

³¹² “Hylli i dritës”, nr. 1-2, Tiranë, 1996, f. 76.

Nga kjo letër kuptojmë dy gjëra të rëndësishme. Së pari, Camaj “standardin“ e sotëm e emërton “toskërishte zyrtare“ dhe, së dyti, për këtë ”toskërishte“ ai përdor fjalën “imponim“, për të cilën nuk mund të bëhet asnjë koment, sepse thënia është krejt e qartë dhe e kuptueshme. Camaj nuk është kundër toskërishtes, as kundër përdorimit të saj, përkundrazi, ai ia njej të gjitha vlerat toskërishtes, por është kundër “imponimit” të saj si gjuhë letrare kombëtare. Ky është përfundimi i parë që del shkoqur e tepër qartë nga letra e mësipërme.

Çështja e dytë, po kaq e rëndësishme, është përpjekja e ndërgjegjshme e Camajt për ta ngritur gegërishten në rangun e një koineje letrare, për ta kthyer në një kryedialekt dhe për ta standardizuar atë. Dhe Camaj tani, jo vetëm me fjalë, por edhe me punë aktive, përpiqet t’ia arrijë këtij objektivit që i ka vënë vetes. Dhe këtë ai e ka shprehur krejt qartë në letrën që sapo lexuam.

Së pari ai mundohet të kodifikojë gegërishten letrare, së cilës i mungojnë manualët përkatëse të domosdoshme për këtë punë. Ai vihet e shkruan *Gramatikën* e tij, thjesht për këtë qëllim, të cilin e ka shprehur krejt qartë në letrën e mësipërme, ku thuhet se “*Albanian Grammar...* përdoret kudo si tekst në përfundim në mësimin e shqipes në universitete, bile edhe në Bashkimin Sovjetik”.

Së dyti, Martini punon me pikësynime të caktuara në veprat e veta, sidomos në prozë, ku përpiqet të japë modelin e një gegërishteje letrare sa më të arrirë, me përpjekjen për të dhënë gjedhen e një “standardi“ të gegërishtes. Dhe këtu duhet të ndalemi e të shpjegojmë për rrugët që ndjek ky për t’ia arritur këtij qëllimi.

Camaj, vazhdon rrugën e paraardhësve të tij gegë, që nga Komisia Letrare e Shkodrës, e cila punoi për afrimin e gegërishtes drejt një koineje të përbashkët. Pikërisht për këtë shkak në veprat e Camajt do të gjejmë përdorimin e diftongjeve *ue* etj., përdorimin e grupeve të bashkëtingëlloreve, përdorimin e *ë* atone edhe aty ku ajo nuk shqipohet fare.

Për të përforcuar mendimin tim, unë do të përmend këtu përfundimet e tre profesorëve të mi të nderuar, të cilët saktësojnë më tej sa thashë më lart .

Prof. Osmani do të shkruajë se “Veçori dalluese e veprës së Martin Camajt është aftësia për t’iu larguar të folmes së ngushtë të vendlindjes dhe për të shkruar një gegërishte me prirje afruese ... Kjo bie në sy në përdorimin e rregullt të zanores *ë*, që në nëndialektin veriperëndimor të gegërishtes ose ka rënë, ose është shndërruar në një zanore tjetër. Po kështu prof. Osmani do të shkruajë për trajtat e përbashkëta fonetike, ku Camaj mënjanon format dialektore (khs. Qenë, gjysmë, fytyrë etj)³¹³.

Akademiku, prof. K.Topalli, ndër tri tiparet themelore që dallon në gjuhën e veprave të M.Camajt, rreshton edhe “pasurinë e madhe leksikore“. E për aq sa i lejon një kumtesë, ai, me një vështrim panoramik, rreshton 47 fjalë të rralla³¹⁴, që Camaj i ka qëmtuar në vendlindje, si dhe 40 fjalë të reja (neologjizma) të ndërtuara me mjeshtëri me brumin e sipas gjedhes së shqipes, duke ndjekur kështu prirjen e përgjithshme të saj³¹⁵.

Prof.Luka, pasi rreshton fjalët e rralla, të nxjerra nga proza “Pishtarët e natës“, vë në dukje se Camaj “punon me logjikën e sistemin e një gjuhëtari, duke i kryer këto ndërtime në natyrën e gjuhës shqipe”³¹⁶. Nga proza “Pishtarët e natës” Luka do të rreshtojë rreth 300 fjalë të rralla, të cilat pasurojnë ndjeshëm jo vetëm gegërishten letrare, po gjuhën shqipe në përgjithësi, duke qenë ato ose fjalë që vijnë drejtpërdrejt nga populli,

³¹³ T. Osmani, *Çështje të shqipes së sotme letrare në Gramatikën e Martin Camajt*, në përmbledhjen “Martin Camaj – Tradita dhe bashkëkohësia”, Shkodër, 1994; *Martin Camaj dhe vepra e tij gjuhësore*, “Gjuha jonë”, nr. 1-2, Tiranë, 2000; *Vëzhgime gjuhësore për veprën e Martin Camajt*, “Shkodra në shekuj”, Shkodër, 2000; *Martin Camaj dhe Gramatika e gjuhës shqipe. Pikëpamjet për gjuhën letrare shqipe*, në përmbledhjen “Tradita dhe e sotmja në vështrimin gjuhësor”, Shkodër, 2009.

³¹⁴ K. Topalli, *Vepra e M.Camajt në aspektin gjuhësor*, në vëll. “Martin Camaj – Tradita dhe bashkëkohësia”, Shkodër, 1994 (*Emra: cakël, gorraç, gulf, gjamatar, hep, kularëz, lerth, lëpeth, lëpizë, lëpushtër, mëngji, mis, ngatërr, qezë, ravë, rëmore, rogë, spetull, strugë, shqekë, shqimth, tëbane, tutël, thrap, zhaurrimë; mbiemra: i cokatun, krekar, i lëbyrët, e lëkuqme, i plojtë, i thukët, i vishkullt; folje: grafulloj, hurp, kaptoj, lavar, mballoj, përdij, përspjet, syzoj, zbruj; ndajfolje: atëbotë, gjithnduersh, nergut, plym, prishakandas, strukshëm*). Khs. edhe rev. “Hylli i dritës”, nr. 1-2, 1994, f. 28 v.

³¹⁵ K. Topalli, *Vepra e Camajt...*, po aty, f. 87.

³¹⁶ D. Luka, *Studime gjuhësore VIII*, Shkodër, 2003, f. 57.

deri tani të panjohura, ose neologjizma, të krijuara nga vetë Camaj, gjithsesi në vazhden e në natyrën e gjuhës shqipe, të cilën ai e njeh me themel.

Si përmbyllje mund të themi:

1. M. Camaj gjuhën e sotme shqipe apo “standardin“ e barazon me “toskërishten“. Për këtë “toskërishte“ ai nuk jep anjë mendim .
2. Standardin e sotëm (pra “toskërishten”), si gjuhë të përgjithshme letrare, ai e sheh si “imponim”.
3. Vetë Camaj punon në mënyrë të ndërgjegjshme për gegërishten letrare, për ta ngritur atë në një koine e në rangun e një kryedialekti. Këtë punë ai e kryen mbështetur në traditën e pasur të gegërishtes, duke nisur me autorët e vjetër të shqipes, nën frymën e rilindasve e në vazhden e Komissisë Letrare të Shkodrës.
4. Mendimi se M. Camaj, në veprën e vet letrare, apo në *Gramatikën*, paska punuar për afrimin e gegërishtes me gjuhën e sotme standard, është i paargumentuar, i pambështetur, e sipas nesh, edhe i gabuar.

**Correspondence
Martin Camaj with Gjon Sinishtën**

In this work the author treats the correspondence of Martin Camaj with Gjon Sinishta, particularly concerning to the problems of standard literary language.

The author concluded that:

1. M. Camaj is equating the nowadays Albanian language or the Standard Albanian language to the “toskerishte”, but about this “toskerishte” he does not give any opinion.

2. The actual standard (Toskerishte) is seen as an imposed general literary language.
3. Camaj himself works consciously with the literary Gegerishte to rise it in the highest level of a primary dialect. This work is done utilizing and supporting on the wealthy tradition of Gegerishte, considering the old writers of Albanian language, being inspired by the works of renaissance period and then of Shkoder Literary Commission.
4. According to her, the consideration that Martin Camaj on his literary work has tried to approach the Gegerishte to the Actual Standard Language, is not reasonable, unfounded and even wrong.